

ENVER HOXHA

VEPRA

24

PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SIIQIPĒRISE



E N V E R H O X H A

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

24

NENTOR 1962 - MAJ 1963

SHTËPIA BOTUESE «8 NENTORI»
TIRANE, 1977

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 24-t

Vëllimi i 24-t i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin dokumente që i përkasin periudhës nëntor 1962 - maj 1963. Shumica e këtyre dokumenteve botohen për herë të parë.

Veçori dalluese e kësaj periudhe në frontin e brendshëm ishte vazhdimi dhe rritja gjithnjë e më shumë e mobilizimit të masave punonjëse me klasën punëtore në krye për të mbyllur me sukses planin e viti 1962, viti i dytë i pesëvjeçarit të tretë. Ky mobilizim erdhi duke u rritur dhe arriti kulmin për ndër të festave të 28 e 29 Nëntorit, 50-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe 18-vjetorit të Çlirimtë Atdheut. Vëllimi hapet pikërisht me dy materiale që flasin për këto festa të shënuara në historinë e popullit tonë.

Në dokumentet e këtij vëllimi pasqyrohet lufta e paepur dhe vendosmëria revolucionare e Partisë dhe e popullit tonë për të zbatuar deri në fund vendimet historike të Kongresit të 4-t, si dhe një varg detyrash që kishin shtruar plenumet e Komitetit Qendror të PPSH në lidhje me realizimin e planit të viti 1963, për preqatitjen dhe kualifikimin e kuadrove, për intensifikimin e bujqësisë etj. Në luftë për të vënë në jetë këto detyra, Komiteti Qendror i PPSH theksonte që të forcohej kudo roli udhëheqës i organizatave-bazë të

Partisë dhe të aktivizoheshin më gjallërisht organizata e masave; të luftohej vazhdimisht për kalitjen ideologjike të komunistëve, të kuadrove e të punonjësve, që këta të vepronin kurdoherë si revolucionarë në çdo sektor; të punohej me këmbëngulje për të kaluar nga një bujqësi ekstensive në një bujqësi intensive, duke zbatuar një agroteknikë moderne, me qëllim që të rritej vazhdimisht prodhimi bujqësor; të luftohej për plotësimin e planit në industri, sidomos për pakësimin e importit e shtimin e eksportit me artikuj të një cilësie të larië etj.

Materialet që botohen në këtë vëllim përbëjnë një tablo të qartë të punës vetëmohuese të popullit tonë në një periudhë të vështirë por të lavdishme. Në ato kushte të rënda të rrëthimit e të bllokadës së egër ekonomike imperialisto-rezisioniste, shkëlqeu edhe një herë uniteti i çeliktë i popullit tonë rrëth Partisë dhe Komitetit Qendror të saj me shokun Enver Hoxha në krye. Forcimi gjithnjë e më shumë i këtij uniteti mbetej kurdoherë garanci e sukseseve dhe e fitoreve tona. Në fjalën e tij të mylljes mbajtur në Plenumin e 9-të të Komitetit Qendror të Partisë që botohet në këtë vëllim, shoku Enver Hoxha thëksonte se «... armiku bën të gjitha përpjekjet që të gjejë ndonjë të çarë midis nesh, prandaj të mos lejojmë të ndodhë asnjë e çarë, sado e vogël, por ta ruajmë dhe ta çelikosim gjithmonë unitetin tonë».

Duke lexuar shkrimet e këtij vëllimi çdo njeri shch edhe një herë luftën e madhe të Partisë e të popullit për të forcuar vazhdimisht preqatitjen ushtarake për mbrojtjen e vendit. Detyra që shtronte Partia ishte përvetësimi sa më i mirë i armëve moderne që dispo-

nonte shteti ynë, njohja jo vetëm nga ana teknike, por edhe nga ana teorike e efektit dhe e përdorimit politik e praktik të tyre. Pregatitja politiko-ushtarake e forcave të armatosura kishte rëndësi të madhe, sepse në luftë roli vendimtar i përket njeriut. Komiteti Qendror theksonte që organizatat e Partisë në ushtri të bëheshin një bërthamë e çeliktë.

Në frontin e jashtëm PPSH vazhdonte të ndiqte një politikë parimore. Vija e saj e drejtë duket si një fill i kuq edhe në një sërë materialesh të këtij vëllimi. Në artikullin me titull «N. Hrushovi përsëri në rolin e demagogut, shpifësit dhe përçarësit» që botohet në këtë vëllim, demaskohet edhe një herë taktika e vjetër e N. Hrushovit, e sulmeve, nga njëra anë, dhe e mashtimit të opinionit publik, nga ana tjetër, hidhet poshtë, përveç të tjerash, parulla e tij për «unitet në lëvizjen komuniste». Me këtë parullë ai donte të tërhiqte pas vetes disa parti, të mashtronte komunistët e popujt, të bënte demagogji, të arrinte që të pushohej lufta kundër grupit të tij. Në këtë artikull shoku Enver Hoxha, midis të tjerash, theksonte: «Ç'kërkon N. Hrushovi? Mos vallë që ne të mbyllim gojën e të heshtim, kurse ai të vazhdojë të diskreditojë, të shpifë dhe të veprojë në dëm të PPSH e RPSH? Kjo është e papranueshme». Uniteti mund të vendoset vetëm mbi baza revolucionare, pa revizionistë dhe kundër revizionistëve.

Në këtë vëllim botahen edhe dokumente të tjera me të cilat demaskohet tradhtia e grupit të N. Hrushovit dhe e revizionistëve të çdo ngjyre. Të tilla janë «Vërejtje mbi terat e Kongresit të 10-të të Partisë Komuniste të Italisë», ««Kali i Trojës» vazhdon veprimta-

rinë e tij në shërbim të imperializmit amerikan» etj.

Krahas luftës parimore kundër revizionizmit modern, PPSH vazhdoi me konsekuençë edhe lustën kundër imperializmit. Në veprat e shokut Enver Hoxha që botahe në këtë vëllim, vihet në dukje edhe një herë se revizionistët modernë po afrohen gjithnjë e më shumë me imperializmin, se «imperializmi amerikan po fut në rrjetën e tij revizionistët sovjetikë», se ai «nuk ka ndërruar as thelbin, as qëllimet», dhe «kërkon të kthejë prapa rrotën e historisë». Për këto arsyen PPSH forcoi edhe më tepër luftën politike dhe ideologjike për demaskimin e imperializmit dhe të revizionizmit.

Kundrejt veprimtarisë thallisht reaksionare të imperializmit dhe të revizionizmit duhet të mbahet qëndrim: ose të pajtoheshe me ta, ose të luftoje kundër tyre. Partia jonë vazhdoi rrugën që kishte nisur me kohë: luftë pa asnjë lëshim si kundër imperializmit, ashtu dhe kundër revizionizmit modern. Kjo dhe vetëm kjo ka qenë dhe është rruga e fitoreve tona revolucionare, rruga e mbrojtjes së vërtetë të revolucionit proletar, të socializmit, të marksizëm-leninizmit.

Dalja në qarkullim e vëllimit të 24-t të Veprave të shokut Enver Hoxha u jep mundësi komunistëve dhe punonjësve të vendit tonë të kenë në duar një armë të re ideologjike. Në këto shkrime ata gjejnë mësimet e vlefshme që ndriçojnë rrugën për zgjidhjen e problemeve të ndryshme politike, ideologjike, ekonomike, organizative, ushtarake etj. Aktualisht duke studiuar këtë vëllim ne armatosemi edhe më mirë për të luftuar në jetë si revolucionarë, për të kryer me sukses detyrat e mëdha që caktoi Kongresi i 7-të historik i PPSH.

GEZIM I MADH PËR POPULLIN SHQIPTAR QË FESTON SOT DY NGJARJE TË MËDHA

Fjala e hapjes në mbledhjen e përbashkët të Byrosë Politike të KQ të PPSH, të Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH, mbajtur në Vlorë me rastin e 50-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe 18-vjetorit të Çlirimit të Atdheut

26 nëntor 1962

Të dashur shokë,

Mbledhjen e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, të Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH e deklaroj të hapur.

Sot, si i gjithë populli shqiptar, ne ndicjmë në zemrat tonë një krenari të ligjshme dhe një gëzim të papërshkruar, sepse festojmë dy nga datat më të lavdishme të historisë së popullit tonë, 50-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare dhe 18-vjetorin e Çlirimit të Atdheut nga pushtuesit fashistë dhe tradhtarët e vendit.

Këto dy ngjarje historike neve na kujtojnë luftërat legjendare të popullit shqiptar që nga shekujt e kaluar

e gjer në ditët e sotme, luftërat e pandërprera kundër armiqve të shumtë, të egër dhe të armatosur gjer nă dhëmbë, që kishin për qëllim copëtimin e Shqipërisë dhe zhdukjen nga faqja e dheut të popullit shqiptar. Por, megjithëse populli ynë ishte një popull i vogël, ai kurdoherë i theu armiqtë dhe doli në dritë.

Duke përkujtuar këto dy data të mëdha neve na bien ndër mend luftërat e popullit shqiptar me heroin e madh legjendar, Skënderbeun në krye, na bien ndër mend luftërat e popullit tonë gjatë kohës së pushtimit turk, luftërat e sakrificat e popullit tonë me rilindasit në krye, përpjekjet dhe zotësia e Plakut të madh të Vlorës, na bien ndër mend luftërat heroike të popullit të Shqipërisë, Lufta e Vlorës më 1920, na kujtohet pushtimi fashist italian i 1939-s, kur i gjithë populli shqiptar u ngrit në këmbë. Gjithashtu, neve na kujtohet themelimi i Partisë sonë heroike Komuniste të Shqipërisë, që ngriti peshë gjithë popullin shqiptar me armë në dorë në kryengritje të përgjithshme të armatosur, në sulm kundër pushtuesve dhe tradhtarëve, na kujtohen trimëritë legjendare të partizanëve, luftërat dhe përpjekjet e popullit shqiptar gjatë këtyre 18 vjetëve, djesa dhe mundi i tij, zotësia e tij, nën udhëheqjen e Partisë, për ndërtimin e jetës së re, për ndërtimin e socializmit.

Ja përsë populli shqiptar ndien një krenari të ligjshme, një gjëzim të papërshkruar në zemrën e tij. Prandaj ne sot përulemi me nderim dhe me respektin më të madh përparrë heronjve të popullit të shekujve të kaluar dhe të ditëve tona.

Në këto ditë solemne ne betohemi se populli ynë,

nën udhëheqjen e lavdishme të Partisë së Punës të Shqipërisë, duke qenë i bashkuar si një trup i vetëm rrëth Partisë së tij, do të ecë kurdoherë përpara për ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë, për mbrojtjen e kufijve të atdheut, për mbrojtjen e nderit, të gjakut, të zakoneve, të gjuhës sonë amtare, për mbrojtjen e të gjitha fitoreve të tij dhe se nuk do të lëmë armik që të guxojë të prekë Shqipërinë tonë të re dhe të fortë, që populli e ka ndërtuar me sakifica e heroizma të pashoqe.

Shokë, ne jemi veçanërisht të gëzuar që sot ndodhemi në Vlorën tonë kreshnike. Në këtë Vlorë u ngrit flamuri ynë kombëtar më 1912, në këtë Vlorë u zhvilluan luftimet më të ashpra më 1920 dhe armiku u hodh në det, në këtë Vlorë heroik, nën kushtimin e Partisë së lavdishme Komuniste të Shqipërisë, krisi rreptë pushka kundër pushtuesve fashistë italianë e gjermanë dhe kundër tradhtarëve. Dhe kjo luftë u zhvillua e furishme, në të katër anët e Shqipërisë, gjer në çlirimin e plotë të atdheut. Prandaj për të gjithë popullin shqiptar Vlora është bërë simbol i lirisë, simbol i heroizmave, simbol i vendosmërisë dhe i patriotizmit të flaktë.

Me këtë rast, duke falënderuar shokët e Komitetit të Partisë dhe të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Vlorës për mikpritjen bujare që na bënë, këtçj, nga kjo mbledhje, ne i drejtojmë popullit heroik të Vlorës përshëndetjet më të zjarrta të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH dhe i urojmë atij me gjithë zemër: gëzuar festat!

Të dashur shokë,

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë më ka ngarkuar t'u propozoj Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH dhe Këshillit të Ministrave të RPSH që, në shenjë nderimi dhe respekti për luftërat dhe fitoret e të parëve tanë që u kurorëzuan me sukses 50 vjet më parë, me Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare, të aprovojnë vendimet e mëposhtme:

1. — T'i jepet qytetit të Vlorës titulli i lartë «Qytet-Hero», duke marrë parasysh kontributin e lartë patriotik që ka dhënë populli i qytetit dhe i rrëthit të Vlorës në luftërat për pavarësi kombëtare e liri, duke marrë parasysh se Vlora kurdoherë, si në të kaluarën ashtu dhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ka qenë një nga vatrat kryesore të luftërave të popullit tonë, duke marrë parasysh se në Vlorë më 28 Nëntor 1912 u shpall pavarësia e atdheut tonë.

2. — Të ngrihet në qytetin e Vlorës Monumenti i Pavarësisë Kombëtare me qëllim që të përjetësohet ngjarja e madhe historike e 23 Nëntorit të vitit 1912.

3. — Patriotët e mëdhenj Ismail Qemali, Bajram Curri dhe Selam Musai të nderohen me dekoratën më të lartë të Republikës, «Hero i Popullit».

4. — Të krijohet një urdhër me tri klasa dhe një medalje «Për veprimtari patriotike» me qëllim që të dekorohen të gjithë ata që me punën e tyre, me armë e me penë, kanë kontribuar e kontribuojnë për çështjen tonë kombëtare.

5. — Të dekorohen me urdhra e medalje ata që i kanë bërë shërbime atdheut e popullit në luftën e tij

për pavarësi kombëtare, liri e përparim. Propozimet konkrete për dekorim që i janë paraqitur Presidiumit të Kuvendit Popullor për aprovim, të plotësohen më vonë me propozime të reja, në mënyrë që asnjë patriot e luftëtar i çështjes së popullit të mos mbetet pa underuar për kontributin që ka dhënë.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit»,
Nr. 283 (4441), 27 nëntor 1962*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

FRYTET E 28 E TË 29 NËNTORIT T'I GËZOJNË NË SHEKUJ NIPËRIT E STËRNIPËRIT TANE

*Fjala në pritjen e dhënë në Vlorë me rastin
e 50-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe
të 18-vjetorit të Çlirimit të Atdheut*

29 Nëntor 1962

Të dashur shokë e shoqë, miq dhe mysafirë,
Sot i madh dhe i vogël nü Shqipëri është në festë.
Zemrat e masave punonjëse gëzojnë për 50-vjetorin e
ditës historike të Shpalljes së Pavarësisë dhe për
18-vjetorin e ditës së lavdishme të Çlirimit të Atdheut.
Këto data të paharruara, të shkruara me gjakun e të
parëve dhe të luftëtarëve partizanë, janë të skalitura
në gjithçka që na rrethon sot në Republikën tonë të
fuqishme socialiste, në veprat madhështore të popullit
që udhëhiqet nga Partia heroike e Punës, në Vlorën
e re e të bukur, në ftyrat e qeshura të punëtorëve, të
fshatarëve e të intelektualëve, në zërat e gëzuar të fë-
mijëve dhe nü këngët revolucionare të brezit të ri.

Po të ndodheshin sot midis nesh patrioti i madh,
Plaku i urtë Ismail Qemali dhe tërë paraardhësit e pas-

ardhësit e tij të lavdishëm, që nga i pavdekshmi Skënderbe dhc deri te dëshmori që ra në përleshje me diversantët titistë e monarko-fashistë, do t'u ndritnin sytë, do t'u gufonte zemra nga kënaqësia kur të shihnin se mundi e gjaku i tyre nuk shkuan kot, se amaneti dhe ëndrrat e tyre u plotësuan.

Ne, shqiptarët, me të drejtë gëzohemi dhe krenohemi për rrugën që ndoqëm dhe që na solli në këto ditë të shënuara, sepse kjo s'qe rrugë e lehtë, rrugë e dredhive dhe e përuljes, e nënshtimit dhe e frikës para më të fortit, por rrugë e përleshjeve me armiqtë e egër të jashtëm dhe të brendshëm, të hapët dhe të maskuar, rrugë e çarë nga populli me gjoks, me mprehtësi e pjkuri të madhe politike, me penë, me pushkë në dorë, me gjak e sakrifica të panumërtë. Dhe për këtë arsy ne i nderojmë sot dhe përulemi me respekt të madh përra para kujtimit të të gjithë atyre që u shkrinë për Shqipërinë, për këtë arsy ua dimë vlerën aq mirë lirisë e të gjitha fitoreve tona, që i mbrojmë ato si sytë c ballit dhc që do t'i ruajmë e do t'i forcojmë në shekujt e ardhshëm.

Shumië u përpoqën hordhitë otomane ta fshinin nga faqja e dheut kombin tonë, emrin e shqiptarit. S'qenë të pakta në këtë drejtim përpjekjet e fuqive të mëdha imperialiste e të shteteve fqinje shoviniste gjatë shekullit të kaluar e gjatë gjysmës së këtij shekulli. Por të gjitha orvatjet e tyre dështuan, sepse Shqipëria ishte, ashtu siç është akoma më shumë sot dhe do të jetë në motet e pafund, një shkëmb i tillë që as e lëkund e as nuk e zhduk dot.

Kur retë e zeza të robërisë otomane mbulonin an-

kënd qielin e atdheut tonë, malet e Shqipërisë që nga Veriu e deri në Jug gjëmonin nga luftërat e popullit tonë heroik e të panënshtuar. Asnjëherë, që nga vdekja e Gjergj Kastriotit legjendar, s'pushuan të parët tanë së luftuari për liri. Gjyshërit tanë nuk ranë kurrë në grackën e të ashtuquajturave reforma turke. Prandaj për më se 30 vjet me radhë në mesin e shkullit të kaluar ata u ngritën me armë në dorë e nën udhëheqjen e trimave të vegjëlisë, të Gjolekës e të Rrapo Hekalit, të Binak Alisë e të Sokol Aramit, lufthan kundër pushtuesve turq dhe reformave të tyre të Tanzimatit.

Si pjellë e përpjekjeve shekullore të armatosura të popullit, si vazhdë e traditave të luftës për liri e pavarsi, si rezultat i zhvillimit politik, ekonomik dhe shoqëror të atëhershëm, lindën në mes errësirës së robërisë ato shkëndija që do ta ndiznin më të fuqishëm zjarrin e madh në zemrat e masave të zhuritura për liri — rilindasit tanë, mendimtarët dhe luftëtarët e mëdhenj, që gjithçka e shkrinë për kauzën e popullit. Ata, si bij të vërtetë të popullit, të frymëzuar nga ndjenjat dhe aspiratat më të shenjta të tij, të përshkuar nga ide demokratike, i dhanë lëvizjes për liri një platformë të qartë politike, një bazë të gjerë ideologjike.

Që nga shkrimet e Naum Veqilharxhit e të arbëreshëve, te kërkesat ekonomike e politike të Zef Jubanit, te programi i Lidhjes së Prizrenit, te vepra e Samiut «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhetë», te poezitë e zjarrta të Naimit, te veprimet e zgjuara e të guximshme të Ismail Qemalit me shokë, dhe deri te luftërat e çetave të lavdishme të armatosura të Themis-

tokli Gërmenjit, Spiro Bellkamenit, Çerçiz Topullit, De-dë Gjo Lulit, Isa Boletinit, Abdi Toptanit, Hoxhë Vokrit, Kamo Sejdinit e të tjerëve, kalon vija e mendimit politik dhe e aksionit revolucionar gjithnjë në zhvillim e në ngritje, që ata kanë pasur si objektiv lirinë e at-dheut, pavarësinë e tij të plotë e të pacunguar nga ana territoriale. Rilindasit ishin njerëz revolucionarë, optimistë, realistë, me zemër të zjarrtë, që i lidhnin ngush-të fjalët me veprat — karakteristikë kjo e mrekulluesh-me e të gjithë popullit tonë në çdo kohë dhe në çdo rrethanë.

Udhëheqësit rilindas ishin dijetarë të mëdhenj, shkencëtarë, shkrimtarë e diplomatë të zotë, njerëz me një filozofi të përparuar dhe me një kuptim të drejtë për luftën dhe për veprimet politike. Kjo është arsyesa që ata e ngritën popullin në luftë për liri e pavarësi në rrethana e kushte jashtëzakonisht të vështira e të rën-da, të brendshme e të jashtme, kur sundonin terrori e obskurantizmi shekullor otoman, kur ndiqeshin egërsisht nga armiqëtë dhe agjentët e tyre brenda, kur mbretëronte politika e djallëzuar «përça e suundo», kur fuqitë imperialiste luanin me fatet e popujve të vegjël, kur vetë pushtuesi turk ishte nën zjarrin e baterive diplomatike e ushtarake të të gjitha fuqive të mëdha evropiane. Në këto kushte e rrethana të rrezikshme ata u orientuan drejt dhe vepruan pa asnjë ngurrim, pa marrë parasysh vdekjen.

Ideja e madhe dhe kryesore e rilindasve, lidhur ngushtë me luftën e armatosur për çlirimin e popullit dhe pavarësinë e atdheut, ishte bashkimi i popullit dhe krijimi luftarak i unitetit të tij moralo-politik, duke

vazhduar kështu traditat tona të lashta e duke i ngritur ato më lart, në një platformë politike çlirimtare. Te bashkimi pa dallim feje dhe krahine ata shihnin bazën e vetme të luftës për çlirimin e Shqipërisë. Për realizimin e këtij qëllimi ata zgjodhën, si një nga hallkat kryesore, propagandimin e gjuhës së përbashkët shqipe, që është elementi i parë i kombit dhe përhapjen e diturisë, krahas luftës politike dhe luftës së armatosur. Ja pse lufta me penë e rilindasve mori një zhvillim aq të madh. Fjala e shkruar do të ishte ai rrip transmisioni i rëndësishëm për te masat, nëpër të cilin do të rridhën si përrua idetë çlirimtare dhe zjarri i pashuar i njerëzve më të përparuar të kohës. Ajo do të shpërndante errësirën e do të mbillte diturinë, do të zgjonte e kalitte ndjenjat kombëtare në zemrat e shqiptarëve, do t'i edukonte, do t'i lidhte e do t'i bashkonte më fort masat, do t'i hidhte ato në luftë për liri. Veqilharxhi e Jani Vretoja, Kristoforidhi e Pashko Vasoja, Jeronim de Rada e Sami Frashëri, Koto Hoxhi e Thimi Mitkoja, bibili i Shqipërisë, Naim Frashëri, dhe mësuesi i palodhur Petro Nini Luarasi, Luigj Gurakuqi e Mihal Gramenoja dhe shumë e shumë të tjerë, iu kushtuan me zjarr gjuhës shqipe, nxorën në dritë thesaret e saj, i kënduan asaj me ndjenja të forta dhe nëpërmjet saj mëmës Shqipëri, propaganduan dhe përhapën më gjerë shkrimin shqip. Në kushtet e terrorit otoman nuk ishte lehtë të bëje atë që bënë ata — të shkruaje, të shtypje e të dërgoje në Shqipëri mijëra abetare e libra të tjerë, të hapje shkollën e parë shqipe më 1887, të organizoje një Kongres të tërë si ai i Manastirit për caktimin e alfabetit unik shqip. Dhe të tëra këto patën pa dyshim

reperkusione të mëdha, të cilat gjetën pasqyrimin e tyre më të mirë në rritjen e vrullshme të lëvizjes revolucionare dhe të kryengritjes së armatosur.

Por rilindasit, duke luftuar për lirinë e Shqipërisë, luftonin në të njëjtën kohë për unitetin territorial të saj, sepse ata e panë mirë ç'rrezik të madh përfaqësonin në këtë drejtim lakmitë territoriale dhc aktet shoviniste barbare të fqinjëve grekë, serbë, malazezë dhe italianë, si dhe përpjekjet e fuqive të mëdha evropiane për copëtimin e atdheut të tyre që vazhduan pa ndërprerje e që vazhdojnë akoma edhe në ditët tona. Pikërisht për këtë arsy, në një moment shumë kritik, për të siguruar lirinë dhe unitetin territorial të vendit dhe si përgjigje kundër komplotit të Kongresit të Berlinit, u organizua më 1878 Lidhja historike e Prizrenit, me Abdyl Frashërin në krye.

Të paharruara do të mbeten betejat legjendare të shqiptarëve që për 3 vjet me radhë mbrojtën me gjoks Plavën e Gucinë, Hotin, Grudën e Ulqinin, duke u bërë kështu një sfidë të pashembullt fuqive perëndimore, që kishin vendosur t'ia shkëputnin ato Shqipërisë. Vështirë, shumë vështirë e patën patriotët tanë dhe në këtë drejtim. Prandaj për sigurimin e atdheut të tyre ata përdorën të gjitha mjetet, që nga armët e deri te veprimet e zgjaura diplomatike. Këto të fundit ata i praktikuin në rastet më të ndryshme, me qëllim që të manovronin në situatat e krijuara, të gjenin aleatë, të shfrytëzonin kontradiktat midis fuqive të ndryshme për shëmbjen e Turqisë, për shkatërrimin e komplateve të fuqive të huaja kundër Shqipërisë dhe për çlirimin e plotë të saj. Ismail Qemali qe një nga më të

shqarit, që ditë të kuptojë dhe, brenda mundësive e rrëthanave, t'i shfrytëzojë këto kontradikta. Por, me gjithëse u vuri shumë rëndësi kombinacioneve politike të jashtme, besim te fuqitë e mëdha imperialiste — që ata ta përkrahnin çështjen e Shqipërisë deri në fund, ai nuk pati. Dhe jeta më vonë vërtetoi se cilat ishin qëllimet e këtyre fuqive. Prandaj bazë për çlirimin e Shqipërisë ishte dhe mbeti, deri në fund, bashkimi dhe vëtë lufta e popullit shqiptar.

Një orientim me rëndësi të madhe i njerëzve të Rilindjes, që vërteton madhështinë, diapazonin e gjerë dhe përbajtjen e thellë revolucionare të lëvizjes sonë kombëtare, ishte synimi për ta lidhur luftën e popullit tonë me luftën çlirimitare të popujve fqinjë kundër armikut të përbashkët, ishte internacionalizmi i tyre. Sa herë ishte theksuar kjo gjë në shkrimet e Samiut, të Naimit e të Ismail Qemalit dhe në memorandumet e kryengritësve! Këtë shqiptarët u munduan ta realizonin më se një herë bile me gjakun e tyre në kryengritjet e Kosovës të viteve 70-të, gjatë krizës ballkanike e në ato të mëvonshmet, si dhe gjatë lëvizjes së Xhonturqëve, ku luajtën një rol të madh dhe i dhanë goditje të njëpasnjëshme Perandorisë Otomane, këtij burgu të vërtetë të popujve. Por pabesia u qëndronte kurdoherë e fshehur prapa krahëve luftëtarëve të mëdhenj shqiptarë. Reaksiuni shovinist serbo-malazez i kralëve etj. synonte me djallëzi ta copëtonte Shqipërinë dhe më në fund arriti të realizojë shkëputjen dhe robërimin e Kosovës. Shikoni tanë sadizmin e kralëve «modernë» titistë: s'ka disa ditë që Radio Beograd, me qëllim të keq kundër popullit tonë dhe për të gënjer popullin heroik

shqiptar të Kosovës, përmendte thirrjet internacionale të Naim Frashërit për bashkëpunim dhe miqësi me popujt fqinjë të Ballkanit kundër turqve, duke na i kundërvënë këto neve. Por Radio Beograd harroi të thoshte se si këto ndjenja të pastra e thirrje të zjarra të Naimit e të të gjithë shqiptarëve u hodhën poshtë me të pabesë dhe me egërsi nga shovinistët serbo-malazez, që i masakruan e i robëruan kosovarët dhe copëtuan Shqipërinë. Dhe kjo nuk është e rastit, këtë atyre s'u bën zemra ta thonë se vetë titistët janë pasardhës të denjë të kralëve. Kurse partizanët tanë, me ndjenjat fisnike të Naimëve, me porosinë e Partisë Komuniste të Shqipërisë në zemër, shkuan e derdhën gjakun e tyre për çlirimin e popujve të Jugosllavisë nga pushtuesit fashistë në shenjë miqësie dhe internacionalizmi të lartë. Partia dhe populli ynë ruajnë si thesar dhe trashëgojnë me besnikëri këtë traditë të mrekullueshme të të parëve tanë, ata e kanë ngritur atë në shkallën më të lartë, në atë të internacionalizmit proletar marksist-leninist.

Kryengritja me armë, siç dihet, është forma më e lartë e luftës së masave kundër çfarëdo shtypjeje. Dhe sa më e organizuar dhe e ndërgjegjshme të jetë ajo, aq më të mëdha janë dhe rezultatet. Në lëvizjen tonë kombëtare ka ekzistuar një proces i pandërprerë rritjeje — nga kryengritjet spontane në ato më të organizuarat e me program, nga ato sporadiket në ato më masivet e deri në kryengritjen e përgjithshme. Pjesëmarrja e gjerë aktive e masave fshatare në to u ka dhënë gjithmonë këtyre kryengritjeve një karakter kryesisht çlirimtar dhe me përbaltje sociale. Këto kryengritje vepruan

në prapavijat e Perandorisë Otomane si mina që, krahas faktorëve të tjerë, kontribuan në shembjen e saj graduale.

Që nga viti 1905 kryengritjet rriten e gradualisht bashkohen, sa në pranverë të vitit 1912 shndërrohen në një lëvizje të fuqishme të armatosur të udhëhequr nga patriotët e mëdhenj Bajram Curri, Hasan Prishtina, Luigj Gurakuqi, Themistokli Gërmenji etj.

50 vjet më parë, në ditët me shi e me borë të nënitorit, rrugë e pa rrugë, në male e në fusha të shkretuarë e të mbuluara me llucë, udhëtonte për në Vlorë Plaku i lavdishëm me flokët e me mjekrën e bardhë si bora, por me zemër si luani, me mendje të ndritur, me suqi të përtëritura sikur të ishte djalë, meqë mbante në gji shpresën e zjarrtë, aspiratën e madhe të shqiptarëve, ëndrrën e të parëve dhe fatin e të ardhmen e brezave të rinj të Shqipërisë. I mbështetur fuqimisht në kryengritjen e përgjithshme të armatosur e në vullnetin e delegatëve të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, Plaku Ismail Qemali kreuz aktin e shkëlqyer historik, duke ngritur më 28 Nëntor 1912 flamurin kombëtar në Vlorën heroike dhe duke shpallur Pavarësinë e plotë të Shqipërisë.

28 Nëntori i vitit 1912, 50-vjetorin e të cilit ne festojmë sot, ishte ngjarja më e shënuar pas afro 5 shekujsh robërie, kurorëzim i përpjekjeve e i luftërave të të parëve tanë për liri nga sundimi i egër dhe i urryer otoman. Ngritja e flamurit më 1912 kurorëzoi përpjekjet vigane të popullit shqiptar, ajo i tregoi popullit shqiptar se lufta e tij e armatosur, bashkimi i tij i çeliktë rrëth një qëllimi të madh, mbrojtja e mëmëdheut,

e nderit, e zakoneve, e gjuhës dhe e traditave fisnike të tij, mposhtën çdo pengesë, mposhtën armiqjtë e tij të fuqishëm, të egër dhe dinakë. Populli shqiptar u tregua i pamposhtur, u tregua trim, i zgjuar, i rreptë dhe i drejtë, prandaj fitoi dhe do të fitojë në shekuj kundër kujtdo, sado i madh e i fortë që të jetë ky, në rast se orvatet të cenojë të drejtat e tij sovrane. Vepër e Ismail Qemalit dhe e patriotëve të tjerë ishte një vepër e lavdishme historike që do të mbetet kurdoherë e pa-harruar. Ajo i tregoi mbarë botës se Shqipëria, që kontribuoi energjikisht në çlirimin e gjithë popujve të Ballkanit, jo vetëm ekzistonte, gjë që armiqjtë ishin përpjekur ta mohonin, por tanj ajo ishte edhe e lirë, e pavarur dhe se do të rronte e do të zhvillohej si një shtet më vete me qeverinë e tij. Le të theksojmë se po të mos ishte luftuar me atë furi dhe po të mos kryhej ai akt në ato kohëra të vështira kur bishat imperialiste po preqatitnin kasaphanën e Luftës së Parë Botërore, do të vështirësohej sigurimi i pavarësisë dhe ndofta tragjedi më të rënda do ta kishin pllakosur atdheun tonë.

Por kuptohet se vetëm me kaq nuk mjaftonte, me Shpalljen e Pavarësisë akoma gjithçka nuk ishte kryer, kjo fitore duhej konsoliduar me luftë të mëtejshme këmbëngulëse dhe me fitore të reja. Baza për një gjë të tillë ishin masat popullore, ishte forca kolosale që përfaqëson lëvizja e masave të gjera të vendit, prandaj tek ato duhej mbështetur në radhë të parë. Por feudalët tradhtarë, në bashkëpunim me fuqitë imperialiste, me ato fuqi që në Konferencën e Londrës të vitit 1913 copëtuan Shqipërinë, i vunë minat Qeverisë së Vlorës

dhe prapë re të zeza mbuluan qellin e Shqipërisë, e cila u bë preja e imperialistëve që preqatitën dhe filuan Luftën e Parë Botërore.

Dihet se si armiqtë e jashtëm e të brendshëm u përpoqën t'i shfrytëzonin fitoret e popullit tonë për qëllimet e tyre. Janë të njoitura dyndjet e ushtrive imperialiste gjatë Luftës së Parë Botërore në vendin tonë të porsaqiruar, si edhe pazarllëku i tyre i turpshëm i sanksionuar në Traktatin e Fshehtë të Londrës për copëtimin e plotë të Shqipërisë. Mirëpo, me gjithë kurthet e rrezikshme të njëpasnjëshme, është fakt se të gjithë ata hesapet i bënин kurdoherë pa hanxhinë. Është për këtë arsy që lufta për konsolidimin e pavarësisë dhe për ruajtjen e têrësisë territoriale vazhdoi pa ndërprerje të rritej e të merrte gjithnjë e më shumë një karakter sa më të theksuar revolucionar e masiv. Kongresi i Lushnjës hodhi poshtë me forcë Traktatin e Fshchtë të Londrës të denoncuar nga Lenini i madh, ndërsa fshatarësia revolucionare e Vlorës, me heronj të tillë si Selam Musain, i hodhi okupatorët italianni në det.

Në këto dhe në ngjarjet e tjera të mëvonshme një influencë të madhe ushtroi Revolucionari i Madh Socialist i Tetorit, që tronditi gjithë botën. Jehona e tij u përhap me forcë edhe te ne. Ju të gjithë i dini vlerësimet e mëdha për revolucionin dhe Leninin që bënин Bajram Curri, Mihal Gramenoja, Avni Rustemi dhe shtypi ynë përparimtar i atëhershëm. Idetë e revolucionit e të Leninit nisën të futen në masat. Prandaj dhe lëvizja popullore, e lindur nga kushtet e brendshme dhe e influencuar nga ato idë, u ngrit në një shkallë

më të lartë dhe arriti në pikën e saj kulminante me përpjekjet e revolucionarëve demokratë-borgjezë të udhëhequr nga Avni Rustemi dhe me revolucionin demokratiko-borgjez të 1924-ës. Goditja e këtyre patriotëve u drejtua kundër tregtarëve të flamujve, feudalëve e bejlerëve, me Zogun në krye, që nga njëra anë vazhdonin të komplotonin me armiqëtë e jashtëm, nga ana tjetër shtypnin e shfrytëzonin pa mëshirë popullin punonjës.

Por prapë s'ishte e thënë që populli ynë të shihte që në atë kohë ditë të mira. Vegla e imperializmit, kryefeudali Ahmet Zogu me ndihmën e jashitme e mbyti revolucionin demokratiko-borgjez. Ai e mbyti sepse ky revolucion nuk i zgjidhi detyrat që i kishte vënë vetes, u shkëput nga masat popullore dhe u minua nga feudalët të ashtuquajtur «patriotë». Pllakosën vitet e zeza të terrorit zogolian, të varfërisë, të urisë, të sëmundjeve e të kërbaçit, vitet e tratativave të ndyra me fashistët italianë që preqatitën terrenin e okupacionit të 7 prillit 1939.

Populli ynë s'u pajtua kurrë me regjimin tiranik të Zogut. Ja pse ky satrap s'gjeti asnjëherë rehat nga grevat, demostratat e kryengritjet e ndryshme, nga veprimet e revolucionarëve të vendit tonë. Ja pse nga gjiri i popullit të shumëvuanjtur dhe nga klasa jonë punëtore, sado e vogël në numër, lindën grupet komuniste. Megjithëse i shitur nga mbreti tradhtar, populli rrëmbcu armët dhe u rezistoi me heroizëm push-tuesve italianë. Ata u priten me pushkë kokës, populli u ngrit i gjithë në këmbë për luftën e tij më të madhe e më të lavdishme.

S'vonoi të vinte dhe dita kaq shumë e dëshiruar dhe e pritur nga populli. Në çastet e rënda të pushtimit të egër italian dhe të rezistencës popullore kundër tij, kur fashizmi kishte futur njerëzimin në Luftën e Dytë Botërore dhe hitlerianët sulmuan me të pabesë vendin e madh të sovjetëve, në çastet kur nga Sheshi i Kuq buçiste kushtrimi i Stalinit për t'u bërë varrin hordhive fashiste, komunistët shqiptarë themeluan Partinë e lavdishme Komuniste të Shqipërisë. Lindi ajo që i kishte munguar popullit në shekuj, lindi udhëheqësja e lavdishme revolucionare konsekuente, e armatosur me doktrinën më shkencore e të përparuar, trashëgimtarja e traditave më fisnikë të popullit tonë, ajo që do ta ngrinte peshë, do ta organizonte në luftë dhe do ta shpinte në fitore. Ne të gjithë jemi dëshmitarë të viteve heroike të Luftës Nacionalçlirimtare, të kësaj periudhe më të lavdishme në historinë e popullit tonë, që u kurorëzua me çlirimin e plotë të atdheut dhe vendosjen e pushtetit popullor.

Partizanët trima të Ushtrisë Nacionalçlirimtare kryen heroizma të padëgjuar. Në fillim, të zbatohur dhe të uritur, me armët që u rrëmbyen armiqve, ata kaluan në çeta shkrep më shkrep e mal më mal, duke i kthyer ato në kështjella, nga ku u dhanë goditje të furishme fashistëve e tradhtarëve. Më vonë, u organizuan në brigada, divizione e korparmata, u vërsulën si shqiponja nga të gjitha anët mbi hordhitë armike, duke i shpartalluar dhe duke i shporrur një nga një nga të gjitha krahinat e qytetet, deri përtëj kufijve të vendit tonë. S'mbeti pëllëmbë e tokës sonë pa u larë nga gjaku i dëshmorëve, s'mbeti skaj pa parë trimëritë legjen-

dare të bijve të popullit që sa e sa herë u hodhën me gjoks mbi mitralozat, topat e tanket e armiqve. Ishin vija dhe udhëheqja e drejtë e Partisë ato që çuan në këmbë një popull të tërë, që e frymëzuan atë për të tilla heroizma, ishin vija dhe udhëheqja e Partisë që e bënë atë të përballojë situatat më të vështira të armiqve të fortë e të djallëzuar, të luftojë pa asnjë kompromis me ta dhe të marshojë pa u ndalur drejt objektivave të qartë, drejt fitores mbi pushtuesit dhe mbi shtypësit, drejt së ardhmes së tij të ndritur. Vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë u rezistoi provave më të rënda të kohës dhe doli triumfuese ashtu siç do të triumfojë kurdoherë.

Nuk shkoi kot gjaku i bijve të Shqipërisë, i derdhur shekuj me radhë, nuk shkuan kot vuajtjet e sakrificat e panumërtë të popullit tonë, morën fund rënkimet e të shtypurve e të munduarve nga xhelatët profesionistë të vjetër dhe «modernë». Gjaku i dëshmorëve të kombit, gjaku i heronjeve të lavdishëm të Luftës Nacionalçlirimtare u bë dritë dhe përtëriti jetën e atdheut tonë të dashur. Për herë të parë qeshën buza dhe zemra e shqiptarit dhe paskëtaj ato do të qeshin sa të ketë jetë mbi dhë. Njëzet e nëntë Nëntori 1944 hapi epokën e re të historisë sonë të ndritur, atë të lirisë së vërtetë dhe të ndërtimit të së ardhmes së lumtur socialiste.

Madhështore dhe të pakrahasueshme janë realizimet e këtyre viteve, e ndritur është vepra e Partisë në shërbim të popullit. Shqipëria, nga një vend krejtësisht i prapambetur feudal-borgjez, ku regjimet tiranike e kishin lënë popullin në varfëri, në mjerim dhe në errësirë të pashembullt, është shndërruar në një

vend të fuqishëm socialist, ku është ndërtuar baza ekonomike e socializmit dhe tani po ndërtohet baza materialo-teknike e socializmit; ajo është bërë një vend me industri të zhvilluar dhe me një bujqësi kolektive, ku populli prodhon të mira të pallogaritshme materiale për lumenin e përmirësuar.

Pas Çlirimtari filloi dhe vazhdon të zhvillohet me vrell një revolucion i thellë kulturor, i cili likuidoi analfabetizmin, e mbushi atdheun anekënd me shkolla, me shtëpi dhe me vatra kulture, po çon përparrë me të shpejtë artet dhe shkencat, ka hapur për masat punonjëse të gjitha dyert e diturisë. Me përpjekjet e saj të palodhura Partia ka rritur një brez të ri të fortë e të shëndetshëm, të ngritur nga pikëpamja politike dhe ideologjike, që është trashëgimtar i denjë i të parëve dhe i prindërve të tij, shtyllë e fuqishme e Partisë dhe e popullit. Ose më mirë, shikoni Vlorën, këtë vatër të shquar të luftës përliri dhe përsocializëm, ku jehoi thirrja e Plakut të kombit dhe zëri i Selamëve të Labërisë, ku buçiten rrugët, kodrat e malet nga betejat e komunistëve dhe të partizanëve me armiqëtë e Partisë dhe të popullit, shikoni Vlorën se si është mbushur me qendra industriale dhe kooperativa bujqësore, me shkolla e godina madhështore, me parqe, lulishte e bulavarde të lulëzuara! Dikur me gjysmë opinge, sot populli i këtij rrethi u gëzohet fryteve të punës së tij, pasurive, jetës së tij të re. Kjo është në miniaturë e tërë Shqipëria jonë, që, nën udhëheqjen e Partisë sonë të Punës, ka çarë dhe pa u ndalur nga asgjë vazhdon të çajë përparrë drejt brigjeve të ndritura të komunizmit. Kjo rrugë e këtyre 18 vjetëve s'ka qenë e lehtë

dhe në të ardhmen gjithashtu s'do të jetë e lehtë. Por ashtu si kalitet hekuri në zjarr, ashtu i kaliti Partia njerëzit në beteja e në vështirësi dhc krijoj një njeri të ri, një njeri të tillë që s'ka furtunë e rrebesch që mund ta thyejë ose ta ndalë në rrugën e tij të drejtë. Shqipëria s'i ka ngjarë kurrë kënetës së fjetur, por lumenjve të rrjedhshëm malorë, të cilëve u ka bashkuar lumenjtë e gjakut e të djersës së popullit të saj.

Perspektiva të mrekullueshme janë hapur përpara popullit tonë, atë e pret një e ardhme gjithnjë më e lumtur, një e ardhme e ndritur. Shqipëria do të ecë përpara akoma më me vrull: do të zhvillohen më tej Industria, bujqësia, arsimi e kultura; atdheu do të mbushet me fabrika, kombinate e miniera të reja që do të prodhojnë mallra më të shumta, më të mira e më të lira; fushat dhe kodrat do të mbulohen akoma më shumë e më bukur me grurë, me pambuk, me duhan, me panxhar, me pemë, me vreshta etj.; do të ketë më shumë shkolla, teatro, kinema, libra, laboratorë. Partia ka vendosur që këto e mjaft të tjera të bëhen, dhe patjetër do të bëhen. Ato do t'i ndërtojë dhc do t'i krijojë populli ynë i lavdishëm, nën udhëheqjen e Partisë dhe do t'i gëzojë vetë.

Në këtë luftë dhe në këto përpjekje titanike u kalit dhc vetë Partia. Ajo grumbulloj një eksperiencë të madhe revolucionare, përballoj pengesa e vështirësi të panumërtë, dërrmoi armiq të egër, të hapët e të maskuar, që u përpoqën ta shmangnin nga rruga e drejtë marksiste-leniniste, iu përgjigj dhëmb për dhëmb çdo atentati dhe komploti të tyre për ta gjunjëzuar e për ta likuiduar, dhe u ngrit, e u ngrit vazhdimisht lart,

sa u bë një brigadë e fuqishme sulmuese, që marshon përpara në krye të popullit të saj drejt shtigjeve të socializmit e të komunizmit.

Partia jonë lufton me vctëmohim dhe heroizëm për forcimin e unitetit marksist-leninist dhe të miqësisë vëllazërore me vendet socialistë që përpinqen t'i minoj-në revisionistët e grupit Hrushov-Tito. Ajo dhe mbarë populli ynë janë të bindur dhe të vendosur se do të kapërcejnë çdo pengesë të revisionistëve modernë në këtë drejtim. Partia dhe populli ynë luftojnë me vendosmëri pér paqen, lirinë, demokracinë e socializmin, kundër imperializmit — armikut kryesor të njerëzimit, kundër neokolonializmit, fashizmit, revizionizmit — armiq të hapët e të maskuar të njerëzimit.

Ne jemi një vend socialist, që ndodhemi në një nga avanpostet më të rëndësishme, ballë pér ballë me imperializmin dhe të rrethuar nga vasalët e aleatët e tij. Republika jonë Popullore, një shtet evropian socialist, me një të kaluar të shkëlqyer, me një jetë prej 50 vjet si shtet i pavarur dhe sovran, nuk është lichtë të bëhet si dikur plaçkë tregu e fuqive imperialiste dhe e disa shteteve shoviniste që akoma kanë pretendime absurde t'i shkëputin ndonjë copë. Shqipëria e re, pér t'ua prerë oreksin çakejve të uritur që akoma s'kanë vënë mend, di të mbrohet, ka me se të mbrohet. S'ka dyshim që ka njerëz të cilët ëndërrojnë si dikur Elefter Venizellosi ndaj vendit tonë. Por, megjithëse edhe Elefter Venizellosi në kohën e tij kishte miq e dashamirës të shumtë imperialistë, megjithëse ai ishte një shërbëtor i verbër i mbretit të topave, Bazil Zaharovit, prapëseprapë Shqipërisë ia mori të keqen. Prandaj ka-

në shumë fakte për të reflektuar djemtë dhe nipërit e Venizellosit dhe miqtë e tyre, në qoftë se dëshirojnë të jenë më realistë dhe të ecin me hapin e kohës. Të njëjtin mësim duhet të nxjerrin dhe trashëgimtarët e kralëve të Serbisë dhe neofashistët e Italisë. Në qoftë se këta mendojnë se në kurrizin e Shqipërisë së vogël si territor e si popull mund të hedhin valle lirisht, në realitet këtë valle ata do ta heqin nën krismën e pushkës. Në qoftë se ata mendojnë se Shqipëria është e izoluar nga ndihma morale dhe materiale e popujve miq e aleatë dhe se aleancat e popullit shqiptar bazohen vetëm në disa fletë karte që mund t'i shkelin, ose mund t'i bëjnë të veprojnë në dëm të Shqipërisë nga grupe tradhtarësh, edhe këtu gabohen rëndë të dyja palët dhe do të ndodhen në kohën e duhur me shpatulla në mur. Pra popullin shqiptar dhe Partinë e tij të Punës askush s'i gënjen dot dhe askush s'është në gjendje t'i trembë.

Vendi ynë dhe kufijtë tanë të paprekshëm më se një herë janë bërë pengesë për bandat e hapëta e të maskuara të imperializmit dhe të pjellës së tij, revisionizmit modern, pengesë e pakapërcyeshme për realizimin e planeve të tyre djallëzore kundër Republikës sonë dhe çështjes së socializmit. Merrni për shembull Vlorën heroike. Siç dihet këtë imperialistët e kanë njuhur disa herë dhe nga kjo kanë kujtime të hidhura, që s'mund t'i harrojnë lehtë. Këtu kishte pikësynim të veçantë dhe Flota VI Amerikane me monarko-fashistët, titistët e disa tradhtarë, por Vlorës dhe tërë Shqipërisë ia morën të keqen. Po Vlorën e njohën dhe revisionistët e grupit të Nikita Hrushovit, që, duke na

grabitur një pjesë të mjetave mbrojtëse ushtarake, duke shkelur çdo akt e çdo marrëveshje zyrtare, pandehën se e lanë të çarmatosur para ujqve imperialistë dhe, pra, pandehën se e futën në dhë të gjallë atë dhe tërë Shqipörinë. Po Vlora dhe tërë Shqipëria rron e qëndron si shkëmb graniti që s'ë tund asnjë dallgë e stuhi, se këtu vigjilon sysiqponjë një popull që udhëhiqet nga Partia heroike e Punës, një popull që nuk është mposhtur mijëra vjet dhe që do të qëndrojë i tillë qindra mijëra vjet të tjera.

Ne shqiptarët jemi sa luftëtarë aq dhe punëtorë e paqedashës. Për paqen popujt duhet të luftojnë me të gjitha forcat dhe mjetet. Këtë bën populli shqiptar. Duhet të luftojmë për një paqe të ndershme, demokratike, të vazdueshme. Një paqe e tillë ka dy armiq të egër përpara: imperializmin botëror dhe agjenturën e tij të ndyrë, revizionizmin modern. Të dy këta armiq të egër, dinakë, popujt e botës me komunistët në krye dhe njerëzit përparimtarë duhet t'i çarmatosin, t'i shfarosin. Kjo luftë e shenjtë për paqen s'është e lehtë, por duhet të arrihet dhe do të arrihet një ditë. Lufta e popullit shqiptar që shprehet dhe përputhet plotësisht me vijën e drejtë, largpamëse, marksiste-le-niniste të Partisë, üshtë e njojur nga të gjithë. Janë të njoitura botërisht, si në planin kombëtar edhe në atë ndërkombëtar qëndrimet e Partisë dhe të Qeverisë sonë për të gjitha problemet që preokupojnë vendin brenda dhe njerëzimin e botën mbarë. Këto qëndrime janë dhe do të jenë kurdoherë revolucionare, prandaj ato kanë fituar zemrën e revolucionarëve në të gjithë botën dhe kapitalistët tok me revizionistët po u bëjnë

një luftë të tërbuar, por pa asnjë sukses. E vërteta që mbron Partia jonë po çan çdo kurth, çdo rrethim, çdo bllokadë. Retë e zeza që përhap mbi botë imperializmi luftënxitës amerikan me këlyshët e tij të çdo kallëpi nuk na trebin. Kundër luftënxitësve imperialistë sot është ngritur një forcë gjigante prej miliona e miliarda njerëzish, që nga ndërtuesit e socializmit e të komunizmit e deri te proletarët e vendeve kapitaliste, që nga luftëtarët e lirisë e të pavarësisë së vendeve të shtypura e të porsaqçliruara dhe deri te partizanët e paqes të të gjithë botës. Historia është e pamëshirshme dhe rrotën e saj s'e kthcijnë dot mbrapsht as imperialistët as revisionistët.

Ngjarjet e kohëve të fundit kanë vërtetuar edhe një herë drejtësinë e vijës së Partisë sonë, konkluzionët e saj të drejta. Këto ngjarje u kanë mësuar shumë gjëra njerëzve të mbarë botës. Komploti kundër Kubës zbuloi me qartësi të veçantë egërsinë e imperializmit amerikan dhe rrezikshmërinë e pazarllëqeve në kurriz të popujve. Në të njëjtën kohë ai tregoi jo forcën «e pakapërcyeshme» të imperializmit dhe të bashkëpunëtorëve të tij, të cilët, të tmerruar, po i puthin atij edhe këmbët e kështu po e inkurajojnë më shumë agresorin, por dobësinë e tij, dobësinë e tyre, që në agoni e sipër po heqin çdo maskë «paqëdashëse» e «liridashëse» dhe po tregojnë ftyrën e tyre të vërtetë.

Edhe lodra e ndyrë që po luhet në kusirin kino-indian nga imperializmi, reaksionarët indianë dhe oportunistët e çdo kallëpi, nuk do të jetë më pak e palavdishme se komploti kundër Kubës. Por, sikurse jeni në dijeni, të gjitha këto po dështojnë dhe me siguri do

të dështojnë deri në fund. Republika Popullore e Kinës ua prishi planet agresorëve dhe ndihmësve të tyre. Deklarata e qeverisë kineze mbi pushimin e zjarrit të njëanshëm për likuidimin paqësor të konfliktit kino-indian, i tregoi edhe një herë të gjithë botës se kush është për paqen dhe kush është agresori. Kina e madhe socialiste ka luftuar dhe lufton kurdoherë në mënyrë të vendosur për paqen dhe miqësinë midis popujve. Partia e saj Komuniste, me shokun Mao Ce Dun në krye, është bërë fener i ndritshëm për të gjithë komunistët e botës në luftën për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Populli 700 milionësh kinez fryniëzon të gjithë popujt në luftën kundër shtypjes e skllavërisë, për liri, demokraci e socializëm. Pikërisht për këto arsyë Partia dhe populli ynë kanë në Republikën Popullore të Kinës, në Partinë Komuniste dhe në kryetarin Mao Ce Dun miq të shtrenjtë dhe bashkëluftëtarë të vendosur, po ashtu sikundër dhe ata kanë në Partinë e popullin tonë vëllezër dhe shokë lufte përjetë.

Luftha kundër revizionizmit modern nuk mund të shkëputet nga luftha kundër imperializmit botëror. Revizionistët modernë, të përfaqësuar nga grupei Hrushov-Tito po veprojnë hapur në të gjitha fushat dhe me të gjitha mjetet për shtrembërimin e marksizëm-leninizmit, për diskreditimin e socializmit e të komunizmit, për të minuar fitoret e proletariatit ndërkombëtar, për të përçarë unitetin e kampit socialist e të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, për të dobësuar nëpërmjet klikave të ndryshme ato parti komuniste ku akoma nuk ekziston një hov revolucionar i ngritur. Në politikën e jashtme revizionistët modernë ecin në gjur-

mët e imperializmit botëror dhe po e ndihmojnë atë duke i bërë konçesione antileniniste të rrezikshme në çështjet më nevralgjike. Një gjë të tillë ata po e bëjnë jo pa qëllim, por për të ndihmuar në vendosjen e hegemonisë botërore të kapitalizmit. Këto vepprime revisionistët po përpiken t'i fshehin me frazat inë demagogjike, duke u munduar të spekulojnë dhe duke luajtur me çështjen e paqes, që është aq e dashur dhe e shtrenjtë për të gjithë njerëzimin. Me veprimet e tyre ata në fakt po inkurajojnë gjithnjë e më shumë agresorët imperialistë me atë amerikan në krye dhe po rrezikojnë seriozisht paqen. Prandaj komunistët e vendeve të ndryshme, duke kuptuar rrezikun e madh të revisionistëve modernë, po luftojnë çdo ditë e më me forcë kundër tyre. Tani lufta e komunistëve të botës për demaskimin e për shpartallimin e revizionizmit modern, këtij rreziku kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, është në ngjitje. Komunistët dhe populli ynë janë krenarë që në këtë luftë të shenjtë Partia e Punës e Shqipërisë ka dhënë, jep dhe do të japë deri në fund kontributin e saj.

Ne, shokë, jetojmë në epokën më të lavdishme, në atë të realizimit të ëndrrave më të bukura të njerëzimit, kur socializmi marshon në mënyrë të pandalshme duke shembur çdo pengesë dhe duke ngritur botën e re. Shqiptarët, ashtu si deri më sot, nuk do të mbeten borxhlinj përpëra historisë. Shqipëria e re sociale, e fuqishme si kurrë ndonjëherë nga vetëdija për të drejtën, nga energjia jetëdhënëse e marksizëm-leninizmit, nga vija e kristaltë e Partisë së lavdishme të Punës, ecën ballëlart përpëra, dhe prapa nuk do të kthe-

het kurrë! Ne kemi vetëm një objektiv, atë që kanë treguar Marks, Engels, Lenini e Stalini — të ardhmen e ndritur të popullit tonë e të mbarë njerëzimit, komunizmin.

Në këto ditë historike të çelikoset edhe më shumë uniteti i pathyeshëm i popullit me Partinë — garancia kryesore e të gjitha fitoreve tona, të forcohet më tej vigjilencia revolucionare për të bërë të dështojnë edhe në të ardhmen çdo plan e komplot i armiqve, të ngrihet më lart vrulli dhe entuziazmi krijues në punë i masave punonjëse për të realizuar të gjithë treguesit e planit të shtetit, për të korrur fitore të reja në frontet e ndryshme të ndërtimit socialist, për forcimin dhe për lulëzimin e atdheut. Të kryejmë si kurdoherë me nder të gjitha detyrat tona patriotike dhe internacionale, në mënyrë që Republika jonë të qëndrojë vazhdimisht kështjellë e pamposhtur e socializmit dhe e paqes në brigjet e Adriatikut; të luftojmë sa kohë të rrabin zemrat tona për triumfin e marksizëm-leninizmit!

Le t'i gëzojë i madh dhe i vogël festat e 50-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë e të 18-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, le të rrojnë në shekuj 28 e 29 Nëntori, le të punojmë e të luftojmë edhe në të ardhmen nën udhëhcqjen e Partisë, në mënyrë të tillë që frytet e 28 e të 29 Nëntorit t'i gëzojnë në shekuj nipërit e stërnipërit tanë, krenarë për veprën e të parëve të tyre!

Duke ngritur këtë dolli për lavdinë e popullit tonë heroik e patriot, për lavdinë e trimave dhe të kryetri-mave që luftuan shekuj me radhë e deri në ditën e sotme dhe ranë në altarin e atdheut, për lavdinë e pu-

nëtorëve dhe fshatarëve, të dijetarëve, filozofëve, shkrimtarëve, poetëve, diplomatëve të shqar të popullit shqiptar, për sukseset e fitoret e popullit tonë në të ardhmen, për atdheun tonë socialist e lumturinë e begatinë e tij, ju stojo të thërrasim një zëri:

Rroftë Republika jonë Popullore!

Rroftë Partia e lavdishme e Punës e Shqipërisë!

Lavdi marksizëm-leninizmit fitimtar!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit».
Nr. 286 (4444), 30 nëntor 1962*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

VËREJTJE MBI TEZAT E KONGRESIT TË 10-TË TË PARTISË KOMUNISTE TË ITALISË¹

[Nëntor 1962]

Udhëheqësit revizionistë të Partisë Komuniste të Italisë, duke ndjekur vijën revizioniste të Tito-Hrushovit mbi zhvillimin botëror, arrijnë në konkluzionin se «imperializmi ka humbur pothuaj krejtësisht bazën e tij koloniale dhe shtetet e popujt e lirë të botës së vjetër të kolonive përpiken gjithashku të gjejnë dhe të ndjekin një rrugë zhvillimi ekonomik që të mos jetë më një rrugë e rëndë dhe e dhimbshme e shfrytëzimit kapitalist» (pika 1, § 2).

Ata pohojnë se «Nga shtetet socialiste, dhe para së gjithash nga Bashkimi Sovjetik (për qartësi lexo: Nga udhëheqësit revizionistë sovjetikë e pasuesit e tyre) sot del një sfidë për garë paqësore me klasat drejtuese borgjeze, për ndërtimin e një rendi ekonomik e sho-qëror në të cilin të plotësohen (të kënaqen) të gjitha aspiratat e njerëzve e të popujve për liri, mirëqenie, pavarësi, për zhvillimin e plotë dhe respektimin e per-

1 Këto teza shërbyen si bazë për artikullin që u botua në gazeten «Zëri i popullit» më 17 e 18 nëntor 1962.

sonalitetit të njeriut (personit njerëzor), për bashkëpunimin paqësor midis të gjitha shteteve».

Më qartë nuk mund të shprehet rruga revizioniste e Hrushovit dhe e Toliatit drejt pajtimit me imperializmin, drejt «integrimit paqësor» politik, ekonomik dhe shoqëror të tyre me imperializmin.

Gjatë zhvillimit të mëtejshëm të tezave të tyre, lidhur me problemin e arritjes së pages, revisionistët italianë zbulojnë fytyrën e tyre të vërtetë pacifiste duke thënë se janë gati të bëjnë çfarëdo koncesioni ideologjik, politik dhe organizativ. Dhe kjo për ta është një gjë e logjikshme sepse bazohet në një koncept të tërë teorik të tyre, që konsiston në teorinë e marrjes së pushtetit pa luftë, dhe vetëm me anë reformash strukturore, me rrugë paqësore, me rrugë evolucionare. Sipas tyre, borgjezia italiane dhe ajo ndërkombëtare do të dorëzohen, natyrisht, me kalimin e kohës dhe pas disa fjalimesh «të zjarra» të Toliatit e të Pajetës në parlament.

Në tezat thuhet: «Edhe në grupet drejtuese, po çaj-në udhën tendenca që me vështirësi po synojnë drejt njohjes së nevojës për evitimin e një lufte të re botërore. Një tendencë e tillë ekziston deri te grupi politik që kryesohej nga presidenti i ri i SHBA-së, i cili përkëtë është orvatur të përpunojë një strategji të re, me anën e së cilës të garantojë — qoftë dhe duke pranuar një farë ulje të tensionit në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe heqjen dorë nga format tradicionale kolonialiste—predominimin ekonomik dhe politik të imperializmit» (pika 4, § 1, në mes).

C'do të thotë kjo? Kjo do të thotë që revisionistët italianë pranojnë se grupet drejtuese imperialiste, bile dhe grupi i Kenedit (pra ajka e imperializmit) po bëhen përkrahëse të evitimit të luftës, po bëhen paqeda-shëse; bile, sipas tyre, kjo gjen shprehjen e saj në «strategjinë themelore të imperializmit» të shpallur nga Kenedi ku paska diçka «të re» si tendenca «për uljen e tensionit në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe hedhjen poshtë të formave tradicionale kolonialiste», pavarësisht se kjo bëhet për të garantuar predomini-min ekonomik e politik të imperializmit (vetëkuptohet — të imperializmit «paqedashës»). A nuk është shprehur qartë këtu teza e famshme e të gjithë revisionistëve modernë se gjoja natyra e imperializmit ka ndryshuar? Udhëheqja revisioniste e PK të Italisë shch te «grupi Kenedi» një element të ri progresist, realist, që është i gatshëm të bëjë lëshime në favor të paqes dhc të socializmit, që dënon kolonializmin (pavarësisht se vendos një formë të re kolonialiste). Me një fjalë, Kenedit dhe grüpiti të tij imperialist i hidhen lule nga grupi i Toliatit. Nga ana tjetër është e kuptueshme se, duke marrë parasysh këtë nënshtrim të tyre ndaj imperializmit amerikan, ç'vlerë mund të kenë polemikat e udhëheqësve të PK të Italisë me borgjezinë italiane, me të cilën ata janë puqur dhe nesër do të puqen akoma më shumë në çështjet më themelore. Ata do të katanësiten në shërbëtorë të imperializmit amerikan, njëlloj siç janë dhe udhëheqësit e borgjezisë së madhe italiane. Kështu aristokracia punëtore italiane po hyn me hap të sigurt në rrugën e shërbëtorëve të kapitalit.

Udhëheqja e PK të Italisë arrin në tezat deri atje

saqë agresionin kundër Kubës, rritjen e garës së armatimeve etj. nuk ia atribuon grupit të Kenedit, por presionit të «grupeve ushtarake», disa njerëzve të këqij që e kanë rrethuar dhe i bëjnë presion këtij «njeriu të mirë, demokrat, paqësor» siç është Kenedi.

Më poshtë në tezat thuhet: «Por do të ishte e gabuar të mohohej fakti se në grupet drejtuese të imperializmit vazhdojnë të manifestohen elementë të diferençimit. Kjo e bën sot më të lehtë izolimin e grupeve ekstremiste, që ekzistojnë në çdo vend dhe që, nga njëra anë, janë në krye të shtatmadhorisë e të organizatave me tendenca fashiste të SHBA-së, nga ana tjetër, janë në krye të militarizmit gjerman dhe të militarizmit francez, të cilët janë të bashkuar për të luftuar kundër perspektivës së uljes së tensionit ndërkombëtar dhe të forcimit të paqes» (pika 4, § 1 më poshtë). Pra, sipas tezave të Kongresit të 10-të të PK të Italisë, duke u mbështetur në «këta njerëz të mirë» të diferencuar, mund të frenohen lehtë ekstremistët, militaristët, fashistët etj.

Duke shpresuar në dashamirësinë e këtyre «njerëzve të mirë» udhëheqja e PK të Italisë arrin në konkluzionin revisionist se atëherë do të vendoset bashkekzistenca paqësore, do të zgjidhen problemet ekonomike dhe politike, do të zhduken divergjencat dhe nuk «do të eksportohet as kundërrevolucioni, as revolucioni». Sepse, siç thuhet në tezat: «luftërat për këta objektiva duhet të udhëhiqen duke përjashtuar si perspektivën e një lufte të re botërore, ashtu edhe mundësinë e ndërryjeve të huaja nga jashtë që synojnë të eksportojnë si kundërrevolucionin, ashtu dhe revolucionin» (pika 4,

akoma më poshtë). Sipas tyre, deri tani revolucioni është eksportuar, domethënë në të ka ekzistuar «syri dhe gishti i Moskës». Si rrjedhim logjik, sipas revizionistëve italianë, po «të mos qe eksportuar revolucioni», nuk do kishim këto kokëçarje, sepse fundi i fundit do të qe bërë vetëm Revolucioni i Tetorit dhe mjaft!, borgjezia dhe «demokracia» e saj me të mirat e veta, si terrorin, vrasjet, masat represive dhe shfrytëzimin e punonjësve do të sillte në mënyrë evolucionare «progressin» — socializmin. Prandaj del se «bashkekzistenca» që predikojnë revisionistët italianë mban në vete «garancinë për imperializmin botëror», moszgjerimin e mëtejshëm të revolucionit, të luftës së klasës punëtore, të diktaturës së proletariatit etj. Kjo është hapët—integrim i socializmit në kapitalizëm, kjo është bille më e poshtër se teoritë oportuniste të Kautskit e të Bernshtajnit. Sepse revisionistët modernë italianë jo vetëm e sigurojnë imperializmin për këtë, por dhe i kanë vënë vetes për detyrë që të shkallmojnë socializmin atje ku ka fituar dhe të shuajnë e të mbytin revolucionin atje ku janë krijuar konditat dhe mund të shpërthejë. Sigurisht imperializmit i nevojiten shërbëtorë të tillë si Hrushovi, Toliati, Titoja etj. për t'i vënë në veprim me qëllim që të nxjerrë fitime duke zgjatur jetën e tij. Por çfarëdo që të bëjnë, imperialistët dhe revisionistët, e kanë më kot, sepse revolucionet do të pëlcasin, klasa punëtore dhe të shtypurit e tjerë do të organizohen dhe do të shpërthejnë. Në fund të fundit imperializmi nuk i shpëton dot vdekjes. Prandaj ai as çarmatoset dhe as heq dorë nga qëllimi i tij për të sunduar botën dhe për të shkatërruar socializmin.

Është për këto arsyet që teoritë revizioniste në shërbim të strategjisë imperialiste duhen demaskuar në mënyrë të ashpër dhe duhen shkularur që nga rrënjet. Revisionistët modernë janë bërë arrogantë, ata sot kanë në dorë fuqi ekonomike dhe ushtarake, dhe për qëllimet e tyre shfrytëzojnë potencialin e autoritetin e Bashkimit Sovjetik e të Partisë Bolshevike. Prandaj t'i godasësh ata me dorashka është, si të thuash, të shposh me gjilpërë një elefant, kurse atyre përkundrazi, duhet t'u jepen pa pushim grushte vdekjeprurëse, goditje të njëpasnjëshme, në mënyrë që t'u çirret maska dhe popujt e komunistët t'i shohin ashtu siç janë në të vërtetë, me të tëra qelbësirat e tyre, pa mundur që këto t'ua fshehin.

Udhëheqësit revizionistë italianë, pra, nëpërmjet tezave që kanë shpallur «predikojnë dhe luftojnë» për një botë paqësore, ku të vëllazërohen të gjithë «nën shenjën e kryqit». Komunistët dhe klasa punëtore, sipas tyre, duhet të tregohen të qetë, tolerues, të mos e ngrenë shumë zërin, dhe në asnjë mënyrë të mos rrakin armët e të vaprojnë ndaj atyre që kanë pushtetin e forcën, sepse këta do të bëjnë vetë lëshime (dhe duhet të bëjnë disa lëshime, të japin ca lëmosha!) për hir të paqes, për hir të «progresit», në favor të pasanikëve etj., etj. Gati predikimi i Papës nga Vatikani: «Pace in terra e in cielo», (me një fjalë vëllazërim dhe harmoni në mes të të pasurve dhe të varfërvë).

Në këtë mënyrë Toliati dhe tradhtarët e tjerë të marksizëm-leninizmit që e pasojnë, do të sigurojnë rehatin e tyre, vilat, automobilat, vendin në parlament dhe në senat etj., etj. «në emër të komunizmit dhe në

saje të bashkekzistencës paqësore», kurse turbulluesit e «kësaj feje hyjnore romake» janë «tradhtarë», «dogmatikë», «sektarë», «stalinistë», «luftëdashës» etj., etj.

Më poshtë në tezat revizionistët italianë shkruajnë: «Grushti i aksionit politik dhe i masave duhet të përqendrohet në radhë të parë kundër grupeve ekstremiste të forcave imperialiste, kundër atyre që përkrahin hapur ashpërsimin e situatës ndërkombëtare dhe luftën, për t'i demaskuar, për t'i izoluar dhe për t'i mundur» (pika 5, § 1). Me këtë ata duan të thonë se edhe atë luftë që gjoja duhet të bëjnë masat, duhet ta drejtojnë jo kundër grupeve si ai i «të mirit Kenedi», por kundër ekstremistëve dhe militaristëve. Prandaj revizionistët predikojnë të bëhet dallim aty ku në fakt nuk mund të ketë dallim, por ku i intereson imperializmit, që të bëhet një «dallim» sa për sy e faqe, në mënyrë që nön lëkurën e «qengjit» të mprehë dhëmbët ujku. E tillë është teoria e revizionistëve.

Në lidhje me politikën e qeveritarëve italianë tezat, duke folur për «paqen dhe politikën paqësore» që gjoja duhet të ndjekin, pranojnë që MEK-u (Tregu i Përbashkët Evropian) nuk duhet të ndalojë luftën për paqe. Në to shkruhet: «Edhe i ashtuquajturi «evropeizëm» i qeveritarëve tanë është radhitur deri tani në këtë kuadër (të përkrahjes së imperializmit amerikan). Por aderimi në MEK nuk mundet dhe nuk duhet të bëhet pengesë për një aksion paqeje» (pika 5, § 5). Me fjalë të tjera revizionistët italianë pranojnë se MEK-u është një organizim kapitalist, i cili nuk e pëngon, por e ndihmon paqen dhe që, pra, mund «ta pra-

nojmë». Dhe duke pranuar MEK-un, ata më poshtë sugjerojnë vetëm luftën kundër «ekstremistëve dhe militaristëve» që janë futur në MEK. Pra, sipas revizionistëve italianë, Tregu i Përbashkët Evropian është «një hap përpara» drejt socializmit.

Në tezat e Kongresit të 10-të të PK të Italisë thuhet se prevalenca ekonomike e kapitalizmit amerikan ka rënë ndaj vendeve të tjera kapitaliste (gjithë pika 6).

Në paragrafin e dytë të pikës 7 të tezave thuhet: «Veçanërisht e dëmshme rezulton se ka qenë tendenca për të pranuar detyrimisht dhe për të aplikuar një model të vetëm ndërtimi të një ekonomie dhe të një shoqërie socialiste, pa marrë parasysh kushtet e ndryshme historike, situatat e ndryshme politike konkrete, traditat dhe nevojat e çdo vendi. Ky drejtim i gabuar, në kundërshtim me parimet e marksizmit dhe me mësimet e Leninit, nuk mund të mos kishte pasoja të dëmshme ekonomike dhe politike, që disa herë janë bërë të rënda për shkak të metodave të kufizimit të jetës demokratike, të cilat nuk justifikoheshin nga rrethana të jashtëzakonshme, të luftës së ashpër të klasës, të luftës civile dhe të ndërhyrjes së huaj për shtypjen e revolucionit». Me këtë, revisionistët italianë ngrenë dhe dënojnë çështjen se gjoja «vendet socialiste vendosin të njëjtat modele të një ekonomie dhe të një shoqërie socialiste pa marrë parasysh kushtet e ndryshme historike, politike, traditat» etj. Me fjalë të tjera, sipas revizionistëve italianë, të gjithë ne, vendet socialiste, në ndërtimin e socializmit duhej të ndiqnim rruġġen e Toliatit, i cili, siç dihet, s'e mori dot fuqinë, s'e

ndërtoi dot socializmin dhe që s'do ta ndërtojë dot kurri me rrugën e tij revizioniste. Sipas tyre, ne kemi kopjuar, sforuar dhe imponuar «metodat dogmatike të dëmshme sovjetike». Kështu që eksperiencia universale sovjetike e periudhës së Leninit e të Stalinit hidhet poshtë, ose goditet në të katër anët nga revisionistët italianë. Mirëpo revisionistët s'thonë një gjë, se te ne, që kemi aplikuar këtë eksperiencë, për shembull, fshatarësia rron mirë, kurse fshatarësia italiane s'ka një pëllëmbë tokë, s'ka bukë të hajë me gjithë «format e metodat» e Toliatit, që jo vetëm s'i kanë dhënë asgjë, por përkundrazi ia kanë vështirësuar situatën. Ata «harrjonë» të thonë se industria te ne është në duart e klasës punëtore, kurse atje ku «lufton» Toliati e kanë kapitalistët, ose se bankat atje, ku predikon Toliati, janë shushunja që pijnë gjakun e popullit, kurse te ne janë në duart e popullit e punojnë vctëm për popullin. E kështu me radhë. Del, pra, se «filozofët» revisionistë italianë merren me llogje e jo me punë, shesin mend e i qajnë hallin kalorësit pse i varen këmbët.

Duke mbrojtur këto teza, revisionistët italianë ndjekin tri qëllime: të diskreditojnë ndërtimin e socializmit në vendet tonë, të ndihmojnë dhe t'i quajnë normale e të drejta devijimet revizioniste në ndërtimin e socializmit në Jugosllavi, në Poloni, dhe të shfajësojnë veten e tyre për faktin që jo vetëm s'kanë bërë gjë, por të tregojnë bile se «kanë bërë mirë», mbasi «me vijën e strukturës së re, që predikojnë, ata do të arrijnë në socializëm». Kështu, ata pozohen si «papët» e mark-sizmit dhe «udhëheqës ideologjikë» për të gjitha ato «parti» që akoma s'e kanë ndërtuar socializmin. Këtyre

«partive» revizionistët italianë u këshillojnë të ruhen nga drejtimet «e mbrapshta» staliniste dhe të shikojnë drejt Romës. Të gjitha rrugët të çojnë në Romë!... dhe Papa («marksist») i Romës është Toljati e Cic¹.

Në pjesën e cituar pak më lart të paragrafit të dytë të pikës së 7 të tezave është shprehur hapur mendimi i revizionistëve italianë se të ashtuquajturat «shtrembërimi të marksizëm-leninizmit» në ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet tona nuk kanë qenë të detyruara të bëheshin, sepse gjoja as pre-sion armik nuk ekzistonte, as luftë klasash nuk ekzistonte (dhe s'kishte pse të ekzistonte!), dhe revolucioni as që kërcënohej nga jashtë! Deri këtu kanë arritur këta tradhtarë, sa të falsifikojnë historinë, të fshehin politikën agresive të imperialistëve, kërcënimet dhe sulmet e tyre kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste. Me këtë ata tregojnë dhe një herë se s'janë tjetër veçse lakej të vërtetë të kapitalistëve.

Më poshtë në tezat, në fund të paragrafit të gjashtë e në paragrin e shtatë të pikës 7, revizionistët italianë shkruajnë: «Vlera primare e eksperiencës së fituar në Bashkimin Sovjetik nuk duhet, pra, të përjashtojë vlerësimin e drejtë të eksperiencës së fituar në kushte të tjera, në Kinën Popullore, në Poloni, në demokracitë e tjera popullore, si dhe në Kubë, në Jugosllavi. Mosqenia dakord me disa pozita që kanë komunistët jugosllavë, për shembull, nuk mund dhe nuk duhet të çojë në mospërfilljen e studimit e të thellimit dhe në mohi-

¹ C^{lo} (frëngjisht) — me shokë.

min e vlerës së asaj që kanë bërë dhe bëjnë ata duke ndjekur një rrugë të tyre».

«Rezolucioni i aprovuar nga organet udhëheqëse të Partisë Komuniste të Italisë në muajin nëntor të vitit 1961, gjatë diskutimit të rezultateve të Kongresit të 22-të të PK të BS, udhëhiqet sipas kësaj vije dhe është plotësisht i drejtë. Ai tregon një rrugë kërkimesh, debatesh dhe thellimi, mbi të cilën është e nevojshme të ecet, duke kërkuar edhe ndihmën e udhëheqësve të partive të tjera, që kanë jetuar drejtpërsëdrejti eksperiencën e marrjes së pushtetit dhe të ndërtimit të socializmit».

Nga kjo del qartë se gabimet dhe devijimet revisioniste jugosllave, (të mos flasim për tradhtinë e hapët dhe vënien e Jugosllavisë në shërbim të plotë të SHBA-së, gjë që revisionistët italianë as e shkojnë fare në mend) udhëheqësit e PK të Italisë i nënvleftësojnë aq shumë, i minimizojnë në atë shkallë, saqë, gjoja në një formë «kritike», ngrenë në plan të parë (pse e theksojnë në mënyrë të veçantë e më shumë) eksperiencën jugosllave të «ndërtimit të socializmit» në atë vend. Dhe në këtë drejtim tanë ata riafirmojnë «drejtësinë» e tezave të kongresit të tyre më 1961, duke u paraqitur si qendra, rreth së cilës duhet të grumbullohen partitë e tjera për të përcaktuar rrugët që duhet të ndiqen për ndërtimin e socializmit në botë.

Sipas tezave të revisionistëve italianë, popujt që do të luftojnë këndeje tutje për të marrë fuqinë në dorë e për të ndërtuar socializmin duhet të ndjekin «rrugë të reja», «forma të reja», «metoda të reja», kurse sa për eksperiencën e fituar nga vendet socialiste, kjo

s'do të bëjë tjetër veçse do të influencojet në mënyrë spontane, kjo eksperiencë duhet mbyllur në një «kafaz» dhe që andej duhet admiruar nga larg. Çdo gjë, gjithçka, sipas këtyre revizionistëve, do të fitohet pa e shkrehur qoftë dhe një herë, pa «çak» e pa «bamb»!

Tezat në ballë vënë premisat, të cilat janë krejt revizioniste, pastaj atyre u vishen kontornot për të maskuar tradhtinë. Ata thonë se «shtrirja gjithnjë e më shumë e sistemit të kapitalizmit monopolist shtetëror tregon objektivisht pjekjen e kushteve për kalimin në socializëm» (pika 8, § 2 në fillim).

Dhe natyrisht, si të gjithë revizionistët, edhe udhëheqësit e PK të Italisë, duke llomotitur më parë për rivendikimet e masave, për «luftën masive demokratike», mbërrijnë në çështjen që transformimet dhe marrja e pushtetit nga klasa punëtore do të vijnë nëpërmjet parlamenteve. «Një funksion i dorës së parë, thuhet në tezat, mund t'u takojë në këtë fushë institucioneve parlamentare, kur në to të jetë aktive një rrymë e fortë demokratike e socialiste, e rrënjosur në popull dhe e lidhur gjithmonë me një lëvizje të masave» (pika 8, § 2 në fund). Lufta parlamentare është «strumbullari» «i dorës së parë» i të gjitha «luftërave» të revizionistëve.

Për revizionistët italianë ka dy lloj luftërash: «lufte për demokraci» dhe «luftë për socializëm»; njëra duhet të influencojet te tjetra. Kush përfaqëson demokracinë?! Po socializmi ç'përfaqëson për revizionistët italianë? Të gjithë këtë teori false, antimarksiste, ata e krijojnë për të ngritur tezat e rrezikshme revizioniste

për eliminimin e diktaturës së proletariatit, për eliminimin e rolit udhëheqës të klasës punëtore. Në tezat thuhet: «Në këto kushte i njëjti term diktaturë e proletariatit mund të marrë një përmbajtje të ndryshme nga ajo që kishte gjatë viteve të ashpra të luftës civile dhe të ndërtimit të parë të socializmit në një vend të rrethuar nga kapitalizmi» (pika 8, § 3 në fillim). Me një fjalë, revisionistët italianë thonë se diktaturës së proletariatit i ka kaluar koha, pse atëherë, në atë kohë «të Noes», vendet ishin të rrethuara nga shtete kapitaliste. Mirëpo Toliati dhe shokët e tij, që pretendojnë të ndërtojnë socializmin, jo vetëm që janë të rrethuar nga kapitalizmi, por këtë e kanë të shtruar në vatrat e tyre. Vetëm se këtë armik të armatosur deri në dhëmbë dhe të shtruar «pajdash» në vatrat e tyre, me sa duket, këta «heronj» revisionistë do ta zbutin dhe do ta shkrijnë, pa dhimbje, me dorashka, me buzëqeshje! Të gjitha këto teza mbështetin tezat hrušoviane, se imperializmit i kanë rënë dhëmbët, se ai është zbutur, se ai nuk pregatitet për luftë, se nuk ekziston rreziku i imperializmit, se nuk ekziston rrethimi kapitalist etj., etj.

Vetëm se në këtë rrugë «kaq të drejtë, kaq të sigurt, thonë revisionistët italianë, na pengojnë nga njëra anë «revisionizmi reformist» (për këtë ka vetëm një radhë, sa për ta përmendur, natyrisht me qëllim, që ta vënë veten e tyre në radhën e marksistë-lenisitëve të vërtetë), nga ana tjetër, dhe sidomos, dogmatikët, «ekstremizmi sektar»». (këtu zgjerohen, jo me një radhë, por me dhjetëra radhë, gjë që natyrisht, kuptohet lehtë pse bëhet). Megjithëkëtë tezat predikojnë ndaj të parëve (revisionistëve reformistë) atrim, jo vetëm

me masat e partive socialdemokrate, jo vetëm me sindikatat e tyre, por edhe me krerët e këtyre partive; asnjë fjalë s'bëhet për luftë ideologjike me ta, pa lëre për tjetër luftë. Kurse ndaj dogmatikëve e sektarëve predikojnë luftë të ashpër ideopolitike, demaskim, shpartallim të tyre. Edhe kjo është fort mirë e kuptueshme pse bëhet.

Në tezat pranohet (tërë paragrafi i fundit i pikës 8) se lufta e klasës punëtore të Italisë dhe e vendeve të tjera kapitaliste të Evropës Perëndimore ka rënë. Mirëpo fajin për këtë udhëheqësit revizionistë të partive komuniste të këtyre vendeve nuk e marrin vetë përsipër, nuk ua atribuojnë atë vijës së tyre të gabuar, tradhtisë së tyre revizioniste dhe nënshtimit të tyre ndaj kapitalit në përgjithësi. Fajin për këtë, natyrisht, e «ka i varfëri»! Pra faji u bë qyrk dhe askush s'pranoi ta vishte as edhe në dimër, pa le në behar!

Në dokumentet historike që kanë përcaktuar «objektivat» e komunizmit ndërkombëtar dhe «rrugën që duhet të ndjekë ky», revizionistët italianë me paturpësi futin dhe rezolucionin e konferencës së Romës të 17 partive komuniste evropiane, ku, natyrisht, ka pasur gjithashtu kontradikta të mëdha (pika 10, § 2 në fillim).

Menjëherë pas kësaj në tezat thuhet: «Në kuadrin e vijës së përcaktuar nga këto dokumente, është e nevojshme që çdo parti të veprojë në mënyrë autonome, duke ua përshtatur qëndrimet e saj politike, veprimin e saj, format e saj organizative dhe të jetës së brend-

shme kushteve të veçanta ekonomike dhe politike të vendit të saj, traditave të tij, formave të jetës së tij demokratike, objektivave imediatë që ekzistojnë në atë vend... (pika 10, § 2). Nga këto e të tjera del qartë se këtë vijë unike, dhe veçanërisht dokumentet e dy mbledhjeve të Moskës të viteve 1957 e 1960, që duhet të zbatohen nga të gjitha partitë komuniste e punëtore, tezat e Kongresit të 10-të të PK të Italisë i bëjnë fërtele, duke vënë aq tepër kushte specifike, saqë dalin po në rrugën e Hrushovit, i cili e ka quajtur Deklaratën e Moskës të vitit 1960 «një kompromis që s'ë ka jetën të gjatë». Në fakt, tezat italiane e marrin këtë Deklaratë dhe e hedhin në shportë.

Për të mbështetur këtë devijim të tyre të hapët, revisionistët italiane «na citojnë marksizëm-leninizmin». Mirëpo ata harrojnë se Deklarata nuk pasqyron eksperiencën e një partie, por eksperiencën e gjithë lëvizjes komuniste botërore. Të 81 partitë komuniste e punëtore prunë në Mbledhjen e Moskës eksperiencën e grumbulluar prej tyre dhe fiksuan në atë Deklaratë esencën e kësaj eksperience dhe orientimet që duhej të ndiqeshin në të ardhmen. Këto janë orientime bazë dhe jo detaje të vogla, karakteristike për disa parti, që Toliati duhet t'i zbatojë sipas situatës, kushteve shoqërore, fetare etj., etj.!

Dhe për ta forcuar këtë tzë «fort të shëndoshë» të tyre, revisionistët italiane në tezat sulmojnë, ashtu siç mund të sulmojnë tradhtarët, Partinë tonë të Punës, për të vetmen arsyë se kjo mbron me rigorozitet marksizëm-leninizmin dhe Deklaratën e Mbledhjes së Moskës të 81 partive komuniste e punëtore. Sulmi kundër

nesh në tezat e tyre arrin shifrën rekord prej 28 rresh-tash: «Në kundërshtimin me udhëheqësit e Partisë së Punës të Shqipërisë dolën mosmarrëveshje të thella. Ato kanë të bëjnë me problemin e lidhjes midis ndërtimit të socializmit dhe respektimit të parimeve të demokracisë, midis forcimit dhe zhvillimit të detyrave të partisë komuniste dhe ekzistencës në radhët e saj të një regjimi të brendshëm të centralizmit demokratik. Ato kanë të bëjnë gjithashtu me solidaritetin dhe unitetin e lëvizjes komuniste ndërkontrolluese dhe të vendeve socialiste, në luftën kundër imperializmit për të mbrojtur veten e tyre. Udhëheqësit e Partisë së Punës të Shqipërisë e braktisën internacionalizmin, hodhën poshtë vijën e përbashkët të lëvizjes komuniste, ndoqën rrugën e polemikave të hidhura dhe false, të fraksionizmit të hapët, të përcarjes së radhëve tona. Qëndrimet e tyre duhet të hidhen poshtë e të dënohen pa ngurrim, duke uruar që ata të mund të gjejnë rishtazi rrugën e marksizmit, të leninizmit, të internacionalizmit proletar» (pika 10, § 4). Asnjë parti tjeter nuk sulmohet në tezat e tyre. Kjo tregon frikën që ata kanë nga drejtësia e PPSH, kjo tregon frikën nga vija jonë e drejtë, e cila i demaskon ata, kjo tregon se shumica dërrmuese e komunistëve në botë mbështetin vijën e drejtë të Partisë sonë. Ja pse revisionistët italianë bëjnë thirrje që ne të na demaskojnë. Mirëpo e kundërtë ka ngjarë dhe do të ngjasë.

Edhe revisionistët italianë propozojnë në tezat variantin e tyre të maskuar për integrimin ekonomik të vendeve kapitaliste dhe socialiste. Bile ata precizojnë

në to vendet e Evropës. Në tezat thuhet: «Por ndërkokë duhet luftuar në kuadrin e luftës botërore për paqen dhe bashkëkzhistencën paqësore, për një politikë bashkëpunimi ekonomik ndërkombëtar, e cila të bëjë të mundur të zhduken kontrastet që pengojnë tanë një zhvillim të shpejtë ekonomik, i cili të gjejë shprehjen e tij në një përparim shoqëror. Sidomos në Evropë është e nevojshme të zhvillohet një iniciativë unitare, për të hedhur bazat e një bashkëpunimi ekonomik evropian edhe midis shteteve me sistem të ndryshëm shoqëror, që të bëjë të mundur, në kuadrin e organeve ekonomike dhe politike të OKB-së, të shtohen shkëmbimet, të zhduken ose të pakësohen pengesat doganore, të ndërhyhet së bashku për të favorizuar përparimin e zonave të pazhvilluara» (pika 10, § 10). Në këtë mënyrë me tezat e tyre revizionistët italianë u afrohen tezave të Titos, tezave të Hrushovit dhe më në fund tezave bazë të Kenedit: «Më parë integrimi i Evropës, dhe pastaj integrimi i saj me Amerikën...».

*Botohet për herë të parë sipas
dorëshkrimit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

NAFTA PËR NE ËSHTË NJË ÇËSHTJE ME SHUMË RËNDËSI

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

10 dhjetor 1962

Raporti që na është paraqitur ka një hyrje shumë të gjatë dhe përmban plot detyra për të kryer. Gjëra të tilla nuk i duhen dhënë Byrosë Politike. Gjersa ju, shokë drejtues të naftës, i dini detyrat që keni, atëherë pse i numëroni një për një? Ju jeni të zanatit dhe duhet t'i zbatoni këto detyra, sepse janë tuajat. Kështu si po bëni ju duket sikur na thoni që «i dimë këto çështje, por po na pengojnë që t'i zgjidhim».

Kini parasysh, shokë, se shteti harxhon fonde të mëdha për çështjen e naftës. Byroja Politike dhe Qeveria, në planin e vitit 1963, pas shumë diskutimesh

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti «Mbi përfundimet e arritura në industrinë e naftës gjatë vitit në vazhdim si dhe mbi realizimin e kërkimeve gjeologjike për mineralet e dobishme dhe masat që duhen marrë për shfrytëzimin e vendburimeve të reja në të ardhmen».

kanë bërë mjaft shkurtime në investime dhe ndërtime, bille u arrit sa të shkurtoheshin edhe nga fondet që duheshin për preqatitjen e kuadrit. Këtë, ju, shokë të naftës, duhet ta keni parasysh, sepse shpenzimet që bëhen për naftën, megjithëse janë të mëdha, ne nuk i kemi prekur, duke vlerësuar si duhet këtë sektor me rëndësi të madhe për ekonominë tonë. Momentet e vështira që po kalojmë ju i dini mirë. Ne i kemi kapërcyer këto vështirësi, të cilat kanë ndikuar dhe do të ndikojnë akoma në gjendjen tonë ekonomike. Ne jemi të bindur se vështirësitë që po na dalin do t'i kapërcejmë, por kjo kërkon një punë këmbëngulëse, shumë të kontrolluar dhe rigorozë.

Siq thanë të gjithë shokët që folën, orientimi i dhënë për naftën është i drejtë dhe ne kemi besim se punëtorët e kuadrot tanë të naftës do të punojnë me këmbëngulje për ta vënë në jetë këtë orientim. Ne jemi optimistë se do të gjejmë fusha të reja naftë. Por ne të kemi parasysh edhe orientimin tjetër që të mos largohemi nga fushat ekzistuese. Ja, për shembull, prodhimi në Marinzë për vitin 1963 nuk mund të zgjidhet si duhet me metodat sekondare që punohet tani, atje duhet të përdoren metodat më të mira që njihen dhe që mund t'i vëmi në jetë.

Metodat sekondare të mos i hedhim poshtë, por të mos pengojmë ato metoda që na kanë dhënë rezultate më të mira dhe forcat të mos i ndajmë në shumë drejtime. Gjithashtu të mos angazhojmë forcat me një eksperiment që mund të jetë i mirë, por që na kushton shumë.

Këtu u fol për eksperiencën që rrit rendimentin,

këtë ta përdorim në mënyrë të tillë që jo vetëm të kemi rezerva për vitin 1964, por shpim-shfrytëzimi, duke përmirësuar treguesit tekniko-ekonomikë, të zgjerojë konturet e Marinzës, të Qytetit Stalin dhe të Patosit, me qëllim që të dimë se çfarë kemi më tutje, natyrisht brenda fondeve të caktuara. Në qoftë se kemi pika shpimi për zgjerim, të ecim më tutje, por në qoftë se shpojmë ku nuk kemi pika të mbështetura në studime të sakta, nuk veprojmi drejt. Prandaj Ministria e Minicerave dhe e Gjeologjisë ta shikojë këtë çështje se mund të jetë e leverdishme.

Në vendet e tjera nxirret naftë edhe nga gëlqerorët. Shtresa gëlqerore ka edhe vendi ynë, në të cilat ka shenja naftë, prandaj duhet të studiojmë eksperiençën e këtyre vendeve dhe të kërkojmë edhe në këtë drejtim duke bërë studime të thella e të plota.

Bashkëpunimi juaj, shokë të naftës, të bëhet në frysme shoqërorëc. Mund të ndodhë që edhe të nxcheni me njëri-tjetrin gjatë diskutimit të një problemi, por për hir të punës duhet ta mblidhni velen, të keni kurdoherë parasysh çështjen e madhe të popullit, të tjerat janë çështje të dorës së dytë. Mendoni në radhë të parë interesin e popullit dhe të Partisë dhe atëherë do të gjeni rrugën e bisedimeve, mirëkuptimin. Ne kemi besim se naftëtarët tanë heroikë do të mobilizohen me të gjitha forcat për t'i dhënë atdheut sa më shumë naftë.

Në naftë ka kurdoherë të papritura, po edhe sektorët e tjerë nuk janë të lichtë për t'u drejtar. Prandaj ashtu si bëhet në sektorët e tjerë, edhe ju, shokë të naftës, përpinquni që të jepni rezultate sa më të mëdha.

Gjer tani në këtë drejtim ju keni dhënë mjaft prova të mira.

Si konkluzion mund të themi se duhet luftuar më shumë me vështirësitë, duhen bërë përpjekje që planet t'i realizojmë. Nga kjo mbledhje m'u forcua edhe më shumë përshtypja se Ministria e Minierave dhe e Gjeologjisë duhet të interesohet më shumë edhe për naftën, ashtu siç vepron për minierat.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

**VEPRAT E BREZIT TONE DO TË DUKEN TË VOGLA
PËRPARA ATYRE QË DO TË BEJNË BREZAT
E ARDIISHËM**

*Nga fjala para nxënësve dhe mësuesve të gjimnazit
të Shkodrës me rastin e 40-vjetorit të tij*

16 dhjetor 1962

Të dashur nxënës dhe mësues,

Kur u nisa për në Shkodër mendova nëse do të ishte më mirë të prepatitja një fjalim akademik, siç është zakon të bëhet në këto raste jubilare nëpër shkolla dhe ta harxhoja këtë pjesë të kohës duke u marrë me hartimin e fjalimit, me rregullimin e stilit, të frazave e të ortografisë, apo t'i shfaqja këtu para jush ndjenjat dhe mendimet e mia të thjeshta për gjimnazin e dëgjuar të Shkodrës. Kështu vendosa ta lija mënyrën e parë dhe të flisja para jush me gjuhën e thjeshtë të popullit. Ne e dimë se shkodranët janë të zotë, jo vetëm për pushkë, kur e lyp çështja e madhe e mbrojtjes së atdheut, por edhe për penë. Shkodranët janë të dalluar për prozë, poezi, muzikë, dramë si dhe për humorin e tyre të hollë. Megjithatë mendova të

flas pa shkruar, dhe besoj se nuk do të ma vini re që s'i kam ndërtuar më parë fjalët që do të them.

Me këtë rast gjëzimi, dëshiroj t'ju transmetoj nga zemra përshëndetjet më të nxchta të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike dhe të miat! Partia dhe Komiteti Qendror, duke shprehur ndjenjat e vërteta, të thella dhe të pastra të të gjithë komunistëve dhe të popullit tonë, kanë një respekt të madh, dashuri e mirënjojje të pafund për gjimnazin tuaj, si një nga shkollat më të lavdishme të Shqipërisë. Ky gjimnaz, që edukon brezin e ri të Shkodrës, ka historinë e vet, gjatë së cilës të rinxjtë dhe të rcjat, që kanë kaluar në të kanë treguar zotësi, zgjuarsi dhe sidomos një patriotizëm të madh. Dhe nuk mund të ishte ndryshe, për arsyen se nxënësit e nxënëset e tij, së bashku me pedagogët patriotë që jepnin mësim në këtë shkollë, ishin bij dhe bija të popullit heroik të Shkodrës, ishin bijtë e bijat e punëtorëve të mjeruar dhe të ishatarëve e të malësorëve të rraskapur të kohës së errët të Zogut dhe të pushtimit italian e gjerman. Ata vazhduan rrugën e prindërve, mëmave dhe baballarëve, të motrave e vëllezërve të tyre të kohëve më të lashta.

I gjithë populli shqiptar, i madh e i vogël e dinë mirë se nga radhët e rinisë shkodrane e veçanërisht nga gjimnazi i Shkodrës kanë dalë heronj të lavdishëm të popullit tonë. Ata nuk kursyen jetën e tyre, po u hodhën në zjarr e në flakë për çlirimin dhe të mirën e popullit, për të thyer përgjithmonë prangat e robërisë. Nga gjimnazi juaj qindra partizanë kanë marrë pjesë në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe me

luftën e tyre të pamëshirshme kundër armiqve, në male e në qytete, frymëzuan masat e popullit në greva, në protesta, në demostrata dhe në luftë të armatosur. Shumë prej tyre kanë udhëhequr repartet partizane në luftërat dhe betejat e lavdishme për t'i sjellë popullit këto ditë të lumtura që gjëzon sot. Nga gjimnazi juaj kanë dalë gjithashtu dhjetëra e dhjetëra kuadro të Partisë dhe të shtctit, të cilët dje ishin nxënës si ju, kurse sot janë duke drejtuar sektorë të ndryshëm nga më të rëndësishmit në vendin tonë.

Në bankat e kësaj shkolle, brenda këtyre mureve, kanë mësuar, kanë punuar e janë lodhur shokët e shqet tona. Këtu ata kanë shprehur pikëpamjet, qëllimet dhe dëshirat e tyre të zjarrta, që shtypeshin e ndrydheshin, në ato kohë të vështira. Por ata kurrë nuk u përkulen, ata ecën përpara, sepse i frymëzonin ndjenjat përparimtare të popullit, mjerimet dhe vuajtjet e tij. Këto dëshira i nxitnin ata në luftë për t'i dhënë popullit liri, për shpëtimin e tij. Në këtë rrugë këta luftëtarë të lavdishëm u frymëzuajn nga familjet e tyre, nga pedagogët dhe nga i gjithë ambienti ku ata jetojnë. Dhe kur erdhi dita ata e treguan me gjakun dhe jetën e tyre edukatën që kishin marrë, vendosmërinë dhe zotësinë e tyre. Për të gjitha këto ju, nxënësë e nxënës të dashur, duhet të jeni krenarë, të jeni krenarë për shkollën ku mësoni, për traditat luftarake të saj!

Përpjekje e sakrifica të mëdha u bënë nga prindërit, gjyshërit e stërgjyshërit tanë për t'ia arritur ditës së çlirimt të atdheut. Ata, në kushtet e regjimeve të egra të terrorit dhe të shtypjes, kanë luftuar, janë dje-

gur e janë vrarë për të mbajtur gjallë gjuhën e bukur shqipe, për ta zhvilluar atë më tej, për të futur thellë shkrimin e këndimin në masat e popullit fukara, te i cili kishte varur shpresat e veta dhe Ismail Qemali. Ky patriot i shquar, pavarësisht se rridhte nga një derë e lartë, ishte me popullin dhe gjer në vdekje ka luftuar për interesat dhe lirinë e popullit shqiptar, megjithëse një kohë të gjatë e kishte kaluar në Stamboll. Në Perandorinë Turke Ismail Qemali ishte një nga figurat kryesore të liberalizimit demokratik, ishte sypatrembur dhe nga ata të paktë që guxonin të atakonin regjimin mesjetar të sulltanëve. Me guximin e trimërinë e tij Ismail Qemali iu imponua atyre aq sa ta respektonin edhe vetë sultani e xhonturqit. Kur ishte puna për të dalë nga situata shumë të vështira, drejtuscit e shtetit turk, që s'linin gjë pa bërë dhe që e goditën këtë «shqiptar të urryer» në parlamentin turk, detyroheshin të kërkonin edhe mendimin e tij. Dhe ky patriot i madh shqiptar ua përplaste pa ngurrim të vërtetën në sytyrë armiqve. Por për Shqipërinë, për popullin tonë, nuk ka luftuar vetëm Ismail Qemali, për të kanë luftuar edhe sa e sa patriotë të tjerë të shquar, gjer tek ata të Luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare, ku morën pjesë edhe shumë nga të rinjtë e gjimnazit tuaj. Prandaj gjimnazi juaj e meriton emrin e lavdishëm «29 Nëntori» që i është vënë; e mbani atë lart e më lart si flamur të papërkulur sa të jetëjeta!

Dyzet vjet ka gjimnazi juaj që është themeluar, por shkollat nuk plaken kurrë. Edhe sikur të jenë

100-200 ose 500-vjeçare ato mbeten kurdoherë të reja, sepse mbushen çdo vit me përsaqësues të brezit të ri, që sjellin vazhdimisht shpresa të reja, këngë e gëzime për jetën dhe dashuri për punë e përmësim.

Por duke qenë se në shkolla çdo vit hyjnë të rinj e të reja, nuk plaken as mësuesit. Diku kam lexuar se mësuesit rrojnë më shumë se njerëzit e profesioneve të tjera dhe plaken më vonë. Mos vallë puna e tyre nuk është e lodhshme? Në të vërtetë puna e mësuesit është shumë e lodhshme, më e lodhshme edhe se shumë profesione të tjera. Por çështja është se mësuesi ka të bëjë kurdoherë me të rinj e të reja, që janë gjithnjë të qeshur c' të gëzuar, prandaj ai që i edukon përtërihet, si të thuash, çdo ditë. Dhe ata që janë të gëzuar e optimistë në jetë, rrojnë më shumë. Mësuesit, më shumë se njerëzit e çdo profesioni tjeter, kanë të bëjnë me të rinjtë, ata ndiejnë kënaqësi të madhe se punojnë me rininë, të ardhmen e vendit, ata rrojnë me gëzimin e një shprese të madhe në shpirtin e tyre. Kur mësuesi vjen çdo mëngjes në shkollë, sa merr takim me nxënësit e vet, hallet familjare dhe ekonomike i harron dhe menjëherë i çelet fytyra. Për këto arsyqe mësuesit dhe pedagogët kurrë nuk duan të ndahen nga shkolla. Në përgjithësi të vjetrit duan të rrinë me të rinjtë, sepse këta u komunikojnë pleqve vrullin' dhe entuziazmin e tyre, dëshirat e tyre të zjarrta. Por njëkohësisht edhe pleqtë u japin të rinjve eksperiencën e tyre të madhe në jetë dhe në luftë. Prandaj ekziston një dashuri e madhe midis nxënësve dhe mësuesve, një unitet

mendimi dhe veprimi, një sinqeritet në marrëdhëniet midis tyre.

Por duhet thënë dhe një gjë se të tilla marrëdhënie midis nxënësve e mësuesve në të kaluarën nuk ekzistonin, ato atëherë ishin të turbullta, për vetë faktin se në radhët e mësuesve kishte dhe të tillë që ishin të lidhur me pushtuesin e i shërbenin atij, megjithëse shumica ishin të mirë. Prandaj midis nxënësve dhe mësuesve krijuarët shumë herë situata të vështira, grindje e zënie.

Këtë e ndërlidon dhe fakti se atëherë kundër shkollës bëhej një luftë e pamëshirshme, e fshehtë dhe e hapët. Regjimi feudoborgjez nuk donte që djemtë dhe vajzat e popullit të mësonin nëpër shkolla, ai kishte frikë nga kjo, se populli duke mësuar do t'ia bënte varrin më shpejt. Prandaj në kohën e rregjimit të Zogut shkollat jo vetëm që ishin të pakta, por merreshin dhe masa të tilla që në to të venin sa më pak nxënës. Pastaj, kur mbaroje shkollën, nuk kishe asnjë perspektivë se ku do të shkoje dhe çfarë do të bëje. Për maturantin, e ardhmja për të mësuar në universitet, nuk ishte e sigurt; për të marrë ndonjë bursë duhej përkrahje, sepse edhe sikur ndonjëri «të kishte satin» të merrte bursë, kjo jepej me një mijë bela. Kështu, ai që mbaronte të mesmen s'dinte ku të vente, se në vend universitet nuk kishte, bursë s'merrte dot, industri nuk kishte, ndërtimë nuk bëheshin, prandaj edhe perspektivën e kishte të errët. Megjithatë nuk mund të mohohet se me vullnetin e mësuesve patriotë, nga ato shkolla të pakta që ishin hapur në kohëra aq të errëta, dolën një mori njerëzish të mësuar, që iu përveshën punës me mundësitë e pakta

që kishin dhe, kur erdhi koha, luftuan krah për krah punëtorëve. Ish-nxënësit e studentët e asaj kohe u hodhën në luftë, u treguan revolucionarë të vendosur, nuk kursyen asgjë për lirinë e atdheut e të popullit. Dhe nga lufta e tyre dhe e gjithë popullit, të udhëhequr nga Partia, vendi u çlirua dhe tanë populli po ndërtton jetën e tij më të mirë, socializmin.

Tani kushtet e shkollave, në krahasim me të kluarën, kanë ndryshuar si dita me natën. si përsa i përket trupit mësimor, ashtu edhe pajisjes së tyre me çdo gjë. Po kryesore është se tanë në këto shkolla mësojnë me zell të madh me dhjetëra mijëra të rinj e të reja. Dhe ato e dinë përse mësojnë, ato dinë gjithashtu se e ardhmja e tyre është e sigurt. Prandaj fryma e shkollës sonë të re ka ndryshuar krejtësisht dhe atje shohim një zhvillim aq të madh, saqë ne të vjetërve, që dimë sa prapa kemi qenë, na bëhet zemra mal. Njohuritë që merrni ju tanë në shkollën e re janë shumë më të mëdha e më të shëndosha në krahasim me ato që kemi marrë ne në shkollën e kohës sonë. Kjo ndodh se të rintjtë tanë, të lindur e të rritur në socializëm, marrin pjesë aktivisht në ndërtimin e vendit, ata jetojnë me aspiratat e mëdha të popullit dhe janë të lidhur ngushtë me të. Të rintjtë dhe të rejat shikojnë qartë se çdo gjë që bëhet është për të mirën e popullit, për sigurimin e tij dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të jetës së tij. Pikërisht për këtë të rintjtë tanë shkojnë në shkollë me dëshirë të madhe dhe mësojnë me zell. Ne shohim tanë se nga shkollat tonë të reja dalin me shumicë inxhinierë, mjekë, njerëz të profesioneve të ndryshme, të cilët, kudo që dërgohen punojnë me zotësi

të rrallë, marrin përsipër dhe kryejnë detyra të vësh-tira. Ju e dini se tani në ndërmarrjet tona ekonomike punojnë vetëm specialistë shqiptarë dhe punët na shkojnë akoma më mirë se përpara; edhe shkollat drejtohen shumë mirë nga arsimtarët tanë. Kështu është puna edhe me fabrikat, minierat, ndërmarrjet bujqësore, koo-perativat etj. Kjo ndodh se ata që kanë mbaruar shkollat e larta osc të mesme profesionale, e gjer te punëtorët e kualifikuar, të gjithë e kanë kuptuar si duhet detyrën e madhe që kanë ndaj vetes, familjes dhe popullit. Kështu, të gjithë këta, duke kaluar nga bankat e shkollave dhe makineritë e fabrikave, kanë pasur parasysh të ardhmen e shkëlqyer që i pret dhe detyrat që u ka vënë përpara Partia, prandaj kanë vënë të gjitha forcat të prodhojnë sa më shumë e sa më mirë, se vetëm kështu do të përmirësohet jeta jonë, do të zbukurohet atdheu dhe ky do të ecë më shpejt në rrugën e socializmit e të komunizmit, do të forcohet e do të bëhet i paprekshëm nga armiqtë që na rrethojnë.

Pikërisht për shkak të këtyre ndryshimeve që janë bërë e po bëhen në vendin tonë shihet një zhvillim i madh i arsimit, një dashuri e madhe për mësim nga ana e nxënësve. Në kohën tonë, kur nc dilnim nga shkolla dhe venim në shtëpi, atje gjenim prindërit analfabetë, motrat dhe nënën të mbyllura në shtëpi. Tani puna qëndron ndryshe. Kur nxënësit dalin nga shkolla dhe venë në shtëpi, aty gjejnë babanë, nënën, vëllezërit dhe motrat që kanë kulturë, janë në punë dhe të zhvilluar politikisht, që u flasin e i këshillojnë për shumë gjëra. Kështu juve, përveç mësimit që merrni në shkollë, merrni një edukatë të shëndoshë edhe

në familje; shkolla dhe familja forcojnë te ju patriotizmin e madh socialist. Në këtë rruge ju të ecni vazhdimisht se jeni shpresa e atdheut. Partia ka te ju, shokë të rinj e të reja, mbështetjen më të madhe e më të sigurt, ju jeni e ardhmja e atdheut dhe e popullit.

Këto që ka bërë Partia për popullin dhe vendin tonë janë gjëra të mëdha, po përpara atyrc që do të bëjë brezi juaj, veprat që ka bërë brezi ynë do të duken të vogla. Sidoqoftë, për këtë të mos na kritikoni, ne kemi bërë aq sa kemi mundur dhe mbi këto baza ju do të ecni akoma më përparrë. Prandaj i dëgjoni me kujdes mësuesit tuaj, organizatën e Partisë dhe të rinisë së shkollës, mësoni me kujdesin më të madh, sepse çdo gjë që do të bëhet, tani e në të ardhmen, do të arrihet me dituri. Ato që ndërtohen tani në vendin tonë nuk janë më gjëra të thjeshta si ishin përparrë, por janë shumë më komplekse. Po fjalën e kam për zhvillimin e madh që ka marrë mbarë njerëzimi. Sot teknika ka arritur rezultate të mira, shkenca është zhvilluar pa masë, pra dhe ndërtimi i socializmit kërkon njerëz të ditur e të zotë. Në të ardhmen do të kemi fabrika të reja me teknikë më të komplikuar, laboratorë më të pajisur e kompleksë etj. Do të vijë koha që gjëra të tilla do të prodhohen edhe në vendin tonë. Kjo kërkon që ne të kemi sa më shumë njerëz të mësuar e të zgjuar. Të gjitha këto që do të ngremë duhen drejtuar.

Juve, të rinjve e të rejave, ju janë hapur të gjitha mundësítë për dituri dhe shkencë, prandaj kurdoherë duhet të bëni përpjekje sa më të mëdha për të mësuar

mirë në shkollë. Partia dhe shteti do të marrin masa që laboratorët e mjetet shkollore ekzistuese, megjithëse me të kaluarën ato as që mund të krahasohen, të pasurohen e të perfekcionohen më shumë, sepse edhe shkenca ecën përpara. Nga ju kërkohet vetëm një gjë, të vini të gjitha forcat që të mësoni, të dëgjoni me vërejtje e të përvetësoni ç'ju thonë mësuesit tuaj. Edhe unë kam qenë dikur mësues dhe e di mirë rëndësinë e kësaj pune, prandaj edhe një herë ju këshilloj të mësoni dhe përsëri të mësoni. Duhet që çdo nxënës t'u vihet mirë mësimit të shkencave dhe gjuhës shqipe. Për mësimin e shkencave unë kam folur edhe herë tjetër, po tanis dua të theksoj veçanërisht kujdesin që duhet të tregoni për të mësuar mirë gjuhën shqipe.

Të mësosh mirë gjuhën tënde, ta shkruash bukur atë, kjo është një nga detyrat kryesore për të gjithë ne, veçanërisht për ju, brezin e ri. Shqipëria ka nevojë për kuadro të shumtë e të shumëllotë, të cilët duhet ta njojin mirë e me baza gjuhën shqipe, e këtë duhet ta bëjë shkolla jonë, e cila duhet të forcojë kërkosat në këtë drejtim. Mësojeni, pra, mirë gjuhën shqipe!

Pasi foli për situatën ndërkombëtare, për luftën pa kompromis që duhet t'i bëjmë imperializmit, për veprimtarinë armiqësore, përcarëse e reaksionare të grupit revisionist të Hrushovit në dëm të PPSH e popullit shqiptar dhe për veprimtarinë armiqësore të revolucionisteve jugosllavë, shoku Enver Hoxha tha:

Vështirësitë që na u krijuan nga grupi i Hrushovit

duhet të na bëjnë të mobilizohemi në punë, se e ardhmja është jona. Ne kemi ndihmën internasionaliste të RP të Kinës, kemi ndihmën e madhe morale të të gjithë komunistëve të botës. Ne kemi një popull të fortë dhe një Parti si çeliku, me një unitet monolit, që nuk është parë kurrë, duke filluar që nga organizata-bazë dhe gjere në krye, në Komitetin Qendror. Asnjë intrigë dhe asnje dallavere e armiqve nuk mund të gjeknë qoftë edhe të çarën më të vogël në Partinë tonë, dhe kjo është garancia më e madhe për popullin tonë, për të ardhmen e Shqipërisë. Ne i kemi të gjitha mundësitë dhe siguritë për të ndërtuar për popullin tonë një industri akoma më të fuqishme, për të përmirësuar më tej bujqësinë, për të nxjerrë më shumë kuadro, për ta forcuar më tej Republikën tonë Popullore. Në këtë mënyrë ne ndihmojmë edhe për dobësimin e mëtejshëm të imperializmit.

Ne do t'i kryejmë të gjitha këto detyra, sepse në krye kemi Partinë që na udhëheq. Prandaj së bashku me të vjetrit, edhe të rinjtë kudo që janë, të vënë të gjitha forcat për të mësuar, punuar dhe për t'u edukuar ashtu siç kërkon Partia. Partia ka detyrë ta bëjë jetën e brezit të ri më të lumtur, më të gëzuar, më të bukur. Por të rinjtë e të rejat t'i futim gradualisht edhe në hallet e jetës, veçse jo menjëherë. Të veprojmë në këtë drejtim si farkëtari që e fut hekurin në zjarr, pastaj i bie vazhdimisht e gradualisht derisa e kalit. Kështu të punojmë edhe ne me rininë tonë.

Unë dëshiroj t'ju them juve, shokëve të Shkodrës, të rinjve e të rejave, se punët në vendin tonë shkojnë

mirë dhe me siguri në të ardhmen do të shkojnë edhe më mirë. Garanci për këtë është Partia jonë.

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë populli shkodran!

Rrofshin nxënësit dhe pedagogët e gjimnazit të Shkodrës, dhe lart e më lart lavdia e shkollës suaj!

*Botohet për herë të parë, me
disa shkurtime, sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**FSHATARËSINË TA MËSOJMË TË DREJTOJE
EKONOMINË E MADHE KOLEKTIVE QË
TË ARRIJË NJË ZHVILLIM TË LARTË
TË BUJQËSISE**

Fjala në aktivin e Partisë të rrethit të Shkodrës

17 dhjetor 1962

Të dashur shokë dhe shoqe,

Sic shikoni numri i shokëve që marrin pjesë në këtë aktiv për intensifikimin e bujqësisë u dyfishua brenda tri orëve. Kjo sallë është mbushur plot, me një fjalë u shtuan pjesëmarrësit. Pra punonjësit e bujqësisë duhet ta marrin seriozisht punën. Ne jemi shqiptarë dhe e kemi zakon që e presim mikun dhe shokëve të klasës punëtore u themi mirë se na erdhët!

Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, marrëdhëni fshat-qytet në vendin tonë çdo ditë kanë ardhur duke u forcuar e duke u kalitur. Ju, shokë punonjës të bujqësisë, jeni të gjuar që shokët punëtorë të Shkodrës ndodhen këtu, dhe së bashku diskutojmë për hallet dhe vështirësitet tuaja. Me këtë nuk dua të them se punonjësit e qytetit nuk kanë, gjithashtu, halle,

po ata hallet e tyre i zgjidhin më shpejt, vështirësitë i kapërcejnë më mirë. Juve, fshatarëve kooperativistë, të udhëhequr nga klasa punëtore, punëtorët ju ndihmojnë pa u kursyer, sidomos duke ju dërguar një nga detachementet më të fuqishme — punonjësit e SMT-së. Pastaj klasa punëtore ju ndihmon edhe me shembullin e saj e ndërgjegjen socialiste në punë.

Këto që ju thashë ishin si hyrje. Tani më lejoni t'ju përshëndes dhe t'ju shpreh mendimin tim, për punimet e këtij aktivivi, të cilat më kanë bërë përshtypje të mirë, sepse si raporti që u mbajt këtu, në emër të byrosë së komitetit të Partisë, nga kryetari i komitetit ekzekutiv të rrethit, shoku Bilal Paruca, ashtu edhe diskutimet e shokëve kryetarë dhe anëtarë të kooperativave, specialistë të mesëm dhe të lartë të bujqësisë, tregojnë pjekurinë e punonjësve dhe të komunistëve të rrethit tuaj në çështjet e bujqësisë.

Është fakt, shokë, se bujqësia jonë ecën çdo vit përpara. Kjo nuk do të thotë se ajo ecën me hapa gjigantë. Sigurisht mund të ishte bërë edhe më shumë, po do të ecet edhe më përpara, se të gjitha përpjekjet tona këtu synojnë. Sidoqoftë në bujqësinë tonë në përgjithësi ka përparime të mëdha, sepse rruga e Partisë, vija e saj edhe për këtë sektor ka qenë dhe është e drejtë, qoftë përsa i përket orientimit politik në lidhje me fshatarësinë kooperativiste, me mekanizimin etj., ashtu edhe përsa i përket orientimit tonë të përgjithshëm. Ne konstatojmë se në bujqësinë tonë, e cila i ka ngjitur shkallët një nga një, nuk ka pasur tronditje e lëkundje, ashtu sikundër ka ndodhur në vendet revizioniste të demokracisë populllore të Evropës.

E vërteta është që në vendin tonë nuk është krijuar bollëku, por furnizimi i popullsisë së fshatit e të qytetit me artikuj të konsumit të gjërë ka ardhur vazhdëmisht duke u ngritur; te ne nuk ka pasur ndonjë çregullim në furnizim, përveç ndonjë rasti të rrallë, të shkaktuar për mungesë organizimi nga ana e organave të tregtisë ose të kooperativave. Me këtë nuk dua të them se këta sektorë nuk kanë punuar mirë, mbasi mungesa të kësaj natyre ka edhe në sektorë të tjera. Sidoqoftë populli është furnizuar kurdoherë në rregull, kurse në disa vendë, si në Bashkimin Sovjetik, Bullgari, Poloni, Çekoslovaki, Hungari etj. këta vjetët e fundit ka pasur tronditje në furnizimin e masave punonjëse me prodhime bujqësore e blegtorale. Në disa nga këto vende janë rivendosur edhe triskat, në mënyrë jo të hapur.

Burimin e vështirësive në këto vende ne duhet ta gjejmë në radhë të parë në çorganizimin e bujqësisë, që është pasojë e ardhjes në fuqi të revizionistëve, siç ndodh në Bashkimin Sovjetik. N. Hrushovi, që llomotit si ndonjë mburravec nga më të ultët se gjoja po lufton për ngritjen e bujqësisë sovjetike, në fakt po e shkatteredon bujqësinë me ndërrimin e kursit në organizimin e në drejtimin e saj, me prishjen e SMT-ve, si edhe me «reformat» e ndërtimit të partisë, që së shpejti do t'u dalë tymi, pasi këto të ashtuquajtura reforma s'po bëjnë gjë tjetër veçse po çojnë në shthurjen e në çorganizimin e partisë. Përveç kësaj, kursi i përgjithshëm revizionist i N. Hrushovit ka shkaktuar pasoja të rënda në tërë politikën e brendshme e të jashtme të BS. Një politikë e tillë, siç mund të kuptohet lehtë, ka

sjellë rënie dhe çmobilizim të masave të gjera të popullit sovjetik. Por kur populli nuk është i bindur në ato veprime që ndërmerr udhëheqja, kur ai sheh se udhëheqja po vepron drejt shkatërrimit të asaj vepre të madhe për të cilën ka derdhur gjak, duhet të jesh i sigurt se ai një udhëheqje të tillë do ta izolojë dhe do ta lërë në rrugë. Dhe në qoftë se populli sovjetik nuk ka mundësi të ngrihet me armë kundër udhëheqjes revizioniste, ai do ta sabotojë programin e saj, sepse ai e sheh ku po e çon N. Hrushovi, e sheh se s'ka asnje arsy që në BS të mungojnë vazhdimesh mishi, sallami, gjalpi etj., prandaj ai po reagon me të drejtë.

N. Hrushovi ka dekluar se do t'i tejkalojë SHBA në prodhimet bujqësore e blegtorale; por tani po hesht, sepse një gjë të tillë nuk e arrin dot, mbasi ekonomia sovjetike, me «organizimet» që po ndërmerr ai, po has në vështirësi të mëdha. Kohët e fundit në gazeten «Pravda» dhe në organet e tjera të shtypit sovjetik shkruhet haptazi për vështirësitë që kanë rrjedhur nga ky «organizim». Po N. Hrushovi nuk e jep veten, dua të them se ai vetë nuk e pohon këtë punë të gabuar, sepse, kuptohet, nuk mund të pohojë dështimin e veprës së tij, mbasi kjo do të thotë falimentim i plotë.

Këto «organizime» që bën vazhdimesh N. Hrushovi në drejtim të partisë, të shtetit, të industrisë, të bujqësisë etj. krijojnë një konfuzion të jashtëzakonshëm, pasiguri dhe kaos. Në mjegullën e tymin e këtyre veprimeve dalin ujqit, shfrytëzuesit, spekulatorët, kulakët. Këto kategori njerëzish po e largojnë Bashkimin Sovjetik nga rruga marksiste-leniniste e ndërtimit socialist.

Krejt ndryshe qëndrojnë punët te ne. Bollëk ne akoma nuk kemi, por populli çdo vit është furnizuar gjithnjë e më mirë, çmimet në këta dy vjet jo vetëm nuk janë ngritur, siç ka ndodhur në disa vende sociale të Evropës, por përkundrazi kemi një stabilitet në ekonomi dhe në çmime. Fshatarësia jonë është mobilizuar në punë me të gjitha forcat, se shesh shembullin që jep klasa punëtore, e cila i mban zotimet, e ruan aleancën me të, e ndihmon atë që të përparojë. Kështu lidhjet midis klasës punëtore dhe fshatarësisë sonë punonjëse kanë qenë jashtëzakonisht të ngushta, të tilla ato do të jenë edhe në të ardhmen.

Në këto situata të vështira që ne po kalojmë për të ccur përpara në rrugën tonë, Komiteti Qendror i Partisë i ka kushtuar një rëndësi të madhe bujqësisë. Partia kurdoherë i ka dhënë rëndësi asaj, po këtej e tutje ne duhet të shtojmë edhe më shumë kujdesin dhe përpjekjet tona për të, me qëllim që në bujqësi të arrijmë të ecim me një hov më të madh për t'i dhënë popullit më shumë prodhime bujqësore e blegtorale dhe për t'u bërë ballë vështirësive që na krijuan revizionistët. Duhet të themi se vështirësi kemi e ndofta mund të kemi edhe më shumë në të ardhmen, sepse jemi në luftë me armiq të mëdhenj, siç është imperializmi dhe revizionizmi modern, agjenturë e imperializmit. Por ne kemi besim se kësaj lufte do t'ia dalim imbanë, sepse nuk jemi një vend dhe një parti e izoluar dhe se në rrugën tonë të drcjtë marksiste-leniniste janë me miliona komunistë dhe punonjës në të gjithë botën. Ne jemi më të fortë, se me ne është drejtësia. Ne do të fitojmë se populli dhe Par-

tia jonë kanë dhënë prova guximi e vendosmërie për kapërcimin e vështirësive. Të mos flasim për të kaluarën e zezë të largët të popullit tonë, po të kujtojmë se si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe gjatë këtyre 18 vjetëve populli ynë ka luftuar me armiq të shumtë dhe të armatosur me të gjitha mjetet, me vështirësi të panumërtë dhe ka fituar. Ai ka luftuar me vendosmëri kundër bllokadës së egër të revizionistëve dhe ka këpçyer me sukses të gjitha vështirësitë e shkaktuara nga ajo; sa më të mëdha kanë qenë vështirësitë aq më të mëdha kanë qenë edhe sukseset. Prandaj situatën ta shikojmë realisht dhe në bazë të këtij realiteti të mobilizojmë të gjitha forcat tona për të ecur përrapa.

Edhe ju, shokë të rrethit të Shkodrës, keni shumë punë për të bërë, po të gjithë së bashku do t'i kryejmë detyrat me ndër dhe do të arrijmë sukseset. Tani ne duhet të preokupohemi edhe më shumë për bujqësinë, prandaj pikërisht për këtë sektor desha të thoshja disa fjalë edhe për rrethin tuaj.

Shkodra është një rreth me një industri të mirë, e cila në këtë pesëvjeçar do të rritet edhe më tepër. Për këtë qëllim kanë filluar punimet e para për ngrijjen e fabrikave të reja. Kjo na gjëzon të gjithë, sepse zhvillimi industrial shton potencialin ekonomik të rrethit dhe të të gjithë Shqipërisë. Mundësitë për zhvillimin e industrisë në Shkodër, nga ana e lëndës së parë, kanë ekzistuar dhe ekzistojnë. Veç asaj, këtu ka edhe një klasë punëtore të sprovuar dhe të talentuar. Komiteti Qendror i PPSH dhe Qeveria janë të kënaqur nga puna e punëtorëve të Shkodrës ku shumë kolektiva

realizojnë e tejkalojnë planet. Kjo nuk do të thotë se në këto qendra pune ka vetëm rezultate të mira. Siguarisht ka edhe të meta e vështirësi si kudo, por me punë e përpjekje ato do të zgjidhen.

Por Shkodra është edhe një rreth bujqësor me rëndësi. Në përgjithësi Komiteti Qendror i Partisë ka mendimin se shokët e komitetit të Partisë, të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor dhe të gjithë kuadrot në rreth tani po i ndjekin punët më mirë edhe në sektorin e bujqësisë, po i ndihmojnë më shumë dhe më konkretisht kooperativat bujqësore. Përmirësime në bujqësi ka pasur te ju në çdo drejtim. Punë e mirë është bërë jo vetëm gjatë fushatave, të cilat, kur nuk janë si zjarr kashte, kanë rëndësi të madhe. Po është konstatuar se në rrethin tuaj kanë ndihmuar kooperativat bujqësore edhe ndërmarrjet ekonomike të qytetit. Me luftën e organizuar që është bërë nga ju kundër vrugut të duhanit, mund të themi se rreziku i madh i kësaj sëmundjeje është kuptuar seriozisht. Ju në kohën e duhur iu përveshët punës në mënyrë shembulllore. Kjo ishte nga ana juaj një luftë e ashpër, ashtu siç është edhe lufta që ju bëni kundër revizionizmit jugosllav, të cilin e keni në kufi. Unë vura re me kënaqësi se shokët e kooperativave bujqësore, që diskutuan përpara aktivit, nuk flenë mbi dafina, ata nuk munguan të përsëritin se edhe në të ardhmen duhen mbajtur sytë hapur kundër këtij rreziku, ata janë të preokupuar e të mobilizuar për luftën kundër vrugut të duhanit, kësaj sëmundjeje të rrezikshme. Kështu, detyrat që janë caktuar t'i keni mirë parasysh e t'i zbatoni si duhet për të marrë prodhim duhani çdo vit e më shumë, sepse vitin e kaluar patëm humbje

jashtëzakonisht të mëdha nga sëmundja. Interesimin e madh që tregoni ju kundër vrugut, është mirë ta kenë parasysh edhe krahinat e tjera.

Ju e dini se grumbullimi i drithit luan një rol të madh në jetën ekonomike të vendit. Klasa punëtore prodhon artikuj edhe për fshatin, po ajo ka nevojë për bukë. Bukë duan gjithashtu edhe ata fshatarë që nuk e prodhojnë vetë. Kjo është gjë e madhe por është për t'u vënë në dukje se ju këtij problemi i keni vënë rëndësi.

Ju keni bërë gjithashtu një punë të mirë edhe me masat që keni marrë për të evituar përmbytjet. Fushat nuk i keni lënë në «mëshirën e zotit», por keni marrë masa konkrete për t'i shpëtuar nga përmbytjet. Kështu të veprohet gjersa të krijohen mundësitë dhe të vijë ajo kohë kur do të ndërmarrim bonifikimin edhe të fushave të rrethit tuaj dhe t'i japim fund kësaj të keqje të madhe.

Përsa u përket forcimit organizativo-ekonomik të kooperativave bujqësore, zbatimit të Statutit ose të vendimeve të Qeverisë ju gjithashtu keni bërë përpjekje. Por lidhur me këto çështje jo vetëm ju, por edhe rrethet e tjera kanë akoma shumë e shumë për të bërë. Në fillim thashë se kooperativistët nuk kanë atë disiplinë që ka klasa punëtore. Kjo është e vërtetë, punëtorët si disiplinën ashtu edhe organizimin e kanë më të mirë. Prandaj në këtë drejtim kooperativistët kanë shumë për të bërë. E vërteta është se tani po zhvillohet një punë më e organizuar e më sistematike për të gjitha këto probleme, por çështja është që në të ardhmen të ecim me ritme më të shpejta.

Duke parë të dhënët mbi bujqësinë e rrethit tuaj, bie në sy se ka sektorë që janë të përparuar dhe të tjerë të prapambetur. Sidomos disa sektorë lënë shumë pér të dëshiruar. Në duhet të kemi parasysh, shokë, se na vihet detyrë që të prodhojmë sa më shumë pér mirëqenien e mbarë popullit. Por që të prodhojmë shumë dhe mirë duhet edhe të mësojmë shumë mirë. Në radhë të parë të mësojnë komunistët, punëtorët, fshatarët. Fshatarësia nga ana e saj duhet të luftojë prapambetjen, mentalitetin e vjetër etj.

Rëndësi të madhe ka çështja që fshatarësinë ta mësojmë të drejto të ekonominë e madhe kolektive, të drejtojë një prodhim të madh, në mënyrë që të arrijë një zhvillim të lartë të bujqësisë. Tani fshatari nuk është më si në ato kohë kur administronte ekonominë e tij individuale me 2-3 hektarë tokë ashtu si mendonte vetë, me mjete primitive dhe që kënaqej me pak. Atëherë fshatari, po të donte të punonte më shumë, nuk kishte mundësi, se i rrinte beu ose agai mbi kokë. Kurse tani kohët kanë ndryshuar. Puna jonë si në industri, ashtu edhe në bujqësi, matet me të ardhurat, me prodhimet. Kështu, po të shohim prodhimet e rrethit tuaj si vlerë, në krahasim me mesataren e Republikës, do të dalë se ju jeni pas. Vlera e prodhimit të përgjithshëm bujqësor pér çdo 100 hektarë si Republikë lëviz nga 2,1 milionë lekë gjer në 3 milionë, kurse Shkodra arrin në 2,4 milionë. Në vitin 1960 si Republikë ka qenë 2,1 milionë, kurse te ju — 2 milionë, më 1961 si Republikë — 2,8 milionë, kurse Shkodra — 2,1 milionë. Edhe në fondin e paprekshëm ju nuk keni arritur akoma mesataren e Republikës. Pér këtë qëllim

ju duhet të luftoni shumë. Po me këtë nuk dua të them se jeni në fund të të gjitha rretheve. Ka edhe të tjera rrethe që janë pas jush, po puna është që rrëthi i Shkodrës, me kushtet që ka dhe traditën e mirë të krijuar, i ka të gjitha mundësitë që të jetë patjetër edhe më përpara. Prandaj fakti që ju jeni nën mesataren e Republikës, duhet t'ju tërheqë vëmendjen seriozisht dhe të luftoni që jo vetëm ta arrini këtë mesatare, po edhe ta tejkaloni. Ju duhet të bëni përpjekje të rritni akoma të ardhurat për çdo 100 hektarë, domethënë të arrini dhe të tejkaloni mesataren si Republikë. Po përkëtë duhet që ju të rritni rendimentet, sepse rendimentet e planifikuara nuk i keni arritur, natyrisht jo se nuk keni punuar, megjithëse mund të kishit bërë edhe më shumë, por ju kanë penguar edhe vështirësitë e natyrës, që gjithashtu duhen llogaritur.

Kryesore dhe pozitive është që në rrethin e Shkodrës ka një farë qëndrueshmërie në çështjen e rendimenteve me tendencë drejt rritjes. Kjo është një gjë e mirë. Kështu këtë vit është plotësuar rendimenti i grurit, kurse në misër ka lëkundje, ka të ngjarë që në misër të mos arrini dot rendimentin, edhe në duhan gjithashtu ka rrezik që të mos e arrini rendimentin e planifikuar. Nga të dhënat që kemi, në duhan mund të arrijmë deri në 5-6 kv për ha., duke llogaritur edhe vjeljen e duhanit vjeshtak, për të cilin ju keni bërë përpjekje. Në rrethin tuaj ka edhe shembuj rendimentesh të mira në duhan. Ju jeni specialistë të duhanit, e njihni dhe e doni këtë kulturë. Ndryshe nga dy vjetët e fundit kur, për shkak të sëmundjes së vrugut, Shkodra ka qenë keq, këtë vit vështirësitë u kapërcyen dhe

ne jemi të bindur se rrathi juaj në të ardhmen do të jetë në ballë të të gjithëve për prodhimin e duhanit.

Përsa i përket mbjelljes së pemëve frutore, nga të dhënët që ka Komiteti Qendror ju e keni tejkaluar planin dhe për këtë sukses unë ju përgëzoj, por tani të gjithë e veçanërisht rinia duhet të kenë kujdes përzënien e pemëve që mbollën.

Kurse në degën shumë të rëndësishme të blegtorisë, me përjashtim të lopës, nuk jeni mirë. Rendimentet e prodhimeve blegtorale nuk i keni pasur të mira, me përjashtim të leshit dhe të qumshtit. Prandaj për blegtorinë duhet të tregoni kujdes shumë të madh.

Pavarësisht nga këto të meta, perspektivat e rrëthit tuaj në bujqësi nuk janë të këqija. Ju keni kooperativa të përparuara dhe jam i bindur se do të arrini rezultate të mira, vetëm duhet mobilizim dhe organizim i mirë i punës.

Tani le të flasim pak më gjerë për Plenumin e KQ të Partisë¹. Plenumi i fundit për intensifikimin e bujqësisë është një Plenum me rëndësi shumë të madhe për jetën e vendit tonë. Komiteti Qendror problemet e bujqësisë i ka shtruar shumë herë, po në mbledhje më të ngushta. Tani ai mendoi të bëhej posaçërisht një Plenum i veçantë për problemin e intensifikimit të bujqësisë, për arsyen se janë krijuar kushtet për t'u hapur perspektivën e ecjes gjithnjë e më përparrë kooperativave bujqësore. Ai vendosi t'u vërë në dorë koopera-

¹ Është fjala për Plumin e 8-të të KQ të PPSH mbajtur më 26-28 tetor 1962 «Mbi masat për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, për sigurimin e rritjes së vazhdueshme të prodhimit bujqësor».

tivistëve një armë të shëndoshë për realizimin e detyres së intensifikimit të bujqësisë, domethënë për dyfishimin e trefishimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale. Duhet ta kemi të qartë, shokë, se kjo detyrë nuk kryhet dot lehtë, ajo nuk bëhet menjëherë dhe as për një, dy ose tre vjet, sepse kur themi të intensifikojmë bujqësinë nuk është fjala të shtojmë 1 ose 2 kv misër për hektar dhe në sipërfaqe të vogla, por të dyfishojmë dhe të trefishojmë prodhimin në shkallë Republike, të arrijmë edhe ne atë nivel që ka arritur bujqësia në vendet e përparuara.

Plenumi i Komitetit Qendror në mbledhjen e vet theksoi se ato që shtrohen përpara punonjësve të bujqësisë dhe gjithë Partisë janë orientime. Raporti i mbajtur me këtë rast i trajton çështjet gjërë dhe thellë. Çdo frazë, çdo udhëzim, çdo orientim i Komitetit Qendror në këtë raport, është thënë në mënyrë të thjeshtë dhe shoqërohet me disa shembuj konkretë, të bazuar në të dhëna të eksperiencës së bujqësisë sonë dhe të vendeve të tjera, si edhe në të dhënat e shkencës. Ato duhet të bëhen objekt i studimeve të thella nga ana e Partisë dhe e kuadrove, veçanërisht e atyre që merren me sektorin e bujqësisë, si edhe nga ana e gjithë fshatarësise së vendit tonë.

Punëtorët kanë disiplinë më të fortë në punë. Duhet të kemi parasysh se klasa punëtore është më e ngritur nga ana kulturore sesa punonjësit e bujqësisë, gjë që ka disa arsyet, të cilat dihen. Edhe sikur të supozojmë që në uzinat e fabrikat tona të ketë po aq inxhinierë sa ka agronomë, zooteknikë e veterinerë në bujqësi, prapëseprapë nuk mund të bëjmë dot krahasi-

me midis tyre, sepse në uzina, fabrika, miniera e në çdo ndërmarrje tjetër nuk janë vetëm inxhinierët që janë të kualifikuar, por ka edhe qindra të tjerë si mjeshtër, kuadro të mesëm e gjer punëtorë të thjeshtë, që në zanatin e tyre janë njerëz të përparuar. Prandaj në këto qendra industriale, kolektivi në tërësi është me një kulturë relativisht më të lartë, kurse në bujqësi nuk është kështu. Në bujqësi puna është më e rëndë, më e gjerë, më e përhapur, veç kësaj atje shumë gjëra varen dhe nga shiu, breshëri ose thatësira, kurse në fabrika nuk ka të tilla të papritura si në bujqësi, në to çdo gjë hyn e gatshme si lënda e parë ose gjysmë e fabrikuar. Prandaj duhen bërë përpjekje që të gjithë kooperativistët t'i ngremë vazhdimesht. Kjo është çështje vendimtare dhe një detyrë e madhe e Partisë dhe e të gjithë kua-drove që punojnë në sektorin e bujqësisë. Duhet të bëhen përpjekje për ngritjen e nivelit agroteknik të të gjithë masës së fshatarësise, dhe kjo jo duke folur nga lart, por duke punuar, ashtu siç bën agronomi i ri i Bushatit që shkon në vend dhe ato që di ua mëson kooperativistëve dhe bashkë me ta qëndron në shi e në baltë për t'i zbatuar konkretisht në jetë. Po deshe të merresh me bujqësinë duhet ta duash tokën, duhet t'u qëndrosh pranë prodhimeve, se puna në bujqësi nuk bëhet duke ndenjur në zyrë dhe duke e parë atë me dylbi.

Cështja e zhvillimit të bujqësisë është një çështje e madhe dhe e rëndësishme. Do t'ju them një anekdotë të jetuar. Partia Komuniste e Francës ka pasur një anëtar të Byrosë Politike, një shok të lavdishëm që ka vdekur, e quanin Pol Vajan Kuturie. Në kujtimet e tij ai tregon se ishte djalë i një artisti. Prindërit kishin një

shërbyese, që u rriste djalin. Kur Kulturie ishte 5-6 vjeç, një ditë shërbyesja e kishte qortuar dhe ky i nxehur e shau me fjalët «fshatare e qelbur». Ajo s'e rrahu, po e rrëmbeu, e çoi në kopësht dhe atje ia mbushi gojën me baltë duke i thënë: «Kjo të ushqen». Dhe vërtet kështu është. Bujqësia është e shenjtë se ajo na ushqen të gjithë.

Prandaj kuadrot tanë, ato që dinë t'ua mësojnë kooperativistëve atje në fshat, në baltë, në shi ose në dëborë dhe në këtë mënyrë të kujdesen që të ngrihet niveli i tyre. Kjo ka rëndësi se kur kooperativisti të mësojë nga se vjen vrugu, si të evitohet e të luftohet ai, kur të kuptojë rëndësinë e punimit të thellë të tokës ose rrezikun e buburrecit etj., etj., atëherë rezultatet do të janë më të mira. Dhe këto gjëra nuk janë të vështira të kuptohen nga fshatari ynë, se ai ka prirje për bujqësi, është edhe përparimtar, ai ka dhënë prova se e hedh poshtë shpejt të vjetërën dhe përqafon të renë. Kur të kuptojë, pra, mirë çështjet kooperativisti ynë, atëherë do të shihni se si do ta intensifikojmë ne bujqësinë.

Raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror, që mbajti në Plenum shoku Hysni Kapo, ju duhet ta punoni me kujdes në organizatat-bazë të Partisë. Po vetëm mos kujtoni se me kaq puna mbaron. U thashë edhe shokëve sekretarë të komiteteve të Partisë të rretheve që specialistët tuaj të bujqësisë, për çdo gjë që ngrihet në raport, si për shembull për plugimet e thella, për luftën kundër sëmundjeve ose për kullimin e tokave etj., në bazë të orientimeve që jepen aty, të preqatitin seminare shkencore dhe praktike, me mësime

të thjeshta, po edhe të thella dhe t'i mësojnë kooperativistët një, dy ose tri ditë me radhë. Kjo punë të bëhet me kohë dhe e pregetit sa më mirë, në mënyrë që njerëzit të përfitojnë konkretisht, dhe të jeni të sigurt se për këtë ndihmë kooperativistët do t'u jenë mirënjo-hës Partisë, kuadrove e specialistëve të bujqësisë. Kjo do të jetë një ndihmë efektive, sepse vetëm duke shkuar në vend agronomët nuk arrijnë dot të ndihmojnë të gjithë fshatarët. Kur agronomi të ketë pregetitur me dhjetëra kuadro të astë në kooperativën bujqësore, që të dinë si të punojnë tokën, që të dinë sa centimetra është kufiri i humusit, kufi që nuk duhet kapërcyer gjatë punimit të thellë të tokës, si duhen bërë punimet për kullimin e tokave e probleme të tjera, një agronom i tillë, edhe në qoftë se ka nën mbikëqyrjen e tij një sipërfaqe të madhe toke, është i qetë se njerëzit që ka mësuar e që ka udhëzuar, brigadierët, traktoristët, kooperativistët, dinë si të punojnë dhe mjafton për të që të shkojë për kontroll e udhëzime herë pas here. Pra mos ta quajmë të mbaruar punën vetëm me punimin e raportit që u mbajt në Plenum. Pastaj, vetëm me një raport ne nuk i themi dot kooperativistit mbi çdo gjë që duhet të bëjë; veç asaj, specialistët e bujqësisë është e ditur që i njohin shumë më mirë nga ne problemet e bujqësisë, ata dinë të grumbullojnë edhe eksperiencën më të mirë dhe t'ia përshtatin çdo vendi, në mënyrë që të ecet përpara.

Ne i kemi të gjitha kushtet ta intensifikojmë bujqësinë. Të intensifikosh bujqësinë do të thotë që në një tokë të caktuar të përqendrojmë sa më shumë investime, që ne të shtojmë mjetet e punës dhe të zbatoj-

më një agroteknikë të përparuar. Kjo do të thotë të marrim prej saj sa më shumë prodhime. Por që t'ia arrijmë kësaj duhet të përqendrojmë te kjo tokë shumë forca materiale e mendore. Me pak fjalë, ne duhet të vëmë të gjitha përpjekjet që të marrim nga e njëjtë sipërfaqe toke sa më shumë prodhime bujqësore e blegtorale. Këtë rrugë na e hapi Kongresi i 4-t i Partisë. Për këtë qëllim janë marrë masa dhe ne kemi arritur rezultate, bile në disa zëra kemi arritur rezultate që janë baras me nivelin e disa vendeve, të cilat përdorin plehun kimik me bollëk. Këto rezultate i kemi arritur sepse puna është organizuar më mirë, SMT-të gjithash tu punojnë mirë, janë bërë përpjekje për të grumbulluar sa më shumë plëh organik etj.

Por për të ecur përpara edhe më shpejt ne duhet të kemi parasysh edhe disa udhëzime themelore që jepen në raportin e Komitetit Qendror, të cilat përbëjnë kodin agroteknik. Prandaj 7 pikat e kodit agroteknik t'i bëjmë bazë të agroteknikës sonë dhc për zbatimin e tyre t'u rrimë gjithnjë pranë kooperativistëve, gjersa t'u bëhen atyre shprehi, jetë. Një patriot plak në Fier, baba i dy dëshmorëve, gjatë kohës së luftës, kur i jepej ndonjë porosi, meqë ishte analfabet, thoshte: «Po është në rregull me pikat e Partisë, unë jam dakord ta kryej». Ndërsa kooperativisti ynë sot është shumë përpara, ai kërkon që, kur të bëhet fjalë për këto 7 pika, të dijë ç'janë këto, përse duhet t'i zbatojë dhe si duhet t'i zbatojë.

Tani unë ndoshta do t'ju mërzis duke i përsëritur këto pika të kodit agroteknik, do të flas ndoshta jo si shokët parafolës që janë specialistë, se unë

specialist si ata nuk jam, por ndonjë gjë do t'jua theksoj, mbasi më ka ngarkuar Komiteti Qendror, pse janë çështje me rëndësi të madhe.

Një nga detyrat kryesore të kodit agroteknik është të plugojmë thellë tokat sepse plugimi i thellë përmirëson regjimin ujor, ndihmon në ajrosjen më të mirë të bimëve dhe në prishjen e barërave të këqija; pastaj kur një toke të pluguar thellë i kalohet lesa ajo bëhet edhe më e mirë. Në raport ka shembuj konkretë që tregojnë se sa thellë duhet punuar toka. Në Institutin e Kërkimeve të Lushnjës vite me radhë janë bërë eksperimente për pambukun dhe për bimë të tjera në lidhje me këtë problem.

Desha t'ju them, në parantezë, që sekretarët e organizataave-bazë të Partisë, kryetarët e kooperativave bujqësore, brigadierët etj. jo vetëm të mos mbeten pa e lexuar raportin që u mbajt në Plenumin e Komitetit Qendror, por secili, kur ka pak kohë të lirë, ta nxjerrë e ta lexojë e rilexojë këtë raport. Nuk është nevoja të lexohet i gjithë raporti menjëherë, por kur je në kohën e plugimit, nxirre dhe lexo atë pjesë që bën fjalë për plugimin e thellë dhe vrite pak mendjen sa thellë duhet punuar konkretisht toka që ke përpara. Raporti i Komitetit Qendror, pra, të jetë si një udhëheqës për veprim për çdo punonjës të bujqësisë. Njerëzit të kuptojnë, midis të tjerash, përfitimet e mëdha që sjell lëvrimi i thellë i tokës. Sipas llogarive që janë bërë e që u thanë në Plenum, në qoftë se bëhet plugimi i thellë i tokës sipas rregullave agroteknike dhe udhëzimeve të Komitetit Qendror, vetëm nga ky opera-

cion mund të merren 8-10 kv/ha më shumë drithë. Më 1965 ne do të bëjmë afro 150 mijë hektarë qilizmë. Të mos pretendojmë të marrim 8-10 kv/ha më shumë, se kjo mund të duket një gjë e madhe, po sikur të marrim vetëm 4 kv/ha, do të kishim 60 mijë tonë drithë më shumë. Pra na del detyrë të marrim masa për të bërë sa më shumë qilizmë. Për këtë qëllim ne kemi traktorë, ata do t'i shtojmë çdo vit edhe më shumë, bile qysh tani jemi duke i shtuar. Parullën e hedhur në Kongresin e 4-t të Partisë për të bërë tokën qilizmë, çdo 3-4 vjet, Plenumi i KQ e ka avancuar duke vendosur që t'i bëjmë tokat qilizmë në dy-tre vjet me mjete të mekanizuara. Sidoqoftë ne nuk duhet të harrojmë e të lëmë pas dore edhe aktivizimin e krahëve të punës për të bërë qilizmë, sepse, po të mos e bëjmë këtë, në vend që të fitojmë, do të humbasim. Sikurse e kemi vendosur në Plenum, çdo krah pune në fshat duhet të bëjë të paktën një dynym qilizmë në vit. Kjo është një detyrë që mund të kryhet nga çdo kooperativist. Prandaj kjo të hidhet si parullë dhe të zbatohet nga të gjitha kooperativat bujqësore.

Pra, po të bëhen punimet e thella të tokës, sipas nevojës së kulturave, 35-50 cm thellë me krahë dhe me mjetet e mekanizuara, ne do të arrijmë ta bëjmë tokën qilizmë një herë në çdo 2-3 vjet. Këtë detyrë ta kemi mirë parasysh dhe të qartë. Natyrisht të qartë mund ta ketë çdo njeri se si hiqet këmbëza e pushkës, po kur vjen puna konkretisht i duket sikur duhen dy pendë që për ta bërë një gjë të tillë. Prandaj edhe përvënien në jetë të kësaj parulle do të na duhet shumë mund e djersë, po mundësitë i kemi që ta vëmë si

duhet në jetë. Prandaj t'i përvishemi mirë punës dhe ta zbatojmë si duhet këtë pikë të parë shumë të rëndësishme të kodit agroteknik.

Një detyrë e rëndësishme në raportin e Plenumit të Komitetit Qendror është edhe sigurimi i plehërimit të tokës. Pa e zgjatur fjalën mbi rëndësinë e kësaj detyre, dua të vë në dukje se ju në Shkodër keni bërë një punë të mirë për grumbullimin e plehut. Kam dëgjuar se shokët e ndërmarrjes bujqësore i marrin vazhdimisht plehrat e qytetit dhe nuk u lënë asgjë kooperativave bujqësore këtu afër. Sidoqoftë kooperativat kanë vetë kafshë, dinë edhe mënyrat se si duhen shtuar plehrat, po ato duhet të bëjnë akoma shumë përpjekje për grumbullimin e të gjitha plehrave. Përpjekjet në këtë drejtim në të gjithë Republikën kanë ardhur duke u rritur dhe si pasojë edhe sasia e plehut të grumbulluar është shtuar. Kështu më 1959 në të gjithë vendin janë grumbulluar gjysmë milion tonë pleh organik, më 1960 një milion, kurse vitin e kaluar akoma edhe më shumë. Megjithatë te ne ka akoma rezerva të mëdha plehrash. Dihet se pa plehra nuk mund të shtohen prodhimet. Prandaj kjo çështje të merret seriozisht dhe të arrijmë që në çdo hektar të hedhim 200 kv pleh organik. Diskutimi që bëri para aktivit kryetari i kooperativës bujqësore të Berdicës është shumë instruktiv për çështjen e plehut. Ai vuri në dukje se nga parcela së cilës i hodhi 200 kv pleh për hektar mori 100 kv/ha oriz, kurse nga parcelat e tjera me tokë të së njëjtës cilësi ai mori më pak oriz sepse u kishte hedhur më pak pleh. Në çështjen e plehut, pra, ne kemi një rezervë të madhe. Prandaj fshatarësia kooperativiste duhet

të mësohet dhe të nxitet që të ndërtojë plehërishte të thjeshta. Të mos mendohet që të bëhen ndërtime të mëdha, po gjëra të thjeshta, me qëllim që të shtojmë sa më shumë sasinë e plehut organik, pa harruar, mos e merrni për të keq, fekalet, sepse sa më shumë të shtojmë plehun aq më shumë drithëra, zarzavate, fruta e bulmet do të kemi. Prandaj të mobilizojmë të gjitha forcat për këtë çështje.

Po nuk janë vetëm plehrat organike që shtojnë prodhimin. Një rëndësi akoma më të madhe për shtimin e prodhimeve tona bujqësore e blegtorale kanë edhe plehrat kimike. Mirëpo, tani për tani, këto lloj plehrash i kemi të pakta për arsyen se i sjellim nga jastë, prandaj dhe i përdorim vetëm për ullinjtë dhe bimët industriale. Kjo na imponon që këto lloj plehrash t'i administrojmë me nikoqirillëk të madh, gjersa ne vetë të kemi ngritur uzinat e plehrave kimike në Fier e në Laç. Nga llogaritë e bëra, duke përjashtuar përdorimin në shkallë të gjerë të plehrave kimike, vetëm me mundësitet e tjera që janë në duart tona, ne mund t'i dyfishtojmë prodhimet. Kur të kemi edhe plehrat tona azotike e fosforike, me siguri që ne do t'i trefishojmë prodhimet. Kjo që po bëjmë tani në lidhje me rritjen e rendimenteve, derisa të kemi përfunduar uzinat e plehrave kimike, është një punë pregatitore, më vonë, kur të përfundojnë këto vepra, do të bëjmë një hop të ri përpëra.

Por përveç plehrave kimike, që do të kemi në të ardhmen, ne mund të sigurojmë në sasi të konsiderueshme në vend edhe llojin e tretë të plehut, plehun e gjelbër. Këtë lloj plehu në përgjithësi ne e kemi lënë

pas dore, megjithëse ka disa ndërmarrje bujqësore që edhe atë e praktikojnë. Por një gjë c tillë nuk bëhet vetvetiu. Për ta përhapur këtë lloj plehërimi duhet të sigurosh farë dhe të mbjellësh ato bimë që pasurojnë tokën. Kjo është një shkencë e tërë. Por këtu ka të bëjë shumë dhe kujdesi për t'i qëndruar vazhdimisht pranë fshatarësisë kooperativiste për zbatimin sa më mirë të kodit agroteknik, sepse kur ky të japë rezultatet e duhura dhe fshatarët të shijojnë lezeten e tyre, ata pastaj e zbatojnë vetë atë. Ne i kemi mundësitë që me forcat tona të brendshme, pa pasur ngritjen e objekteve industriale për prodhimin e plehrave, t'i zbatojmë të gjitha këto masa lidhur me plehërimin dhe të shtojmë prodhimin.

Të luftojmë kundër lagështirës dhe erozionit është një pikë tjetër e kodit agroteknik. Partia, populli dhe shteti ynë kanë bërë shpenzime të mëdha për vepra bonifikimi e tharje të kënetave, për kullimin e ujitjen e tokave dhe nga kjo punë ë madhe kemi fituar 23 mijë hektarë tokë të re dhe kemi siguruar ujitjen e 125 mijë hektarëve tokë, domethënë 30 për qind të të gjithë sipërfaqes së punueshme. Gjer në fund të pesëvjeçarit jemi zotuar të sigurojmë ujitjen e rreth 50 për qind të të gjitha tokave të punueshme të Republikës. Ju, si dhe disa rrethe të tjera, i keni tejkaluar sipërfaqet e tokave të ujitshme. Kur isha në Elbasan në aktivin e Partisë për punimin e vendimit të Komitetit Qendror mbi problemen e pyjeve dhe të ujitjes, shokët e atij rrethi ngurronin shumë për t'u zotuar për realizimin e shifrave të vendosura nga Komiteti Qendror për rritjen e sipërfaqes së ujitshme, kurse më vonë

doli se atë plan që ishte caktuar nga Komiteti Qendror dhe që e pranuan me vështirësi, e kanë tejkaluar me kohë. Shteti ynë ka caktuar sonde të reja për ndërtimin e mëtejshëm jo vetëm të veprave nacionale, por edhe të veprave lokale, si pellgje, hauze etj.; shteti dотë caktojë për këtë qëllim edhe materiale të tilla si dinamit, çimento etj. Tani ka filluar një valë e rendërtimi për hauze e liqene të vogla, po kjo punë duhet intensifikuar edhe më tepër, sepse shtimi i ujitjes është një nga mjetet më të mira për shtimin e rendimenteve të kulturave bujqësore. Prandaj në këtë drejtim edhe ju duhet të punoni akoma më shumë se gjë më sot.

Punës së kullimit të tokave nën kulturë, ju ia keni parë të mirat. Po kjo është një teknikë më vete, sepse vijat e kullimit nuk mund të bëhen sipas rastit e në çdo drejtim, mbasi në vend që të vësh vetulla mund të nxjerrësh edhe sytë. Vijat duhen bërë me sistem, në drejtime të caktuara dhe në bazë të krite-reve shkencore. Këto vija në shumë kooperativa bujqësore i bëjnë mirë, ndërsa në Zadrimë kanalet e treta janë neglizhuar fare, në një kohë kur kjo çështje ka rëndësi të madhe. Në mjaft kooperativa vijat e kullimit, në vend që t'i derdhin në kanalet e treta, i derdhin në të dytat, bile edhe në kolektorin kryesor. Një gjë e tillë i sjell dëme bujqësisë, tokave, sistemit të kanalizimit. Në qoftë se vijat nuk bëhen në drejtimin që duhet, në qoftë se çdo kategori kanalesh kulluese nuk bëhet sipas teknikës përkatëse, atëherë prishet harmonia e kullimit të tokave. Prandaj në këtë drejtim duhet treguar kujdes.

Duhet t'i japim rëndësi të madhe edhe mirëmbajtjes së kanaleve, sepse për ndërtimin e tyre kemi harxuar miliarda. Shteti ka vënë në dispozicion një numër të madh traktorësh e ekskavatorësh për pastrimin e kanaleve kulluese e ujitëse. Në qoftë se këto kanale nuk pastrohen brenda dy-tre vjetësh, atëherë çdo shpenzim që është bërë për to do të shkonte kot dhe kështu bujqësia jonë do të qëndronte në vend. Po pastrimin nuk duhet ta bëjë vetëm shteti. Çdo kooperativë bujqësore duhet të mobilizojë forcat dhe të bëjë pastrimin në mënyrë sistematike në pjesën e kanalit që kalon në tokat e saj. Një punë e tillë duhet bërë edhe në zonën e Zadrimës, atje kanalet duhen pastruar e duhen rregulluar.

Sikurse u theksua nga shumë shokë, rëndësi të madhe ka edhe çështja e preqatitjes së tokave, e zhdukjes së disnivelit të tyre. Çështja shtrohet kështu: tokat duhet të bëhen rrafsh apo kurriz peshku? Që t'i bëjmë rrafsh, nuk jemi në gjendje, se një punë e tillë na kushton shumë, prandaj rekomandohet që ato t'i preqatitim në formë kurriz peshku. Po kjo nuk do të thotë se një punë e tillë është e thjeshtë, përkundrazi edhe kjo është një teknikë, një art më vete. Prandaj së pari të mësojmë mirë vetë, pastaj të mësojmë edhe traktoristët si ta bëjnë këtë punë. Por kjo nuk varet e tëra prej tyre. Gjersa traktoristët të mësojnë si ta bëjnë këtë punë, duhet që tekniku bujqësor t'u qëndrojë mbi kokë atyre dhe t'i ndihmojë ata, duhet t'i ndihmojmë vazhdëmisht «asqerët» e Budo Isufit.

Një luftë të madhe duhet të bëjmë pra përmposhtjen e thatësirës. Ne vuajmë shumë nga thatë-

sira, prandaj të kemi parasysh rekomandimet e agro-teknikës për ruajtjen e vlagës. Të kujdesemi shumë për ruajtjen e objekteve ujitëse, të marrim masa të gjithanshme dhe sa më të thjeshta për ruajtjen e tokave nga erozioni etj.

Sigurimi i farëravc të zgjedhura është për ne një problem shumë i madh. Në këtë drejtim kemi bërë disa hapa, po jemi akoma prapa. Në Plenumin e Komitetit Qendror u diskutua për farërat e shumta që ekzistojnë në vendin tonë. Ne kemi eksperiençë shumëvjeçare për disa farëra të posaçme, që na kanë dhënë rezultate të mira pas eksperimenteve që janë bërë në Institutin e Kërkimeve si dhe në një numër kooperativash bujqësore. Po për këtë problem duhet luftuar edhe më tej me këmbëngulje. Në raport jepen disa orientime se cilat farëra duhet të përdorim, në cilat toka bën kjo lloj fare dhe në cilat lloji tjetër, në ç'kohë duhet mbjellë kjo dhe kur ajo tjetra etj., etj. Zbatimi i këtyre orientimeve ka rëndësi të madhe. Por kjo nuk duhet bërë qorrazi, as nuk duhet të frikësohemi të nxjerrim konkluzione definitive nga eksperiencia e hidhur e një ose dy vjetëve, sepse brenda një kohe të tillë ngjasin edhe fatkeqësi nga koha, mund të ndodhin edhe gjëra të padëshiruara nga pakujdesia e atyre që janë ngarkuar me trajtimin e farërave, të cilët, duke mos zbatuar si duhet detyrat e caktuara, bëjnë që fara të prishet ose të degjenerojë. Prandaj nuk duhet thënë menjëherë se kjo ose ajo farë nuk bën. Sidoqoftë për zbatimin e orientimeve që jepen nga Komiteti Qendror për farërat duhet të ecim me kujdes të madh. Po të tregojmë kujdes, jo vetëm që do të skartojmë të gjitha ato farëra të

cilave «u ka dalë boja», sepse japid rendimente shumë të ulëta, po do të arrijmë të bëjmë edhe zgjedhjen e farërave elite dhë, nga eksperiencia që do të fitojmë, do të mund të krijojmë edhe farëra të tjera, të asta që t'u ambientohen tokës dhe klimës sonë. Kjo ka rënë dësi jashtëzakonisht të madhe.

Të luftohet kundër mentaliteteve të vjetra që ekzistojnë në një numër fshatarësh për përzierjen e farërave, ose kundër praktikës së prishjes së farës kur ndodhen në vështirësi për bukë, sepse këto sjellin që të mbillet çdo farë që del përpara. Këto gjëra fshatarëve tanë u duhen ngulur mirë në kokë. Në përgjithësi ata e dinë se, po të mbjellim farë të zgjedhur, do të marrim edhe rendimente të mira, po duhet të punohet me ta që këtë çështje ta kuptojnë në mënyrë shkencore. Kur thotë Partia që t'i bëhen të gjitha shërbimet farës së zgjedhur ose parcelës ku është mbjellë kjo farë, kooperativisti t'i bëjë të gjitha këto shërbime si duhet dhe të ketë të fiksuar mirë në mendje se nga këto varet në një shkallë të madhe prodhimi i ardhshëm. Për këtë çështje u bënë mjaft diskutime si në Byronë Politike, ashtu edhe në Plenumin e Komitetit Qendror. U tha dhe u rekomandua që të vihen kufij të shtrënguar dhe të mos lejohet kalimi i një fare të papërshtatshme nga një rrëth në tjetrin, sepse, sidomos që jemi një vend me sipërsaqe të vogël toke, një rrëth me tjetrin, bille dhe një parcelë me tjetrën, kanë midis tyre ndryshime të mëdha. Në qoftë se ne do të lejonim qarkullimin e farërave pa kriter nga një vend në tjetrin, atëherë do të kishim dëme të mëdha. Prandaj në këtë drejtim të caktuojmë kusjtë, të cilat ka mundësi të zbatohen, sepse

kooperativistët gjer në një farë shkalle e kanë kuptuar rëndësinë e rrugës moderne të bujqësisë. Punonjësit e specialistët e bujqësisë, në përgjithësi, janë të ndër-gjegjshëm dhë kujdesen për këtë çështje, por megjithatë duhet të tregohemi akoma më shumë të rreptë për zgjedhjen, ruajtjen, shpërndarjen dhe mbjelljen e farës në toka të përshtatshme.

Rëndësi të madhe ka edhe kryerja e shërbimeve me cilësi të lartë dhe në kohën e duhur. Në këtë drejtim kemi përparime, por kemi edhe mungesa të mëdha. Këtu rëndësi ka çështja e edukimit dhe e rritjes së ndërgjegjes së fshatarësisë sonë, e cila ka raste që kënaqet me pak. Tokës ne duhet t'i marrim atë që është e mundur t'i merret, por kjo arrihet duke i bërë asaj të gjitha shërbimet. Kështu ne do të kemi fitime të mëdha

Edhe lufta kundër sëmundjeve, që rrezikojnë kulturat bujqësore, duhet të bëhet me të njëtin kujdes si edhe për njerëzit, sepse janë pikërisht bimët ato që na ushqejnë dhe na mbajnë gjallë. Prandaj jo vetëm t'i japim me bollëk tokës, të mbjellim gjëra të ushqyeshme e t'i bëjmë shërbimet e duhura, që bimët të rriten sa më mirë, por edhe të luftojmë kundër sëmundjeve që prishin bimët, si kundër vrugut të duhanit, krymbit të misrit etj., etj. Këto sëmundje, po të mos luftohen pa mëshirë dhe me mjetet e përshtatshme në kohën e duhur, do të na shkaktojnë dëme të mëdha.

Por humbje ne kemi edhe nga mosmbjellja e sasisë së nevojshme të bimëve për hektar, siç rekomandon agroteknika. Të mos jemi «të shtrenjtë në krunde e të

lirë në miell». Ka fshatarë që nuk largohen nga pikë-pamjet e vjetra: thuaju sa të duash që të hedhin nga 2 kv grurë për ha, ata të tyren bëjnë, hedhin 100-120 kg/ha, ka bile që hedhin 80 kg/ha. Mirëpo duke vepruar kështu marrin rendimente të ulëta.

Të gjithë këta faktorë që thashë janë shumë të rëndësishëm; ata duhen parë me kujdes, sepse realizimi i tyre në jetë, që varet vetëm nga ne dhe jo nga importi, do të bëjë që të na shtohen rendimentet. Duke e zbatuar me kujdes e me përpikëri kodin agroteknik, me siguri do t'i sigurojmë rendimentet që parashikojmë. Sa rezerva na shkojnë kot nga moszbatimi i pikave të kodit agroteknik. E përsëris, këtu nuk e kam fjalën për plehrat kimike, sepse kur të kemi edhe këto atëherë rendimentet do të rriten akoma më shumë. Kësh-tu misër, vetëm nga plugimi i thellë ne mund të marrim 4 kv/ha më shumë; nga ujitja e kësaj kulture — 5 kv/ha më shumë, nga lufta kundër sëmundjeve të mos themi më shumë po 1 kv/ha, dhe po të mbli-dhen të gjitha këto rendimenti do të shtohej rreth 10 kv/ha; duke i shtuar kësaj 11 kv/ha që marrim tani, do të mund të siguronim 21 kv/ha vetëm me rezervat tonë të brendshme dhe minimale. Pra zbatimi i pikave të kodit agroteknik është i domosdoshëm. Prandaj duhet t'i mësojmë kooperativistët dhe kuadrot e bujqësi-së që të ecin në këtë drejtim, se kështu vetëm me rezervat tonë të brendshme ne do t'i dyfishojmë pro-dhimet. Ne i kemi të gjitha mundësitë ta bëjmë këtë hap të madh përpara dhe do ta bëjmë.

Shumë e rëndësishme për rritjen e rendimenteve është edhe një çështje tjeter, renditja e kulturave të

ndryshme bujqësore. Për këtë qëllim në raport jepet edhe mënyra e renditjes. Në përgjithësi kur parabima është e përshtatshme, kultura e re jep rendimente të mira. Për shembull, kur ke mbjellë më parë një bimë prashitëse dhe pastaj një bimë joprashitëse rendimenti ngrihet, kurse kur mbjell të njëjtën bimë dy-tre vjet me radhë rendimenti ulet.

Kisha edhe një rekomandim të veçantë përsa u përket hamulloreve. Gabimet që janë vërtetuar në këtë çështje, janë bërë nga nevoja që kemi pasur për bukë. Hamulloret tona ne duhet t'i mbjellim vetëm në ato toka që kanë ujë. Atje ku nuk ka ujë është e kotë të mbjellim se do të kemi humbje.

Ne duhet të luftojmë shumë për drithërat e bukës. Kjo është një nga detyrat më të rëndësishme që na vë përpara Partia. Kryesorja e kryesoreve është që bukën ta prodhojmë në vend. Prandaj në punën tonë të kemi parasysh luftën që duhet të bëjmë për të marrë nga toka sa më shumë drithëra, domethënë grurë, misër, thekër, elb, tershërë. Ky duhet të jetë një nga preokupacionet tona më të mëdha, gjersa të arrijmë që të mos importojmë drithëra dhe të shtojmë rezervat e tyre. Me gjithë vështirësitë që na dolën, mungesën e bukës nuk e ndieu njeri, sepse Partia dhe Qeveria punuan me nikoqirillëk të madh dhe morën masa për sigurimin e saj. Mirëpo dihet se rezervat edhe harxhohen, nëse nuk përtërihen vazhdimit, prandaj Komiteti Qendror ka vendosur një disiplinë të fortë dhe një regjim të rreptë kursimi që asnje kilogram drithë të mos hiqet nga rezervat shtetërore pa arsyetuar kërkësën me argumente të forta. Këto masa të rrepta u vendosën se

janë kohë të vështira, dhe në kohë të vështira popullit nuk duhet t'i mungojë buka. Prandaj duhen bërë të gjitha përpjekjet për shtimin sa më shumë të rezerveve tona, sepse sa më shumë rezerva të kemi, aq më të fortë do të jemi. Të bëhet pra një luftë e madhe për bukën.

Luftë e madhe duhet të bëhet gjithashtu nga ana e komiteteve të Partisë dhe nga kooperativat bujqësore për ruajtjen e fondit të tokës, se gjer tani janë dhënë pa arsyе toka bujqësore të mira për nevoja të tjera. Tani kjo çështje, në përgjithësi, është vënë në vend, mirëpo megjithatë ka dhe raste që abuzohet. Kur ke kodra afër, përse të ndërtosh shtëpi në fushë ku mund të mbillet drithë ose pambuk? Kur është vendosur që fshati të ndërtohet në një vend të caktuar, të gjitha shtëpitë të janë grumbull dhe afër njëratjetrës, përse një fshatar të ndahet nga të tjerët dhe ta ndërtojë shtëpinë larg? Fshatarët duhet ta kuptojnë se kjo është antiekonomike, jo vetëm nga pikëpamja se humbet toka buke, po edhe se i vettmar nuk jeton dot. Kaluan ato kohë kur një shtëpi ndërtohej andej e tjetra këtej siç bëhej te ne përpara, sidomos në disa krahina, si në Mirditë e gjetkë. Tani kërkohet që njerëzit të banojnë afër e të bëjnë jetë kolektive, sepse në qendër të fshatit tani është shkolla, shtëpia e kulturës, kinemaja e teatri, biblioteka, dyqani, depoja e grumbullimit, aty janë zyrat e këshillit popullor dhe të kryesisë së kooperativës etj. Përse djali ose vajza të detyrohet të vejë në shkollë duke bërë një ose një orë e gjysmë rrugë. Ndërtimet me plan janë gjithashtu të domosdoshme, se do të vijë koha që të bëhet edhe elek-

trifikimi i plotë i fshatit¹, mirëpo një gjë e tillë në një fshat shumë të përhapur do të ishte shumë e vështirë dhe antiekonomike. Ndërtimet e shtëpive, të depove, të stallave etj. të bëhen me kriter dhe komitetet e Partisë e kryesitë e kooperativave bujqësore të janë të rrepta në lëshimin e lejeve, ato të mos jasin tokë mirë për ndërtime, tokat e bukës të ruhen me fanutizëm të madh.

Për blektorinë nuk jemi shumë të kënaqur me sa është bërë. Megjithatë prapë duhet thënë se përparime kemi. Në krahasim me paraluftën numri i krerëve është shtuar, detyrat e vëna për këtë janë zbatuar me sukses, por megjithatë plani nuk është realizuar, sepse në blektori sikur është neglizhuar pak. Prandaj Partia ta marrë në dorë këtë problem dhe kooperativat bujqësore t'i shtojnë përpjekjet për shtimin e numrit të bagëtive dhe sidomos të lopëve, që të marrin prodhimet blektorale në sasi e në cilësi. Këto detyra do të arrihen me përmirësimin e racës dhe sigurimin e bazës ushqimore. Nga lopët e vendit më parë ne kemi marrë vetëm 200-250 litra qumësht në vit, mirëpo lopa e vërtetë duhet të jetë një fabrikë qumshti. Partia jonë përzgjidhjen e kësaj çështjeje ka bërë mjaft përpjekje. Kështu, duke përmirësuar bazën ushqimore ne kemi arritur të marrim nga 600-1000 litra qumësht nga lopët e vendit, gjë që nuk ka ndodhur më parë. Këtë e bëri në radhë të parë ushqimi, kjo është kryesorja. Por edhe përmirësimi i racës luan rol të madh. Edhe në

¹ Elektrifikimi i plotë i fshatrave të vendit tonë përfundoi në 25 tetor 1970.

këtë drejtim ne, gjithashtu, kemi pasur suksese sepse kemi sjellë damazë nga jashtë dhe është bërë kryqëzimi me lopët tona. Po ka ndodhur që edhe na kanë gënjyer me këta damazë, si na ndodhi me hungarezët, të cilët jo vetëm na i shitën shumë shtrenjtë, po dhe të sëmurë. Sidoqoftë, në përgjithësi, ne kemi pasur fitime dhe tani jemi duke ecur drejt përmirësimit të racës së lopës së vendit. Komiteti Qendror rekomandon të përhapim lopën e racës «Xhersei» si një lopë ekonomike nga pikëpamja e konsumit të sasive ushqimore dhe shumë e përshtatshme për kushtet tona, dhe që jep mjaft qumësht e me yndyrë. Për këtë arsyе kryqëzimet të bëhen me këtë racë sepse do të kemi leverdi ekonomike.

Nga ana tjetër, të tregohet kujdes edhe për bagëtinë e imët, në radhë të parë për përmirësimin e racës së dhenve me anë të ndërzimit artificial. Specialistët të luftojnë sa më shumë në këtë drejtim. Ju e keni përmirësuar në rrëthin tuaj racën e dhenve dhe keni arritur rezultate të mira në shtimin e krerëve ashtu edhe në shtimin e sasisë së leshit e të qumshtit, po përsëri në këtë drejtim jemi prapa, jemi akoma në fazën e parë e të dytë. Në këtë çështje rol të madh do të luajnë përpjekjet për sigurimin e bazës ushqimore. Por kooperativat bujqësore duhet të kenë parasysh jo vetëm tufat kolektive të lopëve ose të deleve. Sigurisht kujdesi për blegtorinë kolektive duhet të jetë sa më i madh dhe ato të bëhen shembull edhe për blegtorinë jokolektive, por tufat e blegtorisë së fshatarëve individualë nuk duhen lënë pas dore nga ana e kryesive të kooperativave. Në planet e tyre ato duhet të

mos e harrojnë një gjë të tillë, sidomos zgjidhjen e bazës ushqimore të tufave të oborreve, të cilat të gjitha së bashku përbëjnë një numër shumë më të madh bagëtish se ato të kooperativës.

Sektori individual i blegtorisë shërben për të plotësuar nevojat me prodhime blegtoriale të oborreve, mbasi ne nuk kemi arritur në atë shkallë që të plotësojmë me prodhime të gjitha nevojat e anëtarëve të kooperativës. Kur ta arrijmë këtë, atëherë çdo oborr do ta shohë se nuk ka më nevojë përsë të mbajë lopën ose delet. Mirëpo një gjendje e tillë tani për tani nuk ekziston, prandaj blegtoria e oborreve jo vetëm të mos preket, po përkundrazi të ndihmohet, në radhë të parë me ushqime. Kjo çështje të shihet me kujdes të madh, se sot shumë familje mbajnë bagëti në oborret, të cilat i kullosin pa të drejtë në tokat e kooperativës, kurse në kopshtet e tyre mbjellin kultura, si, për shembull, duhan, nga të cilat sigurojnë fitim. Në qoftë se kooperativa mendon se ka interes që anëtarët edhe duhanin ta mbjellin në kopshtet e tyre edhe bagëti të mbajnë, le të veprohet kështu, por duhet siguruar ushqimi, të sigurohet silazhi bashkërisht nga kullotat kolektive, por të ndërhyhet që çdo familje të mbjellë edhe një pjesë të kopshtit të vet me jonxhë ose me misër për silazh.

Këtej del se duhet t'u jepet kooperativistëve një farë orientimi për sigurimin e ushqimit të blegtorisë së oborreve. Kryesia duhet të mendojë për sigurimin e ushqimit të blegtorisë së oborreve edhe nga kullotat e përbashkëta, gjer me 10 krerë bagëti të imëta për familje, domethënë të mendojë për disa qindra bagëti.

Bagëtinë e oborrit kooperativist ne nuk e kemi lënë për të krijuar në familjet e kooperativistëve ndjenjën e pronësisë private, sepse ne shkojmë drejt zhdukjes së saj, po ne duhet të ndihmojmë duke organizuar punën në mënyrë që kooperativisti të shohë se interes i tij, mirëqenia e tij nuk varet nga 10 dele, por kryesisht nga puna që ai dhe pjesëtarët e familjes së tij do të bëjnë për zhvillimin e pasurisë së përbashkët të kooperativës, nga djersa që do të derdhin në këtë pasuri, nga ditët e punës që do të harxhojnë për mbarëvajtjen e saj. Kjo është kryesorja, ndërsa oborri kooperativist është plotësues.

Komiteti i Partisë i çdo rrethi duhet të interesohet shumë edhe për blegtorinë e atyre fshatrave ku akoma nuk është krijuar kooperativa bujqësore, sepse edhe kjo është një pasuri e madhe e popullit. Më vonë edhe këto fshatra do t'i ndiejnë e do t'i kuuptojnë të mirat e kolektivizimit dhe me vullnetin e tyre do të futen në këtë rrugë. Prandaj edhe këtyre u duhen siguruar kullota, sidomos për dimër. Blegtorët e këtyre fshatrave bëjnë vetë përpjekje për sigurimin e kullotave, po kjo punë duhet bërë sa më e organizuar, prandaj edhe organet e shtetit të ndërhyjnë në këtë çështje.

Komiteti Qendror i Partisë ka rekomanduar që rretheve mund t'u jepen dhe kredi në disa drejtime për të nxitur më tej përmirësimin e kullotave artificiale. Ne bëjmë investime, në radhë të parë, në favor të blegtorisë shtetërore, po edhe në favor të blegtorisë së kooperativave bujqësore dhe të blegtorisë së atyre që akoma s'kanë hyrë në këto kooperativa, sepse edhe kjo në shkallë Republike përbën një ekono-

mi unike shumë të rëndësishme që i shërben interesit të përgjithshëm. Në raportin tuaj nuk u fol, por në mbledhjen e Byrosë Politike dhe të Plenumit të Komitetit Qendror është diskutuar edhe për organizimin e disa formave kolektive të blegtorisë që mund të përdoren në fshatrat e zonave malore të pakolektivizuara, si, bie fjala, shfrytëzimi bashkërisht i kullotave për një ose dy vjet. Këto forma të thjeshta kolektive mund të lehtësojnë fshatarët. Por duhet pasur kujdes që një gjë e tillë të bëhet sipas dëshirës. Qëllimi i Komitetit Qendror, i Qeverisë dhe interesi i popullit është që nga tufat e pakolektivizuara, që përbëjnë një sasi të madhe bagëtish, të marrim sa më shumë prodhime, domethënë edhe me bagëtitë e këtij sektori t'u afrohem rendimenteve të bagëtive shtetërore. Prandaj të luftohet edhe në këtë drejtim.

Për zhvillimin e frutikulturës të bëhen gjithashtu përpjekje të mëdha. Çdo kooperativë bujqësore të krijojë bllokun e vet të frutave dhe të mos bëhen gabime që pemët frutore të mbillen vende-vende, të veçuara, se kemi ekspericencë jo të mirë në këtë çështje. Vetëm në blloqe ne do t'i sigurojmë më mirë fidanët e mbjellë. Ne e dimë ç'rëndësi ka ky sektor për ekonominë tonë, sepse na duhen fruta të freskëta për të ngrënë, për të furnizuar me lëndë të parë industrinë ushqimore që kemi ndërtuar e që do të ndërtojmë etj. Prandaj të mbjellim sa më shumë blloqe pemësh e t'i punojmë në mënyrë të kulturuar, t'u bëjmë shërbimet e duhura që të marrim rendimente sa më të larta. Të kemi parasysh që në asnje mënyrë të mos mbjellim pemë frutore në fushë, po nëpër kodra

që i kemi aq të mira. Për pemë frutore ka mundësi të mëdha të hapim dhe toka të reja me krahë, ose atje ku do të jetë e mundur edhe me traktorë.

Të gjitha këto detyra që thamë duhet t'i realizojmë, por kjo do të bëhet akoma më e mundshme po të marrim masa sa më të mira për forcimin organizativ të kooperativave. Ato në përgjithësi tani janë forcuar dhe puna në drejtimin e tyre është përmirësuar mjaft. Tani ne kemi kryetarë kooperativash të zotë, njerëz me eksperiencë në bujqësi, me stazh lufte dhe pune e që gjëzojnë dashurinë e kooperativistëve. Përveç kësaj, shumë prej tyre kanë kryer edhe shkollën e kooperativave bujqësore. Në të ardhmen do të na dalin kuadro të mesëm bujqësorë, bile edhe të lartë, që do të dërgohen nëpër kooperativa. Po edhe tani kemi mjaft kuadro të mesëm. Në rrethe e në lokalitete ne kemi sot agronomë, zooveterinerë dhe teknikë të mesëni për kultura të ndryshme, të cilët u japid një ndihmë të madhe të gjithanshme kooperativave bujqësore. Por në forcimin organizativ të kooperativave ne duhet të kemi parasysh vazhdimit që këto organizma të kenë karakter demokratik, domethënë që çdo gjë, çdo masë, të vendoset me dëshirën e plotë të anëtarëve, që në çdo rast të veprohet në bazë të vendimeve të asamblesë. Kjo gjë të mos nënveftësohet se ndryshtë punët do të shkojnë keq. Në qoftë se udhëheqja e kooperativës nuk është nën kontrollin dhe ndihmën e asamblesë dhe të organizatës-bazë të Partisë, në qoftë se organizata-bazë nuk është nën kontrollin e masës dhe nuk mbështetet në masë, mund të na ngjasin gjëra të papëlqyera, hatëre, arrogancë, favorizime, të njërit dhe të tjegrit etj.

Ndokush në udhëheqje të kooperativës mund të kujtojë se anëtarët nuk i shikojnë veprimet e tij jo të rregullta, po ai gabohet. Asgjë nuk mund t'u shpëtojë syve të anëtarëve, po në qoftë se ka prej tyre që nuk bëjnë zë, kjo vjen nga respekti që ata kanë për Partinë. Anëtarët e kooperativës te sekretari i organizatës-bazë shikojnë Partinë, por ka prej tyre edhe me mentalitet të pakalitur, që nuk marrin akoma guximin të flasin për ndonjë padrejtësi që bëhet. Për këtë arsyе çështja e zbatimit të vendimeve të asamblesë duhet të jetë nën mbikëqyrjen e organizatës-bazë.

Në organizimin e një ekonomie kaq të madhe siç është kooperativa bujqësore dalin shumë vështirësi që shkaktohen jo vetëm për shkaqe subjektive, po edhe objektive. Në kooperativa puna nuk është edhe aq e lehtë, atje nuk lejohet të të zërë gjumi dhe të mos i vihesh punës në të gjitha drejtimet, atje duhet ta drejtosh vëmendjen në çdo gjë, gjer te pendët e pulave, me qëllim që të jetë e mundur, si i thonë një fjale, të nxirret edhe vaj nga guri, domethënë të shtohen sa më shumë të ardhurat. Rëndësi ka gjithashtu që kryesitë e kooperativave në marrëdhëni me anëtarët të jenë në çdo gjë të drejtë. Mirë ka luftuar në rrëthin tuaj kryetari i kooperativës bujqësore të Dobraçit, që është një shok i zoti dhe me iniciativë; unë mendoj se ai bën shumë mirë që është i kursyer, ai e ka të qartë se kjo pasuri është e popullit. Kur atij i mbushet mendja se diçka është në interesin e kooperativës dhe duhet bërë, ai e diskuton me anëtarët dhe pastaj i futet punës, por në qoftë se dikush i thotë të bëjë një gjë që s'ka ndonjë interes për kolektivin, ai refuzon se mendon për

të mirën jo të një, po të 150 familjeve. Prandaj investimet në kooperativa duhet të bëhen kur t'u vijë koha dhe në atë shkallë sa mban kurrizi i anëtarëve, domethënë pasi kooperativa të ketë siguruar të ardhura të mira.

Kooperativa bujqësore, pra, është një ekonomi e madhe, e koklavitur. Prandaj duhet të bëhet një punë e kujdeshshme organizative nga ana e kryetarit dhe e nënkyetarit të saj, nga ana e sekretarit të organizatës-bazë dhe e kuadrove të tjerë. Atje në radhë të parë duhet të veprohet me drejtësi të madhe nga drejtuesit.

Për mbarëvajtjen e kooperativave bujqësore të kemi parasysh kurdoherë zbatimin e përpiktë të vendimit të Këshillit të Ministrave mbi organizimin dhe shpërblimin e punës. Disa e neglizhojnë këtë vendim, disa shkojnë në tym, kurse ai është bazë, se pasqyron në hollësi çdo çështje që ka të bëjë me kooperativat. Prandaj për organizatën-bazë dhe kryesinë e kooperativës ky vendim duhet të jetë si një kod që duhet zbatuar në kushtet e çdo kooperative. Këtë Komiteti Qendror e vë në dukje se kanë ndodhur dhe gjëra jo të pëlqyera, janë bërë ekzagjerime, dua të them, shpenzime jashtë dëshirës së anëtarëve, në mënyra të parregullta etj. Për këtë ne kemi marrë masa, kemi bërë mbledhje e aktive. Në qoftë se një anëtar dëshiron të vejë në kinemanë e kooperativës, le të shkojë me të holla në dorë; kryetari nuk ka të drejtë t'i mbajë anëtarit ca të holla për kinema, ca për libra, ca për gazeta etj. Organizata-bazë duhet të punojë për t'i bindur anëtarët që edhe në kinema të venë, edhe libra e gazeta të lexojnë dhe po të duan të venë çdo natë

në kinema, këtë ta bëjnë me të holla në dorë dhe jo duke i detyruar e duke u mbajtur paratë. Gjëra të tilla të palejueshme kanë ndodhur. Prandaj vendimet që janë marrë mbi këtë çështje të zbatohen si duhet.

Këto janë shokë, në mënyrë përbledhëse, detyrat që duhen pasur parasysh. Ato mund të mos i kem paraqitur edhe shumë të lidhura ose shumë të plota, po sidoqoftë unë u përpoqa t'ju them në vija të përgjithshme orientimet e Komitetit Qendror. Tani çështja varet nga ne, prandaj, pa i lënë pas dore sektorët e tjerë, të mobilizohemi tërësisht për realizimin e detyrave në sektorin e bujqësisë, meqenëse këto kanë rëndësi të madhe. Dihet se nga bujqësia varet edhe puna në rregull e veprave industriale që kemi ndërtuar. Industria jonë ecën mirë, atë ne do ta zgjerojmë edhe më tepër në të ardhmen, po tani rëndësi shumë të madhe për ne ka edhe bujqësia. Prandaj t'i vihem i punës me të gjitha forcat për të arritur suksese. Ne këto suksese patjetër do t'i arrijmë. Veçanërisht këtu në Shkodër jemi të bindur se, po të merret çështja e bujqësisë mirë në dorë nga ana e Partisë, do të zhduken shumë të meta, lëshime e gabime që janë bërë në të kaluarën në këtë sektor dhe do të arrijmë që në bujqësi Shkodra të zëré një vend të mirë, të shquhet si një nga rrrethet më të dalluara.

Në rrëthin tuaj, ashtu si në shumë rrëthe të vendit, shteti ka bërë investime të mëdha. Por të gjitha këto shpenzime s'kanë qenë të njërit e të tjegrit, ato kanë qenë djersa e popullit, i cili ka kursyer me qëllim që, për shembull, të thahet këneta e Tërbusfit, të bonifiko-

het fusha e Myzeqesë, e Hoxharës, e Thumanës, e Durrësit etj., etj. Komiteteteve të Partisë të rretheve ku ne kemi bërë të tilla investime, e do të bëjmë edhe në të ardhmen, do t'u kërkojmë që të përpinqen të marrin medoemos dyfishin e prodhimeve të sotme. Këtë orientim duhet ta vënë në jetë ata, se dyfishin e prodhimeve të sotme ne nuk do ta kërkojmë, fjala vjen, nga Skrapari, ku nuk kemi bërë ndonjë investim të tillë. Rrethi i Durrësit, për shembull, të cilit Partia dhe Qeveria i kanë krijuar dhe po i krijojnë të gjitha mundësitë, duhet të ndiejë përgjegjësinë dhe të realizojë rendimentet që i kerkohen, kurse kooperativat bujqësore të Librazhdit, që i kanë tokat bujqësore nëpër kodra, kuptohet, nuk do të mund të marrin po ato rendimente të larta. Rretheve kodrinore e malore ne tani u japim edhe bukë. Kurse shokëve të Myzeqesë, në qoftë se nuk i rritin rendimentet, me gjithë investimet e mëdha që kemi bërë e po bëjmë, Partia dhe Qeveria do t'u heqin veshin.

Ne jemi të sigurt se në këtë drejtim rrethi juaj do të korrë suksese. Organizata e Partisë këtu është e fortë dhe e kalitur, këtu ka një fshatarësi patriote, që u ka bërë ballë të gjitha vështirësive, prandaj kooperativat bujqësore dhe e gjithë fshatarësia përparimtarë e rrethit tuaj do t'i realizojë të gjitha detyrat që na vë përpara Komiteti Qendror i Partisë. Për këtë, shokë, unë ju uroj nga zemra, uroj që të keni suksese sa më të mëdha në punën tuaj dhe të dilni faqebardhë!

Pastaj, pasi foli për disa probleme të situatës ndërkombëtare, të luftës që zhvillohet midis marksizëm-lininizmit dhe revizionizmit modern hruščovian, i

cili e ktheu vendin e vet në rrugën kapitaliste-revisioniste, në rrugën e degjenerimit të plotë të jetës politike dhe ekonomike, në rrugën e afshimit të mëtejshëm me imperializmin amerikan e të lëshimeve të paprincipta ndaj tij, shoku Enver Hoxha tha:

Në situatën që është duke kaluar vendi ynë, të jemi të preqatitur për çdo të papritur. Në radhë të parë të jemi të qartë për çështjet politike dhe ideologjike dhe të mobilizohemi plotësisht për realizimin e planeve; të mos kujtojmë se planet do të realizohen lehtë, përkundrazi, në situatat që kalojmë ato do të realizohen me vështirësi, me mundime e përpjekje, me luftë të paprerë. Prandaj kërkohet nga të gjithë, nga më i madhi e gjer te më i vogli, një mobilizim total në çdo drejtim. Ta ngremë gjithnjë lart e më lart patriotizmin e madh e të papërshkrueshëm të popullit tonë. Ky nuk është një patriotizëm fiktiv, po real, që bazohet në faktin se populli e sheh me sytë e veta se çdo gjë në vendin tonë bëhet për të mirën e tij dhe me këtë ai koncepton çdo ditë e më mirë vijën e drejtë të Partisë. Pikërisht për këtë arsyе ekziston një entuziazëm dhe patriotizëm i madh në popull, prandaj Partia të punojë që t'i mbajë kurdoherë gjallë, me punë, me realizime, që t'i japim popullit ato që i kemi premtuar. Komunistët të punojnë dhe tëjenë të tillë që populli të shohë tek ata njerëzit e thjeshtë, punëtorë dhe besnikë të çështjes së tij. Këtë ta kenë mirë parasysh anëtarët e Partisë në çdo kohë, edhe në jetën e tyre personale, në mënyrë që ta mbajnë kurdoherë lart emrin e komunistit dhe prestigjin e Partisë. Po të kihet parasysh kjo nga të gjithë shokët dhe në çdo moment, atëherë as-

një forcë nuk do të jetë në gjendje të dëmtojë sadopak Partinë tonë.

Ju uroj suksese sa më të mëdha, shokë, në realizimin e detyrate që na ngarkon Partia!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

*Botohet për herë të parë, me
disa shkurtime, sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

TEATRI ËSHTË NË NGA MJETET E EDUKIMIT TË MASAVE

*Nga biseda me disa punonjës të artit e të kulturës
të Shkodrës*

18 dhjetor 1962

Shkodra është një krahinë me tradita të mira kulturore, ajo tani ecën në ngjitje jo vetëm në fushën e muzikës, të komedisë e të estradës, po edhe të dramës. Kështu në këtë drejtim një punë e mirë është bërë dhe me shfaqjen e dramës «Plaku i maleve».

Unë e pashë këtë dramë për herë të parë në Vlorë në nëntor, kur u shfaq me rastin e festave të mëdha. Tani, në këtë takim, unë nuk kam qëllim që t'ju bëj ndonjë kritikë. Dëshiroj t'ju them vetëm se ajo bëri një përshtypje të mirë në Vlorë. Të gjithë ata që e panë u shprehën se shfaqja ishte shumë e përshtatshme për këto momente.

Figura qendrore e kësaj vepre është ajo e patriotit të madh shqiptar, Bajram Currit. Kjo tregon se ju, autorë e aktorë, keni punuar mjaft, se një vepër e tillë nuk thuret lehtë. Regjisori që e ka vënë në skenë, duket që është një shok i talentuar. Ai ka vënë në skenë

edhe vepra të tjera, si «Kënetën» që, përsa i përket dramatizimit, ka pasur vështirësi, megjithëse në skenë është vënë mirë.

Unë nuk jam specialist, prandaj, për sa do të them, mos m'i merrni të gjitha për kapital. Shfaqje teatrale unë nuk kam parë shumë, por drama kam lexuar, edhe klasike, edhe të kohës. Edhe kur kam qenë student nuk kam pasur mundësi të frekuentoja shumë teatrin se nuk kisha të holla. Unë mendoj se kur një pjesë të pëlqen, ajo të lë përshtypje, dhe rron me të për një farë kohe edhe pas shfaqjes. Pa marrë parasysh se një pjesë mund të ketë nevojë për përpunim, në qoftë se përshtypja e përgjithshme që ke për të, në fillim është e mirë, do të thotë se vepra është gjithashtu e mirë. Kështu si mua edhe shokëve të tjerë drama «Plaku i maleve» na la përshtypje të mirë kur e pamë. Por kur ftohesh pak nga entuziazmi dhe nga përshtypjet e para të kësaj drame, mendon përsëri dhe e gjykon-veprën me një sy më kritik.

Meqenëse ndodhem në Shkodër, shfrytëzova rastin për të biseduar me ju, me qëllim që këtë pjesë ta bëjmë akoma më të mirë. E vërteta është se ju keni zgjedhur një subjekt të bukur, patriotik, jetën e një personaliteti të popullit tonë, të një njeriu me ide të gjera, me një të kaluar të madhe revolucionare, prandaj me këtë subjekt të rëndësishëm mund dhe duhet të bëhet një dramë kombëtare shumë e bukur.

Ju që merreni me këtë sektor të rëndësishëm të artit i njihni mirë rregullat dhe dini të bëni vlerësimin, sa vend i duhet kushtuar njërsës çështje dhe sa tjetrës.

Duke parë dramën, m'u krijua përshtypja se disa skena janë ca si të tepërtë dhe pa vend. Mendoj se në këtë vepër ka pjesë që mund të zëvendësohen me pjesë të tjera, që të kenë një përmbytje akoma më të lartë, më mobilizuese dhe më edukuese nga këto që janë. Për shembull, skena e prefektit në aktin e parë, përmendimin tim, mund të mos ishte fare. Në një kohë kur publiku pret një dramë të madhe e të fortë, qysh në fillim del në skenë prefekti, i cili bën pazarllék me barkaxhinë për t'u arratisur. Unë nuk arrij të kuptoj kush është ky prefekt dhe ç'përfaqëson ai. Prefekti duket sikur është njeriu i Zogut dhe kur e pashë, unë mendova: mos vallë ky që kërkon të vejë në Itali komploton përvrasjen e Gurakuqit, apo çfarë kërkon? Një nga shokët më tha se mos vallë ky prefekt është Mustafa Kruja, i cili si filoitalian që ishte preqatitë të shkonte në Itali. Pra, mundet që hyrja të rregullohet ndryshe, mendoj unë, se sa të merret me paraqitjen e largimit të njerëzve të tillë si prefekti. Këto episode e ulin vlerën e dramës. Fundi, mundet edhe të mbetet kjo hyrje, por të merret si ide kryesore demaskimi i atyre që, në momentin e dështimit të organizimit të rezistencës, lanë atdheun dhe iu trembën luftës. Më tej duhet të lihet të kuptojet, nëpërmjet fjalëve të Bajram Currit ose të një njeriu të thjeshtë që, ndërsa njerëz të kësaj kategorie braktisin atdheun, populli vazhdon të rezistojë.

Ose të marrim çështjen e organizimit të komplottit përvrasjen e Bajram Currit. Edhe kjo zë një vend të madh në dramë. Duke hyrë në hollësitë e organizimit të atentatit, edhe skena e Kukësit zë një tablo të

tërë që i jep dramës një karakter më shumë policesk. Pra edhe kjo mendoj se e ul pak vlerën e dramës. Intriga, sipas mendimit tim, është dhe duhet të mbetet, por mund të gjendet mënyra që nëpërmjet tekstit të zbulohet që po luhet një intrigë e tillë, pa qenë nevoja të zhvillohet e tëra në skenë. Ka disa drama klasicke, thelbi i të cilave është dueli, domethënë marrja e hakut. Kjo nuk del në skenë, duelin nuk e shëh fare, por rrëth tij zhvillohet e gjithë drama. E gjithë kjo kuptohet nëpërmjet monologëve dhe dialogëve. Pra çështja thuret në mënyrë të tillë që spektatori e jeton këtë akt të rëndësishëm, po pa e parë ak-sionin.

Në pjesën e fundit vepra merr formën e melodramës. Bajram Curri vritet, vajza patriote i bie tradhatarit, pastaj vritet edhe ajo vetë. Domethënë, të vrarët bien njëri pas tjetrit. Kjo e ul tragjedinë. Forma të tilla të paraqituri janë pak si primitive. Në këto drejtime, mendoj unë, drama ka nevojë të ripunohet.

Edhe një gjë tjetër mendoj të keni parasysh: Bajram Curri, si në finale ashtu edhe në disa skena të tjera, nuk duhet të lihet vetëm. Korrigimi i kësaj çështjeje do t'i jepte më shumë madhështi veprës. Bajram Currin ta nxirrni kurdoherë me popullin e armatosur. Kjo të dalë bukur. Aktori që luan rolin e Bajram Currit mendoj se e interpreton shumë bukur, por duhet pasur kujdes që Bajrami të mos dalë si një bajraktar, si një njeri i vëtmuar, me një ose dy trima prapa, por të dalë në masë. Një gjë e tillë do të paraqitej bukur edhe nga ana skenike. Në skenë mund të dilnin edhe

20-30 veta me armë së bashku me Bajram Currin, dhe midis tyre mund të zhvillohej edhe një dialog për të treguar me këtë lidhjet e këtij patrioti me popullin, entuziazmin dhe optimizmin e popullit, si dhe besimin që kishte populli te ky patriot i madh. Njerëzit e popullit duhet të dalin më fuqishëm, kurse armiqtë në këtë pjesë të dalin më pak në skenë. Ky kontrast mund të bëhej. Kështu vepra do të bëhej më e bukur, do të bëhej një dramë kombëtare me rëndësi të madhe.

Ju keni mundësi të mëdha ta zhvilloni e ta trajtoni më gjerë figurën dhe luftën e Bajram Currit, duke ngushtuar skenat e tepërtë dhe duke i zëvendësuar ato me zgjerimin e ideve politike e shoqërore të Bajram Currit. Mundet të flitet edhe për simpatinë e tij për socializmin. Mos harroni se Bajram Curri ka qenë gjithashtu një nga udhëheqësit e kryengritjes në Kosovë. Prandaj të dalë lufta e tij për popullin, mobilizimi i popullit nga ana e tij, domethënë të dalë figura e tij si një bir i popullit tonë etj. Nuk e kam fjalën që në këtë vepër të pasqyrohet gjithëjeta e këtij patrioti, po përpinquni të gjeni momentet më karakteristike të jetës së tij; çështjet e tjera, si intrigat, thurjen e komplateve, rrahjet që bënин në popull njerëzit e Zogut, të shfrytëzohen për të treguar rrezikun që kërcënonë ato momente Shqipërinë dhe Bajram Currin. Për këto gjeni mënyrën se si duhen thënë në dialog. Veç këto gjëra të mos i thotë spiuni, po një njeri i popullit, një luftëtar për çështjen e tij, që të vëré në dukje se «jemi në rrezik», se «po na sulmon armiku», «po komploton serbi» etj.

Mbyllja e dramës mendoj se mund të dilte më e

bukur, më e fortë. Ju mirë keni bërë që në fund tregoni se si vritet Bajram Curri. Por duhet të mendoni që ky akt të përbëjë thelbin e dramës që mbyllja të jetë madhështore, kurse kjo nuk është arritur. Ju e keni mbyllur skenën e fundit duke e futur Bajramin në shpellë, ndërsa vajza vret tradhtarin, ajo vritet e mbi të bie flamuri. Me këtë ju keni dashur të tregoni rezistencën e popullit, por mendoj që atë ta tregoni në forma të tjera. Kryesorja për këtë dramë është akti heroik i Bajram Currit, prandaj ai të tregohet, ai të dalë në një apoteozë, të përbëjë pikën kulminante të mbylljes, por kjo të paraqitet në mënyrë simbolike, të mos tregohet në skenë vrasja.

Për këtë mundet dhe duhet t'ju ndihmojnë dhe kompozitorët. Unë dëgjova elegjinë që ka kompozuar Tonin Harapi për Luigj Gurakuqin. Para se ta dëgjoja pata frikë se mos i kishte dhënë ngjyrën e një vajtimi, po më pëlqeu, se me të vërtetë të mallëngjente, se edhe fjalët e Fan Nolit janë me të vërtetë të larta, plot pasion. Sidoqoftë Tonin Harapi elegjinë e Fan Nolit për Gurakuqin e ka nxjerrë shumë bukur, ajo është një tablo rrëqethëse, po jo vajtuese. Kompozitori mund të japë një tablo madhështore në muzikë për vrasjen e Bajram Currit që të këndohet nga një kor i madh dhe si tekst i këngës të shërbejë poezia e Nolit. Pra të dalë një himn madhështor.

Skena mund të bëhet më e madhe, duke nxjerrë në sfond bjeshkët e Shkëlzenit me pamjen e tyre të mahnitshme, ku të duken mirë shpella e Dragobisë dhe luftha e Bajram Currit. Elegjia, pra, mund të mbylljet me këtë shpellë dhe me flamurin. Kështu, si e imagjinoj

unë, mund të dalë madhështore dhe do t'i ngrejë peshë spektatorët. Të kihet parasysh që mbyllja e pjesës të çelë perspektiva, të paralajmërojë të ardhmen, të hapë horizonte, të japë idenë që për vendin tonë do të vijë një kohë e re, më e bukur.

Këto ishin vërejtjet e mia për veprën.

Ju, shoku regjisori, e keni vënë shumë mirë në skenë dramën, çdo gjë u përshtatet idesë dhe qëllimeve të saj. Unë mendoj se te ju kemi një regjisori me talent. Gjithashtu, mendoj se autorët mund t'i ndihmosh edhe ti, sepse shfaqja e një drame, e një opere ka rëndësi. Ja, për shembull, po afron 500-vjetori i vdekjes së Skënderbeut, shokët shkrimtarë e kompozitorë a nuk duhet të mendojnë për të preqatitur libretin e për të vënë në skenë një operë për këtë Hero Kombëtar?

Nga aktorët që luajnë në dramën «Plaku i maleve» më pëlqen ai që interpreton rolin e Bajram Currit. Rolin e vajzës Tinka Kurti e luan shumë lirisht dhe i përshtatet shumë personazhit. Edhe aktori që interpreton rolin e babait të saj, Sadi Leka, e luan bukur; gjithashtu edhe vëllai i saj. Të mos lë pa përmendur edhe artistin që luante mirë rolin e Sali Manit. Përveç këtyre artistëve, që u dalluan, unë mund të them se i gjithë kolektivi në përgjithësi ka interpretuar mirë.

Shfaqjen e panë edhe disa pleq, shokë të Bajram Currit, që kishin ardhur në Vlorë të ftuar për festat. Ata ishin shumë të gëzuar për këtë shfaqje dhe e pëlqyen. Njëri nga ata bëri vërejtje vetëm për qylafin e Bajram Currit që e kishte pak si në ngjyrë hiri. Po këto janë gjëra që përmirësohen, hollësira për ata që kanë

pasë jetuar me Bajramin. Sidoqoftë pleqtë ishin entuziastë se e duan figurën e këtij patrioti të madh.

Nuk di nëse i kam drejt apo jo këto vërejtje që bëra. Mund edhe të mos jenë të tëra të drejta. Kur shkruhet një dramë, të gjithë bëjmë vërcjtje, jo hiq këtë pjesë, jo hiq atë. Mirëpo, po të bësh shkurtime apo ndryshime të pastudiuara mirë, vepra nuk mund të qëndrojë në këmbë. Është sigurisht më lehtë të kritikosh, kurse është shumë më e vështirë të bësh një dramë. Një gjë të tillë nuk e bën dot çdo njeri. Sidoqoftë po t'ju duket se vërejtjet e mia kanë vlerë, i kini parasysh. Qëllimi im këtu është ta përmirësojmë dramën, të bëjmë një gjë edhe më të mirë. Po edhe kështu si e keni, ju vazhdoni ta shfaqni.

Pasi shkëmbeu disa mendime me të pranishmit për zhvillimin e mëtejshëm të teatrit dramatik, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Çdo vit te ne kërkesat e kulturës rriten, prandaj shpenzimet për këtë sektor zënë një vend të madh. Për edukimin dhe për dëfrimin e rinisë dhe të fëmijëve ne duhet të mendojmë mirë. Unë nuk kam shkuar ndonjëherë në teatrin e kukullave në Tiranë, po vetëm fjalë të mira kam dëgjuar për të nga shokët, si edhe nga një francez që ka qenë drejtor i Liceut të Korçës dhe tani është drejtor i një teatri të vogël prej 6 veta në Francë. Ai dhe e shoqja e tij e njohin më të teatrin e muzikën dhe, kur e panë teatrin tonë të kukullave, u habitën dhe thanë se në Francë në qytete që janë 2-3 herë më të mëdha se Tirana nuk ka të tillë teatro, të pajisur me gjithë këto mjete që kemi ne. Sepse dihet që në vendet kapitaliste teatrot janë pri-

vatë, prandaj bëhen shumë pak shpenzime, kurse aktorët dhe gjithë punonjësit e tjerë të teatrit shfrytëzojnë shumë. Por për rininë, sidoqoftë, ne duhet të mendojmë.

Unë do të mendoja që ju të bënë një punë më të organizuar për edukimin profesional të punonjësve të teatrit. Të siguroni edhe disa materiale të veçanta të përkthyera, të zgjedhura nga gjuhë të tjera, ku të tregohet mjeshtëria e artistëve të dëgjuar në skenë.

Ju që jeni punonjës profesionistë të teatrit, duhet që filmat artistikë t'i shikoni jo vetëm nga pikëpamja e përbajtjes së tyre, po të mban edhe shënimë, dhe t'u rekomandoni aktorëve edhe disa skena të veçanta, që ju e gjykon se u vlejnë atyre për të mësuar nga artistët e shquar të vendeve të tjera, anët pozitive të artit të tyre. Ka pastaj dhe filma të veçantë për edukimin profesional të aktorëve të teatrit, prandaj të shohim edhe në këtë drejtim ç'mund të bëhet. Për filma të tillë nuk do të kursejmë. Teatri është një nga mjetet e edukimit të masave që materialisht është i kushtueshëm, sepse e subvencionojmë, por fitimet që vijnë nga ai në drejtim të edukimit të masave punonjëse janë të mëdha.

Botohet për herë të parë si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

ZGJONI TE STUDENTËT DASHURINË DHE VULLNETIN PËR PUNË KRIJUESE

*Nga fjala me pedagogët dhe studentët e Institutit
Pedagogjik Dyvjeçar të Shkodrës*

18 dhjetor 1962

Përmes një entuziazmi, gëzimi, hareje dhe brohorritjeve për Partinë e Punës dhe shokun Enver Hoxha, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror, pasi i përshëndeti studentët dhe pedagogët e Institutit Pedagogjik Dyvjeçar të Shkodrës, midis të tjerash tha:

Jam shumë i gëzuar që vizitoj institutin tuaj. Me këtë rast ju uroj nga zemra: e gëzofshi godinën e re! Përparimet tuaja janë të mëdha, por mundësitë janë që ju të përparoni edhe më shpejt. Faktor me rëndësi për këtë është e duhet të jetë edhe ndihma e Universitetit të Tiranës. Por kjo s'mjafton. Ju gjithashtu duhet të krijoni lidhje e të shkëmbeni eksperiencë edhe me institutet e tjera qoftë brenda vendit tonë, ashtu dhe jashtë, sigurisht me ato vende, të cilat duan të kenë miqësi me ne.

Ju, shokë pedagogë, jeni njerëz me kulturë, të edukuar dhe patriotë, prandaj përpinquni të përhapni

shkencën dhe diturinë në rininë tonë, e cila është e zellshme të studiojë, ndjek me pasion shkencën, ka ndjenjën e së resë dhe me siguri do ta përvetësojë atë gjithnjë e më mirë. Kuadrot që punojnë në shkollat tona, të çfarëdo moshe qofshin, kanë ndërgjegje të lartë në detyrën e tyre fisnike; ata kanë bërë e bëjnë të gjitha përpjekjet që studentët të dalin nga bankat e shkollës sa më të prebat, më të kulturuar dhe më të mbrujtur me idealet e marksizëm-leninizmit.

Të huajtë, pas vizitave që bëjnë në institutet tona dhe pas takimeve të tyre me pedagogët e studentët tanë, dalin me përshtypje nga më të mirat për rezultatet e arritura dhe njohuritë shkencore të pedagogeve tanë.

Pastaj shoku Enver Hoxha, pasi foli për kushtet në të cilat mëson sot rinia jonë, për perspektivat që do të kenë institutet e shkollat tona të larta në të ardhmen, vazhdoi:

Instituti juaj Pedagogjik tashmë ka krijuar një traditë të mirë. Mua më kanë informuar se mësuesit që dalin nga dyert e tij janë plotësisht të ndërgjegjshëm në punë, e kanë marrë me pasion profesionin, sepse është i bukur, ata po i kryejnë mirë detyrat që u ngarkohen, kudo ku i ka dërguar Partia, në cilind vend qofshin, sepse janë nisur gjithmonë nga interesi i përgjithshëm i popullit.

Në vendet kapitaliste një mjek duhet të ketë një stazh pune rreth 15 vjetësh për t'i besuar një vend pune me përgjegjësi. Krejt ndryshe ndodh te ne, ku kuadro të rinj, me ndërgjegje të plotë dhe vullnet të madh, drejtojnë sot vende me përgjegjësi.

Shoku Enver Hoxha, pasi foli me admirim edhe përgjuhën shqipe që na e lanë trashëgim të parët, tha:

Në fushën e gjuhës letrare shqipe kemi bërë përparime, por ka dhe disa të meta. Prandaj, ashtu siç e duam gjuhën tonë, duhet ta pasurojmë atë me fjalët dhe me shprehjet e popullit, me traditat e bukura që trashëgojmë brez pas brezi. Në sintaksë duhet të jetë matematicienë, ta pasurojmë gjuhën shqipe dhe ta pastrojmë atë nga fjalët e panevojshme të huaja. Tani kur gjuha është më e përparuar dhe më e përcaktuar duhet të shkruhet dhe të shqiptohet drejt e pastër, pastaj edhe të pasurohet vazhdimesht. Në vendin tonë kemi shumë lloj bimësh, kafshësh për të cilat të parët tanë patjetër kanë pasur emra. Detyra jonë është t'i gjejmë fjalët përkatëse dhe, po të mos i gjejmë, atëherë të formohen fjalë të reja për to, sipas natyrës së gjuhës sonë. Gazetat tona shkruajnë me një fjalor të kufizuar, sepse nuk kujdesen për njohjen e fjalorit, përdorimin e tij etj.

Një detyrë e madhe u bie edhe pedagogëve të shkencave, të cilët duhet të zgjojnë vazhdimesht te studentët dashurinë dhe vullnetin për punë krijuese. Pedagogët tanë duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për ngritjen e tyre profesionale, të studiojnë literaturë të huaj, të mësojnë ndonjë gjuhë të huaj, të futin gjithmonë gjëra të reja në mësim, duke mos lënë pas dore edhe kuriozitetet shkencore, sigurisht duke pasur parasysh ato që nuk i ngarkojnë studentët po i ndihmojnë të zgjerojnë horizontin e tyre.

Jam i gjëzuar që vizitova institutin tuaj dhe dëgjova për sukseset tuaja. Dëshiroj që ky institut të arrijë

suksese më të mëdha. Ju pedagogët të rritni cilësinë e punës që instituti të nxjerrë kurdoherë kuadro të mirë, vajza e djem me eksperiencë, të cilët kurrë nuk do të jenë të tepërt në vendin tonë.

Pastaj, shoku Enver Hoxha, pasi i uroi për suksesetë mëtejshme në punën edukative, i shoqëruar nga autoritetet e vendit dhe pedagogët, vizitoi auditorët mësimorë dhe laboratorët e institutit.

Botohet për herë të parë, me shkurttime, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PUNËTORET TË BËHEN NË RADHË TË PARË SPECIALISTË NË PROFESIONIN E TYRE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

22 dhjetor 1962

Bashkimet profesionale mendoj se duhet t'i rishikojnë të gjitha format e metodën e punës së tyre, dhe të nxjerrin një eksperiencë të re nga e gjithë eksperiencia e gjertanishme për edukimin e klasës punëtore. Mendoj që të mos bëjmë kapica formash e mënyrash të tjera duke shpikur të reja sa të mos mundim t'i kontrollojmë e të mbytemi kështu në një oqean formash dhe metodash. Format kryesore të punës duhet t'i konkretizojmë, t'i bëjmë më praktike e më të pranueshme nga punëtorët, me qëllim që ata të mund të edukohen më mirë dhe të mobilizohen më shumë për zbatimin e detyrave. Në këtë drejtim duhet të shihet edhe koha që u merret punëtorëve, sepse mbledhjet pesëminutëshe, për shembull, ka raste që bëhen edhe 50 minuta, bile nganjëherë edhe dy-tri orë. Këto quhen mbledhje

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi disa çështje të edukimit të klasës punëtore me qëndrimin socialist ndaj punës.

pesëminutëshe, kurse në realitet ka raste që zgjatin shumë. Kështu nuk bëjmë gjë tjetër veçse një punë formale, u humbasim kohën punëtorëve, nuk i lëmë ata të merren me çështjet kryesore.

Bashkimet profesionale dhe Partia të kenë parasysh gjënë kryesore që punëtorët janë punëtorë. Ne nuk kemi as në plan, as për qëllim që të gjithë punëtorët t'i bëjmë me universitet. Po të nisemi nga kjo pikëpamje gabojmë. Kjo nuk do të thotë se nga punëtorët që kemi në punë nuk do të dalin elementë, të cilët do të shquhen në punë e në studim sa të mbarojnë edhe universitetin. Të tillë ka e do të ketë, por jo të mendohet që e gjithë klasa punëtore do të marrë shkollë gjersa të arrijë të mbarojë universitetin.

Detyra e Partisë është që punëtorët të bëhen në radhë të parë specialistë të profesionit të tyre. Kjo është kryesore për ne. Bile ne të përpinqemi që shumica e tyre të bëhen kuadro të mesëm. Edhe në programin e shkollave të përgjithshme të kemi parasysh që ta vëmë theksin në preqatitjen e kuadrove të mesëm punëtorë. Kjo rrugë që ndiqet te ne ka sjellë e do të sjellë edhe në të ardhmen frytet e saj të mira. Punëtorët duhet të perfektionohen në zanatin e tyre, të ngrihen në kategori. Edhe pas 20 ose 25 vjetësh, kur universiteti ynë do të ketë nxjerrë shumë kuadro të lartë, punën vendimtare në industri, bujqësi etj. do ta bëjë masa e punonjësve që do të ketë arsim të mesëm. Do të vijë një kohë që preqatitjen e kuadrove të lartë ta kufizojmë dhe pranimet në universitet t'i shtrëngojmë, sepse ne nuk mund të diplomojmë, për shembull, 10 agronomë për 10 hektarë tokë. Ndërsa kuadro të

mesëm ne do të preqatitim vazhdimisht. Prandaj një nga detyrat kryesore të bashkimeve profesionale është edukimi tekniko-profesional i punëtorëve. Për këtë qëllim është e domosdoshme t'u jepet rëndësi kurseve të kualifikimit në qendrat e punës, brenda formave e metodave ekzistuese.

Natyrisht kualifikimi nuk bëhet pa pasur kulturë të përgjithshme. Shkolla fillore për këtë qëllim është e domosdoshme, edhe për kryerjen e 7 ose 8-vjeçares duhen bërë përpjekje, po në drejtim të shkollës të jemi një çikë elastikë. Një teknik i kategorisë së gjashtë e të shtatë, që është i kualifikuar, kur është mbi 40 ose 45 vjeç, unë do të thoshja që të mos insistonim aq shumë që ai të mbarojë medoemos shkollën 7-vjeçare e të mesme. Një punëtor i tillë është i aftë që t'u mësojë të rinjve zanatin e tij. Ne duhet të synojmë që një punëtor të marrë kulturë të përgjithshme për çka mund të ketë nevojë, në radhë të parë të jetë politikisht i ngritur, të dijë mbi situatën ekonomike në Shqipëri etj. Po punëtorët ne i kemi rrethuar me forma të shumta edukimi, që i ndihmojnë ata të kuptojnë çështje të tillë. Në qoftë se punëtori nuk di, fjala vjen, ku është Zanzibari, sepse atje zhvillohet një kryengritje, po të dojë ai të shtojë njohuritë, mund të pyesë dhe të mësojë. Mirëpo tani punëtorit me moshë të kaluar i thuhet të dijë edhe thyesat edhe algjebër. Nuk është keq t'i dijë edhe këto, por tani, afër këtyre punëtorëve ka (dhe nesër do të ketë më shumë) elementë të rinj, të cilët, në rast nevoje, do ta ndihmojnë për të zgjidhur me anë të algjebrës ndonjë problem teknik.

Ndërsa me punëtorët me moshë të rritur synimi

kryesor të jetë perfektionimi i mëtejshëm në profesionin e tyre, me punëtorët e rinj të jemi më kërkues, sepse kanë mundësi më të mëdha dhe janë në gjendje të mbajnë barrë më të rëndë në drejtim të edukimit. Sidomos brigadat që luftojnë për të fituar titullin «Brigadë e Punës Socialiste», po nuk patën edhe kushtin e shkollës, nuk mund të dallohen nga masat. Të gjithëve u kërkojmë të jenë patriotë, të sjellshëm e të disiplinuar në punë e në shoqëri, të zbatojnë rregullat, të realizojnë e të tejkalojnë normat, por në brigadat e punës socialiste ka disa gjëra plus, që janë më të vështira. Pikërisht për këtë arsyе ato quhen «Brigada të Punës Socialiste».

Megjithatë, në kushtet e caktuara për këto brigada mendoj të shihet mundësia për të bërë ndonjë thjeshtim në kuptimin që brendapërbrenda brigadave të jemi më elastikë me njerëzit, mund të ketë edhe ndonjë diferencim midis tyre. Pastaj, lidhur me edukimin e klasës punëtore, ka rëndësi lufta për zhdukjen e mbeturinave mikroborgjeze, për forcimin e disiplinës etj.

Çështja e fundit që desha të theksoja ka të bëjë me mbledhjet e prodhimit. Këto kanë një rëndësi të madhe, por kam përshtypjen që rregullat për funksionimin e tyre nuk zbatohen si duhet. Rolin kryesor këtu e ka administrata, drejtori, kryeinxhinieri dhe kuadrot e tjerë kryesorë, të cilët duhet të ndiejnë nevojën e mbledhjes së prodhimit. Por një rol të madh për këto mbledhje luajnë edhe organizatat profesionale, të cilat çështë e domosdoshme të ngrenë problemet që duhen shtruar përpara ndërmarrjes e punëtorëve dhe të marrin vendime për zgjidhjen e tyre. Nuk është mirë të

ngatërhojen udhëzimet me gojë që jepen në punë e siper me çështjet kyç që duhen shtruar në mbledhjet e prodhimit. Për shembull, një punëtori i jepet detyra të shpojë pusin, caktohet vendi, drejtimi, thellësia etj. Inxhinieri shkon në vend dhe e mëson atë si të punojë konkretisht etj. Këto janë udhëzime, janë zbatimi në praktikë i rregullave dhe i eksperiencës së fituar, dhe jo mbledhja e prodhimit. Por nga eksperiencia e gjithë punës së përditshme dhe mujore në ndërmarrje ose në reparte dalin disa probleme kryesore kyç, të cilat në procesin e punës ose nuk janë zbatuar si duhet, ose janë penguar, pra del nevoja për të marrë masa organizative e teknike dhe të zgjidhen drejt e shpejt çështjet. Për këtë kërkohet edhe përkrahja e punëtorëve, kritika dhe vërejtjet e tyre ndaj veprimeve të udhëheqjes. Atëherë zhvillohet mbledhja e prodhimit, e cila organizohet mirë, punëtorët njoftohen me kohë, gjithkush mendon dhe sjell aty eksperiencën, sugjerimet e kritikat etj. Kështu mbledhjet mundet dhe duhen bërë të efektshme, ndryshe do të janë formale. Prandaj në këtë drejtim organizatat profesionale të aktivizohen më mirë.

Ne u kemi bërë vërejtjen shokëve të bashkimeve profesionale që të mos merren shumë me prodhimin, po kësaj çështjeje ata nuk mund t'i shpëtojnë. Sigurisht, të kenë parasysh që të mos bëjnë punën e organeve shtetërore, por çështja e realizimit të planeve është pasqyrim i gjithë qëndrimeve socialiste të punëtorëve ndaj punës. Në qoftë se në një ndërmarrje ka disiplinë, në qoftë se nuk ka orë të humbura në punë, nëse plani realizohet, kjo do të thotë se puna po-

litike, edukative, shkencore e organizative në këtë ndërmarrje zhvillohet në rregull. Ata që qëndrojnë mirë politikisht janë në gjendje të realizojnë e të tejkalojnë edhe planet. Prandaj puna politike duhet të synojë në atë që punëtori të bëhet njeri i kulturuar, të pajisët me vetitë e një komunisti dhe të kuptojë që detyra e tij në shoqëri është realizimi i planit dhe zbatimi me përpikëri e në mënyrë të ndërgjegjshme i detyrave që i ngarkohen.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

NJERËZIT E DREJTËSISË DUHET TË KENE CILËSI TË LARTA POLITIKE DHE MORALE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

22 dhjetor 1962

Partia është dhe duhet të jetë e ndërgjegjshme për punën e rëndësishme që kryejnë gjykatat. E them këtë sepse akoma ka një kuptim deri diku të cekët në lidhje me rolin e tyre. Në këtë drejtim Partia duhet të jetë më e mobilizuar, që gjykatat të jenë në lartësinë e detyrës së vet. Sot duhet t'i shohim çështjet akoma më thellë se në vitet e para të pasçlirimit, sepse shteti ynë konsolidohet gjithnjë e më tepër, tanë kemi një shumicë të madhe ligjesh, kodin civil, kodin penal, kodin e procedurës, kodin e punës dhe urdhëresa e shumë dispozita të tjera, prandaj të ecim kurdoherë duke u bazuar në to. Në qoftë se nuk veprojmë sipas tyre, atëherë kemi shkelur ligjshmërinë socialiste, të cilën në asnje mënyrë nuk duhet t'ia lejojmë vetes.

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi sigurimin e udhëheqjes së Partisë në organet e drejtësisë.

Për këtë duhet të luftojë në radhë të parë Partia, por edhe vetë trupi gjykues e prokuroria, ku Partia ka shokë nga më të mirët, të cilët i ka caktuar në këto organe për të zbatuar drejtësinë e popullit, drejtësinë e Partisë. Prandaj nga shokët e Partisë duhet të ketë një konsideratë të madhe për punonjësit e gjykatave e të prokurorisë. Vendimet e gjykatave duhet të jenë akte me autoritet. Partia t'i udhëheqë organet e drejtësisë, t'u japë atyre orientim të drejtë dhe të zhvillojë me punonjësit e tyre një punë të madhe edukative.

Shokët që punojnë në organet e drejtësisë duhet të jenë njerëz të zgjedhur, me cilësi të larta politike dhe morale, me qëllim që populli të ketë besim të plotë tek ata. Këtë besim shokët që punojnë në organet e drejtësisë duhet ta fitojnë vetë me punën dhe me qëndrimet e tyre. Në këtë mënyrë ata do t'ë ndihmojnë në rritjen e autoritetit të organeve ku punojnë, do t'ë ndihmojnë gjithashtu edhe Partinë. Kundër shfaqjeve që njollosin figurën e njeriut të drejtësisë sonë Partia duhet të jetë e rreptë. Mund të ndodhë, për shembull, që edhe një gjykatës të shkurorëzohet me gruan e vet, por kjo të jetë me arsyet e plotë, që opioni publik të bindet. Në qoftë se ai e ndan gruan pa arsyet, populli këtë nuk ka për ta pritur mirë, si rrjetdhim, karriera e një gjykatësi të tillë ka marrë fund, pavarësisht se ai politikisht mund të jetë njeri i mirë, osc mund të bëjë edhe autokritikë në organizatën-bazë për gabimin që ka kryer. Një njeri i tillë, edhe sikur ta marrë përsëri gruan që ndau, nuk bën më për gjykatës.

Në zbatimin e ligjeve tona, krahë sukseseve, vi-

hen re edhe mjaft shkelje. Prandaj është e qomosdoshme të ngrihet në një nivel të lartë forcimi i disiplinës shtetërore. Disiplina të jetë kudo e fortë. Çdo ent, ndërmarrje apo sektor duhet të respektojë ligjet dhe urdhëresat, në mënyrë që të ketë sa më pak shkelje të tyre. Në këtë drejtim kërkohet një punë më e madhe edhe nga prokurorët popullorë të fshatrave, të cilët kanë një rol të rëndësishëm. Ndodh që prokurori popullor i fshatit, kur shikon shkelje të ligjit, nuk ndërhyr te kryetari i këshillit popullor të fshatit ose te kryetari i kooperativës bujqësore, me qëllim që të kërkojë zbatimin e ligjit. Prandaj që prokurori popullor i fshatit të luajë si duhet rolin e vet, duhet t'u kushton kujdes zgjedhjes dhe edukimit të tij.

Një punë më e organizuar duhet bërë me kryetarët e kooperativave bujqësore dhe me sekretarët e organizatave-bazë të Partisë që këta të njojin më mirë ligjet e shtetit dhe rregulloret, sepse në këtë mënyrë do të kërkojnë nga vetja, nga punonjësit dhe nga komunistët që çështjet të gjykojnë në bazë të ligjeve dhe të zgjidhen sipas tyre. Në qoftë se drejtuesit nuk i dinë ligjet, atëherë le të pycsin ata që i dinë, pastaj të veprojnë, sepse ndryshtë bëhen shkelje.

Natyrisht çdo rast që gjykohet varet edhe nga rrethanat e veçanta, por nganjëherë ekziston një disnivel i madh në dhënen e dënimeve për të njëtin faj, nga një rreth në tjeterin, nga një gjykatë në tjetrën. Ndoshta kjo kërkon ndonjë studim, përgjithësim dhe konkluzione nga ana e Gjykatës së Lartë. Në mbledhjet e Presidiumit të Kuvendit Popullor kemi diskutuar lutje të personave të dënuar me vdekje. Disa vendime ne i

kemi kthyer duke gjykuar se nuk kanë qenë të drejta, na është dukur se dënim i me vdekje në këto raste është dhënë duke u tërhequr më shumë nga opinioni i rrethit. Ky opinion duhet mbajtur parasysh, por duhet edhe ta edukojmë opinionin, sepse ka raste që një njeri vret një tjetër dhe për shkak të disa rrëthanave nuk duhet dënuar me vdekje, kurse opinioni thotë që fajtori të vritet. Gjyqtarët në këto raste duhet të qëndrojnë mbi opinionin publik, bille edhe mbi opinionin e shokëve të Partisë, dhe ta gjykojnë mirë çështjen. Edhe në drejtim të vjedhjeve e të fajeve të tjera ka shkallëzime të shumta. Gjykatësit, të tërhequr nga opinioni, mund të gabojnë në marrjen e ndonjë vendimi për këtë qëllim, prandaj ata duhet të vihen mirë në dijeni nga Partia. mbi situatën në përgjithësi, veçanërisht mbi situatën politike dhe ekonomike të rrethit, në mënyrë që vendimet e tyre të jenë kurdoherë me vend.

Edhe për faje politike ka një gamë të madhe dënimesh. Kur një element paraqit rrezikshmëri të madhe, kur ai tradhton atdheun ose i jep armikut sekrete të shtetit, atëherë mund të jepet dënim i kapital. Por kur një njeri arratiset, tradhton atdheun dhe pas ca kohësh kthehet në Shqipëri, ne mund edhe ta falim ose të mos nxitohemi duke i dhënë dënimin më të rëndë. Natyrisht, qëndrimi që do të mbahet varet nga rrezikshmëria e personit. Në qoftë se një njeri i tillë bëhet divergent ose strehues kriminelësh, mundet edhe të pushkatohet, po mund t'i jepet edhe dënim i maksimal me burg. Duke gjykuar mirë dhe me ndërgjegje të plotë rrezikshmërinë e një elementi armik, duhen parë, pra,

me kujdes rrrethanat dhe kushtet që e kanë shtyrë për të kryer një faj, në mënyrë që, kur të jepet vendimi, këtë ta pranojë menjëherë opinioni. Prandaj gjykatësit ne duhet t'i mbajmë afër. Partia t'i mbajë në korent dhe t'i kritikojë kur kanë gabime, kur bëjnë lëshime, kur tregohen oportunistë ose kur janë shumë sektarë dhe nuk e gjykojnë mirë situatën. Të jesh gjyqtarështë çështje me shumë rëndësi dhe delikate.

Rëndësi të madhe ka edhe puna e ndihmësgjyqtarëve, sepse edhe këta luajnë rol në gjykimin e problemeve. Ndihmësgjyqtarët janë njerëz me një të kaluar të mirë, por, nga ana profesionale dhe nga mundësitetë për të studiuar materialet që u paraqiten gjykatave, çalojnë. Caktimi i ndihmësgjyqtarëve te ne u jep mundësi masave punonjëse të jenë afër në gjykimin e çështjeve dhe ndihmon në mënyrë efektive gjykatat në punën e tyre. Por që t'i kemi të përhershëm ndihmësgjyqtarët nuk është e mundur, sepse ata janë me qindra, por edhe të zëvendësohen vazhdimesht, domethënë të bëhet qarkullimi i dendur e i shpeshtë i tyre, edhe kjo nuk më duket e mirë. Prandaj në çështjen e këtij qarkullimi duhet treguar kujdes dhe ndihmësgjyqtarët të mësohen që të lidhen me gjykatat, me punën dhe me detyrat e tyre.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

NE PORTIN E DURRESIT TE PUNOHET VAZHDIMISHT PER EDUKIMIN E KUADRIT E TE PUNETOREVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

22 dhjetor 1962

Durrësi është porti ku ne kemi përqendruar shumicën e import-eksportit tonë, prandaj edhe vështirësitë janë të paevitueshme. Megjithatë mund të themi se shokët e portit kanë bërë përpjekje shumë të mira dhe kanë arritur suksese në punë.

Ju shokë që punoni në Portin e Durrësit keni fituar një eksperiencë të madhe, e cila ju ndihmon për të përballuar një punë mjaft të gjerë dhe me vështirësi të shumta. Për këtë ju keni dhënë prova të një organizimi të mirë të punës. Por në Portin e Durrësit, që është porti kryesor i vendit tonë, është e domosdoshme të punohet vazhdimesht për edukimin e kuadrit dhe

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e Partisë për edukimin ideologjik dhe preqatitjen profesionale të kuadrit të porteve, flotës tregtare dhe kantierit detar.

të punëtorëve. Në këtë drejtim është bërë një punë e mirë, ndryshe atje do të kishte konfuzion. Pikërisht këtu qëndron merita e organizatës-bazë të Partisë, e drejtorisë së portit dhe e gjithë punonjësve.

Natyrisht, edhe juve duhet t'ju ndihmojnë, në radhë të parë dikasteret dhe të gjitha ndërmarrjet që kanë të bëjnë me ju. Ndërmarrjet dhe dikasteret duhet t'i kuptojnë vështirësitë dhe gjendjen e krijuar në port dhe të marrin masa organizative për të tërhequr sa më shpejt mallrat e tyre. Një punë e tillë nuk bëhet vetëm me urdhër, por me luftë të vazhdueshme dhe të gjith-anshme nga ana e Partisë, e ministrive dhe e drejtoreve të ndërmarrjeve. Mendoj që, pavarësisht nga vështirësitë dhe të metat që ekzistojnë në port, dikasteret dhe ndërmarrjet kanë më shumë faj dhe nuk është aspak e drejtë që fajet e tyre t'ia hedhin portit. Shokët drejtues të dikastereve duhet të interesohen më shumë që ta lichtësojnë portin. Le ta lëmë bitumin, sepse çështjen e tij e dimë për ç'arsye ka mbetur në port, por mallrat e tjera duhet të tërhiqen në kohën e caktuar. Nga ana tjetër, edhe Ministria e Komunikacioneve duhet të aktivizohet më shumë në drejtim të lehtësimit të portit.

Na vjen mirë që shokët e portit kanë zhvilluar një punë të efektshme edukative. Si rrjedhim, atje ka një gjendje të shëndoshë morale dhe politike, ka përpami dhe nuk kanë ndodhur gjëra të papëlqyeshme. Nuk përjashtohet që në një kolektiv të madh, siç është ai i këtij porti, të ndodhë edhe ndonjë rast jo i mirë, sepse mund të ketë njerëz që t'i shpëtojnë kontrollit të Partisë. Por ndonjë preokupacion të veçantë për portin

nuk kemi pasur. Byrosë Politike ose Sekretariatit të Komitetit Qendror nuk i ka ardhur ndonjë ankesë në këtë drejtim. Kjo tregon edhe interesimin e madh të Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit për punën në port, ku gjenden pasuri të mëdha.

Na vjen mirë gjithashtu që në kantierin detar kemi një kolektiv të shëndoshë, ku punojnë njerëz të edukuar mirë, që tregojnë interesim për ndjekjen e shkollës dhe që me punën e tyre të mirë influencojnë në përmirësimin e punës në të gjithë portin.

Flota tregtare nuk i ka ato mundësi dhe lehtësi që kanë sektorët e tjera të portit në lidhje me edukimin e punonjësve, sepse mjetet detare janë në lëvizje. Megjithatë, edhe në këto mjete organizata-bazë e Partisë duhet të bëjë përpjekje dhe të punojë për edukimin komunist të punonjësve. Por të kihet kujdes që ky edukim të mos bëhet në mënyrë formale, por në bazë të një programi të menduar dhe të përpunuuar mirë. Për shembull, para se vaporri «Vlora» të niset për në Republikën Popullore të Kinës, komiteti i Partisë të preqatitë materiale ngajeta dhe historia e të gjithë popujve dhe vendeve ku do të kalojë ky vapor. Kështu, para se vaporri të arrijë në Egjipt, fjala vjen, komisari i flet kolektivit për historinë e këtij vendi, gjithashtu edhe gjatë ditëve që vaporri qëndron në Port-Said, ose kur kalon gjatë Kanalit të Suezit, ai u flet punonjësve të vaporit edhe mbi ekonominë e këtij vendi, mbi politikën që ndjek qeveria e tij, mbi luftën e këtij populli, mbi agresionin që u organizua në vitin 1956 etj. Pasi vaporri kalon në Detin e Kuq mund të bëhen leksione të kësaj natyre mbi popujt dhe vendet e këtyre zona-

ve, mund t'u flitet, për shembull, për monopolet angleze dhe amerikane, për ngjarjet në Jemen, për jetën në vendet arabe dhe kur vaporri futet në Oqeanin Indian të bëhet fjalë për Indinë, për Singapurin, për Indokinën etj. Po të bëhet një punë e tillë politike edukative marinarët do të kthehen në Shqipëri të edukuar e të mësuar shumë më mirë se ata që kanë kryer shkollën 7-vjeçare; ata shohin edhe me sytë e tyre si jetojnë e punojnë popuj të ndryshëm, si vuajnë nga shfrytëzimi kapitalist. Ato që thuhen në libra ata i shohin edhe në jetë.

Këtu u tha që anijet të lidhen me radiomarrëse për të marrë ndonjë lajm nga vendi. Edhe kjo ka rëndësi, por mbajtja e leksioneve, ashtu siç thamë më sipër, c'ngre lart ndërgjegjen e punonjësve të flotës dhe nivelin e tyre kulturoro-edukativ. Kështu këta punonjës do të jenë në gjendje të bëjnë dhe vetë krahasime ç'është socializmi, ç'është kapitalizmi etj. Kështu, kur punonjësi i flotës sonë zbret në një vend kolonial, do të kuptojë të këqijat e kolonializmit dhe do të thotë: «Ku të kam, moj Shqipëri, të të puth në ballë!». Kur ndonjë nga vaporët tanë kalon, për shembull, nëpër Jugosllavi, komisari, natyrisht, do t'i bëjë kolektivit leksion edhe për luftën kundër titizmit, por ai duhet t'i tregojë atij edhe ç'është Jugosllavia, t'i flasë mbi gjeografinë e këtij vendi, si dhe mbi historinë e popujve që jetojnë atje. Në këtë mënyrë ata do të kuptojnë edhe më mirë se ku e ka katandisur Jugosllavinë klika revizioniste e Titos. Kur vete vaporri ynë në Dubrovnik, marinarët tanë do të shikojnë se si janë mbushur dyqanet e këtij porti me mallra amerikane, por, kur do

të jenë sgruar nga komisari, ata do ta kuptojnë qëllimin e klikës së Titos që, për të bërë propagandë te të huajtë për gjoja bollëkun që ka në Jugosllavi, furnizon më mirë qytetet bregdetare e qendrat turistike. Por njerëzit tanë që i mëson Partia të shikojnë larg, e kuptojnë se revisionistët jugosllavë u kanë hapur dyert mallrave të huaja që i sjellin me kredi ose privatish, duke minuar kështu interesat e zhvillimit të industrisë së tyre dhe të vetë punonjësve. Prandaj komisarët e vaporëve duhet t'i ilustrojnë sa më mirë bisedat e tyre për t'i edukuar punonjësit e vaporëve ashtu si duhet. Në këtë drejtim, pra, duhet punuar më me kujdes.

Përsa i përket kuadrit, kur të mbarojnë shkollat, do t'ju jepen të tjerë, por gjatë kësaj kohe shikoni mos bëni ndonjë rregullim brendapërbrenda ndërmarrjeve tuaja. Shikoni çfarë mund të ndihmojë në këtë drejtim edhe kantieri detar ose drejtoria e flotës tregtare.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

TELEGRAM DËRGUAR NDËRTUESVE TË IIIDROCENTRALIT TË BISTRICES

21 janar 1963

Të dashur shokë,

Lajmi mbi suksesin tuaj të ri dhe të madh, takimin e përpiktë të dy tuneleve, më 17 janar, më gjëzoi shumë, ashtu siç ka gjuar të gjithë Partinë e popullin tonë. Këtu u manifestuan dhe një herë ndërgjegjja e lartë socialiste, vullneti i hekurt dhe aftësitë e shëndoshë të punëtorëve, të teknikëve, të inxhinierëve dhe të kuadrove tanë të tjerë, të cilët zgjidhën detyra të komplikuara dhe përballuan pengesa e vështirësi të mëdha e të papritura, duke triumfuar mbi to.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë ju përshtendes nga zemra dhe ju falënderoj për këtë fitore të re që i dhatë popullit! Në të njëjtën kohë shpreh besimin dhe uroj që ajo t'ju nxitë për të kryer sa më parë e më mirë detyrat që keni përpara për t'i dhënë atdheut këtë vepër të madhe të planit të tretë pesëvjeçar.

Çdo sukses juaji është një fitore e re në rrugën e ndërtimit të socializmit, në luftën kundër armiqve imperialistë, revisionistë e monarko-fashistë që na kanë halë në sy.

Le t'jua dëgjojmë zérin vetëm për të mirë, ashtu sikundër ua ka dëgjuar zérin tërë bota Partisë e popullit tonë!

Lavdi ndërtuesve të hidrocentralit të Bisticës!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit»,
Nr. 18 (4488), 22 janar 1963*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

TE FUTIM KULTUREN SOCIALISTE NE ÇDO FAMILJE TE FSHATIT TONE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

22 janar 1963

Të bësh punë kulturore do të thotë që kultura-socialiste të futet në çdo shtëpi, në çdo familje kooperativiste, relativisht me ngritjen e nivelit të fshatit. Të mendosh gjëra të tjera më të mëdha jashtë fuqive të fshatit tonë, do të thotë të mos jesh realist. Në fshat, mësuesi, tekniku bujqësor, infermieri etj. janë njerëzit më me kulturë, prandaj këta duhet të ndihmojnë për zhvillimin e kulturës. Por nuk janë vetëm këta që bëjnë punë kulturore, punën kryesore për zhvillimin e kulturës në fshat duhet ta bëjë Partia, e cila është udhëheqëse e gjithë jetës dhe e veprimit tarisë së njerëzve.

Çdo vit çmobilizohen nga ushtria djem të rinj, të cilët venë në fshat, por këta Partia nuk i aktivizon si

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi gjendjen kulturore në fshatrat e zonave malore.

duhet. Në gjendjen e fshatit tonë ushtari është njeri i qytetëruar në shumë drejtime dhe mund të sjellë shumë gjëra të reja në jetën e popullit. Edhe pse ushtarët nuk janë aktivizuar në mënyrë të organizuar në aktivitetet kulturore, nuk do të thotë se ata kulturën që kanë marrë gjatë jetës në ushtri s'e kanë çuar në fshat. Mënyrën e re të jetesës, luftën kundër disa mbeturinave të vjetra në ndërgjegjen e njerëzve e shumë gjëra të tjera të reja, Partia i ka çuar në fshat në mënyrë të organizuar dhe të paorganizuar. Por mendoj se, po të mobilizohen më mirë të gjitha këto forca në fshat, domethënë mësuesit, agronomët, punonjësit e shëndetësisë, vajzat që kanë kryer ose që po kryejnë filloren dhe 7-vjeçaren, si edhe ata që kanë kryer shërbimin ushtarak, duke u ndihmuar si duhet nga Partia, ne do të kemi një ngritje më të madhe të kulturës në fshat, jo vetëm përsa u përket këngëve e valleve, por edhe mënyrës së ushqimit, të të fjeturit, të veshjes, të pastërtisë, të rregullimit të shtëpisë, të rritjes së fëmijëve etj., etj. Prandaj, të gjithë këta njerëz të mbahen afër nga Partia dhe t'u rekomandohet kooperativave t'i aktivizojnë. Këta njerëz të flasin në familjet dhe të afërmít e tyre ashtu si dinë, të jenë në fshat përquesit e asaj kulture që kanë marrë në ushtri apo në shkollë. Në fakt këta janë më të kulturuar nga fshatarët e tjerë, janë më të kulturuar nga prindërit e tyre. Puna e Partisë të arrijë gjer atje sa edhe nxënësit e shkollës së fshatit të çojnë në shtëpitë e tyre një frysme të re të përparuar e revolucionare.

Në fshat, të kihet parasysh edhe çështja e lidhjeve familjare, vajtja e ardhja te njëri-tjetri. Edhe përpara

shtëpitë tonë kanë qenë të hapura për miqtë. Natyrisht atëherë kjo gjë bëhej në mënyrë patriarchale. Por njerëzit venin te njëri-tjetri pasdarke, këndonin, kërçenin, bënин muhabet. Më duket se këto zakone duke u zhveshur nga patriarkalizmi duhen inkurajuar, sepse janë të mira. Për fshatin të mos merret si shembull jeta e qytetit, ku punëtori ose nëpunësi kanë kushte të tjera që ndryshojnë me ato të fshatit. Fshati ka vajtje-ardhjen te njëri-tjetri. Kjo bille duhet edhe të organizohet. Askush nuk e ndalon sekretarin e organizatës-bazë të Partisë në fshat t'u thotë disa shokëve me parti dhe pa parti që «sonte ejani të vemi për muhabet te filani». Dhe të shkojnë. Sipas traditës, fshatari është mikpritës për mysafirët, po të ketë, për shembull, u pjek edhe gështenja dhe gjatë pasdarkës zhvillojnë muhabete të ndryshme.

Në lidhje me përhapjen e kulturës në fshat, mua më duket se rolin kryesor nuk e luan numri i dhomave, i stoleve dhe i pajisjeve të tjera që mund të jenë në vatrën e kulturës. Mund të ndërtosh edhe 5 dhoma e t'i pajisësh me 100 stola dhe të mos zhvillosh asnjë aktivitet. Natyrisht edhe baza materiale ndihmon për ecjen e punës përpëra, por nuk është kjo e gjitha. Kultura në fshat nuk mund të zhvillohet në ato mënyra dhe në atë shkallë që zhvillohet në qytet. Po të mendojmë kështu, sidomos për fshatrat e malësive, do të bënim gabim të madh. Në vatrat e kulturës të fshatrave malore mund të zhvillohen vetëm disa aktivitete të vogla, të improvizuara, por tërheqëse. Në qoftë se atje do të mendohet që artisti, për shembull, të pajiset me rroba, të përdorë makiazhe etj. nuk ka për t'u bërë asnjë aktivitet.

Por edhe në dhomat e vogla të vatrave të kulturës mund të bëjmë diçka. Vatra e kulturës duhet të jetë një pikëmbështetje për përhapjen e kulturës, por në të, sigurisht, nuk mund të grumbullohet i gjithë fshati. Po edhe atje ku ka ndërtesa të mëdha e moderne, siç është shtëpia e kulturës në Bulgarec, fjala vjen, fshatarët nuk venë çdo mbrëmje. Ca më keq pastaj në vratat e kulturës të fshatrave malore, ku banorët i kanë edhe shtëpitë larg. Megjithatë, në rast se kooperativa bujqësore ka mundësi dhe kërkon të bëjë edhe shtëpi kulture me shumë dhoma, le ta bëjë. Për këtë ajo vendos vetë, ne mund të ndërhyjmë vetëm atëherë kur bëhen shpenzime të mëdha dhe taprohet. Po kryesorja është të zhvillohen aktivitete.

Prandaj, vratat e kulturës në fshat duhet të bëhen qendra të zhvillimit të kulturës, ku mësuesit dhe punonjës të tjerë të pregetit, të jenë organizatorë për të përhapur kulturën në masat e fshatit, në përshtatje me kushtet dhe jo jashtë realitetit. Ne nuk kemi mundësi të bëjmë gjëra të mëdha në fshat, sepse edhe të ardhurat nuk i kemi në atë masë që në çdo fshat të kemi shtëpi kulture ose të mbajmë në shumicë njerëz me rrogë. Kjo do të ishte shumë e rëndë për ne. Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në një fshat kushton, veç kësaj plani i shtetit për ndërtimë është shumë i ngarkuar. Prandaj hëpërhë nuk mund të caktojmë fonde në këtë drejtim. Edhe ndërmarrjet e ndërtimit do t'i ngarkonim jashtë fuqisë së tyre. Megjithatë diçka mund të bëhet edhe nga ana e shtetit.

Në materialin që na është paraqitur thuhet se ne mund të kemi kuadro në të gjitha lokalitetet. Atëherë

mendoj se në disa lokalitete të synojmë që të bëjmë edhe ndonjë shtëpi kulture, natyrisht, tani për tani, jo të madhe, por me perspektivë, që në të ardhmen t'i bëhen shtesa. Sot për sot kemi mundësi të bëjmë ndonjë gjë të vogël, brenda fondeve që disponojmë. Për shembull, në Peqin, që është një qytet i vogël, është mirë të ketë një njeri për çështje të kulturës, kështu edhe në Leskovik, Ballsh, Roskovec, Libohovë, Milot, Fushë-Krujë etj. Sidoqoftë këto qendra të mos i caktojmë tani, po të studiohen dhe pastaj të vendosim, në bazë të fondeve që do të kemi.

Përsa i përket librit, mendimi im është se në kooperativat bujqësore ka një interesim të përgjithshëm për leximin e tij, prandaj kooperativat bujqësore duhet të caktojnë një fond për blerjen e këtyre librave. Ne nuk duhet të lejojmë që vatrat e kulturës, si në Bërxull, të jenë të papastrat. Përgjegjësi i kësaj vatre nuk interesohet as për librat. Në qoftë se libraria popullore i dërgon atij të mbyllur në pako edhe librin e kontabilitetit, që nuk ka ç'u duhet fshatarëve, përgjegjësi i vatrës së kulturës duhet t'ia kthejë librarisë. Në qoftë se libraria nga qyteti u dërgon vatrës ose shtëpisë së kulturës në fshat libra që nuk u duhen, kjo ndodh se përgjegjësit e këtyre institucioneve nuk marrin nga ndërmarrja e librit ato botime që kërkojnë lexuesit. Ndryshtë puna për të parë filma. Besoj se fshatari ynë nuk është në kundërshtim që t'i shkojë në fshat autokinemaja dhe ai të paguajë për filmin që sheh.

Edhe për riparimet në shkolla mund të ndihmojnë kooperativat bujqësore. Në qoftë se duhet meremetuar shkolla e fshatit ose duhen ndërtuar banka të reja,

natyrisht diçka mund të bëhet edhe me punë vullnetare, po ka edhe gjëra që duhen paguar. Vendimi i Byrosë Politike nuk thotë që nëpër shkolla paskëtaj të mos vihet më dorë nga kooperativat bujqësore. Por nuk është e drejtë që për çdo gjë të paguajë kooperativa. Atëherë ku është puna vullnetare me forcat e anëtarëve të kooperativës? Këta të ftohen e të binden që të bëjnë edhe punë vullnetare. Kjo do të ngrejë lart ndërgjegjen dhe frymën patriotike të tyre. Pra të mos kërkohet që çdo gjë në kooperativa të bëhet me ditë-punë.

Byroja Politike, duke dhënë këto direktiva, ka për qëllim që të mos abuzohet në të ardhurat e fshatarësisë kooperativiste. Them kështu sepse në këtë drejtim janë bërë mjaft abuzime, që rëndojnë në ndarjen e të ardhurave të kooperativave. Kryesia e kooperativës bujqësore duhet të përcaktojë se për cilat do të paguajë vetë kooperativisti, për cilat gjëra duhen mbajtur nga llogaria dhe përfarë do të paguajë kooperativa. Për ato që fshatari do të paguajë vetë, çështja varet nga puna politike që do të bëjë Partia, në mënyrë që ai të kuptojë se filmi, libri etj., janë të nevojshëm për ngrijtjen e nivelit të tij politik e kulturor. Në këtë mënyrë do të jenë të paktë ata fshatarë që nuk do të blejnë libra ose që nuk do të shkojnë të shkojnë një film.

Le të marrim çështjen e festivaleve. Ne dëshirojmë që në fshatrat tonë të zhvillohen vallet, këngët, muzika etj. Por a është e drejtë që në fshat të mblidhen 30-40 elementë që këndojnë ose hedhin valle duke u paguar ditët e punës kooperativa? Jo, kjo nuk është e drejtë. Kooperativa bujqësore mund të konkurrojë me

disa veta në shkallë rrethi dhe këta t'i paguajë, kurse brenda në fshat aktivitetet kulturore e artistike le të zhvillohen me baza vullnetare, jashtë kohës së punës. Pra kooperativa të mos u paguajë ditët e punës këtyre amatorëve, sa herë që këta do të mblidhen në fshat për të bërë prova e për të dhënë shfaqje artistike.

Ndryshe shtrohet çështja e shpenzimeve për punët komunale në fshat, sepse çezma, për shembull, që ndërtohet në kooperativë, u duhet të gjithë kooperativistëve, ajo do t'u shërbejë të tërë fshatarëve, prandaj çimentoja që do të blihet duhet të paguhet nga kooperativa, pra një objekt i tillë është në interesin e përgjithshëm.

Ose të marrim çështjen e rregullimit të rrugës së fshatit. Kjo duhet të bëhet me kontributin vullnetar të fshatarëve, sepse të gjithë do të ecin mbi të. Një punë e tillë gjithashtu nuk duhet të bëhet me pagesë, me gjithëse për ndërtimin e rrugës së fshatit mund të duhen një ose dy muaj punë, bile edhe më tepër. Objekte të tillë të bëhen me punë vullnetare dhe jo me ditë-punë nga kooperativat.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

GRATË DUHET TË FITOJNË E TË RRITIN PERSONALITETIN E TYRE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

22 janar 1963

Problemi i gruas ka një rëndësi të madhe dhe saherë që ta marrim në shqyrtim, nuk do të bëjmë keq. Ne e shohim që kemi suksese në zhvillimin e gruas dhe në pjesëmarrjen e saj në aktivitete të ndryshme, por kemi akoma shumë për të bërë. Duke e parë më realisht këtë problem, vëmë re se organizata e gruas nuk është ndihmuar dhe aktivizuar sa duhet. Partia nuk i ka dhënë akoma ndihmë në mënyrë të organizuar organizatës së gruas, që ajo t'i kryejë detyrat si duhet si organizatë shoqërore masash.

Në përgjithësi unë kam përshtypjen se kur merrët në shqyrtim veprimitaria e organizatës së gruas, ose kur mendohet për të nga komitetet e Partisë të rretheve, interesimi nuk është në atë masë si dhe për

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën me masat e grave në fshat.

organizatën e rinasë. Organizata e rinasë ka një rëndësi shumë të madhe dhe Partia bën mirë që interesohet shumë pér të, megjithëse edhe në drejtim të rinasë ka akoma lëshime, të meta dhe pakujdesi. Interesimi i Partisë pér rininë ka bërë që të kemi rezultate të mira përsa u përket edukimit të rinasë, ndershmërisë së saj, patriotizmit dhe vendosmërisë së saj. Ndërsa pér organizatën e gruas nuk tregohet i njëjtë interesim. Ky është një nënveftësim, është, dashje pa dashje, refleks i mentaliteteve të vjetra, që ekzistojnë akoma edhe te ne ndaj gruas, sido që Partia ka përcaktuar qartë rëndësinë e këtij problemi dhe e di mirë se pa gruan nuk mund të ecet pérpara, se pa pjesëmarrjen e saj fshati nuk mund të pérparojë, ekonomia nuk mund të forcohet, nuk mund të ngrihet politikisht gjysma e popullsisë së vendit. Megjithëse këto Partia i ka të qarta, kur vjen çështja konkretisht pér të ndihmuar organizatën e gruas, në këtë drejtim nuk bëhet sa duhet. Prandaj këtë mungesë interesimi duhet ta kapércejjmë. Por si duhet ta kapércejjmë?

Dihet se Partia, duke filluar që nga lart e gjer në bazë, duhet të zgjidhë shumë probleme që na kanë zënë këmbët, si në zhvillimin e kulturës, në çështjet e prodhimit, në shëndetësi etj. Por të jemi të qartë se pa futur gruan në të gjithë këta sektorë dhe pa e bindur atë në rrugë revolucionare që të marrë pjesë në të gjitha këto fusha, nuk mund të zgjidhen problemet si duhet, nuk mund të ecet pérpara. Ne e kishim shumë drejt që nuk e prishëm organizatën e gruas, bile morën masa pér ta forcuar akoma më shumë. Mirëpo le ta shikojmë se c'është bërë pér këtë çështje nga ana

organizative, sidomos me kuadrin që punon në organizatën e gruas. Nuk janë më të pakta gratë se rinia në numër, gjithashtu nuk është më e vështirë puna e rinisë nga ajo e gruas; bile mua më duket se puna me gruan është shumë më e vështirë sësa me rininë. Rinia i ka shqelmuar mentalitetet e vjetra. Me punën e saj plot vrull, ajo ecën pa druajtje drejt së ardhmes, kurse ka akoma mjaft gra që pengohen nga mbeturinat e feudalizmit dhe të fesë, pengohen nga sundimi i burrit dhe nënvleftësimi që ato u bëjnë vetë rolit dhe forcës së tyre fizike dhe mendore. Gruaja jonë nuk është akoma në atë shkallë që të kuptojë sa rëndësi ka ajo për veten dhe për familjen e saj. Prandaj çështjen e organizatës së gruas Partia duhet ta shohë më nga afër. Mua më duket se nuk është aspak e drejtë që të paraqitet si e vështirë për të gjetur përgjegjëse të gruas për një qytet prej 20 ose 40 mijë banorësh, por kjo vështirësi ndodh nga nënvleftësimi që i bëjnë vetë komitetet e Partisë kësaj çështjeje. Është e pamundur të mos ketë jo një, por shumë gra në qytete, bile dhe në fshatra, që mund ta marrin përsipër drejtimin e organizatës. Janë me qindra e mijëra gra që marrin pjesë në aktivitete politike dhe ekonomike të rëndësishme. Mirëpo në rrethe bëhen propozime që në krye të organizatës të jetë kjo ose ajo shoqe e vjetër. Është e drejtë që të ketë në organizatë edhe aktiviste të vjetra, sepse ato kanë eksperiencë të madhe, por duhet të ketë edhe të reja, edhe gra me kulturë. Në këtë organizatë duhet të vijnë elementë të rinj, me mentalitetin e kohës, që të jenë në gjendje të kuptojnë kërkesat dhe nevojat e masës së grave. Në krye të organizatës së gruas të vihen shoqe

me autoritet dhe, natyrisht, ky autoritet vendoset me punë dhe me zotësi.

Punën me masat e grave nuk duhet t'ia lëmë vetëm organizatës së gruas dhe organizatat e Partisë të mos interesohen sa duhet. Edhe kur janë bërë përparime, si në drejtim të ngritjes së gruas në përgjegjësi, shohim se tani ka tërheqje, puna në këtë drejtim ka rënje. Këtë çështje ta shohim me kujdes nga ana organizative, duke konkretizuar detyrat kryesore të organizatave-bazë të Partisë, të cilat të ndihmojnë shoqet e organizatës së gruas që jo vetëm të kenë iniciativë, por të marrin edhe masa për ecjen përpëra të punës së kësaj organizate. Nga ana e Partisë, nga ana e Komitetit Qendror dhe e drejtorive pranë aparatit të tij, të mendohet për një sërë problemesh, me zgjidhjen e të cilave do t'i jepet një ndihmë e drejtpërdrejtë organizatës së gruas. Kjo organizatë ka disa detyra të veçanta, por ka edhe detyra të përbashkëta me organizatat e tjera.

Gratë që marrin pjesë në prodhim, që janë anëtare të bashkimeve profesionale, anëtare të kooperativave bujqësore, që punojnë në skuadra, brigada etj., jo vetëm që e kuptojnë më mirë rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në punë, interesin e tyre familjar dhe interesin e përgjithshëm, por me to bëhet njëkohësisht edhe një punë edukative politike e organizuar. Prandaj në këtë drejtim, për të pasur rezultate nië të mira, organizata e gruas duhet ndihmuar drejtpërsëdrejti nga Partia.

Organizata e gruas ka për të zgjidhur disa probleme të rëndësishme që na preokupojnë: së pari, është me rëndësi çështja që të rritim te gratë ndjenjën e personalitetit të tyre në shoqëri dhe në familje. Lidhur

me këtë përfshihen të gjitha problemet që kanë të bëjnë me gruan, duke filluar që nga lindja e fëmijëve, mirërritja dhe edukimi i tyre e deri te higjiena, mirëqenia e harmonia në familje. Për zgjidhjen e këtyre problemeve një rol të madh do të luajë gruaja. Të gjitha këto, sidomos problemet shoqërore, organizata e gruas t'i marrë në dorë dhe t'i zhvillojë si duhet e të mos bëjë gjëra formale, si, fjala vjen, konferenca me temë si u krijuar shiu etj. Më duket që kemi hyrë në disa punë shabllone, duke kujtuar se në këtë mënyrë luftojmë fanatizmin e grave. Unë nuk them që të mos bëjmë konferenca me tema të kësaj natyre, por mendoj që tani nuk ka shumë gra që të thonë se shiun na e dha perëndia. Mendoj që me gratë të zhvillohen biseda e mbledhje ku të trajtohen, për shembull, më shumë probleme të higjenës. Nëpërmjet këtyre temave të trajtohen burimet e sëmundjeve, që gruaja të kuptojë se sëmundjet përhapen nga mikrobet, nga papastërtia etj. Natyrisht Partia këto nuk i ka lënë mënjanë, por probleme të tillë të trajtohen jo vetëm në mënyrë shkencore, por mbi një bazë reale, të diferencuar, jo vetëm nga rrethi në rreth, por edhe nga fshati në fshat.

Kur themi që gratë duhet të fitojnë e të rritin personalitetin e tyre, kjo nuk do të thotë që ato të vihen kundër burrave, por do të thotë që çështja të kuptohet drejt, në mënyrë njerëzore, bashkëshortore, shoqërore. Duhet punuar që të zhdukjet ndjenja e inferioritetit të gruas, ndjenja e mungesës së aftësive intelektuale tek ajo. Në këtë drejtim ne kemi shumë shembuj të mirë. T'i thuhet gruas se nuk është e vërtetë, siç flitej për-

para, se ajo është leshgjatë e mëndjeshkurtër. Sa e sa vajza kanë mbaruar sot shkolla të ndryshme dhe punojnë e mendojnë jo më keq nga djemtë! Duke punuar konkretisht ne do të ndihmojmë, pra, që të zhduket ndjenja e inferioritetit në mendjen e grave. Për këtë qëllim të gjenden forma dhe metoda të përshtatshme dhe të trajtohen ato nga organizata në mbledhje e konferenca, që kjo çështje të futet në rrugë të drejtë. Për këtë qëllim duhet të punohet nga Partia dhe nga organizata e gruas që probleme të tilla të trajtohen drejt në mbledhje të përbashkëta të organizatës së Partisë, të gruas dhe të organizatave të tjera shoqërore.

Ne duhet të bëjmë llogari sa shumë punon gruaja në shtëpi dhe në kushtet që ndodhemi të veprojmë që ta ndërrojmë këtë situatë. Por në qoftë se na del që gruaja pasi punon tërë ditën jashtë, punon edhe 8 orë të tjera në shtëpi, domethënë 16 orë punë ditën, për të kjo është një barrë shumë e rëndë. Gjithashtu, nuk mundet që gruaja e fshatit të punojë 8 orë në shtëpi dhe 2 orë të merret me punët e kooperativës. Zgjidhja më e drejtë e problemit është që, duke u sqaruar roli i madh i gruas, dhe ajo të ketë personalitetin e vet, të bindet edhe burri prapanik që të ndihmojë në punët e shtëpisë. Një grua e emancipuar, me personalitet, ka influencë të madhe te burri, prandaj ajo, me zotësinë e saj, të arrijë që burri të marrë pjesë edhe në punët e shtëpisë.

Mendoj se nuk është e vërtetë që të gjithë burrat nuk marrin pjesë dhe nuk ndihmojnë fare në punët e shtëpisë. Problemi është se burrat ndihmojnë pak në punët e shtëpisë. Po ta mësojmë gruan të ketë persona-

litetin e saj në shtëpi, po ta mësojmë atë që t'u ndajë punët të gjithë pjesëtarëve të familjes, që nga fëmijët gjer te burri, ne do ta lehtësojmë gruan nga shumë punë të shtëpisë dhe jetën familjare do ta bëjmë më të kulturuar, burrin do ta futim në një rrugë më të drejtë, që edhe ai të marrë pjesë në punët shtëpiake. Prandaj në këtë drejtim të bëjmë një studim. Këtë ne nuk do ta bëjmë me dekrete, por me punë bindëse, edukative, me agjizacion e propagandë, në mbledhje të burrave dhe të grave; një herë dhe njëqind herë do t'ua themi këto gjëra në radhë të parë anëtarëve të Partisë dhe atyre të rinisë, që ta kuptojnë me të vërtetë rolin e madh që luan gruaja në jetë.

Gruaja ka shumë kokëçarje. Këtë duhet ta kuptojë mirë çdo burrë. Ajo ka çështjen e ekonomisë shtëpiake, ajo ka detyra të vështira si nënë, ka çështjen e lindjes e të rritjes së fëmijëve, gjëra këto që nuk janë të vogla, ajo ka përsipër edukimin e fëmijëve dhe gruaja që është në marrëdhënie pune ka punë edhe jashtë familjes. Duhet t'i bëjmë të ndërgjegjshëm burrat që gruaja është shumë e ngarkuar më punë, prandaj duhet të lehtësohet në familje.

Por si duhet lehtësuar gruaja? Në qytete, në një përqindje të mirë, ka shumë burra që ndihmojnë në punët e shtëpisë, kurse në fshat një gjë e tillë nuk bëhet akoma. Prandaj në këtë drejtim duhet të ndihmohet organizata e gruas nga ana e Partisë, sepse nuk është lehtë që të thyhet mentaliteti i fshatarëve. Në qoftë se në këtë çështje nuk ndihmojnë seriozisht organizatat e Partisë, të jemi të sigurt se nuk do të rritet pjesëmarrja e burrit në punët e shtëpisë. Mendoj se

Partia duhet ta masë punën e saj me atë se në ç' nivel e ka ngritur gruan, sepse ngritja e gruas, edukimi i saj patriotik, ndershmëria e saj, puna e saj për shtimin e prodhimit, luajnë një rol vendimtar për ecjen përpresa të vendit tonë. Te gruaja Partia ka një forcë vendimtare. Partia duhet të punojë vazhdimisht për ngritjen e personalitetit të saj, për shtimin e respektit ndaj saj, ta mësojë gruan që të fitojë zotësinë për racionalizimin dhe organizimin e punës dhe të kohës, pastaj këto cilësi t'i edukojë edhe te pjesëtarët e tjerë të familjes.

Rëndësi ka për gruan edhe puna për edukimin politik të saj në punë e sipër. Kjo do të luajë një rol vendimtar dhe do të ndihmojë shumë për edukimin e grave. Prandaj Partia dhe organizata profesionale jo vetëm t'i nxjerrin gratë për të marrë pjesë në punë, por edhe t'i preqatitin që të marrin pjesë në mënyrë të organizuar, që të marrin përgjegjësi dhe t'i mbajnë ato, bile të shkojnë edhe më përpresa dhe jo të térhiqen. Një gruaje të tillë, që edukohet, punon dhe shkon përpresa, do t'i rritet personaliteti para burrave.

Prandaj organizata e gruas ta përmirësojë programin e vet. Këtë program ajo ta kombinojë me organet përkatëse të shtetit, të cilat kanë edhe shumë mundësi për ta ndihmuar organizatën e gruas. Por të mos harrohen roli i saj edukativ dhe përpjekjet për të zhdukur në mënyrë sistematike të metat që e pengojnë seriozisht ecjen përpresa të gruas.

Më duket se edhe lidhjet e organizatës së gruas me organizatën e rinisë nuk janë të gjalla dhe sistematike, si për stadin aktual, ashtu edhe për të ardhmen. Përveç kontakteve të drejtuesve të rinisë dhe të gruas

në bazë dhe në qendër, mendoj se nuk është keq që, herë pas here, të bëhen në çdo rrëth mbledhje të përbashkëta të komitetit të rinisë, udhëheqjes së organizatës së gruas dhe bashkimeve profesionale për shkëmbim eksperience për çështje të caktuara që kanë lidhje me disa probleme të gruas dhe të të reja. Dhe nga ky shkëmbim eksperience të nxirren disa detyra që mund të dalin për secilën organizatë, të jepet këshfu një ndihmë reciproke për vënien në rrugë të drejtë të këtij problemi. Mua më duket se duhet dhe mund të krijohen disa forma të tilla bashkëpunimi për koordinimin më mirë të veprimtarisë së këtyre organizatave, për ta çuar më përpara punën me gratë dhe me të rejat.

Po këshfu rëndësi kanë edhe lidhjet e vazhdueshme të shoqeve të organizatës së gruas me shokët e bashkimeve profesionale dhe të rinisë, të cilat nuk duhen lënë pas dore. Vetë shoqet drejtuese të grave, sikurse u tha këtu, janë druajtur të venë nëpër ministritë dhe të bisedojnë me shokët përgjegjës për problemet e organizatës. Shihni, pra, edhe te shoqet drejtuese vihet re ndjenja e inferioritetit të gruas! Ato duhet të venë më shumë në drejtoritë e aparatit të Komitetit Qendror për të biseduar se ç'është menduar për problemin e gruas. Të mos interesohesh për problemin e gruas është gabim i madh, por duhet menduar thellë edhe se si të punohet për këtë problem të rëndësishëm.

Në përgjithësi ne mund të themi se organizata e gruas është interesuar për këto probleme dhe ka zhvilluar aktivitete të mira. Për këtë ne i përgëzojmë shoqet e kryesisë së BGSH për punën e tyre. Kur ato kanë

shkuar në bazë për punën e organizatës, me punën e mirë që kanë bërë, kanë krijuar entuziazëm në masat e grave, por ky entuziazëm duhet mbajtur gjallë, prandaj shokët e Partisë në bazë të kenë më tepër kujdes për organizatën e gruas.

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë
nga procesverbali i mbledhjes
së Sekretariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

DUKE REALIZUAR PLANET, NE FORCOJME REPUBLIKËN TONE

*Nga fjala e mbylljes në Plenumin e 9-të
të KQ të PPSH¹*

26 janar 1963

Po u japim fund punimeve të këtij Plenumi mbi çështjet e rëndësishme siç janë plani dhe buxheti. Raporti i Byrosë Politike të Komitetit Qendror mbi detyrat e planit për vitin 1963 ishte i plotë, i qartë dhe mobilizues. Edhe diskutimet e të gjithë shokëve, në të cilat çështjet u shtruan në mënyrë edhe më të detajuar, na armatosën të gjithë për të bërë një punë më të fryshtme gjatë këtij viti.

Plani i vitit 1963 nuk është diçka e re për anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror dhe për të gjithë kuardrot e ekonomisë, të qendrës dhe të bazës, sepse të

1 Plumi i 9-të i KQ të PPSH, që zhvilloi punimet më 25-26 janar 1963, dëgjoi, diskutoi dhe aprovoi raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi plotësimin e planit dhe të buxhetit për vitin 1962 dhe mbi masat për plotësimin e planit dhe të buxhetit për vitin 1963», mbajtur nga shoku Spiro Koleka.

gjithë ju e keni parë atë me kohë, ai është detajuar dhe tani jemi në kohën e lidhjes së kontratave. Tre muaj më parë u bë Plenumi për intensifikimin e bujqësisë ku u analizuan hollësisht çështjet e bujqësisë dhe u caktuan detyrat përkatëse për këtë sektor të rëndësishëm. Prandaj unë nuk do të zgjatem mbi këtë çështje. Vetëm dëshiroj të theksoj disa gjëra.

Me gjithë sukseset që janë arritur në realizimin e planit të vitit 1962, kemi pasur edhe mjaft vështirësi e mungesa të shkaktuara si nga situatat që na kanë krijuar armiqjtë e jashtëm ashtu edhe nga shumë të meta që ne vetë kemi akoma në punë. Sidoqoftë realizimin e planit të vitit të kaluar mund ta konsiderojmë një sukses të madh për Partinë dhe për popullin tonë. Ky, mund të themi, është rezultat i patriotizmit të madh të popullit tonë, i aftësive drejtuese të komunistëve dhe i zotësisë së kuadrove tanë.

Në fushën e importit janë bërë përpjekje të mira dhe u siguruan një sërë materialesh që ndikuan në mënyrë pozitive në realizimin e planit. Edhe në drejtim të eksportit nuk kemi ecur keq. Me vendet revisioniste të Evropës, me përjashtim të BS, shkëmbimet tona tregtare vazhdojnë, dhe kjo natyrisht në saje të korrektesës parimore nga ana jonë, ndonëse ata kanë qenë kurdoherë të gatshëm ta pengonin zhvillimin e ekonomisë sonë.

Këtë vit plani i shtetit tonë është më i ngarkuar, por eksperienca e vjetme do të na shërbejë për një punë më të mirë. Partia dhe populli ynë, të gjithë kuadrot të kenë parasysh ashtu si gjer tani që me vetëmohim edhe më të madh të vazhdojnë luftën për realizi-

min e planeve, për plotësimin e mungesave që kemi dhe për kapërcimin e vështirësive. Këto probleme duhet të jenë në rendin e ditës, të ngrihen me forcë më të madhe nga sa kanë qenë ngritur vitin e kaluar. Duke marrë parasysh qëllimin që ka Partia jonë dhe situatat ndërkombe të që janë krijuar, duhen përpjekje të mëdha dhe sakrifica për të realizuar detyrat që na shtron Partia.

Vitin e kaluar qëllimi i Partisë në realizimin e planit ishte të zhvilloheshin më tej forcat prodhuase në vendin tonë dhe popullit të mos i mungonin as artikujt ushqimorë, as mallrat industriale. Tani ne mund të themi se këtë detyrë e realizuam me sukses. Situata, në kushtet e bllokadës, ka qenë e vështirë, por populli nuk e ka ndierë atë dhe për të ecur akoma më përpara këtë vit duhet të vazhdohet lufta në këtë drejtim.

Luftën dhe përpjekjet tona duhet t'i drejtojmë në radhë të parë në pakësimin e importit. Është e vërtetë që ne e kemi caktuar çdo gjë, se çdo gjë është llogaritur dhe duhet të bëhen të gjitha përpjekjet nga ana e Ministrisë së Tregtisë që t'i sjellim të gjitha ato që janë caktuar. Por kjo nuk përjashton vonesa në sigurimin dhe në sjelljen e tyre në kohë. Një gjë e tillë nuk duhet të pengojë realizimin e planit ose furnizimin e fabrikave me makineri. Por kjo, nga ana tjetër, nuk do të thotë se nuk do të bëjmë edhe ekonomi. Sidoqoftë në çdo rast ne duhet të ekonomizojmë, sepse sa më pak të importojmë, aq më tepër kursime në devizë do të bëjmë. Megjithatë tani për tani ato që janë të domosdoshme duhet t'i importojmë patjetër. Ne duhet të bëjmë gjithashtu të gjitha përpjekjet që të krijojmë në

rezervën shtetërore fonde në devizë ose në materiale, të cilat nuk do të venë dëm kurrë, përkundrazi do të vlejnë si flori për situata të vështira. Për këto çështje ne duhet të mendojmë vazhdimesht. Kur përpinqemi t'i krijojmë shtetit rezerva në devizë ose në materiale të importit dhe deficitare, të kemi parasysh se me këtë mënyrë kemi forcuar pozitat ekonomike dhe të mbrojtjes së shtetit tonë.

Që të mundim të bëjmë sa më shumë ekonomizime dhe të pakësojmë importin, ne duhet të shtojmë përpjekjet për shpikje e racionalizime, të shfrytëzojmë metodat e reja në prodhim etj. Është e vërtetë se një sërë shpikjesh e racionalizimesh janë vënë në zbatim, po disa po zvarriten akoma. Detyra jonë është që të gjitha këto propozime kaq të vlefshme që kanë bërë punonjësit dhe specialistët për të prodhuar e për të zëvendësuar shumë e shumë materiale që importojmë, t'i vëmë sa më shpejt në shfrytëzim. Të gjitha punishet e fabrikat që po ngremë me mjetet tona për prodhimin në seri të shumë mallrave që na duhen, t'i përfundojmë sa më parë sepse ato na mbushin disa boshillëqe që tani na kushtojnë shumë, na kërkojnë devizë dhe për të cilat nuk jemi të sigurt nëse do të na vijnë në kohën e duhur.

Derisa ne i bëjmë këto objekte me lëndën e parë të vendit, me shpikjet e racionalizimet e punonjësve tanë, duhet t'i ndërtojmë mirë dhe shpejt. Pastaj të bëjmë përpjekje që ato të mos i llogaritim me çmimet e importit, por me çmimet e brendshme. Domethënë këto objekte që kemi filluar t'i ndërtojmë me mjetet tona, të përpinqemi t'ua nxjerrim koston më të lirë, për

të plotësuar edhe më mirë nevojat e popullit e të ekonomisë.

Të luftojmë gjithashtu për shtimin e eksportit, sepse ne kemi nevojë të madhe për klering dhe devizë, prandaj të mos e harrojmë edhe këtë detyrë për asnjë minutë. Me Republikën Popullore të Kinës duhet të jemi shumë korrektë, të dërgojmë atje mallra të cilësisë që kërkohet, sipas standardeve të caktuara. Kurse me vendet revisioniste të Evropës Lindore dhe me vendet kapitaliste duhet të tregojmë edhe kujdes se gjemë vështirësi të mëdha në tregtinë me ta. Prandaj nga ana jonë duhen bërë përpjekje që të përmirësojmë cilësinë e të gjitha prodhimeve të eksportit.

Ashtu sikurse është thënë shumë herë dhe u theksua edhe në raportin që iu paraqit këtij Plenumi, në qoftë se ne prodhojmë pa cilësi, atëherë prodhimet tona nuk do t'i shesim dot jashtë, domethënë nuk do të realizojmë kleringun dhe si pasojë nuk do të na vijnë në kohën e duhur edhe materialet e nevojshme që u duhen industrisë dhe bujqësisë sonë. Prandaj, e përsëris, për të siguruar tregje të jashtme, ne duhet të prodhojmë mallra me cilësi sa më të mirë.

Në radhë të parë ne duhet të bëjmë tregti me ato vende ku tregjet tona janë të stabilizuara, por në rast se ato nuk duan të bëjnë tregti me ne, në rast se ato na vënë çmime më të ulëta për mallrat tona ose na paraqitin kushte të rënda, atëherë të gjemë tregje të tjera. Veçse nuk do të lejojmë asnjëherë të na bëjnë presion ekonomik, të na detyrojnë të ulim çmimet dhe të shfrytëzojnë kështu në kurrizin tonë. Që t'i dalim përpara çdo të papriture ne duhet të bëjmë oferta për

mallrat tona edhe në vendet kapitaliste, në radhë të parë për minerale të cilat ngrenë peshë të madhe në eksportin tonë. Sa më me cilësi të mirë të jenë mineralet tona, si kromi, hekuri, bakri, aq më shumë do ta stabilizojmë tregun me cilindo shtet. Prandaj të punojmë seriozisht në këtë drejtim, sepse nga mineralet dhe nga duhani ne kemi të ardhura të mëdha. T'u vëmë shumë rëndësi këtyre produkteve.

Sikundër kemi diskutuar edhe në Byronë Politike, shokët e tregtisë duhet të përpinqen më shumë për t'u gjetur treg mallrave tona. Për këtë qëllim ata të marrin masa për të reklamuar mallrat, pastaj të ndjekin me kujdes çmimet e tyre dhe të manovrojnë, sepse mundet që disa çmime në tregun ndërkombëtar të kenë rënë. Mirëpo ulja e çmimeve për mallrat tona do të thotë që të krijojmë deficite në bilancin e tregtisë dhe që të mos kemi deficite duhet t'i shtojmë prodhimet e t'i nxjerrim ato me cilësi të mirë. Ndryshe në tregtinë tcnë, sidomos me vendet kapitaliste, mund të na ngjasin lëkundje në çmimet.

Për ne janë të gjitha mundësitë që në industri e në miniera jo vetëm ta realizojmë planin, por edhe ta tejkalojmë atë, sepse në këta sektorë ne kemi klasën tonë punëtore heroike, kemi kuadro të zotë e me stazh që drejtojnë e mbi të gjitha kemi Partinë që udhëheq me vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste.

Problem tjetër me rëndësi të madhe për ne është bujqësia. Për këtë nuk do të zgjatem, por them të kemi parasysh se periudha që po kalojmë është një vit jo i zakonshëm, sepse kanë rënë e po bien që prej 4 muajsh e këtej shira të mëdha të shoqëruara me të ftohta të

forta. Me të lashtat nuk arritëm të realizojmë planin, bille dhe një pjesë e mirë e atyre që mbollëm na u dëmtuan nga koha e keqë. Deficitin tonë më të madh ne e kemi te buka. Prandaj duhet të bëjmë përpjekje shumë të mëdha për të mbjellë drithëra buke në pranverë që ta kompensojmë këtë deficit. Puna nuk qëndron vetëm në atë që ta mbjellim misrin, por edhe ta prashitim në rregull, ta ujitim, ta korrim, ta mbledhim e ta futim brenda. Në rast se nuk do të mobilizohemi totalisht për këtë çështje, do të kemi vështirësi dhe këto vështirësi do të na krijohen që tani. Kjo është e natyrshme dhe e kuptueshme. Kërkesat për bukë kanë filluar të shtohen. Shteti do t'i përballojë ato patjetër, në çdo kohë, po çështja është që atë sasi që do të japimi tani ta zëvendësojmë medoemos në kohën e mbjelljes, ndryshtë vështirësitë do të na shtohen. Prandaj të bëjmë të gjitha përpjekjet, të mobilizojmë të gjitha forcat për realizimin e planit të mbjelljeve të pranverës.

Përveç kësaj, të kujdesemi të bëjmë ekonomi në bukë, sepse fshatarët tanë, megjithëse të kooperuar dhe patriotë, prapë ruajnë mentalitetë të vjetra. Fshatarët orientohen edhe nga koha, ata presin gjersa të vijë koha e prodhimit të ri dhe nuk e prekin atë që kanë. Kështu bukën që kanë në shtëpi, megjithëse jo të mjaftueshme, e ruajnë gjer në korrjen e re. Ne shohim se, me gjithë porositë që janë dhënë, përsëri po shkelen urdhrat e rrepta që janë lëshuar, për shembull, në fshatra të Tiranës po hanë grurin e dezinfektuar, ashtu siç ndodhi në Lushnjë. Prandaj në këto çështje kërkohet disiplinë e rreptë, së pari për ruajtjen e shëndetit të popullit, pastaj edhe për ruajtjen e farës, e cila nuk duhet prekur. Në

këto gjëra s'kemi të bëjmë me individë, por me një koooperativë bujqësore, me ekonomi socialiste, ku ka organizatë-bazë partie, asamble dhe kryesi, prandaj atje kur merren vendime ato duhet të zbatohen. Si është c mundur që të hahet fara? Përkundrazi fara duhet ruajtur me kujdes të madh. Po të mos tregohemi të kujdeshëm për ruajtjen e saj, jo vetëm do të na helmohen njerëz, por edhe fara do të na zhduket dhe pastaj nuk do të kemi çfarë të mbjellim. Kështu do të na krijohen deficite të mëdha që nuk duhet t'i lejojmë.

Buka nuk na ka munguar asnjëherë pas Çlirimit; te ne nuk ka pasur krizë për bukë, po tani ky problem del më në pah edhe nga mungesa e disa zarzavateve, sidomos e patateve, e fasuleve që nuk u realizuan sipas planeve. Patatja qysh tani po na mungon dhe ajo është njëloj si buka. Prandaj vitin e ardhshëm të kemi parasysh që jo vetëm të luftojmë me të gjitha forcat për realizimin e planit të drithërave të bukës, duke u bërë atyre sa më mirë shërbimet e duhura, sikurse u theksua në raport dhe siç theksoi në diskutimin e tij shoku Hysni Kapo, por njëkohësisht të mendojmë edhe për zarzavatet, për mishin, qumshtin dhe bimët industriale. Buka do të na ushqejë ne, njerëzit, kurse bimët industriale do të ushqejnë kryesisht industrinë tonë. Prandaj kur themi të luftojmë për pakësimin e importit dhe për shtimin e eksportit, rëndësi të madhe t'u vëmë edhe bimëve industriale, pambukut, duhanit dhe panxharit. Prandaj edhe për këto të luftojmë shumë.

Në plan parashikohet të mbillet këtë vit edhe luledielli. Këtë detyrë ta keni mirë parasysh. Lulediellin nuk e vëmë në plan për «meze», po për të prodhuar

vaj, prandaj duhet të luftojmë ta mbjellim dhe ta prodhojmë. Ne jemi përpjekur prej kohësh për të mbjellë lulledielli, por në fillim rezultatet nuk qenë ato që pritnim. Te kooperativistët tanë ishte kriuar koncepti i dëmshëm se lulledielli nuk bëhet te ne dhe na varfëron tokën. Po atëherë ne farë nuk kishim, plehra kimike gjithashtu, edhe eksperiencë nuk kishim, kurse tani kooperativat do t'i kenë këto. Prandaj të krijojmë një mentalitet të ri për këtë bimë industriale të rëndësi shme dhe shumë të nevojshme, të interesohemi në mënyrë të veçantë për këtë kulturë që të na japë rendiment sa më të madh dhe me prodhimin që do të marrim nga kjo kulturë për çdo hektar, të sigurojmë të ardhura më shumë nga sa marrim kur i mbjellim tokat me misër.

Ndërtimet e reja që do të bëjmë këtë vit dhe në të ardhmen janë të rëndësishme dhe do t'i rritin më tej forcat prodhuese të vendit tonë, ekonominë tonë. Por kini parasysh se këto kërkojnë shumë forca pune. Në plan këto janë parashikuar. Mirëpo shtimi i punëtorëve do të sjellë shtesën e fondit të pagave, pra do të dalin më shumë të holla përjashta dhe për t'i mbuluar ato do të duhen më shumë furnizime. Prandaj në këto situata Byroja Politike dhe Qeveria kanë marrë disa vendime shumë të rëndësishme, të cilat u janë komunikuar të gjitha rretheve. Partia dhe pushteti, ndërtuesit dhe prodhuesit duhet të luftojnë për zbatimin me përpikëri të këtyre vendimeve. Për sigurimin e forcave të punës është e nevojshme që sa të jetë e mundur në qytete të futim sa më shumë gra në punë. Në çdo rrethku bëhen ndërtime të mëdha, në ato punë që mund t'i

bëjnë gratë, të vendosen shoqe qytetare, të cilave t'u sigurojmë edhe disa kushte për rritjen e fëmijëve, si kopshte e çerdhe, dhe burrat të shkojnë në ndërtime e në punë të tjera më të rënda, me qëllim që të hiqen sa më pak forca nga fshati. Tërheqjen e forcave nga fshati ta bëjmë me kriter, ndryshe do të gabonim shumë, sepse edhe veprat që parashikohen në plan do të ndërtohen ngadalë dhe me vështirësi, edhe fshatit do t'i mungojnë forca dhe do të ulet prodhimi bujqësor. Prandaj në këtë çështje duhet bërë shumë kujdes. Parasë gjithash forcat që janë pa punë në qytet duhet të futen në punë në ndërtim dhe kur veprat të ndërtohen, ato të dërgohen edhe në shfrytëzimin e tyre. Prandaj të studiohen me kujdes forcat akoma pa punë në qytet. Por në sektorin e ndërtimeve rol të madh do të luajë edhe organizimi i mirë i punës.

Rëndësi të madhe t'i kushtojmë aktivizimit të grave me punë në prodhim, si në qytet ashtu edhe në fshat. Kujdesi që duhet të tregojë Partia për problemin e gruas duhet të jetë i madh sepse kjo është një çështje me rëndësi të jashtëzakonshme. Kur flitet për gruan, asnë nga ne nuk e nënveftëson këtë problem, po kur vjen puna për ta zbatuar në praktikë vijën e Partisë për këtë çështje, konstatohen dobësi të mëdha. Duhet të jemi të bindur mirë se pa përparimin e gruas nuk mund të ecim përpara. Për këtë problem të kemi parasysht mësimet e Leninit dhe të Stalinit. Nëse gruas në fshat ose në qytet ne i japim rëndësinë e duhur në drejtimin politik, ideologjik, ekonomik etj., atëherë jeta jonë shoqërore do të ecë më shpejt përpara. Duhet punuar në radhë të parë që të ngrihet personaliteti i gruas,

që ajo të jetë në gjendje të punojë, të shprehë pa drujtje mendimet, të ndërtojë, të drejtojë etj. Në rast se nuk interesohemi për gruan, në qoftë se në fshat vazhdojnë të ekzistojnë mbeturinat e vjetra ndaj saj, nëse lejojmë akoma që gruaja të ngarkohet me türkuzë, nëse vazhdohet që gruaja të punojë në arë e në shtëpi dhe disa burra të rrinë e të tundin derën dhe të dredhin mustaqet, pra, nëse nuk i luftojmë të gjitha këto mbeturina shumë të rrezikshme, shoqëria jonë nuk ecën dot shpejt përpara. Është mirë që caktohen shifra që gruaja në kooperativë të bëjë 250 dhe 300 ditë-punë në vit. Mirëpo në qoftë se i cakton këtë normë gruas, atëherë burrit duhet t'i caktosh 400 ditë-punë në vit, sepse gruaja punon edhe në shtëpi. Po të llogaritim orët e punës dhe djersën që harxon gruaja, përveç punëve jashtë shtëpisë edhe në ato brenda shtëpisë, llogaritë do të dalin ndryshe. Jo vetëm nga ana materiale por edhe nga ajo humanitare ka rëndësi të madhe kjo çështje. Në rast se ne do ta ngremë vazhdimisht edhe më tepër personalitetin e gruas në shoqëri e në familje do të shohim sa mirë do të na ecin punët, nuk do të kemi rezistencë në fshat për daljen e gruas në punë. Brenda në familje gruaja luan një rol të madh, ajo, si nikoqire e shtëpisë, ka influencë të madhe te burri, bile edhe tek ata burra që dominojnë mbi gruan, prandaj, po ta ngremë gruan më shumë politikisht e ideologjikisht, po ta rritim rolin dhe personalitetin e saj në shoqëri, do të thyhen mjaft koncepte, sidomos tek ata burra që kanë plot vese dhe janë të prapambetur.

Pastaj ngritja e rolit të gruas në familje e në shoqëri është e lidhur drejtpërdrejt me çështjen e eduki-

mit të rinishë kudo që është kjo, në punë, në shkollë ose në familje. Kur Partia t'i ketë bërë nënët, motrat dhe gratë tona luftëtare të ndërgjegjshme për socializmin, do të kemi edhe një rini me të vërtetë heroike në punë, në shkollë e kudo.

Konstatojmë me keqardhje se në industri, në bujqësi dhe në sektorë të tjera shumë gra janë zbritur nga përgjegjësia. Përse të ndodhë një gjë e tillë? Përse të mos preferohen gratë në punë njëlloj si burrat? Apo pse gruaja për të ripërtërirë jetën duhet të marrë disa muaj leje? Në kohën e shtatzënësisë gruaja harxhon energji. Shteti dhe Partia i kanë parashikuar këto gjëra, gruas i janë siguruar disa të drejta që i takojnë e që i ka merituar. Prandaj atyre punonjësve që drejtojnë në sektorë-të ndryshëm dhe kanë mendime nënëvlefësuese për gruan, duhet t'u hiqet veshi. Këtë parantezë e hap sepse roli i gruas, si në fshat ashtu dhe në qytet, në çështjen e ndërtimit të socializmit është i madh, prandaj të kihet parasysh vazhdimi.

Dëshiroj të flas pak edhe për kursimet që duhet të bëjmë, sidomos këtë vit dhe të mos mendohet aq lehtë që të marrim sa më shumë punëtorë në sektorin e ndërtimitve. Shumë fabrika e vepra të tjera që po ndërtojmë janë fillestare dhe nuk duhet t'i ngarkojmë me shpenzime të kota. Sivjet, që është një vit pregaritor, ka mjaft probleme që duhen zgjidhur, ka gjëra që duhen pregaritur, ka materiale që duhen siguruar, duhen ruajtur e duhen transportuar atje ku duhet etj. Por në të gjitha këto procese duhet punuar me ekonomi, prandaj të ruajmë me shumë kujdes lekun e shtetit, duke pasur parasysh që të gjitha punët pregaritore që do të bëjmë sivjet

për vitin e ardhshëm t'i bëjmë me ekonomi e të mos jemi dorëlëshuar.

Ekonomi të bëjmë kudo, jo vetëm në punët e shtetit, por secili të bëjë edhe në familjen e tij. Kjo është njëkohësisht edhe një detyrë patriotike që qëndron kurdoherë në rendin e ditës. Nuk shtrohet çështja që njeriu të hajë më pak dhe të dobësohet, por në familje të ekonomizohet edhe buka që të mos shkojë dëm asnje copë e vogël, të mësohen fëmijët të mos hedhin asnje kafshatë bukë e jo vetëm ata, por të gjithë në shtëpi. Kjo do të na sjellë shumë gjëra të mira. Shteti do t'i sigurojë të gjitha nevojat për punonjësit, por në rast se kjo gjë kuptohet në mënyrë patriotike, atëherë secili, edhe në shtëpinë e vet, pasi të llogaritë shpenzimet që i duhen për ushqim dhe për nevojat e tjera, disa të holla duhet t'i depozitojë në librezën e kursimit, sepse përvçe që pak nga pak do t'i shtohen për të plotësuar ndonjë nevojë që mund t'i dalë përrpara, këto të holla do t'i përdorë edhe shteti për financimin e ekonomisë, për ndërtimin më shpejt të objekteve të parashikuara në plan, gjë që do të jetë në dobi të përgjithshme. Ka njerëz që porsa marrin rrögën i harxhojnë të tëra të hollat. Ato janë të holla personale që secili mund t'i bëjë si të dojë, po përsë të mos bëjë njeriu ekonomi që do të jetë edhe në të mirën e tij edhe në dobi të shtetit? Të veprohet kështu nga secili s'ka gjë më të mirë. Pra të hollat duhen administruar, në radhë të parë, qysh në familje. Ai që vepron sistematikisht kështu në familje, ai është nikoqir i mirë, korrekt e dorështrënguar edhe në administrimin e fondeve monetare të shtetit, për të cilat kurrë nuk duhet qenë dorëlëshuar. Këtë edukatë

Partia ta futë edhe në ekonominë kooperativiste. Prandaj kushdo nga ne, që i bie puna të vejë në fshat, të bisedojë me fshatarët për ta rregulluar edhe ata më mirë ekonominë shtëpiake.

Në lidhje me evitimin e shpenzimeve të kota Partia ka bërë një luftë të madhe dhe ka pasur rezultate. Në rastet e disa ngjarjeve në familje, si në dasma, lindje, vdekje etj., shpenzimet tani janë ulur shumë. Sidoqoftë dihet se kur dikush do të martojë djalin, fjala vjen, kjo është një ngjarje e gëzueshme për familjen, prandaj ai do të thërrasë disa miq për të gëzuar, por jo të bëhen shpenzime të mëdha. Edhe në fshat Partia të mos mjaf-tohet vetëm duke i luftuar këto gjëra thjesht nga ana fetare, por t'i jepet të kuptojë fshatarit se një regjim i shëndoshë ekonomik në familje, përmirëson jetën e familjes dhe i shërben njëkohësisht edhe çështjes së përgjithshme. Prandaj të bëhet ekonomi kudo dhe këtë t'ua bëjmë edukatë, në radhë të parë, komunistëve dhe patriotëve tanë. Këto janë detyra që do të kërkohen të bëjë secili, në rrugë të drejtë, të cilat, po të realizohen me sukses, do të sjellin fitime të pallogaritshme për gjithë vendin tonë.

Të gjithë punonjësit që punojnë me vegla e makineri, të cilat i sjellim nga jashtë me devizë dhe me vësh-tirësi të mëdha, t'i ruajnë si sytë e ballit, ashtu si shoferi Xhel Jakupi dhe traktoristi Budo Isufi ruajnë ma-kinën dhe traktorin, sepse ato na duhen për të shtuar prodhimet, për transport etj. Makineritë të mbahen kur-doherë pastër dhe të shfrytëzohen në punë me rendi-mënt të plotë. Në qoftë se i shfrytëzojmë kështu, punojmë me kujdes dhe i mbajmë mirë, ato do të kenë

jetë të gjatë. Xhel Jakupi ka bërë gjer tani 400 000 km me makinën e tij, pa revizionim të përgjithshëm, me gjithatë makinën e ka si të re. Këtë shembull të shkëlqyer dhe sa e sa të tjerë si ky t'i bëjmë jetë të dytë në industri, në transport e kudo ku ka makineri.

Veçanërisht makineria që ka Ministria e Ndërtimit duhet të shfrytëzohet në mënyrë racionale për të gjitha nevojat, sidomos për kursimin e fuqisë punëtore në ndërtimin e veprave të mëdha industriale. Anëtarët e Partisë dhe patriotët pa parti, të mendojnë kurdoherë interesin e madh që ka ekonomia e vendit tonë dhe fitimet e mëdha që do të kemi nga zgjatja e jetës së makinërisë.

Çdo gjë varet nga njerëzit, nga kualifikimi i tyre. Për këtë Partia dhe pushteti u kanë hapur kuadrove horizonte dhe mundësi të mëdha që të mësojnë e të perfektionohen. Por duhet të vendoset disiplinë dhe rregull te njerëzit nga ana e Partisë. Shokët drejtues të dikasteve të interesohen më shumë për këtë çështje.

Njerëzit tanë i kemi patriotë, të ngritur politikisht e ideologjikisht. Unë kam bindjen e plotë se planin, sidomos që është i ngarkuar dhe me gjithë vështirësitë që kemi e që do të hasim, do ta realizojmë me sukses, sepse Partia është në unitet të ngushtë me popullin, se ajo i mban mirë në dorë frenat e drejtimit të shtetit dhë të ekonomisë. Politika e Partisë sonë është e drejtë, revolucionare, inkurajuese, e tillë që mobilizon rreth saj të madh e të vogël. Qëllimi i Partisë është që mirëqenia e popullit të rritet çdo vit më shumë se viti që kalon. Masa e Partisë dhe patriotët e kanë të qartë këtë qëllim të Partisë dhe janë mobilizuar tërësisht për ta realizuar atë

në jetë. Vija e Partisë i bën punonjësit e vendit tonë patriotë të flaktë për kapercimin e vështirësive. Partia dhe gjithë populli e kuptojnë se, duke prodhuar më shumë, ne i zhvillojmë më tej forcat tona prodhuese dhe e shikojnë se çdo vit në Shqipëri hyjnë në shfrytëzim fabrika, uzina etj., se çdo vit hidhen themelë për ndërtimin e veprave të reja për zhvillimin e ekonomisë sonë, për t'i dhënë më shumë popullit. Të gjithë e kanë të qartë perspektivën.

Një çështje tjetër që doja të prekja është edhe ajo e forcimit dhe e mbrojtjes së atdheut për të garantuar fitoret e arritura dhe të ardhmen e vendit tonë. Komunistët dhe patriotët shqiptarë e dinë se situatat që po kalojmë janë të tillë që duhet të punojmë edhe më mirë, por ama edhe të marrim masa për mbrojtjen e atdheut. Parulla jonë në këto situata është «në njérën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën». Populli shqiptar, i cili është shquar në luftërat e tij liridashëse kundër armiqve, e kuption shpejt rëndësinë e madhe që ka çështja e mbrojtjes, prandaj në qoftë se kujdo te ne i shpjegohet mirë se atdheu ynë duhet të jetë i fortë përpara çdo rreziku nga armiqtë e shumtë që e rrethojnë, në çdo moment është gati të hidhet në luftë e të sakrifikojë edhe jetën për mbrojtjen e atdheut. Dhe secili e sheh se mbrojtja e atdheut tonë po forcohet, prandaj janë marrë për këtë qëllim të gjitha masat kundrejt çdo rreziku eventual që mund të ndodhë. Rreziqe ka, po kur je i fortë armiku ta ka frikën dhe vendi ynë është me të vërtetë i fortë. Nëse të tjerët do të ndërmarrin aventura, ata me siguri do të dështojnë me turp. Nuk përjashtohet që armiqtë të ndërmarrin ndonjë aventurë, po ne jemi të

bindur se nuk do të fitojnë. Ne mbrojmë atdheun tonë, jemi komunistë e nuk jemi më pak të armatosur se ata dhe kjo nuk është një bindje e kotë. Ne luftuam jo vetëm me Italinë fashiste, por edhe me Gjermaninë naziste që ishte shumë më e fortë e megjithatë fituam.

Pra, populli ynë e kuption fare mirë rëndësinë e mbrojtjes dhe të ruajtjes së të drejtave të tij e të vendit tonë. Prandaj kur sheh se ushtrinë e kemi të fortë, të armatosur dhe të gatshme, kur sheh se ne kemi rezerva në çdo gjë për të përballuar çdo situatë, ai me frymën e optimizmit revolucionar që e karakterizon do të hidhet në çdo aksion që i bën thirrje Partia. Kurse një frymë e tillë revolucionare nuk ekziston në ato vende që kanë regjime fashiste dhe qëllime agresive. Prandaj ne themi se çdo ndërmarrje e tyre do të dështojë.

Duke forcuar mbrojtjen e vendit tonë, duke punuar me forcat e veta për të fuqizuar ekonominë tonë, Partia e Punës dhe Republika Popullore e Shqipërisë, kontribuojnë edhe në mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, dhe të çështjes së çlirimt të popujve të shtypur. Prandaj kontributi që jep Partia jonë në këtë situatë çmohet nga lëvizja komuniste ndërkombëtare, nga të gjithë popujt përparimtarë.

Situata në botë tani është e vështirë dhe këto vështrësi i krijojnë imperialistët, me ata amerikanë në krye. Megjithëkëtë për popujt dhe forcat revolucionare në botë që luftojnë kundër imperializmit situata është e favorshme, kurse për imperialistët dhc revisionistët modernë situata është e disfavorshme.

Është e qartë se imperializmi kërcënnon paqen. Ai

pregatitet për luftë, me qëllim që t'i bëjë varrin komunizmit dhe të vendosë hegemoninë e tij në botë, ta kthejë prapa rrotën e historisë. Me një mijë e një mënyra imperialistët amerikanë po futin në rrjetin e tyre revisionistët kudo që janë dhe në radhë të parë revisionistët hrušovianë, revisionistët jugosllavë, dhe të gjithë ata që i pasojnë këto dy grupe kryesore të revisionizmit modern.

Imperializmi amerikan nuk ka ndërruar as thelbin dhe as qëllimet. Këtë e tregojnë vetë ngjarjet që zhvillohen. Të marrim problemin e çarmatimit. Nuk ka as shenjën më të vogël që të tregojë se imperialistët do të çarmatosen. Përkundrazi gjithçka tregon se ata po armatosen. Kuptohet se këtë e bëjnë për të luftuar kundër popujve, kundër lëvizjes punëtore ndërkombëtare dhe pararojës së saj, partive të wërteta komuniste dhe punëtore. Prandaj teoritë e N. Hrushovit, e këtij renegati të marksizëm-leninizmit, që thotë «të përpinqemi për një botë pa armë e pa luftë», janë antimarksiste. N. Hrušovi është revisionist dhe pikëpamjet e tij mbi çarmatin janë idealiste. Ai nuk flet për realitetin, me gjithëse hiqet sikur është realist. Në të kundërtën, çarmatimi i imperialistëve dhe sidomos i imperialistëve amerikanë, nuk mund të bëhet në rrugën që thotë N. Hrušovi. Me rrugën idealiste, metafizike të N. Hrušovit, imperializmi nuk do të çarmatoset kurrë.

Edhe fjalët plot bujë për ndalimin e provave të armëve atomike janë sa për t'u hedhur hi syve popujve në të gjithë botën. Këtë bën N. Hrušovi dhe këtë duan edhe imperialistët amerikanë. Në politikën e jashtme N. Hrušovi ka pësuar vazhdimesh disfata. Pikërisht

për këto arsyen nga imperializmi amerikan diçka me të cilën të mundë të mbulojë disfatat e tij. Në fakt, çështja e ndalimit të provave të armëve bërthamore nuk ka përfunduar. Dhe tani ne shikojmë në artikullin e sotëm të gazetës «Pravda» se Bashkimi Sovjetik i ka bërë koncesione Kenedit në lidhje me këtë çështje. Kështu koncesioni që Hrushovi u bëri imperialistëve duke pranuar kontrollin ndërkombëtar, do të thotë pranim i spiunëve në tokën e BS, sikurse është shprehur ai përpara për disa vjet me radhë. Këtë kapitullim tani e zbukuron gazeta «Pravda» duke i dhënë ngjyrë tjetër. Ky është një koncesion që iu bë imperialistëve amerikanë, të cilët, sipas tradhtarit N. Hrushov, «duhet të jenë të kënaqur dhe të mos kërkojnë gjë tjetër». Por në fakt imperialistët amerikanë nuk janë të kënaqur as me këtë lëshim, me tri inspektore në vit, ata duan të paktën 10 kontolle dhe kësaj do t'ia arrijnë.

Po vallë mos u dha fund armatimeve dhe ndalimit të provave të armëve bërthamore me këto koncesione që u bën N. Hrushovi imperialistëve amerikanë? Jo! Vija e imperialistëve amerikanë është që të armatosen vazhdimisht, ta rritin sa më shumë potencialin ushtarak.

Me presione, shantazhe dhe me frikën që u ka futur revizionistëve, imperializmi përpinqet t'ia arrijë dalngadalë dhe me takt qëllimit të vjet. Këtë qëllim do ta arrijë pasi revizionistët hrushovianë, këta tradhtarë të çështjes së komunizmit, sipas dëshirës së tyre, të vendosin terrorin e hapët në vendet dhe në partitë e tyre, në mënyrë që popujt dhe komunistët të mos ngrenë dot krye dhe atëherë do t'u bëjnë katërcipërisht.

lëshime imperialistëve. Këtë e themi sepse shikojmë si po rrokullisen ngjarjet brenda një kohe të shkurtër. Ne mendojmë se vetëm lufta e popujve mund t'i detyrojë imperialistët të çarmatosen dhe jo si mendojnë revizionistët.

Por ne konstatojmë se në radhët e imperialistëve ka kontradikta të mëdha. SHBA duan që të gjitha shtetet kapitaliste të Evropës të jenë nën komandën e tyre, domethënë që armët bërthamore të përqendrohen në duart e tyre, që vetëm amerikanët të japid urdhër kur dhe ku të duan. Anglia që është edhe ajo një forcë bërthamore, ra dakord me Kenedin për të marrë raketat amerikane «Polaris». Mirëpo Franca nuk e pranon diktatin amerikan. Dë Goli ruan edhe ai interesat e borgjezisë së madhe franceze, ai do të ketë një forcë atomike të vetën, gjë që nuk u intereson amerikanëve. Franca e ka bombën atomike dhe është duke e zhvilluar atë. Qëndrimet e Dë Golit nuk pajtohen me propozimet e Kenedit dhe gjer tanë nuk mendohet se ai do të bëjë ndonjë kthesë.

Dë Goli kërkon të gjejë mbështetje te Gjermania e Adenauerit. Adenaueri bashkohet me Dë Golin se ka interesat e tij. Kohët e fundit midis Adenauerit dhe Dë Golit u nënshkrua dhe një traktat, ku, përveç të tjerrave, parashikohet që kryeministri i Francës e i Gjermanisë Perëndimore të takohen dy herë në vit, presidentët e republikave dy herë në vit, ministrat e jastëm çdo muaj etj.

Militarizmi gjerman e ndihmon Francën edhe me fonde të mëdha për krijimin e forcës goditëse atomike franceze. Kjo nuk u intereson imperialis-

tëve amerikanë. Nga ana tjetër, Adenaueri akoma nuk do t'ua prishë amerikanëve, për arsyen se interes i tij kryesor është t'u marrë atyre bombën atomike dhe raketën «Polaris», sepse, në qoftë se gjermano-perëndimorët i shtien në dorë këto armë, atëherë ata me siguri, siç e kanë zakon fashistët, kanë për të shkelur të gjitha marrëveshjet që janë nënshkruar për të mos pasur armë të tilla. Por Dë Goli e tha hapur idenë se Franca nuk mund ta pranojë diktatin amerikan në lidhje me përdorimin e bombës atomike. Prandaj Dë Goli lufton të jetë i pavarur.

Kështu ndodhi edhe me çështjen e Gjermanisë dhe të Berlinit, për të cilën Hrushovi është tërhequr. Fjalimi i tij në Kongresin e 6-të të PSB të Gjermanisë s'ishte as mish as peshk. Ai nuk tha asgjë nëse do të nënshkruhet traktati i paqes me Gjermaninë dhe kur do të bëhet «i lirë» dhe «i çmilitarizuar» Berlini Perëndimor. Pra edhe në çështjen gjermane Hrushovi ka punuar dhe punon në interes të imperialistëve, në dëm të socializmit dhe të çështjes së revolucionit.

Të marrim luftën që bëjnë popujt e vendeve të Amerikës Latine, e cila është bërë një vullkan shpërthimesh revolucionare. N. Hrushovi synon ta shuajë lëvizjen revolucionare në këto vende. Të gjithë ata udhëheqës që janë në krye të partive komuniste e punëtore në vendet e Amerikës Latine, N. Hrushovi bën përpjekje të jashtëzakonshme t'i mbajë afër, duke i paguar dhe duke u përpjekur t'i bindë që «të luftojnë» vetëm për bashkekzistencën paqësore. Lufta për bashkekzistencë paqësore në kuptimin që i jep kësaj N. Hrushovi do të tholë t'i dorëzohesh imperializmit,

të mos flasësh fare për revolucion dhe të heqësh dorë prej tij, që punëtorët të mos përpinqen të ngrenë krye kundër kapitalizmit, me një fjalë, po të shprehesh thjesht ideja është kjo: sakën se merr pushkën ti, popull, dhe del në mal, prit sa të bëhet çarmatimi dhe paqja e përgjithshme se atëherë do të marrësh pushtetin me anën e parlamentit! Por në vendet e Amerikës Latine po ndodh e kundërtë. Lëvizja revolucionare në vendet e Amerikës Latine, e udhëhequr nga elementët revolucionarë marksistë-leninistë, ka marrë një hov të madh dhe është në ngritje.

Veprimitaria tradhtare dhe qëndrimet revizioniste të Hrushovit po u sjellin një dëm të madh partive komuniste në Lindjen e Afërme dhe të Mesme e në disa vende afrikane, të cilat janë futur në ilegalitet. Kështu ka ndodhur me Partinë Komuniste të Algjerisë, të Marokut, të Tunizisë, të Egjiptit, të Sirisë, të Libanit, të Irakut, të Jordanisë etj., disa nga udhëheqësit e të cilave janë futur në burg, disa të tjerë shetisin andej e këtej. Atyreve nuk u jepet asnjë e drejtë as për shtyp, as për mbledhje, as për propagandë. Ky është rezultat i vijës së bashkekzistencës paqësore të konceptuar nga N. Hrushovi që i katandisi në një gjendje të tillë këto parti. Udhëheqësit revizionistë të këtyre partive u bënë lakejtë e Hrushovit dhe shkatërruan partitë e tyre pikërisht në këto momente të rëndësishme. Nga njëra anë N. Hrushovi punoi për të përçarë partitë komuniste dhe punëtore të këtyre vendeve, nga ana tjetër borgjezisë në fuqi, xhelatëve të komunistëve, ai u jep ndihma të mëdha ekonomike. Po kështu N. Hrushovi përcau edhe Partinë Komuniste të Indisë. Të gjithë ele-

mentët e vërtetë marksistë në këtë parti tani janë futur nëpër burgje, kurse jashtë ka mbetur ajo pjesë tradhtarësh, me në krye tradhtarin Dange, që është bashkuar haptazi me Nehrunë, dhe ndërkojë N. Hrushovi i jep ndihmë Indisë.

Një nga preokupacionet kryesore të politikës së N. Hrushovit ka qenë bashkimi i tij me grupin e Titos. Sa drejt e ka shtruar Partia jonë këtë çështje. Nuk është nevoja të trajtojmë këtu të gjitha peripecitë që kanë të bëjnë me atrimin Hrushov-Tito, sepse për këtë kemi folur, mjafton të përmendim se Partia jonë i ishte bërë pengesë në këtë drejtim N. Hrushovit. Këtë ky e shprehu haptazi në fjalimin e fundit në Sovjetin Suprem kur ishte edhe Titoja. Në këtë fjalim ai tha se udhëheqësit shqiptarë ishin bërë pengesë për atrimin dhe miqësinë në mes të popullit sovjetik dhe atij jugosllav.

Revizionistët e tjerë janë për taknikën e P. Toliatit që është «më i singertë». Ky tha se «kemi qenë të gabuar» në Mbledhjen e Moskës në lidhje me jugosllavët, qëndrimi që u mbajt ndaj këtyre në këtë mbledhje nuk ka qenë i drejtë. N.Hrushovi nuk dëshiron ta thotë haptazi një gjë të tillë, po është fakt se ai ka punuar me të gjitha mundësitë për rehabilitimin sa më shpejt të klikës së Titos, për futjen e ideologjisë revisioniste në lëvizjen komuniste. Kjo u afirmua me vajtjen, kohët e fundit, të Titos në Moskë dhe në kongresin e PSB të Gjermanisë.

Fjalimi i N.Hrushovit dhe i Titos në Moskë dhe artikujt e «Pravdës» ishin aq shumë të ashpër kundër nesh dhe kundër PK të Kinës, saqë të gjithë menduan,

dhe nuk u gabuam, që tani N. Hrushovi dhe pasuesit e tij e kanë marrë parasysh dhe kanë vendosur të dalin hapur kundër PK të Kinës. Kjo veprimitari u shoqërua me sulme kundër kësaj partie në kongresin e PK të Çekoslovakisë, në atë të Hungarisë dhe të PK të Italisë. Një frymë e tillë përshkoi edhe kongresin e PSB të Gjermanisë që u bë në Berlin.

Në mjaft parti ka lëvizje. Kudo po ngrihet rezistenca e komunistëve, të cilët po punojnë që të organizohen. Në PK të Italisë ka rezistencë nga masa e partisë, rezistencë kjo që shprehet në trakte e në broshura. Janë me qindra letrat që i drejtohen ambasadës sonë nga komunistë të ndryshëm italianë, shumë prej të cilëve kërkojnë materialet tona. Kurse N.Hrushovi ka frikë nga materialet tona si djalli nga temjani dhe i këshillon njerëzit që të mos i lexojnë ato. Po sidomos që të bëjë ai, materialet tona kërkohen e lexohen kudo. E njëjtë gjë ndodh edhe në vende të tjera të Evropës, si në Poloni, në Çekoslovakia, në RD Gjermane etj. Fakte e shembuj të tillë ka shumë.

Politika e dështuar revisioniste e ka detyruar N.Hrushovin të përdorë një taktikë tjetër. Pasi na shau mirë e mirë, tani kërkon të ndërpritet polemika, të mos flasim më kundër njëri-tjetrit dhe t'ia lëmë kohës të vërtetojë kush ka të drejtë dhe kush nuk ka të drejtë. Pastaj të bëhet një mbledhje e partive komuniste, por, sipas arsyetimeve të tij, kjo duhet të pregetitet, prandaj kërkohet kohë për një gjë të tillë, sepse janë vështrimësuar situatat, janë nxehur gjakrat.

Qëllimi i N. Hrushovit dhe i të gjithë miqve të tij ishte që, duke na sulmuar ne, shqiptarët, të na izolonte

nga lëvizja komuniste ndërkombejtare dhe t'i binim në gjunjë e të ndiqnim kursin e tij. Gjersa ne nuk e bëmë këtë ai «na ka përjashtuar» nga lëvizja komuniste botërore.

N.Hrushovi bën të gjitha përpjekjet që të na eliminojë, po këto përpjekje e dobësojnë më shumë pozitën e tij. Këtu nuk shtrohet problemi vetëm për ne, sepse çështja jonë nuk është diçka në vetvete, po është një çështje e marksizëm-leninizmit. Ka me miliona komunistë dhe punonjës në botë që luftojnë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe kundërshtojnë revizionizmin dhe këtë gjë N. Hrushovi e di mirë.

N.Hrushovi në kongresin e fundit të PSB të Gjermanisë körkoi që ne të mbyllim gojën mbi këto çështje. Po si mund të mbylljet goja e një partie, qeverie dhe e një populli në kurriz të të cilëve janë bërë gjithë ato që dimë? Të mbylli shqipërinë do të thotë ta lësh të lirë N.Hrushovin të bëjë punën e tij, të mbajë fjalime si do ai, të bëjë marrëveshje e kompromise me imperialistët nga të katër anët si do ai. Kjo do të thotë që ti si parti ose si shtet të mos e thuash mendimin tënd, vetëm të regjistrosh në gazetë ato që bën ai. Po a mund të jetë marksiste kjo? Sigurisht jo! Marksizëm-leninizmi nuk e pranon një gjë të tillë. Vetëm revizionistët mund të bëjnë atë që do N. Hrushovi. Prandaj kundrejt veprimtarisë revizioniste të grupit të Hrushovit duhet të mbahet qëndrim: ose do t'i përkrahësh qëndrimet dhe pikëpamjet e tij ose do të dalësh kundër tij. Sharje ne nuk përdorim, po veprimitarë antimarksiste, revolucioniste të tij dhc të atyre që e pasojnë kemi të drejtë dhe

duhet ta demaskojmë. Ju e lexuat artikullin që botuam ne kundër tezave të PK të Italisë¹. Udhëheqësit revisionistë të kësaj partie, pasi mësuan përbajtjen e artikullit tonë, thanë se «me shqiptarët nuk mund të bisedohet» e ç'nuk thanë kundër nesh.

N.Hrushovi mundohet të lidhet mirë me grupet revisioniste që janë në fuqi, por me ta ka edhe kontradikta. Ja, për shembull, Gomulka kërkon të mos i bindet edhe aq N.Hrushovit, të jetë më shumë «i parvarur» (sigurisht jo në rrugë marksiste-leniniste). Gomulka është një antimarksist me damkë, por në rrugën e tij revisioniste ai nuk do ta heqin për hunde revisionistët e tjera, por të ecë vetë e krahas tyre. Edhe me udhëheqësit e vendeve të tjera revisioniste N.Hrushovi ka mosmarrëveshje. Këto kundërshtime ata nuk i kanë në çështjet ideologjike, sepse në këtë fushë janë të gjithë revisionistë, por i kanë në taktykën e veprimtarisë së tyre dhe në çështje të interesave të tyre ekonomike të veçanta. Ne jemi të bindur se këto kundërshtime midis tyre do të zmadhohen. Kontradikta ata kanë shumë edhe për arsyet e kushteve të vështira ekonomike në të cilat gjenden.

Po të bëjmë konkluzionin e punës sonë del se forcat revolucionare në botë janë në ngritje, kurse revisionistët janë në situatë të vështirë. Sigurisht ata kanë akoma forca të mëdha ekonomike dhe ushtarake, e përpinqen t'i gënjejnë njerëzit me një propagandë të madhe. Megjithatë forcat e marksizëm-leninizmit janë në ngritje kudo në Evropë, në Amerikën Latine, në

¹ Shih në këtë vëllim, f. 30.

Azi dhe në Afrikë dhe ato do të demaskojnë çdo ditë e më shumë vijën oportuniste, revizioniste, tradhtare të N.Hrushovit.

Partia jonë do të ecë si kurdoherë në rrugë të drejtë pa asnje kompromis në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit, duke qenë e sigurt se ne do të fitojmë. Rruga jonë është e drejtë, prandaj simpatia dhe dashuria për Partinë tonë janë shumë të mëdha nga të gjithë popujt dhe komunistët e botës. Në përsaqësitet tona jashtë shtetit drejtohen njerëz të ndryshëm dhe komunistë që thonë: «Mbahuni, qëndroni, se po t'ju ndodhë ndonjë rrezik do të ngrihen të gjithë në këmbë në mbrojtje të Shqipërisë!». Me këtë ata duan të na thonë se nuk jemi vetëm, se me kauzën tonë janë me miliona.

Kjo ndodh, shokë, se rruga jonë është e drejtë dhe siç kemi vazhduar do të vazhdojmë të ecim dhe do të fitojmë. Për këtë qëllim në radhë të parë të ruajmë mirë Partinë, sepse armiku bën të gjitha përpjekjet që të gjejë ndonjë të çarë midis nesh, prandaj të mos lejojmë asnje të çarë, sado e vogël, por ta ruajmë dhe ta çelikosim gjithmonë unitetin tonë. Mund të ketë në popull dësa njerëz të paqartë, sadopak qofshin, t'i sqarojmë ata, t'i sjellim në rrugë të drejtë patriotike. Unitetin e fortë dhe patriotizmin e lartë në Partinë dhe në popullin tonë nuk i gjen në asnje vend. Uniteti i Partisë sonë me popullin dhe patriotizmi i tij janë të ndërgjegjshëm, prandaj të punojmë që akoma më shumë t'i kalitim. T'i themi popullit ku është rreziku dhe si duhet luftuar e kapërcyer, komunistët të jenë kurdoherë afër popullit, të ndajnë me njëri-

-tjetrin të mirat dhe të këqijat. Një detyrë jona nga më të rëndësishmet është të vëmë të gjitha forcat për realizimin e planeve tona.

Kjo mbledhje e Plenumit të Komitetit Qendror, shokë, le të na shërbejë për forcimin akoma më shumë të unitetit të radhëve të Partisë, për çelikosjen e unitetit të Partisë me popullin, për forcimin e mëtejshëm të atdheut tonë, për realizimin e detyrave të rëndësishme që u shtruan për plotësimin me sukses të planit dhe të buxhetit të këtij viti.

Rroftë Partia!

*Botohet për herë të parë, me
disa shkurttime, sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

ORGANIZATA E PARTISË NË USHTRI DUHET TË JETË NJË BËRTHAMË E ÇELIKTË

*Nga fjala e mbajtur në Durrës në mbledhjen vjetore
të kuadrove të Ushtrisë sonë Popullore*

5 shkurt 1963

Të dashur shokë oficerë,

Dëshiroj t'ju flas vetëm mbi disa gjëra, që nuk janë të panjohura për ju. Unë personalisht, si të gjithë shokët e Komitetit Qendror si edhe gjithë Partia jonë jemi të gëzuar që në ushtrinë tonë kemi kuadro të zotë dhe me eksperiencë të madhe partie dhe ushtarake, të cilën e keni fituar në luftë, në shkolla dhe në stërvitje. Partia dhe Komiteti Qendror jo vetëm janë krenerë me ju, por kanë edhe besimin e plotë se detyrat që ju janë ngarkuar, ashtu siç i keni kryer gjer tanë, do t'i kryeni më së miri edhe në të ardhmen dhe sidomos në rast rreziku për atdheun. Prandaj me këtë rast dëshiroj t'ju përgëzoj për gjithë përparimet e mëdha që janë bërë në Ushtrinë tonë Popullore.

Partia dhe ju, anëtarët e saj në ushtri, duke ndjekur me besnikëri mësimet e marksizëm-leninizmit dhe direktivat e Komitetit Qendror e të Qeverisë si dhe udhë-

zimet e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, e keni modernizuar ushtrinë, nga ana e cilësisë, e keni bërë atë një nga ushtritë më të forta. Ky është një sukses i madh për Partinë tonë.

Përparime ju keni bërë gjithashtu në lidhje me armatimet. Ushtria jonë e ka përmirësuar shumë cilësinë e saj në drejtim të pajisjes me armë të llojeve të ndryshme. Këto armë që ka sot ushtria jonë, janë moderne dhe, në kushtet tona, plotësisht të mjaftueshme për t'u mbrojtur dhe për t'i dhënë çdo armiku goditje për vdekje. Këto armë ushtarakët tanë i përdorin me sukses, sepse nga ana profesionale ata janë ngritur shumë.

Profesioni juaj si ushtarakë nuk është i lehtë, ai nuk mësohet si poezia, po mësohet në shkolla ushtarake të kategorive të ndryshme. Një pjesë e mirë e ushtarakëve tanë kanë mësuar në shkollat e vendit dhe në Akademinë e Lartë Ushtarake që kanë ngritur Partia dhe pushteti popullor.

Dëshiroj të theksoj gjithashtu se kuadrot e ushtrisë sonë nuk janë të tillë që dinë vetëm artin ushtarak, por janë kuadro edhe me një kulturë të gjerë të përgjithshme. Shumica juaj kanë mbaruar shkollat e përgjithshme të vendit tonë. Kultura e përgjithshme nuk është e panevojshme për ushtarakët, bile përkundrazi, ajo është shumë e nevojshme për ta. Ai që ka bërë shkollën e kulturës së përgjithshme ka gjetur lehtësira shumë të mëdha në punën për ngritjen e tij, si ideopolitike, ashtu edhe profesionale.

Partia i ka dhënë një rëndësi të madhe edukimit tuaj, veçanërisht edukimit ideologjik e politik. Kështu që përsa i përket ngritjes suaj ideopolitike është bërë

një punë e madhe dhe tani Partia ka te ju gjeneralë dhe oficerë, nënoficerë dhe ushtarë, njerëz besnikë të çështjes së popullit, të Partisë dhe të marksizëm-leninizmit. Te ju Partia dhe populli kanë njerëz të edukuar me një patriotizëm dhe besnikëri të ndërgjegjshme, me një kuptim sikurse e kërkon marksizëm-leninizmi.

Ju e keni kuptuar drejt rolin e ushtrisë, pikërisht se Partia ka punuar për t'jua bërë të kuptueshme një gjë të tillë. Këtë çështje e ka kuptuar shumë mirë dhe i gjithë populli ynë. Roli i ushtrisë sonë ka qenë, është dhe do të jetë i madh në çdo kohë, ai është i tillë vëçanërisht në këto momente të vështira ndërkombëtare dhe do të jetë i tillë gjersa të fitojë çështja e madhe e komunizmit, gjersa të shkatërrrohet plotësisht imperializmi.

Populli ynë është luftëtar. Vuajtjet e kanë mësuar dhe e kanë detyruar atë t'i mbajë armët kurdoherë gati për mbrojtjen e atdheut, ai ka treguar kurdoherë zotësi dhe heroizëm. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ai hodhi bazat e shëndosha të Ushtrisë së tij Popullore. Prandaj ai e kuption fare qartë, politikisht dhe ideologjikisht, se pa një ushtri të fortë dhe besnike të çështjes së tij dhe të socializmit, të popullit dhe të PPSH, që e udhëheq në rrugën e socializmit dhe të komunizmit, ai nuk mund të rrojë. Këtë populli e ka kuptuar dhe e ka të qartë, prandaj ka bërë, bën dhe do të bëjë sakrifica të mëdha që ushtria e tij të jetë e gatshme dhe e zonja në çdo moment për mbrojtjen e atdheut dhe të Partisë.

Ju vetë, shokë, c kuptioni mirë detyrën që ju kanë vënë Partia dhe populli, domethënë kuptioni rolin e

madh të ushtrisë dhe këtë, sikurse ju thashë, e ka kuptuar edhe vetë populli. Prandaj ai e mbështet me të gjitha forcat vijën e drejtë parimore të Partisë në drejtim të mbajtjes, të edukimit, të forcimit dhe të modernizimit të Ushtrisë sonë Popullore.

Përsa i përket armatimit modern që ka ushtria jone, një pjesë e tij na ka ardhur nga BS. Andej duhej të na vinin edhe armatime të tjera. Po, për fat të keq, atje ka ardhur në fuqi një klikë tradhtarësh me N.Hrushovin në krye. Si pasojë, ju e dini që na u prenë të gjitha armatimet që ishin në marrëveshje dhe që duhet të na jepeshin si vend aleat dhe anëtar i Traktatit të Varshavës. Ato armatime, sovjetikët duhet të na i jepnin jo vetëm sepse ishin në marrëveshje, por edhe se një gjë të tillë e kërkonte internacionalizmi proletar, bashkëpunimi marksist-leninist, vëllazëror midis vendeve socialiste.

Ne kishim prebatit kuadro të aftë që mund të merrnin në duart e tyre armë moderne, të cilat do të përdoreshin jo vetëm për mbrojtjen e atdheut tonë socialist, por edhe të kampit të socializmit. Mirëpo, siç thashë, N.Hrushovi i preu furnizimet në këtë drejtim, megjithatë ne pa armatime nuk jemi. Këto armatime janë në duart tuaja dhe ju e dini se ato janë shumë të mira, ju i keni provuar vetë.

Me këto lloj armësh dhe në këto sasi që disponojmë sot, ushtria jonë është në gjendje t'i bëjë ballë çdo sulmi armik nga çdo anë që të vijë dhe ta asgjësojë atë.

Tani ka rëndësi çështja që këto armë t'i zotërojmë sa më mirë. Kjo është një e vërtetë që e dimë të gjithë. Po ajo nuk duhet kuptuar sikur armët duhet t'i zotë-

rojë vetëm ushtari, përkundrazi, ato duhet t'i zotëroni të gjithë ju, që nga gjeneralët e gjer te ushtarët e thjeshtë, të gjithë, pra, duhet t'i njohin e të dinë t'i përdorin ato nga ana teknike thjesht e njohjes, nga ana teorike e efektit dhe nga ana praktike e përdorimit. Gjithashtu ne duhet jo vetëm të mësojmë që t'i përdom me efikasitet të plotë këto armë, të dimë mirë edhe forcën e tyre shkatërruese, në të tria drejtimet që thashë, por pastaj këto që dimë ne t'ua mësojmë edhe ushtarëve. Atëherë këto armë të fuqishme që na kanë vënë në dorë Partia dhe aleatët tanë, do të dimë t'i përdom patjetër në mënyrë të përsosur.

Kur bëhet luftë, medoemos duhen armët, atje vepron logjika: po më qëllove, edhe unë do të qëlloj që të të vrasi. Mirëpo armët në duart e armiqve tanë nuk e kanë atë efekt që kanë kur janë në duart e njerëzve të popullit, në duart e ushtarëve dhe të oficerëve tanë. Këta janë bij të popullit shqiptar të edukuar nga Partia me ndërgjegje të lartë patriotike dhe me pikëpamje të qarta mbi rëndësinë e çështjes së armës dhe të ushtrisë në luftë.

Rolin vendimtar në luftë e luan kurdoherë njeriu. Përsa u përket armëve, ato, si mjet, do t'i japid mundësi njeriut që me zotësinë, trimërinë, zgjuarsinë dhe forcat e tij të shpirtit, me anën e tyre të mundë armikun. Por kjo nuk do të thotë që ju, ushtarakët, të lini pas dore njohjen dhe përdorimin e mirë të armëve.

Normat dhe rregulloret i kemi nxjerrë duke u bazuar në artin ushtarak stalinian. Këtë duhet të mos e harrojmë. Ne jemi armiq për vdekje të N.Hrushovit, por ushtria jonë është edukuar me artin ushtarak

marksist-leninist të Ushtrisë së Kuqe dhe, plus kësaj, edhe me eksperiencën e madhe shekullore të popullit tonë, veçanërisht të Luftës Nacionalçlirimtare.

Dua të flas diçka në lidhje me teknikën që kemi sot. Teknika jonë më vonë mund të ndryshojë në drejtim të shtimit dhe të perfeksionimit të saj, ashtu sikurse edhe teknika e armikut mund të ndryshojë në këto drejtime. Prandaj Ministria e Mbrojtjes Popullore duhet të jetë kurdoherë në korent të ndryshimeve që ndodhin në armatimin e ushtrive armike dhe të efektit të tyre, meqenëse momentet janë të tilla që duhet t'i dimë këto gjëra. Çështja duhet gjykuar kështu: armikun nuk duhet as ta mbivlerësojmë as ta nënveftësojmë. Kështu duhet ta shohim e ta gjykojmë si duhet edhe teknikën e armikut, realisht, se në bazë të njohurive të taktikës dhe të armëve të tij ne do të përputnjmë edhe mbrojtjen, edhe sulmin tonë. Prandaj të jemi sa më mirë në dijeni të ndryshimeve që bëjnë armiqtë tanë, se kështu do të kemi mundësi të studiojmë dhe të ndërmarrim me shpejtësi kundörmasat e duhura, për t'u bërë ballë atyre si nga ana e cilësisë, ashtu edhe nga ana e sasisë. Këto ndryshime kanë shkaktuar dhe shkaktojnë vazhdimisht korrigjime në drejtim të taktikës dhe të strategjisë së luftës. Por me gjithë ndryshimet që konstatojmë në ndërtimin e taktikës dhe të strategjisë së armiqve, ne shohim që ka edhe çështje që nuk ndryshojnë dhe nuk mund t'i ndryshojnë as armët moderne, as armët atomike, apo ato me hidrogjen, as raketat ndërkontinentale.

Ju të gjithë e dini se faktori kryesor në luftë është njeriu, që luan rolin vendimtar. Edhe në një luf-

të eventuale në të ardhmen këtë rol nuk mund ta luajnë armët atomike, as armët bakteriologjike, ashtu si-kundër nuk e kanë luajtur ato edhe në luftën e kaluar. Fatin e Luftës së Dytë Botërore nuk e vendosi bombardimi i Hiroshimës dhe i Nagasakit. Imperialistët thonë se Japonia u dorëzua për shkak të bombardimit të Hiroshimës dhe të Nagasakit, me armë atomike, por kjo nuk është aspak e vërtetë. Fatin e Luftës së Dytë Botërore e vendosi njeriu. Prandaj edhe në luftën e ardhshme rëndësi kryesore do të kenë faktori njeri, si edhe terreni, sipas të cilit mund të përdoren me shumicë ose me pakicë të tilla armë. Armët atomike janë me të vërtetë të tmerrshme, këtë as që e diskuton njeri. Mirëpo N.Hrushovi, për të mbrojtur pikëpamjet e tij re-vizioniste, dhe duke pasur frikë nga imperialistët, aku-zon PK të Kinës dhe Partinë tonë se gjoja flasin koton dhe nuk e kuptojnë rrezikun e madh që sjell përdorimi i armëve atomike. Të gjithë e dimë këtë rrezik, por dimë edhe një gjë tjetër, që këto armë nuk janë vendimtare për të vendosur fatin e luftës. Armët bërthamore janë shkatërruese, por ato nuk mund t'i shuanë të gjithë njerëzit dhe popujt. Përkundrazi, janë njerëzit ata që më së fundi do të shkatërrojnë edhe armët atomike, edhe ata që duan t'i përdorin ato, imperialistët amerikanë. Në këtë çështje vendimtare ne jemi në kundërshtim të hapët me N. Hrushovin, me këtë zëdhënës të shantazhierëve imperialistë amerikanë, që kërcënojnë botën me armët atomike. N.Hrushovi nuk bën tjetër veç asaj që bëjnë imperialistët, ai është bërë zëdhënës besnik i përhapjes së propagandës imperiale për frikësimin e popujve, për të cilën punojnë

prej kohësh Pentagoni dhe Departamenti Amerikan i Shtetit. Prandaj, me gjithë ndryshimet që mund të ndodhin në strategjinë dhe në taktikën në lidhje me armët e reja që dalin, çështjet vendimtare dhe kryesore të luftës nuk do të ndryshojnë. Për këtë arsyе populli dhe ushtria jonë, artin ushtarak, strategjinë dhe taktikën e vct për t'u mbrojtur nga agresorët eventualë të vendit tonë, e ndërtojnë në mënyrë konkrete, reale dhe në përshtatje me situatën e vendit dhe të popullit tonë, në përputhje me marksizëm-leninizmin.

Dua të theksoj, shokë, se ka rëndësi të madhe që në përgjithësi të njihet arti ushtarak i armikut. Armikun që ke përpara duhet ta njohësh kush është jo vetëm në teori, por edhe në zbatimin praktik të artit të tij ushtarak në fushat e ndryshme të betejave dhe me ndryshimet eventuale të përdorimit të armëve. Këto ju duhet t'i mësoni në mënyrë shkencore dhe jo saprë të kaluar kohën, sepse përgjegjësia e ushtarakeve në momente krize për atdheun është jashtëzakonisht e madhe. Prandaj çdo gjë ju duhet ta mësoni në mënyrë shkencore, të thelluar dhe të nxirrni konkluzione të drejta për të përballuar veprimet luftarake të armikut kundër atdheut dhe popullit tonë.

Rreth e rrötull atdheut tonë ne kemi armiq. Armiku ynë kryesor është imperializmi amerikan, i cili, në një konflikt eventual kundër popullit dhe vendit tonë, mund të ndërhyjë dhe me forcat e tij detare ose desante, me marinë dhe me aviacion. Një gjë e tillë nuk përjashtohet. Prandaj nuk përjashtohet, në radhë të parë, që të bëhen përpjekje për të njohur qëllimet, strategjinë dhe taktikën ushtarake të imperializmit

amerikan, të cilat u diktohen dhe me të cilat edukohen gati të gjitha ushtritë e NATO-s pa përjashtim. Po rreth e rrrotull vendit tonë ne kemi fqinjë që janë aleatë të SHBA-së. Prandaj nga ne duhen njohur edhe ushtritë e tyre, metodat e tyre të luftës, armatimet e tyre etj.

Përsa u përket monarko-fashistëve grekë, dua të theksoj që oficerët tanë të njohin mirë taktikën e ndjekur nga ushtria e tyre gjatë Luftës Italo-Greke, të njohin veçanërisht atë pjesë të luftës që është zhvilluar në territorin tonë. Ushtarët dhe oficerët tanë që komandojnë repartet në Jug të Shqipërisë, këtë eksperiencë ta studiojnë me kujdes, bile të njohin me imtësi malet, grykat dhe gjer hendeget ku janë zhvilluar luftimet, mënyrat e luftës me toga, me kompani ose me divizione etj., si i kanë sulmuar grekët italiannët, me sa trupa e me çfarë mjete etj. Grekët dhe amerikanët mendojnë të stërvitin elementë të ndryshëm gjoja për luftë partizane dhe t'i futin fshchtazi në Shqipëri që të luftojnë, por një gjë të tillë ata nuk do të mund ta bëjnë. Ata bile nuk do të mund të bëjnë dot luftën partizane edhe sikur të vijnë me çeta të mëdha. Sido që të vijnë, ata do të asgjësohen, se në luftën e tyre gjoja partizane ata nuk do të udhëhiqen nga ideale të mëdha të popullit. Përveç kësaj, ata do të kenë përballë tyre një popull të rreptë, armik për vdekje të tyre, ata nuk do të udhëhiqen nga një parti e brumosur me teori përparamtare marksiste-leniniste, nuk do të njohin vendin etj., etj.

Të kemi kurdoherë parasysh që të studiojmë me kujdes dhe të njohim eksperiencat e ushtrive të tjera, që këto të na shërbejnë për të mësuar qëllimet dhe

mënyrat e zbatimit të tyre në territorin tonë kundër popullit tonë dhe për t'i asgjësuar ato. Ne jemi të bindur se, sado të mëdha të jenë në numër ushtritë armike, sado armatime të kenë ato (dhe ne e dimë që kanë më shumë), prapëseprapë ato nuk do të fitojnë dot kundër nesh. Ne nuk jemi të vetmuar. Të jemi të qartë se Shqipëria kurrën e kurrës nuk do të jetë e vetme. Kjo nuk është një frazë e thatë, por një bindje e patundur marksiste-leniniste. Sigurisht, Traktati i Varshavës nuk vlen më për ne, bile tani, gjersa në krye të BS qëndron N.Hrushovi dhe grapi i tij dhe në krye të vendeve të demokracisë popullore janë në fuqi elementë revizionistë që haptazi kanë shpallur dhe kanë predikuar kundërrevolucionin në Shqipëri, gjersa ata u lidhën me revisionistët jugosllavë që tërë jetën kanë komplotuar kundër vendit tonë, Traktati i Varshavës mund të jetë për ne një traktat i dëmshëm, te i cili Partia dhe Qeveria jonë nuk mund të bazohen më.

Atëherë përse nuk e denoncojmë ne Traktatin e Varshavës? N. Hrushovi, për të na luftuar edhe më mirë, atë do; revisionistët kanë bërë një mijë e një gjëra në kundërshtim me Traktatin e Varshavës dhe, me veprimet e tyre ndaj nesh, ata në fakt s'na llogaritin anëtarë të këtij traktati. Por lidhur me këtë çështje Partia dhe Qeveria jonë i kanë zënë të gjitha kyçet; ne nuk do t'u japim atyre armë të na luftojnë, por në të njëjtën kohë ne nuk do të lejojmë që Traktati i Varshavës të shërbejë për të skllavëruar popullin shqiptar, për të rrëzuar pushtetin dhe Partinë tonë. Për ne është më mirë që në këto kushte nuk jemi më në këtë traktat. Por edhe vetëm nuk jemi, sepse pa-

varësisht se ndodhemi shumë larg RP të Kinës, ajo është aleatja jonë besnikë dhe e fortë. Kina është aleate jo vetëm për faktin se na mbështet në luftën kundër revizionizmit, por kryesisht për faktin se me të ne kemi një vijë të përbashkët të drejtë. Si e tillë ajo është një aleate që në rast rreziku do ta mbrojë gjer në fund popullin shqiptar, atdheun tonë, Republikën Popullore të Shqipërisë. Mbrojtjen e vendit tonë nuk e përcakton Traktati i Varshavës, të cilin N.Hrushovi e çori. Veç asaj, duhet kuptuar se nuk është vetëm traktati që na mbron, por kryesisht ideologjia marksiste-leniniste, vëllazërimi dhe qëllimi i përbashkët kundër armiqve të përbashkët. RP e Kinës, sado që është larg, ka një peshë të madhe. Prandaj përsa i përket mbrojtjes sonë, ajo është afër Shqipërisë.

Situatat pa dyshim do të ndryshojnë. Si e qysh s'e dimë, po jo në një ditë. Kryesorja çshtë se sido që të bëhet, sado armë dhe aviacion që të kenë më shumë nga ne agresorët, ata do të thyhen, sepse do të jenë agresorë, fashistë, sepse ata nuk do të luftojnë për një çështje të drejtë dhe nuk do të kenë përkrahjen e popujve, as të popujve të tyre. Populli grek i theu fashistët italianë se këta ishin agresorë, luftonin për një çështje të padrejtë, donin t'u pushtonin vendin, kurse grekët luftonin për një çështje të shenjtë dhe të drejtë, për mbrojtjen e atdheut të tyre dhe prandaj fituan. Kështu do ta pësojnë edhe monarko-fashistët grekë në qoftë se do të sulmojnë vendin tonë, sepse në një rast të tillë ata do të jenë agresorë, çështja e tyre do të jetë e padrejtë. Përse i mundëm fashistët italianë dhe nazistët gjermanë? Se ata ishin agresorë, fashistë, shty-

pës dhe vrasës, kurse populli shqiptar mbronte një çështje të drejtë, lirinë dhe pavarësinë e atdheut dhe udhëhiqeje nga marksizëm-leninizmi. Po ushtria dhe populli ynë tani, pas 20 vjetëve që kanë kaluar nga ajo kohë, kanë dhe avantazhe të tjera, ata tani nuk janë më të varfër dhe pa armë si gjatë Luftës Nacional-çlirimtare, kur ishin të armatosur keq. Ushtria jonë Pcpullore është tani një ushtri moderne, e pajisur me armët më të reja dhe ka pas vetes një popull të zjarrtë që mobilizohet plotësisht për t'i ardhur asaj në ndihmë në çdo rast që ta kërkojë nevoja e mbrojtjes së atdheut. Prandaj kushdo që do të orvatet të sulmojë Shqipërinë, do të jetë i destinuar të thyhet, të humbasë, kurse ne do të fitojmë.

Por, që të fitojmë, ne duhet të perfekcionohemi vazhdimi me artin ushtarak marksist-leninist. Në këtë çështje të kemi parasysh që të mos na largojë vëmendjen nga kjo detyrë kryesore detyra tjetër e madhe — lufta e pamëshirshme dhe e paepur kundër grupit revisionist tradhtar të N.Hrushovit dhe të Titos, iksit dhe ipsilonit deri te Gomulka. Në ushtrinë tonë çdo gjë marksiste-leniniste është e domosdoshme.

Rëndësi të madhe për ne ka eksperiencia e madhe e ushtrisë kineze me karakteristikat e saj. Ajo është një ushtri jo vetëm me potencial të madh njerëzor, po shumë interesante edhe në lidhje me artin e saj ushtarak. Në të ka gjëra që neve na shërbejnë, sidomos eksperiencia e luftës partizane të kësaj ushtrie, si dhe ajo e luftës kundër imperializmit. Në këtë eksperiencë natyrisht ka shumë gjëra, po ne mundet dhe duhet të studiojmë ato që janë të përshtatshme për vendin to-

në. Veçanërisht ne duhet të studiojmë me vëmendje çështjet e luftës, për të cilat ka shkruar shoku Mao Ce Dun, pasi ato janë një ndihmë shumë e madhe për komunistët e çdo vendi. Çështjet e luftës të trajtuar nga shoku Mao Ce Dun i mësojnë të gjithë komunistët, veçanërisht ata të vendeve të paçliruara, ose të porsaqçliruara në luftën e tyre kundër imperializmit dhe kolonializmit të ri. Rëndësi ka që këto vepra dhe eksperienca e madhe e ushtrisë kineze janë në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Partia së shpejti do të ketë në dorë vëllimet e veprave të shokut Mao Ce Dun, ku trajtohen edhe probleme për çështjet ushtarake, prandaj është mirë që shokët e Partisë së së, sidomos oficerët, t'i studiojnë ato me kujdes.

Për ne gjithashtu ka rëndësi edhe eksperienca e luftës së Koresë, për faktin se atje u vërsulën ushtritë imperialiste të 15-16 shteteve dhe e bënë atë poligon për eksperimentimin e të gjitha armëve moderne, përvç armëve atomike. Metoda e luftës së amerikanëve në Kore, taktika dhe strategjia e tyre atje, si edhe takтика dhe strategjia që ushtria koreane dhe kineze vunë përballë imperialistëve në këtë luftë, kanë një rëndësi të madhe studimi. Këtu u shtrua çështja e mbrojtjes me anën e tuneleve nga bombardimet ajrore me napalm, që mund të përdoret nga armiqtë në rast lufte edhe kundër nesh. Kur kemi shkuar me shokun Mehmet më 1956 në Kore, në një muze pamë se si ishin ndërtuar tunelet nën tokë me disa shtresa, sipas kalibrit të bombave që hidheshin nga armiku. Prandaj eksperienca e koreanëve neve duhet të na shërbejë. Kam lexuar se në luftën e Koresë janë bërë shumë ndryshi-

me si në operacionet e amerikanëve ashtu edhe të vetë shokëve kinezë dhe koreanë. Kinezët kanë ndjekur një taktikë tjetër lufte nga ajo që kanë zbatuar në vendin e tyre, e cila u kishte sjellë fitime të mëdha. U detyruan ta bëjnë këtë nga zhvillimi konkret i operationeve të armiqve në Kore dhe kjo i ka ndihmuar të fitojnë. Edhe amerikanët në fillim menduan të bënin në Kore luftë tankesh, por pastaj u detyruan të mos i dërgonin ata atje se nuk kalonin dot. Kjo nuk do të thotë se kundër nesh ata nuk do të përdorin tanket.

Por mbi të gjitha shokët tanë duhet të njojin mirë eksperiencën e Luftës sonë Nacionaçlirimtare. Ne mund të themi se e dimë këtë eksperiencë ngaqë e keni bërë vetë luftën, dhe është e drejtë të themi se ky është thesari më i çmuar për ne, baza e preqatitjes së çdo oficeri dhe të çdo ushtari shqiptar. Por çështja është që këtë t'ua mësojmë sa më mirë të gjithëve, dhe atyre që s'e kanë jetuar këtë luftë. Mbi këtë eksperiencë të përpunuar, të perfekcionuar, bazohet shkenca e re ushtarake e ushtrisë sonë të sotme. Të gjithë shokët që kanë bërë luftën partizane kanë eksperiencë kolosale, prandaj oficerët tanë janë shumë më të zotë dhe më superiorë se oficerët e ushtrive fashiste kundërshtare që mund të sulmojnë vendin tonë. Në të gjitha çështjet parimore të artit luftarak modern të ushtrisë sonë, ne do të gjemë parimet bazë të Luftës Nacionaçlirimtare. Natyrisht këto parime në ushtrinë tonë të sotme janë ngritur në një nivel më të lartë dhe janë perfekcionuar më shumë në përputhje me qëllimet taktike dhe strategjike të një horizonti veprimi më të gjerë ku kërkohet një lidhje organike e

veprimeve të rregullta me armë të një potenciali më të madh nga ato që kishin çetat, batalionet ose brigadat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe me efekt shumë shkatërrues dhe të ndjeshëm për armikun. Në veprimet luftarake me njësi të mëdha, siç shihet në eksperiencën e përditshme, taktika e luftës, ajo e mbrojtjes dhe e mësymjes, e sulmit dhe e kundërsulmit të ushtrisë sonë, sot ka elementë shumë më të përparuar dhe të perfekcionuar se ata të njësiteve partizane. Prapë-serapë kur ne kalojmë në veprimet e reparteve më të vogla, si në batalion, në kompani ose në togë, ne shikojmë qartë, natyrisht edhe këtu të perfekcionuara dhe organikisht të koordinuara me të gjithë operacionin kryesor, parimet e sulmit dhe të kundërsulmit, të mbrojtjes aktive, të befasisë, tipike të njësiteve të ushtrisë partizane, si dhe luftën në rrëthim, daljen nga rrëthimi etj.

Kur themi ta studiojmë mirë eksperiencën e Luftës sonë Nacionalçlirimtare, duhet të kemi parasysh të gjitha çështjet dhe kjo eksperiencë të studiohet nga kuadrot në shkollat tonë. Por këto lidhje dhe këto ndryshime në mes të Luftës Nacionalçlirimtare dhe artit modern të ushtrisë sonë duhet të vazhdohet të studiohen akoma edhe më mirë, më me imtësi nga të gjithë kuadrot dhe ushtarët pa përjashtim, dhe jo vetëm në teori, por edhe në praktikë.

Kur bëhen mësime praktike, ushtarëve nuk u duhet folur në mënyrë të përgjithshme, por t'u flitet konkretisht se këtu, në këtë apo në atë vend, ka luftuar filan kompani e këtij apo e atij batalioni, brigade ose divizioni, t'u thuhet sa armiq morën pjesë në këtë luf-

të, çfarë armësh dhe çfarë taktkike përdorën ata, cilat pozicione kishin zënë forcat tona dhe ç'taktikë u përdor nga ne në këtë luftë gjer në përfundimin e betejës. Oficerët tanë këto beteja duhet t'i hedhin në harta me të dhëna ekzakte për çdo kodër, osc mal, ku janë zhvilluar luftimet e çetave, të batalioneve, të brigadave tona etj., me shënimë se sa ishin tanët dhe sa armiq kishin përballë, ç'taktikë kanë përdorur çetat tona, sa armiq kanë vrarë, si u rrrethua dhe si shpëtoi nga rrithimi çeta jonë etj. Kështu, ushtarët do të mësojnë mbi sukseset dhe të metat e baballarëve të tyre, si luftuan ata për të mbrojtur pëllëmbë për pëllëmbë vendin tonë.

Studimi i eksperiencës së Luftës Nacionalçirimtare me këto të dhëna është i mundshëm, sepse të gjithë i keni jetuar ato. Tani detyra juaj është t'i hidhni ato në letër në mënyrë shkencore. Nga shkrimet e luftës më kanë pëlqyer shumë gjëra, po nuk më kanë pëlqyer aspak disa shkrime të fryra, sepse fryrja e gjerrave nuk është e mirë. Kur ne kemi një histori kaq të pasur e të lavdishme, përsë të mos i themi edhe të metat dhe mossukseset tona? Ne duhet t'i themi edhe këto që njerëzit t'i dinë dhe të mësojnë edhe nga ato. Brezat e ardhshëm, veçanërisht ushtria jonë, të frymëzohen drejt në praktikë dhe në teori nga kjo eksperiençë e madhe e Luftës Nacionalçirimtare, që është në bazë të artit ushtarak modern të ushtrisë së.

Lufta eventuale, shokë, me një ushtri armike dhe me armë moderne do të zhvillohet jo në qzell, por në territorin e atdheut tonë, në këtë tokë ku kanë luftuar

shqiptarët gjatë shekujve. Këtu ku kanë luftuar partizanët tanë, në territorin tonë, ne do të sulmojmë dhe do të mbrohem nga armiqjtë, gjersa t'i shpartallojmë. Ne, pra, do të luftojmë në këtë vend, ku kanë vepruar dhe kanë luftuar çetat partizane dhe njësitet e rregulla e të mëdha të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, eksperiencia e të cilëve është shumë e vlefshme për ushtrinë tonë të sotme. Prandaj, si thashë, në stërvitjet e ushtrisë sonë duhet të zërë një vend të rëndësishëm njohja nga ana e reparteve të ndryshme me terrenin ku ato veprojnë dhe do të veprojnë në kohën kur vendi ynë mund të sulmohet, njohja me taktikën, me operacionet e çetave partizane dhe të njësive të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. E kam fjalën për njohjen me veprimet konkrete, me terrenin ekzakt dhe me të dhëna ekzakte dhe jo të imagjinguara. Prandaj, për një gjë të tillë të bëhet në vend e në mënyrë konkrete kritika e veprimeve të forcave tona dhe të kundërshtarit, gjithashtu po konkretisht e në terrenin ku janë zhvilluar luftimet, të nxirren konkluzionet e drejta dhe të bëhen paralelizmat e duhura me një përlleshje të mundshme në të ardhmen. Një metodë pune e tillë do t'i japë mundësi ushtrisë sonë, kuadrove dhe ushtarrëve tanë të përfitojnë sa më shumë nga eksperiencia e prindërve të tyre, në luftë, nga gabimet e sukseset e tyre, do t'i ndihmojë ata ta njohin terrenin pëllëmbë për pëllëmbë, gjë që ka rëndësi shumë të madhe, sepse, megjithëse territori ynë është i vogël, te kuadrot tanë do të krijohet besimi se ky territor na jep avantazhe të shumta për t'u mbrojtur, për të sulmuar e për të kundërsulmuar, për të ruajtur të gjalla forcat

tona, për të bërë kërdinë mbi armikun dhe më në fund për të korrur fitore.

Dua të theksoj edhe një gjë tjetër. Arti ushtarak modern, gjithë këto dituri dhe shkenca nuk duhet të zhdukin shpirtin revolucionar të njerëzve tanë, karakteristikën kryesore të partizanëve që dinin të dilnin nga çdo situatë, sado e vështirë që të ishte, dhe ta kaptërcenin atë me sukses. Ushtari ynë i tanishëm duhet të edukohet me shpirtin revolucionar të partizanëve. Me një shpirt të tillë, Partia jonë e lavdishme e ka edukuar dhe e ka krijuar këtë ushtri moderne, duke filluar që nga njësitet e çetat e para në Luftën Nacionallçlirimtare. Prandaj t'i ruajmë si gjënë më të shtrenjtë tiparet karakteristike të Luftës Nacionallçlirimtare dhe shpirtin revolucionar të partizanëve, ta forcjmë, ta modernizojmë e ta perfeksionojmë ushtrinë tonë me të dhëna të kohës në baza reale të situatave aktuale.

Unë dua të theksoj në mënyrë të veçantë se njérëzit tanë të forcave të armatosura duhet ta njohin mirë terrenin ku do të veprojnë, jo vetëm në hartë, por kryesisht duke e shkelur terrenin me këmbë, pëllëmbë për pëllëmbë, duke e jetuar e duke e parë atë me syrin e ushtarit të frymëzuar nga një mision kolossal e me përgjegjësi, jo si ëndërrues, por si oficerë, të cilëve Partia u ka ngarkuar detyrën e lartë të shpëtojnë popullin dhe brezat e ardhshëm të tij. Ushtarit dhe oficerit nuk u lejohet të vizitojnë vendin si poetë, por ta shikojnë atë si ushtarë e oficerë, si shkencëtarë, për të njohur çdo qoshe e çdo vrimë të tij. Harta nuk ta ngjall dhe nuk ta rrënjos plotësisht besimin e duhur

te vendi ku do të mbrohesh, ku do të sulmosh e do të kundërsulmosh; besimin e patundur në forcat e tua ta ngjall shumë më mirë shkelja e gjallë e terrenit, toka mëmë. Kur ta shohësh me sy se në këtë apo në atë kodër ka një hendek, një rrëpirë ku mund të luftosh vetë me pesë veta, atëherë bëhesh i fortë si çeliku, të ngjallet besimi në vetvete, ai besim që nuk ta ngjall dot harta, e cila s'ka gjë tjetër vetëm vija. Natyrisht oficerit edhe harta i duhet, por kur vendin e njeh mirë, atëherë çdo gjë e ka shumë të qartë dhe në zemër është i bindur se andej nuk hyn dot armiku, për të mjafton të vërë në qoshe mitralozin dhe të bëjë kërdinë mbi armikun.

Ka shumë rëndësi që ju oficerët dhe ushtarët të zhvilloni së tepërmë kujtesën vizuale. Kjo fitohet me praktikë. Ka shumë njerëz që mbajnë mend me sy, ashtu siç ka edhe njerëz që nuk kanë sy të fortë, por veshin e kanë më të zhvilluar, domethënë njobin me veshë, si një farë Veip Qorri¹ që e kam njobur dikur në Gjirokastër. Kur më ndodhte të kthehesha nga Franca, ky, Veip Qorri, sa më dëgjonte zërin, më fliste menjëherë në emër, le të kishim edhe dy vjet pa u pjekur. Kështu duhet të stërviten edhe ushtarët e oficerët tanë. Por ata duhet të zhvillojnë sa më shumë sidomos kujtesën vizuale, domethënë syri i tyre të jetë si një aparat fotografik, atë që sheh një herë ta fiksojë mirë dhe të mos e harrojë, terrenin ose diçka tjetër që sheh tani t'i gjejë sot dhe mot, jo vetëm ditën por edhe natën, jo vetëm në ditë me diell, po edhe kur ka

1 Kështu quhej Veip Mërkuri, bejtexhi.

mjegull, jo vetëm natën me hënë, por edhe kur ka tu-fan. Po njohe mirë terrenin ai bëhet pastaj i pakapër-çyeshëm nga armiku, po njohe mirë vendin do të dish ku të vendosësh skuadrën, do të dish sa kohë mund të mbrohesh me një mitraloz dhe kur duhet tërhequr. Ne kemi shumë nevojë për një gjë të tillë. Me këto the-sare të mëdha që kemi, ne do t'i bëjmë ballë me sukses çdo armiku. Ne kemi, si terren shumë të përshtatshëm, ashtu edhe njerëz të zotë, të edukuar me ideologjinë më përparimtare, të cilët, duke e njojur mirë këtë ter-ren, do të bëjnë që ne të fitojmë mbi armikun. Duke studiuar me imtësi terrenin, pra, vendi ynë do të bëhet i paprekshëm nga armiqjtë.

Drejtoria Politike sa të jetë e mundur duhet të evi-tojë transferimet e oficerëve nga një vend në tjetrin pa arsyet e shëndosha. Dhe kjo, qoftë për arsyet se dëmton ekonomikisht kuadrot, qoftë edhe, sidomos, për këto që thashë. Kur e lyp nevoja edhe transferime do të bëjmë. Oficeri që është në Korçë mund të vijë edhe në Tiranë. Po një nga arsyet për të mos i lëvizur kuadrot e ushtrisë është edhe ajo që t'u japë atyre sa më shumë kohë dhe mundësi të njojin ter-re-nin në majë të gishtérinjve.

Kur ushtarët çmobilizohen, ata përsëri duhet të gjejnë kohë për ta njojur sa më mirë vendin ku do të jetojnë e do të punojnë. Këtë ata duhet të mos harrojnë ta bëjnë, pra, dhe në jetën civile dhe ta bëjnë me atë sy sikurse e kanë mësuar në ushtri. Prandaj t'u rekomandohet organizatave të rinisë dhe të SHNUM-it që ta bëjnë një gjë të tillë me anën e ekskursioneve, ku të marrin pjesë jo vetëm të rinj, po edhe vajza e

gra. Është mirë që ekskursionet që bëhen për këtë qëllim, të udhëhiqen edhe nga ndonjë oficer topograf i mirë, i cili të gjejë rastin për t'u bërë të njojur ekskursionistëve terrenin edhe nga ana ushtarake, në mënyrë që ata t'i shohin vendet tri të katërtat si poetë dhe një të katërtën si ushtarakë, domethënë nga të dyja anët.

Edhe gratë t'i mësojmë në këtë drejtim. Në ushtrinë tonë ne nuk kemi gra, por në rast rreziku, përveç ushtrisë moderne ne do të kemi edhe reparte partizane. Këtu u tha se në ç'mënyrë duhet t'i koordinojnë veprimet ushtria jonë e rregullt dhe njësitet partizane që do të mbeten në prapavijat e armikut dhe do t'i shkaktojnë atij dëme të mëdha. Njësitet partizane të ardhshme nuk do të jenë si ato që krijuam gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ato ne i filluam nga çetat, dhe arritëm pas një lufte të gjatë gjer në brigada, divizione e korparmata, ndërsa repartet partizane të ardhshme do t'i kemi të organizuara në formacione të pajisura me topa e mitralloza. Kjo do të jetë një ushtri e rregullt e organizuar që do të veprojë në prapavijat e armikut. Por përveç atyre do të ketë edhe reparte territoriale të vetëmbrojtjes, popullin e armatosur. Shumë nga këta njerëz do të jenë gra, të cilat tani nuk janë më të prapambetura e të paditura si në të kaluarën. Po dhe gratë shqiptare të asaj kohe, sido që ishin, porsa u bëri thirrje Partia, rrökën pushkën dhe dolën në mal. Tani, pas gati 20 vjet jete të lirë, gruaja në vendin tonë ka marrë një hov të madh zhvillimi, ajo është ngritur lart nga çdo pikëpamje, ajo është besnikë e atdheut dhe e popullit. Prandaj në qoftë se do të sulmohet at-

dheu, me mijëra do të jenë gratë që do të ngrihen në këmbë, do të hidhen në ushtri e në repartet partizane dhe do të kryejnë ato detyra që kryen brigadat e divisionet tona të Luftës Nacionalçlirimtare. Kështu, në frontin e luftës ne do të kemi ushtrinë tonë të rregullt që do të luftojë për mbrojtjen e vendit, kurse në prapavijat e armikut do të luftojnë repartet partizane edhe vetë në mënyrë të pavarur, por edhe duke koordinuar veprimet e tyre me ushtrinë e rregullt. Prandaj Ministria e Mbrojtjes Popullore të studiojë çështjen që këto reparte partizane të bëhen një mbështetje e fortë e luftës së popullit tonë, edhe me luftë partizane, edhe me veprime të koordinuara me komandën e ushtrisë së rregullt që do të veprojë në front. Kemi 20 vjet që Partia na ka mësuar dhe kemi arritur të ngremë një ushtri moderne me shpirt të lartë luftarak, me ndërgjegje të pastër, të pajisur me armë moderne dhe që udhëhiqet nga qëllime revolucionare, nga ideologjia marksiste-leniniste. Ne kemi një popull të kalitur gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe në luftën për ndërtimin e socializmit, prandaj ai di si të luftojë dhe si të mbrohet. Pra edhe në prapavija, në rast se sulmohemi, do të kemi një tjetër ushtri të organizuar. Në kushte të tillë ne do të bëjmë kërdinë mbi armikun që mund të na sulmojë.

Kuadrot tanë të ushtrisë duhet të pajisen me njo-huritë e domosdoshme ushtarake, po këto duhet të bluhën mirë në kokë, të asimilohen dhe të shërbejnë në punë në çdo kohë, të shërbejnë për zbatimin e drejtë dhe të frytshëm të detyrave, për zbatimin si duhet të rregullave dhe të urdhavrave të Komandës, të Qeverisë

dhe të Komitetit Qendror të PPSH në kohë paqeje dhe në kohë emergjencë¹.

Të kemi kurdoherë parasysh rrezikun e zbatimit shabllon, që rrjedh pikërisht nga mospërvetësimi i plotë i njohurive ushtarake dhe mosthellimi në situatat, të dimë, në rrethana të caktuara, kur duhen zbatuar dhe si duhen zbatuar këto njohuri që keni marrë gjatë 10-15 vjetëve, lidhur me situatat konkrete aktuale dhe me perspektivën. Ato që secili lexon, duhet t'i mësojë thellë, t'i bluajë mirë në kokën e tij, të rrojë me to, në forma dhe në ngjarje të ndryshme. Secili kur mëson duhet të mendojë dhe të pyesë veten: sikur të më ndodhë kështu, çfarë do të bëj? Në rastin e duhur dituria do t'i shërbejë një njeriu të tillë si të veprojë në një situatë të caktuar apo në një tjetër. Kjo është punë e mirë, por megjithatë nuk është e gjitha. Krahas asaj, duhet të ruhem i shumë nga shabllonizmi, sepse mund të kemi mësuar mirë një gjë dhe jemi të vendosur ta zbatojmë, mirëpo situata konkrete, plot të papritura, mund ta hedhë poshtë atë dhe të kërkojë zgjidhje të tjera. Prandaj duhen njohur, për shembull, taktika dhe strategjia e armikut, ato duhen vëzhguar në zhvillim, sepse armiku mund të ndryshojë çdo gjë gjatë veprimeve luftarake, sipas situatave që i paraqiten. Atëherë edhe taktika, edhe strategjia jonë gjithashtu mund dhe duhet të ndryshojnë, ato mund dhe duhet të jenë dinamike, revolucionare, sipas situatave që paraqiten.

Duhet pasur parasysh që në një moment të cak-

¹ Gjendje e rëndë, e jashtëzakonshme.

tuar armiku mund ta ndryshojë taktikën e tij, prandaj edhe ti duhet ta ndryshosh atë, që të evitosh kurthin që të ngre ai. Nëse ti nuk e sheh konkretisht këtë dhe vazhdon me taktikën e vendosur që më parë, nuk ke gjë në vijë. Prandaj duhet përpjekur sa të jetë e mundur të futet armiku në thes, sepse lufta kërkon të ngresh kurthe, të mashtrosh kundërshtarë; gjatë operacioneve duhet vepruar shpejt, sepse situata nuk pret. Prandaj në fushën e betejës, gjatë operacioneve ushtarake, sado të pregetitura me kujdes të jenë ato, mos lejo që armiku të të kapë në metodat shabllone. Gjatë luftës duhet pasur parasysh çdo gjë, edhe rregulloret, edhe normat, edhe disiplina, po edhe evitimi i shabllo-nizmit.

Kuadri oficer, sidomos ata të shtabeve e të komandave kanë një përgjegjësi të madhe në zbatimin e detyrave të tyre. Ata duhet të jenë të pajisur me zgjuarsi e trimëri, zemrën ta kenë nga ana e majtë dhe të jenë gjakftohtë. Trimëria dhe gjakftohtësia për oficerët duhet të shkojnë bashkë. Ai që është trimës i gjakftohtë. Trimëria, gjakftohtësia dhe zgjuarsia duhet të jenë cilësitë që duhet të dallojnë oficerët tanë. Ato duhet të gërs hetohen me zotësinë profesionale, me iniciativën e mençur, me disiplinën e fortë ushtarake, me dashurinë e zjarrtë dhe sjelljet e ngrohta me ushtarët, si edhe me zbatimin gjer në fund të vendimeve të marra. Populli shqiptar i ka të gjitha këto virtute. Por Partia na ka mësuar dhe na mëson që t'i zhvillojmë ato edhe më tej. Prandaj kur themi se duhet trimëri, gjakftohtësi dhe zgjuarsi nga oficerët tanë, që në të vërtetë i kanë këto dhe që përbëjnë një vijë për të

gjithë oficerët, nën oficerët, shtabet dhe ushtarët tanë, themi njëkohësisht se këto cilësi duhet të gërshetohen edhe me zotësinë profesionale dhe me iniciativën e mençur. Po nuk pate iniciativë nuk mund të jesh oficer me disiplinë të fortë ushtarake, me dashuri të zjarrtë dhe me qëndrime të afërta me ushtarët. Oficeri ynë duhet të sillet me ushtarët e tij si babai me djemtë, si vëllai më i madh i tyre. Oficerët tanë në kohë luftë dëshiron që të qëndrojnë në çadra si ushtarët. Nën oficerët dhe ushtarët duhet t'i mësojmë të jetojnë si në kohë rreziku, sepse, që të dalim fitimtarë, në qoftë se na sulmohet atdheu, duhet të jemi të pregetur e të stërvititur për çdo situatë. Partia ju ka udhëzuar kurdoherë ju dhe Ministrinë e Mbrojtjes Popullore që stërvitjet dhe ushtrimet të mos i bëni vetëm në kohë me diell, po edhe në shi, në borë dhe në furtunë. Ta kalitim sa më shumë ushtrinë tonë, se pa një kalitje të tillë nuk do të përballohen vështirësitë. Kështu, pra, nga ana e kulturës fizike t'i kalitim njerëzit, ata të ushtrohen në shi dhe në borë që në rast rreziku të mos na sëmuren, të jenë rezistentë. Edhe me cilësi të tilla t'i pajisim oficerët dhe ushtarët tanë.

Por ato që kanë më shumë rëndësi janë cilësítë shpirtërore, sepse duhet pasur parasysh që lufta që fillon nuk mbaron në një ditë. Sidomos momentet e para të luftës kanë rëndësi vendimtare. Kush nuk humbet toruan në fillim, ai del faqebardhë dhe fitimtar në fund. Në qoftë se humbet toruan në fillim, kur të vijnë breshëritë e goditjeve të para, atëherë lindin rreziqe të mëdha, dhe kjo sidomos kur toruan e humbet udhë-

heqja. Prandaj në luftë kërkohet gjakftohtësi, trimëri dhe njohje e mirë e terrenit. Me qenë sa më afër ushtarëve, me qenë gjakftohtë dhe me zënë pozita që në fillim — kjo duhet. Duke vepruar kështu di si të lufthosh dhe si të mbrohesh, në luftë atdheu duhet të mbrohet pëllëmbë për pëllëmbë.

Armikun duhet ta urrejmë gjer në fund, ta lustojmë dhe ta asgjësojmë pa mëshirë. Por që ta lustojmë, ta dëmtojmë sa më shumë dhe ta mundim, duhet të kemi parasysh që nga njerëzit tanë të na vriten sa më pak, kurse mbi armikun të bëjmë kërdinë. Në nuk i kemi njerëzit pör t'i hedhur në kasaphanë. Edhe Kina që është një vend i madh, me qindra milionë banorë, nuk i dërgon njerëzit e vet në kasaphanë, sikurse propagandon N.Hrushovi me paturpësinë më të madhe. Po kur armiku na sulmon atdheun, duhet ta mbrojmë me sa më pak humbje në njerëz dhe të mos e lejojmë atë të futet lehtë në brendësi të territorit tonë.

Të mësohen ushtarët të futen në llogore e në tuneli kur duhet. Për ç'arsye të luftohet me kapadaillëk në këmbë që të të marrë plumbi në ballë e të mos bësh gjë? Kurse duke u futur në llogore, me gjithë këto mjete moderne që ke në dorë, mund të bësh shumë punë: do të vrasësh qindra armiq. Prandaj udhëzimet për luftën e llogoreve të zbatohen si duhet. Kjo nuk do të thotë të rrimë vazhdimisht në llogore. Duhet ditur se llogore të pazaptueshme nuk ka. Në luftë ka momente të favorshme, kur duhet sulmuar për ta shkatërruar një pozicion të armikut, ka edhe momente kur duhet tërhequr. Prandaj ushtari duhet ta mbajë lopatën në çdo kohë me vete dhe kur qëndron në pozitë

cion, të mos rrijë kot, por të punojë me të për të hapur një vend për mbrojtje dhe pastaj që andej ta godasë armikun. Oficerët tanë kanë përgjegjësi të madhe përzbatimin e këtyre normave.

Një detyrë me rëndësi kolosale për të gjithë ne është të punojmë pareshtur për forcimin e Partisë në ushtri. Partia udhëheq çdo sektor te ne, ajo është zemra që i jep jetë çdo sektori; edhe në organizatën e Partisë në ushtri ne kemi një bërthamë të çeliktë. Ta ruajmë të pastër këtë bërthamë, ta kemi organizativisht të shëndoshë, të ketë në radhët e saj unitet mendimi dhe veprimi, të respektohen normat leniniste në organizatat-bazë, të bëhet kritikë dhe autokritikë me zemër të pastër e me ndërgjegje komuniste, në bazë të rregullave që ka caktuar Komiteti Qendror. Të shtohen radhët e Partisë në ushtri me njerëzit më të mirë. Normat që ka caktuar Komiteti Qendror për pranimet në Parti, në ushtri të respektohen, sepse kjo çështje ka rëndësi. Por, pa e bërë rrugë tejkalimin e normave, njerëzit që japid prova, që janë besnikë dhe të zotë, të palodhur në zbatimin e detyrave që u ngarkohen, që punojnë me vetëmohim për edukimin dhe për forcimin e ushtrisë, të pranohen në Parti. Me të tillë njerëz le të mos kemi frikë se kapërcehen normat, se në këto raste e dimë që në Parti na hyjnë njerëz të shëndoshë. Normat i kemi caktuar se kemi disa konsiderata për prejardhjen e atyre që vijnë në Parti, prandaj duam të rregullojmë përbërjen, sa punëtorë dhe sa nëpunës do të na futen në Parti. Në radhë të parë ne duam të na futen më shumë punëtorë dhe më pak

nëpunës. Numri i këtyre të fundit nuk duhet të ngrihet, po kjo nuk duhet të merret në mënyrë të ngurtë.

Një punë e madhe në ushtri duhet të bëhet edhe për edukimin ideopolitik; çdo gjë te ju duhet të shpjegohet dhe të kuptohet në dritën e marksizëm-leninizmit. Shokët që punojnë në Drejtorenë Politike të ushtrisë dhe në degët politike të reparteve ta zhvillojnë këtë punë me një gjallëri akoma më të madhe, në mënyrë që të kuptohen thellë materialet teorike të Partisë sonë. Thashë se që nga ju oficerët e gjer te ushtarët çdo gjë duhet të kuptohet në prizmin e marksizëm-leninizmit. Kjo gjë ka të bëjë, pra, edhe me çështjen e armëve, se arma nuk duhet parë vetëm nga një anë — si një çështje teknike, vetëm sa për të ditur se ç'largësi arrihet në qitjen e kësaj apo të asaj arme, por duhet parë dhe nga ana tjetër, nga ana e qëllimit të përdorimit të saj, sepse arma ka moralin dhe qëllimin e saj politik dhe ideologjik. Prandaj nga ana e Partisë dhe e Drejtorisë Politike të gjenden forma dhe mënyra që kur ngarkohen oficerët për të shkuar poshtë që të japid shpjegime për armët nga ana teknike, ata të flasin edhe për rëndësinë politike të këtyre armëve, për rolin e tyre kur janë në duart e popullit dhe të Ushtrisë së tij Popullore.

Prandaj puna ideologjike në ushtri të mos zhvillohet në mënyrë shabllone, duke u mbështetur kurdoherë në tekstet e aprovuara. Natyrisht tekstet duhen pasur parasysh, po puna ideologjike duhet bërë më e gjallë, më luftarake, më e lidhur me situatën, me armët, me stërvitjet luftarake që po zhvillohen e me vendin ku zhvillohen ato, me njerëzit etj., në mënyrë që të dalë

i qartë qëllimi i kësaj pune. Prandaj Drejtoria Politike duhet të kujdeset për ta pastruar punën e saj politike dhe ideologjike nga shablonizmi; po kështu shokët e tjerë që punojnë në këtë sektor, zëvendëskomandantët për punën politike të mendojnë që puna e tyre politike dhe ideologjike në reparte të shoqërohet me një vepriktari konkrete të lidhur me çështjet praktike dhe aktuale, të mendojnë qysh më parë çfarë do të shpjegojnë në dritën e marksizëm-leninizmit.

Ushtria te ne duhet të mbahet në korent mbi zhvillimin dhe mbi përparimet e ndërtimit të socializmit në vendin tonë, ajo duhet të rrojë e lidhur dhe jo e shkëputur nga populli dhe nga të gjitha ngjarjet e rëndësishme të jctës së tij. Ushtarët duhet të vihen në dijeni edhe për shiun dhe për borën që bie në vendin tonë, ku bie dhe sa bie. Punëtorët politikë të Partisë në ushtri duhet t'i vënë në dijeni ushtarët mbi të mirat e mbi sukseset, mbi hallet dhe mbi vështirësitë e popullit. Djali nga Tropoja, që e ke ushtar në repartin që komandon, kur sheh që bie shi i madh, mendjen e ka te familja, te nëna dhe babai në Malësinë e Madhe, prandaj, që të jetë i qetë, duhet t'i thuash sa shi ka rënë, ç'masa ka marrë pushteti, çfarë ushqimë e gjëra të tjera ka dërguar shteti etj. Ju duhet të ndërhyni që ushtarëve t'u vijnë letra sa më parë nga familjet e tyre. Vetëm kështu ai do të shikojë te oficerët e tij kujdesin e nënës, të babait, apo të vëllait të madh dhe në kolektivin e repartit — familjen e vet. Puna e Partisë në ushtri është sa delikate aq edhe e domosdoshme, ajo shërben për t'i kalitur njerëzit tanë në çdo drejtim. Në qoftë se Partia në ushtri nuk do të

bëjë një punë të gjallë politike dhe ideologjike me një-rëzit, kjo do ta dobësojë ushtrinë tonë. Prandaj të punohet si duhet për ta kalitur vazhdimisht ushtrinë nëpërmjet një pune ideopolitike sa më të mirë.

Për çështjet e politikës së brendshme nuk do të flas shumë, se jeni në dijeni. Kohët e fundit janë bërë në rrethe aktive për probleme ekonomike, tani do të bëhen edhe konferencat e Partisë. Ju jeni në dijeni se, me gjithë vështirësitë që kemi hasur për shkak të kushteve natyrore dhe të luftës së armiqve, në realizimin e planeve ekonomike ne kemi suksese. Pra punët tona kanë ecur mirë. Shumë sektorë i kanë realizuar dhe tejkaluar planet, populli është furnizuar me çdo gjë. Gjithashtu na është dashur të mendojmë dhe të forcojmë edhe mbrojtjen e vendit, gjë që ju e dini mirë. Kështu janë shtuar shpenzimet për ushtrinë me ushqime, me veshmbathje etj. Përveç këtyre, nga ana e shtetit janë shtuar dhe rezervat, ato kanë qenë dhe janë të domosdoshme për vendin tonë. Dhe populli këto masa i ka pritur mirë, se e di që me këtë mënyrë nuk do të mbetet nesër kurrë keq as për bukë, as për gjë tjetër.

Këtë vit ne na ka dëmtuar shumë koha e keqe. Në bujqësi, përveç dëmeve të tjera, nga shirat nuk arritëm ta realizonim planin e mbjelljes së të lashtave në vjeshtë; në blegtori mund të kemi dështime nga të ftohit. Prandaj gjatë pranverës që vjen ne duhet të bëjmë përpjekje të mëdha për plotësimin e këtyre deficiteve dhe për këtë të gjitha mundësitë i kemi se disponojmë forcën e nevojshme motorike, por mbi të gjitha se kemi Partinë që është mobilizuar mirë për

këtë punë. Kështu me një punë fort të shtrënguar dhe heroike ne mund t'i realizojmë planet në bujqësi. Kurse industria në përgjithësi i ka realizuar mirë detyrat gjatë vitit 1962, kështu ajo do të realizojë mirë edhe detyrat e vitit 1963.

Përsa u përket materialeve që priten të vijnë nga importi, mund të themi se gati të gjitha marrëveshjet janë përfunduar me sukses.

Situata politike dhe ekonomike e vendit tonë, pra, është e kënaqshme. Do të kemi vështirësi, por jemi të bindur se këto, ashtu si i kemi kapërcyer, përsëri do t'i kapërcejmë me sukses. Do të na duhet të bëjmë edhe sakrifica. Sakrifica do t'ju takojë të bëni edhe ju. Ja, për shembull, normat që keni në fuqi mund t'i rishikoni dhe atje ku janë të tepërtta t'i ulni. Mendoni interesin e përgjithshëm të popullit dhe të ardhmen e vendit. Natiqisht, ushtria duhet të mbahet në rregull, të furnizohet me çdo gjë dhe si duhet, por ama atje ku duhen bërë kursime, të bëhen. Ju duhet të kujdeseni që në ushtri të ketë rregull, disiplinë, të mos ketë prishje, shpërdorime, vjedhje. Ku ka të tilla dobësi, veçanërisht në ushtri, të kuptohet se atje punon armiku. Në këto drejtime, pra, ushtria duhet të jetë shumë në rregull. Atje ku ka mundësi të bëhen kursime, të bëhen, pa shkaktuar këto veprime në asnje mënyrë dobësimin e shërbimit. Nganjëherë, ju edhe bujqësinë, edhe ndërtimin t'i ndihmoni në mënyrë të organizuar.

Pastaj shoku Enver Hoxha foli për gjendjen ndërkombëtare. Ai u bëri një analizë të hollësishme mark-siste-leniniste një vargu problemesh të rëndësishme, siç ishin: problemi i çarmatimit, i bashkekzistencës paqë-

sore, i kontradiktave midis vendeve imperialiste etj. Në përfundim shoku Enver Hoxha tha:

Kështu shokë, në përgjithësi perspektiva për ne është e mirë; pozitat e marksistëve në partitë e tjera motra po forcohen çdo ditë e më shumë. Situata për imperialistët dhe shërbëtorët e tyre revizionistë nuk është e favorshme. Lëvizja revolucionare, çlirimtare, paqedashëse antiimperialiste do të vijë vazhdimisht duke u rritur. Ky është ligji dhe kursi i pandalshëm i historisë. Por megjithatë, si kurdoherë, edhe rreziqet ekzistojnë. Prandaj Partisë dhe popullit u vihet detyrë shumë e madhe, mobilizimi i plotë për ndërtimin me sukses të socializmit, këtu, në grykën e ujkut, duke mbajtur si kurdoherë në njëren dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën. Populli ynë u mësua me këtë situatë, kjo iu bë atij një jetë e dytë, prandaj ai është kurdoherë vigjilent e sypatrembur. Vija e drejtë e Partisë bën të çahen malet dhe të realizohen planet, të kapërcehen vështirësitë, ajo na bën të jemi kurdoherë vigjilentë kundër armiqve.

Prandaj në këto drejtime edhe ushtria jonë ka detyra të mëdha. Ju duhet të punoni intensivisht, për të qenë të preqatitur në çdo moment për zbatimin e detrave shumë të rëndësishme që ju ka ngarkuar Partia dhe populli. Në ushtri, si kudo në vendin tonë, të shton edhe më shumë vigjilencia, veçanërisht sekretet ushtarake të ruhen si sytë e ballit, sepse armiku synon shumë të punojë në këtë drejtim që të na lusojë.

Të punojmë që të forcojmë Partinë në ushtri, ta kemi atë të fortë dhe të pastër, të bëjmë që në Parti të ketë kurdoherë unitet të çeliktë ideologjik, politik

e organizativ, ta ruajmë atë si sytë e ballit; Partia në ushtri të jetë kurdoherë e fortë si zemra në trupin e shëndoshë. Vetëm kështu ne do të kemi kurdoherë një ushtri të fortë e të shëndoshë, ashtu siç e kemi dhe tani. Partia jonë ka një unitet monolit dhe është e fortë si çeliku; në saje të këtij faktori ajo i ka thyer armiqjtë e jashtëm dhe të brendshëm, ka fituar dashurinë dhe simpatinë e madhe të popujve dhe të komunistëve të të gjithë botës, dashuri e simpati që vijnë vazhdimit duke u rritur. Ne që jemi anëtarët e saj, me të drejtë jemi krenarë për të, prandaj të bëjmë çdo gjë për ta mbajtur kurdoherë lart e më lart emrin e Partisë sonë për ndërtimin me sukses të socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë, për mbrojtjen e socializmit dhe të lëvizjes komuniste ndërkombe të, për triumfin e marksizëm-leninizmit.

Personalisht dhe në emër të Komitetit Qendror ju uroj suksese të mëtejshme në punën tuaj!

Rroftë Partia jonë heroike!

*Botohet, me shkurtime, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**NGA KONFERENCAT E PARTISË, PËR DHËNIE
LLOGARI E ZGJEDHJE, KOMUNISTËT DALIN
ME FORCA TË REJA PËR TË PUNUAR
EDHE MË MIRË NË TË ARDHMEN**

*Nga fjala në konferencën e Partisë të rrethit
të Lushnjës*

10 shkurt 1963

Jam shumë i gjëzuar që këto ditë ndodhem në Lushnjë dhe po marr pjesë në konferencën tuaj. Unë kisha dëshirë të madhe të asistoja në konferencën e Partisë të rrethit tuaj dhe shokët e Byrosë Politike e pranuan me gjëzim propozimin tim, sepse ajo e vlerëson veçanërisht organizatën e Partisë të rrethit të Lushnjës, për luftën e saj, për përpjekjet, për kompaktësinë dhe për vendosmërinë në zbatimin e vijës së Partisë. Prandaj në emër edhe të shokëve të Byrosë Politike ju uroj nga zemra dhe ju përgëzoj për punën e mirë që ka bërë organizata e Partisë e rrethit të Lushnjës dhe për sukseset që keni arritur në punë!

Konfcrencat e Partisë, sikurse e dini, kanë një rëndësi të madhe në jetën e Partisë, sepse këtu vijnë të deleguarit e organizatave-bazë, bëjnë analizën kri-

tike marksiste-leniniste të punës së tyre, shkëmbejnë eksperiencën e organizatave të tyre, qoftë kjo me karakter politik, ideologjik, organizativ ose ekonomik, për forcimin e organizatës së Partisë, të lidhjeve të tyre me popullin dhe për ndërtimin e ekonomisë socialiste. Në konferencë gjykohet pastaj edhe veprimtaria e udhëheqjes, si në shkallë rrethi, ashtu edhe e organizatave-bazë. Prandaj për të gjithë Partinë dhe kuadrot e saj konferenca është një provim, ata që kanë punuar mirë lavdërohen dhe marrin forca të reja; por forca të reja marrin gjithashtu edhe ata që kritikohen, me këto forca këta luftojnë për të ndrequr të metat dhe për të punuar më mirë në të ardhmen. Kjo është një eksperiencë shumë e mirë e Partisë sonë.

Partia jonë e ruan dhe e zbaton këtë praktikë që na ka dhënë dhe na jep rezultate shumë të mira. Mua më la përshtypje shumë të mira konferenca juaj. Këtë nuk e them për t'ju bërë qejfin, po tani edhe një herë shoh se sa larg jemi nga ato kohë të vështira në vitet e para pas Çlirimt për organizatën e Lushnjës. Të gjithë e dini, veçanërisht shokët e vjetër të organizatës së Partisë të Lushnjës, se në organizatën tuaj ka pasur disa elementë jo të shëndoshë, karrieristë, njerëz pa princip, elementë antiparti, nga qyteti, të cilët në një farë mënyre kishin marrë lustrën e komunistit dhe dolën në organizatën tuaj me pikëpamje të shtrembra. Mirëpo Partia i kritikoi ata, mori edhe masa, u pastrua prej tyre dhe tani mund të themi, e këtë e provojnë edhe faktet, se qysh atëherë e gjer më sot organizata juaj ka shkuar vazhdimisht duke u forcuar çdo vit. Tani ajo është një organizatë e shëndoshë, e fuqishme,

pa sëmundje politike dhe ideologjike, me plot kuadrot e vendosur dhe të ngritur.

Qysh atëherë kanë kaluar shumë vjet; njerëzit e Partisë sonë kanë fituar një eksperiencë shumë të madhe, janë kalitur jashtëzakonisht shumë, jo vetëm duke mësuar nga librat, por kryesisht duke luftuar në praktikë për zbatimin e vijës së drejtë të Partisë. Duhet thënë se njerëzit tanë përvèç Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare kanë bërë edhe luftën e madhe të ndërtimit të socializmit, pavarësisht nga vështirësitë e mëdha e të shumta që u kanë dalë vazhdimisht Partisë dhe vendit tonë. Këto vështirësi e kanë kalitur shumë Partinë, i kanë kalitur kuadrot e saj. Sigurisht, librat, leksionet dhe mësimet që kanë marrë komunistët në për shkollat e Partisë, në kurset e ndryshme e në shkolla profesionale dhe në ato të kulturës së përgjithshme i kanë ngritur kuadrot tanë nga ana politike, ideologjike dhe kulturore. Por e gjithë kjo kulturë është mbrujtur njëkohësisht me një punë të madhe në praktikë, në luftë me vështirësitë e shumta për ngritjen e industrisë, për kolektivizimin e bujqësisë etj., etj., përndërtimin e socializmit në qytet dhe në fshat dhe në këtë drejtim Partia jonë ka një eksperiencë shumë të madhe, që nga lufta me armë, në luftën kundër diverstantëve, në luftën për forcimin e pavarësisë, e lirisë së atdheut, për ndërtimin e socializmit dhe gjer në luftën kundër imperializmit e revizionizmit. Kjo është një eksperiencë jashtëzakonisht e madhe që shfaqet në çdo moment të jetës së Partisë dhe të popullit tonë, në çdo mbledhje organizate-bazë, aktivi dhe konference partie. Gjatë këtyre dy ditëve që ne marrim pjesë në punimet

e konferencës, kam vënë re se të gjithë shokët ndoqën me vëmendje të madhe si raportin e mbajtur këtu, nga shoku Qemal Myrseli, i cili ishte një raport shumë i mirë dhe me përbajtje të lartë, konkret, real, që përfaqëson aktivitetin e gjithë organizatës suaj, raport kritik, që çel edhe perspektiva dhe i shtron detyra gjithë organizatës së Partisë të rrethit tuaj, ashtu edhe diskutimet. Udhëheqja e organizatës së Partisë të rrethit tuaj është një udhëheqje e mirë, e shëndoshë, ajo e ka ndihmuar gjithë organizatën të ecë përpara. Por edhe organizata e ka ndihmuar dhe e ndihmon udhëheqjen e komitetit të Partisë për forcimin e punës së saj, për zhdukjen e të metave dhe të dobësive që ka ose për të tjera që mund të shfaqen në punë e sipër. Thashë se edhe diskutimet që u bënë këtu u dëgjuan me kujdesin më të madh nga të gjithë, sepse përbajtja e tyre ishte e mirë dhe me interes për Partinë. Në diskutime shikohet një vullnet i madh për të ecur përpara për realizimin e planeve, për të forcuar unitetin organizativ, politik dhe ideologjik të Partisë, e lidhur kjo me kritikat kundër të metave dhe dobësive. Një gjë e tillë ka rëndësi të madhe dhe tregon forcën e organizatës së Partisë. Gjatë diskutimeve ka pasur dhe disa përsëritje, por përsëritja në mbledhje të tillë nuk mund të përjashtohet, se çdo komunist që merr fjalën në konferencë do ta thotë pikëpamjen e tij për qëndrimin e Partisë sonë, qoftë në punët tona të brendshme, qoftë në çështjet ndërkombëtare etj. Prandaj nuk përjashtohet që edhe unë, që po flas tani pas jush, të bëj ndonjë përsëritje.

Delegatët që morën pjesë në këtë konferencë du-

ket që janë të interesuar ta njohin mirë gjendjen e rrethit dhe rezultatet në ndërtimin e socializmit dhe kanë dëshirë të përfitojnë nga eksperiencia e shokëve të organizatave të tjera bazë, të ndërmarrjeve dhe të kooperativave bujqësore. Kjo është një çështje që ka rëndësi të madhe, sepse tregon, nga ana tjeter, thjeshtësinë e komunistëve; midis atyre që u thanë mund të ketë gjëra që ju i dini mirë, megjithatë diskutantët ju i dëgjuat me shumë kujdes për të mësuar prej tyre çdo gjë të re.

Një çështje tjeter që më bëri përshtypje të mirë ishte dhe pjesëmarrja e shoqeve në diskutime. Disa prej atyre që diskutuan janë shoqe të reja që punojnë në kooperativat bujqësore ose në sektorë të tjerë të ekonomisë në qytet. Në diskutimet e shoqeve ne shikojmë forcën e madhe të gruas që është zgjuar te ne, pjekurinë e tyre, pavarësisht se ato janë të reja. Nuk është çështja që për të qenë i pjekur duhet të jesh i vjetër në moshë. Natyrisht i vjetri ka një eksperiencë më të madhe, por nuk do të thotë se duke qenë i ri në moshë je i papjekur. Kështu te shoqet tona shihet një vullnet i madh për punë në drejtim të organizimit dhe ky është rezultati i punës së madhe që ka bërë Partia, pa të cilën gruaja jonë do të ishte akoma shumë prapa. Por dua të them gjithashtu se kemi akoma shumë për të bërë në këtë drejtim.

Unë kam edhe disa kritika për t'ju bërë, por mendoj që këto t'i lë për në fund që të mos harrohen; në fillim fola vetëm për përshtypjet e mia të mira për konferencën tuaj.

Si në gjithë vendin tonë edhe në rrethin tuaj bë-

hen përpjekje të mëdha për ndërtimin e socializmit dhe janë arritur suksese. Unë nuk do t'i përmend tani se populli dhe ne bashkë me të, duke luftuar e duke djersitur, i kemi realizuar ato. Problemet e planit u bënë edhe çështje të Plenumit të fundit të Komitetit Qendror mbi punën për realizimin e detyrave që na shtron Partia për vitin 1963.

Ne patëm sukses në realizimin e planit industrial dhe ky është një faktor vendimtar, i cili tregon forcën e madhe të klassës punëtore, disiplinën e saj, ndërgjegjen në punë dhe ngritjen e saj profesionale, ideologjike dhe politike. Klassa jonë punëtore është bërë tani një forcë me të vërtetë e shëndoshë me të cilën Partia jonë ka të drejtë të mburret. Në ndërmarrjet kryesore plani është realizuar, po ne kemi pasur edhe pika të dobëta, kemi pasur edhe mungesa, të cilat nuk janë ndierë për shkak të tejkalimit të planit nga sektorët e tjera. Në vija të përgjithshme plani është realizuar në mënyrë të kënaqshme. Ne nuk e realizuam dot planin vetëm në naftë. Përpjekjet edhe në këtë sektor kanë qenë të mëdha, por, përveç mungesave subjektive, kemi pasur edhe disa vështirësi objektive. Mungesat e ndryshme, mendoj, nuk është nevoja t'i përsëris, se në çdo sektor mund të themi që ka akoma të meta, prandaj nuk duhet shkuar me mendimin se çdo gjë është e përsosur.

Në sektorin e minierave plani është realizuar me sukses. Gjithashtu ai është realizuar edhe në sektorin e artizanatit, sektor ky jo i vogël dhe që ka një rëndësi të madhe për ekonominë popullore, sepse i vjen në ndihmë industrisë. Planet janë realizuar edhe në sek-

torin e arsimit e të kulturës ku ne kemi ecur mjaft përpara, kurse në bujqësi e kemi realizuar më mirë nga viti i kaluar. Megjithatë në këtë sektor në të gjithë Republikën kemi pasur deficite, ashtu siç keni pasur në shumë drejtime edhe ju në rrethin tuaj. Është e vërtetë që në bujqësi na kanë dëmtuar edhe kushtet e vështira atmosferike, por edhe vetë ne kemi pasur mjaft të meta, sepse nuk kemi shfrytëzuar sa duhet mundësitë tona reale, nuk kemi shfrytëzuar rezervat e mëdha të brendshme në sektorin e bujqësisë. Këto na kanë krijuar deficite, që e rëndojnë ekonominë tonë. Megjithatë, me gjithë vështirësitë dhe mungesat në realizimin e planit në bujqësi, gjendja në furnizimin e popullit ka qenë e mirë. Popullit nuk i kanë munguar mishi, zarzavatet, sheqeri, orizi, vaji, gjalpi, makaronat etj. Ky është një sukses i madh sidomos po të marrim parasysh momentet e vështira që kalojmë për shkak të përpjekjeve të mëdha që bën imperializmi amerikan dhe satelitetë e tij për të dëmtuar vendet socialiste dhe lëvizjen komuniste ndërkontinentare. Kjo na detyron ne të mbajmë forcat në këmbë dhe të modernizojmë mbrojtjen. Por vendi ynë ka pasur dhe vështirësi të tjera të mëdha që u janë shtuar të parave, sikurse janë qëndrimet dhe veprimitaria armiqësore e grupit të N. Hrushovit dhe e atyre që e ndjekin atë, që i kanë bërë e i bëjnë vendit tonë një bllokadë të madhe ekonomike, presione politike dhe ideologjike, me qëllim që të vështirësojnë gjendjen në vendin tonë. Por qëllimit revisionistët nuk ia arrijnë dot dhe situata, përkundrazi, tek ata është vështirësuar, ndërsa te ne ajo jo vetëm nuk është keqësuar c as ka mbetur në

vend, por është përmirësuar. Populli dhe Partia janë janë ekonomiqarë dhe administratorë të mirë të pasurisë socialiste, ata e kullandrisin atë në mënyrë që të mos gjendemi në befasi, në rast të ndonjë vështirësie më të madhe, të mos mbetemi me gisht në gojë, sikurse po ndodh në vende të tjera ku në udhëheqje janë revizionistët. Popullit i është dhënë çdo gjë, është kënaqur dhe në qoftë se diku ka pasur ndonjë vështirësi në furnizim, kjo ka ndodhur nga mosorganizimi i mirë i shpërndarjes dhe i shitjes.

Gjatë kësaj kohe që na u krijuan këto vështirësi të mëdha ne nuk mund ta ngrinim dot më tej nivelin e parashikuar, sepse kemi qenë të detyruar të merrnim masa për forcimin e mbrojtjes së vendit. Pastaj, duke marrë parasysh situatën si zhvillohet, kemi marrë gjithashtu masa për shtimin e rezervave shtetërore. Tani në këto momente të tjerët kanë krizë, kurse për ne situatat janë vërtet të vështira, por kemi siguruar rezerva të mjaftueshme ushqimesh dhe materialesh të të gjitha llojeve edhe për ditë të mira, edhe për ditë të këqija.

Të jemi të qartë se plani i vitit 1963 është mjaft i ngarkuar, por janë peshuar të gjitha mundësitë që ai të realizohet. Ky plan, siç u tha edhe në raport, edhe për rrethin tuaj është i ngarkuar për arsyen e bujqësisë. Gjendja e bujqësisë këtë vit është vështirësuar se qysh nga tetori dhe gjer tani klima ka qenë në disfavorintonë. Veç kësaj, që në vjeshtë ne kemi pasur deficite në mbjellje, sidomos në grurë dhe këto deficite duhet t'i plotësojmë në pranverë, duke i mbjellë me misër tokat që s'u mbollën me të lashta; edhe për të mbjellat

që na i prishi shiu, tani që vjen pranvera u vihen detyra të mëdha shokëve kooperativistë, traktoristë dhe në radhë të parë organizatës së Partisë. Po nuk qe Partia në ballë për të shfrytëzuar momentet e përshtatshme qysh tani, duke nisur nga puna për hapjen e vijave kulluese e gjer në të gjitha punimet e tjera, që do t'u japid mundësi mjeteve mekanike dhe kafshëve të punës për t'u futur në ara, do të kemi vështirësi për më vonë. Prandaj gjendja nuk na lejon të humbasim asnjë minutë, ne duhet medoemos të realizojmë jo vetëm planin e mbjelljeve të pranverës, por të plotësojmë edhe deficitet e vjeshtës.

Edhe në sektorët e tjërë plani si Republikë është i ngjeshur, por plotësisht i realizueshëm dhe kjo nuk na frikëson. Ne nuk kemi frikë për asgjë, jo vctëm në lidhje me realizimin e planit në sektorin e industriës, por as për ndërtimet, sido që në këtë sektor shifrat janë më të mëdha se vjet. Duhet të luftojmë të metat në organizimin e punës së këtij viti dhe të tre-gohemi shumë të kujdeshëm për të qenë të gatshëm vitin e ardhshëm kur të fillojmë nga ndërtimi i veprave të reja të mëdha që do t'i bëjmë me ndihmën e Republikës Popullore të Kinës. Për objektet e rëndësishme që do të ndërtohen këtë pesëvjeçar, ju keni një farë ideje, po ide më të plotë do të ketë secili kur të kenë mbaruar këto vepra. Mund të themi se këto objekte, që do të ndërtohen gjatë këtyre tre vjetëve të fundit, kanë një rëndësi të madhe për ne, ato do ta fuqizojnë shumë industrinë tonë, do t'i sigurojnë ekonomisë së vendit tonë të ardhura të mëdha, me një fjalë do të ndihmojnë që të përmirësohetjeta e popullit.

Këtë vit në të katër anët e Shqipërisë filluan ndërtime të reja, si në Elbasan, Berat, Gjirokastër, Shkodër etj., prandaj në fushën e ndërtimeve viti 1963 do të jetë një vit i madh pune. E kam fjalën për objektet më të mëdha, se për të tjerat, siç janë ndërtimi i fabrikave të ndryshme të zakonshme, i veprave të bonifikimit, i rrugëve, i banesave etj., nuk do të kemi vështirësi. Për objektet e mëdha të pesëvjeçarit viti 1963 është një vit preagatitor, viti i organizimit dhe i marrjes së masave për të ecur përpara në dy vjetët e fundit të pesëvjeçarit. Dhe ne do të bëjmë ç'të jetë e mundur që t'i ndërtojmë objektet e parashikuara, me punë, me organizim dhe me mobilizim të gjithanshëm. Prandaj ta organizojmë mirë punën, se me të vërtetë detyrat që ne kemi marrë përsipër për këta tre vjet janë të rënda por duhet t'i kryejmë ato patjetër. Ta marrim me përgjegjësi të madhe këtë çështje jo vetëm për t'u treguar të tjerëve çfarë jemi në gjendje të bëjmë ne, por kryesisht për t'i ndërtuar këto vepra të mëdha shumë të rëndësishme, për të mirën e popullit tonë. Ndërtimin e objektit më të rëndësishëm të pesëvjeçarit, uzinën e plehrave azotike, e siguruam me ndihmën internacionale të RP të Kinës. Ngritja e saj do të jetë shpëtim për bujqësinë e vendit tonë, një sukses shumë i madh për ekonominë tonë kombëtare.

Të luftojmë për zbatimin e kodit agroteknik, në mënyrë që të realizojmë rendimentet që kemi caktuar, të punojmë që të preagatitim kuadrot dhe të kemi sistemuar të gjitha fushat tona dhe, kur do të kemi përfunduar ndërtimin e uzinave të plehrave kimike, pra kur ta kemi plehun kimik, atëherë «ta vëmë takien mbi sy»,

se, duke bërë një punë edhe më të mirë e më të kualifikuar se tani, rendimentet do të na shtohen edhe shumë më tepër.

Rëndësi për vendin tonë ka shfrytëzimi i mineralit të hekurit. Hekuri për industrinë është si buka për njerëzit. Sot për sot që nga tubat e gjer në pjesët më të vogla metalike jemi të detyruar t'i importojmë. Kur i do qejfi polakut ose çekut na jep, por së shpejti ne do të kemi industrinë tonë të hekurit që do të shfrytëzojë mineralin tonë. Në kemi zbuluar gjer sot shumë burime të mineralit të hekur-nikelit, por kemi shenja dhe po zbulojmë edhe hekur të thjeshtë, kështu që industria që do të ngremë nuk do ta harxhojë kot nikelin.

Vendi ynë është i pasur në minerale; Veriu i Shqipërisë sidomos është një thesar i madh në këtë drejtim. Me ngritjen e metalurgjisë neve na hapet një perspektivë e madhë për shfrytëzimin e hekurit. Rezervat në këtë lloj minerali të vlefshëm janë të mëdha dhe me to mund të punohet për shumë vjet. Në këto kushte do të jemi në gjendje të sigurojmë edhe metallurgjinë tonë me lëndë të parë. Tani në fillim ne do të ngremë një uzinë të vogël përpunimin e hekurit, por më vonë, krahas kësaj, do të ngremë edhe metallurgjinë e madhe në Elbasan.

Gjatë këtij pesëvjeçari do të ngremë edhe një sërë objektesh të tjera të rëndësishme, sikurse është kombinati i ri i tekstileve në Berat. Kështu ato vepra që janë parashikuar në plan do të ngrihen dhe materialet për to kanë filluar të vijnë. Tani çdo gjë për ndërtimin në kohë me sukses, për përvetësimin dhe monti-

min e këtyre veprave gjatë tre vjetëve të fundit të pesëvjeçarit, varet vetëm nga ne, nga organizimi i punës sonë, prandaj mobilizimi ynë të jetë i fortë, i shëndoshë dhe luftarak. Ne jemi të sigurt që kësaj pune do t'ia dalim me sukses sepse eksperiencë dhc kuadro kemi.

Ju keni afër rrethin e Fierit të cilin duhet ta ndihmoni me forcat tuaja, natyrisht në mënyrë të organizuar e jo duke lejuar që njerëzit të largohen nga fshati sipas qejfit. Në radhë të parë, për ndërtimet që do të bëhen në Fier, ju mund të mobilizoni forca nga qyteti. Qytetarët s'ka pse të mos venë atje sepse Fieri është një qytet i bukur. Sigurisht ju thoni se Lushnja është edhe më e bukur, por me punën e përbashkët Ficeri do të bëhet një qytet i rëndësishëm industrial. Rëndësi për këtë qëllim ka çështja që edhe industrinë e re ta ngremë, edhe fshatin të mos e braktisim, sepse klasa punëtore që punon në qytet, që të ushqitet do bukë, mish, zarzavate etj., prandaj, po të ikin kooperativistët pa kriter nga fshati, do të na pakësohen prodhimet bujqësore në një kohë që klasa punëtore shtonhet, kështu punëtorët nuk kanë me se të plotësojnë nevojat e tyre. Duke u bërë me kriter një lëvizje e tillë edhe prodhime bujqësore e blektorale do të kemi më shumë në qytet, edhe fshati do të furnizohet vazhdëmisht me mallra industriale të mira dhe çdo vit më të lira. Kjo është një aleancë e tërë. Partia është në gjendje ta bëjë këtë punë dhe nga lart udhëzimet për këtë janë dhënë.

Perspektiva e ekonomisë sonë për këtë vit është e mirë, si nga ana e eksportit, ashtu edhe nga importi.

Marrëveshjet me vendet që kemi lidhje ekonomike u arritën dhc u realizuan më mirë dhe më shpejt se vitet e tjera.

Pjesën më të madhe të eksport-importit tonë ne e kemi me RP të Kinës, me të cilën marrëveshjen për vitin 1963 e përfundua më shpejt, ato që kërkuam Kina na i dha. Dhe me vendet e tjera ne i kemi siguruar të gjitha mallrat kryesore që na duhen. Ne kemi marrëdhëniet tregtare edhe me vendet e demokracisë popullore të Evropës. Këto marrëdhëniet udhëheqësit revizionistë të këtyre vendeve i mbajnë se kanë nevojë për mallrat tona. Çekët, për shembull, kanë nevojë që nga hekuri ynë e gjer te domatet e Divjakës.

Sidoqoftë viti 1962 për ne ka qenë një vit i vështirë, vit i zbulimit të tregjeve për mallrat tona. Vështirësi në eksport kemi vetëm për bitumin e naftës që e disponojmë në sasi të mëdha, por edhe këtë problem do ta zgjidhim. Si përfundim mund të themi se plani i eksport-importit këtë vit është shumë më i mirë se çdo vit tjeter, prandaj artikujt kryesorë nuk do t'i mungojnë ekonomisë sonë.

Në këto kushte të mobilizojmë edhe më shumë forcat për ta realizuar me sukses planin e vitit 1963, për të përmirësuar në radhë të parë jetën e popullit tonë, sepse edhe situaña e jashtme na e imponon një gjë të tillë. Ne duhet të qëndrojmë të fortë dhe kemi bindjen se plani i këtij viti, sado i rëndë që është dhe sado vështirësi që të hasim, është i realizueshëm. Por pa luftë, pa përpjekje, pa një frymë të lartë patriotizmi dhe sakrifice të gjitha këto detyra të mëdha nuk mund të realizohen. Ne jemi të bindur se Partia

jonë që është një parti e zonja, parti e disiplinës, e sakrificës dhe e mençur, do t'ua dalë në krye të gjitha detyrave, sepse ajo udhëheq një popull patriot e të lidhur ngushtë me të. Paralelisht me mobilizimin duhet të luftojmë që të mësojmë vetë, në radhë të parë, e të mësojmë edhe popullin.

Detyrat tona për bujqësinë janë thënë në vendimet e Plenumit të veçantë që u bë për këtë sektor dhe në këtë fushë po bëhet shumë punë. Vendimi i Plenumit të KQ të PPSH mbi intensifikimin e bujqësisë u punua në të gjitha aktivet e Partisë ku u shtruan detyra të rëndësishme. Këto detyra ne duhet t'i kemi tanë para-sysh në punën tonë. Qëllimi kryesor është që të ngremë rendimentin e kulturave bujqësore. Për t'ia arritur kësaj, midis të tjerash duhet të punojmë shumë për zgjerrimin e njohurive tona agroteknike, të cilat duhet t'i zbatojmë në praktikë në mënyrë sa më të përsosur. Atëherë mund të arrijmë rezultatet dhe qëllimet që i kemi caktuar vetes.

Populli e di se, veçanërisht këtu në rrëthin e Lushnjës, shteti ka dhënë shumë për bujqësinë. Kontributi i të gjithë popullit shqiptar për bujqësinë në këtë rrëth ka qenë i madh; 1 miliard e 300 milionë lekë janë shpenzuar gjer tanë për bonifikimet te ju dhe të tjera fonde janë duke u shpenzuar e do të shpenzohen në të ardhmen. Pra populli dhe Partia ju kanë ndihmuar shumë, prandaj edhe ju duhet t'i përgjigjeni si duhet kësaj ndihme. Mundësive që ju ka krijuar populli, Partia dhe Qeveria në rrëthin tuaj t'u përgjigjeni me nder. Ju keni bërë shumë dhe puna juaj është e dalluar në këtë drejtim, por nuk mund të themi se i keni

shfrytëzuar të gjitha mundësitë, sepse ka akoma shumë për të bërë.

Ne kemi besim se detyrat e reja që ju vihen përpara ju do t'i kryeni, mbasi organizata juaj është e fortë. Pa një organizatë të fortë partie, nuk mund të kishit asnjë rezultat. Në të ardhmen me siguri ju do të arrini rezultate edhe më të mëdha nga ato që keni arritur gjer më sot, sepse Partinë në rreth e keni të fortë, popullin e keni patriot, ai ka bërë përparime të mëdha në jetën e tij, se në të kaluarën ka qenë i vuajtur, i mjeruar, i shtypur, sa ishte i detyruar t'ua linte vajzat e tij bejlerëve që i mbanin si shërbëtore, i shfrytëzonin si kafshë dhe kjo ndodhte se atëherë njerëzit vuanin për bukë. Por u krijua Partia, dhe populli nën udhëheqjen e saj u organizua, u edukua, luftoi, u çirua e tani ka dalë në ditë të bardha. Gjithkush mund ta marrë me mend ç'patriotizëm i madh vlon në zemrën e popullit të Lushnjës, por prapë është e vështirë ta imajjinosh një gjë të tillë si duhet.

Populli i rrethit tuaj ka një vullnet të madh; në të gjithë njerëzit e gjen këtë vullnet, që nga të rinjtë, te gratë e gjer te pleqtë, me të cilët mund të kemi edhe disa kontradikta për mënyrën e jetesës. Ja, për shembull, një plak që është anëtar i kooperativës bujqësore nuk do që vajza e tij të rrijë gjer natën vonë në vatrën e kulturës. Kushdo që të jetë, po t'i vonohet djali apo vajza, do t'ia bëjë pyetjen vetes, do të pyesë ku është, pra do të interesohet, që ata të mos futen në rrugë të gabuar. Prandaj edhe plaku i Myzeqesë e bën një gjë të tillë. Megjithatë mbledhje do të bëhen, por jo çdo natë e deri vonë. Sidoqoftë këto janë gjëra të

vogla që rregullohen, Pleqve, nga një anë, s'u vjen mirë kur vonohen vajzat ose djemtë, por, nga ana tjetër, urojnë dhe thonë: «Të rrojë Partia që na çlroi, na përmirësoi jetën dhe na dha mundësi që djemtë dhe vajzat tona t'i shohim të gjuzuara». Prandaj ata u thonë fëmijëve të tyre: «Ta ruani dhe ta doni Partinë, sepse më parë neve na kullonte gjaku dhe vuanim gjithë jetën, kurse tani punojmë për veten tonë, kemi shtëpitë tona, tokën tonë, bagëtitë tona».

Ky patriotizëm i madh i popullit do të forcohet akoma edhe më shumë, do të forcohet edhe më shumë uniteti dhe dashuria për Partinë, për atdheun e bukur që po e ndërtojmë me gjak dhe me djersë, për marksi-zëm-leninizmin. Duke pasur një organizatë partie të fortë dhe një popull kaq patriot, detyrat që i janë vënë rrëthit të Lushnjës në bujqësi do të realizohen, në radhë të parë për përmirësimin e jetës suaj, po edhe për të mirën e gjithë popullit tonë.

Është fakt shumë interesant që gjatë konsultës popullore janë bërë 283 propozime nga njerëzit tuaj me një vlefshë prej 9 milionë lekësh. Kjo nuk është gjë e vogël, sidomos duke marrë parasysh që ju jeni rrëth bujqësor dhe industrinë e keni akoma të vogël. Kështu është tani, por, duke marrë parasysh shenjat e mira që kemi, ndoshta edhe këtu te ju na del naftë dhe atëherë lëre çfarë do të bëhet Divjaka, do të mbushet me puse vajguri, me domate dhe me agrume, lum punëtorët e naftës që do të punojnë e do të jetojnë atje. Po të vërtetohet një gjë e tillë në këtë zonë, do të na krijohet një fushë e re naoste me perspektivë. Gjatë këtyre tre vjetëve, industria edhe në rrëthin e Lushnjës do të ecë

përpara me ndërtimin e fabrikave të reja të përpunimit të rrushit, të qumshtit dhe me atë të letrës.

Bujqësia e rrëthit tuaj është në gjendje t'i kryejë detyrat që i janë vënë përpara, sepse te ju është kollektivizuar 94 për qind e tokave dhe e familjeve fshatare. Kjo ka sjellë si rezultat shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale. Në vitin 1938 rrëthi juaj prodhonte vetëm 13 mijë tonë drithë, kurse sot ai prodhon 42 mijë tonë. Pambuk nga 82 tonë që prodhoheshin atëherë, tani prodhohen mbi 11 mijë tonë e kështu me radhë, sepse bujqësia jonë tani është vënë mbi baza të shëndosha. Ne nuk duhet të kënaqemi me kaq, por të mobilizohemi për rezultate akoma më të mëdha.

Mirë e bëri këtu kritikën një shok kundër të kënaqurit me pak, se me të vërtetë ka njerëz që kënaqen me disa suksese, duke menduar se tani jemi mirë, të ardhurat na janë shtuar, shtëpi të reja kemi ndërtuar, prandaj ç'na duhet të punojmë më shumë. Po ne duhet të luftojmë që vazhdimisht ta bëjmë edhe më të mirë jetën, të punojmë kurdoherë më mirë që të ndërtojmë bazën materialo-teknike të socializmit. Në raport vireshin në dukje edhe mjaft dobësi në punët tuaja. Nga të gjitha këto të meta ne duhet të nxjerrim mësime.

U vini rëndësi në radhë të parë drithërave të bukës, jo në kuptimin që i kanë pasë dhënë dikur në regjimet shtypëse të së kaluarës, sigurimit të një cope bukë me presh, sikur kjo ishte gjithçka. Populli ynë i varfër në kulm e i vuajtur ka ëndërruar për një copë bukë. Tani që popullit Partia i ka siguruar çdo gjë, buka na duhet në radhë të parë për të ngrënë, se ajo është ushqimi ynë kryesor, na duhet edhe për rezerva, drithin e

përdorim edhe për ushqimin e kafshëve. Duke pasur prodhim të madh misri, do të na shtohet edhe blegtoria, do-methënë do të kemi më shumë mish, qumësht, gjalpë, djathë, gjizë, lesh etj. I vini rëndësi të madhe misrit, pastaj edhe pambukut që e keni kulturën kryesore dhe përritjen e të cilit ju keni fituar eksperiencë të madhe. Përpara në rrethin tuaj mbilleshin sasi të vogla pambuku, kurse tani pambuk mbjell çdo kooperativë; kësh-tu te ju është grumbulluar një eksperiencë e madhe për këtë kulturë. Sa vajza të reja ka tani në rrethin tuaj që kanë arritur shifra rekord në vjeljen e pam-bukut!

Më pëlqeu shumë diskutimi i një kooperativisteje të re nga Gorreja. Ajo mori këtu një zotim të guxim-shëm se do të realizojë në skuadrën e saj 16 kv pambuk për ha, bile tha se do ta kalojë këtë shifër. Është fakt se rendimentin dhe prodhimin e pambukut në rrethin tuaj e keni stabilizuar, kjo tregon se ju ia bëni mirë shërbimet kësaj bime dhe kur ia bën shërbimet, prodhimin e ke të siguruar, me përjashtim të ndonjë viti kur ndodh kohë e keqe. Prandaj gjersa shumë nga kooperativat tuaja e kanë stabilizuar prodhimin ato tani janë në gjendje ta ngrenë atë vazhdimisht çdo vit.

Çështjen e mbjelljeve dhe problemet e tjera bujqësore ju i dini më mirë nga unë. Për këto u fol edhe në raport dhe në diskutime, por unë dua t'ju jap një këshillë, që në praktikë të mos vonoheni, t'i shpejtoni mbjelljet, sepse plani sivjet është shumë i ngarkuar, prandaj mos humbisni as minutën.

Ju këshilloj që kodin agroteknik ta përvetësoni mirë. Ai që i njeh dhe i zbaton mirë pikat e këtij kodi

është agronom nga më të mirët edhe sikur të ketë ecur përpara vetëm me praktikë. Juve edhe shkollat dhe kurset nuk ju mungojnë. Kooperativistët e dalluar, komunistët, të rintjtë, gratë, me parti dhe pa parti, në rrethin tuaj kanë eksperiencë të madhe në çështjet e bujqësisë, sepse ata punojnë vazhdimisht në ara dhe i kuptojnë fare mirë pikat e kodit agroteknik, por rëndësi ka që ato të zbatohen në mënyrë të organizuar.

Një nga pikat e kodit rekomandon që tokat të punohen thellë qilizmë. Të gjithë e dinë rëndësinë e kësaj punc, sepse me punimin e thellë do të kemi rendimente më të mëdha nga 2-3 e gjer në 7-8 kv për hektar më shumë. Mirëpo, megjithëse e dini rëndësinë e kësaj pune, duhet thënë se vitin e kaluar në vend që të bënit 12 mijë hektarë ju keni bërë qilizmë vetëm 3 150 hektarë. Në qoftë se do të ecet ashtu si ka vendosur Komiteti Qendror që brenda dy-tre vjetëve toka të punohet një herë qilizmë, me ritmin që e keni filluar ju do t'ju duhen 12 vjet. Kështu nuk mund të zbatohen udhëzimet e Komitetit Qendror për të punuar me mjetet mekanike dhe me krahë. Për realizimin e kësaj detyre ne kemi porositur dhe së afërmi do të na vijnë rrëth 400 plugje «Martineli», me të cilat do të bëhet një punë shumë e madhe për punimin thellë të tokave. Por, veç në rrethin tuaj nuk duhet të lihet pas dore edhe punimi qilizmë me krahët e njerëzve.

Ju gjithashtu e dini rëndësinë e madhe që ka plehërimi, një nga 7 pikat më të rëndësishme të kodit agroteknik. Po nuk i hodhët plësh tokës, rendimentet që do të marrim do të jenë të vogla. Prandaj edhe në këtë çështje të ecim me ritmet që kemi caktuar, duke ia

hedhur plehun tokës në afatet e caktuara. Në rrithin tuaj ju keni torfë. Tani janë bërë disa propozime për të parë sa kushlon transportimi i saj. Përveç mjeteve të shpejta, mendoj që ju të shfrytëzoni për këtë qëllim edhe mjetet primitive që keni në rreth, ta çoni torfën ku duhet, ta kompostoni sipas rregullave dhe pastaj ta hidhni në arë. Atje ku keni hedhur torfë të kompostuar me fekale keni marrë 4-5 kv/ha më shumë. Mirëpo duhet vënë në dukje se vitin e kaluar ju vetëm 20 për qind e keni realizuar planin e plehërimit të tokave me torfë. Prandaj në këtë drejtim ju duhet të bëni shumë e më shumë.

Le të marrim çështjen e ujitjes dhe të kullimit. Ne themi të mbjellim më shpejt, prandaj edhe sistemin e ujitjes ta kemi në gatishmëri të plotë dhe ujitjen ta bëjmë sa të jetë e mundur jo me përblytje, por me brazda se kështu do të sigurojmë rendimente më të larta. Ujitja duhet bërë në mënyrë shkencore. Por që ta kemi në gatishmëri sistemin e ujitjes duhet t'i pastrojmë në rregull kanalet e treta dhe të dyta dhe kanalet kryesore me mekanizmat dhe mundësitet që ka shteti, por edhe me forcat e kooperativistëve. Kjo çështje ka një rëndësi të madhe. Duhet të zhduket mentaliteti që kanalet ujitëse janë të shtetit. Sigurisht edhe shteti duhet dhe do t'ju ndihmojë në këtë drejtim dhe po vë të gjitha forcat për t'i ardhur në ndihmë fshatarësissë, po dijeni se ne jemi një vend që kemi vënë në dispozicion për këtë qëllim një forcë shumë të madhe motorike. Ne tani e kemi mekanizuar shumë mirë bujqësinë, do të sjellim çdo vit e më shumë edhe mekanizma të tjera. Një pjesë të kësaj force ne do ta caktojmë edhe për

pastrimin e kanaleve ujitetëse. Për ta përmirësuar më tej gjendjen e tyre ne kemi marrë vendim për të krijuar një drejtori të posaçme për pastrimin e kanaleve ujitetëse kryesore kur mbushen me baltë, kurse kanalet e dyta e të treta do t'i pastrojë edhe shteti me mjetet që ka. Por këtë vit duhet ta kryeni më mirë këtë punë, sepse vitin e kaluar vetëm 50 për qind e realizuat planin e pastrimit të kanaleve me forcat tuaja.

Të vijmë në çështjen e farërave. Rëndësinë e këtij problemi nuk po e vë në dukje se ju e dini më mirë nga unë. Vetëm merrni masa që farërat të mos i përzieni siç ka ndodhur gjer tanë. Prandaj ashtu si për të gjitha çështjet tregoni shumë kujdes edhe për farërat që luajnë një rol vendimtar në prodhimin bujqësor. Rregullat duhet të zbatohen me rreptësi. Órithi që është përfarë dhe i dezinfektuar duhet të përdoret vetëm për të mbjellë dhe në asnjë mënyrë nuk duhet përdorur për të ngrënë, siç ndodhi një herë në rrëthim tuaj.

Kështu, pra, pikat e kodit agroteknik, që janë rezultat i punës së punonjësve tanë të pararojës, të zbatohen me përpikëri që nga pastrimi i farës, gjatë mbjelljeve, shërbimeve kulturore, korrjeve e shirjeve pa firo dhe gjer në depozitim e drithit. Po t'i bëjmë këto si duhet atëherë mbi rendimentet e realizuara do të fitonim edhe gjer në 10 kv/ha që gjer tanë na shkojnë këtë nga pakujdesia jonë. Prandaj ta zbatojmë me kujdes të madh kodin agroteknik sepse një gjë e tillë do të na ndihmojë për ngritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore.

Doja të flisja pak edhe për përhapjen e eksperienccës së përparuar. Në rrëthim tuaj ka shumë kooperativa

bujqësore, brigada, skuadra dhe punonjës që dallohen në punët e bujqësisë dhe të blegtorisë. Nuk dua të them se organizata e Partisë nuk ka punuar për shpërndarjen e eksperiencës së përparuar, por kjo eksperiencë duhet të shpërndahet akoma më mirë, në mënyrë më të organizuar. Të vihen më mirë në dukje punonjësit më të dalluar të bujqësisë, një kooperativë të shfrytëzojë më me seriozitet eksperiencën e madhe dhe të mirë të koooperativës fqinjë. Përhapja e eksperiencës së përparuar është një faktor i madh për ecjen përpëra të bujqësisë sonë. Merrni shembullin e Rako Pinës dhe të Budo Isufit dhe si u punua për përhapjen e eksperiencës së tyre të vlefshme. Në saje të një pune të mirë e të organizuar që u bë për përhapjen e eksperiencës së tyre, tani janë me qindra ata që ndjekin shembullin e tyre. Puna që bënë ata në fillim ishte e pabesueshme nga të tjerët dhe e vështirë për t'u vënë në zbatim. Ja shoku Rako Pina, pa marrë parasysh interesin personal dhe të familjes së tij, por duke u udhëhequr nga interesi i përgjithshëm, e la traktorin e ri dhe mori në përdorim traktorin e vjetër, pavarësisht se me të ai do të kishte përkohësisht rezultate më të pakta dhe të ardhurat do t'i uleshin. Ai e bëri këtë sepse nuk mund të lejonte që traktorët e vjetër të mos shfrytëzoeshin, gjë që ishte në dëm të ekonomisë së përgjithshme. Ai kishte besim të madh në të ardhmen dhe në forcat e veta, ishte i ndërgjegjshëm se në fillim do ta kishte vështirë, por me një punë më të mirë ai do të punonte si edhe me traktorin e ri e njëkohësisht puna e tij do të bëhej shembull dhe këtë shembull do ta ndiqte një ushtri e tërë. Prandaj e meritoi me plot të drejtë deko-

ratën. Kështu kanë menduar në fillim edhe heroi Budo Isufi e shumë shoferë të lavdishëm në vendin tonë që kanë marrë zotim të bëjnë nga 500 dhe 600 mijë kilometra pa riparim të përgjithshëm. Bile Xhel Jakupi ka besim se do të arrijë të bëjë edhe 1 milion kilometra.

Shembulli i më të dalluarve, pra, të ndiqet më shumë dhe më mirë ta organizojmë përhapjen e eksperiencës së tyre, kështu do të ecim përpara me ritëm të shpejtë.

SMT-ja ka luajtur dhë tani e në të ardhmen do të luajë gjithnjë rol më të madh në bujqësi sepse në fshat ajo është pararoja. Traktoristët janë përfaqësuesit e klasës punëtore në fshat, prandaj shpresat e mëdha janë vënë mbi ta. Tani traktoristët të janë të armatosur mirë për fushatën e mbjelljeve të pranverës që na afroi. Në radhë të parë, të shpejtohen punimet për riparimin e traktorëve dhe gjer më 15 shkurt, sikurse u tha në raport, ata të janë gati për të dalë në fushë. Tani ne kemi një forcë të madhe motorike që vazhdimisht po shtohet, kemi dhe traktoristë të zotë, kemi siguruar dhe zëvendëstraktoristë të mirë, pastaj i kemi pasuruar dhe do t'i pasurojmë edhe më tej repartet e riparimit të traktorëve. Por traktoristët të kenë parasysh që gjithë mekanika që kemi sjellë na kushton valutë të madhe, prandaj çdo makinë të mbahet mirë, të shfrytëzohet si duhet sepse duhet vënë në dukje që, vitin e kaluar, një numër i madh traktorësh dhe kombajnash në rrethin tuaj nuk e realizuan ngarkesën. Disa deficite që ka pasur ferma dhe disa kooperativa bujqësore i takojnë edhe SMT-së që nuk ka qenë në gatishmërinë e duhur. Prandaj organizata e Partisë dhe traktoristët të

kenë kujdes për t'i pasur në gatishmëri traktorët. Traktoristët të kenë edhe ata parasysh të zbatojnë agroteknikën e përparuar gjatë punimit të tokave. Për këtë të jenë vetë të ndërgjegjshëm e të ndihmojnë edhe kooperativistët.

Përsa i përket sigurimit të mensave, për të cilat u fol këtu, unë do të bisedoj me shokët e Ministrisë së Bujqësisë, por edhe shokët e kooperativave të kujdesen për t'u krijuar kushte më të mira traktoristëve. Mirë u tha këtu që traktoristët tanë janë bij të popullit, të klasës punëtore, edhe ata kanë të drejtë të bëjnë një jetë të rregullt, t'u sigurohet strehimi, t'u sigurohet mensa që ta gjejnë bukën gati dhe të hanë në kohë. Në SMT-të tonë ne kemi punëtorë të ndershëm, prandaj të vihet rregull në këtë çështje, brenda normave dhe kritereve të caktuara.

Në blegtori ju keni pasur suksese, po keni pasur dhe të meta e vështirësi. Planin e lopëve për vitin 1963 e keni realizuar qysh tashti, prandaj për këtë sektor, ku ju jeni mirë, nuk kam ç'të them. Ju edhe detyrimin e mishit e të leshit e keni realizuar, por çështja është që të bëni më shumë përpjekje për shtimin e numrit të kafshëve, gjë që varet nga sigurimi i bazës ushqimore. Ju duhet ta shton konvejerin e gjelbër. Sigurimi i ushqimit për bagëtinë siguron sukseset në këtë sektor, prandaj numri i kooperativave bujqësore që përdorin konvejerin e gjelbër të shtohet edhe më shumë. T'i vini gjithashtu rëndësi çështjes së silazhit.

Rrethi i Lushnjës ka qenë vendi i pulave, i bibave, i rosave etj. Nënët dhe motrat tuaja dinë si t'i rritin shpendët dhe i duan ato. Aq më tepër ato tani duhet

të punojnë për shtimin e shpendëve, sepse tani i rritin për të plotësuar nevojat e tyre dhe jo për beun. Prandaj edhe këtë sektor mos e lini pas dore, se duke mbajtur shpendë ju do të shfrytëzoni edhe kokrrat e fundit të drithit që mbeten në arë. Kështu do të keni edhe mish më shumë. Në lidhje me drithin bëni të gjitha përpjekjet që të korrni e të shini pa firo.

Ju keni pasur rezultate të mira edhe në sektorët e tjerë të ekonomisë, si në industri, në artizanat etj. Edhe në tregti nuk keni shkuar keq, popullin e keni furnizuar mirë. Por ka pasur edhe disa raste kur furnizimi i popullit nuk është bërë në rregull, për mungesë të organizimit të punës. Të meta të tilla duhet t'i eviton menjëherë se s'ka arsyet e ndodhin.

Përsa i përket vajit, atë që prodhojmë, popullit ia japim të gjithë, mirëpo vetëm vaji i ullirit nuk mjafton për të plotësuar nevojat e të gjithëve, por vaj kemi sa të duash, vaj kikiriku, vaj susami, vaj soje; tani populli ua njohu vlerën këtyre lloj vajrave dhe i përdor. Pastaj ne kemi edhe gjalpë, kemi sallo etj. dhe në krahësim me vendet e tjera jemi shumë mirë. Përsa i përket vajit të ullirit, duke marrë parasysh se nuk është i mjaftueshëm, do të marrim masa për një shpërndarje më të drejtë të tij. Që tregtia të ecë mirë, problemi duhet parë jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe si një çështje e madhe politike. Shitet duhet të mësohen të mos bëjnë hatëre, tek ata nuk duhet të ekzistojë koncepti «e kam mik» dhe t'i japid sa të dojë njërit apo tjetrit, por t'u shërbejnë mirë dhe njëlloj të gjithëve.

Në sektorin e arsimit e të kulturës ju keni pasur suksese dhe për këtë ju përgëzoj nga zemra. Shkollat e

rrethit tuaj, nxënësit dhe mësuesit janë shtuar në qytet dhe nëpër fshatra. Ju tani keni mjaft vatra dhe shtëpi kulture me kuadrot përkatës. Shokët e kooperativave që diskutuan në konferencë folën për vatrat dhe shtëpitë e kulturës dhe prej tyre kuptova se vajzat që i drejtojnë ato janë me të vërtetë të afta e me kulturë, shumë prej tyre kanë bërë dhe shkollë dhe e kryejnë mirë detyrën.

Me këtë rast dua t'ju them të keni parasysh se pa pjesëmarrjen aktive të gruas nuk ndërtohet dot socializmi, po nuk kuptuam këtë atëherë do të mbetemi prapa me gjithë kuptimin e fjalës. Prandaj Partia të bëjë një punë të madhe për ngritjen e gjithanshme të gruas. Gruaja luan një rol vendimtar në familje dhe jashtë saj.

Më duket se një shok që diskutoi këtu foli si me të qeshur që gratë e Divjakës dalin në pazar e psonisë. Kjo ka të bëjë me mbajtjen e të hollave në familje. Çështja e parasë ka akoma rëndësi, ajo është e rrënjosur në ndërgjegjen e njerëzve. Kush ka paranë ai ka edhe pushtetin, fuqinë. Përpara fitonte burri, ai kishte edhe paratë, prandaj gruaja, kur donte të blente ndonjë fustan ose një palë këpucë etj., ia kërkonte burrit me frikë, se ishte e varur ekonomikisht nga ai. Mirëpo, një gjë e tillë sot nuk mund të ndodhë, sepse gruaja është vetë në punë, ajo fiton vetë. Kështu çështja e ekonomisë në familje tani nuk është si përpara. Megjithatë është mirë që kuletën në familje ta marrë gruaja se kjo është më nikoqire se burri. Të gjithë jemi të ndershëm, të gjithë duam ta bëjmë jetën sa më të mirë dhe shtëpinë ta kemi sa më të pajisur, të gjithë duam që

fëmijët të na rriten të shëndetshëm e të edukuar, të vishen dhe të ushqehen mirë. Atëherë kur puna është kështu të kemi më shumë besim te gruaja që na i ka bërë fëmijët, që i do si shpirtin dhe kujdeset të na i rritë dhe të ardhurat t'ia japim asaj, se të jemi të bindur që do t'i qeverisë si duhet. Kështu të thyhet mentaliteti i vjetër për gruan në këtë drejtim dhe kjo në familje të bëhet me të vërtetë e barabartë me burrin, pastaj, kur ta kemi arritur këtë, nuk ka rëndësi nëse i mban gruaja apo burri të ardhurat e familjes.

Çdo komunist në radhë të parë duhet të punojë në familje për të thyer atje zakonet dhe mentalitetet e vjetra. Në këtë drejtim duhet punuar se ka në familje edhe njerëz që nuk e kuptojnë një gjë të tillë. Prandaj Partia duhet të punojë edhe në këtë drejtim. Të punohet gradualisht për edukimin dhe ngritjen e gruas, gjersa ajo të fitojë personalitetin e duhur, sepse nga një gjë e tillë ne do të kemi rezultate konkrete, në radhë të parë familja do të jetë më e gjëzuar, më e përparuar,jeta aty do të jetë më e qetë, të gjithë do të shkojnë në harmoni dhe fëmijët do të rriten më mirë. Gjithashtu edhe jashtë do t'i jepet gruas mundësi të punojë edhe më mirë.

Gruaja nëpër fshatra duhet të punojë edhe në fushë, dhe të punojë mirë. Natyrisht për gratë duhet të caktoni edhe norma sa ditë-punë të bëjnë, por duhet pasur parasysh se ato në shtëpi nuk rrinë duarlidhur, por punojnë, bile në familje punojnë shumë dhe po të bëhet llogari do të dalë se gruaja punon sa burri, kurse nderohet më pak. Bile ka akoma raste që kur burrat shtrohen në sofër gratë u rrinë në këmbë. Zakone

të tilla qoftë në fshat apo në qytet duhet të luftohen dhe të zhduken. Edhe gruaja vetë duhet të luftojë për emancipimin e saj.

Partia në përgjithësi ka bërë një punë të madhe në këtë drejtim. Shikoni sa mirë mësojnë tani vajzat nëpër shkolla, shikoni sa shumë gra e vajza kemi në arsim, rrëth 70 për qind të arsimtarëve janë gra dhe ne do të luftojmë ta shtojmë edhe më shumë këtë numër. Personelin e shëndetësisë, sidomos të ulëtin e të mesmin, e kemi më shumë gra, po ka edhe gra mjeke, gra dhe vajza gjen në profesione nga më të ndryshmet gjer gjeologe, bile shumë të zonjat. Kudo që punojnë gratë, në të gjithë sektorët, punojnë shumë mirë. Prandaj të zhdukjet mentaliteti që gratë janë më inferiore nga burrat. Është një fitore e madhe e Partisë dhe e popullit tonë që gruaja është ndihmuar të ecë përpala, pa një faktor të tillë nuk mund të ndërtohet socializmi.

Një problem tjetër i rëndësishëm është ai i kuadrit, të cilin ju duhet t'i kushton vëmendjen më të madhe. Plenumi i vitit të kaluar i Komitetit Qendror¹ ka vënë detyra të rëndësishme për këtë problem, prandaj duhet punuar për zbatimin e tyre. Ja, në rrëthin tuaj ka një numër arsimtarësh që nuk e kanë arsimin përkatës dhe nuk vazhdojnë shkollat. Partia t'u vërë atyre këmbët në një këpucë që ta marrin arsimin përkatës. Shumë kryetarë kooperativash bujqësore, që janë shokë

¹ Plenumi i 7-të i KQ të PPSH «Mbi përmirësimin e mëtejshëm të punës për preqatitjen dhe për kualifikimin e kuadrit», u mbajt më 18-19 korrik 1962.

me eksperiencë, kanë mbetur akoma me 7-vjeçaren. Ata duhet të nxiten dhe të synojnë për më tutje. Për edukimin agrozooteknik të kuadrove të bujqësisë nuk bëhet sa duhet, ndërsa mundësitë tani te ne janë të mëdha. Prandaj të përfitohet në maksimum nga këto mundësi, specialistët e bujqësisë t'i ndjekin më shumë format që janë caktuar për ngritjen e tyre dhe të bëjnë përpjekje sa më të mëdha që të përfitojnë efektivisht nga ato. Specialistët e bujqësisë, gjithashtu, të bëjnë më shumë përpjekje për të shkuar në bazë. Mirë dhe drejt i kritikoi këtu një shok ata që nuk shkojnë sa duhet në bazë. Nuk duhet të presin derisa t'i kërkojnë kooperativat bujqësore dhe pastaj të venë, por të shkojnë vetë, pa u ftuar.

Punët tona venë mirë, sidomos në drejtim të ngritjes ideopolitike të komunistëve. Mua më erdhi shumë mirë kur dëgjova diskutimin e një inxhinieri të ri, i cili foli këtu jo vetëm për punën që është bërë nga ana e organizatës-bazë të Partisë atje ku punon, por çështjet e punës ai i lidhi edhe me çështje ideologjike, ai kritikoi shokët që nuk i shtrojnë në Parti vërejtjet dhe mosmarrëveshjet që kanë me njëri-tjetrin. Në jetë ka shumë çështje që kërkojnë zgjidhje, prandaj ai që nuk është i armatosur me marksizëm-leninizmin gjen vështirësi në zgjidhjen e tyre. Partia u ka dhënë anëtarëve të saj të gjitha mundësitë për ngritjen e tyre politike dhe ideologjike me anën e shtypit, radios, të shkollave dhe kurseve të ndryshme për përvetësimin e teorisë marksiste-leniniste. Në këtë drejtim duhet të bëhet kujdes, sepse nuk jemi më si në vitet e para pas Çlirimt ose si në kohën e themelimit të Partisë

kur njerëzit ishin akoma pa eksperiencë, kur shumë komunistë jo vetëm nuk kishin kulturë të përgjithshme, por nuk dinin as të shkruanin e as të lexonin. Në ato kohë ishte i vështirë përvetësimi i teorisë sonë marksiste-leniniste. Po tani ato kohë kanë kaluar, njerëzit kanë ndryshuar, kanë ecur përpara, të rrallë janë ata që nuk kanë shkollë. Të paktën shkollën fillore e kanë të gjithë, po tani kjo është e pamjaftueshme. Të gjithë duhet ta kenë shkollën 7-vjeçare, se njerëz të tillë që kanë një eksperiencë të madhe me kaq shkollë do të jenë në gjendje ta përvetësojnë më mirë teorinë tonë. Prandaj t'i vihem i punës në këtë drejtim, se kjo do të na forcojë ndërgjegjen tonë socialiste. Ne kemi nevojë ta kalitim çdo ditë e më shumë ndërgjegjen me ideologjinë tonë, sepse ka edhe raste, qoftë në industri apo në bujqësi etj., domethënë në radhët e klasës punëtore e të fshatarësisë sonë kooperativiste, dhe ca më tepër në radhët e intelektualëve, që manifestohen shfaqje mikroborgjeze, të cilat e dëmtojnë punën.

Duhet thënë se në punën tonë kemi akoma shfaqje negative, si lëshime, neglizhenca, shpërdorime etj., që rrjedhin nga shkaku se ndërgjegjja e njerëzve nuk është akoma në atë nivel që e kërkon Partia. Prandaj në këtë drejtim duhet bërë një punë e madhe edukative në Parti dhe në rini të cilën e kemi të pastër, luftarake, energjike. Partia të kujdeset që rininë ta kemi sa më të pastër se tek ajo synon të futet armiku, prandaj ta edukojmë më së miri rininë tonë, në mënyrë që ajo të ndjekë traditat e lavdishme të organizatës së saj dhe të popullit tonë. T'i qëndrojmë afër rinisë dhe të kujdesemi për të. Rinia jonë punon, djersin, lodhet në

punë, prandaj ajo ka nevojë edhe për të dëfryer, po dëfrimi veç të jetë me masë, brenda normave të moralit tonë komunist. Ta ruajmë rininë nga tendencat dekadente ku përpinqen ta hedhin imperialistët dhe revizionistët me anë të propagandës, të shtypit, të radios, të filmave, të muzikës etj., etj. Në të gjithë këta sektorë Partia jonë ushtron kontrollin e vet, me qëllim që të mos e lejojë rininë tonë të bjerë pas veseve të këqija. Kurse në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet ku në fuqi janë revizionistët udhëheqjet revizioniste po e çojnë rininë në një rrugë të shfrenuar dhe shumë më të rrezikshme se në vendet kapitaliste. Në vendet kapitaliste është bërë prej kohësh një jetë e shthurur, bile atje nuk u bëjnë përshtypje veprimet e degjeneruara e skandaloze, sepse janë mësuar me gjëra të tilla, ato u janë bërë zakon. Por në vendet socialiste të Evropës, ku morali i klasës punëtore nuk ka qenë i tillë, revizionistët, duke lejuar tendencat liberale, dekadente, kozmopolite, në fakt po e degjenerojnë rininë. Si posojë, ata po e futin atë në një qorrak, po e shtyjnë drejt një moçali të qelbur.

Kurse rinia jonë është e kulluar si kristali, nuk është prekur nga sëmundje të tilla dhe ne ta ruajmë të pastër atë edhe në të ardhmen. Por që ta ruajmë rininë, nuk do të thotë ta mbyllim, ta lëmë pa dëfrim, pa kinema e pa teatër, pa këngë, valle e pjesë muzikore ose pa libra. Të gjitha këto duhet t'ia sigurojmë rinisë se është e ardhmja e vendit tonë dhe këto të shërbejnë për edukimin komunist të saj. Prandaj sa më mirë ta edukojmë rininë, aq më e fortë do të jetë ajo, aq më e gatshme do të jetë ajo për mbrojtjen e atdheut, aq

më shpejt do të përparojë vendi. Kur ne mendojmë për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit kemi parasysh sidomos rininë, në radhë të parë, që asaj t'ia bëjmë jetën të lumtur, prandaj luftojmë që ta edukojmë atë mirë në fryshtë e marksizëm-leninizmit. Edukimit të rinisë Partia i ka vënë rëndësi dhe ka arritur suksese të mëdha. Prandaj rinia jonë është e fortë.

Në radhë të parë të kujdesemi të forcojmë Partinë, se ajo është garancia për çdo fitore që kemi arritur dhe për të ardhmen e popullit tonë. Në Partinë tonë nuk ka sëmundje, ajo është e pastër ideologjikisht dhe politikisht dhe në qoftë se në ndonjë organizatë-bazë ka grindje, mosmarrëveshje, tarafe, shfaqje të smirës etj., ne e dimë se këto nuk janë një sëmundje e përgjithshme, ato janë fenomene të rralla në jetën e Partisë dhe nuk kanë karakter politik. Ato janë disa mbeturina mikroborgjeze që mund të bëhen të rrezikshme në qoftë se lihen të zhvillohen. Sidomos midis komunistëve gjëra të tilla nuk duhet të ndodhin, ato duhet të pastrohen menjëherë. Partia na mëson që çdo komunist, kur ka diçka, t'ia hapë zemrën asaj, t'ia thotë menjëherë organizatës-bazë dhe shokët ta dëgjojnë me kujdes të madh, me gjakftohtësi, pa inate dhe në këtë fryshtë të edukohen të gjithë anëtarët e Partisë. Sidomos ata komunistë që janë me përgjegjësi të tregohen më të matur përpara kritikave që u bëhen dhe t'i ndreqin gabimet. Atij që ka të drejtë t'i jepet e drejta që i takon, kurse ai që nuk ka të drejtë të kritikohet dhe të luftojë përtë rregulluar gjendjen. Partia jonë punon me njerëzit, i farkëton ata, i shëron dhe i ndreq.

Të kemi parasysh se njerëzit nuk jetojnë të mby-

llur në shtëpi, aq më tepër komunistët, të cilët jetojnë bashkë me popullin, në mes të të cilit ka edhe njerëz që nuk e kanë arritur akoma shkallën e ndërgjegjes, të kulturës e të edukatës së lartë socialiste. Te mjaft njerëz ka akoma mbeturina. Prandaj, porsa duket një mosmarrëveshje, një zënkkë e vogël, duhet të ndërhyhet menjëherë që të evitohet.

Partia jonë është në rrugë të drejtë, anëtarët e saj edukohen dhe kaliten në një fryshtë shëndoshë marksiste-leniniste. Është pikërisht kjo fryshtë shëndoshë që ekziston në Partinë tonë, e cila, me gjithë vështirësitë jashtëzakonisht të mëdha që ka kaluar dhe kalon, qëndron e palëkundur nga rruga e saj e drejtë dhe çan me sukses përpara, duke kapërcyer çdo pengesë e vështirësi.

Po të mos ishte në rrugë të drejtë Partia jonë, po të mos qëndronte fort mbi mësimet e marksizëm-leninizmit, ajo nuk do të ishte as monolite dhe e pathyeshme siç është, në Partinë tonë nuk do të kishte unitet mendimi dhe veprimi, përkundrazi do të lindnin e do të lulëzonin lloj-lloj sëmundjesh të ndryshme që do ta dobësonin. Por sëmundje të tilla në Partinë tonë nuk ka, prandaj ajo është kaq shumë e fortë dhe korr sukseze të mëdha në drejtim të forcimit të unitetit të saj ideologjik, politik dhe organizativ. Këtë unitet të çeliktë të Partisë, shokë, ta ruajmë dhe ta forcojmë vazhdimisht duke luftuar në kohë çdo shfaqje negative, sado e vogël që të jetë ajo.

Pastaj shoku Enver Hoxha foli mbi karakterin dhe natyrën agresive të imperializmit me atë amerikan në krye, mbi kontradiktat ndërimperialiste, mbi qëllimet

dhe veprimtarinë antimarksiste të Hrushovit dhe të pashuesve të tij, mbi pikëpamjet e revisionistëve hrušovi-anë lidhur me bashkekzistencën paqësore, çarmatimin, për lidhjen Hrušov-Tito, për gjendjen në disa vende të Evropës që e heqin veten socialiste, për gjendjen e pikëpamjet në disa parti revizioniste të Evropës Perëndimore dhe gjendjen në vendet e Amerikës Latine etj. dhe në fund tha:

Në situatat që po kalojmë ne duhet të qëndrojmë të fortë në vijën tonë marksiste-leniniste, të mos bëjmë lëshime, të ruajmë si sytë e ballit unitetin e Partisë, se armiqtë me të gjitha mjetet e propagandës përpinqen të depërtojnë në radhët e Partisë sonë. Po kot e kanë, sepse anëtarët e Partisë janë të kalitur, të ngritur mirë politikisht dhe ideologjikisht. Sado hollë që të punojë armiku, njerëzit tanë i kuptojnë manovrat e tij, kuptojnë dhe nuhatin kur bie zilja false. Partia, duke i ngritur vazhdimit anëtarët e vet, politikisht dhe ideologjikisht, i ka mësuar njëkohësisht edhe të gjykojnë drejt për çdo gjë.

Të kemi besim të madh në vijën e drejtë të Partisë sonë. Ne nuk jemi vetëm. Më vonë do të kemi edhe më tepër shokë përkrah nesh dhe revizionistët do të demaskohen. Natyrisht fitorja jonë nuk është e afërt, ne do të kemi akoma përpjekje me revizionistët. Veç ne jemi të sigurt se më në fund revizionizmi do të humbasë, do të dërrmohet.

Me Partinë në krye, t'i vihem i punës për të realizuar me sukses planet tona. Kjo është detyra urgjente politike, ideologjike dhe ekonomike. Duhet të kuptohet nga të gjithë se, po të realizojmë planet tona, ne

forcojmë me këtë mënyrë Republikën tonë, atdheu ynë bëhet i paprekshëm, forcoheni jo vetëm ekonomikisht, po edhe politikisht e ideologjikisht.

Çështja e realizimit të planit, pra, është jo vetëm një detyrë për çdo punonjës, po njëkohësisht është edhe kënaqësi për popullin tonë. Ne jemi vërtet një Parti e vogël, por në çështjen e madhe të socializmit nuk ka parti të madhe apo të vogël. Për triumfin e kësaj çështjeje të madhe kemi edhe ne detyrën dhe rolin tonë, jo vetëm me anën e shkrimeve, të shtypit e të propagandës, po edhe me punë konkrete, që të shohë bota ç'po bëhet te ne dhe ç'po bëhet tek ata, pse ndodh kështu te ne e pse ngjasin këto gjëra të shëmtuara tek ata. Të vërtetohet me punën tonë të drejtë se vija jonë, vija e Leninit dhe e Stalinit, kur zbatohet drejt, korr suksese, përkundrazi kur ajo shkelet, kur tradhtohet, çfarëdo maske të përdoret, rezultatet do të janë të kundërta.

Prandaj, shokë, duke pasur parasysh këto, t'i përvishemi punës me zell. E gjithë kjo punë që po bëjmë tani të na shërbejë për plotësimin e detyrave. Të punojmë sa më mirë që të realizojmë planet dhe ta meritojmë plotësisht emrin e madh që kemi si anëtarë të Partisë sonë.

Partinë ta duam si shpirtin, ta ruajmë si sytë e ballit e ta forcojmë. Këtë nc e bëjmë kur realizojmë planet dhe detyrat tona, kur i realizojmë mirë dhe si duhet ato, kur jeta në organizatat-bazë bëhet luftarake, kur njerëzit kaliten, mbruhën mirë me frymën e Partisë dhe bëhen të aftë e të gatshëm për çdo gjë. Atëherë

Partia bëhet si çeliku. Ne të tillë e kemi Partinë tonë, por të punojmë vazhdimisht që ta çelikosim akoma më tepër.

Ju uroj nga zemra, shokë, për suksese të reja në të gjitha drejtimet!

Rroftë Partia!

Botohet për herë të parë, me shkurttime, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MENDJA DHE DORA E NJEREZVE TANË DO TA BËJNË FUSHËN E MYZEQESE EDHE MË TË BUKUR E MË PJELLORE

*Fjala para kooperativistëve të Bishqethmit
në rrëthin e Lushnjës*

11 shkurt 1963

Jam shumë i gjëzuar që sot ndodhem midis jush, shokë dhe miq të dashur të kooperativës së Bishqethmit. Me rastin e konferencës së Partisë së këtij rrithi, dëshiroja të shihja disa nga sukseset e krahinës suaj. Unë u thashë shokëve të komitetit të Partisë të rrëthit se doja të veja më mirë në Gorre se sikur e ndiej veten më afër me të, sepse atje më dërguan për herë të parë Partia dhe pushteti për t'u dhënë fshatarëve tapitë e tokës. Këtë ngjarje e mbajnë mend pleqtë, po edhe të rinxjtë, edhe ata që atëherë ishin 5-6-vjeçarë dhe brohorisnin në atë kohë bashkë me prindërit e tyre, pa qenë akoma në gjendje të kuptionin ç'ishte Reforma Agrare dhe rëndësinë e saj.

Reforma Agrare, që bëri në atë kohë Partia, shokë, pas përbrysjes së bejlerëve dhe të feudalëve të vendit, ishte një nga fitoret më të mëdha të popullit tonë. Par-

tia, që e udhëhoqi popullin në Luftën Nacionalçlirimtare, në luftën më të lavdishme të popullit tonë, ndër pikat kryesore të programit të saj kishte çështjen e çlirimit të fshatarësisë, ndarjen e tokave atyre që i punonin dhe u përkisnin, se aty ata kishin lënë koskat, kishin derdhur gjakun dhe djersën etërit dhe gjyshërit e tyre për të mahur bejlerët dhe agallarët që sundonin. Të rintjtë nuk e dinë si duhet ç'kanë vuajtur të parët e tyre nga ata qenër. Partia vuri detyra qysh në fillim të çlirohej fshatarësia, se pa çlirimin e saj nuk mund të çlirohej populli shqiptar. Duhej çliruar, pra, fshatarësia jonë punonjëse nga zgjedha e feudalëve, e bejlerëve dhe e fashistëve italianë, të cilët, të ndihmuar nga politika tradhtare e Ahmet Zogut, kishin shkelur Shqipërinë dhe kishin në plan që vendin tonë të bukur, këto fusha pjellore të Myzeqesë t'i mbushnin me kolonë italiane, kurse ne, populli i këtij vendi, të ishim hyzmeqarët e tyre, ose të na degdisnin në Afrikë dhe tokat tona të bëheshin përjetë të italiane. Kjo ishte politika tradhtare e Ahmet Zogut dhe e imperialistëve italiane. Për këto arsyë, pra, duhej luftuar, që të çlirrohej fshatarësia.

Kur flitet për pavarësinë e popullit, në radhë të parë të kuptohet çlirimi i vendit nga pushtuesit e huaj, që populli të jetojë i lirë në truallin e vet dhe të bëhet zot i tokës së tij. Pra lufta për çlirimin e popullit e të vendit nga Italia fashiste ishte e lidhur dhe me luftën për zgjidhjen e problemit të tokës. Prandaj u bë Reforma Agrare fill mbas Çlirimit, e cila u krye me sukses të madh te ne.

Shumica e partizanëve në repartet e Ushtrisë sonë

Nacionalçlirimtare ishin fshatarë. Partia që e udhëhoqi këtë luftë, në radhë të parë duhej të përmbushte me doemos dëshirën shekullore të fshatarësisë pér tokë, t'ua jepte tokën atyre që e punonin, t'i ndihmonte siç i ndihmoi pas Çlirimit me kredi që ta përmirësonin tokën, që kjo të prodhonte më shumë dhe kështu të përmirësohej jeta e fshatarëve tanë dhe e gjithë popullit. Rrethi juaj, qoftë në historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ashtu edhe gjatë punës pér realizimin e Reformës Agrare, zë një vend me rëndësi historike. Në fshatrat tuaja u dhanë tapitë e para pér zotërimin e tokës.

Por shumë vjet kanë kaluar që nga ajo kohë, por nuk duhen harruar kurrë përpjekjet, vuajtjet dhe luttërat e të parëve tanë, ato t'i kujtojmë vazhdimisht. Ju shikoni si kanë ndryshuar fushat te ne pas afër 20 vjet Çlirimi aq sa një që s'ka qenë këtu gjatë kësaj kohe nuk do t'i njihte. Por si do të bëhen fushat tona, të mos themi pér 20 vjet, po bile edhe pas 10 vjetësh akoma? Kopshte të bukura do të bëhen! Mirëpo, të rinjtë e asaj kohe do të kujtojnë sikur të tilla kanë qenë kurdoherë në qoftë se ne nuk do t'u themi se ato janë bërë me djersën e njerëzve tanë, me punën dhe me përpjekjet e tyre, me sakrifica të mëdha.

Përpara këtu ishte pyll e ferra dynjaja. Po tani? Tani shikoni: këto fusha të bukura nuk u gjetën kështu të hazërtë. Prandaj që t'u duken këto të këndshme dhe t'u dhimbisen, të rinjve tanë duhet t'u tregohet e kaluara, historia plot vuajtje e popullit tonë, se kështu ata do të punojnë më mirë që të jetojnë më bukur e më shumë nga ne. Ja, miku im i vjetër, xhaxhoja që

kam këtu afër, është 80 vjeç. Ai më tha qëpari se po të ishte akoma regjimi i bejlerëve «do ta kishte paguar me kohë hoxhën». Edhe ai plaku tjetër drejt e ka kur thotë se tani e ndien veten tamam si të ri, megjithëse është 64 vjeç. Ai ka vuajtur shumë gjatë jetës, po ndien një gëzim të madh që është i lirë, që punon i bashkuar me shokët e tij në kooperativë, kjo e përtërin atë, e bën t'i shtohet jeta dhe, megjithëse është plak, prapë me duar lidhur nuk qëndron, punon, se puna i sjell gëzim dhe e bën të ri. Me punë janë bërë gjithë këto përparime jo vetëm në kooperativën tuaj po në gjithë Shqipërinë.

Rëndësinë e bashkimit të tokave në kooperativa e kuptoi mirë fshatarësia. Kolektivizimi bëri që të ndryshojë pamja e fushave tona. Jo vetëm kaq, por ndryshoi dhe vetë jeta e fshatarësisë sonë, u përmirësua si nata me ditën me të kaluarën. Ja këtë e bëri Partia. Kjo ndodhi se populli u bashkua rrëth Partisë dhe dihet se bashkimi bën fuqinë.

Një mjek që diskutoi në konferencën e Partisë foli edhe për sukseset që janë arritur pas Çlirimt në rrethin tuaj në përmirësimin e shëndetit të popullit. Ai tha se kur sëmuret njeri edhe në afërsitë e Libofshës, menjëherë mjekët gjenden pranë tyre. Po si ishte në Myzeqe përpara, të grinte mushkonja dhe ethja. Tani ato i përkasin së kaluarës, sepse sot gjendja është krejt ndryshe.

Më kënaqën shumë ato që dëgjova këtu nga kryetari i kooperativës mbi punën tuaj. Unë i kam dëgjuar edhe herë tjetër, por shoku kryetar na foli më me hollësi për punën dhe sukseset e kooperativës suaj.

Ju e dini mirë rëndësinë e tokës. Mirëpo toka të jep si ta punosh, po e punove mirë të jep, ndryshe s'të jep asgjë. Partia na ka mësuar ta shfrytëzojmë dhe ta ruajmë këtë tokë si sytë e ballit dhe çdo vit ta bëjmë më pjellore. Për këtë qëllim ajo ka dhënë udhëzime konkrete. Shteti gjer tani vetëm në rrethin tuaj ka investuar 1,3 miliardë lekë. Qindra milionë të tjerë do të jepen përsëri vetëm për rrethin tuaj, që çdo fushë këtu të bonifikohet gjer në fund, që dhe bujqësia te ju të bëhet me të vërtetë moderne. Në Myzeqe jo vetëm të mos ketë moçale, por të kompletohet sistemi i kanalizimeve, parcelimi të bëhet kudo i plotë, të shfrytëzohen në maksimum ujërat për ujitje, mekanizimi i bujqësisë të arrijë në një shkallë të lartë, të krijohen mundësitë për plehërimin e duhur të tokës, ja çfarë synon Partia këtu te ju.

Veçanërisht në rrethin tuaj janë marrë shumë masa dhe janë arritur rezultate të mira. Partia ka vendosur që në rrethin tuaj dhe të Fierit e në disa rrethe të tjera fushore, të bëhen punime të tillë që ta transformojmë sa më shpejt bujqësinë, sepse këto janë nga fuhat më të bukura e më pjellore të vendit dhe, me siguri, mendja dhe dora juaj do ta bëjnë fushën e Myzeqesë edhe më të bukur e më pjellore. Kjo tokë do të bëhet hambar, në radhë të parë për ju, sepse tokat janë tuajat. Kur keni ju, kanë edhe banorët e zonave kodrinore e malore, pra ka i gjithë vendi. Megjithëse koperativa bujqësore janë ndërtuar edhe në zonat kodrinore e malore, atje e kanë më vështirë, por edhe atje njerëzit punojnë e prodhojnë.

Kini parasysh se ju këtu, në këtë tokë keni lindur,

këtu punoni, jetoni e gjëzoni. Prandaj, po e punuat mirë tokën do të dilni faqebardhë. Mundësitë i keni të gjitha, prandaj i shfrytëzoni më së miri. Toka këtu ishte edhe më parë, po ju nuk i kishit ato mjete, atë forcë të bashkuar, diturinë dhe kuadrot që keni tanë. Mund të thotë ndonjëri se ka eksperiencë dhe i di mirë punët e bujqësisë. Për këtë ne i heqim kapelen. Po mos t'ju vijë keq, dituria juaj është e vogël në krahasim me përparimet e mëdha që ka arritur shkenca e bujqësisë sot. Dikur ju merrnit vetëm 7-8 kv/ha grurë ose misër, kurse tanë ka njerëz që marrin pa frikë 20 dhe 25 kv/ha se shfrytëzojnë mjetet që kanë dhe diturinë e fituar. Në shkollat e shumta që hapi Partia dërgoi djem e vajza të reja dhe i pajisi me diturinë dhe eksperiencën e madhe që ka arritur shkenca bujqësore në botë dhe në vendin tonë.

Por në këtë drejtim ne jemi akoma në hapat e parë, sepse jo të gjithë e kanë marrë këtë dituri dhe eksperiencë si të rinjtë e të rejat që kanë bërë shkollë. Megjithëkëtë edhe ata duhet akoma të mësojnë nga librat, nga eksperienca e më të përparuarve dhe nga praktika. Duhet pasur parasysh se dituria ka dalë nga praktika. Njerëzit e zotë e me shkollë, që kanë bërë zbulime në këtë fushë, i kanë vërtetuar ato në praktikë, për shembull sa thellë duhet hedhur fara, një metër apo 50 cm., me ç'temperaturë, sa jep me ujitje dhe sa pa ujitje, ata kanë nxjerrë rasatet që prodhojnë më shumë në disa kushte të caktuara etj., etj. Këto gjëra ata i kanë zbatuar më parë në praktikë, pastaj i kanë shkruar në libra që rinia i mëson në shkolla e në kurse dhe pastaj i zbaton në jetë. Mirëpo të rinjtë e të rejat të dëgjojnë

edhe këshillat tuaja se ju e njihni tokën, klimën, keni eksperiencë. Kështu të ndodhë edhe me agronomët dhe zooteknikët tuaj të rinj. Tani këta janë duke punuar me zell, bashkë me kooperativistët, po kur të venë 40-45 vjeç atëherë do të bëhen njerëz me të vërtetë të zotë e **me** një eksperiencë të madhe në bujqësi. Bashkë me rritjen e eksperiencës dhe të zotësisë së tyre, do të rritet edhe prodhimi ynë bujqësor. Në rrethin e Lushnjës, si dhe në kooperativën tuaj, ka mundësi të mëdha për rritjen e prodhimit.

Orientimin në bujqësi e kemi në rregull. T'i vëmë rëndësi në radhë të parë prodhimit të bukës, pastaj këtu te ju edhe pambukut. Partia na rekordon që bukës t'i vëmë kujdesin më të madh, ajo është kryesorja, jo në atë kuptim që kishin prindërit tanë të shkretë që luftonin të bënин pak bukë dhe ta hanin me qepë, sepse, për më tutje, nuk i linte beu, po tani të gjithë e dimë se buka është vërtet ushqimi kryesor, por, veç asaj, duke pasur sa më shumë bukë, do të kemi edhe nga të tjerat. Kur të vijë koha të kemi shumë misër dhe të marrim me lehtësi nga 20-25 kv/ha, do të sigurojmë edhe ushqim për bagëtitë, do të kemi edhe silazhe më shumë dhe kështu qumësht, djathë, gjalpjë e gjizë do të kemi me bollëk. Edhe bagëtisë po nuk i dhe nuk të jep.

Bukën tani ne e kemi të sigruar. Popullit tonë asnjëherë nuk i ka munguar dhe nuk do t'i mungojë buka. Edhe sikur të bëjë mot i keq si këtë vit, prapë Partia i ka marrë të gjitha masat dhe ka sigruar çdo gjë për popullin. Kohët e vështira kaluan për popullin tonë, prandaj tani fshatarësia jonë të mos mendojë vetëm për bukë e qepë, por të ketë edhe mjaft prodhime

bujqësore, blegtoreale etj., të ketë tamam si duhet të rrojë në socializëm dhe në këtë drejtim po ecën. Prandaj t'i shfrytëzojmë si duhet këto mundësi që ka krijuar Partia.

Të luftojmë për të arritur rendimente të larta për çdo kulturë. Kjo realizohet duke punuar tokën si duhet thellë me traktor, po edhe me krahë. Të rinjtë e të rejat, sidomos, të punojnë për të bërë qilizmë. Duhet të dini se ne tani kemi një forcë shumë të madhe motorike që do ta shtojmë edhe më shumë. Brenda këtij muaji do të na vijnë edhe traktorë të rinj, këtë vit do të vijnë gjithsejt 500 të tillë dhe çdo vit kështu do të ndodhë. Po kjo nuk do të thotë që ne të mos shfrytëzojmë krahët e punës, të mos përdorim në bujqësi çdo gjë që kemi në dispozicion.

Bujqësinë ne do ta mekanizojmë në çdo drejtim. Mundësi ka sidomos punimi i thellë i tokës. Për këtë qëllim kemi porositur të na vijnë 400 plugje «Martíneli» për qilizmë. Këta mekanizma duhet t'i shfrytëzoni edhe ju. Tani ju keni traktoristë edhe nga fshati juaj dhe kjo është gjë e mirë. Po kujdes t'i vini përdorimit të mirë dhe ruajtjes së makinave e veglave bujqësore, sepse këto janë si dyfeku në luftë, pa dyfek s'luftohet dot. Kështu bujqësia pa traktorë nuk ecën përpara. Traktoret që kemi t'i mbajmë e t'i përdorim mirë, ta punojmë tokën me ta në bazë të agroteknikës, prandaj u thoni traktoristëve të kenë mendjen në këtë çështje se me punën e tyre ata forcojnë kooperativën, sigurojnë fëmijët dhe brezat e ardhshëm.

Për kullimin e tokave ky vit është shumë i favorshëm. Shpëtimi i tokave nga ujët sigurohet me anën e

kanaleve e vijave kulluese. Prandaj të bëjmë sa më parë punimet në to që të na kullojnë tokat, sepse, brenda 3-4 ditëve, të tërë traktorët do të jenë në fushë, por ata s'punojnë dot në ujë e në baltë. Duhet të shpejtohem i një bujqësi se na ikën koha. Pra të merren masa për kullimin e tokave, kanalet, vijat e dyta e të treta t'i pastrojmë, ato ne i kemi hapur për kullimin e ujërave, mirëpo, kur bien shira, ujërat i mbushin me baltë, prandaj, po të mos pastrohen, djersa e derdhur dhe shpenzimet e bëra për ndërtimin e tyre, do të na venë kot. Pastrimet e kanaleve kulluese, të vijave të treta e të dyta duhet të bëhen nga kooperativistët, kurse pastrimin e kanaleve të mëdha kryesore do ta bëjë shteti me mekanizma. Të mos kërkohet që çdo gjë ta bëjë shteti. Ky do t'ju ndihmojë, ato forca që ka do t'i futë në punë për pastrimin e kanaleve, po ato që ju përkasin juve duhet t'i bëni ju.

Rëndësinë e ujitjes ju e dini shumë më mirë nga unë. Po e ujite misrin do të marrësh prodhim të madh. Ujitja është një mjeshtëri më vete. Në qoftë se tokës i fut ujë pa masë, e mbyt dhe kështu prish prodhimin. Prandaj ujët e kanaleve, për ndërtimin e të cilave shteti ka harxhuar shuma kolosale, të përdoret si duhet se kështu do të kemi fitime të mëdha. Bima ujin e do në masën e caktuar. Unë nuk them që ujin ta masim me gram, po them që të mos ujitim me përmbytje, po me brazda, megjithëse kjo mënyrë do një çikë zanat dhe punë më shumë. Një gjë e tillë duhet pasur më shumë kujdes sidomos për misrin dhe pambukun që janë kultura delikate. Disa thonë se misri është bimë e fortë, po e mbolle bëhet vetë. Ai mund të rritet edhe vetë, por

ne duam të marrim sa më shumë prodhime prej tij, prandaj kujdesemi, përveç shërbimeve të tjera, edhe për ujitjen.

Ka rëndësi të madhe gjithashtu çështja e farës. Po hodhe në tokë farë të mirë, edhe prodhimi do të jetë i mirë. Prandaj farërat të ruhen si duhet e të mos përzihen llojet e tyre. Kur korret prodhimi të tregohet kujdes i madh për sigurimin e farës. Veç asaj, në një siperfaqe të caktuar toke të hidhet aq farë sa duhet. Ka fshatarë që nuk hedhin sasinë e duhur të farës, duke menduar se shkon dëm. Përkundrazi një gjë e tillë dëmton. Prandaj futni për çdo hektar jo më pak se 2 kv farë grurë, se kështu do të marrim 16-17 kv/ha. Kush hedh më pak, dijeni se ai i bën hile vetes. Partia nuk do që juve t'ju vejë dëm fara dhe të varfëroheni, po ju këshillon të hidhni farë sa duhet që të merrni rendimente të larta, të kemi më shumë të ardhura. Më përpara kishte arsyë që nuk hidhej sasia e duhur e farës në tokë, se njerëzit nuk kishin të hanin bukë, kurse tani s'ka frikë njeri për bukë. Prandaj i hidhni farë sa i duhet tokës që t'ju mbushet hambari.

Sikurse tha kryetari juaj, në pambuk ju keni arritur ta stabilizoni rendimentin. Kjo është një gjë e mirë dhe tregon se ju keni marrë njohuri për rritjen e kësaj kulture dhe dini që pambuku jep të ardhura të mira. Po duhet të dini gjithashtu që çështja e pambukut nuk ka kufi. Gjer tani ju keni marrë 8-11 kv/ha. Ka skuadra të ju që vjet kanë marrë 16 kv/ha dhe sivjet janë zotuar të marrin 19 kv/ha. Por pambuk mund të marrësh edhe 30 e 35 kv/ha edhe 40 bile, dhe do t'ia arrijmë kësaj edhe këtu te ju, mbani mend.

Mbi rendimentet ne do te flasim me mirë në te ardhmen kur te sigurojmë plehrat kimike. Do te vijë koha kur vetë ju do te thoni: «More, sa shumë jemi mburrur atëherë kur merrnim vetëm 8 ose 10 kv/ha pambuk, dhe atyre që merrnin 15-16 kv/ha u dukej kjo një shifër e lartë, kurse tani ne marrim 20-25 dhe 30 kv/ha!». Me siguri ne do ta arrijmë këtë, sepse ju në radhë te parë do te perfeksiononi me shumë agro-teknikën, do te dini çfarë shërbimesh i duhen pambukut etj. Mbi te gjitha, shokë, do te ndihmojë për rritjen e prodhimeve plehu që do te kemi atëherë, për prodhimin e te cilit këtë pesëvjeçar do te ngremë një uzinë te madhe plehrash azotike në Fier. Tani ne jemi duke ndërtuar edhe uzina për prodhimin e plehrave fosfatike. Te tilla plehra tani i importojmë në sasira te vogla dhe japim nga pak vetëm për pambuk. Kur te mbarojmë uzinat tona, atëherë do tu hedhim pleh bimëve në sasinë e duhur. Tani mekanizma kemi, tokën e kemi shumë te mirë, ujet për ujitje çdo vit e më shumë e shtojmë, njerëzit i kemi te mirë, te zgjuar, te mençur, vuajtjet e së kaluarës na kanë bërë te mprehtë, djemtë e bejlerëve e te agallarëve ishin te trashë e parazitë, kurse djemtë e vajzat e popullit, te fshatarëve tanë e kanë syrin pishë, ata janë te zotët e punës. Prandaj me te gjitha këto kushte në te ardhmen edhe në bujqësi do te bëjmë hapa te mëdhenj përpara.

Me këto suksese që kemi arritur, ne nuk jemi te kënaqur, prandaj duhet te luftojmë që te ecim edhe më përpara. Ka njerëz që tani thonë sa i lumtur jam, shtëpi ndërtova, bukë kam, prandaj te rrojë Partia. Por në te ardhmen mirëqenia do te rritet më shumë,

do të dalin gjëra edhe më të mira dhe do të kërkosh t'i blesh. Këto ne do t'i bëjmë me punën, me djersën e klasës punëtore e të fshatarësisë sonë.

E ardhmja jonë, pra, do të jetë e bukur. Prandaj vini të gjitha forcat në punë, kryeni me zell çdo detyrë dhe punoni. Në radhë të parë, të punojnë të rinjtë dhe të rejat, po edhe brezi ynë nuk do të mbetet pas. Unë di se shumë nga ju kanë bërë edhe nga 500 ditë-punë në vit. Kryesorja është që të rinjtë e të rejat të jenë në ballë të punës. Punoni kurdoherë në mënyrë të organizuar, mban parasysh çështjen e normave. Për të gjitha këto probleme kryesia dhe organizata-bazë e Partisë e kooperativës kanë përgjegjësi të madhe, vëçanërisht në çështjen e organizimit të punës.

Kur kryesia e vjetër bëri gabime që sollën dëmtimin e kooperativës, Partia mori masa dhe në udhëheqje u vunë njerëz më të zotë, më besnikë dhe më të ndërgjegjishëm. Prandaj tani punët tuaja po ecin përrpara. Por që të ecin punët përrpara, sado i mirë të jetë kryetari i kooperativës dhe sekretari i organizatës-bazë, ata duhet të kenë vazhdimisht ndihmën e anëtarëve dhe të jenë kurdoherë nën kontrollin e popullit. «Trimi i mirë me shokë shumë», thotë një fjalë e urtë popullore. Në qoftë se çdo gjë ia var në qafë vetëm atij që drejton, ke bërë gabim të madh, sepse duhet të punojnë të gjithë, dhe më shumë ata të kryesisë, dhe shokët me përgjegjësi t'i japin llogari popullit, t'i thonë arsyet përse u bë kështu ose ashtu kjo punë, përse ndodhi ky gabim dhe si duhej bërë më mirë; të vihet në dukje kush bën faje dhe t'i paguajë ato. Po punove mirë populli të thotë ecë përrpara se nuk e ke keq, jemi

me ty, po gabove tē heq veshin dhe, po nuk vure mend, tē flak tutje. Kështu na mëson Partia.

Ajo që vendos në kooperativë është asambleja. Kryesia duhet tē punojë në bazë tē vendimeve tē Partisë dhe tē asamblesë. Natyrisht kryesia merr vendime në bazë tē udhëzimeve tē asamblesë, po në shumë raste qysh më përpara këshillohet me ju, për një çështje thërret herë njërin, herë tjetrin, i pyet si ta bëjmë këtë ose atë punë. Mirëpo kryesia, kur bëhet fjalë për një punë dhe gjen kundërshtime nga anëtarët e kooperativës, duhet tē mendojë përse i vijnë këto kundërshtime dhe kjo nuk duhet tē konsiderohet si punë armiqësore. Për shembull kryesia vendos tē bëhet një stallë, mirëpo shumë anëtarë tē thjeshtë mund tē thonë këtë vit kjo s'ka ç'na duhet, disa tē tjerë thonë ta bëjmë më tē vogël etj. Atëherë shokët e kryesisë dhe tē organizatës-bazë duhet tē vrasin mendjen, tē thellohen dhe tē marrin masa sa më tē drejta dhe kundërshtime tē tilla tē mos i interpretojnë si punë armiqësore, por t'i vlerësojnë drejt vërejtjet dhe sugjerimet e tē tjerëve. Kur një anëtar i drejtohet kryetarit tē kooperativës ose sekretarit tē organizatës-bazë dhe i thotë se kjo dhe ajo punë nuk po na shkojnë mirë, kryetari ose sekretari e kanë për detyrë ta dëgjojnë atë me vëmendje dhe tē marrin masa për ta përmirësuar gjendjen. Prandaj tē punohet që asambleja tē jetë kurdoherë në këmbë, sepse ajo është forca kryesore në kooperativë, ajo punon dhe bën çdo gjë; kur veprohet sipas vendimeve tē saj, çdo gjë do tē shkojë mirë. Kur asambleja thotë do tē ecet kështu, ashtu duhet tē bëjë edhe kryetari.

Partia jonë është e fortë dhe kjo vjen se ajo është

e lidhur ngushtë me popullin. Po u shkëputë nga populli, dhe nuk e dëgjove këtë, mbarove. Prandaj udhëheqja e kooperativave duhet të lidhet ngushtë me popullin, me asamblenë dhe të veprojë në bazë të Statutit dhe të vendimeve të asamblesë. I kini parasysh mirëkëto gjëra.

Sidomos ata që punojnë në sektorin e llogarisë tëjenë nën kontrollin e kryesisë dhe të asamblesë, sepse kooperativa është si një familje e madhe që disponon pasuri të shumta, të cilat duhet të administrohen mirë. Ja, kooperativa juaj ka 1 650 veta, kjo nuk është një forcë e vogël për t'u drejtuar. Në kooperativë sidomos duhet mbi të gjitha drejtësi e madhe për anëtarët; llogaritari duhet t'i shënojë ndershmërisht në regjistër ditët e punës, t'i japë secilit hakun dhe jo punën e njërit t'ia regjistrojë tjetrit. Në kooperativë të favorizohen ata që duhen favorizuar, për shembull, mund të favorizohet një plak i sëmurë, ose një anëtar me shumë fëmijë dhe që ka vetëm një krah pune, por të bëhen hatëre kjo nuk duhet të lejohet. Prandaj të bëhet kujdes i madh në këtë drejtim, në mënyrë që në kooperativë të sundojë harmonia midis gjithë anëtarëve.

Doja të bëja një vërejtje. Ne burrat duhet të kemi më shumë besim te gratë, të kemi respekt të madh për to. Partia jonë lufton që të ketë barazi të plotë midis burrit dhe gruas. Gruaja përpala ishte si robëreshë, si skllave, me një fjalë gruaja nuk konsiderohej si njeri. Po vallë a ishte e drejtë kjo? Sigurisht në asnjë mënyrë jo! Atëherë përsë të mos e konsiderojmë gruan të barabartë me veten tonë? Lidhur me zotësinë e njerëzve, për gratë përpala ekzistonte një-

koncept shumë fyes se ato «janë leshgjata e mendje-shkurtëra». Po kjo nuk është e vërtetë. Tani që Partia ua ka hapur rrugët të gjithëve ky mendim është flakur-tej, dhe gratë tona janë inxhiniere, mjeke, mami, më-suese, agronomë etj. Kështu, pra, gratë janë po aq të zonjat sa edhe burrat.

Ne i shohim gratë që shkrihen në punë, mirëpo ka disa njerëz të cilët nuk janë të kënaqur që gratë bëjnë vetëm nga 180 ditë-punë në vit në kooperativat bujqësore. Jo 180 po edhe 250 ditë-punë mund të bëjnë gratë, por u duhen krijuar kushtet për një gjë të tillë; pa të llogaritim një herë edhe punët që bëjnë gratë në shtëpi? Prandaj për t'i lehtësuar ato, që të punojnë edhe më shumë jashtë, Partia kërkon nga ne, burrat, që të japim edhe ne ndihmën tonë në punët e shtëpisë.

Vendi ynë ka bërë përparime të mëdha pas Çlirimt. Gjatë këtyre dy-tre vjetëve të fundit të pesëvjeçarit ne do të ndërtojmë në gjithë Shqipërinë një numër të madh veprash industriale dhe ekonomike. Kemi një kombinat tekstili, po do të ngremë edhe një tjetër në Berat, do të punojmë për ngritjen e metalurgjisë etj. etj. Gjatë këtyre vjetëve, pra, kudo në Shqipëri do të ziejë puna. Ndërtimet e mëdha që do të bëhen do ta pasurojnë dhe më shumë vendin tonë. Do të shtohen kërkosat për gjetjen e vendburimeve të reja për naftë. Me të ardhurat që do të kemi nga zbulimi i vendburimeve të naftës e të mineraleve do të importojmë gjëra të vlefshme për nevojat e ekonomisë dhe për konsumin e përditshëm të popullit. Do të ndërtojmë hidrocentrale të tjera, që drita elektrike

me kohë të shkojë kudo, në çdo fshat, do të sjellim makina për t'ia lehtesar punët gruas, sidomos për larrjen e teshave. Të tilla gjëra do të kemi në të ardhmen.

Prandaj të mobilizohemi sa më shumë në punë e të jemi edhe vigjilentë se rreth e rrotull kemi armiq. Të gjitha këto që duam të ngremë bëhen me përpjekje. Gjatë këtyre 19 vjetëve ne kemi bërë shumë gjëra, jemi përtëritur, po ato nuk janë arritur lehtë. Kemi luftuar kundër armiqve e tradhtarëve gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, po edhe sa kemi bërë pas Çlirimit kundër diversantëve që na i kanë dërguar nga ajri, nga toka, ose nga deti! Pra gjatë mobilizimit për ndërtimin e gjithë këtyre veprave të mëdha pas Çlirimit populli ynë jo vetëm punoi, po qëndroi dhe me sy hapur, luftoi për ruajtjen e fitoreve të arritura, për të sotmen dhe të ardhmen e tij.

Situatën në vendin tonë e kemi të fortë si çeliku, armiqtë e brendshëm dridhen nga frika, se e shohin ç'bën populli kur është në fuqi dhe udhëhiqet nga Partia. Ne duhet të punojmë që të ecim dhe më përrpara. Elementët e këqij, kur gjejnë rast, hedhin ndonjë fjalë kundër, po me frikë në zemër, se e dinë çfarë i pret po bënë ndonjë gjë kundër popullit. Ne kemi armiq edhe jashtë vendit, si imperialistët, sidomos imperialistët amerikanë, dhe revisionistët jugosllavë, Hrushovët, monarko-fashistët grekë etj., të cilët bëjnë çmos të na shkatërrojnë. Po të ishte kjo në dorë të tyre ata do të kishin vepruar dhe në fakt disa herë kanë vepruar kundër Partisë dhe popullit tonë. Po nuk ua kanë arritur qëllimeve të tyre, sepse e dinë që ne jemi të fortë dhe që do ta pësojnë keq sikur të na

ngasin. Pastaj Shqipëria nuk është vetëm por ka shumë miq në botë.

Mbi të gjithë zot i vetes në atdheun e vet është populli ynë, i fortë si çeliku, i lidhur ngushtë rrëth Partisë. Po të jesh i dobët armiqjtë të shtypin, po kur je i fortë ta kanë frikën. Le të jetë e vogël Shqipëria, por çdo armik që do të tentojë të kalojë këtej, do të lërë koskat në malet e fushat tona siç i lanë fashistët italianë e gjermanë dhe lakejtë e tyre, bejlerët, ballistët, zogistët etj. Dhe kur ndodhi kjo? Atëherë kur Partia jonë ishte e re, kur nuk kishim as armë, as ushtrinë që kemi sot. E megjithatë edhe atëherë ne i mundëm armiqjtë. Po tani? Sot populli ka dhe armët dhe pushtetin në duart e veta. Kur i panë pleqtë patriotë ata «fishekët»¹ e nëndetëseve gjatë festës së 50-vjetorit në Vlorë u çuditën dhe plot besim thanë se me të tilla mjete ne grimmë çdo armik. Ushtrinë, pra, sot e kemi të fortë, sepse e fortë është Partia, i fortë është populli, se në ushtri janë djemtë tuaj që dinë çfarë ruajnë dhe përse luftojnë. Këtu midis jush ka pleq që i kanë djemtë oficerë. Ata janë djemtë e popullit dhe punojnë për të mbrojtur atdheun dhe popullin. Populli është zot tani në vendin tonë, prandaj ai i ka mësuar djemtë e tij oficerë që të dinë si e përse t'i përdorin armët.

Megjithëse ne jemi të fortë, armikun kurrë nuk duhet ta nënvleftësojmë, nuk duhet të thuash se ai nuk është gjë e ta flesh mendjen. Po armikun nuk duhet as ta mbivlerësosh dhe të kesh frikë prej tij. Të dy rastet, edhe nënvleftësimi edhe mbivlerësimi, janë të

1 Është fjala për siluret.

gabuara. Ne askujt nuk i biem në qafë, po edhe nuk lejojmë që të tjerët të përzihen në punët tona. Ne kemi thënë që do ta pësojë, kush do të na bjerë në qafë.

Prandaj të ecim përpara me siguri të madhe, të realizojmë planet, të dërgojmë djemtë e vajzat në shkolle që të bëhen të zot. Djemtë që kryejnë shërbimin ushtarak, të sjellin në fshat frymën e dashurisë për punën, përparimin, kulturën, disiplinën dhe sjelljen e mirë. Të punojmë sa më mirë për rritjen e ekonomisë sonë, të jemi vigjilentë e të forcojmë vazhdimesh unitetin se kështu nuk kanë çfarë të na bëjnë armiqtë.

E tillë është rruga jonë, shokë. Kjo është një rrugë e drejtë dhe ne do ta zbatojmë me sukses se kemi një Parti të fortë dhë një popull si çeliku. Prandaj, të rrojë Partia, të rrojë populli ynë, rrofshin kooperativistët e kooperativës bujqësore të bashkuar të Bishqethmit!

Botohet për herë të parë së pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TRAKTORISTËT JANE REPARTI PARAROJË I KLASËS PUNËTORE NË BUJQËSI

*Nga fjala para kolektivit punonjës të SMT-së
së Lushnjës*

11 shkurt 1963

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Byrosë Politike ju përshëndes nga zemra dhe ju uroj punë të mbarë, shokë të SMT-së! Bujqësia pret shumë nga ju, se ju jeni reparti pararojë i klasës punëtore në bujqësi. Pa mekanizim, pa traktorë, bujqësia nuk mund të ecë përpara dhe të ketë gjithë këto suksese të mëdha.

Mekanizimi luan një rol të madh vendimtar në bujqësi, në radhë të parë për arsyet e punimit më të mirë të tokës, të mbjelljeve, korrjeve e shërbimeve kulturore të një niveli agroteknik më të lartë, po edhe për transformimin e mentalitetit të kooperativistëve. Duke përdorur mekanizimin në bujqësi fshatarësia përisjet me shumë cilësi të nevojshme, të cilat i keni ju njerëzit e klasës punëtore, si vendosmërinë, energjinë, disiplinën, rregullin etj. Nëpërmjet jush përhapet në fshat ideologja e klasës punëtore. Kështu, pra, bash-

kë me shërbimet në ara, ju bëni edhe një shërbim të madh po aq të rëndësishëm në edukimin e fshatarësisë sonë me frymën dhe me moralin e lartë të klasës sonë punëtore. Prandaj ne mund ta ndiejmë veten të lumtur që kemi në vendin tonë një forcë të madhe traktoristësh e ndihmëstraktoristësh.

Partia, populli dhe shteti kanë bërë dhe do të bëjnë sakrifica për krijimin e SMT-ve. Me kredi e me klering kemi sjellë e do të sjellim makineri të tjera me të cilat i vihet në ndihmë bujqësisë. Fshatarësia për këtë qëllim i është mirënjohëse Partisë. Natyrisht e gjithë kjo makineri duhej të vihej në dorë të njerëzve besnikë të popullit, të mësuar dhe të edukuar nga Partia. Por përpara ishin të rrallë ata që dinin të ngisnin traktorët, se në vendin tonë nuk ka pasur të tillë, prandaj pas Çlirimt Partisë i duhej të pregetiste dhe i pregetiti kuadrot për këtë qëllim, duke marrë djem nga fshati e qyteti, duke i futur në kurse e në shkolla dhe u besoi atyre këtë armë të fuqishme siç është mekanika bujqësore.

Ashtu si në çdo fushë tjetër, edhe në përvetësimin e mekanikës veçanërisht, ne kemi pasur rezultate të mëdha, kemi krijuar një mori kuadrosh që janë bërë të zotë dhe njojin si duhet zanatin; ata jo vetëm dinë t'i drejtojnë traktorët, por dinë dhe të fshehtat e tyre, dinë të çmontojnë e të montojnë pajisje nga më të ndërlikuarat e traktorit e t'i riparojnë në çdo kohë. Me një fjalë edhe ju, shokë traktoristë, jeni si ushtarakë të zotë, specialistë, që dinë si rëndësinë teorike e praktike të armës, por edhe rëndësinë politike e ideologjike të saj. Edhe ju të tillë kuadro jeni, që e dini

rëndësinë praktike, teorike, politike e ideologjike të armës suaj, traktorit. Të gjitha këto duhej të kombinoheshin dhe kuadrot tanë të edukoheshin me një frymë të tillë, sepse vetëm kështu do të korrnin sukcese në ndërtimin e socializmit në fshat dhe traktorët do të jepnin atë rendiment që kërkon Partia.

Armën mund të dish ta përdorësh, por mund të mos e dish efektin e saj. Ju i njihni traktorët, po dini edhe anën teorike dhe anën ideologjike të rëndësisë së tyre, dini që pa traktorë nuk mund të kemi bujqësi socialiste të përparuar, nuk mund të zhvillohen si duhet bimët dhe të rriten rendimentet. Në qoftë se traktoristi nuk kupton ndërtimin dhe zhvillimin e socializmit, rëndësinë e madhe të kolektivizimit dhe rolin e vet në fshat si element i klasës punëtore, në qoftë se nuk do të kuptonte efektin politik dhe ideologjik të mekanizimit në bujqësi, atëherë nuk do të ishin arritur këto rezultate. Kur fshatari, i cili dikur në ato toka lodhej e gjakosej për të marrë me vështirësi 6-7 kv misër për ha, sheh se tani që e punon tokën me traktor merr 12-15 dhe gjer në 25 ky/ha, atëherë ai krijon me të vërtetë idenë e qartë ç'do të thotë socializëm, ç'është e ku po e çon vija e drejtë e Partisë, ç'do të thotë mekanizim. Këtë çështje Partia e ka shtruar kudo, veçanërisht te ju. Tani në radhët e traktoristëve ne kemi elementë të tillë të klasës punëtore që e kuptojnë mirë rëndësinë e gjithanshme të mekanikës bujqësore në fshat.

Ne kemi sot një forcë të madhe motorike që do ta shtojmë akoma në të ardhmen. Nga Kina po vazhdojnë të na vijnë traktorë të tjera për të shpejtuar

mbjelljet e pranverës. Ja Miti Bozoja mori shënim për këtë çështje, megjithëse për Lushnjën ai mund të mendojë në fund fare, për të mos e quajtur ndonjëri lokalist! Po s'ka kush t'i thotë lokalist, Bozoja e di se direktiva e Partisë është që Fieri dhe Lushnja janë nga rrëthet bujqësore më të rëndësishme, prandaj këtu duhet shtuar dhe do ta shtojmë mekanizimin.

Para se të vija këtu, bisedova pak me drejtorin e SMT-së suaj, i cili më foli me entuziazëm se SMT-ja juaj traktoristët i ka të kualifikuar e bashkë me ta edhe ndihmësit e tyre janë njerëz të preqatitur mirë dhe me perspektivë.

Kuadri është një faktor me rëndësi të madhe në çdo sektor e veçanërisht te ju. Prandaj kësaj çështjeje i vini kujdes më të madh. Çdo traktorist të jetë mjeshtër i përsosur jo vetëm për traktorin që ka në ngarkim, por të jetë njëkohësisht edhe specialist për punën që bën. Prandaj, përveç kurseve për kualifikimin si traktoristë, zbatoni të gjitha këshillat e domosdoshme agroteknike lidhur me punimin e tokave, me shërbimin që u duhet bërë kulturave bujqësore, që punën të mos e bëni në mënyrë mekanike, por të kuptoni mirë edhe anën teorike të saj. Për shembull, përsë toka duhet punuar kaq thellë, përsë duhet mbjellë në këtë kohë dhe jo më vonë, përsë kjo bimë duhet prashitur kështu ose ashtu etj. Partia ju rekomandon të bëheni specialistë edhe në këtë drejtim, domethënë jo vetëm për veten tuaj, po edhe për fshatarët.

Ju jeni elementë të përparuar, tani në fshatra kemi edhe agronomë e teknikë të mesëm bujqësorë më shumë, po për punën tuaj ju duhet të jeni vetë teknikë

dhe të tregoheni në lartësinë e zbatimit të metodave të përsosura agroteknike në punimin e tokës, në mënyrë që kooperativistët të mos kenë ankesa ndaj jush se nuk e keni punuar tokën mirë osc thellë, pra ata të mbeten të könaqur nga ju. Ndërgjegjja dhe niveli juaj agroteknik të jenë shumë më lart nga ai i fshatarëve. Me këtë që them është lidhur edhe interesë i përgjithshëm edhe interesë juaj personal, interesë i familjes suaj që ka lidhje me punimin dhe me prodhimin.

Është mirë tani që traktoristët bëjnë pjesë vetë në kooperativat bujqësore, ku secili ka edhe pjesëtarët e familjes që janë anëtarë të kooperativës. Tani ne synojmë që traktoristët të jenë vendës. Atje ku punon brigada ose traktori, edhe traktoristët të jenë nga ai fshat ose lokalitet. Kjo ka rëndësi të madhe edhe për ju. Ne e dimë se ju keni bërë sakrifica, keni pasur vëشتirësi, po këto ishin të domosdoshme të bëheshin në një shkallë më të madhe përpara dhe më pak tani, por sakrifica do të duhen akoma. Sidoqoftë situatat tani kanë ndryshuar si për të gjithë edhe për ju. Tani të gjithë ju keni shtëpitë tuaja, i keni rregulluar e mobiluar ato. Po ka akoma disa traktoristë që punojnë larg në zona kodrinore ose të tjerë që nuk e kanë afër familljen dhc kanë vëشتirësi. Ka gjithashtu edhe disa vëشتirësi të tjera që u ngritën në konferencën e Partisë, si për çështjen e ushqimit, të mensave që duhet të ndreqen dhe do të ndreqen etj., me qëllim që më shumë të përmirësohet gjendja juaj.

Ju e keni të qartë që çdo vit që kalon situata jonë përmirësohet. Një nga faktorët kryesorë për këto përmirësimë jeni edhe ju. Zhvillimi i bujqësisë me ritme të

larta, së cilës Partia i ka vënë rëndësi shumë të madhe, është në rendin e ditës. Ne kemi bërë përparime në bujqësi, po akoma jemi prapa, prandaj duhet t'i vëmë forcë të madhe për ta ndihmuar edhe më shumë këtë sektor. Për zhvillimin e bujqësisë janë harxhuar gjer tani miliarda lekë dhe të tjerë do të harxhohen në të ardhmen. Në vendin tonë janë bërë punime të mëdha pér këtë qëllim, të paimagjinueshme, saqë edhe të huajtë që kanë ardhur në vendin tonë janë habitur. Megjithëse kemi bërë shumë, ka akoma edhe shumë pér të bërë nga Partia, nga shteti dhe nga fshatarësia në drejtin të tharjes së mëtejshme të kënetave e të moçaleve, të sistemimit të tokave, të hapjes së kanaleve të reja, të shfrytëzimit e të mirëmbajtjes së kanaleve ekzistuese etj. me mekanizma, pa mekanizma, me krahë dhe me plugje të térhequra me qé. Kjo është një punë e madhe që duhet të bëhet duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë, mekanizmat dhe forcat e punës.

Rëndësi të madhe ka çështja e ngritjes së nivelit teknik të të gjithë fshatarësisë sonë. Ne duhet të punojmë që çdo fshatar, çdo kooperativist të bëhet specialist pér çështjet e bujqësisë. Nuk dua të them me këtë që ata të bëhen me universitet, por të ngrenë vazhdimisht nivelin e njohurive të tyre. Sigurisht teknikët e bujqësisë, agronomët dhe veterinerët luajnë e do të luajnë një rol të madh në përhapjen e së resë në fshat. Po përsëri sado shumë teknikë, mekanizma dhe specialistë të bujqësisë që të kemi në fshat, prapëseprapë në rast se nuk ngrihet niveli teknik e kulturor i gjithë masave kooperativiste, ne nuk do të arrijmë ato rezultate që dëshirojmë. Prandaj, me gjithë rezultatet e mi-

ra që kemi arritur gjer tani, ky është një problem i madh për të cilin duhet punuar edhe më tej, sepse, në qoftë se fshatarësia nuk kupton, fjala vjen, si duhet rëndësinë e kanaleve, mirëmbajtjen, pastrimin e shfrytëzimin si duhet të ujit që sjellin ata, ne nuk do të kemi ato përfitimi që parashikojmë. Po edhe një gjë aq e komplikuar sa të mos e kuptojë fshatari ynë sot kjo nuk është. Është e vërtetë se çështja e ujitjes është një teknikë që të mëson ta përdorësh ujin si duhet, ashtu si dini të përdorni edhe ju vajrat e grasot, të cilat po të mos ia hedhësh në rregull motorit, traktori prishet, nuk punon; kështu edhe fshatari, në qoftë se nuk di sa ujë t'i hedhë bimës, mund ta lërë pa e ngopur atë dhe ajo thahet, ose e kundërtë e mbyt. Prandaj duhet të praktikohet kudo ujitja me brazda. Një metodë e tillë nuk është diçka që s'mund të mësohet. Po si në çdo gjë edhe për këtë duhet kujdes, disiplinë, rregull e organizim në punë, sepse vetëm kështu do të realizojmë detyrat e zotimet e marra dhe në këtë drejtim kemi shumë për të bërë.

Bujqësisë duhet t'i kushtojmë një vëmendje shumë të madhe, se ajo është baza e ekonomisë sonë, na sigenon bukën dhe lëndën e parë për industrinë tonë. Ne duhet të luftojmë për sigurimin e bukës në vend. Sigurisht, gjersa ne të prodhojmë sasira të mjaftueshme drithi do të importojmë. Por Partia dhe shteti tani kanë krijuar rezerva për ditë të mira dhe të këqija. Por ne duhet të prodhojmë më shumë drithë dhe mundësitet tani i kemi: mekanizimin, ujitjen, kullimin e tokave etj. Tani ne do të ndërtojmë edhe uzinën e plehrave azotike në Fier, dhe atëherë, kur të kemi pleh, jo do ta

dyfishojmë, por do ta trefishojmë prodhimin. Megjithatë gjersa të prodhojmë vetë plehra, ne i kemi të gjitha mundësitë t'i rritim edhe më tepër rendimentet.

Duhet të rritim gjithashtu edhe rendimentet e bimëve industriale, jo vetëm për të siguruar lëndën e parë për fabrikat tona, po edhe për eksport. Të tjerët kanë nevojë për pambuk, të prodhojmë, pra, më shumë që të eksportojmë për të përballuar shpenzimet tona të importit. Prandaj sa më shumë prodhime të shesim aq më tepër e zgjerojmë tregtinë tonë të jashtme dhe mundësitë i kemi ta bëjmë këtë. Le të ecet në shembullin e atyre skuadrave që marrin rendimente shumë të mira në kooperativat bujqësore. Ju e dini se ka parcela mbi ujë ku është arritur të merren gjer në 18 kv/ha pambuk, bile edhe në Maminas, në afersitë e Tiranës që ishte një rrreth i prapambetur. Kjo do të thotë se bujqësia jonë, sidomos në disa kooperativa, ka ecur përpara. Në këtë drejtim ne kemi mundësi të mëdha, prandaj ta zhvillojmë edhe më shumë bujqësinë.

Me gjithë vështirësitë që kemi pasur në çështjet ekonomike kemi dalë mirë. Vija e drejtë e Partisë ka bërë që punëtorët e fabrikat të mos mbeten pa punë, popullit të mos i mungojnë artikujt ushqimorë, si buka, mish, perimet etj. Në vendin tonë çdo gjë ka shkuar në rregull, populli është furnizuar pa ndërprerje, në treg nuk ka vështirësi dhe në masat ka entuziazëm të madh; populli ndihet i sigurt në atdheun e tij dhe ka besim të plotë në vijën e drejtë të Partisë. Në situatat e vështira, kur na bëhet luftë e hapur dhe e nëndheshme, blokadë e hapët dhe e fshehtë nga ana e imperialistëve

dhe e armiqve që kemi në kufi, si edhe nga revizionistët, që nga Titoja e gjer te N. Hrushovi, ne duhet të punojmë edhe më mirë akoma. Komunistët që merren me sektorin e tregtisë të përpiqen dhe t'i kuptojnë këto gjëra edhe më shumë se të tjerët.

Ndryshe ndodh në vendet revizioniste, të ashtuquajtura të demokracisë popullore të Evropës, që dikur kanë qenë më të pasura. Sot, në çështjet ekonomike, si në industri, ashtu edhe në bujqësi, po kalojnë një krizë të madhe e të rëndë. Kjo krizë është pasojë e vijës revizioniste të udhëheqjeve të tyre, e vijës së tyre tradhtare antimarksiste. Masat e popullit dhe të komunistëve e kuptojnë dhe e shohin ku i çon kjo vijë që zbatojnë grupi i N. Hrushovit dhe të gjithë ata që e pasojnë. Ata e shohin dhe e kuptojnë se kjo vijë shkon në kundërshtim me interesat e socializmit dhe të komunizmit, se ata që janë në fuqi s'janë veçse disa klika që qëndrojnë kundër dëshirës së popullit. Prandaj masat dhe komunistët në këto vende rezistojnë dhe luftojnë dhe kjo bëhet në mënyrë të gjithanshme. Në Çekoslovaki, për shembull, industria tani ndodhet në vështirësi për mungesë të qymyrit dhe të energjisë elektrike, saqë edhe në Pragë nuk ka drithë të mjaftueshme dhe rrugët ndriçohen pjesërisht edhe me gaz. Buka atje ka filluar të shpërndahet me triska, kurse në vendin tonë bukë ka satë duash. Mish atje nuk gjen, te ne ka vazhdimisht. Kështu mungojnë me radhë frutat, zarzavatet etj. E njëjta gjë ndodh në Poloni, në Rumani, në BS ku nuk prodhohet sa duhet, sepse të gjitha ndryshimet organizative që ka bërë dhe bën N. Hrushovi me shokë janë ndryshime në rrugën kapitaliste, prandaj kjo gjë ka

krijuar një rezistencë edhe në fshatarësinë e këtyre vendeve. Kjo është një shfaqje e pakënaqësisë së punonjësve për vijën e udhëheqjes. Punonjësve me këtë vijë po ju errësohen perspektivat. E gjithë kjo situatë ka bërë që në këto vende të ngrihen çmimet herë zyrtarisht dñe herë në heshtje.

Fenomene të tilla nuk kanë ndodhur në vendin tonë dhe nuk do të ndodhin, sepse rruga jonë është e drejtë dhe kjo është një tjetër armë e madhe që vërtetton drejtësinë e vijës së Partisë sonë. Kjo është e qartë jo vetëm për ne, por edhe për të tjerët që e shohin realitetin tonë.

Pasi foli për disa probleme të gjendjes ndërkombëtare, sidomos për qëndrimet antimarksiste dhe lëshimet që i bëhen imperializmit nga grupi i Hrushovit, shoku Enver Hoxha tha:

Dje shtypi sovjetik ka botuar një artikull jashtëzakonisht të ulët, në të cilin përpinqet të trajtojë çështje teorike të disa problemeve të mëdha të kohës; mirëpo aty lihet në heshtje çështja e çlirimit të popujve të shtypur dhe të vendeve kapitaliste, nuk flitet asgjë për luftën kundër imperializmit dhe për luftën për marrjen e pushtetit. Në këtë artikull u bëhet apologjia revizionistëve jugosllavë, të cilët «kanë bërë gabime» po, sipas tij, Stalini na paska bërë gabime edhe më të mëdha! «Shokët jugosllavë, thuhet në artikull, nuk janë pa gabime, po tani ata i kanë korrigjuar prandaj duhet t'i afrojmë». Këto janë përralla, sepse vetë veprimet e revizionistëve jugosllavë vërtetojnë të kundërtën.

Në këtë artikull bëhet thirrje demagogjike për

bashkim «që të jemi të fortë, që të forcohet kampi socialist» etj. Ai përpinqet të bëjë edhe një farë autokritike kur thotë se nuk është e lejueshme që mosmarrëveshjet ideologjike që mund të lindin midis dy partive, të kalojnë dhe në politikë dhe në ekonomi. Mirëpo, kush e ka bërë një gjë të tillë? Këtë N. Hrushovi nuk e thotë. Me këtë ai do të na thotë neve që ju shqiptarët mos kërkoni më të bëj autokritikë, atë që doni ju unë e bëra në këtë formë. Por puna është që ta thotë drejt, hapur që ka bërë gabime, dhe jo me pehlivanillëqe.

Artikulli për të cilin fola është pa vlerë, plot demagogji që i shërben N. Hrushovit të bëjë propagandë për grupin e tij. N. Hrushovi kërkon pajtim, ai theksin e vë te pajtimi, kërkon të merret vesh, të bjerë në ujdi me imperialistët, po manovrat e tij nuk i ha njeri. Megjithatë atij i duhet të bëjë të tilla zigzage për të fituar kohë.

Ta forcojmë edhe më tepër Partinë, ta kalitim dhe ta ruajmë si sytë e ballit. Kjo është detyra jonë kryesore. Për këtë qëllim të punojmë që të ngrihem që ditë e më shumë ideologjikisht. Tani i kemi të gjitha mundësitë, sepse jemi më të preqatitur nga ana kulturnore, prandaj mund ta thithim më mirë teorinë tonë ngadhnjimitare, marksizëm-leninizmin. Në këtë drejtim na ndihmon shumë edhe eksperiencia 19-vjeçare, që nga Çlirimi e këtej, e Partisë, e kuadrove tanë, e popullit tonë që ka luftuar e ka kapërcyer kaq shumë vështirësi të brendshme e të jashtme, ekonomike dhe politike. Këto vështirësi dhe përpjekjet për t'i kapërcyer ato e kanë forcuar pa masë intelektin e kuadrove tanë, i kanë nxi-

tur ata të studiojnë dhe të përvetësojnë parimet bazë të marksizëm-leninizmit mbi të cilat mbështetet, punon dhe ecën përpala Partia jonë. Një punë e tillë ka krijuar mundësi kolosale që kuadrot tanë të përpiqen dhe të ngrihen sa më shumë ideologjikisht.

Imperialistët dhe revisionistët përdorin lloj-lloj manovrash për të mashtruar komunistët. Eksperiencia e luftës së përditshme me vështirësitë dhe lufta kundër armiqve, i ka kalitur njerëzit tanë nga ana politike dhe ideologjike. Njerëzit tanë, edhe ata pa shkollë, është e vështirë të mos e kuptojnë situatën politike. Puna dhe lufta ata i kanë bërë të shkathët dhc ideologjikisht qëndrojnë në pozita të shëndosha.

Një çështje tjetër me rëndësi, për të cilën doja të flisja, është puna që duhet të bëjmë të gjithë ne për realizimin e detyrave të planit. Edhe ju punonjësit e SMT-së tani duhet të keni gjithçka në gatishmëri dhe të hidheni në fushë për të filluar nga puna. Të shfrytëzoni mirë kohën, bile edhe minutat, sepse këtë pranverë kemi shumë për të bërë, bile veç planit të mbjelljeve ne duhet të mbulojmë edhe deficitet e mbjelljeve që nuk arritëm të bënim dot në vjeshtë dhe dëmet që na u shkaktuan nga dimri i keq. Prandaj mbjelljet këtë pranverë të përpiqemi t'i bëjmë në afatet optimale. Kjo ka rëndësi të madhe.

Rol të madh për realizimin e planeve në bujqësi do të luani edhe ju, shokë traktoristë. Prandaj mobilizohuni jo vetëm për realizimin e planeve, po edhe për tejkalimin e tyre, në mënyrë që të realizojmë premtimet që i kemi dhënë popullit, të përmirësojmë vazhdimisht

jetën e tij. Kjo ka rëndësi shumë të madhe, sidomos këtë vit që bëri një dimër i jashtëzakonshëm dhe i rëndë nga pikëpamja e klimës. Plani këtë vit është gjithashtu shumë i ngarkuar, po i realizueshëm. Partia dhe populli janë mobilizuar për ta fituar edhe këtë betejë të rëndësishme.

Mundësitë materiale për realizimin e planeve tona ekzistojnë, gjithashtu ekzistojnë edhe mundësitë financiare për këtë qëllim. Tani mbetet puna vetëm te mobilizimi i Partisë dhe i popullit për realizimin e planit të këtij viti dhe për të mos lënë asgjë për ta plotësuar më vonë, duke marrë parasysh se plani i dy vjetëve të ardhshëm, të fundit të pesëvjeçarit, do t'ü jetë akoma më i ngjeshur. Por realizimi në tërësi i gjithë planit tonë të tretë pesëvjeçar do të jetë një gjë madhështore, sepse me ngritjen e objekteve të parashikuara industria jonë do të forcohet shumë. Atëherë do të na duken të vogla veprat e ngritura gjer tani. Të gjitha këto vepra ne do t'i përfundojmë për të mirën e ekonomisë sonë populllore, për përmirësimin e mëtejshëm të jetës së popullit tonë dhe njëkohësisht për të provuar me fakte dhe prova konkrete se vija e Partisë sonë është marksiste-leniniste, t'u themi si miqve, ashtu edhe armiqve se Partia jonë është në binarë plotësisht të shëndoshë, prandaj ka edhe rezultate të mira në të gjithë sektorët, në bujqësi, në industri, në arsim, në kulturë etj.

Partia ka besim të plotë te ju, shokë punonjës të SMT-së, dhe duke përfituar nga ky rast që ndodheni midis jush, ju uroj suksese sa më të mëdha në punën tuaj, të korrni fitore dhe të realizoni si duhet dhe me

nder detyrat që ju janë ngarkuar, të cilat janë të mëdha por plotësisht të realizueshme! Asnjëherë mos harroni se ju jeni repart i klasës punëtore për të ndihmuar fshatarësinë tonë kooperativiste.

Rroftë Partia!

*Botohet për herë të parë, me
disa shkurtime, sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

STUDIMET KUR VIHEN NË JETË, KTHEHEN NË VLERA MATERIALE PËR TË MIREN E POPULLIT

*Nga fjaia me kuadrot bujqësorë të rrëthit dhe
me punonjësit e Stacionit Eksperimental
Bujqësor të Lushnjës*

11 shkurt 1963

Jam shumë i gëzuar që ndodhem midis jush. Unë vij për herë të parë në institutin tuaj. Komiteti Qendror e ka pasur në kujdes të veçantë punën e këtij instituti. Partia e çmon shumë punën që bëni ju që prej 15 vjetësh dhë kujdesi i saj në të ardhmen do të jetë akoma edhe më i madh. Partia është krenare që ka krijuar kushte kaq të favorshme për punë shkençore dhë që këtu, në institutin e Lushnjës, kemi një grup të mirë kuadrosh që shtohen nga viti në vit.

Nuk mund të futem në gjëra të thella se nuk jam specialist në këto çështje. Kurse ju i dini këto shumë më mirë nga ne të tjerët. Në të vërtetë edhc ne përpinqemi t'u futeni problemeve shkencore të bujqësisë, por sigurisht ne nuk i dimë aq thellë sa ju që jeni specialistë të kësaj fushe. Prandaj ne jemi krenarë që

Partia ka pregetitur çdo vit e më shumë shokë të tillë si ju të zotë për ta shpënë gjithnjë përpëra bujqësinë tonë. Referati që dëgjuam është i mirë, i plotë dhe na njohu me tematikën e problemave, sukseset dhe detyrat tuaja.

Ju e kuptioni rëndësinë e madhe që i vë Partia bujqësisë. Për këtë qëllim duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet që masat e popullit dhe sidomos fshatarësia të ngrenë nivelin e vet agroteknik. Kuptohet që zhvillimin e bujqësisë nuk mund ta bëjnë vetëm instituti juaj ose agronomët tanë, sado të shumtë që të jenë ata në numër. Ne mund t'ia arrijmë qëllimit në bujqësi vetëm në rast se agronomët dhe gjithë specialistët e bujqësisë e të bleqtorisë i vënë vetes si qëllim që diturinë dhe eksperiencën e tyre t'ia japid masës së fshatarëve për të rrëzuar te këta pikëpamjet e vjetra të trashëguara nga e kaluara në trajtimin e të gjitha problemeve bujqësore. Do të vijë dita që do të kemi më shumë kuadro dhe atëherë norma e hektarëve që ka sot çdo agronom nën mbikëqyrjen e vet do të pakësitet, kështu që çdo agronom do të ketë mundësi t'i ndihmojë më shumë fshatarët. Mirëpo agronomi prapëseprapë nuk arrin dot të jetë kudo në të gjithë sipërfaqen që ka në ngarkim. Prandaj në qoftë se ai punon me koopertivistët që këta t'i kuptojnë thellë çështjet, nuk e kam fjalën që t'i ngrejë në nivelin e tij, por t'i bëjë të aftë jo vetëm të kuptojnë rëndësinë e mësimeve agroteknike dhe të këshillave që duhen zbatuar në praktikë, po t'i kuptojnë ato edhe nga ana teorike, atëherë ne do të kemi rezultate të mira në punë.

Juve, studiuesve, ju ngarkohet detyra që të gjitha

temat që keni marrë përsipër t'i studioni rrënjesisht, duke u bazuar edhe në eksperiencën e bujqësisë së vendeve miq. Edhe eksperienca e vendeve të tjera, paravësisht se ato mund të jenë vende kapitaliste, duhet të studiohet. Kapitalistët dhe latifondistët që kanë forma zbatojnë në to një agroteknikë të përparuar, sigurisht për interesat e tyre, për të marrë sa më shumë fitime për vete. Eksperiencën dhe diturinë e tyre ne ta studiojmë dhe ta zbatojmë në kushtet e vendit tonë në dobi të popullit.

Ne të studiojmë sidomos eksperiencën e atyre vendeve që kanë tokë dhe klimë të ngjashme me ato të vendit tonë. Ja, këtu ju po studioni farën e grurit të një vendi, e cila është e mirë dhe e përshtatshme për kushtet e vendit dhe të klimës sonë. Përhapjes së varieteteve të këtij gruri dhe trajtimit të tyre ne duhet t'u kushtojmë kujdes të madh që gruri të na rritet edhe neve më së miri e të marrim rendimente të larta.

Ose të marrim prodhimin e ullinjeve. Ne duhet të punojmë për të stabilizuar prodhimin e tyre. Në të ardhmen kodrat tona do t'i mbushim me ullinj dhe përkëtë mundësitë janë. Prandaj tematikën që keni zgjedhur ta përpunoni si duhet, duke vënë të gjitha forcat, mendimet dhe dituritë tuaja në këtë çështje. Ne jemi akoma në hapat e parë të një pune të organizuar shkençore që do t'i shërbejë shumë zhvillimit të bujqësisë sonë.

Më parë ju filluat dhe përfunduat studimin e konvejerit të gjelbër. Kjo ishte një punë shumë e mirë. Natyrisht e reja futet me vështirësi, po kanë kaluar disa vjet dhe tani në Lushnjë ka 22 kooperativa buj-

qësore që e praktikojnë konvejerin e gjelbër. Kështu ndodh edhe në rrethet e tjera me këtë çështje. Ne duhet të mos kënaqemi me këtë që është arritur, por të bëjmë gjer në fund përpjekje për ta futur kudo një praktikë të tillë. Për sukseset e arritura në këtë çështje merita kryesore i takon gjithë kolektivit tuaj. Kështu mund të përmendim edhe shumë gjëra të tjera që janë bërë.

Pyeta drejtorin e më tha se nga ministria ka dhe nuk ka interesim, dhe nga ju nuk ka instistim sa duhet për vënien në jetë të studimeve që përfundoni. Prandaj duhet të ketë interesim që studimet tuaja të përfunduara të mos zvarriten nëpër sirtare dhe dollape, apo të mjaftoheni duke i bërë të njohura vetëm nëpër revista, por të merren e të zbatohen në praktikë në kooperativa të ndryshme bujqësore që kanë kushte të përshtatshme për zbatimin e studimeve që keni bërrë ju, të jepen direktiva rigorozë nga Partia dhe push-teti që të kalohet në këto forma të reja punc. Prandaj metodat e eksperimentuara këtu e që kanë dhënë prova nuk duhet të lënë mënjanë përhapjen e eksperien-cës në fusha të gjera. Në këtë drejtim edhe ne nga qendra duhet të bëjmë më shumë, po edhe ju duhet të insistoni më tepër. Një gjë të tillë e kërkon interesit i vendit tonë, prandaj edhe sedra juaj duhet t'ju nxitë në këtë çështje. Djersa që derdhni, studimet dhe shpik-jet që bëni duhet të vihen në jetë dhe të zbatohen që të kthchen në vlera materiale për të mirën e popullit. Prandaj insistimi nga ana juaj për këto çështje ka rëndësi të madhe.

Për drithërat e bukës ju thatë se po eksperimen-

toni dy lloje farërash hibride që janë në prodhim. Natyrisht puna e farës hibride nuk është një çështje e lehtë. Për këtë u fol edhe në Plenumin e Komitetit Qendror, prandaj nuk duhet lënë pas dore edhe pse kanë dalë vështirësi, të cilat duhen kapërcyer. Pra duhet bërë studimi i farërave hibride, sidomos i atyre farërave hibride që duhen eksperimentuar në vendin tonë. Për një varietet misri hibrid, u tha para ca kohe, nuk bën se u krimb, por ai u krimb vetëm atje ku pat lagështirë. Gjetkë në vendin tonë ai ka dhënë rezultate të mira. Kjo farë në Korçë është mbjellë në dy kooperativa, ku kanë marrë nga 40-45 kv/ha misër. Kjo nuk është gjë e vogël. Prandaj këtë çështje, mendoj, ta keni parasysh.

Studimet që po bëni ju tani janë gjëra me vlerë, vazhdoni me to, por mos harroni edhe ato lloje farërash për të cilat besimi është tronditur te disa. Kini parasysh se, kur ato janë mbjellë, mund të ketë qëlluar kohë e keqe, tokat ku janë mbjellë mund të kenë qenë jo të përshtatshme, metodat agroteknike mund të mos jenë përdorur plotësisht etj. Pastaj duhet pasur parasysh se atëherë ne nuk kishim kuadro, kurse tani kemi institutin dhe vetëm në rrëthin tuaj kemi gjithë këta agronomë. Prandaj një rruge të tillë duhet t'i hyjmë pa frikë, të mendojmë për bukën, të cilën duhet ta bëjmë vetë, dhe i kemi të gjitha mundësitë për këtë.

Sikundër u diskutua në Plenumin e Komitetit Qendror për intensifikimin e bujqësisë, ne kemi shembuj të mrekullueshëm që tregojnë se kemi marrë rendimente shumë të mira në grurë dhe në misër. Këto re-

zultate janë arritur sepse janë zbatuar mirë agroteknika dhe janë kombinuar si duhet eksperienca e madhe e fshatarësise së bashkuar në kooperativë, me njojuritë që u jepen fshatarëve. Sikur kjo eksperiencë të përhapet në të gjitha kooperativat bujqësore, do të kemi më shumë bukë. Për bukën ne duhet të luslojmë shumë, sepse ajo është ushqimi kryesor.

Në qoftë se vija e partisë është e drejtë ajo patjetër është mobilizuese për masat e popullit dhe jep rezultate të mira. Në qoftë se vija e partisë nuk është e drejtë, si në vendet ku në fuqi kanë ardhur revolucionistët, masat tërhiqen, demoralizohen se shohin që nuk kanë interes të punojnë dhe të prodhojnë.

Në Poloni pothuaj nuk ka fare kolektivizim të bujqësisë. Kjo ka shkaktuar një krizë të madhe ekonomike, gjë që e ka detyruar shtetin të irritë çdo vit e më shumë importimin e drithërave të bukës. Këtë vit Polonisë i duhen tre milionë e gjysmë tonë drithë dhe 8 milionë tonë patate. Mirëpo ku t'i gjejë? Prandaj ka krizë. N. Hrushovi e ka njoftuar qeverinë polake se më shumë se gjysmië milioni tonë drithë nuk i jep. Tek amerikanët Gomulka ka shkuar me kohë dhe ata gjithashtu më shumë se 600 mijë tonë nuk i japin, kurse Polonisë i duhen edhe më se tri herë më shumë. Prandaj mund të merret me mend sa e vështirë duhet të jetë gjendja ekonomike në Poloni. Kjo është arsyje që atje çmimet po ngrihen vazhdimisht. Kjo situatë bën të nevojshme që atje të bëhet një analizë e këtyre çështjeve, mirëpo kush ta bëjë? Kush merr përsipër të thotë të vërtetën përse ndodh kështu? Në Poloni parti marksiste-leniniste nuk ka, partia atje është kthyer

në një organizatë socialdemokrate. Në udhëheqjen e Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë nuk ka unitet mendimi dhc veprimi, nuk ka unitet organizativ. Në të vërtetë në udhëheqje të partisë polake është Gomulka, po brendapërbrenda partia është çorbë. Atje ka katër grupe që kanë në krye Gomulkën, Zambrovskin, Cirankieviçin dhe Ohabin dhe çdo grup mandon e punon për hesap të vet. Çështja e realizimit të planit në Poloni është tragjike. Plani i vitit 1962 nuk është realizuar. Në këto kushte duheshin marrë masa rigorozë. Mirëpo në Byronë Politike ndërsa një grup thoshte t'i njoftohej kjo gjendje partisë, tjetri thoshte plani ka qenë ireal, grapi tjetër thoshte se nuk ka qenë ireal e kështu atje s'e merr vesh i pari të dytin.

Përse bujqësia në Poloni nuk shkon mirë? Sepse atje i kanë favorizuar kulakët, që po spekulojnë me katër duar.

Po si do të shkojë puna e bujqësisë në Poloni? Sigurisht atje kolektivizimi nuk do të bëhet se në fuqi janë revisionistët, që nuk e duan ndërtimin e socializmit në fshatin polak, domethënë nuk duan që të përmirësohet jeta e fshatarëve të varfër, dhe këshillojnë që shteti polak të procedojë duke blerë tokat e fshatarëve dhe me këto të krijohen ferma shtetërore. Sipas tyre, vetëm kështu mund t'i bëhet ballë krizës në bujqësi. Marksistë-leninistët atje nuk janë dakord për t'ua blerë tokat fshatarëve dhe kërkojnë që kundër kulakëve të zbatohet via leniniste; ata janë pör krijimin e kooperativave bujqësore dhe kulakëve t'u merren tokat, sepse në Silezi ka shumë toka djerrë që u janë dhënë kulakëve, të cilët janë bërë me mjekër. Mirëpo

në udhëheqje ka një grup që i mbron kulakët, një tjetër mbron fshatarësinë e mesme, të tjerë kanë hedhur parullën për të krijuar ferma shtetërore, me një fjalë atje është një kaos. T'i blesh tokat do të thotë të veprosh si ka bërë Titoja në Jugosllavi që ka ngritur ferma të mëdha kulakësh duke blerë toka, mbasi shitblerja e tokës në Jugosllavi është e lirë. Fshatarët në këto ferma bëhen punëtorë krahu, ndërsa kulakët zgjerojnë tokat e tyre. Në Jugosllavi sot të gjitha SMT-të punojnë në favor të kulakëve. Një gjë të tillë kërkon të bëjë edhe Gomulka në Poloni. Kjo është tendenca e të gjithë vijës revizioniste. Me këtë udhëheqje që është sot në fuqi në Poloni nuk mund të ketë tjetër drejtim veç këtij kaosi që ekziston.

Ose të marrim Bullgarinë. Sa mirë ishte atje përpëra bujqësia, kurse tani ka kriza përmallra ushqimore, bile gjer te qepët. E tillë ka arritur situata në këtë vend dhe kjo është pasojë e vijës së tyre revizioniste. Klima në Bullgari është gati njëloj me klimën tonë. Kurse vendi ynë, që ka qenë më pak i përparuar se Bullgaria në bujqësi, edhe në kushtet e blokadës së egër revizioniste, nuk ka ndierë krizë, përkundrazi ne jemi shumë mirë dhe çdo vit që kalon do të jemi kurdoherë më mirë, për arsy se vija e Partisë sonë është e drejtë.

Plenumi i fundit i Komitetit Qendror theksoi se duhet t'i vihet rëndësi e madhe bujqësisë. Kjo nuk do të thotë që industriatin ta lëmë mënjanë. Në industri janë bërë dhe do të bëhen edhe pesëvjeçarin tjetër investime të mëdha, po industria jonë tani ka marrë një rrugë të mirë, planet në këtë sektor po realizohen dhe

puna është më e lehtë, ndërsa në bujqësi puna është më e vështirë. Pastaj bujqësia jonë ka qenë shumë e prapambetur, fshatarësia dikur, në të kaluarën, ka qenë mbërthyer nga mbeturinat e fortë mikroborgjeze. Megjithatë përparimet tona edhe në fshat janë të mëdha. Në bujqësi, për shembull, kemi bërë investime kolosale, prandaj t'i shumëfishojmë forcat dhe përpjekjet dhe çdo mundësi që kemi krijuar pas Çlirimt ta shfrytëzojmë në mënyrë sa më rentabël. Për këtë pesëvjeçar do të ndërtojmë uzinat e plehrave kimike. Realizimi i këtyre objekteve do të jetë një ndihmë shumë e madhe për bujqësinë tonë, prandaj t'i përfundojmë ato e të punojmë shumë më mirë nga sa kemi punuar gjer tanë.

Drejtori juaj i shtroi mirë dhe në rrugë partie problemet që keni për të kryer, prandaj nuk mendoj të zgjalem mbi këtë çështje se nuk dua të përsëris. Vëtëm dua t'ju them se nga ju Partia kërkon punë të madhe, jo vetëm këtu në institut, jo vetëm në parcelat eksperimentale, po në shkallë edhe më të gjërë. Ju keni bërë mirë që secili ka marrë në patronazh nga një kooperativë bujqësore. Por mos u mjaftoni vetëm me kaq, këtë punë ta merrni me sedër revolucionare dhe të punoni me vendosmëri komuniste, për ta ngritur kooperativën që i është caktuar secilit dhe, duke e konsideruar këtë si një punë me përgjegjësi të madhe, ta ndihmoni konkretisht kooperativën, në mënyrë që të shihen qartë rezultatet e punës suaj.

Pastaj bashkëpunënëlorët tuaj duhet të shtohen jo vetëm në rrethin e Lushnjës, po në të gjithë Shqipërinë. Ju për këtë punoni, për përparimin e bujqësisë

në të gjithë Shqipërinë. Prandaj bashkëpunëtorët tuaj duhet të jenë të shumtë dhe të mos lihen në fatin e tyre që ata të rriten vetvetiu. Ata ju duhet t'i ushqeni si dallandyshet e vogla që i kon e ëma, t'u dërgoni materiale, t'i sillni këtu, t'i çoni në fushat tuaja, t'u bëni leksione, të mbani korrespondencë të rregullt me ta dhc t'i përgjigjeni në kohë çdo kërkesë të tyre, t'u bëni pyetje dhe t'u jepni këshilla. Me një fjalë të punoni në mënyrë të tillë që t'i rritni ata me një frymë të shëndoshë bashkëpunimi shkencor, t'i lidhni sa më ngushtë me institutin dhe të jeni të sigurt se këshillat dhe vendimet tuaja do të zbatohen në terren. Unë e di se ju e bëni një gjë të tillë, por mendoj se duhet ta bëni edhe më mirë.

Përsa u përket çështjeve politike në botë, ka turbullira, po në përgjithësi gjendja ecën në favorin tonë dhe në disfavor të armiqve të socializmit dhe të komunizmit. Shumica e njerëzve në botë ushqen simpati për komunizmin, mbështet luftën për socializëm dhe urren imperialistët amerikanë dhe të tjerë. Forca e popujve, në radhë të parë forca e vendeve socialiste dhe e të gjithë popujve të tjerë të çliruar e gjysmë të çliruar ose që shfrytëzohen akoma nga kolonialistët, po të hidhet në balancë, në shumë pikëpamje është shumë më e madhe nga ajo e imperialistëve, e revisionistëve, si nga ana morale, politike, ideologjike dhe ekonomike, ashtu edhe nga pikëpamja ushtarake.

Më poshtë shoku Enver Hoxha, pasi foli mbi kontradiktat e thella në fushat politike, ekonomike, ushtarake etj., që po i brejnë përbrenda vendet imperialiste,

mbi dëmin e madh që po shkakton politika revizioniste e N. Hrushovit dhe e pasuesve të tij në lëvizjen komuniste ndërkontinentare, veçanërisht politika e tij e afrimit me imperializmin amerikan, tha:

Në këto situata ne duhet të punojmë që ta forcojmë edhe më shumë pozitën e Partisë sonë, ta ruajmë Partinë nga armiqtë, ta kemi kurdoherë, siç e kemi, të pastër, të fortë dhe më të çeliktë akoma. Partia jonë është një Parti që ka dhënë prova të shumta në situata shumë të vështira. Ajo nuk është kriuar nëpër zyra, por ka dalë nga gjiri i vuajtur i popullit tonë, nga Lufta e vështirë Nacionalçlirimtare, nga lufta e rëndë për ndërtimin e socializmit. Luftë të rreptë kanë bërë Partia dhe populli ynë për 19 vjet me radhë për ndërtimin e socializmit. Në vështirësitet e mëdha ekonomike e politike, në luftë kundër komploteve të shumta, të brendshme e të jashtme, janë kalitur njerëzit tanë, është çelikosur Partia jonë. Prandaj ne kemi suksese në rrugën tonë. Për të ardhmen e popullit tonë ta ruajmë dhe ta forcojmë vazhdimisht Partinë, të sjellim në Parti njerëz të shëndoshë të klasës punëtore, elementë nga më të mirët e fshatarësisë e të inteligjencës sonë, t'i edukojmë masat me frymën e lartë të patriotizmit socialist dhe me idetë e mëdha të marksizëm-leinizmit. Të bëjmë përpjekje që edhe ata që gabojnë ose që kanë gabuar në të kaluarën të ndreqen, asnjeri të mos ia lëmë armikut.

Me vijën e saj të drejtë Partia ka arritur suksese të mëdha në bashkimin moralo-politik të të gjithë popullit, në unitetin monolit Parti-popull. Shumë nga ata që nuk na donin në fillim, që nuk e kuptionin rrugën

dhe qëllimet e Partisë, tani na kuptojnë shumë mirë, na duan dhe punojnë me ndërgjegje, se e shohin që pikëpamjet e tyre kanë qenë të gabuara. Megjithatë duhet të jemi vigjilentë se ka edhe disa njerëz që hiqen si të mirë, po janë gjarpërinx. Njerëz të tillë t'i kemi kujdes, t'i sqarojmë dhe po bënë këq, ata e dinë mirë se drejtësia e Partisë dhe e popullit do të bjerë e pamëshirshme mbi kokën e tyre.

Të mobilizohemi që të realizojmë planet. Kjo ka një rëndësi shumë të madhe se ka lidhje me përmirësimin e jetës së popullit, me ndërtimin e plotë të socializmit, me zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhue se në vendin tonë, si edhe për t'u bërë një shembull ku të tjerët të shohin se çfarë mund të arrihet në një vend socialist që udhëhiqet nga një Parti, rruga e së cilës ndriçohet nga marksizëm-leninizmi. Dhe ja provat: në çdo drejtim, në ekonomi, në industri, në bujqësi, në arsim, në kulturë etj., ne ecim gjithnjë përpara, përmirësojmë jetën e popullit, duke u ngjitur vazhdimesht përpjetë. Një parti që nuk është në binarët e marksizëm-leninizmit nuk mund të ecë në një rrugë si kjo që ndjek Partia jonë.

Realizimi i planeve tona, pra, ka rëndësi të madhe vendimtare. Prandaj ju uroj punë të mbarë dhe suksesët në detyrat që keni përpara! Partia pret shumë nga ju. Unë kam bindjen se ju po i kryeni dhe do t'i kryeni me ndër detyrat që ju janë ngarkuar, duke vënë të gjitha forcat mendore dhe fizike për zhvillimin e bujqësisë. Punoni me kujdes sidomos në përhapjen e eksperiencës suaj ashtu si duhet në kuadrot më të ulët dhe në përgjithësi në gjithë masën e fshatarësisë.

Edhe një herë ju përgëzoj për punën që keni bërë gjer tani dhe ju uroj suksese të mëtejshme në punët dhe në detyrat tuaja të ardhshme!

Rroftë Partia!

*Botohet për herë të parë, me
disa shkurtime, sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

E VĒRTETA DO TË DALE, ASAJ S'MUND T'I VĒSHI GARDHE

*Nga biseda me përsaqësuesin e një partie
marksiste-leniniste*

2 mars 1963

Pas përshëndetjes me mysasirin fjalën e mori

SHOKU ENVER HOXHA: Artikujt e «Zhenminzhibao» dhe të revistës «Flamuri i kuq» që janë botuar dhe vazhdojnë të botohen edhe në shtypin tonë¹ kanë një rëndësi të madhe për komunizmin ndërkombëtar, për të gjithë popujt që luftojnë kundër imperializmit. Sido-

1 Është fjala për serinë prej 8 artikujsh të botuar gjatë viteve 1963-1964 në «Zhenminzhibao» dhe në revistën «Flamuri i kuq», organe teorike të KQ të PK të Kinës, përmes të cilëve shfaqen hapur pikëpamjet dhe vija e drejtë e PK të Kinës në mbrojtje të pastërtisë së marksizëm-leninizmit dhe goditet ashpër veprimtaria e revisionistëve hruščovianë dhe e pasuesve të tyre si tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe përcarës të unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Këta artikuj gjatë asaj periudhe u botuan të plotë edhe në shtypin tonë.

mos për çështjen e socializmit, si të thuash, ata janë dritë udhëheqëse për komunistët marksistë dhe për patriotët në botë.

Në këto situata, kur revisionistët modernë hoqën maskat për të goditur marksizëm-leninizmin, vija e PK të Kinës, e udhëheqjes së saj dhe e shokut Mao Ce Dun në luftën e drejtë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, për sqarimin e problemeve të mëdha ndërkombëtare dhe ideologjike, për përkrahjen e lëvizjeve nacionalçlirimtare të popujve, ka qenë një fener ndriçues për komunizmin ndërkombëtar. Ne mendojmë se artikujt kanë pasur dhë do të kenë akoma më shumë reperkusione të thella, në radhë të parë në vendet e ashtuquajtura të kampit socialist ku sundojnë klikat revisioniste, por që rrënjet i kanë mbi ujë. Sado bllokadë që t'u bëjnë revisionistët këtyre artikujve, sado radiostacione të fuqishme që të ngrenë për të penguar dëgjimin e Radio Pekinit, e vërteta do të dalë, asaj s'mund t'i vësh gardhe.

Në Partinë dhe në popullin tonë janë pritur me entuziazëm këta artikuj, në të cilët ne shohim drcjtësinë e vijës së PK të Kinës dhe unitetin e plotë të pikëpamjeve të saj me Partinë tonë të Punës.

Komunistët shqiptarë janë prekur veçanërisht nga mbrojtja që u ka bërë e u bën PK e Kinës Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë. Nuk do të ngjasë kurrë, thotë PK e Kinës, që të përjashtohet nga lëvizja komuniste ndërkombëtare Shqipëria dhe të futen renegatët jugosllavë në këtë lëvizje. Çdo problem, gjer te çështja e Stalinit, në artikujt trajtohet me nivel të lartë.

Çështja e Stalinit është me rëndësi të madhe teoreike, politike dhe drejtësie. Ajo nuk është një çështje sentimentalizmi, po tregon vlerësimin e drejtë marksist-leninist ndaj J.V. Stalinit, këtij teoricieni të madh të marksizëm-leninizmit dhe nxënësi besnik të Marksit, Engelsit dhe të Leninit, tregon vlerësimin e drejtë që i bëhet kontributit të shquar të tij për ndërtimin e socializmit në BS dhe për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, kundër trockistëve, buharinistëve etj. J.V. Stalini mund të ketë bërë edhe gabime, por përpara veprës së tij të madhe revolucionare ato gabime janë të vogla. Vepra e tij ka rëndësi të madhe dhe i djeg tradhtarët revizionistë, të cilët, duke goditur këtë anë të drejtë të Stalinit, kërkonin të zinte vend më lehtë tradhtia e tyre. Edhe kjo, pra, është një çështje e shtruar shumë drejt nga PK e Kinës.

Mbi këto çështje dhe mbi të gjitha çështjet e tjera që përshkohen nga fryma e marksizëm-leninizmit Partia jonë është dhe do të jetë dakord. Si Parti, si Komitet Qendror, si Byro Politike dhe si komunistë ne i respekojmë PK të Kinës dhe shokun Mao Ce Dun për këtë luftë të madhe parimore që zhvillojnë aktualisht për triumfin e socializmit dhe të komunizmit dhe për pastrimin e rrugës nga ideologjia e poshtër revizioniste.

Ne kemi marrë vendim që këta artikuj t'i shtypim në broshura dhe t'i përhapim në Parti e në popull. Ato do t'u jepen shkollave e institucioneve të Partisë dhe do të jenë materiale të rëndësishme ideologjike që do të punohen thellësisht te ne. Tani jemi duke botuar në shqip edhe vëllimet me vepra të zgjedhura të Mao Ce Dunit, të cilat do t'i kenë të gjithë anëtarët e

Partisë sonë në të gjithë sektorët, si ata që punojnë në aparatet e Partisë, edhe të tjerët që punojnë në sektorët e arsimit, kulturës, të ushtrisë etj. Para ca ditësh unë shkova në mbledhjen vjetore të kuadrove të ushtrisë në Durrës. Atyre u rekomandova që, përveç materialeve që kanë në duar, të studiojnë me kujdes, të kuptojnë thellë dhe të zbatojnë në situatat tona teorinë e luftës që ka trajtuar Mao Ce Duni kundër armiqve imperialistë, kundër kapitalizmit.

Shumë bukur janë shkruar këta artikuj, ja, për shembull, sa bukur thuhet atje në një vend (*shoku Enver Hoxha ngrihet, merr buletinin e lajmeve dhe lexon citatin e mëposhtëm të artikullit teorik të revistës kineze «Flamuri i kuq»*): «Tani disa njerëz që e quajnë veten partizanë «të zhvillimit krijues të marksizëm-lenisizmit», kujtojnë se historia botërore zhvillohet sipas urdhrit të shkopit të tyre të dirigjentit dhe jo sipas ligjeve të zhvillimit shoqëror që ekzistojnë objektivisht. Këtu është me vend të kujtojmë fjalët e filozofit të njojur francez Didero, të cilave u referohej V. I. Lenini në veprën e tij «Materializmi dhe empiriokriticizmi»: «Ka qenë një çast çmendurie, kur pianoja e pajisur me aftësinë e ndijimit kujtoi se ishte e vëtmja piano në botë dhe se tërë harmonia e gjithësisë ishte përbledhur në të»¹.

Veçanërisht artikulli që doli për Moris Torezin dhe tani ky i fundit për Palmiro Toliatin, janë një pasqyrë e qartë e gjithë platformës së problemeve kyç; atje argumentohet se si janë dhe si duhen kuptuar këto

¹ Shih: V. I. Lenin. Veprat, vëll. 14, f. 33.

probleme në rrugën marksiste-leniniste, si duhet lufuar për zbatimin e tyre në jetë, si duhet t'i kuptojmë armiqjtë imperialistë, armiqjtë revizionistë dhe si duhet t'i përballojmë ata për t'i shkatërruar. Njerëz si Torezi e Toliati janë nga ata njerëz që, siç ndërrojnë këmi-shët çdo ditë, ndërrojnë edhe pikëpamjet, edhe ideo-logjitet.

Moris Torezi edhe kur ka biseduar me mua është karakterizuar nga veprime të kësaj natyre. Në fillim, kur kemi biseduar bashkë, Torezi ka qenë i vendosur kundër revizionistëve jugosllavë. Ai më ka thënë mua tekstualisht kështu: «Shoku Enver, përsa u përket jugosllavëve ata janë tradhtarë dhe nuk është nevoja të bisedojmë për këtë çështje». Një kjo. Çështja tjetër është që me PK të Italisë Moris Torezi ka pasur kontradikta që në ato momente kishin të bënin me çështjen e tezave që shtroi haptazi Palmiro Toliati. M. Torezi ishte në kundërshtim me policentrizmin që shtruan udhëheqësit komunistë italianë, ishte në kundërshtim me tezën e italianëve se kapitalizmi e ka përmirësuar gjendjen aktuale të proletariatit në Itali, në Francë e gjetkë. Kjo do të thoshte se kapitalizmi gjoja po i bënte lëshime proletariatit! Moris Torezi ka qenë në kundërshtim me udhëheqësit e PK të Italisë gjithashtu edhe për disa çështje të tjera. Tani Moris Torezi këto kundërshtime parimore që ka pasur me komunistët italianë, i ka zhdukur plotësisht. Ne një gjë kemi të qartë për të: aktualisht ai vepron sipas shkopit të dirigjentit.

Por këto kohët e fundit çështë bërë e paqartë çështja e Torezit. Ai ka dy muaj që nuk po dëgjohet fare;

është i sëmurë, është hequr mënjanë, ka kundërshtime me udhëheqjen, apo ndodhet në Bashkimin Sovjetik? Këtë nuk e dimë. Po është fakt se ai nuk u duk as në konferencën e partisë, as në kongresin e studentëve francezë. Ai jo vetëm nuk shkoi në këto mbledhje të rëndësishme politike për të folur, po nuk dërgoi as ndonjë mesazh dhe as mesazh nuk iu dërgua atij nga këto mbledhje. Një praktikë të tillë e kanë bërë zakon në PK të Francës për të mos i lënë rast borgjezisë të shfrytëzojë në favor të saj mungesën e udhëheqësve. Ju keni dëgjuar për shkrimtarin francez Aragon, anëtar i KQ të PK të Francës. Ky nuk mori pjesë në konferencën e fundit të partisë, po i drejtoi një mesazh konferencës duke kërkuar falje për mungesën e tij, sepse ishte duke shkruar historinë e BS... Edhe konferenca i bëri atij mesazh dhe e uronte për punën që kishte marrë përsipër. Këtë e them se po të ishte i sëmurë Torezi do t'i dërgonte mesazh konferencës.

Thuhet se Moris Torezin e kanë mënjanuar, po kush e ka vënë mënjanë s'dihet mirë. Thonë se e ka vënë mënjanë grupi i Valdek Roshesë dhe i Raimond Gijosë, disa thonë «është mënjanuar që të mos komprometohet gjer në fund» dhe kjo është një taktilë tjetër e N. Hrushovit, sepse njerëz të tillë si Moris Torezi revizionizmit i duhen në momente akoma më të vështira «për të evitar përqarjen në parti». Po këto të dhëna nuk janë aq të qarta. Botimi i artikujve të PK të Kinës do ta sqarojë edhe më mirë këtë çështje.

Kurse Zhak Dyklo ka folur shumë më pak, për të mos thënë aspak kundër partive tona. Në Konferencën e Moskës të vitit 1957 unë me Dyklonë ishim ulur pra-

në njëri-tjetrit. Kur foli Toliati dhe hodhi parullën mbi reformat strukturore, domethënë «mbi rrugën italiane» për në socializëm, Zhak Dykloj më kapi nga krahu dhe më tha se «Toliati është një tradhtar, një revisionist, prandaj do të ngrihem t'i përgjigjemi». Pas pushimit Dykloj u ngrit dhe e kritikoi ashpër dhe hapur Toliatin.

Tani vihet pyetja, këta shokë i kanë ndryshuar plotësisht pikëpamjet e tyre? Këto gjëra lufta dhe koha do t'i vërtetojë.

Revisionistët hruščovianë tani duhet të janë në pozita jashtëzakonisht të vështira, si brenda vendit të tyre, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Ata nuk ndryshojnë dhe tradhtarë do të janë kurdoherë. Po ne duhet të veprojmë në një mënyrë të tillë që të bëhen të padëmshëm, të kthehen në kufoma, domethënë t'ua heqim edhe atë fije autoriteti të rremë që kërkojnë të mbajnë mbi mendjen e njerëzve, duke u maskuar me parulla marksiste-leniniste. Sigurisht qëndrimet e drejta të PK të Kinës, të Partisë sonë dhe të partive të tjera që qëndrojnë në pozita të forta marksiste-leniniste, ua kanë gjerryer shumë bazamentet e tyre false. Sidoqoftë, ata armët akoma nuk i lëshojnë, po me qëndrimet tona të drejta marksiste, shpejt ose vonë, do të vijë dita që armët e tyre nuk do të shkrepin më.

Ata do të përdorin një mijë e një takтика, po është e qartë se PK të Kinës, PPSH dhe partitë e tjera që mbajnë qëndrim të mirë nuk do t'i gënjejnë dot kurrë. Është gjithashtu e qartë se në këtë debat të përgjithshëm u janë hapur sytë miliona komunistëve në vendet e tjera të botës. Mjafton që t'u hipë ca dyshimi

njerëzve dhe të thyhet miti i krijuar duke u bazuar në prestigjin e BS dhe të PK të BS dhe filli i lëmshit revizionist do të ikë vetë, revizionistët do të demaskohen e do të shkatërrohen.

Ne shohim ç'po ngjet në shumë parti në perëndim, në ato të vendeve të Amerikës Latine e gjetkë. Në një nga artikujt kinezë është shtruar shumë mirë çështja e tri debateve të mëdha në lëvizjen komuniste botërore, njëri në kohën e Leninit, njëri në kohën e Stalinit dhe i treti në ditët tona.

Tani është detyra jonë, përveç të tjerave, që të gjitha këto materiale t'i shpërndajmë në të katër anët e botës, domethënë t'ua vëmë në dorë të gjithë komuniste. Ne do të bëjmë ç'është e mundur në këtë drejtim, sepse na kërkohen materiale kudo nga miqtë dhe shokët tanë të botës, sidomos në Itali, Francë, Belgjikë, Luksemburg etj. Tani po na drejtohen letra të shumta dhe secili nga njerëzit që na dërgon letër, na shkruan edhe adresatë shumta se ku duhet t'i drejtojmë materialet që ata kërkojnë. Shumë mirë shkojnë punët tonë. Revizionistët me të vërtetë dridhen nga frika, ata, sikurse thuhet në artikull, kanë ftyrën e buallit të egër, po zemrën e kanë prej miu. Ne do të kemi luftë të madhe me ta, po do t'i shkatërrojmë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbajtur në këtë takim që gjendet në AQP

PROPAGANDA E ORGANIZUAR E PARTISË BËN QË LIGJET TË ZBATOHEN DREJT

*Fjala e mbajtur në mbledhjen e Presidiumit
të Kuvendit Popullor të RPSH¹*

5 mars 1963

Dëshiroj edhe unë të them pak fjalë rreth çështjes që diskutojmë. Në radhë të parë desha të theksoj se puna e prokurorisë për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë socialiste është e madhe dhe e rëndësishme. Kemi suksese në këtë drejtim, por duhet të punojmë akoma më tepër, se ndërtimi i socializmit nxjerr në shesh të palarat e atyre elementëve keqbërës që manifestojnë shfaqje të huaja. Shkelje të ligjshmërisë sonë socialiste nga elementë keqbërës vërehen e do të vërehen akoma në të ardhmen. Rëndësi ka fakti që në kemi shumë përparime në demaskimin dhe në parandalimin e veprimeve kundër ligjit. Kjo i detyrohet punës politike të Partisë për bindjen e njerözve me ndjenjën e respektimit të ligjit.

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi gjendjen e ligjshmërisë, në bazë të një informacioni të paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm i RPSH.

Puna politike e Partisë në këtë drejtim luan një rol të madh dhe të shumanshëm. Zbatimi i përpiktë i ligjeve arrihet para së gjithash kur këto kuptohen mirë dhe drejt nga shtetasit që i zbatojnë. Propaganda e organizuar nga ana e Partisë i shërben edukimit të popullit edhe në këtë drejtim.

Prokurori popullor në fshat disave mund t'u duket sikur s'ka rëndësi, por në të vërtetë nuk është kështu. Prokurori popullor i fshatit, natyrisht, nuk mund të ketë autoritetin e prokurorit të përgjithshëm apo të atij të rrëthit, por, në qoftë se do të zgjidhen në çdo lagje, fshat dhe qendër pune njerëz të ndershëm e të pjekur politikisht, këta do t'i ndihmojnë shumë organet e prokurorisë në përbushjen e detyrave të tyre. Prokuroret popullorë dhe këshilltarët popullorë në fshat nuk duhet të zgjidhen medoemos nga radhët e pleqve të fshatit. Këta t'i mbajmë afër, që të na jasin eksperiencën e tyre të jetës, të na këshillojnë se janë të pjekur, por pleqtë analfabetë të fshatit nuk mund ta kryejnë punën e prokurorit popullor të socializmit. Që të bëjnë punën e prokurorit njerëzit duhet të dinë të shkruajnë dhe të gjykojnë, sepse duhet të njojin ligjet, që janë të lidhura dhe rregullojnë një sërë çështjesh materiale, politike, ekonomike. Prandaj duhet t'i vihet shumë kujdes zgjedhjes së prokurorëve popullorë, sidomos në fshat. Të zgjidhen as medoemos pleq, as edhe njerëz shumë të rinj, por të tillë që të janë të pjekur, seriozë, të ndershëm dhe me një farë kulture.

Mbi të gjitha, prokurorët popullorë duhet të janë njerëz me kurajë civile, për të mbrojtur ligjet. Natyrisht duhet të zgjidhen si prokurorë popullorë njerëz

që gjëzojnë besimin e fshatarëve dhe me perspektivë për të fituar autoritetin e vërtetë të prokurorit.

Kam përshtypjen se me këta prokurorë bëhen disa konferanca, seminare e mbledhje, por në të gjitha këto punë ka formalizëm, prandaj shkojnë kot. Punonjësit e Partisë duhet të kenë kujdes të madh në këtë drejtim.

Të shikojmë, shokë, si do të na vejë puna e komisioneve të kundërvajtjeve, por të përpinqemi që ato të na jasin rezultate të mira.

Nuk më duket e drejtë praktika që kundërvajtësit t'i gjykojë kryesia apo kryetari i një organizate ekonomike, sikurse është kooperativa bujqësore, dhe jo këshilli popullor si organ i pushtetit në fshat. Këto çështje që dalin dhe gjobat që vihen për dëmet në kooperativat bujqësore, ju, shoku prokuror, duhet t'i kishit ngritur me forcë në mbledhjen e Qeverisë. Në materialin që lexova unë nuk flitet për këto gjëra, që na u thanë tani me pyetjet që ju drejtuam. Është e domosdoshme që të tregohet kujdes i madh në zgjedhjen e këshillave popullore e veçanërisht të kryetarëve të tyre. Në qoftë se komisionet e kundërvajtjeve duhet të kryejnë detyrat e tyre në bazë të kompetencave që u janë dhënë me ligj, atëherë në krye të këshillit popullor, që realizon qeverisjen e vendit në fshat, ca më tepër duhet të zgjidhen njerëz të mirë e të aftë për të drejtuar.

Kemi afër 20 vjet që jemi çliruar, prandaj ne kemi mundësi të zgjedhim njerëz të përshtatshëm për të drejtuar fshatin, njerëz të rinj, të rinj dhe nga mosha, që mendoj se do ta kryejnë mirë punën. Këta të rinj duhet të janë me shkollë, dhe mendoj se është e pamundur të mos kenë mbaruar 7-vjeçaren. Në qoftë se nuk

kanë mbaruar as shkollën 7-vjeçare, këshilltarët nuk mund të jenë të preqatitur për drejtimin e punëve të pushtetit, këta njerëz nuk mund të luajnë rolin e tyre në mënyrë të pavarur, por kalojnë nën hijen e kryesisë së kooperativës bujqësore. Kryetarët e këshillave popullore duhet të jenë njerëz të aftë për zbatimin e kompetencave të tyre dhe të mos shndërrrohen në bisht të kryesisë së kooperativave.

Që të gjykosh problemet serioze, që lidhen me shkeljet e ligjshmërisë, sidomos në fushën e ekonomisë, kjo punë është shumë e madhe. Shkeljeve të ligjit u duhet vënë fre jo vetëm nga ana materiale, por dhe nga ana morale. Në fshat ekzistojnë mjaft mbeturina patriarchale e mikroborgjeze, por zhdukja e këtyre mbeturinave duhet bërë me luftë në fushën ideopolitike, ligjore, morale etj. Në qoftë se nuk kemi njerëz të tillë, që të jenë të zotë për të luftuar edhe për edukimin moral të njerëzve, atëherë nuk do të ecim përpara me vrullin që kërkohet. Për të gjitha këto arsyet del se kanë rëndësi të madhe kuadrot në fshat. Nuk mund të thuhet se kemi neglizhuar në këtë drejtim, por ama zgjedhja e përshtatshme e kuadrove nuk është parë gjithnjë me syrin e Partisë.

Kryetarët e kooperativave bujqësore duhet të jenë njerëz të aftë e të mirë, edhe llogaritarët e kooperativave gjithashtu. Në këtë drejtim kemi arritur disa sukses, por jo gjithçka. Pra, përveç kujdesit që duhet treguar për prokurorët popullorë e kryetarët e këshillave popullore, duhet kapur mirë edhe ky kyç, mbasi kuadrot luajnë një rol të madh për forcimin e ndërgjegjes së të gjithë njerëzve që jetojnë në atë ambient shoqë-

ror. Prandaj Partisë, organeve shtetërore dhe të prokurorisë u bie barra t'i shikojnë mirë këto probleme dhe të marrin masa për zgjedhjen e njerëzve të përshtatshëm. Në këtë drejtim të jemi të vëmendshëm sidomos kur të bëhen zgjedhjet.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH që gjendet në AQP

TE FORCOJME PËRBËRJEN E PARTISË NË BAZË TË NJË STUDIMI SHKENCOR

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

15 mars 1963

Dua të bëj edhe unë disa vërejtje mbi këto çështje, për të cilat preokupohen edhe shokët. Ne bëmë mirë që e morëm në shqyrtim forcimin e mëtejshëm të përbërjes së Partisë, po mund dhe duhet ta studiojmë akoma më thellë dhe më gjerë këtë problem.

Përbërjen, rritjen, funksionet dhe forcimin e Partisë duhet t'i shohim në mënyrë dialektike, në procesin e ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Është e domosdoshme të ruajmë si sytë e ballit parimet bazë të ndërtimit të Partisë për pranimet në radhët e saj, sigurisht duke mbajtur parasysh kurdoherë që klasa punëtore të zërë vendin kryesor.

Partia ka një funksion shumë të madh: të luajë rolin udhëheqës në të gjithë sektorët e jetës së atdheut

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi përbërjen e Partisë dhe detyrat për përmirësimin e mëtejshëm të saj.

tonë. Pra në qoftë se ne nuk bëjmë parashikime dhe nuk japim orientime në çështjen e pranimeve, kjo nuk do të ishte e drejtë, do të bënim gabim. Partia duhet të drejtojë kudo, funksioni i saj është edhe drejtues, edhe edukues, ajo duhet të drejtojë gjithë jetën ekonomike, politike, kulturore, ushtarake të vendit. Organizatat e Partisë në çdo sektor të jetës së vendit tonë, punojnë, edukojnë dhe mobilizojnë masat për të ecur përpara në rrugën e ndërtimit të socializmit. Por, ashtu siç rritet dhe zhvillohet në të gjitha drejtimet jeta e vendit tonë, ashtu duhet të rritet e të zhvillohet në të gjitha drejtimet edhe organizata e Partisë, ajo nuk duhet të çalojë asnjëherë, por përkundrazi, të zgjerohet dhe të rritet duke ruajtur parimet marksiste-leniniste të saj. Ajo duhet të zgjerohet, të forcohet e të kalitet sipas një studimi shkençor, proporcionalisht me zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të jetës së vendit tonë.

Në këtë drejtim s'ka përsë të trembemi. Të tërë thanë se në fshat nuk po na ecin punët mirë e megjithatë nuk është dhënë ndonjë orientim i qartë se si të punohet për shtimin e radhëve të Partisë në fshat, se mos na prishet proporcioni! Kështu e marrim me frikë rritjen e Partisë në fshat. Ne nuk harrojmë që Partia jonë është parti e klasës punëtore. E tillë qe kjo që kur u krijua, megjithëse punëtorët në vendin tonë numëroheshin me gisht dhe në shumicën e saj dërrmuese ajo përbëhej nga fshatarë dhe në një pjesë nga intelektualë, mirëpo kjo përbërje nuk e tronditi Partinë, përkundrazi ajo i përmushi si duhet dhe në interes të klasës punëtore të gjitha detyrat që iu vunë për-

para. Tani Partia jonë, me bërthamën dhe kolonën vertebrale, klasën punëtore, është forcuar shumë. Këtë orientim ne do ta kemi kurdoherë parasysh në rritjen dhe në kalitjen e klasës punëtore. Por në çështjen e ndërtimit socialist të fshatit ne duhet të mbajmë parasysh momentin aktual. Socializmin në fshat neve nuk do të na e ndërtojnë disa punëtorë që do të pranojmë më shumë, të themi, në kombinatin e tekstileve «Stalin». Për këtë qëllim na duhet të krijojmë në fshat një organizatë-bazë partie të shëndoshë e të fortë, që të drejtojë ekonominë socialiste, sepse do të jetë kjo organizatë që do të organizojë, do të edukojë dhe do të mobilizojë kooperativistët në rrugën e socializmit.

Ose të marrim çështjen e arsimit dhe të kulturës. Këta sektorë në vendin tonë kanë ecur me hapa të mëdhenj përpara. Në ta punojnë një mori e madhe kuadrossh që kemi preqatitur dhe akoma më tepër do të preqatitim më vonë, shumë nga të cilët janë futur në Parti. Këta janë elementë me përbërje të shëndoshë, patriotë. Mirëpo në qoftë se ne shkojmë nga parimi se këta kuadro janë intelektualë, në kuptimin e vjetër borgjez të fjalës, në qoftë se ne i identifikojmë me intelektualët e vjetër që kishin plot lakra në kokën e tyre, pra, në qoftë se intelektualët që ka preqatitur Partia dhe që punojnë në frontin e artit e të kulturës, nuk i shkojmë në prizmin marksist, në qoftë se edhe në këta sektorë Partinë nuk e shkojmë në rritje, në mënyrë progresive, sipas nevojave dhe situatave, atëherë ne kemi gabuar dhe do ta frenojmë ndërtimin e socializmit në vendin tonë, do të krijojmë momente të vështira për Partinë

në sektorët e kulturës dhe të arsimit. Edhe këtu neve nuk mund të na ndihmojnë 3-4 punëtorë që mund të pranojmë më shumë, ta zëmë, në zdrukhtarinë «Misto Mame», po do të na ndihmojnë ata që do të pranojmë në organizatën-bazë të Teatrit Popullor etj. Kudo në këta sektorë ne duhet të kemi komunistë që të udhëheqin, që të edukojnë dhe të mobilizojnë punonjësit në tërë veprimtarinë e tyre, sipas frysë së Partisë. Kështu mund të themi edhe për të gjithë sektorët e tjera.

Është e nevojshme të vihet në dukje se Partia ka ecur përpara, është forcuar. Këto studime, që i marrim herë pas here në shqyrtim, kanë për qëllim të na ndihmojnë për të marrë masa të mëtejshme për forcimin e Partisë si në drejtim të përbërjes, ashtu dhe të shtrirjes së saj, të edukimit dhe të rritjes së ndërgjegjes së komunistëve dhe të punonjësve. Këto masa duhet të jenë të vazhdueshme dhe të merren në bazë studimesh të bëra me kriter.

Për rritjen e Partisë mendoj se ne mund dhe duhet t'i paraqitim Byrosë Politike një studim më të mirë, të lidhur edhe me zhvillimin e popullsisë. Ky studim do të na orientojë sa njerëz punojnë në ekonomi, bile në sektorë të vecantë (sa në industri, sa në bujqësi, sa në transport etj.). Kjo është një çështje me rëndësi shkencore. Ku qëndron këtu ana shkencore? Kjo qëndron në atë që organizata e Partisë, fjala vjen në kombinatin e tekstileve «Stalin», veçanërisht sekretari i organizatës, duhet të ketë kurdoherë parasysh dhe në radhë të parë çështjen e forcimit të organizatës-bazë. Por mendoj se ai nuk e bën si duhet dhe në mënyrë

shkencore këtë punë. Përse? Në qoftë se ai thotë që në kombinat të pranohen në Parti 40 komunistë të rinj se duhen pranuar, kjo është e gabuar. Më parë ai duhet të shikojë sa anëtarë partie janë në këtë repart dhe sa në tjetrin, si shkon aktiv i pa parti i këtij reparti, a e drejtojnë dot si duhet punën anëtarët e Partisë që janë aktualisht në këtë repart, apo janë të pamjaftueshëm etj. Nga një studim i tillë i gjithanshëm sekretari i organizatës-bazë del me konkluzion që në këtë repart është e nevojshme të pranohen edhe dy anëtarë partie, në tjetrin duhet bërë një pranim etj. Duke studiuar gjendjen në çdo repart, ai do të dalë me një studim përfundimtar, të bazuar në kushtet dhe në nevojat e kombinatit «Stalin» dhe do të ndihmojë për ta bërë organizatën e Partisë një organizatë pararojë, një shtab me të vërtetë luftarak për të edukuar si duhet punëtorët. Anëtarët e rinj të Partisë do të nxirren nga aktivë i punëtorëve më të mirë. Prandaj detyra e sekretarit është që të punojë me ta, t'i edukojë, t'i aktivizojë në punë dhe t'i konsiderojë sikur janë anëtarë partie, kështu t'i pregetitë për t'u futur në Parti. Njerëz të tillë vjen koha që vetëm teserën e Partisë nuk kanë, po ata janë, si të thuash, bolshevikë pa parti. Qëllimi i organizatës së Partisë është që atje ku ajo vepron, të ngrejë peshë tërë kolektivin, ta bëjë atë me të vërtetë luftarak, ta edukojë dhe ta mobilizojë për realizimin e planit të shtetit.

Shtimi i radhëve të Partisë nuk është një qëllim në vetvete. Rreth kësaj çështjeje sekretari i organizatës-bazë duhet të llogaritë çdo gjë. Ai të ketë parasysh numrin e komunistëve të organizatës, por duhet të bëjë

edhe llogari të tjera: sa komunistë janë të sëmurë, dhe për këtë shkak largohen nga puna, sa mund të transferohen në sektorë të tjerë, sa janë të moshuar etj. Natyrisht të shkuarit nga mosha do të vazhdojnë të punojnë, po dihet se ata nuk janë në gjendje të veprojnë me ritmin e mëparshëm, kur kanë qenë të rindë. Është e vërtetë që komunistët e moshuar kanë eksperiencë dhe pjekuri të madhe, por në punën e Partisë duhet edhe hov e iniciativë. Në bazë të një studimi të tillë, byroja e organizatës dhe sekretari i saj mund të përcaktojnë sa anëtarë partie të rindë duhen pranuar dhe këta do të zgjidhen nga aktivë pa parti, të tjerët që mund t'i kenë kushtet, le të mos pranohen tanë për tanë, por të mbahen afër Partisë. Në qoftë se ecim me një kriter të tillë, atëherë e ruajmë të shëndoshë Partinë, si udhëheqëse dhe organizatore e masave punonjëse.

Nga një studim i tillë dalin orientime të sakta. Këto janë orientime dhe jo plan. Nuk duhet të na ndodhë si në vitin 1948, kur punohej me plan për rekrutimet në Parti, atëherë ne nuk kishim eksperiencën që kemi sot. Prandaj, Byroja Politike, drejtorisë së organeve të Partisë, Rinisë e Bashkimeve Profesionale dhe komiteteve të Partisë duhet t'ua japë një orientim të tillë mbi shtimin e radhëve të Partisë.

Dëshiroj tanë të bëj ndonjë propozim konkret. Pranimet në fshat nuk po na ecin si duhet, atje kemi dobësi, prandaj këtë çështje ta shohim seriozisht. Propozoj që të bëjmë një ndryshim në proporcionet për një dy-tre vjet.

Para ca kohësh ne dhamë një orientim për pranimet nga klasa punëtore. Tani është arritur që njerëz

të klasës punëtore të përbëjnë rreth 32 për qind të efektivit të Partisë. Një rezultat të tillë për kushtet tona aktuale mund ta quajmë të kënaqshëm. Me këtë nuk dua të them që tani, me pranimet nga klasa punëtore, të numërojmë në vend, po komitetet e Partisë të rretheve ta shikojnë këtë çështje në çdo organizatë-bazë. Të pranohen anëtarë atje ku duhen pranuar dhe të mos pranohen anëtarë të rinj vetëm se duhen futur punëtorë, por sipas kritereve të caktuara. Si pasojë, ne do të kemi më pak pranime në kombinatin e tekstileve «Stalin», ndërsa në një organizatë-bazë që është më e dobët, mund të pranojmë më shumë. Në qoftë se do të veprojmë kështu, atëherë mund ta shohim për një periudhë më konkretisht këtë çështje dhe të mos kemi frikë se na bie përqindja e klasës punëtore, se me këtë Parti dhe klasë të fortë punëtore që kemi tani, duke marrë parasysh edhe fshatarësinë revolucionare, në kë-ta tre-katër vjet, do të punojmë që ta forcojmë Partinë në fshat, pra të forcojmë çështjen e ndërtimit të socializmit në fshat.

Po si do të bëhet kjo? Në radhë të parë duke u kuptuar mirë çështja. Orientimi që po jepet nuk do të thotë që tani të shkelen kriteret, përkundrazi, pranimet si kurdoherë t'i bëjmë duke ruajtur parimet, të gjemë njerëzit më të pastër, më luftarakë, me cilësi të mira politike e morale, me aftësi më të mëdha, të zotë nga ana organizative, të dhënë pas çështjes së Partisë. Në qoftë se do të ndjekim këto kritere të shëndosha, gjatë 3-4 vjetëve ne do t'i kemi forcuar organizatat-bazë të Partisë të fshatrave, si rrjedhim do të kemi forcuar atje ekonominë socialiste dhe në përgjithësi do të kemi

forcuar gjithë Partinë. Me përbërjen e klasës punëtore që kemi tani mund të them se kjo është në gjendje ta luajë si duhet rolin e saj në udhëheqje të fshatarësisë. Por, duke vepruar kështu, nuk do të thotë që gjatë gjithë kësaj kohe të mos futim në Parti elementë nga të klasës punëtore. Për këtë është caktuar detyra që me elementët më aktivë nëpër ndërmarrjet ekonomike, të reja dhe të vjetra, brenda këtyre dy-tre vjetëve, të kri-johet një aktiv i shëndoshë i klasës punëtore, që pas-këtaj ata të futen në Parti, atëherë ne e shikojmë përsëri dhe përqindjen për klasën punëtore e ngremë përsëri.

Orientimi ynë mbi pranimet në Parti bazohet në përbërjen e popullsisë që kemi ne. Ne e ndërtojmë punën e Partisë në bazë të kushteve tona konkrete, kështu bëjmë edhe për pranimet në Parti.

Shokët drejtues të komiteteve të Partisë të rretheve, në bazë të organizimit që kemi bërë, kanë një ndarje pune, por për çështje organizative të Partisë mund të themi se interesohen fare pak. Prandaj, sekretari i komitetit të Partisë që ka sektorin e organizimit, duke bashkëpunuar edhe me sekretarin e parë dhe me shefin e sektorit të organizimit, të organizojë, kur ta shohë të nevojshme, ndonjë mbledhje për të parë, së bashku, si po ecet veçanërisht me çështjet e forcimit të organizatave-bazë në fshat. Ne duam që brenda një viti të kemi rezultate në forcimin e organizatave-bazë në fshat, prandaj një herë në gjashtë muaj sekretari i ngarkuar me këtë çështje t'i raportojë byrosë së komitetit të Partisë mbi punën që është bërë, ndërsa ne këtu në Komitetin Qendror ta shohim këtë çështje

një herë në vit, gjersa të vihet në rrugë. Mendoj të pre-frojmë për pranime në Parti në kooperativa bujqësore, për shembull, të tilla si ajo e Cakranit, që është si një ndërmarrje e madhe ekonomike, se sa të japim një orientim që të bëhen më shumë pranime në një fshat tjetër, që s'ka dhe aq rëndësi ekonomike. Çështja duhet kuptuar nga pikëpamja që kjo punë të luajë rol në ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Kjo nuk do të thotë që ne t'i lëmë pas dore fshatrat që sot s'kanë shumë rëndësi ekonomike. Dua të them që vërtet do të kemi një orientim, por të mos i qëndrojmë strikt atij. Por komiteteve të Partisë orientime duhet t'u jepen, se këto janë direktiva bazë, që do të ndihmojnë për forcimin e punës së Partisë në fshat dhe t'u themi se këto orientime nuk janë të prera. Në qoftë se fshati, për shembull, ka kaluar një çikë më shumë nga orientimi, nuk është ndonjë gjë e madhe, rëndësi ka çështja që organizata-bazë e fshatit të mos bëjë pranime formale.

Për Shkollën e Partisë ne i kemi dhënë orientimet, po mendoj që në këtë frymë që diskutojmë sot, të pre-gatitim për shokët që mësojnë atje disa referate për ndërtimin e Partisë, jo në via të përgjithshme, po për çështje konkrete që i dalin Partisë gjatë jetës së saj. Mund të hartohen disa tema të veçanta për ata që ndje-kin shkollën dhe që merren me çështjet organizative të Partisë. Gjithashtu, po për këto çështje të zhvillohen seminare me sekretarët e organizatave-bazë të fshatit dhe të qytetit, që të ngrihet niveli i sekretarit, i cili ka një detyrë të madhe për rritjen, shtrirjen dhe forcimin e Partisë.

Në qoftë se pranojmë këto orientime, atëherë t'i shqyrtojmë në Sekretariatin e Komitetit Qendror, pastaj t'ia paraqitim edhe një herë për aprovim Byrosë Politike.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

LËVIZJET E SHUMTA TË ARSIMTARËVE JANE NË DËM TË SHKOLLES

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

16 mars 1963

Para se të them disa fjalë pér kuadrot e arsimit, kam një vërejtje pér shokët e ushtrisë. Kur na paraqiten biografitë e kuadrove të ushtrisë, shkruhet aq shumë, dhe propozohen aq lëvizje, sa është vështirë të përqendrohesh. Ca më tepër kur na vijnë këtu pér shqyrtim edhc lëvizje të arsimtarëve.

Ministria e Arsimit është një sektor që interesohet pér kuadrot e saj. Këtij dikasteri i është dhënë nga Partia e drejta që, kur ka kundërshtime midis rretheve pér transferimin e ndonjë arsimtari, çështjen ta zgjidhë vetë, me kompetencë². Në qoftë se arsimtarët duan t'i drejtohen KQ të Partisë, portën e kanë të hapët. Ne

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi disa probleme që kanë dalë gjatë punës në zbatimin e instruksionit të KQ të PPSH pér kuadrin.

2 Më vonë, në kuadrin e zgjerimit të kompetencave të bazës, kjo e drejtë iu la rretheve.

jemi të detyruar ta verifikojmë e ta shqyrtojmë lutjen e një arsimtari si për të gjithë të tjerët. Arsimtarit ne nuk i vëmë pengesa për të bërë lutje, përkundrazi e shikojmë kërkesën e tij me kujdes dhe në përfundim i jepet përgjigje nëse ka apo nuk ka të drejtë. Por lëvizjen e arsimtarëve nuk mund t'ia lëmë spontaneitetit. Në këtë çështje duhet të kërkojmë rregull.

Mendoj se nuk duhet lejuar lëvizja e mijëra arsimtarëve çdo vit. Puna e mësuesit ka rëndësi të madhe. Ai duhet të lëvizë sa më pak, po të jetë e mundur të shërbejë në të njëjtën shkollë. Lëvizjet e shumta të arsimtarëve çdo vit janë në dëm të shkollës. Rretheve u janë dhënë kompetenca për të bërë transferime, por në këtë drejtim vihen re edhe hatëre, prandaj është e nevojshme të ushtrohet kontroll nga ana e Ministrisë së Arsimit. Rretheve mund t'u lihet e drejta të bëjnë propozime për lëvizje arsimtarësh, po për këtë të njoftojnë me kohë Ministrinë e Arsimit, e cila ka të drejtën të aprovojë ose jo lëvizje nga një rreth në tjeterin. Rretheve t'u lihet në kompetencë të bëjnë ndonjë lëvizje të drejtë dhe në përgjithësi të mos inkurajojmë transferimet e arsimtarëve.

Ndodhin fenomene të tjera. Në një shkollë në Elbasan ka, fjala vjen, dhjetë mësues, nga të cilët nëntë të aftë dhe një të paaftë. Mirëpo kjo shkollë përpinqet ta heqë dhe ta zëvendësojë me një të zotin, duke siguruar kështu tërë mësuesit të zotë, kurse mësuesi i dobët nga ana profesionale shkon në një shkollë ku ka dhe tre-katër të tjerë të tillë. Në këtë mënyrë, në rastin e dytë ulet cilësia e mësimdhënies. Kjo nuk është as e mirë as e drejtë.

Tani tè ne situatat kanë ndryshuar. Edhe rrethe si Librazhdi nuk janë më ato që kanë qenë. Prandaj ai mësues që cështë nga Gjirokastra dhe tani shërben në Librazhd duhet ta kuptojë dhe të mos kërkojë të vejë në Gjirokastër, sepse ka rrethe që sot për sot nuk i plotësojnë dot nevojat me forcat e veta.

Ju, shokë tè Ministrisë së Arsimit, duhet tè udhëzoni seksionet e arsimit në rrethe që tè bëjnë sa më pak transferime tè arsimtarëve dhe vetëm në rastet e domosdoshme. Për shkollat e mesme dhe tè larta aprovin e pushimit jam dakord ta bëjë Ministria e Arsimit.

Botohet për herë tè parë sipas tekstit tè nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekretariatit tè KQ tè PPSH që gjendet në AQP

**PUNA E SHOQATES SË KRYQIT TË KUQ
TË PËRQENDROHET MË TEPËR ATJE KU
MUNGOJNË FORCAT E ORGANeve
TË SHËNDETËSISE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

16 mars 1963

Kryqi i Kuq është një organizatë që ka edhe mjete financiare pak a shumë të mira për të zhvilluar një aktivitet të fryshtëm shëndetësor. Në krye të kësaj organizate ne kemi një shok të vjetër, të zot e me eksperiencë, shokun Mane Nishova.

Duke marrë në shqyrtim këtë çështje të mos shkojmë nga parimi që tërë shëndetësinë e ka mbi supe Kryqi i Kuq dhe t'i kërkojmë këtij çdo gjë. Problemin e shëndetit të popullit e ka në dorë Ministria e Shëndetësisë. Kryqi i Kuq është një shoqatë që ka lidhje ndërkombëtare, po kjo shoqatë, me mjetet dhe fondet që ka në dispozicion, mund t'i vijë në ndihmë shëndetësisë po-

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e propagandës shëndetësore nga Kryqi i Kuq Shqiptar.

pullore, jo në mënyrë të hallakatur, të shpërndarë, sa të mos shohë i pari të dytin. Kryqi i Kuq të mos shtrihet atje ku shëndetësia popullore ka forca, por, pa e mënjanuar aktivitetin e vet në vende të tilla, të synohet që puna e shoqatës së Kryqit të Kuq të përhapet atje ku forcat e shëndetësisë popullore nuk janë në gjendje të përballojnë punën. Për shembull, në kombinatin e tekstileve «Stalin» ne kemi një numër të madh punëtorësh, këtu ka 7 mjekë dhe mjaft personel tjetër shëndetësor, disa pika të caktuara sanitare etj. Atëherë ç'duhet Kryqi i Kuq në këtë ndërmarrje? Po të kemi një organizatë të shëndoshë të Kryqit të Kuq, kjo le të shtrihet edhe në ndërmarrje të tilla, po më shumë Kryqi i Kuq duhet të synojë të zhvillojë veprimtarinë atje kënuq ka mundësi hëpërhë të shkojnë organet e shëndetësisë, atje ai të përqendrojë forcat e veta.

Kryqi i Kuq të ketë parasysh edhe ndihmën e shpejtë në bazë të fondeve e të materialeve që disponon, këtë ta bëjë jo atje ku ka mjekë dhe klinika, po atje ku nuk ka. Për shembull, nëpër shkolla mund të vendoset kutia e Kryqit të Kuq dhe për dhënen e ndihmës së shpejtë mund të caktohet një nga mësuesit, i ndihmuar nga një ose dy vajza nxënëse. Po çështja është që fondet e Kryqit të Kuq të mos shpenzohen në qytete, po më shumë në fshatra ku nuk kemi gjëra të tilla.

Jam dakord që Kryqi i Kuq të bëjë propagandë shëndetësore, sepse ai ka funksionin që të aktivizojë njerëzit në këtë drejtim, po çështja është që të aktivizojë personelin mjekësor paralelisht me punën e organeve të shëndetësisë. Është detyra e organeve të shën-

detësisë që t'u thonë mjekëve të kryejnë edhe detyra të tjera, pra jo vetëm në klinikat ku shërbejnë, por të interesohen edhe për shëndetësinë në fshat. Kjo punë mund të koordinohet nga ana e organeve të shëndetësisë dhe e Kryqit të Kuq, sepse ka një numër të madh të personelit shëndetësor. Në bashkëpunim me shëndetësinë, Kryqi i Kuq duhet të përcaktojë disa drejtime të nevojshme, natyrisht jospeciale, por për propagandën shëndetësore masive, për shembull, për disa sëmundje të përhapura e shoqërore. Kuptohet që kjo nuk do të jetë një propagandë shumë e thellë shkencore, por një propagandë preventive, profilaktike. Kryqi i Kuq mund të bëjë gjithashtu propagandë për pastërtinë, për çështjen e ujërave të zeza etj. Për çështjet speciale duhet të interesohet dhe të punojë Ministria e Shëndetësisë.

Me këtë rast dëshiroj të theksoj se leksionet dhe plakatet që pregetiten për masat e popullit, ndihmojnë si të veprohet, sidomos kur mjeku është larg, por këto nuk janë të mjaftueshme. Prandaj të shkruhen e të botohen edhe libra, që flasin për rritjen e fëmijëve, për higjienën, për ndihmën e shpejtë, për disa lloj sëmundjesh etj. Një gjë të tillë ne mundet dhe duhet ta bëjmë. Këta libra, duke marrë parasysh edhe kulturën e popullit tonë, duhet të jenë të thjeshtë. Libra të tillë me karakter praktik janë të domosdoshëm, sepse ai që i blen, i ka pronë individuale në shtëpinë e tij, i hap sa herë që t'i nevojiten dhe edukohet me ta nga ana shëndetësore. Çdo njeri që është larg mjekëve dhe spitaleve, kur i lind nevoja, është i detyruar, në mos një

herë, një herë tjetër, të lexojë libra të tillë se i sëmuret një herë djali, një herë vetë dhe në këta libra mund të marrë disa udhëzime praktike se si të veprojë për luftimin e sëmundjes.

Marrëdhëniet ndërkombëtare të Kryqit tonë të Kuq t'i zhvillojmë, por të kemi parasysh që t'u presim rru-gën edhe tentativave të informacionit dhe të spiunazhit të huaj, që luftojnë të depërtojnë nëpërmjet kësaj organizate. Kryqi i Kuq Ndërkombëtar është një fondacion i madh, që mund të ketë edhe ka miliarda në dispozicion. Prandaj mund të pranohen prej tij disa ndihma, sidomos aparatura.

Përveç kësaj, të shihet çfarë mund të bëhet nga shteti dhe ç'mund të ndihmojë Kryqi i Kuq për fëmijët me të meta, si të verbër, të shurdhër etj. nëse mund të ketë për ta një institucion të veçantë. Një gjë të tillë ju, shokë të Kryqit të Kuq, shikojeni. Një institucion të këtij lloji mund ta drejtojë Kryqi i Kuq Shqiptar me mjekët dhe personelin e vet. Kjo do të ishte një ndihmë e mirë për shtetin tonë, sepse Kryqi ynë i Kuq është në gjendje të bëjë një ndërtesë dhe të mbajë një spital prej 50-60 shtretërish.

Këtu u fol edhe për dhurimin e gjakut. Mendoj se fushata për dhurimin e gjakut nuk duhet të lihet që të bjerë, të shuhet si zjarr kashte. Kjo është një çështje e madhe dhe e rëndësishme patriotike. Gjaku që dhurohet nevojitet për të shpëtuar jetën e njerëzve. Prandaj çdo dhurues gjaku duhet të dijë se cilit grup gjaku i përket.

Në parim ne e pranojmë këtë fushatë, por në praktikë, përveç masave teknike, duhen marrë edhe masa

të mira organizative. Ministria e Shëndetësisë, para se të fillojë fushata, të njoftojë Qeverinë nëse janë marrë ose jo të gjitha masat organizative.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verball i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

ARMA E SIGURIMIT ËSHTË DORA E ÇELIKTË E POPULLIT QË NDËRTON SOCIALIZMIN

*Mesazh drejtuar organeve të Sigurimit të Shtetit
me rastin e 20-vjetorit të krijimit të tyre*

19 mars 1963

Të dashur shokë,

Sot, së bashku me ju, punonjësit e organeve të puneve të brendshme, të gjithë komunistët e njerëzit pa parti, mbarë populli ynë festojnë 20-vjetorin e themelimit të Armës së lavdishme të Sigurimit të Shtetit. Më lejoni që në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në emër të gjithë Partisë dhe popullit tonë si dhe në emrin tim personal t'ju përshëndes nga zemra në këtë ditë kaq të shënuar dhe t'ju uroj suksese të reja të shkëlqyera në kryerjen e detyrave tuaja sa të vështira aq edhe fisnikë e njerëzore! Ju jeni nga luftëtarët e vijës së parë në luftën e shenjtë përmbrojtjen e fitoreve të revolucionit tonë, për sigurimin e ndërtimit socialist dhe të punës paqësore të popullit, për triumfin e çështjes së madhe të komunizmit, kundër armiqve të betuar të popullit tonë e të mbarë njerëzimit, imperialistëve amerikanë e bashkë-

punëtorëve dhe veglave të tyre të çdo ngjyre, kundër revizionistëve modernë, këtyre renegatëve të urryer të marksizëm-leninizmit.

Arma e Sigurimit lindi në zjarrin e Luftës Nacionaalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve. Atë e krijoj Partia nga gjiri i popullit dhe, tok me popullin, nën udhëheqjen e Partisë, ajo dha një kontribut shumë të madh. Sigurimi i Shtetit së bashku me armët e tjera të diktaturës së proletariatit dërrmoi rezistencën e klasave të mundura shfrytëzuese, të mbeturinave të tyre dhe të armiqve të jashtëm, siguroi qëtësinë dhe jetën e re e të lumtur në Shqipërinë sociale. Këtë armë të fuqishme e kanë njojur më së miri agjenturat dhe bandat mercenare të imperialistëve amerikano-anglezë, të revizionistëve jugosllavë, të monarko-fashistëve grekë e të tjerë, të cilëve kaq herë ajo u ka shkurtuar duart grabitqare që drejtoheshin nga atdheu ynë. Punonjësit e sigurimit janë bërë nga njerëzit më të afërt e më të dashur të masave punonjëse. Në vijën dhe udhëheqjen e drejtë të Partisë dhe në mbështetjen te populli qëndron forca e Armës sonë të Sigurimit.

Te ju, të dashur shokë të sigurimit, atdheu ka armatën e heronje të heshtur, që mishëroni cilësitet e njerëzve të rinj me moral të lartë komunist, të thjeshtë, të palodhur, patriotë të zjarrtë, trima, të gatshëm të sakrifikoni gjithçka për popullin, të dashur me të, të rreptë dhe të pamëshirshëm me armiqtë. Partia kërkon që edhe në të ardhmen ju t'i kushton popullit gjithëshpirtin dhe zemrën tuaj, ndërsa armiqve t'u rezervoni vetëm grushtin dërrmues!

Ndërtimi i socializmit në vendin tonë po përparon vazhdimisht, planet e shtetit po realizohen dhe po tejkalohen, jeta e popullit është përmirësuar e do të përmirësohet edhe më tej në të ardhmen. Vështirësitetë dhe pengesat që na kanë ngritur armiqtë, janë kapërcyer dhe do të kapërcehen në saje të patriotizmit të masave punonjëse dhe të udhëheqjes së drejtë e largpamëse të Partisë.

Misioni juaj në situatën aktuale për popullin, atdheun e socializmin ka një rëndësi kolosale. Rrota e historisë vazhdon pa u ndalur përpara, drejt komunizmit. Imperialistët me ata të SHBA-së në krye, të ndihmuar nga llumi i mbarë njerëzimit deri te revisionistët modernë Tito-Hrushov e kompani, po mundohen ta kthejnë atë prapa. Ata kurdisin komplete kundër paqes, kundër socializmit, kundër lëvizjes komuniste ndërkommbëtare, kundër atdheut tonë. Po s'ka asnje dyshim se ata do të dështojnë. Nën udhëheqjen e Partisë, duke u mbështetur vazhdimisht te mëma juaj — populli, dhe në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha armët e tjera të diktaturës së proletariatit, ju si kurdoherë të jeni vigjilentë, në gjendje gatishmërie që t'u shkaktoni atyre disfata të pandreqshme.

Armiqtë do të përpiken kurdoherë të na dëmtojnë. Të dërrmohet çdo përpjekje e tyre në këtë drejtim!

Armiqtë do të mundohen të bëjnë provokacione, të dërgojnë spiunë e të hedhin banda diversantësh në vendin tonë. Jini vigjilentë dhe shpartalloni me kohë dhe pa mëshirë çdo tentativë të tyre në këto drejtime!

Përgjithësoni dhe pasuroni më tej eksperiencën tuaj të madhe për t'i prerë rrugën çdo veprimi të dëmshëm nga ana e armikut, për ta hutuar, neutralizuar dhe për ta likuiduar atë!

Sot nga Arma e Sigurimit kërkohet një punë sa më e kualifikuar. Ajo duhet të godasë kurdoherë në shenjë. Ajo duhet të parandalojë të keqen aty ku mund të shfaqet ose të zhvillohet, të zbatojë dhe të mbrojë me vendosmëri ligjshmërinë socialiste. Punonjësi i sigurimit të jetë sa luftëtar i shkëlqyer kundër armiqve, aq edhe punëtor politik dhe agjitator i shquar i maseve.

Të ngrihet vazhdimisht niveli profesional dhe ideo-politik i punonjësve të Sigurimit të Shtetit!

Si kurdoherë pranë jush do të jetë Partia. Ajo, që e krijoi dhe e ka udhëhequr Armën e Sigurimit nga fitore në fitore, edhe në të ardhmen do ta udhëheqë atë në fitore të reja. Te Partia ju do të gjeni forcën e pamposhtur për të kapërcyer çdo pengesë e vështirësi. Të përshkohet e gjithë puna e sigurimit nga një partishmëri e thellë bolshevikë.

Arma e Sigurimit është dora e çeliktë e popullit që ndëronton socializmin. Ta bëni atë të pathyeshme dhe ta ngrini lart e më lart lavdinë e saj!

Edhe një herë ju uroj, të dashur shokë, që gjithmonë të qëndroni ballëlart para Partisë e atdheut, që nga radhët tuaja të dalin heronj të rinj legjendarë, për të cilët do të janë krenarë brezi ynë dhe ata që do vijnë pas nesh, që në kështjellën e pamposhtur — Republikën Popullore të Shqipërisë dhe në çështjen e pa-

vdekshme të marksizëm-leninizmit, në socializmin e komunizmin, të ndritë dhe mendja, djersa e gjaku i punonjësve të lavdishëm të Armës sonë të Sigurimit!

Enver Hoxha

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Botuar për herë të parë në
librin: «PPSH për organet
e Punëve të Brendshme»,
vëll. I, f. 522. Tiranë, 1974*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**GAZETA «BASHKIMI» SI AGJITATORE
DHE PROPAGANDISTE ËSHTË GJITHMONË
NJË GAZETË E DASHUR PËR POPULLIN**

*Përshëndetje drejtuar kolektivit të gazetës
«Bashkimi»*

25 mars 1963

KOLEKTIVIT TË GAZETËS «BASHKIMI»

Të dashur shokë,

Me rastin e 20-vjetorit të daljes së numrit të parë
të gazetës «Bashkimi», në emër të Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Këshillit të Përgjithshëm
të Frontit Demokratik të Shqipërisë dhe tij
min personal ju përshëndes me gjithë zemër dhe ju
uroj suksese të mëtejshme në punën tuaj fisnikë për
të mirën e popullit, të Partisë dhe të ndërtimit të so-
cializmit në vendin tonë!

E vështirë por e lavdishme, ashtu si e gjithë shtypit
tonë popullor, ka qenë rruga e pëershkuar nga ga-
zeta «Bashkimi», organ qendror i Frontit Demokra-

tik të Shqipërisë, gjatë këtyre 20 vjetëve të jetës së saj, sepse e vështirë dhe e lavdishme ka qenë rruga nëpër të cilën ka ecur populli ynë gjatë këtyre viteve nën udhëheqjen e Partisë sonë heroike.

«Bashkimi» lindi në zjarrin e luftës për çlirimin e atdheut vetëm disa muaj pas Konferencës së Pezës dhe u bë një armë e fuqishme për bashkimin e të gjithë popullit në Frontin Nacionalçlirimtar. Ai u bë një organ luftarak për mobilizimin dhe për organizimin e masave në luftën kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit, për demaskimin e armiqve të bashkimit të popullit tonë dhe për krijimin e Shqipërisë së lirë, demokratike e popullore.

Në vitet e para pas Çlirimtës të vendit «Bashkimi» dha një kontribut të madh për organizimin dhe për forcimin e pushtetit popullor, për mobilizimin e masave në shërimin e plagëve të luftës dhe në rimëkëmbjen e ekonomisë, si dhe për propagandimin e vënies në jetë të reformave të mëdha revolucionare.

«Bashkimi» ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm në luftën për forcimin e pavarësisë së atdheut, kundër armiqve të tërbuar të popullit tonë, imperialistëve, si dhe kundër revizionistëve modernë; ka ndihmuar dhe ndihmon në forcimin dhe në modernizimin e pushtetit popullor të këshillave, në mobilizimin e masave për vënien në jetë të politikës së Partisë, të kolektivizimit të fshatit dhe për forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativave bujqësore, për ndërtimin e socializmit në vendin tonë dhe për edukimin patriotik të punonjësve; ka dhënë dhe jep një kontribut të çmueshëm për forcimin e unitetit moralo-politik të

popullit tonë në Frontin Demokratik të Shqipërisë, të udhëhequr nga Partia.

Urojmë që edhe në të ardhmen, gazeta «Bashkimi», si një organ i rëndësishëm i shtypit tonë popullor, duke zhvilluar më tej traditat e tij luftarake, të arrijë suksese edhe më të mëdha në luftën e tij për edukimin e masave me frymën e patriotizmit të lartë dhe të internacionalizmit proletar, për çelikosjen e unitetit të popullit tonë rrëth Partisë, për demaskimin e armiqve të socializmit, imperialistëve dhe revizionistëve modernë, për mobilizimin e punonjësve në luftën për ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë. Duke ecur në këtë rrugë dhe duke ngritur vazhdimisht cilësinë e shkrimeve, operativitetin e lidhjet me masat, gazeta «Bashkimi» do të rritë më tej rolin e saj si agitantore, propagandiste dhe organizatore kolektive dhe do të bëhet një gazetë edhe më e dashur për popullin.

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 72 (4542), 26 mars 1963*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

KONFERENCAT E PARTISË NË RRETË TË JENË KURDOHERE MBLEDHJE PUNE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

8 prill 1963

Në përgjithësi, siç theksohet edhe në raportin që na është paraqitur, mund të themi se organet e organizatat-bazë të Partisë e kanë çdo vit e më mirë në dorë situatën politike dhe ekonomike të vendit. Natyrisht, qëllimi ynë është që Partia të bëhet sa më luftarake, t'i kuptojë çështjet sa më thellë dhe të japë një ndihmë sa më të madhe në problemet që na preokupojnë. Këtu duhet të përqendrohet gjithë kujdesi i udhëheqjes së Partisë, si në qendër dhe në bazë. Mund të themi se ajo i ka të gjitha mundësitë për një gjë të tillë, për arsyen se kuadrot tanë sot kanë një eksperiencë të madhe si në punën e Partisë, ashtu edhe në punët shtetërore dhe të ekonomisë.

Çështja është që, përvçë të tjerave, mbledhjet e

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi zhvillimin e fushatës për dhënie llogari e zgjedhje».

byrove, të plenumeve, të aktiveve dhe të konferencave të Partisë, të zhvillohen kurdoherë në nivel më të mirë, të jenë kurdoherë mbledhje pune. Dhe kjo varet shumë nga drejtuesit kryesorë të Partisë në rreth, sa janë në gjendje këta shokë të drejtojnë, të kapin e të trajtojnë në raporte problemet kyç dhe të përcaktojnë se ku duhet të jepet ndihma më e madhe e konkrete.

Në byrotë e komiteteve të Partisë trajtohen probleme të veçanta dhe konkrete, ku vihen në dukje të metat dhe përcaktohen detyrat për përmirësimin e punës në drejtime të caktuara, kurse në plenumet dhe në konferencat e Partisë duhet të kemi shumë kujdes për problemet që trajtohen në raport. Po të shikojmë tani se si bëhen raportet që mbahen në këto forume të larra të Partisë, pa dyshim që ka përmirësimë, por në to ka edhe ujë. Shpeshherë, në këto raporte ka gjëra të zakonshme, që komunisti i dëgjon vazhdimisht çdo ditë. Kjo rrjedh se, kur pregetiten këto raporte, byroja e komitetit të Partisë nuk përcakton se çfarë problemesh kryesore do të shtrohen në plenum ose në konferencë.

Megjithëse raporti i konferencës së Partisë quhet «raport për dhënie llogari e zgjedhje» mendoj se në të nuk duhet të flitet për të gjitha çështjet, por për disa probleme kryesore që s'kanë shkuar mirë dhe pastaj të përcaktohen detyrat konkrete për të ardhmen. Patjetër, në raportin e konferencës duhet të bëhet një pasqyrë mbi gjendjen politike dhe ekonomike të rrethit, po, kur të hyhet në trajtimin e problemeve, këtu duhet përqendruar në disa çështje kryesore të Partisë e të shtetit, në bazë të vendimeve që janë marrë nga

organet më të larta lidhur me realizimin e detyrave të planit, se si janë zbatuar këto dhe çfarë masash duhen marrë që të zbatohen plotësisht. Po të shtrohen në raport të gjitha problemet që ka rrethi, atëherë nuk do të bëhet asgjë, sepse problemet e Partisë janë të shumta. Kjo nuk do ta bëjë konferencën e Partisë një mbledhje pune dhe instruktive, po një mbledhje ku jepet një farë raporti rutinë, gjë që duhet me çdo mënyrë ta evitojmë.

Rëndësi ka edhe çështja e formulimit të vendimit. Formulimit të vendimeve më duket se nuk i jepet rëndësia e dorës së parë. Mirëpo, pregatitja e mirë e vendimit ka rëndësi të madhe, sepse në bazë të detyrave që do të caktohen, do të bëhet edhe mobilizimi i Partisë, sepse organizatat-bazë të Partisë nuk marrin raportin që mbahet në konferencë, por vendimin. Prandaj këto vendime duhet të janë mobilizuese dhe jo me fraza e formula stereotipe.

Në raporte duhet paraqitur thelbi i problemeve dhe çështjet të trajtohen në një mënyrë të atillë që t'u jepet mundësi të tjerëve të nxitin mendimin. Prandaj raportet duhet të pregetiten më mirë dhe vendimet që merren të janë mobilizuese, me detyra të reja dhe interesante, të janë sinteza e gjithë punës së Partisë. Që të bëhet kjo punë duhet që sekretari i Partisë gjatë procesit të punës dhe të kontrollit, të mbajë shënimë për problemet që dalin, të cilat duhen përgjithësisht për të gjithë organizatën e Partisë. Në këtë fushë është e nevojshme të bëjmë disa përmirësimë, në mënyrë që ta forcojmë edhe më tepër punën e Partisë.

Raportet që paraqiten në bazë kanë edhe kritikë e

autokritikë. Po edhe në këtë drejtim mua më duket se janë gjetur disa formula të përgjithshme. Tani kuadrot tanë janë rritur dhe janë forcuar, prandaj duhet të dilet me një kritikë dhe autokritikë më konkrete, e cila të jetë e lidhur më mirë me punën që bëhet, me rezultatet që arrihen, në mënyrë që edhe baza të ketë kënaqësi. Në raportin që na është paraqitur thuhet se si: është bërë kritika nga poshtë. Në qoftë se byroja do të dijë të tregojë konkretisht se si është bërë kjo kritikë nga poshtë dhe si është punuar për forcimin e saj, kjo do të jetë një gjë më e mirë. Një praktikë e tillë, më duket mua, duhet të zgjerohet.

Një sektor me rëndësi ku duhet ta forcojmë punën tonë të Partisë janë ndërmarrjet bujqësore shtetërore. Në rrethet ku ndodhen këto ndërmarrje Partia duhet ta marrë mirë në dorë punën e tyre, duke i konsideruar ato si qendra të rëndësishme, që u afrohen pak a shumë fabrikave, ku kemi një masë të madhe punëtorësh dhe ka një organizim teknik e shtetëror, një punë më të organizuar se në kooperativat bujqësore. Atje ka një numër të mirë teknikësh dhe elementë të klassës punëtore, prandaj nuk është aspak e drejtë që këto të dalin me rezultate më të dobëta se kooperativat bujqësore. Në këto ndërmarrje duhet bërë një punë më e madhe edukative me punëtorët, si nga Partia ashtu edhe nga ana shtetërore, nga Ministria e Bujqësisë, sepse këtu ka mbeturina mikroborgjeze më tepër se te punëtorët e fabrikave.

Në këtë raport ngrihet edhe çështja e njerëzve që largohen nga fshati. Ky është një proces që nuk mund të ndalet menjëherë, por që duhet ta frenojmë. Ai që

mbaron shërbimin ushtarak duhet bindur që të kthehet përsëri në fshat. Për këtë qëllim është e domosdoshme që agitacioni dhe propaganda të veprojnë për të ngjallur në masat dashurinë për fshatin. Kjo kërkon që të përdoren forma të përshtatshme të punës bindëse. Për shembull, të përdoret më shumë leximi i letërsisë artistike dhe shfaqja e filmave, që ngjallin dashurinë për fshatin. Më duket se në këtë drejtim nuk bëhet sa duhet. Prandaj dokumentarët tanë, krahas punimeve që tregojnë për bonifikimet, të paraqitin edhe panorama të fshatit, duke i shoqëruar edhe me shprehje që me të vërtetë të ngjallin dashurinë për fshatin. Pra, duhet të bëhet një propagandë më e gjallë, më e dukshme dhe e gjithanshme. Është e vërtetë se në fshat nuk ka bulevardë dhe opera, por anët e bukura të fshatit mund dhe duhet të paraqiten sa më gjerë.

Një çështje tjetër që konstatohet është edhe ajo e kuadrove të mesëm ose të lartë që duan të kthehen në Tiranë. Në qoftë se atyre u janë dhënë premtime nga ana e dikastereve për t'i sjellë në Tiranë, këto premtime duhen tërhequr dhe ata të këshillohen që të kryejnë mirë detyrat e tyre atje ku janë dhe të marrin familjet me vete, duke liruar kështu edhe banesat, në qoftë se këto janë shtetërore.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verballi i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

RRETHI I KORÇËS I KA TË GJITHA MUNDËSITË QË TË ARRJË REZULTATE MË TË MËDHA NË PUNË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

8 prill 1963

Ne mendojmë se rrethi i Korçës duhet të shquhet më shumë në kryerjen e detyrave të tij, sepse organiza-tata e Partisë e këtij rrethi është e fortë dhe njerëzit janë të ngritur. Edhe kuadro Korça ka shumë. Kjo është e natyrshme, sepse ky është një rreth bujqësor i përparuar dhe qytet me një industri të zhvilluar. Në rrëthin e Korçës jo vetëm janë shtuar kuadrot e lartë e të mesëm në bujqësi, por edhe vetë kooperativistët kanë një nivel të mirë arsimor, kulturor dhe teknik. Këto janë disa nga arsyet që në këtë rreth ka rezultate të mira dhe në të ardhmen do të ketë me siguri rezultate edhe më të mira.

¹ Në këtë mbledhje u diskutua lidhur me zbatimin e detyrave të Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi dobësitë e vërtetuara në punën e Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës».

Sidoqoftë edhe organizata e Partisë e rrethit të Korçës nuk u ka shpëtuar të metave në punë, megjithëse nuk ka gabime ideologjike dhe politike. Të metat në Korçë bien në sy, sepse nga ky rreth ne kërkojmë më shumë dhe kjo është shfaqje e besimit të Partisë për komunistët dhe punonjësit e këtij rrethi. Derisa ka pasur dhe ka të meta, të cilat i kritikoi edhe konferenca e Partisë e rrethit, duhet të luftohet që këto të meta të zhduken. Partia bën mirë që i kritikon të metat, sepse kjo i shërben përmirësimit të punës së saj.

Kuadrot e komitetit të Partisë dhe të komitetit ekzekutiv të këshillit populor të rrethit në përgjithësi janë të mirë, por kritika, që u bëhet për një kërkim më të mirë të llogarisë, është e drejtë. Kjo kritikë duhet t'i bëjë shokët drejtues të Partisë dhe të pushtetit në rreth që të punojnë më mirë dhe të forcojnë më tepër llogarinë për zbatimin e detyrave.

Këtu bëhet vërejtje në adresë të Komitetit Ekzekutiv të Korçës në lidhje me prishjen e shtëpive të vjetra. Që të mendosh për t'i zëvendësuar shtëpitë e vjetra me shtëpi të reja nuk është mirë, sepse nuk shton kontingjentin e banesave. Por edhe t'i lëmë banesat të shkatërrohen nuk është e drejtë. Më duket se në këtë drejtim janë bërë lëshime, prandaj fondet e cakluara për ndërtim, të përdoren mirë. Nga ana tjeter, me anën e kooperativave të artizanatit, të merren masa për të bërë meremetimin e shtëpive ekzistuese.

Ju, shokë të Korçës, të keni parasysh traditat e vjetra të klasës punëtore të rrethit tuaj. Të punoni që traditat e mira dhe luftarake të klasës punëtore të Korçës të ruhen e t'ë zhvillohen. Në të kaluarën ajo ka

qenë e vogël në numër, por e ka mbështetur e para rrugën e Partisë, prandaj për përparimin e qytetit e të fshatit, për forcimin e disiplinës në punë, për përhapjen e kulturës, për të luftuar zakonet prapanike në masat e popullit, mbështetjen kryesore duhet ta keni te klasa punëtore. Për këtë arsyre rëndësi të veçantë t'i jepni edukimit të klasës punëtore jo vetëm për forcimin e punës së Partisë në qytet, por edhe në fshat. Përpinquni që rinia të mos infektohet nga ndikimet e mentalitetit mikroborgjez që ekziston edhe në Korçë. Mentaliteti mikroborgjez te brezi i ri kalon nëpërmjet prindërve në qoftë se nuk bëhet një punë e mirë edukative dhc kulturore e organizuar. Pas Tiranës, Korça ka shumë mundësi për një punë të gjerë kulturore, sepse është një rrëth i mësuar dhe i kulturuar. Nëpërmjet punës edukative politike, ideologjike e kulturore me klasën punëtore dhe me rininë forcohet puna e Partisë jo vetëm në qytet, por edhe në fshat. Ju i keni fshatrat e fushës jo vetëm të zhvilluara nga ana ekonomike, por edhe të qytetëruara e të përparuara. Prandaj ju i keni të gjitha mundësitë ta forconi organizatën e Partisë dhe të arrini cdhe rezultate të mira ekonomike.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

N. HRUSHIOVI PËRSERI NË ROLIN E DEMAGOGUT, SHPIFËSIT DHE PËRÇARESIT

Nga artikulli i botuar në gazeten «Zëri i popullit»

18 prill 1963

Më 30 mars të këtij viti Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik i dërgoi një letër Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, e cila u botua në gazeten «Zëri i popullit» të datës 17 prill 1963.

Në këtë letër, përveç të tjerave, trajtohen çështje që kanë të bëjnë me organizimin e bisedimeve dypalëshe midis përfaqësuesve të PK të BS dhe të PK të Kinës, lidhur me marrëdhëniet e tyre reciproke dhe me preqatitjet për një mbledhje ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore.

Partia e Punës e Shqipërisë është shprehur gjithnjë për rrugën e takimeve, të bisedimeve e të konsultimeve shoqërore e të barabarta për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin midis partive komuniste e punëtore të vendeve të ndryshme dhe në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare në tërsi.

Partia jonë mendon se shkëmbimi reciprok i pikë-

pamjeve dhe organizimi i takimeve e i bisedimeve dy-palëshe është çështje e brendshme e partive përkatëse.

Por meqenëse në këtë letër N. Hrushovi, duke nxitur më tej polemikën publike me Partinë e Punës të Shqipërisë (gjë që vërteton edhe një herë se thëniet e tij në Kongresin e 6-të të Partisë Socialiste të Bashkuar të Gjermanisë se duhet ndaluar polemika etj. janë blof e hipokrizi), sulmon dhe shpif në mënyrë tendencioze kundër saj, duke u përpjekur njëkohësisht në mënyrë demagogjike të paraqitë veten e qëndrimet e tij si korrekte me mësimet e marksizëm-leninizmit e të deklaratave të Moskës, ne po i përgjigjemi.

Në letrën e KQ të PK të BS dërguar KQ të PK të Kinës, midis të tjera, thuhet sa vijon:

«Në letrën tuaj ju prekni çështjen shqiptare dhe atë jugosllave. Siç ju kemi shkruar, ne mendojmë se këto çështje, megjithëse janë parimore, nuk munden dhe nuk duhet të eklipsojnë në vetvete problemet kryesore të kohës, që kërkojnë diskutim në takimin tonë.

Partia jonë, duke dënuar veprimet përçarëse të udhëheqësve shqiptarë, njëkohësisht ka ndërmarrë pa ndërprerje hapat e nevojshëm për normalizimin e marrëdhënieve të PPSH me PK të BS dhe me partitë e tjera motra. Megjithëse udhëheqësit e PPSH kohët e fundit kanë ndërmarrë dhe vazhdojnë të ndërmarrin sullme shpifarake kundër partisë sonë dhe popullit sovjetik, ne, duke u udhëhequr nga interesat më të larta, nuk heqim dorë nga mendimi se marrëdhëniet midis PK të BS dhe PPSH mund të përmirësohen. Në fund të shkurtit të këtij viti, KQ i PK të BS tregoi dhe një herë iniciativën dhe i bëri KQ të PPSH propozimin për zhvillimin

e një takimi të dyanshëm të përfaqësuesve të të dyja partive tona. Por edhe ky hap yni shoqëror nuk gjeti jehonën e duhur nga ana e udhëheqjes shqiptare. Udhëheqësit e PPSH nuk e konsideruan të nevojshme bile as ta merrnin letrën tonë, ku përmbahej propozimi i KQ të PK të BS për takimin e dyanshëm. Më vonë, siç duket, pasi u menduan më mirë, udhëheqësit shqiptarë dërguan një letër, në të cilën ata, duke paraqitur një sërë rezervash dhe kushtesh, flasin për një takim të tillë. Në qoftë se është treguar me të vërtetë dëshira, ne jemi gati ta bëjmë një takim të tillë».

Siç shihet, grupi i N. Hrushovit edhe në këtë paragraf ka kombinuar urrejtjen, shpifjen, sulmin kundër PPSH me mashtrimin dhe demagogjinë. Ai përpinqet me çdo mënyrë të bëjë përgjegjës të tjerët për sajet e veta, orvatet t'ia hedhë përgjegjësinë Partisë së Punës të Shqipërisë për gjendjen e padëshirueshme në marrëdhëni sovjeto-shqiptare. Me këtë ai përpinqet edhe një herë të mashtrojë tërë lëvizjen komuniste dhe opinionin publik ndërkombëtar.

E ashtuquajtura «çështje shqiptare» nuk është një incident i rastit dhe i izoluar

Në letrën e lartpërmendur, që KQ i PK të BS i drejton KQ të PK të Kinës flitet për një të ashtuquajtur «çështje shqiptare», që «nuk mund dhe nuk duhet të eklipsojë në vetvete problemet kryesore të kohës». Por ç'është kjo e ashtuquajtur «çështje shqiptare» dhe

a ekziston ajo në të vërtetë? Në vetvete nuk ekziston kurrfarë «çështje shqiptare», ajo është vetëm një trillim i N. Hrushovit, që i duhet atij për të fshehur qëndrimet e veprimet e veta armiqësore ndaj PPSH e RPSH dhe për të justifikuar sulmet e shpifjet e tij të mëtejshme kundër tyre. Ajo është një orvatje për ta paraqitur këtë «çështje» si një problem të dorës së dytë, të veçantë, të shkëputur «nga problemet kryesore të kohës», nga divergjencat e thella parimore që kanë lindur në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe që, sipas tij, qenka krijuar gjoja për shkak të pikëpamjeve e qëndrimeve «të gabuara» dhe «të padrejta» të udhëheqësve shqiptarë.

Në gjykimin e këtij problemi ne nuk nisemi nga pozita të ngushta, nuk nisemi vetëm nga fakti që jemi drejtpërdrejt të interesuar, por mendojmë se ky është një problem thellësisht parimor.

E ashtuquajtura «çështje shqiptare» nuk është aspak një incident i rastit dhe i izoluar, ajo nuk kufizohet bilo as në kuadrin e ngushtë të marrëdhënieve thjesht sovjeto-shqiptare, por është një nga shfaqjet më të theksuara dhe tipike të luftës së madhe që zhvillohet sot midis marksizëm-leninizmit, nga njëra anë, dhe revizionizmit modern, të përfaqësuar nga klika titiste dhe grupi i N. Hrushovit, nga ana tjeter. Ajo është pjesë përbërëse e kësaj lufte, sepse Partia e Punës e Shqipërisë qëndron me vendosmëri në pozitat revolucionare të marksizëm-leninizmit dhc bën një luftë të papajtueshme kundër revizionizmit modern. Me këtë çështje të madhe parimore është gërshetuar e është lidhur ngushtë edhe çështja e marrëdhënieve sovjeto-

-shqiptare, çështja e marrëdhënieve midis dy partive e dy vendeve tonë.

Si lindi e ashtuquajtura «çështje shqiptare»? Para se grupei i N. Hrushovit të dilte hapur me vijën e tij thellësisht antimarksiste, oportuniste, revizioniste, kur ai e zhvillonte veprimtarinë e tij në forma pak a shumë të kamufluara dhe me zigzage, të imponuara nga rrethanat e kohës, Partia e Punës e Shqipërisë, duke qëndruar në pozita të drejta marksiste-leniniste, ka qenë në një papajtueshmëri të heshtur me të për një sërë çështjesh të rëndësishme, siç janë qëndrimi ndaj J. V. Stalinit e veprës së tij, qëndrimi ndaj revizionistëve jugosllavë etj. Megjithëse për shumë çështje PPSH kundërshtonte veprimet e N. Hrushovit në mënyrë të heshtur, përsa u përket revizionistëve jugosllavë ajo bënte një luftë të hapët, të vendosur dhe mbante një qëndrim të prerë ndaj tyre, si renegatë të marksizmit dhe armiq të socializmit, duke rënë kështu në kundërshtim të hapët me përpjekjet e N. Hrushovit për rehabilitimin e klikës titiste, afrimin dhe pajtimin e tij me të. Qysh atëherë N. Hrushovi shihte qartë se në Partinë e Punës të Shqipërisë kishte një pengesë serioze në rrugën e realizimit të kursit të tij antimarksist. Kjo përcaktonte edhe qëndrimin e maskuar armiqësor të tij kundër PPSH për vijën e saj të drejtë në përgjithësi, dhe sidomos për qëndrimin e saj të vendosur e të prerë ndaj klikës titiste — alates së ardhshme të N. Hrushovit. Megjithëkëtë, deri në këtë kohë akoma nuk ekzistonte e ashtuquajtura «çështje shqiptare». «Çështja shqiptare» lindi atëherë kur N. Hrushovi iu vu hapur punës për të përçarë unitetin e kampit socia-

list e të lëvizjes komuniste ndërkombejtare, atëherë kur ai, në mënyrë brutale e me metoda antimarksiste, u përpoq t'u imponojë atyre vijën e tij revizioniste. Kjo ndodhi në Mbledhjen e Bukureshtit të qershorit të vitit 1960 dhe në Mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtore në Moskë në nëntor të po atij viti, ku PPSH, së bashku me parti të tjera motra, kundërshtoi me vendosmëri orvatjet përcarëse të N. Hrushovit, kritikoi pikëpamjet, qëndrimet e veprimet e dëmshme dhe antimarksiste të tij, mbrojti me guxim vijën marksiste-leniniste të lëvizjes komuniste ndërkombejtare dhe çështjen e unitetit të saj. Që këtu N. Hrushovi divergjencat ideologjike midis Partisë së Punës të Shqipërisë dhe grupit të tij i nxori hapur, që këtu si kundërveprim filloj lufta e hapët dhe e paparim e grupit të N. Hrushovit dhe e pasuesve të tij kundër PPSH, luftë e cila u bë gjithnjë më e ashpër dhe e egër, duke arritur kulmin me sulmet publike nga tribuna e Kongresit të 22-të të PK të BS dhe pas tij në organet e shtypit dhe në kongreset e disa partive të tjera.

Kështu, pra, e ashtuquajtura «çështje shqiptare» lindi si një aspekt i luftës midis marksizëm-leninizmit e revizionizmit, midis partive që qëndrojnë në pozita revolucionare dhe revizionistëve modernë — grupit të N. Hrushovit e pasuesve të tij. Në të vërtetë, pra, kjo është një çështje që ka të bëjë me vijën e përgjithshme të lëvizjes komuniste ndërkombejtare, me të cilën gjithnjë, në mënyrë të maskuar ose të hapët, ka qenë në kundërshtim N. Hrushovi, kjo ka të bëjë me çështjen se në ç'rrugë duhet të zhvillohet kjo lëvizje — në rru-gën e marksizëm-leninizmit apo të revizionizmit.

PPSH ka ndjekur me besnikëri vijën e përbashkët të lëvizjes komuniste ndërkomëtare

Vija e PPSH ka qenë kurdoherë në përputhje të plotë me vijën e përgjithshme të lëvizjes komuniste ndërkomëtare, ajo ka qenë një vijë e drejtë e pandryshuar për të gjitha problemet e zhvillimit të sotëm botëror. Partia e Punës e Shqipërisë u është përmbajtur me besnikëri mësimeve themelore të marksizëm-leninizmit dhe parimeve të internacionalizmit proletar, dokumenteve programatike të lëvizjes komuniste ndërkomëtare, deklaratave të Moskës të viteve 1957 e 1960. Vija e saj e drejtë është shprehur qartë në të gjitha materialet e dokumentet e Partisë, si dhe në të gjithë veprimtarinë praktike të Partisë dhe të Qeverisë sonë.

Partia e Punës e Shqipërisë ka qëndruar vazhdimisht në pozitat e luftës së papajtueshme kundër imperializmit, nuk ka ushqyer asnje iluzion mbi ndryshimin e natyrës së tij agresive, ka demaskuar me vendosmëri politikën agresive luftënxitëse të imperializmit, dhe në mënyrë të veçantë të atij amerikan, të cilin e ka konsideruar si qendrën e reaksionit botëror dhe xhandar ndërkomëtar, si armikun më të egër të popujve të të gjitha vendeve. Duke qenë plotësisht e ndërgjegjshme për ndryshimin e raportit të forcave në botë, në favor të forcave të socializmit, të paqes dhe të lëvizjes nacionalçlirimtare, ajo as nuk i ka mbivlerësuar dhe as i ka nënveftësuar kurri të forcat e imperializmit dhe nuk ka bërë asnje gabim, qoftë aventuristik, qoftë kapitullues.

Partia e Punës e Shqipërisë ka ndjekur me vendosmëri politikën e miqësisë, të lidhjeve vëllazërore, të bashkëpunimit e të ndihmës reciproke me të gjitha vendet socialiste. Ajo u ka qëndruar besnikë dhe ka respektuar me rigorozitet normat e marrëdhënieve midis vendeve socialiste e partive komuniste. Ndihmëni e përkrahjen e vendeve të tjera socialiste ajo e ka konsideruar kurdoherë si një faktor shumë të rëndësishëm për ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Nga ana e saj, ajo ka dhënë kontributin e vet për forcimin e kampit socialist dhe të unitetit të tij.

Në marrëdhëniet me vendet kapitaliste PPSH dhe Qeveria e RPSH kanë ndjekur me konsekuençë politikën e bashkekzistencës paqësore, të bazuar në parimet e barazisë, të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit dhe të respektit reciprok, politikë të cilën e kanë parë gjithnjë si një formë të luftës së klasave në arenën ndërkombëtare që zhvillohet në të gjitha frontet, ideologjik, politik dhe ekonomik, midis dy sistemeve, atij kapitalist dhe socialist. Këtë politikë ato e kanë quajtur dhe e quajnë si një politikë të drejtë midis vendeve me sisteme të ndryshme shoqërore dhe nuk e kanë shtrirë kurrë në marrëdhëniet midis klasave të kundërtë në vendet kapitaliste, si dhe në marrëdhëniet midis popujve të shtypur e të sklavëruar dhe kolonizatorëve imperialistë.

Luftën për bashkekzistencën paqësore midis vendeve me sisteme të ndryshme shoqërore PPSH e ka parë si një nga rrugët e rëndësishme për ruajtjen dhe për forcimin e paqes në botë. Në përshtatje me kushtet e reja, ajo nuk i ka konsideruar dhe nuk i konsi-

deron sot luftën botërore dhe luftërat e tjera agresive të imperializmit si fatalisht të pashmangshme, por në të njëjtën kohë i përbahet pikëpamjes se përderisa ekziston imperializmi, mbetet edhe baza për luftëra agresive. Ajo ka bërë gjithnjë dallim midis luftërave të drejta dhe të padrejta, ka përkrahur pa rezerva luftërat e drejta dhe ka demaskuar c'ka dënuar agresorët imperialistë. Partia e Punës e Shqipërisë e ka parë luftën për paqe si luftë kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, sepse pikërisht prej tyre vjen rreziku i luftës, ata janë armiqtë e paqes. Ajo ka menduar dhe mendon se paqja dhe bashkekzistenca paqësore nuk mund t'u lypen imperialistëve, ato nuk mund të sigurohen me lajka dhe lëshime ndaj tyre, por vetëm duke ua imponuar atyre me anën e një lufte të vendosur të të gjitha forcave paqedashëse të botës.

Partia e Punës e Shqipërisë e ka parë lëvizjen nacionalçlirimtare të popujve kundër shtypjes imperialiste për lirinë dhe pavarësinë kombëtare si një nga lëvizjet më të mëdha të kohës sonë, që minon pozitat e imperializmit dobëson dhe ngushton sferën e sundimit të tij. Por Partia jonë mendon se sistemi kolonial i imperializmit nuk është likuiduar akoma, se nën këtë sundim vuajnë akoma miliona e miliona njerëz të kontinenteve të tëra dhe se imperialistët, me ata të SHBA-së në krye, bëjnë të gjitha përpjekjet, duke mos u ndalur përpara luftërave e agresioneve të hapëta, për të ruajtur pozitat e tyre dhe për të rivendosur, në forma të reja, shtypjen e shfrytëzimin e tyre kolonial. Lufta e këtyre popujve kundër imperializmit është në të njëjtën kohë një luftë për triumfin e paqes dhe të

bashkekzistencës paqësore, një aleate e madhe dhe një mbështetje e fuqishme për luftën revolucionare të klasës punëtore ndërkombejtare dhe për të gjitha vendet socialiste. Pikërisht për këto arsyë PPSH dhe Qeveria e RPSH kanë përkrahur pa rezerva këtë luftë të drejtë të popujve për çlirimin kombëtar kundër imperializmit dhe i kanë dhënë asaj gjithë ndihmën e tyre. Këtë përkrahje dhe ndihmë ne e kemi konsideruar si një detyrë të lartë internacionliste.

Gjithashtu, PPSH ka përkrahur e ka mbështetur pa rezerva lëvizjen revolucionare të klasës punëtore e të masave punonjëse të vendeve kapitaliste kundër shtypjes e shfrytëzimit kapitalist, për çlirimin e tyre shoqëror. Ajo i është përbajtur gjithmonë pikëpamjes leniniste se revolucioni nuk mund të eksportohet.

E tillë ka qenë vija e PPSH dhe e Qeverisë së RPSH qysh para se N. Hrushovi të nxirrte në skenë «çështjen shqiptare». Kjo vijë konsekiente mbeti e pandryshuar dhe nuk iu përshtat vijës oportuniste revisioniste të N. Hrushovit edhe pasi ky doli hapur me kursin e tij antimarksist, në kundërshtim me vijën e përgjithshme të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombejtare. Vija e drejtë dhe pozita parimore e PPSH nuk i kanë pëlqyer kurrë N. Hrushovit dhe ky është shkaku kryesor i kontradiktave e i mosmarrëveshjeve me të, i luftës së tij të egër kundër saj. Pikërisht për këtë arsyë ai e ka quajtur vijën e Partisë sonë një vijë «sektare», «dogmatike», «aventureske» dhe udhëheqjen e PPSH si «partizane të kultit të individit, të te-

rrorit, të shkeljes së ligjshmërisë socialiste» etj., duke synuar me këtë të diskretojë PPSH dhe të frikësojë të tjerët, me qëllim që t'u imponojë atyre vijën e tij antimarksiste.

Me gjithë demagogjinë, N. Hrushovi nuk mund të mbulojë vijën e tij fund e krye revizioniste

Por cila është kjo vijë që N. Hrushovi është përpjekur dhe po përpinqet t'ia imponojë lëvizjes komuniste e punëtore ndërkontrolluese dhe të cilën ai e trumbezon me bujë të madhe si një vijë marksiste-leniniste krijuese? Në të vërtetë, me gjithë demagogjinë e tij, ajo është një vijë fund e krye revizioniste e oportuniste, që i ka sjellë dhe po i sjell një dëm shumë të madh kampit socialist, lëvizjes komuniste ndërkontrolluese, luftës revolucionare e çlirimtare të popujve kundër imperializmit, çështjes së paqes, lirisë, demokracisë e socializmit.

Në propagandën e tij, dhe veçanërisht në atë të kohëve të fundit, grupi i N. Hrushovit, duke vazhduar përhapjen e tezave të tij antimarksiste, përpinqet të provojë me lodra fjalësh se gjoja pikëpamjet dhe veprimet e tij u përgjigjen plotësisht deklaratave të Moskës, mësimeve leniniste dhe interesave të kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkontrolluese. Kështu, për shembull, grupi i N. Hrushovit thotë se gjoja udhëhiqet nga «fryma leniniste e luftës së papajtueshme kundër imperializmit» dhe përsërit disa konkluzione të

deklaratave të Moskës se «thelbi antipopullor e grabitqar i imperializmit nuk ka ndryshuar», se «imperializmi amerikan kryen tani funksionet e xhandarit ndër-kombëtar», se «imperializmi, për shkak të thelbit të tij grabitqar, nuk mund të çlirohet nga tendenca për t'i zgjidhur kontradiktat në arenën ndërkombëtare me anën e luftës» etj., etj.

Por si përputhen këto me deklaratat e mëparshme dhe me të gjitha veprimet e N. Hrushovit? A nuk është N. Hrushovi ai që gjatë shumë vjetëve është përpjekur të mbjellë iluzione mbi gjoja ndryshimin e natyrës së imperializmit e të krerëve të tij dhe mbi këtë bazë të ndërtojë tërë qëndrimin e veprimtarinë e vet? Është pikërisht ai që, pa marrë parasysh «thelbin grabitqar të imperializmit», ka deklaruar më se një herë se qysh sot mund të krijohet «bota pa armë, pa ushtri e pa luftëra», se «viti 1960 do të hyjë në histori si viti i fillimit të realizimit të kësajëndrrë shekullore të një-rëzimit» (Biseda e N. Hrushovit me drejtoren e gazetës argjentinase «Klarin» më 30 dhjetor 1959), se «qysh në kohën e tanishme po krijohet mundësia reale për të përjashtuar përfundimisht e përgjithnjë luftën nga jeta e shoqërisë» (Fjalimi i N. Hrushovit në Indonezi më 21 shkurt 1960). Është pikërisht N. Hrushovi ai që ka deklaruar se «imperialistët e kanë marrë seriozisht thirrjen tonë për garë në zhvillimin ekonomik... ne po i tërheqim vazhdimisht vendet kapitaliste në rrugën e garës paqësore midis dy sistemeve», se «tani çështja shtronhet kështu: cili sistem do të tregojë një vitalitet më të madh, domethënë cili sistem në kohën më të shkurtër do t'u japë popujve më shumë të mira ma-

teriale e shpirtërore» (Artikulli i N. Hrushovit në revistën «Komunist», Nr. 12, gusht 1962).

Në kundërshtim flagrant me ato që thuhen në dy deklaratat e Moskës mbi imperializmin amerikan dhe krerët e tij, N. Hrushovi para moskovitëve, para gjithë popullit, para qeverisë dhe partisë deklaroi, pas kthimit nga vizita e tij në SHBA, se Presidenti i SHBA-së, D. Ajzenhauer, «do singjerisht të likuidojë gjendjen e luftës së ftohtë» dhe se «gëzon besimin absolut të popullit të tij» (Fjalimi i N. Hrushovit në mitingun e punonjësve të Moskës më 28 shtator 1959). Duke lavdëruar Ajzenhauerin, Makmilanin e Dë Golin, N. Hrushovi ka thënë se «të gjithë ata e kuptojnë nevojën që t'i shërbijnë uljes së mëtejshme të tensionit ndërkombëtar dhe zgjidhjes së problemeve ndërkombëtare me rrugën e bashkëbisedimeve e jo me anë të luftës» (Fjalimi i N. Hrushovit në Azerbajxhan më 25 prill 1960).

N. Hrushovi nuk i ka kursyer lëvdatat edhe për pasardhësin e Ajzenhauerit, presidentin Kenedi. Bile edhe në ditët e rënda të krizës së Karaibeve, kur Kenedi dhe qeveria e tij treguan hapur fytyrën e tyre prej luftënxitësi e agresori, N. Hrushovi, në mesazhin e tij të 27 tetorit 1962, i shkruante Kenedit: «Kujdesi juaj për sigurimin e SHBA-së është i kuptueshëm për mua, zoti president, sepse kjo është detyra e parë e presidentit... ju doni të siguronni vendin tuaj dhe kjo është e kuptueshme». Kurse në mesazhin e dërguar një ditë më vonë, më 28 tetor 1962, i shkruante atij: «Unë shpreh kënaqësinë dhe mirënjojen time për kuptimin nga ana juaj të përgjegjësisë që bie tani mbi ju për ruajtjen e paqes në gjithë botën».

Sipas deklaratave të N. Hrushovit, lufta nuk është pjellë e imperializmit, e politikës së tij agresive, por rreziku i saj ardhka vetëm nga disa «të çmendur», nga disa «të tërbuar», të cilët «preferojnë më mirë të vdesin në kapitalizëm, sesa të rrojnë në komunizëm». Dhe, sipas tij, janë pikërisht këta njerëz ata që bëjnë «presion të fortë» mbi presidentët «paqësorë» (që dëshirokan të rrojnë në komunizëm!) dhe mbi qeveritë e SHBA-së e të vendeve të tjera imperialiste dhe që i shtyjnë ata të ndjekin «disa herë» një politikë të jashtme jopaqësore. Bile N. Hrushovi ka arritur deri atje sa të shpifë se rreziku i luftës vjen sot edhe nga «njërëzit që e heqin veten marksistë-leninistë, por që në të vërtetë janë dogmatikë dhe nuk besojnë në mundësinë e fitores së socializmit e të komunizmit në kushtet e bashkekzistencës paqësore me kapitalizmin» (Fjalimi i N. Hrushovit në Sovjetin Suprem të BRSS më 12 dhjetor 1962).

Kjo listë deklaratash e thëniesh të N. Hrushovit, që zbuluojnë imperializmin e krerët e tij, duke i paraqitur ata si «paqedashës», mund të zgjatej shumë. Por mendojmë se edhe kaq është e mjaftueshme. E ku është këtu «fryma leniniste e luftës së papajtueshme kundër imperializmit», me të cilën përpinqet të mashtrojë njërit N. Hrushovi?

N. Hrushovi, duke vazhduar me konsekuençë rrugën e tij demagogjike, deklaron se gjoja ai merr parasysh ndryshimin e raportit të forcave në arenën ndërkombëtare dhe thotë se për ruajtjen e paqes dhe shmangjen e luftës botërore «duhet forcimi i mëtejshëm e i vazhdueshëm i sistemit socialist, uniteti i të gjitha for-

cave të klasës punëtore ndërkombejtare, i lëvizjes nacionallçlirimtare, i të gjitha forcave demokratike».

Por a mbështetet me të vërtetë N. Hrushovi në këto forca për ruajtjen e paqes dhe shhangjen e luftës botërore dhe të luftërave të tjera agresive që ndërmerr imperializmi? Po të gjykosh nga tërë konceptet dhe veprimet praktike të grüpuit të N. Hrushovit në fushën e politikës ndërkombejtare, del se, sipas tij, faktet e paqes e të popujve varen nga «njerëzit e mëdhenj», nga «urtësia» dhe «arsyeja» e tyre, nga takimet dhe bisedimet e N. Hrushovit me përfaqësuesit e imperializmit, sidomos të atij amerikan. Qysh më 31 tetor të vitit 1959, në fjalimin e mbajtur në Sovjetin Suprem të BRSS, N. Hrushovi deklaroi: «Ne e kemi thënë më se një herë se problemet më të ndërlikuara ndërkombejtare mund t'i zgjidhin vetëm kryetarët e qeverive, të cilët kanë kompetenca të mëdha. Vetëm ata janë në gjendje të pastrojnë grumbullin e anomalive në marrëdhëniet ndërkombejtare, të cilat janë mblehdhur gjatë shumë vjetëve të luftës së ftohtë». Pikërisht në këtë frymë ai dhe njerëzit e tij e quajtën takimin Hrushov-Ajzenhauer në Kemp Devid si fillimin e një «etape të re», e një «ere të re», si një «kthesë në historinë e njerëzimit». Kurse anëtari i KQ të PK të BS, ministri i Jashtëm i BS, A. Gromiko, deklaroi, në fjalimin e mbajtur në Sovjetin Suprem më dhjetor 1962, se «po pati harmoni midis Kryetarit të Qeverisë Sovjetike, N. Hrushovit, dhe Presidentit të SHBA-së, Kenedit, do të ketë edhe zgjidhje të problemeve ndërkombëtare». Bile, për të realizuar sa më mirë «këtë harmoni», kohët e fundit u vendos që të krijohet edhe

lidhja direkte telefonike midis Hrushovit dhe Kenedit, midis këtyre dy burrave të shtetit që paskan në dorë fatet e njerëzimit! Ja cili është preokupacioni i vërtetë i N. Hrushovit!

Pra,jeta tregon përditë e më qartë se fjalët e revizionistëve modernë për forcën e popujve, për rolin e masave në luftën për mbrojtjen e paqes etj., etj. nuk janë tjetër veçse demagogji e mashtrim. Këtë e ka shprehur vetë N. Hrushovi në fjalimin e tij të 12 dhjetorit 1962, ku luftën e popujve kundër imperializmit e quajti «sharje të kota», «fjalë boshe», «deklarata bombastike», që nuk i shkaktojnë asnjë dëm imperializmit. Për më tepër, N. Hrushovi nuk ka ngurruar t'i akuzojë si luftënxitës, që «duan ta shtyjnë botën drejt katastrofës bërthamore», që duan të sigurojnë fitoren mbi kapitalizmin nëpërmjet «luftës midis shteteve, shkatërrimit, gjakut dhe vdekjes së miliona njerëzve», të gjithë ata që guxojnë të demaskojnë imperialistët dhe që u bëjnë thirrje popujve të ngrihen kundër imperializmit, për mbrojtjen e paqes dhe për çlirimin e tyre kombëtar e shoqëror.

Për të larguar popujt nga lufta e drejtë kundër imperializmit, për të paralizuar lëvizjen revolucionare dhe luftën nacionalçirimitare të popujve, N. Hrushovi është bërë një propagandist vullnetar i politikës së shantazhit atomik që ndjek imperializmi amerikan, gjë që tregon se atij i ka hyrë frika në palcë, se ka shkarë në llumin e disfatizmit, se ka humbur çdo besim në forcën e popujve, në të ardhmen e njerëzimit, në triumfin e socializmit e të komunizmit në mbarë botën. A nuk e vërteton këtë fjalimi i N. Hrushovit në shoqë-

rinë austro-sovjetike më 2 korrik 1960, ku tha: «Në qoftë se në këtë tokë ne nuk mund të jetojmë ashtu si qeniet e gjalla mundën të jetonin në arkën e Noes dhe do të fillojmë të zgjidhim me luftë mosmarrëveshjet midis shteteve — kujt nuk i pëlqen socializmi e kujt nuk i pëlqen kapitalizmi, atëherë ne do ta zhdukim arkën tonë të Noes, rruzullin tokësor»? Po këtë ide ai e përsëriti edhe duke folur në Kongresin e 6-të të PSB të Gjermanisë, ku deklaroi: «Sipas llogarive të shkencëtarëve, vetëm si rezultat i goditjes së parë, do të vriteshin 700-800 milionë veta. Nga faqja e dheut do të zhdukeshin e do të shkatërroheshin të gjitha qytetet e mëdha jo vetëm të dy fuqive bërthamore kryesore — të Shteteve të Bashkuara dhe të Bashkimit Sovjetik, por edhe të Francës, Anglisë, Gjermanisë, Italisë, Kinës, Japonisë dhe të shumë vendeve të tjera të botës. Pasojat e luftës atomike e me hidrogjen do të ndikonin gjatë jetës së shumë brezave të njerëzve, duke shkaktuar sëmundje, vdekje, duke çuar në zhvillimin më të shëmtuar të njeriut». Deklarata të këtij lloji ka me shumicë në fjalimet e N. Hrushovit dhe në materiallet propagandistike të grupit të tij.

Dhe ç'tregojnë të gjitha këto? Të tilla qëndrime pesimiste e kapitulluese i shërbejnë vetëm imperializmit dhe i sjellin një dëm të madh luftës së popujve për mbrojtjen e paqes. E me të vërtetë, ç'të mirë mund të sjellë propaganda e shantazhit atomik, me të cilën është bashkuar edhe N. Hrushovi, kur imperializmi i kërcënë popujt me luftë e agresion? Mos vallë me këtë frymë disfatizmi duhen edukuar e duhen pregatitur popujt e vendeve socialiste dhe popujt e tjerë pa-

qedashës, që, në rast të një lufte që mund të shpërthejnë imperialistët, të kapitullojnë pa kushte e të ngrenë flamurin e bardhë? Ç'gjë ka të përbashkët këtu me deklaratat e Moskës? A nuk është demagogji, pra, kur tani N. Hrushovi thotë se «ne do t'i detyrojmë imperialistët të mos harrojnë se, po të shpërthejnë luftën për të zgjidhur me forcën e armëve çështjen se në ç'rrugë do të zhvillohet njerëzimi — në rrugën e kapitalizmit apo në atë të socializmit, kjo do të jetë lufta e fundit, në të cilën imperializmi do të shpartallohet përfundimisht»? Nuk ka dyshim se demagogjia dhe sofizmat e N. Hrushovit nuk do të mund të trebin dhe të mashtrojnë marksistë-leninistët dhe popujt.

N. Hrushovi flet shumë për bashkekzistencën paqësore, për kuptimin e saj leninist, për zbatimin në praktikë sipas konkluzioneve të deklaratave të Moskës. Bile, për të qenë «brenda», kohët e fundit thekson se bashkekzistenca «presupozon luftën e pandërprerë ideologjike, politike dhe ekonomike midis dy sistemeve shoqërore, luftën klasore të punonjësve brenda vendeve të sistemit kapitalist, duke përfshirë luftën e armatosur, kur popujt e konsiderojnë atë të domosdoshme, zhvillimin e vazhdueshëm të lëvizjes nacionalçirimitare të popujve të vendeve koloniale e të varrura». Por sa larg është në të vërtetë N. Hrushovi nga këto teza! Në qoftë se ai e koncepton kështu bashkekzistencën paqësore, atëherë pse i akuzon Partinë e Punës të Shqipërisë dhe partitë e tjera motra, të cilat u përbahen me konsekuençë konkluzioneve të Deklaratës së Moskës lidhur me këtë çështje, se gjoja ato janë kundër bashkekzistencës paqësore?

N. Hrushovi në fakt edhe në këtë rast bën demagogji, lojë fjalësh, sepse, megjithëse e pranon me fjalë se «bashkekzistencë paqësore nuk do të thotë pajtim i ideologjisë socialiste me atë borgjeze», ai mendon se kontradiktat ideologjike midis dy sistemeve do të zgjidhen jo me anën e revolucionit për fitoren e socializmit në vendet e ndryshme, por nëpërmjet garës ekonomike paqësore midis dy sistemeve. Kështu, në intervistën dhënë gazetarëve brazilianë më 5 dhjetor 1957, N. Hrushovi ka thënë: «Në qoftë se të gjitha çështjet e pazgjidhura do të zgjidhen me anën e bisedimeve dhe kontradiktat ideologjike midis sistemit socialist dhe atij kapitalist me anë të garës paqësore në zhvillimin e ekonomisë, kulturës dhe në plotësimin e kërkuesave materiale e kulturore të njerëzve, mund të themi me bindje se për njerëzimin do të sigurohet një periudhë e gjatë paqeje».

Megjithëse me fjalë pranon se bashkekzistenca paqësore nënkupton luftën politike midis dy sistemeve, N. Hrushovi në fakt ka hequr dorë nga kjo luftë dhe, në vend të demaskimit të politikës agresive e luftënxitëse të imperializmit me atë amerikan në krye, përhap, siç e theksuan më sipër, gjithfarë iluzionesh pacifiste për imperialistët dhe u thur lëvdata krerëve të tij. «Duhet të bëjmë që lufta e pashmangshme ndërmjet dy sistemeve, ka thënë N. Hrushovi, të shkrihet pa përjashtim në luftën midis ideologjisë dhe në garën paqësore, në konkurrencën, në qoftë se mund të flitet në një gjuhë më të kuptueshme për kapitalistë» (Fjalimi i N. Hrushovit në Sovjetin Suprem të BRSS-në janar 1960). Dhe pikërisht bashkekzistencën paqë-

sore, të kuptuar në këtë mënyrë, sekretari i sotëm i KQ të PK të BS, B. Ponomarjov, e ka quajtur «formën më të lartë të luftës së klasës ndërmjet dy sistemeve të kundërtë — socializmit dhe kapitalizmit» («Pravda», datë 12 gusht 1960).

Megjithëse me fjalë pranojnë se bashkekzistenca paqësore nuk e përjashton, por e presupozon luftën e klasave dhe luftën nacionalçlirimtare, N. Hrushovi dhe grupei i tij në të vërtetë i përbahen pikëpamjes se bashkekzistenca paqësore dhe gara ekonomike midis dy sistemeve janë mjeti kryesor e më efektiv për çlirimin kombëtar e shoqëror të popujve. «Bashkekzistenca paqësore dhe vetëm ajo, ka thënë anëtari i KQ të PK të BS, A. Rumjancev, është rruga më e mirë dhe e vetmja rrugë e pranueshme për zgjidhjen e problemeve me rëndësi jetike që qëndrojnë para shoqërisë» («Probleme të paqes dhe të socializmit», Nr. 1, viti 1962).

Me koncepte të tillë antimarksiste grupei i N. Hrushovit në të vërtetë e ka shtrembëruar konceptin marksist-leninist të bashkekzistencës paqësore, nga njëra anë, duke e shpallur atë «vijë të përgjithshme të politikës së jashtme» të vendeve socialistë, ndërsa nga ana tjetër, duke u përpjekur t'ia imponojë atë si «vijë të përgjithshme» tërë lëvizjes revolucionare e çlirimtare botërore, me qëllim që t'i detyrojë popujt të heqin dorë nga lufta e tyre revolucionare e çlirimtare.

N. Hrushovi ia kundërvë luftën për paqe dhe për bashkekzistencë paqësore lëvizjes revolucionare e çlirimtare botërore. Ai propagandon me të madhe se «lufta për paqe është bërë kushti më i rëndësishëm i luftës për socializëm», se «asnje problem i lëvizjes re-

volucionare të klasës punëtore dhe i lëvizjes nacional-çlirimtare nuk mund të shqyrtohet tani pa u lidhur me luftën për paqe, për shmangjen e luftës termobër-thamore» (Fjalimi i N. Hrushovit më 16 janar 1963 në Kongresin e 6-të të PSB të Gjermanisë). Propagandistët e tij kanë arritur bile deri atje sa ta quajnë çarmatimin «faktorin më të rëndësishëm për çlirimin e popujve kolonialë», sa të thonë se çarmatimi është «qëllimi kryesor i popujve që luftojnë për çlirimin kombëtar». Ç'kuptim tjetër kanë fjalët e N. Hrushovit se «çdo luftë lokale mund të shndërrohet sot në luftë botërore», se «nga çdo shkëndijë mund të ndizet zjarri botëror», përveçse popujt duhet të heqin dorë nga lufta e tyre revolucionare e çlirimtare dhe të pranojnë si qëllimin më të lartë të luftës së tyre pàqen dhe bashkekzistencën paqësore? Po në këtë frymë N. Hrushovi ka thënë se «çarmatimi i plotë e i përgjithshëm do të krijonte mundësi të reja për t'u dhënë ndihmë shteteve, ekonomia e të cilave në kohën e tanishme është akoma e dobët dhe ka nevojë për ndihmë nga ana e shteteve më të zhvilluara», se një ndihmë e tillë (e dhënë edhe nga ana e fuqive imperialiste) «do të mund të hapte një epokë të re në zhvillimin ekonomik të Azisë, Afrikës dhe Amerikës Latine» (Fjalimi i N. Hrushovit në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së më 18 shtator 1959), se «paqja e qëndrueshme në kushtet e çarmatimit të plotë e të përgjithshëm do të lejonte të viheshin të gjitha rezervat që ekzistojnë në botë në shërbim të plotësimit më të madh të nevojave materiale e kulturore të njerëzve».

Grupi i N. Hrushovit jo vetëm përhap iluzione se

çështja e çlirimt e kombëtar e shoqëror të popujve do të vijë automatikisht si rezultat i realizimit të çarmatimit, i garës ekonomike dhe i bashkekzistencës paqësore midis dy sistemeve, duke i hedhur popujt në këtë mënyrë në pasivitet e në pritje, se çlirimi dhe përparrimi do t'u vijë si dhuratë nga jashtë, por, nga ana tjetër, ai nuk thekson aspak se lufta revolucionare e çlirimtare e popujve kundër imperializmit është një forcë e madhe, që luan një rol shumë të rëndësishëm për sigurimin e paqes dhe të bashkekzistencës paqësore dhe për arritjen e çarmatimit, se kjo luftë është një ndihmë e madhe për forcimin e pozitave të sistemit socialist botëror dhe për të gjitha forcat që luftojnë për triumfin e socializmit në botë.

Iluzionet e qëndrimet oportuniste kanë penguar arritjen e sukseseve më të mëdha për çështjen e popujve, të paqes e të socializmit

Demagogjia, pikëpamjet revizioniste dhe veprimtaria praktike e grupit të N. Hrushovit lidhur me çështjet e mësipërme shtrihen edhe në të gjitha çështjet e tjera kardinale të kohës që preokupojnë lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe mbarë njerëzimin. Dhe të gjitha ato vërtetojnë në mënyrë të padiskutueshme vetëm një gjë: se ai, duke u vënë në opozicion të hapët dhe duke minuar deklaratat e Moskës, i ka sjellë dëme shumë të mëdha lëvizjes komuniste dhe tërë lëvizjes revolucionare e çlirimtare në botë.

Këto dëme dalin sidomos në evidencë si njolla të

errëta në sfondin e rezultateve të mëdha që janë arritur në saje të politikës paqedashëse të Bashkimit Sovjetik e të vendeve të tjera socialiste dhe të luftës së proletariatit ndërkombetar, të popujve të shtypur e të forcave të tjera paqedashëse kundër imperializmit, për paqe, liri, demokraci e socializëm. Partia e Punës e Shqipërisë ka përkrahur dhe e ka mbështetur kurdoherë politikën e drejtë të shtetit sovjetik dhe të të gjitha shteteve të tjera socialiste lidhur me problemet e mëdha aktuale, siç janë ai i evitimit të luftës botërore, i çarmatimit dhe i ndalimit të armëve atomike, problemi gjerman dhe i Berlinit Perëndimor etj. Jo vetëm kaq, por Partia jonë ka qenë dhe është luftëtare e vendosur dhe konsekuente për zbatimin deri në fund të politikës së përbashkët të vendeve socialiste për zgjidhjen e këtyre problemeve.

S'ka asnjë dyshim se fitoret e kampit socialist dhe të mbarë popujve do të ishin akoma më të mëdha në qoftë se nuk do të përhapeshin e të mbilleshin mendime subjektive e iluzione të parealizueshme, që janë nisur nga koncepte antimarksiste mbi natyrën dhe qëllimet e imperializmit. Situata e favorshme, e krijuar në saje të luftës së popujve dhe të ashpërsimit të kontradiktave të imperializmit, do të kishte shkuar akoma më përpara në qoftë se mendimeve dhe qëndrimeve oportuniste do t'u pritej rruga, në qoftë se do të zbatoheshin me konsekuençë vija dhe vendimet e përbashkëta.

«Bota pa armë, pa luftëra dhe pa ushtri», e cila gjoja do t'i dhurohej njerëzimit qysh më 1960, përvëç iluzioneve të kota dhe dëmeve për luftën e popujve, as-

një të mirë nuk u solli atyre. Dhe s'kishte si të ndodhë te ndryshe. Sa kohë që ekziston imperializmi, kjo parullë është e parealizueshme. Dhe me të vërtetë, paravësish nga lulet që u janë hedhur «presidentëve paqësorë», imperialistët, gjatë viteve të fundit, kanë vazhduar me të njëjtën egërsi si dhe më parë një varg veprimesh luftarake në anë të ndryshme të botës, si në Kongo, në Vietnamin e Jugut, në Laos, në Angolë etj., duke mbetur në gjak popuj të tërë, për të ruajtur sundimin e tyre kolonial, ose për të rivendosur neokolonializmin, sundimin e shfrytëzimit të pamëshirshëm, të terrorit e të vrasjeve. Revisionistët nuk e kanë konsideruar dhe nuk e konsiderojnë imperializmin të tillë siç është — kështjellë të reaksionit botëror, sepse ata gjithmonë kanë menduar e mendojnë sikur me lajka e lëshime do të mund ta kënaqnin dhe ta bindnin «xhandarin ndërkombëtar» për të krijuar «me arsyе të shëndoshë» «botën pa luftëra».

Ose, lidhur me problemin e çarmatimit të plotë e të përgjithshëm, sa dëme sollën iluzionet e përhapura se krerët e imperializmit amerikan do të shkonin në bisedime «me sinqeritet» për zgjidhjen e këtij problemi! Në të vërtetë, imperialistët i kanë përdorur dhe i përdorin këto bisedime të pafund vetëm si perde tymi për të mbuluar preqatitjet e tyre për luftë. Imperializmi jo vetëm që nuk po çarmatoset, por e ka rritur në maksimum garën e armatimeve, ai po armatoset deri në dhëmbë me mjete gjithnjë e më moderne, duke investuar për këtë dhjetëra miliarda dollarë, ai po u jep armët atomike revanshistëve të Bonit, po pajis me raketa «Polaris» aleatët e tij etj., etj. Kështu qëndron

puna edhe lidhur me ndalimin e provave atomike. Imperializmi amerikan e realizoi programin e shpërthimeve të tij të fundit, ai vazhdon e preqatitet për prova të reja. Në këtë çështje ai s'po bëhet «i arsyeshëm» as nga lëshimet e N. Hrushovit që, ndonëse dikur thoshte se «inspektimi» është një akt spiunazhi, siç është me të vërtetë, pranoi të bëhen tri inspektime të tillë në vit në territorin e Bashkimit Sovjetik. Megjithëkëtë, imperialistët amerikanë, që në fakt nuk janë për ndalimin e provave atomike, nuk janë të kënaqur as me këtë lëshim, ata kërkojnë lëshime të reja, kërkojnë t'u hapen dyert e Bashkimit Sovjetik të paktën me 8 deri 10 inspektime në vit.

Dihet se Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera socialistë prej kohësh kanë përcaktuar drejt dhe kanë koordinuar politikën e tyre edhe lidhur me zgjidhjen e çështjes gjermane dhe të Berlinit Perëndimor. Por ç'gjë të përbashkët me këtë politikë kanë premtimet e bujshme, lëkundjet e herëpashershme dhe tërheqjet «elastike» të N. Hrushovit për këto çështje? Qëndrimi i tij joserioz dhe joparimor duket qartë qoftë edhe vetëm nga këto deklarata të tij:

Në konferencën e shtypit të mbajtur në Kremlin më 27 nëntor 1958, N. Hrushovi, duke argumentuar nevojën e përfundimit të traktatit të paqes me Gjermaninë brenda 6 muajsh, domethënë deri më 27 maj 1959, dhe të zgjidhjes së problemit të Berlinit Perëndimor, deklaronte: «Si pasojë e politikës së fuqive perëndimore, Berlini Perëndimor u shndërrua në një farë tumorë kanceroz. Dhe në qoftë se nuk likuidohet ai, një gjë e tillë kërcënon me një rrezik, i cili mund të ketë pa-

soja mjaft të padëshirueshme. Për këtë ne vendosëm të bëjmë një operacion kirurgjik, domethënë të likuidojmë statusin e pushtimit të Berlinit».

Më 5 mars të 1959-s, në fjalimin e tij në Lajpcig, N. Hrushovi, duke iu referuar afatit të caktuar për firmimin e traktatit të paqes me Gjermaninë, deklaronte: «Ne u kemi thënë dhe u themi udhëheqësve të vendeve perëndimore: në qoftë se ju, zotérinj, dëshironi të bisedoni me ne duke u bazuar në arsyen, ne mund ta shtyjmë këtë afat nga 27 maji më 27 qershor. Në qoftë se doni dhe në korrik, por duhet të zgjidhet çështja e Berlinit Perëndimor, çështja e traktatit të paqes me Gjermaninë».

Mbaroi viti 1959. Ndonjë afat tjeter nuk u caktua, por megjithëkëtë, në konferencën e shtypit në Paris më 18 maj 1960 N. Hrushovi, duke deklaruar se për firmimin e traktatit të paqes me RD Gjermane «projektet tanimë janë gati», theksonte se s'kishte mbetur tjeter veçse «të nxjerrim stilografin nga xhepi, të ulemi, ta nënshkruajmë dhe ta shpallim atë».

Mbaroi edhe viti 1960. Më 15 qershor 1961, në fjalimin e mbajtur me anën e radios e të televizionit, N. Hrushovi deklaronte: «Ne u lutemi të gjithëve të na kuptojnë drejt: nuk mund të shtyhet më përfundimi i traktatit të paqes me Gjermaninë, duhet të arrihet zgjidhja paqësore e çështjeve në Evropë sivjet»; dhe më 21 qershor të 1961-së precizonte: «Ne së bashku me shtetet e tjera paqedashëse do të nënshkruajmë në fund të këtij viti traktatin e paqes me RD Gjermane».

Në fjalimin e mbajtur në radio e në televizioni më

7 gusht 1961, duke argumentuar nevojën e përfundimit imediat të këtij traktati, N. Hrushovi theksonte: «Ç'do të thoshte të shtyhej përfundimi i traktatit të paqes me Gjermaninë edhe për disa vjet të tjerë? Kjo do të thoshte të tregoheshim tolerantë ndaj forcave agresive, të tërhiqeshim para presionit të tyre. Një situatë e tillë do të inkurajonte edhe më tepër NATO-n dhe qeverinë e Bonit për të formuar në Gjermaninë Perëndimore divizione të reja e më të reja, për t'i pajisur ato me armë atomike dhe termobërthamore, për ta kthyer Gjermaninë Perëndimore në forcën kryesore të shpërthimit të një lufte të re botërore». Këtë ide N. Hrushovi e përsëriti edhe në intervistën dhënë gazetarit amerikan D. Pirson më 26 gusht 1961, ku thoshte: «Çdo vonim do të interpretohet nga qarqet revançiste të Gjermanisë Perëndimore si një inkurajim për agresion dhe për shpërthimin e një lufte të re».

Nuk kaluan as dy muaj pas këtyre deklaratave dhe në raportin e mbajtur në Kongresin e 22-të të PK të BS, më 17 tetor 1961, N. Hrushovi shpalli: «Në qoftë se fuqitë perëndimore tregojnë gatishmëri për zgjidhjen e çështjes gjermane, çështja e kohës së nënshkrimit të traktatit të paqes me Gjermaninë nuk do të ketë dhe aq rëndësi, atëherë nuk do të ngulim këmbë që ta nënshkruajmë atë patjetër përparrë 31 dhjetorit 1961».

Kështu mbaroi viti 1961 dhe në fund të vitit 1962, më 7 nëntor, pyetjes së gazetarëve se në ç'datë mund të nënshkruhet traktati i paqes me Gjermaninë, N. Hrushovi iu përgjigj: «Është fjala si për një lindje, kur vjen koha e duhur, fëmija lind. Prisni kohën, pra!». Dhe,

më në fund, në fjalimin e tij në Kongresin e 6-të të PSB të Gjermanisë, pasi e konsideroi ndërtimin e murit midis dy pjesëve të Berlinit si arritjen e asaj që dëshironim, deklaroi: «Tani, në qoftë se e shikojmë çështjen nën prizmin e interesave të drejtpërdrejta të vendeve socialiste, çështja e përfundimit të traktatit të paqes në të vërtetë nuk qëndron ashtu si qëndronte përpara marrjes së masave mbrojtëse në kufirin e RD Gjermane me Berlinin Perëndimor». Fill pas kësaj deklarate, disa pasues të N. Hrushovit e shtruan çështjen se tani kush ngre problemin e traktatit të paqes dhe të Berlinit «bën punën e armikut» dhe «merr anën e luftënxitësve».

Të gjitha këto deklarata sharlataneske s'janë gjë tjetër veçse dëshmi e qëndrimeve të paparim të N. Hrushovit, që diskreditojnë dhe komprometojnë politikën e shtetit sovjetik dhe të kampit socialist.

N. Hrushovi ka pretenduar se e njeh mirë botën me problemet e saj të rënda e të komplikuara dhe se u ka dalë gjërave përpara, por fakti është se ai këto i njeh së prapi dhe është vënë në bisht të tyre.

Pasqyra më e shëmtuar e veprimeve të gabuara e të dëmshme të N. Hrushovit, e koncepteve të tij revisioniste dhe e lëshimeve të tij të paparim është, dyshim, qëndrimi i tij në krizën kubane dhe ndaj konfliktit kufitar kino-indian. Në ngjarjet e Kubës N. Hrushovi veproi edhe si aventurier edhe si kapitullant. Dihet se gjatë zhvillimit të krizës së Karaibeve jo vetëm iu bënë lëshime të njëanshme imperialistëve amerikanë, duke tërhequr nga Kuba raketat, avionët, specialistët ushtarakë, por iu bënë presione të shumta edhe

një vendi sovran që të pranonte kontrollin ndërkom-bëtar të imperializmit amerikan në territorin e vet, për t'i çuar në vend kështu premtimet që iu dhanë presidentit Kenedi nga ana e N. Hrushovit. Kurse lidhur me konfliktin kufitar kino-indian, ai jo vetëm shpalli qëndrimin gjoja asnjanës, por arriti derisa t'i japë ndihma ushtarake klikës reaksionare indiane, që kishte filluar veprime agresive ndaj një vendi socialist.

S'ka dyshim se për dëmet që i ka sjellë dhe po i sjell lëvizjes komuniste e punëtore ndërkom-bëtare me politikën e tij revizioniste, N. Hrushovi diku do të duhet të përgjigjet. Ai do të duhet të përgjigjet si para partisë e popullit të tij, ashtu edhe përpara tërë lë-vizjes komuniste në forumet e ardhshme ndërkom-bëtare.

Ndodh që në luftën e tyre partitë dhe revolucionarët e vërtetë të kenë jo vetëm fitore, por edhe dis-fata, të cilat pjesërisht mund të ndodhin edhe për shkak të gabimeve subjektive. Por partitë komuniste dhe revolucionarët e vërtetë nuk kanë frikë që të kritikojnë drejt dhe që të njohin gabimet e tyre. Kurse me N. Hrushovin ndodh ndryshe: ai ka frikë të njohë gabimet dhe dështimet e tij. Bile jo vetëm kaq, por ai përpinqet me çdo mënyrë t'i fshehë ato me demagogjinë e tij, të shtrembërojë të vërtetën dhe ta paraqitë atë në një dritë të rreme dhe të kërkojë që të tjerët t'i mbajnë ison, të mos e kritikojnë, por të fshehin të vërtetën. N. Hrushovi bën demagogji kur, krahas pikëpamjeve e veprimeve revizioniste, krahas lëshimeve oportuniste të kombinuara me «furtuna në gotë të ujit», që e kanë shpënë në kaq gabime të rënda,

thotë se nuk ka pasur iluzione për imperializmin. Ai bën demagogji kur, krahas mbivlerësimit të bisedimeve dhe rolit të personaliteteve, shpall se përkrah aksionet e masave, lëvizjen revolucionare e çirimitare të popujve dhe lidhjen e tyre me zgjidhjen e problemeve të mëdha, si sigurimi i paqes, çarmatimi, ndalimi i armëve atomike etj. Ai, në fund të fundit, bën demagogji kur shkel e saboton deklaratat e Moskës dhe një-kohësisht betohet për besnikëri ndaj tyre. Natyrisht, në të gjitha këto raste e të tjera të këtij lloji, kur është çështja për zgjidhjen e problemeve akute ndërkombëtare, ai përpinqet të fshehë këmbët e të forcojë demagogjinë me sulme kundër «dogmatikëve luftënxitës» të Partisë së Punës të Shqipërisë etj., duke bërë pyetjen patetike: «Po pse, si doni ju, t'i zgjidhim çështjet me luftë?». Më kot N. Hrushovi shpif kundër PPSH dhe partive të tjera marksiste! Partia e Punës e Shqipërisë kurrë nuk ka menduar se çështjet ndërkombëtare duhet të zgjidhen me luftë. Ajo ka menduar dhe mendon se për zgjidhjen e tyre ka vetëm një rrugë, dhe kjo është zbatimi me konsekuençë i vendimeve të përbashkëta dhe i deklaratave të Moskës, qoftë për çështje të veçanta si ajo e traktatit me Gjermaninë, qoftë për të gjitha çështjet që preokupojnë sot njerëzimin. Këtë ka kërkuar dhe kërkon Partia jonë.

Demagogjia dhe truket N. Hrushovit s'do t'i shkojnë kurrë, sepse një gjë e tillë do të ishte shumë e rrezikshme për tërë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Prandaj është e domosdoshme që t'i vihet gishti plagës me guxim, të vihen gjërat në vend, të zbulohet e vërteta lakuriq, me qëllim që lëvizja jonë të shkojë akoma më

me vrull përpara dhe të përbushë misionin e saj historik. Pikërisht këtë do të bëjnë partitë marksiste-lininiste, pikërisht këtë do të bëjnë revolucionarët e vërtetë.

Pozitat e grupit të N. Hrushovit janë vënë përpara një rreziku serioz, përpara rrezikut të demaskimit të plotë. Dhe s'kishte si të ndodhë ndryshe. Trumbetat revizioniste do të ngjireshin një ditë dhe «heronjtë» opertunistë do të ndesheshin me marksistë-lininistët në gjirin e partive të tyre dhe me komunizmin ndërkom-bëtar. Kursi i tyre antimarksist, i ndjekur me aq bujë, solli një sërë vështirësish për vetë grupet revizioniste, jo vetëm në politikën e jashtme, por edhe në atë të brendshmen — ekonomike, kulturore etj., të cilat nuk mund të mbuloheshin për shumë kohë as me demagogji, as me fjalime pompoze, as me të ashtuquajturat jehona, që tingëllojnë si rënie kambanash pa të kremte.

N. Hrushovi po detyrohet të bëjë organizime e rior-ganizime të shumta në të gjitha fushat e aktiviteteve, të cilat nuk kanë sjellë gjë tjetër veçse një kaos të rrezikshëm për vetë grupin e tij. Atij iu desh me zemër të copëtuar të goditë djalin e tij të dashur Jevtushenko, që e rriti dhe e përkëdheli, që e bëri trumbetuesin e antistalinizmit duke i dhënë vendin e nderit në «Pravda». Por manovrat demagogjike të N. Hrushovit nuk gënjejnë lehtë e për shumë kohë as bolshevikët e popujt sovjetikë, as komunistët e popujt e vendeve të ndryshme.

Përpara vështirësive serioze ndodhen edhe aleatët e N. Hrushovit, të cilët ai i futi në qorrsokak, i kom-prometoi, i lidhi pas qerres së tij dhe tani i heq zvarrë

drejt greminës. Por megjithëkëtë ka njerëz që mendojnë, dhe kjo është pozitive; ka nga ata që reagojnë, dhe kjo është akoma më pozitive; ka dhe nga ata që përpëliten, që tremben dhe s'guxojnë, por që dyshojnë në të ashtuquajturat të mira të këtij kursi revizionist. Këta janë në luftë me partitë e tyre, me shokët e tyre, me ndërgjegjen e tyre, janë në luftë me N. Hrushovin dhe Titon. Revizionistët me damkë me shpatë zhveshur po veprojnë në mënyrë të turpshme për t'i vënë këta njerëz para dilemit, ose përpara në rrugën e plotë të tradhtisë, ose qërohuni se jeni «stalinistë, antimarksistë, dogmatikë, nationalistë»!

Të gjendur përpara pakënaqësisë së masës së komunistëve dhe të popullit, sidomos për shkak të vështirësive që ka krijuar politika e tyre në të gjitha fushat e jetës, edhe aleatët besnikë të N. Hrushovit përdorin demagogjinë, kopojnë në çdo gjë «frymëzuesin» e tyre dhe në të njëjtën kohë përpiqen të çojnë deri në fund «destalinizmin», rehabilitimin total të tradhtarëve, spastrimin e partisë dhe të aparatit shtetëror jo vetëm nga «stalinistë» por edhe nga «të vagëtit», nga «hezituesit». Këta revizionistë përpiqen të tregohen më katolikë se papa, sepse vetëm në këtë shohin shpëtimin e tyre. Por sulmi i tyre i ngjet sulmit të Don Kishotit mbi mullinjtë e erës.

Grupi i N. Hrushovit përpara presionit të marksistë-leninistëve përpiqet të mbrohet duke bërë gjoja të vetat argumentet e marksistëve, ata venë deri atje sa, për të mashtruar masat, nga koha në kohë i këndojnë edhe Stalinit. Revizionistët i dinë mirë fijet e komplottit të madh që kurdisën kundër Bashkimit So-

vjetik dhe komunizmit ndërkombëtar duke sulmuar veprën dhe personin e J.V. Stalinit. Por edhe marksistët ua kanë zbuluar këto fije dhe po ua presin ato njërën pas tjetrës, aq sa merimanga e zezë një ditë do të mbetet pa pëlhirën e vet. N. Hrushovi e di fare mirë se ç'rëndësi kolosale ka çështja e Stalinit jo vetëm për Bashkimin Sovjetik, po për gjithë komunizmin ndërkombëtar, për vetë marksizëm-leninizmin. Ai kujtoi se e likuidoi dhe e kapërceu këtë çështje, ai kujtoi se kri-joi një «gogol» të tmerrshëm në botë, kaq sa jo vetëm nuk do të guxonte ta mbronte më njeri, por edhe emri i Stalinit nuk do të zihej në gojë. Mirëpo ngjau e kundërtë. Marksistë-leninistët dhe revolucionarët e vërtetë, popujt përditë e më mirë po e shohin se çështja e J. Stalinit është një çështje me rëndësi parimore në luftën midis marksistëve dhe revizionistëve, sepse ajo ka të bëjë me mbrojtjen e leninizmit, se, pa u vënë në vend Stalini dhe vepra e tij, nuk mundet të ecë përpëra lëvizja revolucionare, çështja e marksizëm-leninizmit. E drejta nuk mund të errësohet, sepse ajo është dritë; gënjeshtra, shpifja dhe demagogjia janë armët e komplotistëve, armët e errësirës.

N. Hrushovi në front të përbashkët me revizionistët jugosllavë

Në letrën që KQ i PK të BS i dërgoi më 30 mars 1963 KQ të PK të Kinës, jo vetëm që flitet për një të ashtuquajtur «çështje shqiptare», por ajo vihet edhe në një plan me çështjen jugosllave, me fjalë të tjera,

RP e Shqipërisë krahasohet me Jugosllavinë titiste dhe PPSH me klikën renegate të Beogradit.

Dihet se N. Hrushovi ka ndjekur me këmbëngulje ndaj Jugosllavisë vijën e pajtimit, të afrimit e të bashkimit të plotë, të bashkëpunimit të gjithanshëm, duke kriuar një front të përbashkët me klikën e Titos, nën pretekstin se Jugosllavia «është një vend socialist» dhe LKJ «një parti motër». Dhe këtë vijë të tij, që është në kundërshtim flagrant me Deklaratën e vitit 1960, në të cilën revisionistët jugosllavë janë dënuar njëzëri si renegatë nga të gjitha partitë komuniste e punëtore, ai përpinqet t'ia imponojë tërë lëvizjes komuniste ndërkombëtare, duke sulmuar me egërsi të gjithë ata që i qëndrojnë besnikë Deklaratës dhe kundërshtojnë afrimin me klikën titiste, orvatjet e N. Hrushovit për ta futur Jugosllavinë në familjen e vendeve socialiste dhe LKJ në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Për të mashtruar opinionin publik, për të justifikuar pikëpamjet e veprimtarinë e vet, N. Hrushovi trumbeton se në Jugosllavi «po bëhen ndryshime», se «politika e jashtme e Jugosllavisë përputhet me politikën e shteteve socialiste», se, në fund të fundit, «për disa çështje ideologjike shikon divergjencë serioze dhe për këtë do të flitet hapur me shokët jugosllavë». Demagogjia e N. Hrushovit nuk mashton dot njeri, sepse për të gjithë është e qartë se asnje «ndryshim» nuk është bërë e nuk po bëhet në Jugosllavi nga klika titiste që të tregojë se atje po korrigohen gabimet, por përkundrazi, në mënyrë të pandalshme po ecet në rrugien e tradhtisë, në rrugien e rivendosjes së kapitalizmit. Vetë udhëheqësit e revisionistëve jugosllavë më se

një herë kanë deklaruar se asnje ndryshim nuk është bërë dhe nuk do të bëhet në kundërshtim me programin e LKJ të aprovuar nga Kongresi i saj i 7-të. Përse N. Hrushovi nuk ia tregon lëvizjes komuniste se ku konsistojnë ndryshimet për të cilat flet ai? Përse, në vend të fjalëve të përgjithshme, nuk sjell fakte konkrete? Është e qartë se fakte konkrete nuk ka dhe s'ka për të gjetur kurrë.

N. Hrushovi e kupton se është e pamundur të futet minarja në thes, se nuk është e lehtë të bindet komunizmi ndërkombëtar se ai respekton Deklaratën e Moskës kur e shpall Jugosllavinë një vend socialist. Prandaj, për t'u treguar gjoja parimor, thekson se për disa çështje ideologjike nuk është dakord me «shokët» jugosllavë dhe se këto do t'ua thotë atyre. Por cilat janë këto çështje ideologjike dhe si do t'u thuhen vërejtjet atyre, sheshit apo në mënyrë konfidenciale? Deklarata e Moskës thekson se detyra e partive komuniste është të demaskojnë pandërprerë revizionizmin jugosllav. Këtë konkluzion të drejtë të Deklaratës N. Hrushovi dhe grupi i tij jo vetëm e kanë lënë në harresë, por përkundrazi, janë sulur më se një herë dhe sulen me arrogancë kundër atyre partive që me besnikëri zbatojnë Deklaratën dhe që demaskojnë pikëpamjet e veprimtarinë e renegatëve titistë.

Të gjitha faktet tregojnë se N. Hrushovi e grupi i tij, duke shqelmuar deklaratat e Moskës, jo vetëm kanë hequr dorë nga lufta për demaskimin e revizionizmit jugosllav, por prej vitesh po ndjekin me këmbëngulje vijën e bashkimit të plotë me të, duke krijuar kështu frontin e përbashkët revizionist. Dhe kjo ndodh jo pse

klika e Titos ka «ndryshuar», por sepse ka ndryshuar qëndrimi i N. Hrushovit e i grupit të tij, të cilët kanë kaluar vetë në pozitat e revizionizmit, në pozitat e anti-marksizmit. Kjo duket qartë edhe në qëndrimin ndaj një teze tjetër të deklaratave të Moskës, të asaj që e përcakton revizionizmin si rrezikun kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkontaktare.

N. Hrushovi edhe për këtë çështje thotë se respekt ton deklaratat e Moskës, se bile zhvillon një luftë në dy fronte: kundër revizionizmit e kundër dogmatizmit. Por si qëndron e vërteta? Përveç klikës renegate të revizionistëve jugosllavë, dihet gjithashtu se pikëpamjet revizioniste janë përqafuar, përveç të tjerave, edhe nga udhëheqja e PK të Italisë me P. Toliatin në krye, pikëpamje që kanë gjetur shprehjen e tyre në shumë dokumente e materiale zyrtare të saj. Megjithatë, N. Hrushovi dhe grupi i tij nuk kanë thënë as edhe një fjalë të vetme kritike për këto pikëpamje oportuniste; përkundrazi, kanë marrë nën mbrojtje dhe përfitojnë nga çdo rast për t'i thurur lëvdata vijës revizioniste të P. Toliatit e shokëve të tij, duke e paraqitur atë si një shembull të «marksizmit krijues». Një nga shfaqjet më të shëmtuara të revizionizmit modern është edhe grupi i Dangës në Indi, i cili është bërë një shërbëtor i bindur i qarqeve më reaksionare të borgjezisë indiane dhe ka kaluar në tradhti të hapët e në socialshovinizëm. Por edhe ndaj këtij grupi tradhtar e vijës së tij N. Hrushovi dhe përkrahësit e tij jo vetëm nuk kanë thënë asnjë fjalë kritike, por përkundrazi, bëjnë «takime të përzemërtë» me Dangen, duke e inkurajuar kështu atë të ecë edhe më tej në rrugën e tradhtisë.

Ku është, pra, «lufta e vendosur» e N. Hrushovit dhe e grupit të tij kundër revizionizmit? Ata kanë hequr dorë nga kjo luftë, sepse vetë qëndrojnë në pozitat e revizionizmit, bile përpiken me çdo mjet t'i detyrojnë edhe të tjerët të heqin dorë nga një luftë e tillë. Në fakt, gjithë tehun e luftës së tyre N. Hrushovi dhe grupei i tij e kanë drejtuar kundër të ashtuquajturit «dogmatizëm», me të cilin ata nënkuptojnë në të vërtetë marksizëm-leninizmin.

N. Hrushovi mban një qëndrim të hapët armiqësor kundër PPSH dhe RPSH

Në letrën e 30 marsit drejtuar KQ të PK të Kinës, grupei i N. Hrushovit, siç e thamë qysh në fillim të këtij artikulli, sulet me shpifje e akuza kundër PPSH, duke treguar në këtë mënyrë edhe një herë qëllimet e tij përcarëse. Ne nuk na çudit aspak ky fakt. N. Hrushovi vazhdon me konsekuencë qëndrimin armiqësor ndaj PPSH, sepse PPSH është dëshmitare e gjallë, «e padëshiruar», mbi kurrizin e së cilës janë eksperimentuar, por pa sukses, të gjitha «normat» e N. Hrushovit në marrëdhëniet me partitë motra dhe vendet e kampit socialist, që nga lajkat e premtimet e deri te ndërhyrjet më brutale, presionet, bllokadat, shpifjet dhe thirrjet për kundërrrevolucion. Sa cinike duken dhe sa false tingëllojnë deklaratat që dëgjohen shpesh, veçanërisht këto kohët e fundit, nga revisionistët e grupit të N. Hrushovit, se udhëheqja sovjetike u përbahet parimeve të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tje-

trit, të respektimit të çdo partie, e madhe apo e vogël qoftë, të ndihmës e përkrahjes reciproke, se nxjerrja sheshit e mosmarrëveshjeve dhe sulmet publike kundër partive motra mund vetëm t'i thellojnë divergjencat, se shtrirja e mosmarrëveshjeve ideologjike në fushën e marrëdhënieve shtetërore midis vendeve socialiste është krejt e palejueshme dhe shumë e dëmshme etj., etj.!

Në letrën e fundit drejtuar PK të Kinës N. Hrushovi ndjek takтикën e tij të vjetër, të sulmeve, nga njëra anë, dhe të mashtrimit të opinionit publik, nga ana tjetër.

Ai vazhdon pretendimin e tij të njojur se gjoja ai ka bërë dhe vazhdon të bëjë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe normalizimin e marrëdhënieve midis dy partive e dy vendeve tonë, porse të gjitha këto përpjekje nuk paskan gjetur «jehonën e duhur» nga ana e udhëheqjes shqiptare.

Ne e kemi thënë prej kohësh dhe e përsërisim se këto pretendime nuk kanë asnjë bazë. Partia e Punës e Shqipërisë më se një herë ka sqaruar me fakte e dokumente të shumta se udhëheqja e sotme sovjetike, me N. Hrushovin në krye, jo vetëm nuk ka bërë asnjë hap për përmirësimin e marrëdhënieve sovjeto - shqiptare, por përkundrazi, ka ecur me këmbëngulje në rru-gën e thellimit e të acarimit të mëtejshëm të mosmarrëveshjeve, duke kryer akte armiqësore, njërin më të rëndë se tjetrin, kundër Partisë dhe vendit tonë. Në artikullin e 7 shkurtit 1963, për të nxjerrë në shesh të vërtetën përpara opinionit publik, KQ i PPSH i propozoi KQ të PK të BS të botojmë bashkërisht materialet

e dy partive e qeverive tona, korrespondencën e zhviluar midis nesh lidhur me mosmarrëveshjet. Por ky propozim yni është pritur me heshtje varri nga grupi i N. Hrushovit. Është e qartë se N. Hrushovi ka frikë nga e vërteta dhe nuk dëshiron që opinioni publik të njohë me dokumente realitetin, që të shohë se përse është përpjekur në fakt ai dhe ku ka synuar duke nxitur e duke acaruar mosmarrëveshjet sovjeto-shqiptare. Prandaj ai preferon të ndjekë rrugën e demagogjisë.

Këtë rrugë përpinqet të ndjekë ai edhe kur shkruan në letrën e 30 marsit drejtar KQ të PK të Kinës se «KQ i PK të BS tregoi edhe një herë iniciativën dhe i bëri KQ të PPSH propozimin për zhvillimin e një takimi të dyanshëm të përfaqësuesve të të dy partive tona». Do të kishte qenë shumë më mirë që KQ i PK të BS ta citonte plotësisht letrën e tij drejtar KQ të PPSH për këtë qëllim, aq më tepër që ajo përbëhet vetëm nga pak rreshta, në mënyrë që komunistët e botës të bindeshin për «hapin shoqëror» dhe për zbatimin në praktikë nga ana e udhëheqësve sovjetikë, me N. Hrushovin në krye, të parimeve të respektit, të barazisë e të pavarësisë së partive motra (!?). Ne ia propozojmë KQ të PK të BS që ta bëjë një gjë të tillë. Nga ana jonë, duke marrë parasysh faktin se letërkëmbimin midis dy partive tona në fillim të marsit 1963 N. Hrushovi përpinqet ta përdorë për shpifje të reja kundër PPSH, po citojmë këtu tekstin e plotë të përgjigjes sonë dërguar KQ të PK të BS në datën 13 mars 1963:

«Në datën 11 mars 1963 në KQ të PPSH u prit i ngarkuari me punë i RS të Çekoslovakisë në Tiranë, Miroslav Hollub, me kërkesën e këtij të fundit. I ngar-

kuari me punë i RS të Çekoslovakisë, me porosi të KQ të PK të BS, dorëzoi për informacion një letër që KQ i PK të BS i ka drejtuar KQ të PK të Kinës, së bashku me një letër përcjellëse drejtuar KQ të PPSH, të përbërë prej disa rreshtash, me anën e së cilës KQ i PK të BS, duke pretenduar që letra e tij drejtuar një partie të tretë të jetë si bazë për normalizimin e marrëdhënieve sovjeto-shqiptare, në të kaluar e sipër, propozon që «midis PK të BS dhe PPSH të organizohen bisedime dypalëshe». KQ i PPSH mendon se një hap i tillë i KQ të PK të BS, i bërë në këtë mënyrë, duke marrë shkas letrën e KQ të PK të BS drejtuar KQ të PK të Kinës, e cila përbante argumente dhe konsiderata që u përkasin marrëdhënieve dhe nevojës për bisedime midis PK të BS dhe PK të Kinës, e paraqit në fakt PPSH të varur nga një parti tjeter, gjë që nuk mund të konsiderohet ndryshe veçse si diskreditim, denigrim dhe përbuzje për PPSH, shkelje e parimit të barazisë e të respektit reciprok, si parim elementar në kontaktet e marrëdhënieve midis partive komuniste e punëtore. Prandaj letra e mësipërme e KQ të PK të BS nuk u muar në dorëzim, si e papranueshme.

KQ i PPSH nuk mund të mos mendojë se KQ i PK të BS tregon edhe një herë mungesën e dëshirës së singertë për normalizimin e marrëdhënieve midis dy partive tona dhe, me sa duket, përpinqet të sigurojë një pretekst fals se gjoja PPSH nuk pranon bisedime dy-palëshe.

KQ i PPSH, që në marrëdhëniet me partitë motra u përbahet normave leniniste të respektit reciprok, ka qenë dhe është gati të pranojë dhë të studiojë me

vëmendje çdo letër e çdo propozim që KQ i PK të BS do t'i drejtojë Partisë sonë, por ai do të hedhë poshtë çdo orvatje për të diskredituar PPSH, për të shkelur pavarësinë e saj, të drejtat e saj të barabarta në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. PPSH ka qenë dhe është kurdoherë gati për bisedime dypalëshe me PK të BS, në rast se KQ i PK të BS do të krijojë të gjitha kushtet e barazisë së plotë».

Siq del qartë nga letra e sipërme e KQ të PPSH drejtuar KQ të PK të BS, e ashtuquajtura «iniciativë» e udhëheqjes sovjetike për bisedime dypalëshe në të vërtetë ndiqte qëllime keqdashëse, përbënte një orvatje për të diskredituar PPSH, për të marrë nëpër këmbë pavarësinë e saj.

Ne jemi plotësisht të bindur se për N. Hrushovin ishte fare e qartë se propozimi për bisedime dypalëshe me PPSH, i bërë në atë formë, duke e konsideruar Partinë tonë vetëm si një shtojcë të një partie të tretë, ishte i papranueshëm për PPSH, si për çdo parti të pavarur që ka respekt për veten e saj. Por atij iu desh kjo për demagogji, për të mashtruar të tjerët, për t'ia hedhur fajin Partisë së Punës të Shqipërisë dhe për të justifikuar kështu kursin e tij të luftës kundër PPSH e RPSH, orvatjet e tij për t'i nxjerrë ato nga radhët e lëvizjes komuniste e të kamipit socialist. Atij iu desh kjo për ta pasur si pretekst dhe për të treguar me të se gjoja ai ka bërë gjithçka për normalizimin e marrë-dhënieve sovjeto-shqiptare, por udhëheqësit shqiptarë çenkan kundër çdo takimi e bisedimi. Nuk kaloi shumë kohë dhe ky parashikim i Komitetit Qendror të PPSH u vërtetua plotësisht. Për këtë dëshmon qartë letra që

KQ i PK të BS i dërgoi më 30 mars KQ të PK të Kinës.

Duhet thënë se N. Hrushovi me këmbëngulje përpigjet të vazhdojë lojën e tij. Është kuptimplotë fakti që udhëheqësit sovjetikë në letrën drejtar KQ të PK të Kinës theksojnë: «Në qoftë se është treguar me të vërtetë dëshira, ne jemi gati ta bëjmë një takim të tillë». Edhe këtu ndiqet e njëjtë taktikë: si të thuash, «ne e shprehëm dëshirën tonë», «e zumë qoshen», «ne e thamë fjalën tonë nëpërmjet PK të Kinës», tani fjalën e kanë udhëheqësit shqiptarë. Ne u themi udhëheqësve sovjetikë: drejtojuni direkt KQ të PPSH, por duke zbatuar normat e njohura të respektit e të marrëdhënieve reciproke midis partive. Krijoni kushtet e barazisë së plotë, të cilat deri tani i keni shkelur me të dyja këmbët në marrëdhëniet me PPSH dhe me RPSH, në qoftë se jeni me të vërtetë pér normalizim të marrëdhënieve tona. Hidhni tej dorezat diplomatike, arsyetimet boshe mbi prestigjin dhe frazat demagogjike. Mos harroni se jeni shumë fajtorë ndaj PPSH e RPSH. Në qoftë se mendoni se mund t'i kapërceni lehtë veprimet antimarksiste e antishqiptare që ju keni bërë ndaj PPSH e RPSH, gaboheni rëndë!

Por N. Hrushovi dhe grupi i tij nuk janë sinqerisht pér bisedime dhe pér zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me PPSH. Këtë e vërteton qoftë edhe fakti që udhëheqësit sovjetikë, edhe kur flasin pér bisedime e pér zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, vazhdojnë sulmet e shpifjet kundër PPSH. Ata i akuzojnë udhëheqësit shqiptarë se gjoja vazhdojnë «veprimet e tyre përçarëse» dhe «ndërmarrin sulme shpifëse» kundër PK të BS dhe popullit sovjetik.

Grupi i N. Hrushovit, duke akuzuar si përçarëse PPSH, përpinqet të humbasë gjurmët e veprimtarisë së vet përçarëse. Çfarë quan «veprime përçarëse» të udhëheqësve shqiptarë N. Hrushovi? Mos vallë duhet quajtur veprim përçarës fakti që PPSH nuk iu nënshtrua diktatit të N. Hrushovit në Mbledhjen e Bukureshtit e të Moskës, që ajo pati guximin të shfaqë pikëpamjen e saj dhe, në mbledhje të komunizmit ndërkombëtar, të kritikojë pikëpamjet e veprimet e tij antimarksiste, kurse komplotet e N. Hrushovit kundër partive motra marksiste-leniniste prapa krahëve dhe orvatjet për të térhequr në to, me anë kërcënimesh e presionesh, partitë e tjera, u dashkan quajtur veprime marksiste-leniniste në dobi të unitetit? Përse u dashka të lavdërojmë si «elasticitet marksist-leninist» shkeljet flagrante të deklaratave të Moskës nga ana e N. Hrushovit, kurse mbrojtjen e tyre nga ana e PPSH dhe e partive të tjera marksiste-leniniste u dashka ta quajmë veprim përçarës? Jo, nuk është PPSH, por është grupi i N. Hrushovit ai që, me pikëpamjet dhe veprimet e veta, ka dëmtuar e po dëmton rëndë unitetin e kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, është ai që ka futur e po thellon çdo ditë e më shumë përçarjen në radhët tona. Dhe në qoftë se grupi i N. Hrushovit bën zhurmë për unitetin, faktet tregojnë se ai nuk është për një unitet të vërtetë marksist-leninist, po për një unitet të rremë antimarksist, jo mbi bazën e deklaratave të Moskës, por mbi një bazë revizioniste.

Në letrën e KQ të PK të BS të 30 marsit drejtuar KQ të PK të Kinës, thuhet se «udhëheqësit shqiptarë kanë ndërmarrë e vazhdojnë të ndërmarrin sulme shpi-

fëse» kundër PK të BS e popullit sovjetik. Ku, në ç'rast ne kemi shpifur kundër PK të BS dhe popullit sovjetik? Le të na tregojë qoftë edhe një shembull të vetëm N. Hrushovi. Partia dhe populli ynë kurdoherë kanë ushqyer e ushqejnë një dashuri të madhe e respekt të thellë për Partinë e lavdishme Bolshevikë, të themeluar nga Lenin, dhe për popullin vëlla sovjetik. Ne gjithmonë i kemi konsideruar e i konsiderojmë ata si miqtë tanë të zemrës, ushqejmë për ta ndjenjat internacionale më vëllazërore, u kemi qenë, u jemi e do t'u jemi përjetë mirënjoës për gjithçka ata kanë bërë për të mirën e popullit e të Partisë sonë. Partia e Punës e Shqipërisë i edukon vazhdimisht masat e komunistëve dhe të popullit me dashuri për Bashkimin Sovjetik. Kjo duket në të gjithë veprimtarinë e propagandën e saj, kjo duket edhe në shtypin tonë, i cili i mban ata në koren mbi jetën e sukseset e punonjësve sovjetikë, paravarësisht se në shtypin sovjetik prej tre vjetësh nuk është shkruar asnjë fjalë mbi përpjekjet e luftën për socializëm të popullit shqiptar. Lufta parimore që bën PPSH kundër revizionizmit modern është njëkohësisht edhe një luftë për mbrojtjen e Bashkimit Sovjetik. Koha do ta vërtetojë këtë.

Edhe ndaj vetë grupit të N. Hrushovit ne nuk kemi bërë kurrë ndonjë shpifje. Ne kemi thënë gjithnjë të vërtetën, duke iu referuar fakteve reale, qëndrimeve e veprimeve të N. Hrushovit. Ne kemi thënë dhe themi se N. Hrushovi i pari i nxori sheshit mosmarrëveshjet tona në Kongresin e 22-të të PK të BS, duke u dhënë armë armiqve tanë dhe duke krijuar kështu një precedent të rrezikshëm në lëvizjen komuniste ndërkombëtarë.

bëtare, kur kongresi i një partie përdoret si tribunë për të sulmuar e për të dënuar arbitrarisht partitë e tjera. Ne kemi thënë dhe themi se grapi i N. Hrushovit ndërprenë gjitha kreditë, tërroqi të gjithë specialistët sovjetikë nga Shqipëria, dëboi studentët shqiptarë nga shkollat e Bashkimit Sovjetik, prishi të gjitha marrëveshjet tregtare, kulturore e ushtarake, bile preu edhe marrëdhëniet diplomatike, duke vendosur kështu një bllokadë të plotë kundër RPSH. Ne kemi thënë dhe themi se grapi i N. Hrushovit i ka shpallur në mënyrë shpifëse udhëheqësit e PPSH si agjentë të imperializmit të shitur për 30 aspra. Ne kemi thënë dhe themi se N. Hrushovi dhe njerëzit e tij kanë marrë hapur nën mbrojtje armiqë e pushtetit tonë popullor, të dënuar si tradhtarë të atdheut e agjentë të spiunazheve të huaja, si dhe elementët e ndryshëm antiparti, dhe në të njëjtën kohë kanë bërë thirrje për përblyesjen e udhëheqjes së partisë e të shtetit në Shqipëri, duke ndërhyrë kështu brutalisht në punët e brendshme të Partisë e të vendit tonë. Të gjitha këto janë të faktuara me dokumente. Ne do të mund të përmendnim këtu edhe shumë fakte të tjera, si, për shembull, veprimet armiqësore dhe arbitraritetet e grupit të N. Hrushovit ndaj RPSH lidhur me Traktatin e Varshavës dhe KNER-in. Por tani nuk e shohim të nevojshme të zgjatemi në këtë çështje dhe në të tjera.

Të tilla janë disa nga faktet të cilave ne u jemi referuar në polemikën me grupin e N. Hrushovit. Në qoftë se këto janë shpifje, siç thotë N. Hrushovi, atëherë le të marrë guximin e t'i mohojë publikisht këtakate, të cilat tani njihen nga tërë bota, akte që në

tërësi në praktikën ndërkombëtare u ngjasin vetëm masave që një vend ndërmerr kundër një vendi tjetër vetëm në prag të shpalljes së luftës.

Në të vërtetë nuk jemi ne, por është N. Hrushovi ai që shpif me paturpësi kundër Partisë dhe vendit tonë. Ç'kërkon N. Hrushovi? Mos vallë që ne të mbyllim gojën e të heshtim, kurse ai të vazhdojë të diskreditojë, të shpifë dhe të veprojë në dëm të PPSH e RPSH? Kjo është e papranueshme. Le të jetë një herë e mirë e qartë se kjo nuk është rruga e drejtë që shpie në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe normalizimin e marrëdhënieve sovjeto-shqiptare.

Në qoftë se N. Hrushovi është për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe forcimin e unitetit, këtë duhet ta tregojë me vepra, të ndërmarrë hapa realë e jofiktivë, të heqë të gjitha pengesat që ai ka krijuar në marrëdhëni midis dy partive e dy vendeve tona. Ashtu siç guxoi të sulmojë në mënyrë shpifëse, të ndërhyjë në punët e brendshme dhe të kryejë veprime armiqësore kundër Partisë e vendit tonë, ashtu ai duhet të marrë edhe guximin t'i dënojë botërisht köto qëndrime e veprime antimarksiste dhe të kthehet në respektimin rigoroz të normave internacionale të marrëdhënieve midis partive komuniste e punëtore e midis vendeve socialistë. Ne do të mirëprisnim çdo hap të sinqertë në këtë drejtim.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 92 (4562), 18 prill 1963

Botohet me disa shkurtimë si pas gazetës «Zëri i popullit», Nr. 92 (4562), 18 prill 1963

**MUZIKA DHE KËNGËT KANE RËNDËSI TË MADHIE,
T'I VLERËSOJMË DHE T'I INKURAOJMË
DREJT ATO**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

10 maj 1963

Në përgjithësi në fushën e muzikës dhe të artit janë bërë përparime dhe ka ndryshuar mendimi për to. Në pushtetin popullor s'ka përcëmim për muzikën dhe artin tonë, ashtu siç bënte borgjezia në të kaluarën, e cila jo vetëm që nuk i kultivonte këto, por edhe i nën-çmonte. Kompozitorët tanë meritojnë të lavdërohen, sepse kanë arritur suksese të mëdha në punën e tyre. Kjo ndodh sepse këta shokë e kanë kuptuar mirë vijën e Partisë dhe rëndësinë e muzikës në jetën socialiste.

Dihet se muzika, në çdo vend, ka shprehur karakteristikat e jetës dhe të shijes së popullit. Këtë mund ta shohësh qoftë në folklor, qoftë në muzikën e përpunuuar.

1 Në këtë mbledhje u diskutua për zhvillimin e muzikës së lehtë dhe të këngës. Në mbledhje ishin ftuar dhe anëtarë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve.

Në to janë pasqyruar kurdoherë ndjenjat dhe aspiratat e popullit. Prandaj orientimi që ka dhënë Partia për t'i vënë rëndësi folklorit, është shumë i drejtë. Është me vend ajo që u tha në këtë mbledhje se folklori bën evolucion e nuk mbetet i pandryshuar e i papërpunuar. Po ta shikosh nga ana shkencore konstaton se folklori ynë ka ndryshuar, është zhvilluar e është pasuruar. Por, gjatë procesit të zhvillimit, ne do të ruajmë në folklorin dhe në muzikën tonë karakteristikat kombëtare dhe do të forcojmë përbajtjen socialiste. Duke u mbështetur në muzikën popullore, të krijojmë një muzikë me të vërtetë shqiptare, që të jetë e afërt dhe e dashur për popullin.

Kur themi se duhet të ruajmë folklorin dhe karakteristikat e muzikës sonë kombëtare, kjo nuk do të thotë që njerëzit tanë të muzikës të mos inspirohen nga muzika e madhe e popujve të tjerë, po ajo të jetë një urë që zgjeron horizontin në punën krijuese për të pasqyruar ndjenjat dhe veprën e popullit të vet. Herë pas herec unë lexoj biografi të muzikantëve të ndryshëm. Po të marrësh Bizenë, shikon se ai e ka shkruar «Arlezianën» i bazuar mbi dramën me të njëjtin emër të shkrimittarit francez A. Dode. Unë kam qenë në ato vende dhe po ju them se kur dëgjoj muzikën e tij shikoj se ai ka ruajtur karakteristikën e Provancës dhe pasqyron jetën e shijen e popullit francez. Ose të marrim Listin. Në rapsodinë hungareze ai është inspiruar gjatë një nate, duke ndenjur me ciganët, kur kishte vajtur në fshatin e tij. Duke dëgjuar muzikën e popullit, ai mundi të gjallërohet e të mbështetet në të. Por kjo muzikë e Listit nuk është një kopje folklori të thatë, por vepra më e madhe e tij.

Ose të marrim kompozitorin austriak Hajdnin. Ai, me gjithëse ishte një klasik tipik, prapëseprapë u përpoq të shkëputet nga recetat dhe të mbështetet në muzikën e popullit. Prandaj, me receta mendoj se nuk duhet shkruar. Unë them se këto çështje mund dhe duhet të diskutohen midis muzikantësh, kjo nuk është ndonjë gjë e keqe. Ju, shokë, që merreni me muzikë, keni një rol të madh, sepse nëpërmjet jush Partia siguron partishmërinë në muzikë. Partia ju ka edukuar drejt ju, prandaj ajo ka besim se edhe ju do ta udhëhiqni drejt muzikën.

Puna e muzikës është e rëndë. Unë bisedoj shpesh me Nexhmijen¹ për vështirësitë që paraqit muzika (me këtë s'dua të them se puna e shkrimittarëve është e lehtë). Muzikë nuk mund të kompozojë kushdo, mua më duket se të kompozosh është një punë shumë e vështirë.

Mendoj se muzika e lëhtë nuk duhet të konsiderohet ashtu siç e kuptojnë disa — vetëm pér vallëzim, sepse ka vallëzim e vallëzim. Ka vallëzime dekadente, siç janë ato të Perëndimit, të cilat tani janë përhapur edhe në vendet socialiste ku në fuqi kanë ardhur revizionistët. Këto klika u kanë hapur rrugën xhazeve, muzikës dekadente etj. dhe po shkojnë drejt degjenerimit të plotë.

Drejt u tha këtu që tangoja është tango, po tangoja jonë duhet të ketë dhe intonationet shqiptare, ajo duhet kompozuar në mënyrë të tillë që të ketë në rregull e në harmoni formën me përbajtjen. Nuk është e drejtë që tërë muzika e lehtë të përbëhet vetëm nga tema e dashurisë. Kjo nuk do të thotë që në muzikën tonë të lehtë

1 Në atë kohë drejtore e Drejtorisë së Arsim-Kulturës në aparatin e KQ të PPSH.

të eliminohet tema e dashurisë. Kur ishim në një rast në Shkodër, në një koncert u kënduan 7 këngë dashurie. Po përse të ekzistojë kjo njëanshmëri aq më shumë kur dihet se Shkodra ka kaq kompozitorë? Çështja është që të ketë këngë sa më të larmishme, me një përbajtje të shëndoshë politike c shoqërore, të ketë dhe këngë patriotike, këngë mbi punën etj. Natyrisht, të ketë edhe këngë për dashurinë e pastër socialistë. Veç kësaj, muzika e lehtë të jetë jo vetëm për të kërcyer, por dhe për të kënduar.

Mendoj se studimi i folklorit është një gjë e mirë, por të njohësh vendin në tërësi si muzikant është një gjë akoma më e mirë, më e gjerë, më e plotë. Në qoftë se themi për shkrimitarët që duhet të njohin jetën e popullit, përpjekjet e tij në ndërtimin e socializmit, bukuritë e natyrës shqiptare etj., që të nxjerrin vepra të përshtatshme për popullin tonë, këtë duhet ta themi edhe për kompozitorët. Kjo është një bazë e madhe frymëzimi. Ata që kanë fituar një kulturë të lartë, që njohin muzikën dhe folklorin, kur venë dhe njihen edhe me masat, me punën e tyre të gjallë, mund të bëjnë vepra shumë të bukura. Në qoftë se veprojnë kështu, ata kurritë nuk do të gabojnë, po përkundrazi do të dinë të shfrytëzojnë kulturën e tyre të madhe për t'i shërbyer sa më mirë popullit, do të dinë t'i japin muzikës intonationet e popullit tonë. Vajtja në bazë për të ndihmuar kuadrot do të jetë një punë e lavdërueshme, sidomos për ju që jeni kuadro të lartë. Kur të tjerët do të shkojnë Çesk Zadenë, Tish Dainë e të tjerë që të shkojnë në bazë, atëherë do të venë edhe ata. Në këtë drejtim ju do të keni ndihmën e Partisë dhe të Qeverisë.

Folklori, jeta e popullit dhe veçoritë e vendit, duke përfshirë dhe veçoritë e natyrës, lënë vulën e tyre mbi muzikën e një vendi dhe e bëjnë atë të dallohet nga muzika e vendeve të tjera. Ndoshta mund edhe të gaboj, por mund të them se unë e dalloj muzikën franceze-dhe italiane nga ajo gjermane. Ashtu si dallojmë muzikën ruse nga muzika jonë. Unë vë re se në muzikën ruse, në tingujt dhe në melodinë e saj të shtruar pasqyrohet edhe natyra e ftohtë e vendit dhe hapësirat e mëdha të tij. Te ne s'ka hapësira të mëdha, po male e gërxhe, lumenjtë janë të rrëmbyeshëm e jo të qetë si Vollga. Muzika jonë krahas tipareve të reja të shoqërisë socialiste duhet të shprehë edhe tiparet e natyrës sonë. Prandaj muzika jonë duhet të jetë e gjallë. Ju këto i ndieni vetë dhe i shprehni në muzikë. Muzika jonë ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Ajo ngjall optimizëm dhe pa optimizëm nuk ecet përpara. Ne kemi një popull heroik, inteligjent dhe përparimtar, prandaj këtij duhet t'i japim ato që duhet të ketë një popull me cilësi të tillë. Në lëmin e muzikës, shokët kompozitorë kanë bërë një punë të madhe me operën, që ka gjallëruar skenën tonë dhe na nderon brenda dhe jastë vendit.

Thatë se së shpejti do të organizohet një plenum i Lidhjes për muzikën e lehtë. Me këtë rast, unë mendoj që para se të bëhet plenumi, të shikohet se çfarë mundësi kemi për t'i ndihmuar më tepër kompozitorët tanë, në mënyrë që kur të venë në plenumin e tyre, të flasin me zë më të sigurt. Jam i mendimit se për zhvillimin e muzikës dhe të arteve mund të rriten disa nga fondet që janë caktuar për këtë qëllim. Natyrisht të gjig-

tha dëshirat sot për sot nuk ua plotësojmë dot. Për preqatitjen e kompozitorëve dhe të dirigjentëve duhet të ndihmojnë shkollat e këtyre profileve. Të ndihmojmë, pra, më shumë për muzikën dhe këngët që janë ushqim për popullin.

Partia me vijën e saj të drejtë u ka rritur autoritetin popullit dhe vendit tonë. Ju, me punën tuaj, me kompozimet tuaja do të ndihmoni pör të popullarizuar edhe më shumë sukseset tona. Një shqiptar i mërguar, që kishte ardhur para disa kohësh nga Australia, na tha: «Kush na njihte ne më parë? Kurse tani, dyqani i vogël ku shes kartëpostale çshtë bërë një qendër e madhe frekuentimi, ku njerëzit vijnë e pyesin: Ç'vend është Shqipëria? Sa milion ka vendi juaj? Pastaj fillojnë e flasin me admirim se si ky popull i vogël e fitoi lirinë, pasi doli e luftoi në mal dhe se si e mbron atë me guxim etj., etj.». Ju e dini mirë vetë se me sa fjalë të mira flasin për popullin dhe vendin tonë popujt e vendeve ku keni vajtur. Ne dërgojmë jashtë vendit lloj-lloj materiale të dobishme, si artikuj etj., por, kur njihen me muzikën tonë, kur dërgon ansamble, është akoma më mirë, sepse krijon në ato vende një përshtypje të gjallë dhe një ndjenjë të bukur për vendin tonë.

Njerëzit tanë të artit dhe të kulturës do të shkojnë tani së afërmi në Algjeri dhe në vende të tjera; me këtë rast ne do të propagandojmë jo vetëm vendin tonë, por edhe çështjen e socializmit në tërësi, do të fitojmë miq të rinj për Shqipërinë. Populli algjerian ka një simpati të madhe për vendin tonë, personalitete të vendit i kanë thënë ambasadorit tonë se në vendin e tyre kanë vajtur edhe ansamble e artistë të vendeve të tjera, po njerëzit

tanë do t'i presin me përzemërsi të veçantë, dhe këtë ata e thonë duke u nisur nga fakti që populli ynë ka ndihmuar dhe ka përkrahur luftën e tyre çlirimtare. Muzika dhe arti luajnë një rol të rëndësishëm edhe për populazimin e vendit tonë. Prandaj muzika ka rëndësi të madhe, atë duhet ta vlerësojmë drejt dhe ta inkurajojmë.

Ne jemi dakord me mendimet që shfaqën këtu shokët kompozitorë, të cilëve u urojtmë suksese edhe më të mëdha në të ardhmen!

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

T'U PRITET RRUGA TË METAVE NË SEKTORIN E BLEGTORISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

10 maj 1963

Organet qendrore, në radhë të parë Ministria e Bujqësisë dhe Drejtoria e Bujqësisë pranë aparatit të Komitetit Qendror të Partisë si dhe organet e Partisë e të pushtetit në bazë duhet që çështjes së blegtorisë t'i kushtojnë kujdes të madh. Këtu u konstatua se për problemet e blegtorisë nuk tregohet interesim i duhur, se ju, shokë, që merreni me këtë sektor, shpeshherë kënaqeni me rezultatet e arritura ose përpinqeni t'i kapërceni situatat duke paraqitur shifra të përgjithshme. Për çështje të blegtorisë janë bërë një varg mbledhjesh, janë marrë edhe vendime, por në zbatimin e detyrave shikohet se ka shfaqje të burokratizmit. Në qoftë se nuk do të merren masa për të sigruuar ushqimin e nevoj-

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi sigurimin e bazës ushqimore dhe dimërimin e gjësës së gjallë në rrethet Skrapar, Dibër, Pukë dhe Mat».

shëm të blegtorisë dhe për të ruajtur shëndetin e saj, bagëtitë do të sëmuren dhe do të dëmtohen ashtu sikurse sëmuret e rrezikohet edhe njeriu. Po të lejojmë burokratizëm në zbatimin e detyrave për zhvillimin e blegtorisë dhe nuk do të merren masat për t'i dalë përpara gjendjes jo të kënaqshme, atëherë do të kemi gjithnjë rënie në numrin e bagëtive.

Mendoj se janë të gjitha mundësitë t'u pritet rruga këtyre të metave. Duke shikuar statistikat konstatahet se në disa rrethe është mjaft prapa niveli i blegtorisë. Sot, që kemi një ekonomi socialiste të planifikuar, mundësitë janë shumë më të mëdha për zhvillimin e blegtorisë. Por çështja është se nuk i kushtohet rëndësia e duhur këtij problemi.

Shokët sekretarë të komiteteve të Partisë thanë këtu se e kanë njoftuar Ministrinë e Bujqësisë për prerjen e gjethes së dushkut dhe se kanë pritur me 2-3 muaj për zgjidhjen e kësaj çështjeje, se u janë caktuar fondet për lerat, po ato kanë mbetur pa u bërë, për shkak se «nuk e merr askush përsipër ndërtimin e tyre», prandaj «do të marrin masa t'i bëjnë vetë, se nuk janë zbatuar detyrat që janë caktuar për çështjen e kullotave» etj., etj. Të gjitha këto tregojnë se këtu ka burokratizëm dhe se nuk luftohet si duhet për zhvillimin e këtij sektori të rëndësishëm të ekonomisë, duke filluar nga baza e deri në qendër. Përse duhet të vijë puna gjer në Sekretariatin e Komitetit Qendror që të rregullohet çështja e prerjes së gjetheve të dushkut? Pse nuk janë bërë më parë të gjitha hesapet? Edhe paskëtaj këto çështje nuk do të zgjidhen në qoftë se nuk do të merren me seriozitetin e duhur. Për zhvillimin e blegtorisë kemi bë-

rë një Plenum të veçantë të Komitetit Qendror dhe janë mbledhur aktivet e Partisë. Nga ana tjetër, janë organizuar mbledhje të ndryshme, për të cilat janë harxhuar edhe mjaft para, por më duket se këto mbledhje bëhen mbi kartëra dhe nuk shënojnë kthesë. Po nuk u arrit kjo, atëherë do të thotë se këto mbledhje kanë qenë formale.

Kemi biseduar që të shikohet çështja e kullotave dimërore e verore dhe na është thënë se kjo punë është bërë. Po të jetë se kjo punë është bërë sikurse u tha këtu, që, për shembull, në rrethin e Burrelit kanë vajturi vetëm dy teknikë, të cilët nuk kanë rënë fare në kontakt me njerëzit që merren me blegtorinë atje, atëherë kështu bëjmë shpenzime të kota. Edhe shokët e Partisë në rrethe duhet t'u vënë kujdes këtyre çështjeve. Blegtoria është po aq e rëndësishme sa edhe bujqësia. Prandaj, sa kujdes tregohet për bujqësinë, po aq interesim duhet të tregohet edhe për blegtorinë.

Kullotat që prishen për t'u bërë vreshta, në rast se nuk studiohen mirë dhe nuk mbahet parasysh sigurimi i bazës ushqimore, kjo do të thotë se veprohet në dëm të blegtorisë. Me sa duket, kur propozohet që kullotat të prishen e të bëhen vreshta, nuk mendohet fare për blegtorinë, kurse Komiteti Qendror i Partisë nuk ka vendosur kështu. Komiteti Qendror ka thënë që të happen toka të reja dhe të mbillen vreshta, por, nga ana tjetër, ka thënë që të mbahet parasysh edhe çështja se me çfarë do të zëvendësohet ushqimi për bagëtinë.

Plenumi i Komitetit Qendror për çështjen e blegtorisë është bërë qysh në vitin 1958. Qysh nga ajo kohë duhej të ishin kapërcyer shumë vështirësi, kurse në

fakt ne shikojmë se kundër vështirësive nuk po luftohet si duhet. Komiteti i Partisë në rreth duhet ta ngrejë zérin për t'i vënë fre Ministrisë së Bujqësisë kur shikon se ajo nuk po zbaton si duhet vendimet e Komitetit Qendror. Në qoftë se Partia lejon që atje në bazë të vijnë e të vendosin për çështjet e kullotave vetëm ata dy veta që ka dërguar Ministria e Bujqësisë, atëherë ajo nuk e ka kryer mirë detyrën e saj.

Për ju, shokët e Tiranës dhe të rretheve të tjera, nuk është mirë që vini në Sekretariatin e Komitetit Qendror e thoni se «na janë dhënë kaq milionë lekë nga shteti për ndërtimin e lerave, po s'ka kush t'i bëjë», ose që keni kaq vjet dhe s'jeni në gjendje të arrini që kooperativat bujqësore të përfitojnë nga eksperienca c blegtorëve tanë për ruajtjen e bagëtisë. Puna është se përkëto probleme nuk interesoheni në shkallën e duhur, se, sado që të thoni, për shembull, ju, shokë të Skraparit, se «organizatat c Partisë interesohen», neve nuk na mbushet mendja për një gjë të tillë. Nënkyryetari i kooperativës, që merret me problemet e blegtorisë, duhet të luftojë me të vërtetë për blegtorinë dhe jo të mendojë vetëm për të marrë ditët e punës së tij; ai duhet të kërkojë nga kryctari i kooperativës dhe sekretari i organizatës-bazë të Partisë që ose të marrin masa për të siguruar ushqimin e blegtorisë, ose t'i thotë organizatës-bazë që nuk jam dakord për të zgjedhur përsëri krytar ose sekretar partie këta që janë sot. Ai duhet t'i thotë sekretarit të organizatës-bazë se nuk e ka marrë atë vend me tapi, meqë ka mbaruar Shkollën e Partisë, se ti, sekretar, duhet ta zgjidhësh këtë çështje, sepse ja-

në 2 000 dhen pa ushqim. Një gjë të tillë duhet ta bëjnë edhe kooperativistët ndaj kryesisë së kooperativës. Në rast se fshatarët kanë frikë të veprojnë kështu, por e gjejnë më të lehtë të më drejtohen mua me letra, kjo nuk është e drejtë. Prandaj, shokë, duhet t'u kushton kujdesin e duhur këtyre çështjeve dhe të mos lihen pas dore.

Kush do të vijë t'ua pastrojë juve, shokë të rretheve, kullotat? Çdo vit po kjo gjë thuhet. Ne kemi thënë që të merren masa për pastrimin dhe për mirëmbajtjen e kullotave. Ku shpenzohen të hollat që janë destinuar për kullotat? Mos këto përdoren për punë të tjera? Përse të vejë bagëtia ku janë baxhot? Në rast se nënkyeministri përkatës, Abdyl Këllezi, ka caktuar një rregull të tillë, atëherë të vihet përpara përgjegjësisë, sepse në qoftë se bagëtia do të mblidhet rreth baxhos, ajo nuk ka se çfarë të hajë. Ç'është ky burokratizim i madh? Vendimet që merren duhet të zbatohen.

Për format e organizimit që u fol këtu, nuk di se çfarë të them, këto mund të janë të mira, po lufta dhe përpjekjet do të nxjerrin forma akoma edhe më të mira. Ne nuk duhet të lejojmë që të ketë qetësi, që të bëhet një mbledhje sa për të kaluar radhën. Jo, këtë nuk duhet ta lejojmë. Përkundrazi, të punojmë që mbledhjet të bëhen konkrete, ku të merren masat e nevojshme, për të përmirësuar gjendjen. Jam dakord se në plotësimin e detyrave për blegtorinë ka edhe vështirësi, sidomos kur bën dimër i madh, po kur s'bën dimër duhet të kemi edhe rënie më të pakta në numrin e bagëtisë.

Pra, duhet të interesohemi më shumë për këto çësh-

tje. Ju, shokë të rretheve, i shikoni këto probleme, shikoni çfarë ju ka dhënë shteti, çfarë është bërë gjer tani, çfarë duhet bërë akoma dhe merrni masat e nevojshme.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verball i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

**«KALI I TROJËS» VAZHDON VEPRIMTARINË
E TIJ NË SHËRBIM TË IMPERIALIZMIT
AMERIKAN**

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

12 maj 1963

Sekretari i Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Din Rask, bëri një vizitë të shpejtë më 4 maj në Beograd. Në komunikatën zyrtare thuhet se «ai pati një bisedim të gjatë e miqësor me presidentin Tito dhe me sekretarin jugosllav për punët e jashtme Koça Popoviç».

Vizitën e Din Raskut në Jugosllavi e pasoi një jehonë e madhe e shtypit perëndimor, i cili e vlerësoi atë si një konfirmim të marrëdhënieve të përzemërta që ekzistojnë midis dy qeverive dhe si një hap të mëtejshëm për bashkërendimin e pikëpamjeve dhe të qëndrimeve në lidhje me problemet e gjendjes së sotme ndërkombëtare.

Agjencia amerikane e lajmeve, UPI, duke iu referuar një burimi jugosllav të mirinformuar, shkruan se «këto bisedime ishin shumë të dobishme». Nga ana amerikane shprehet sidomos kënaqësia se këto bisedime u

dhanë mundësinë mareshalit Tito dhe bashkëpunëtorëve të tij të ritheksojnë dhe të shpjegojnë politikën e tyre të «mospjesëmarrjes në blloqe». Sigurisht, ana amerikane e di mirë se ç'fshihet nën parullën e revizionistëve jugosllavë të «mospjesëmarrjes në blloqe» dhe përse përdoret ajo, sepse ata vetë ia kanë ngjitur këtë etike të. Por, siç thotë UPI, «megjithatë mendohet në qarqet amerikane se politika jugosllave e ekuilibrit midis dy blloqeve shkakton në disa raste keqkuptime që pastaj është vështirë të zhduken. Prandaj presidenti Kenedi vë në dukje në mesazhin e tij nevojën për një përpjekje nga ana jugosllave që të ndalohen pozita të tilla delikate».

Këtë udhëzim të presidentit miliarder, për të vepruar me «delikatesë», ia çoi Titos Din Rasku, i cili, si pas shtypit zyrtar amerikan, «bëri hetime pranë përsaqësuesve jugosllavë mbi qëndrimet që do të mbajnë ata në lidhje me një varg çështjesh që do të diskutohen në organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në të njëjtën kohë i informoi ata në lidhje me qëndrimin amerikan kundrejt problemeve të Laosit, të konfliktit kino-indian dhe të Kubës». Mjafton t'i heqësh kësaj fjalie guaskën e frazologjisë diplomatike, për të kuptuar qartë se shëfi i Departamentit Amerikan të Shtetit i dha Titos planin e punës, udhëzimet për qëndrimet që duhet të mbajë klika e tij ndaj problemeve më të rëndësishme ndërkombëtare, ndaj forcave të paqes e të socializmit dhe forcave të agresionit e të luftës.

Shkëmbimi i vizitave midis personalitetëve amerikane e jugosllave është forma legale e mbajtjes së kontaktave midis padronit e shërbëtorit, e marrjes së ra-

portit dhe e dhënies së direktivave për veprimtarinë e mëtejshme kundër socializmit e çdo lëvizjeje revolucionare për liri e pavarësi.

Pse i dërguari i Kenedit zgjodhi pikërisht kohën e tanishme për të bërë takimin me Titon? Një gjë e tillë nuk është as e rastit dhe as thjesht për kortezin. Kjo ka lidhje kryesisht me faktin se kohët e fundit, si rrjedhim i qëndrimeve antimarksiste të N. Hrushovit e gjithë grupit të tij, që me zell të papërbajtur po përpiken ta futin «kalin e Trojës» si triumfator në gjirin e lëvizjes komuniste e të kampit socialist, duke e shpallur klikën titiste si «besnikë të marksizëm-leninizmit» dhe LKJ si një «parti motër», roli i agjenturës revisioniste të Beogradit ka marrë një rëndësi të veçantë. Nga njëra anë, klika e Titos është bërë një ndërmjetëse e kualifikuar, dhe bile një «këshilltare» në pazarllëqet e kombinacionet diplomatike midis grupit të N. Hrushovit dhe imperialistëve amerikanë, nga ana tjetër, asaj i janë hapur të gjitha portat në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet revisioniste të Evropës, gjë që i ka krijuar prioritetin e agjenturës më të informuar të imperializmit amerikan në drejtim të këtyre vendeve. Në fakt, një agjenturë e madhe, në shërbim të imperializmit amerikan, si një merimangë me Titon në qendër dhe me shumë miza në rrjetën e saj, po vepron tani intensivisht në vendot revisioniste, në sytë, me dijeninë e plotë, me bekimin dhe tolerimin e N. Hrushovit e të pasuesve të tij revisionistë. Agjentët titistë, si ujqër të uritur, po lëshohen kudo dhe futin hundët në aparatet e partive, në aparatet ekonomike, në gjirin e intelektualëve, bile edhe në ato organe ku përpunohet diplomacia, duke arritur deri atje sa të

shtien në dorë edhe dokumentet më sekrete të ndonjë Komiteti Qendror partie¹.

Veprimitaria agjenturore e klikës së Titos në vendet socialiste që kanë hyrë në rrugën e revizionizmit, ndjek qëllime të shumta:

Së pari, titistët përpiken, dhe jo pa sukses, të njohin dobësitë dhe vështirësitë që ekzistojnë në këto vende, t'i thellojnë këto, të mbjellin përçarje, të sabotojnë ndërtimin e socializmit, të përhapin konfuzion ideologjik, të përhapin pikëpamjet e tyre antimarksiste e antileniniste, të krijojnë anarki dhe çorganizim në ekonomi dhe në jetën e partisë e të shtetit dhe të informojnë pastaj ekzaktësisht padronët e tyre amerikanë, në mënyrë që këta të fundit të dinë të përcaktojnë si duhet politikën e tyre agresive kundër vendeve socialiste, të përcaktojnë strategjinë dhe takтикën e tyre në luftën kundër socializmit.

Së dyti, titistët përpiken të ndihmojnë elementët revizionistë që kanë dalë në krye të disa partive komuniste, t'i mbështetin e t'i përkrahin ata, të aktivizojnë elementët antimarksistë e tradhtarë në drejtim të përçarjes së unitetit të vendeve socialiste dhe të lëvizjes komuniste. Krahas me këtë, ata diskreditojnë dhe luftojnë kuadrot e shëndoshë të partisë që i rezistojnë, në forma të ndryshme, sulmit frontal të revizionizmit modern e që mbrojnë pastërtinë e marksizëm-leninizmit.

Së treti, dhe kjo ka rëndësi të veçantë, agjentët e imperializmit amerikan në Beograd bëjnë çmos për të shtënë në dorë sekretet ushtarake të Bashkimit Sovje-

1 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 21, f. 175.

tik e të vendeve të tjera të demokracisë populllore, për t'u transmetuar padronëve të tyre në Pentagon. Ata mundohen të njohin dobësitë në kuadrot udhëheqës të ushtrisë së këtyre vendeve dhe, nëpërmjet këtyre, të demoralizojnë ushtrinë, të mbështetin të dobëtit, të frikshmit, aventurierët etj. dhe të luftojnë kuadrot e shëndoshë, patriotët, marksistë-leninistët.

Fakte të shumta tregojnë se «kali i Trojës» vazhdon të zhvillojë veprimtarinë e tij armiqësore në shërbim të imperializmit amerikan. Mesazhet Tito-Kenedi dhe bashkëbisedimet Tito-Rask synojnë drejt intensifikimit të veprimitarisë diversioniste e përçarëse të klikës së Beogradit kundër forcave të socializmit, në kushtet e favorshme që i krijoi asaj kursi revizionist i N. Hrušovit për rehabilitimin dhe pajtimin e plotë me të.

Klika e Titos, duke i shërbyer kursit të politikës së jashtme të imperialistëve amerikanë, ka ndjekur dhe ndjek një vijë sabotuese e përçarëse edhe kundër lëvizjes nacionalçlirimtare, kundër luftës së popujve për të mbrojtur lirinë e pavarësinë e tyre. Duke u fshehur nën maskën e gjoja vendit të paangazhuar, banda e renegatëve titistë përpinqet të tërheqë në orbitën e imperializmit, të futë në shërbim të politikës së tij vendet që porsa kanë fituar lirinë, ose që janë ngritur në luftë kundër kolonizatorëve të vjetër e të rinj. Ky qëllim i klikës së Titos u duk qartë në rastin e Indisë. Dihet mirë se si borgjezia reaksionare indiane, e kryesuar nga Nehrui, i cili gjithashtu fshihej nën etiketën e «të paangazhuarit», u vu në shërbim të politikës së agresionit e të luftës së imperializmit amerikan dhe sulmoi Republikën Popullore të Kinës, se si imperializmi amerikan

i jep asaj miliarda dollarë për të përsëritur sulmet aggressive kundër një vendi socialist. Dihet gjithashtu fort mirë se si, në kundërshtim me frymën e përgjithshme të vendeve me të vërtetë paqedashëse e antikolonialiste të Azisë e të Afrikës për t'i dhënë fund agresionit të borgjezisë indiane, klika e Titos përkrahu haptazi, inkurajoi dhe nxiti reaksionin indian, për të vazhduar agresionin ushtarak, për ta hedhur borgjezinë e madhe indiane plotësisht në prehërin e imperializmit.

Një fakt tjetër, që flet sheshit për veprimtarinë përcarëse të revisionistëve jugosllavë, është edhe plani i tyre, i paraqitur nga bashkëpunëtori i ngushtë i Titos, S.V. Tempo, për të organizuar një konferencë ndërkombëtare të sindikatave të vendeve të paangazhuara. Edhe këtu synimi është një: të mbjellë përcarje në klasën punëtore, në masat punonjëse të këtyre vendeve, t'i largojë ato nga lufta e tyre e drejtë antiimperialiste e antikolonizatore, të shuajë frymën e tyre revolucionare. Por njerëzit më përparimtarë, njerëzit që përfaqësojnë dhe luftojnë për mbrojtjen e interesave të popujve e të kombeve të tyre në këto vende, po e kuptojnë dita-ditës më mirë rolin e «kalit të Trojës», në shkallë ndërkombëtare, që luan klika tradhtare e Beogradit. Ata ndjekin me vigjilencë veprimet përcarëse të revisionistëve jugosllavë, që përpiken të futin hundët në punët e tyre të brendshme në dobi të imperializmit amerikan dhe, në forma të ndryshme, këto forca përparimtare luftojnë kundër tyre.

Në kuadrin e orvatjeve për të penguar lëvizjet revolucionare të popujve të Azisë e të Afrikës, tanj, pa e ndalur veprimtarinë përcarëse në këto vende, klika e

Titos po pregetitet për ta ndihmuar imperializmin amerikan edhe në një front të ri. Padroni amerikan po e nis shërbëtorin e vet për një turne në vendet e Amerikës Latine, ku lëvizja për të flakur zgjedhën e kolonizatorëve të egër të Uashingtonit merr dita-ditës vrull të madh. Pikësynimet e vizitës së Titos në këto vende janë të qarta. Ai duhet të punojë sipas planit amerikan për të shuar frymën revolucionare në këto vende, për të mbjellë përçarje në klasën punëtore, për të përkrahur elementët revisionistë, për t'u vënë patricia pozitave të tronditura të imperializmit amerikan. Por edhe në këtë ndërmarrje të re famëkeqe revisionistët modernë do të pësojnë disfatë.

N. Hrushovi dhe pasuesit e tij, në përpjekjet e tyre për të justifikuar afrimin me revisionistët jugosllavë, ngrenë në qìell ndonjë fjalë që Titoja thotë, tek-tuk, për socializmin, për marksizmin, për komunizmin etj. Por dihet për ç'qëllim i përdor Titoja këto fjalë dhe si vepron në praktikë. Duke komentuar vizitën e Raskut në Beograd, agjencia amerikane e lajmeve, UPI, shkruante: «Vëzhguesit kompetentë thonë se jugosllavët e kuptojnë se kanë disa vështirësi me Uashingtonin, për shkak se ndonjëherë flasin se ndjekin «vijën marksiste-leniniste». Por po këta vëzhgues shtojnë se «ndërsa jugosllavët mund të flasin në këtë mënyrë si komunistë doktrinistë, ata veprojnë në mënyrë pragmatike».

Vetë Din Rasku, disa kohë më parë, e ka pohuar haptazi se nuk duhen parë fjalët që mund të thonë ndonjëherë udhëheqësit jugosllavë, por veprat e tyre. Në një fjalim të mbajtur në senatin amerikan, ai ka deklaruar se «ndihma amerikane e dhënë nga Trumani, Aj-

zenhaueri dhe Kenedi forcoi pavarësinë e Jugosllavisë dhe e bëri Titon një shembull të rëndësishëm të shkëputjes me sukses të një vendi komunist nga imperializmi sovjetik». Rasku e quajti vendimin e marrë për të ndihmuar Jugosllavinë «plot imagjinatë dhe të guximshëm». «Rezultatet, tha ai, i kaluan parashikimet tona. Jugosllavët kanë treguar sinqeritet në detyrimet e tyre kundrejt nesh».

Udhëheqësit revisionistë jugosllavë nuk e kanë fshehur kurrë bashkëpunimin e tyre të ngushtë me qarqet drejtuese të Uashingtonit. Ata kanë përgënjeshtuar fuqimisht çdo zë që është përpjekur të shtrembërojë këtë realitet. Kështu, për shembull, Titoja, në një fjalim të mbajtur pas kthimit nga Bashkimi Sovjetik në dhjetor të vitit të kaluar, deklaroi: «Jugosllavia politikën e saj të jashtme nuk mund ta ndryshojë... Janë plotësisht absurde supozimet e disa njerëzve në Perëndim se tani Jugosllavia, për shkak të përmirësimit të marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik e me vendet e tjera socialiste, do të braktisë politikën e saj të marrëdhënieve të mira me SHBA-në dhe me vendet e tjera perëndimore. Ky është një vlerësim i gabuar i parimeve të politikës sonë të jashtme». «Qëllimi i politikës së jashtme jugosllave, shkruante gazeta «Borba» në pragun e vizitës së Raskut, është mbajtja e marrëdhënieve të mira me SHBA-në». «Ne, ka thënë Titoja, jo vetëm që nuk do të hcqim dorë nga një politikë e tillë, por do të përpinqemi, përsa na përket neve, ta shpiem më përpara».

Vizita e Din Raskut në Jugosllavi dhe rezultatet e saj, që tregojnë qartë se klika titiste vazhdon të luajë rolin e saj tradhtar si agjenturë e imperializmit ameri-

kan, përgënjeshtrojnë edhe një herë, para gjithë opinionit publik, deklaratat antimarksiste të N. Hrushovitë e të përkrahësve të tij se «Jugosllavia është një vend socialist», se Titoja e klika e tij «janë marksistë-lenis-të», se «shokët jugosllavë po bëjnë kthesë» në veprimtarinë e tyre, se «LKJ është një parti motër marksiste-lenisiste» etj., etj.

Me të drejtë komunistët, revolucionarët dhe gjithë njerëzit e ndershëm të botës e pyesin N. Hrušovin:

Ku qëndron socializmi i klikës së Titos? Mos vallë në sulmet dhe në shpifjet monstruoze kundër sistemit sovjetik, në komplotet kundër vendeve socialiste dhe në spiunazhin e diversionin e saj në dobi të imperializmit amerikan? Apo në teoritë revisioniste të kodifikuara në programin famëkeq të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, mbi të cilin është bazuar e gjithë veprimitaria e klikës së Beogradit?

Ku qëndron socializmi i klikës së Titos? Mos vallë në kushtetutën e re, e cila i vë etiketën «socialiste» Republikës së Jugosllavisë për të maskuar më mirë veprimtarinë e saj kundërrevolucionare, për të përligjur rivendosjen e kapitalizmit në Jugosllavi, kushtetutë për të cilën gazeta «Izvestija» e datës 10 maj 1963 shkruan se «krijon një bazë të mirë juridike për bashkëpunimin e mëtejshëm midis BS dhe Jugosllavisë, për zhvillimin e miqësisë së tyre gjithmonë më të madhe, për afrimin gjithmonë e më të madh të Jugosllavisë me shtetet e tjera sociale në emër të arritjes së qëllimeve të përbashkëta»? Apo në faktin që në fshatin jugosllav mbi 90 për qind e tokave të punueshme janë pronë private dhe atje mbizotëron ekonomia kulake, që rritet e forco-

het vazhdimisht, që në qytetet numri i ndërmarrjeve private ka tejkaluar të 115 000, pa përmendur këtu të ashtuquajturat ndërmarrje shoqërore të cilat janë kthyer gjithashtu në ndërmarrje kapitaliste? Ku qëndron socializmi i klikës së Titos? Mos vallë në ekzistencën e sistemit të shfrytëzimit, apo në anarkinë në prodhim dhe në luftën e konkurrencën tipike kapitaliste që bëjnë në mes tyre ndërmarrjet e ashtuquajtura shoqërore? Ku qëndron socializmi i klikës së Titos? Mos vallë në politikën e saj të jashtme, që përputhet me politikën e imperializmit amerikan? Apo në milionat e miliardat e dollarëve amerikanë që ajo merr, në një kohë kur revolucionarët dhe popujt kryengritës të botës shtypen barbarisht dhe marrin plumbë nga imperialistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre, siç i ndodhi Kubës në Plazhin Zhiron, kundër së cilës «shokët e miqtë» jugosllavë të N. Hrushovit nuk kanë lënë gjë pa thënë?

Në Kongresin e 7-të të Partisë Komuniste të Bullgarisë në vitin 1958, N. Hrushovi, duke folur për dollarët amerikanë që marrin revisionistët jugosllavë, ka deklaruar: «Për çfarë arsyе imperialistët, të cilët synojnë të fshijnë nga faqja e dheut shtetet socialiste dhe të shtypin lëvizjen komuniste, në të njëjtën kohë financojnë njërin nga vendet socialiste, i japin atij kredi me kushte të favorshme, si dhe dhurata? Dihet mirë se asnjeri nuk do të besojë se gjoja në botë ekzistojnë dy socializma: një socializëm të cilin e urren në mënyrë të tërbuar reaksiuni botëror dhe një socializëm tjetër i pranueshëm për imperialistët dhe të cilit ata i japin ndihmë dhe përkrahje. Të gjithë e dinë se imperialistët asnjëherë dhe asnjërit nuk i japin të holla më kot, përsytë e bukur.

Ata i derdhin kapitalet e tyre vetëm në ato ndërmarrje prej të cilave shpresojnë të marrin fitime të mira. Në qoftë se imperialistët bien dakord që t'i jepin «ndihmë» ndonjë shteti socialist, këtë ata, natyrisht, nuk e bëjnë që ta forcojnë atë. S'ka asnje dyshim se qarqet monopoliše të Shteteve të Bashkuara nuk janë të interesuara në forcimin e socializmit dhe në zhvillimin e teorisë marksiste-leniniste».

Por revisionistët jugosllavë kanë marrë dhe vazhdojnë të marrin edhe sot e kësaj dite dollarë nga imperialistët amerikanë. Siç dihet botërisht, ata kanë marrë gjer tanë nga imperialistët amerikanë e fuqitë e tjera perëndimore afro 5 miliardë dollarë ndihmë ekonomike dhe ushtarake. Uashingtoni nuk i kursen dollarët kur është fjala për të mbajtur në këmbë ekonominë, ushtrinë dhe aparatin policor të klikës së Titos. Kjo u duk qartë edhe gjatë vizitës së Din Raskut. Me gjithë fshehtësinë që u përpogën të mbajnë revisionistët jugosllavë mbi shumat e reja të dollarëve që do të derdhen në favor të klikës së renegatëve revisionistë, e vërteta doli në shesh. Vetë shtypi zyrtar perëndimore hoqi petën lakin. Kështu, agjencia amerikane e lajmeve shkruante: «Qëndrimi amerikan është se Tito ja duhet të ndihmohet veçanërisht në fushën ekonomike. Shpresohet, megjithëse kjo shpresë nuk është shprehur zyrtarisht, se mareshali Tito mund të anojë përfundimisht nga Perëndimi». Faktin që Din Rasku i ka dhënë ose i ka premtuar një ndihmë të re klikës revolucioniste të Beogradit, e shpjegon më mirë agjencia franceze e lajmeve, AFP, e cila, në një njoftim nga Beogradit më 4 maj, shkruante: «Titoja zhvilloi bisedi-

me për marrëveshje të reja të frytshme me Francën dhe Italinë, siguroi kreditë britanike, hapi rrugën për rivendosjen e shkëmbimeve ekonomike me Gjermaninë Perëndimore. Por ai ka nevojë edhe për diçka tjeter, tani ai dëshiron të sigurojë nga Shtetet e Bashkuara premtimin se kapitalet amerikane do të investohen në ekonominë jugosllave. Këtu qëndron, pra, rëndësia e vizitës së Raskut».

Por sot marrja e dollarëve amerikanë nga ana e revizionistëve jugosllavë nuk e pengon N. Hrushovin të deklarojë solemnisht se «Jugoslavia është vend socialist», se me dollarët amerikanë dhe me ndihmën e imperialistëve klika e Titos «ndërton socializmin». Sa shpejt ndryshuan kohët dhe, bashkë me to, edhe rolet!

E pyesim N. Hrushovin:

Mos vallë imperializmi amerikan, nga dollari i të cilët kullon gjaku i punëtorit, siç ka thënë Lenini (apo Lenini na qenka vjetruar!), ka ndryshuar natyrën dhe sot me dollarët e tij mund të ndërtohet socializmi? Që kur dollarët amerikanë u bënë faktorë të dosmosdoshëm për ndërtimin e socializmit?

E pyesim N. Hrushovin:

Përse imperialistët amerikanë i japid Jugosllavisë kaq miliarda dollarë? Përse investojnë ata me kaq bujari dollarët e tyre mbi këtë «kalë të Trojës»? Është e qartë se kjo nuk bëhet aspak as për ndërtimin e socializmit në Jugosllavi, as për sytë e bukur të Titos, po për interesat politike, ideologjike dhe ekonomike të krerëve të imperializmit amerikan dhe të reaksionit në luftën e tyre kundër socializmit e komunizmit, kundër lirisë e pavarësisë së popujve, kundër paqes.

Gjendemi me të vërtetë përpara një situate kurioze: N. Hrushovi, nga njëra anë deklaron se «Jugosllavia ndërton socializmin» me dollarët amerikanë, kurse, nga ana tjetër, ai vetë dhe pasuesit e tij shpifin kundër PPSH, e akuzojnë atë që lufton me vendosmëri, me papajtueshmëri dhe me konsekuençë kundër imperializmit amerikan e shërbëtorëve të tij, si të shitur tek imperializmi për 30 aspra dhc u presin ndihmën dhe kreditë vendeve socialiste për të likuiduar në to socializmin. A nuk e bëjnë të qartë këto fakte se ujët e këtyre vijave shkon në një mulli, në mullirin anti-socialist dhe pro imperializmit amerikan?

Sot grupi i N. Hrushovit, pasi shkeli me të dyja këmbët Deklaratën e Moskës të 81 partive komuniste e punëtore, që e dënone klikën e Titos si tradhtare ndaj marksizëm-leninizmit, si minuese e përçarëse të lëvizjes komuniste, të kampit të socializmit e të forcave paqedashëse në botë, si shërbëtore të imperializmit amerikan, hesht si gur varri për lidhjet e Titos me imperialistët, hesht për dollarët që ajo merr si shpërbirim të tradhtisë së saj, hesht për komplotet e reja që ajo kurdis. Dhe kjo heshtje, në sfondin e korit revisionist që oshëtin se renegatët na qenkan bërë «shokë e vëllezër që ndërtojnë socializmin», do të thotë: «Shikoni e ndiqni Titon. Merrni shembull prej tij. Sa me zgjuarsi vepron! Ai po ua hedh amerikanëve: u merr dollarë, ndërton me to socializmin e s'u jep asgjë. Imperializmi jo vetëm ka ndryshuar natyrë, por është bërë edhe qole e budalla!».

Por popujt e vendeve tona socialiste, që kanë vite që po ndërtojnë socializmin dhe po gjëzojnë frytet e

punës së tyre, e dinë se ç'do të thotë «eksperiencia jugosllave» për ndërtimin e socializmit. Ajo nuk është gjë tjetër veçse një variant i maskuar i rrugës përvendosjen e kapitalizmit të lidhur pas qerres së imperializmit amerikan.

Revisionistët modernë të grupit të N. Hrushovit që janë bërë shokë e vëllamë me Titon, si zakonisht, do të thonë se këto janë shpifje të shqiptarëve. Në qoftë se këto që themi ne janë shpifje, atëherë përpinquni po mundët t'i hidhni poshtë me fakte. Tregoni qëllimet paqedashëse e prosocialiste të vizitës së Raskut dhe të bisedimeve të tij me Titon. Argumentoni se me dollarët amerikanë mund të ndürtohet socializmi. Provoni se klika e Titos, duke u vënë në shërbim të strategjisë themelore të imperializmit amerikan, kontribuon për forcimin e kampit socialist e të lëvizjes komuniste, për forcimin e paqes në botë. Vërtettoni se klika e Titos, duke bashkërenduar veprimtarinë e saj politike dhe duke ia nënshtruar ekonominë e saj «ndihmës amerikane» dhe rrugës së ekonomisë kapitaliste amerikane, jep kontributin e saj në triumfin e çështjes së klasës punëtore ndërkombëtare, jep kontributin e saj për çlirimin nacional e shoqëror të popujve të shtypur, kryen detyrën e saj internacionaliste. Dhe kështu, nga njëra anë, do të sqaroni opinionin publik për rolin «e shquar» të «shokëve» tuaj jugosllavë dhe, nga ana tjetër, «do të dërrmoni shpifjet e shqiptarëve»!

Miqtë, përkrahësit dhe adhuruesit e Titos, grupei revolucionar i N. Hrushovit nuk mund t'i përgjigjen opinionit botëror komunist për këto gjëra, sepse digjen, se dielli nuk mund të mbulohet me shoshë. Por

ata nuk mund as të kritikojnë pozitat armiqësore e tradhtare të klikës titiste, pasi ata janë plotësisht solidarë me të, sepse kjo do të ishte vetëvrasje për ta. Prandaj grupi i N. Hrushovit hiqet zvarrë në llumin e tradhtisë e të demagogjisë dhe si rrugëdalje të vetme gjen heshtjen dhe ngushëllon veten e përpinqet të gjënjëjë të tjerët duke përdorur parullën e zakonshme e bajate se «shqiptarët shpifin». Por edhe me heshtjen, e cila, veçanërisht në këto momente, i nevojitet N. Hrushovit për t'u marrë vesh me qetësi me imperialistët dhe për të kurdisur, bashkë me klikën titiste, komplete të reja, nuk mund t'ia arrijë qëllimit, pasi realiteti mbi klikën revizioniste jugosllave nuk mund të fshihet, pasi veprimtaria armiqësore e titistëve në shërbim të imperializmit amerikan nuk mund të maskohet me asnjë mënyrë.

Revizionizmi modern mendon se ia ka hedhur thonjtë në grykë marksizëm-leninizmit. Ai mendon se demagogjia, intrigat, sulmet e kompletet e tij kanë frikësuar dhe kanë demoralizuar komunistët në botë. Por revizionistët gabohen rëndë. Me marksizëm-leninizmin është bota e tërë, janë të gjithë njerëzit e ndershëm të rruzullit që luftojnë me vendosmëri për triumfin e ideve të tij, kundër armiqve të tij. Grupet revizioniste Tito-Hrushov duhen demaskuar pa mëshirë, në mënyrë revolucionare. Këtej varet likuidimi i shpejtë i kësaj sëmundjeje të rrezikshme për socializmin dhe komunizmin. Komunistët në të gjithë botën nuk do të lejojnë të gënjen që merimanga titiste të endë cergën e saj në partitë komuniste dhe punëtore të botës. «Kalin e Trojës», sado përpjekje që të bëjë për t'u kamufluar,

e pret disfata e sigurt. Çështja e madhe e marksizëm-leninizmit do të triumfojë mbi të gjitha komplotet e intrigat, sabotimet e përçarjet, diversionet dhe shpifjet e armiqve të tij imperialistë dhe të shërbëtorëve të tyre revisionistë.

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

VËSHTIRËSITË NE NUK NA TREMBIN,
PËRKUNDRAZI ATO NA KALITIN

*Bisedë në takimin me delegacionin e Federatës
Pankineze të Bashkimeve Profesionale*

13 maj 1963

Shoku Enver i pyeti mysafirët se si janë me shëndet dhe si e kaluan gjatë vizitës që bënë në Shqipëri. Pasi miqtë u përgjigjën se e ndienin veten shumë mirë, dhe se kishin mbetur shumë të kënaqur, shoku Enver Hoxha vazhdon:

Ne jemi shumë të gjuar që ju ndodheni midis nesh, sepse na lidh një miqësi e ngushtë. Kjo miqësi është mbrujtur nga mësimet e marksizëm-leninizmit. S'luan rol se jemi larg gjeografikisht. Me zemër ne jemi afër njëri-tjetrit. Përse populli dhe Partia jonë i duan kaq shumë popullin dhe partinë tuaj? Ne nuk ju duam ngaqë jeni një popull i madh, por kryesisht sepse jeni një popull me tradita shumë të mira dhe me cilësi të larta: ju jeni të thjeshtë, njerëz me zemër të pastër, i doni të tjerët me sinqeritet, i ndihmoni popujt, u jepni atyre eksperiencën tuaj të madhe, diturinë dhe mençurinë shekullore të popullit kinez, cilësi e virtute këto

që Partia Komuniste e Kinës i ka koncentruar në mënyrë shkencore dhe i «ka kanalizuar», si lumin Jance, në rrugën e marksizëm-lininizmit për të mirën e popullit kinez, të popullit tonë dhe të popujve të tjerë. Populli i madh kinez e konsideron popullin e vogël shqiptar të barabartë. Ja, pra, për këto gjëra ju duam ju, Partinë tuaj Komuniste dhe shokun Mao Ce Dun. Por s'është vetëm kjo; ne shqiptarët ju duam në mënyrë të veçantë sepse kemi shumë gjëra që na lidhin tok dhe këto janë vuajtjet e mëdha që kemi hequr në të kaluarën, trimëria, lufta kundër imperializmit me në krye atë të SHBA-së dhe kundër revisionistëve modernë të grupit Tito-Hrushov. Ja, këto na bashkojnë ne, popullin shqiptar me kolosin kinez.

Ne kemi hasur dhe hasim vështirësi të mëdha nga imperializmi amerikan dhe revisionistët modernë Tito-Hrushov etj., por ne do t'i mundim dhe do t'i shkatërrojmë këta. Nikita Hrushovi, që, për fat të keq, është në krye të Bashkimit Sovjetik, na punoi një mijë të zezat, sepse pa një rrezik të madh në partitë tona të cilat mbajnë lart flamurin e marksizëm-lininizmit. Ai u përpoq të organizonte bllokada kundër nesh. Siç dihet, neve, revisionistët modernë na prenë të gjitha ndihmat, na hoqën specialistët, na nxorën një mijë pengesa. Po megjithatë ata s'na mposhtën dot. Vështirësi ne kemi pasur dhe kemi, mirëpo populli u mobilizua si një trup i vetëm rrëth Partisë dhe iu vu punës akoma më me vrull. Kina na ndihmoi për plotësimin e nevojave të planit tonë pesëvjeçar.

Ju e patë popullin tonë më 1 Maj, patë punëtorët dhe kooperativistët tanë në qytete, në fabrika, në koo-

perativa. Kemi vështirësi, por, siç e vutë re, morali është i lartë, vendosmëria dhe besimi i popullit për të zbatuar vijën e drejtë dhe planet e Partisë dhe të pushtetit janë të patundura. Populli ynë është i qartë dhe di çdo gjë. Ne në çdo situatë, dhe sidomos në situatat e vështira, kemi vepruar kurdoherë kështu: e kemi sqaruar popullin mbi çdo gjë, ia kemi thënë troç të vërtetën. Sado e drejtë të jetë vija, populli duhet të shohë ku e ka forcën, ku i ka dobësitë, ku janë dhe si janë armiqtë, ku i kemi vështirësitë; ai duhet të dijë se si duhet luftuar, për ta vënë pastaj në jetë këtë vijë të drejtë. Kështu, pra, ne ia thamë popullit të gjitha, i thamë se mund të na ndodhin dhe katastrofa natyrore, se mund të na mungojë buka, mishi etj. Prandaj populli është i pregatitur shpirtërisht për të përballuar çdo situatë. Si rrjedhim, me gjithë përpjekjet e mëdha të imperialistëve, të revizionistëve jugosllavë, të monarko-fashistëve grekë, të Hrushovit me shokë për të na nxjerrë lloj-lloj pengesash e vështirësish, nuk është populli ynë por armiqtë janë deziluzionuar.

Plani ynë në industri është realizuar dhe po realizohet vazhdimisht me sukses. Edhe bujqësia nuk është keq, por kemi akoma shumë për të bërë, se edhe shirat e shumta dhe të pareshtura që kanë rënë, na kanë penguar. Megjithatë ne po përpinqemi që këto t'i kapërcejmë. Ne prej kohësh kemi filluar bonifikimin e fushave, organizimin e ujitjes, mekanizimin e bujqësisë, me qëllim që të mund t'i kryejmë punët sa më shpejt dhe më mirë dhe këto të gjitha na kanë ndihmuar shumë. Por vitin e kaluar bëri një dimër i madh. e kështu një pjesë e grurit na u prish. Këtë tani do ta zëvendësojmë

me misër. Me përjashtim të grurit, stina bujqësore paraqitet mirë: mbjelljet janë kryer në kushte të mira agro-teknike dhe, po ra edhe ca shi në verë, do të jemi në përgjithësi mirë, me gjithë vështirësitë që na kanë ndodhur. Po vështirësitë ne nuk na trembin, përkundrazi ato na kalitin.

Ne tani kemi filluar ndërtimin e mjaft objekteve të rëndësishme për zhvillimin socialist të vendit. Kudo zien puna ndërtimitare. Deri dje agjencitë e huaja telegrafike thoshin: mbeti Shqipëria, ajo mori fund sepse Kina ndodhet larg dhe s'e ndihmon dot! Kurse realiteti ynë po i detyron edhe agjentët e huaj të pranojnë punën e madhe ndërtimitare që po kryhet anembanë Shqipërisë.

Ne do të përpinqemi që objektet tona industriale t'i ndërtojmë në kohë. Klasën punëtore e kemi të re, por entuziaste, të vendosur dhe përparimtare për të përvetësuar teknikën moderne. Revisionistët sovjetikë na i hoqën teknikët e tyre, po tani punët po i bëjmë vetë: hidrocentralet po i ndërtojmë dhe i drejtojmë vetë. Teknikët kinezë që kanë ardhur në vendin tonë punojnë si vëllezër të vërtetë, në një kohë kur për disa specialistë çekë që kemi akoma, paguajmë mbi 10 fishin e rrogës së specialistëve tanë më të kualifikuar. Dhe për të marrë një rrogë të tillë ata vetëm sa rrinë, sepse me duar nuk prekin gjë, bile u thonë shokëve tanë: «kjo s'del, kjo s'bëhet» etj., etj. Po punëtorët dhe specialistët tanë e bëjnë «të pamundurën» të mundur, bile më shpejt dhe më mirë sesa ç'do të mund ta bënин specialistët çekë apo sovjetikë.

Pra, më në fund, ç'na bëri Nikita Hrushovi me sul-

met dhe bllokadat e tij, çfarë arriti? Në të vërtetë filloj izolimi dhe shkatërrimi i revizionistëve modernë. Në partitë komuniste dhe punëtore janë ngritur dhe po ngrihen forcat e shëndosha kundër vijës revizioniste e tradhtare që ndjekin udhëheqësit e partive të tyre. Në Çekosllovaki revizionistët kanë frikë nga populli dhe nga masa e partisë, ndaj marrin vendime të fshehta. Përsa u përket problemeve ekonomike, revizionistët kanë rënë dhe po bien gjithnjë e më shumë në pesimizëm. Në Poloni Gomulka dhe Hendrikovski thanë se kivit do të jetë më i keq se viti i kaluar përsa u përket problemeve ekonomike. Edhe Novotni foli për vështirësitë që i kanë pllakosur.

Po në Bashkimin Sovjetik që ka një industri dhe bujqësi të zhvilluar, çfarë ngjet? Atje ka 3-4 vjet që mungojnë shumë prodhime ushqimore. Bullgarët që janë të njojur në bujqësi, tani s'kanë as qepë dhe vijnë e blejnë te ne.

Kurse Kina i kapërceu dhe po i kapërcen me sukses të gjitha ato vështirësi të mëdha natyrore. Ju morët vendime të drejta dhe tani po i vini ato në jetë. Shokët tanë që kanë vizituar Kinën na kanë thënë se vitin e kaluar ju arritët suksese të reja. Pse ndodhin të gjitha këto? Sepse vija e partisë suaj është e drejtë dhe sepse populli kinez e ndjek atë me bindje e vendosmëri.

Revizionistët modernë s'kanë asgjë të përbashkët me ideologjinë marksiste-leniniste dhe politikisht kanë dështuar. Atyre u ka hyrë frika në palcë, dhe me siguri do të shkatërrohen. Hrushovi dhe revizionistët e tjerë dridhen nga frika përpara imperialistëve. Kurse ne s'tundemi, ne jemi të sigurt se imperializmi dhe revizio-

nistët do të dërrmohen. Ky kuqtim i drejtë mbi imperializmin s'u vjen për ujdi revizionistëve. Hrushovit kjo s'i leverdis, se, po të bëjë kthesë, ai duhet të futet në gropë. Nikita Hrushovi është një armik i pandreqshëm.

Pasi shokët e delegacionit të Federatës Pankineze të Bashkimeve Profesionale folën për përshtypjet shumë të mira që kishin nga vizitat nëpër RP të Shqipërisë dhe çmuani lart dashurinë e besimin që tregon populli shqiptar për Partinë e tij të Punës dhe për popullin kinez e PK të Kinës, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Masat janë forca vendimtare. Ne, unë, shoku Mehmet, shoku Hysni e të tjerë marrim shumë letra, nga punëtorë, fshatarë, poetë etj., në të cilat ata shprehin dashurinë dhe besimin e madh te Partia si dhe dashurinë për Partinë Komuniste të Kinës. Ndjenjat e tyre të larta dhe prekëse tregojnë, midis të tjerash, edhe se çrrënëjë të thella ka miqësia jonë.

Revizionistët nuk i kanë masat me vete. Në vendet e demokracisë popullore të Evropës masat nuk i dëgjojnë udhëheqjet e tyre. Kështu, për shembull, kur në Varshavë u bë manifestimi i 1 Majit nuk ishte vënë asnjë flamur nga demokracitë popullore, që të evitonin daljen e flamujve të Shqipërisë dhe të Kinës. Mirëpo masat e popullit të dy-tri lagjeve të Varshavës kishin mbushur duart me flamuj të Kinës dhe të Shqipërisë dhe parakaluan kështu kundër dëshirës së udhëheqjes së partisë. Atje, kur bëhen mbledhje të partisë, ndonëse të rralla, komunistët u kërkojnë llogari të deleguarëve: «Ç'bëhet me Shqipërinë dhe Kinën?»... Të deleguarit u përgjigjen: «Pjetje bëni, këto do t'i dërgojmë më lart për t'i sqaruar, tani po diskutojmë çështje të tjera!» Pra, ata

nuk i kanë masat me vete. Bllokatat e tyre kundër së vërtetës së marksizëm-leninizmit, kundër materialeve tona s'kanë sukses; masat e komunistëve dhe të popullit janë zgjuar, po zgjohen dhe kundërshtojnë vijën revizioniste të udhëheqjes së tyre. Materialet tona dhc materialet tuaja kundër revizionizmit kërkohen dhc shpërndahen atje nga komunistët e vërtetë si bukë e mirë.

Çdo e keqe ka edhe një të mirë. Dalja e revizionistëve modernë ishte një e keqe për kampin socialist dhe lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, por në të njëjtën kohë ishte edhe një e mirë, sepse u zbulua një sëmundje që duhet shëruar me luftë revolucionare. Po të mos e zbulonim këtë sëmundje, ajo do infektonte tërë trupin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Partia juaj dhe Partia jonë janë ngritur kundër kësaj sëmundjeje dhe po e jepin ilaqin ashtu siç duhet, me doza të caktuara, për të shëruar të infektuarit dhe për të likuiduar të pashërueshmit.

Ju, të dashur shokë kinezë, keni te populli ynë një mik besnik ndaj marksizëm-leninizmit, si në kohëra të mira ashtu dhe në kohëra të këqija. Të tillë miq ju konsiderojmë edhe ne ju.

U dërgoni përshëndetjet dhe falënderimet tona Bashkimeve Profesionale të Kinës! Ju uroj suksese në punën tuaj! Sukseset tuaja janë edhe tonat.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbajtur në këtë takim që gjendet në AQP

PO S'E PREGATITE POPULLIN PËR RRUGËN E REVOLUCIONIT NUK FITOHET LIRIA

*Nga biseda në takimin me një delegacion të Qendrës
së Punonjësve të Kubës*

13 maj 1963

SHOKU ENVER HOXHA: Jemi shumë të gjëzuar që ndodheni në vendin tonë ju, përfaqësuesit e popullit kuban. Te ne i madh e i vogël është njojur me fitoren e popullit tuaj kundër imperializmit amerikan dhe qeverisë reaksionare vendëse. Ky është një shembull për të gjithë, sepse ju kishit të bënë drejtpërsëdrejti me SHBA-në dhe me klika të shitura tek ata. Partia jonë e populli ynë janë e do të jenë kurdoherë me luftërat nacionalçirimtare të popujve, me rrugën e revolucionit si rruga e vetme dhe e sigurt për të fituar lirinë dhe për të ndërtuar jetën e re socialiste.

Popullin tonë që nëpër shekuj e kanë robëruar, e kanë shtypur dhe e kanë grabitur pa mëshirë armiq nga më të egrit, e shpëtoi rruga e revolucionit popullor, lufta kundër fashizmit, kundër imperializmit; atë e shpëtoi marksizëm-leninizmi. Ndryshe ai s'do të gjente shpëtim. Dikur Pasionarja ka thënë një fjalë të mirë:

Më mirë të vdesim në këmbë, sesa të rrojmë në gjunjë! Po këtë ajo e tha atëherë, kur po bëhej revolucioni spanjoll. Tani ajo ka shkarë në revizionizëm dhe mendon se pushtetin klasa punëtore spanjolle do të mund ta marrë në Spanjën e Frankos me rrugë paqësore. Zor se do t'ia dalë në krye kësaj pune! Por populli spanjoll është një popull luftëtar që do të dijë kurdoherë se si duhet vepruar. Pse vullnetarisht e lëshuan Batista dhe Shtctet e Bashkuara të Amerikës pushtetin e tyre në Kubë? Pse Zogu dhe fashizmi pa luftë e lëshuan pushtetin e tyre në Shqipëri? Prandaj ne jemi me popujt që luftojnë për lirinë, pavarësinë dhe përparimin shoqëror. Por revolucioni proletar nuk përfundon me shkatteredimin e pushtetit të vjetër dhe vendosjen e pushtetit të tipit të ri. Rruga e tij është e gjatë, e vështirë dhe në këtë rrugë duhet ecur me konskuencë, me largpamësi, duke zbatuar parimet e marksizëm-leninizmit. Partia jonë, besnikë e këtyre parimeve as ka lejuar dhe as do të lejojë kurrë të bëhet politikë mbi kurrizin e popullit tonë, dhe as të bëjë apo të lejojë kompromise në kurri të popujve të tjerë. Ata që e tradhtojnë rrugën e revolucionit, ata që janë me dy faqe do të turpërohen, taktikat e tyre të gabuara do të dështojnë, tradhtia do t'u dalë në shesh.

Ne e dimë që ju keni vështirësi për përballimin e të cilave është e nevojshme edhe ndihma vëllazërore e vendeve miq. Por populli ynë thotë një fjalë: pospatë ndihmë, shtrëngjo rripin, ha bile dhe bar, por lirinë mos e shit! Me luftë e me përpjekje kapërcehen vështirësitë. Pas Çlirimt ne u ndodhëm në varfëri e në prapambetje të madhe, por populli ynë trim u udhëhoq

drejt nga Partia jonë e Punës dhe me guxim i përballoi të gjitha vështirësitë. Armiqtë imperialistë me në krye ata amerikanë, revisionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë, neofashistët italianë etj., që kur jemi çliruar na kanë sulmuar vazhdimesh me mënyra të ndryshme, na kanë dërguar spiunë dhe diversantë nga ajri, nga toka dhe nga deti, por kanë dështuar, sepse ne kemi qëndruar kurdoherë vigjilentë e të vendosur në rrugën tonë të drejtë. Po ashtu udhëheqja e tanishme e Bashkimit Sovjetik me në krye Hrushovin sillen ndaj popullit dhe Partisë sonë si armiq. Nikita Hrushovi është revisionist. Por as sulmet e tij antishqiptare, as presionet e bllokadat e tij armiqësore s'kanë për të na kthyer nga rruga e marksizëm-leninizmit.

Prandaj s'ka gjë se ju jeni pranë Majamit. Armiqtë që janë struktur atje s'do ta harrojnë Plazhin Zhiron.

Në kohën e ngjarjeve në Zhiron, gjatë krizës së Karaibeve dhe në çdo rast tjetër kur agresorët janki kanë kërcënuar sovranitetin dhe lirinë e vendit tuaj, populli shqiptar është ngritur në demonstrata e mitingje në përkrahje të çështjes suaj të drejtë. Synimet dhe përpjekjet e imperialistëve amerikanë në këto raste dështuan në saje të heroizmit të popullit tuaj, të qëndrimit të vendosur të Fidel Kastros dhe të përkrahjes internacionale të popujve të tjerë.

Ne na akuzojnë si luftënxitës. Por historia jonë flet krejt ndryshe. Ne vërtet kemi luftuar shekuj me radhë maleve, luginave, fushave, por gjithmonë kemi luftuar për të fituar lirinë e vendit tonë dhe kurrë për t'u rrëmbyer lirinë të tjerëve. Të tillë luftë, luftë të drejtë çlirimtare, ne kemi bërë dhe për këtë jemi dhe do të jemi

kurdoherë. Ne e duam paqen dhe luftojmë për sigurimin e saj. Por popullit duhet t'i themi se ku është dhe cili është armiku, se cilat janë planet e tij, se si ai armatoset vazhdimisht, prandaj dhe ne duhet të jemi gjithmonë gati. Po s'ia bëre popullit të qartë rreziqet që e kanson, po s'e pregatite popullin për rrugën e vështirë e të gjatë të revolucionit, nuk sigurohet liria, fitorja nuk vjen vetvetiu. Ne me armë e fituam lirinë dhe me armë e mbrojmë e do ta mbrojmë. Si t'i themi popullit ne hidh armët, kur monarko-fashistët kanë kërkuar dhe kërkojnë gjysmën e Shqipërisë?! Si t'i themi popullit ne hidh armët, kur revisionistët modernë e kanë halë në sy Shqipërinë dhe së bashku me imperialistët pregatiten me të gjitha mënyrat dhe kërcënojnë vazhdimisht lirinë dhe sovranitetin e vendit tonë?! Si t'i themi popullit ne hidh armët, kur neofashistët italianë pregatiten për sulme kundër vendit tonë, kur flotat e fuqive aggressive, të armatosura gjer në dhëmbë, lundrojnë në Mesdhe?!

Ashtu si ne, sot kërcënohen të gjithë popujt nga imperialistët dhe veglat e tyre. Atëherë ç'të bëjmë, t'i këndojmë himne Kenedit sikur gjoja ai do paqen, në një kohë kur në të vërtetë përpinqet t'u bëjë varrin Kubës dhe vendeve të tjera? Kjo do të ishte tradhti ndaj popullit tonë, ndaj gjakut të derdhur nga shokët tanë, ndaj të gjithë popujve. Prandaj ne themi se duhet të qëndrojmë kurdoherë vigjilentë dhe të mos gënjejhemi nga demagogjia borgjeze e revisioniste. Ne pushkën as e kemi hequr e as do ta heqim nga supi përderisa në botë të ketë armiq të popujve e të lirisë. Për këtë Hrushovi na ka kritikuar. Po si të mos e bëjmë këtë gjë,

kur jemi të rrethuar kudo nga armiq?! Te ne i tërë populli preqatitct rregullisht për mbrojtje dhe që në sinjalin e parë, mblidhet nën armë, plotësisht në gjendje të përballojë çdo rrezik. U pëlqen apo jo kjo të tjerëve për ne s'ka rëndësi. E rëndësishme është që ne kështu preqatitemi për të mbrojtur vendin tonë, lirinë, fitoret tona, socializmin.

Botohet për herë të parë, ma shkurtlme, sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbajtur në këtë takim që gjendet në AQP

SOT TË GJITHA TË MIRAT QË BËN POPULLI ME PUNËN E TIJ, I GËZON VETË

*Takim me shqiptarin Sadik Bleta, anëtar i kryesisë së
shoqërisë «Skënderbeu» të kolonisë shqiptare
në Argjentinë*

18 maj 1963

SHOKU ENVER HOXHA: Gëzohem shumë që erdhët në atdhe. Si ju duken ndryshimet që janë bërë në Shqipëri gjatë këtyre vjetëve?

SADIK BLETA: Ndryshimet që ka pësuar atdheu ynë janë si dita me natën. Unë nuk mund t'i shpreh ashtu si duhet me fjalë ndryshimet e mëdha që janë bërë në Shqipëri gjatë kësaj kohe. Por mund të them se ato që janë bërë këtu gjatë 15 vjetëve, nuk mund të bëhen as për 150 vjet në vendin ku jetoj unë.

SHOKU ENVER HOXHA: Gjetkë, në vendet kapitaliste, mund të jenë bërë gjëra edhe më të mëdha, po për t'i realizuar ato janë dashur qindra vjet. Pastaj, të gjitha të mirat që arrihen atje me gjakun e me djerësën e punëtorëve e të fshatarëve, i gëzojnë të tjerët, që janë një pakicë, kapitalistët. Ndërsa këtu, në Shqipëri, që kurse populli, i udhëhequr nga Partia, mori pushtet-

tin në dorë, të gjitha këto të mira i realizon 'dhe i gjëzon vetë. Këtë e shikojmë jo vetëm ne, që jemi këtu dhe ju që vini e gëzoheni në atdheun tuaj, por edhe të huaj, sidomos ata që kanë qenë një herë më parë, të cilët habiten e gëzohen për ndryshimet e mëdha që janë bërë në vendin tonë.

SADIK BLETA: Për të gjitha këto të mira që gjëzon sot populli shqiptar të rrojë Komiteti Qendror i Partisë me Ju në krye! Me sa pashë gjatë këtyre ditëve, duke shëtitur nga Jugu i Shqipërisë, me punën që është bërë, brenda disa vjetëve, Shqipëria, me prodhimet e saj, si ullinj, agrume etj. do të plotësojë jo vetëm nevojat e saj, por edhe do të eksportojë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne kemi mbjellë dhe do të vazhdojmë të mbjellim ullinj, rrush etj. Ne kemi bërë një punë të madhe për tharjen e kënetave dhe të mocaleve, por në këtë drejtim na duhet dhe ca kohë për t'i tharë të gjitha. Këneta e Durrësit, që ju mund ta keni parë tani, nuk do të duket më në të ardhmen. Traktorë tashti kemi mjaft dhe çdo vit numri i tyre do të shtohet. Fabrika të reja ndërtohen dhe të tjera do të ngrihen në vitet e ardhshme. Së shpejti do të ndërtojmë edhe uzinën e plehrave kimike. Kopshte të bukura do të bëhen fushat dhe kodrat tonë! Të gjitha këto i bëjmë që populli ynë të jetojë më mirë.

Shumë shkolla janë hapur për të rritur kulturën e popullit. Sot nuk ka fshat që të mos ketë të paktën shkollën e tij fillore, kurse në shumë të tjera ka dhe shkolla 7-vjeçare.

SADIK BLETA: Kur isha në Shqipëri në vitin 1921 doli ligji që në fshatrat me 25 nxënës të ketë nga një

mësues, po në fakt ky ligj mbeti në letër, në fshatin tonë, me gjithëse ishim 85 nxënës, nuk pati asnje mësues. Tani nga fshati ynë kanë dalë 45 mësues.

SHOKU ENVER HOXHA: Tani do të dalë ligji që djemtë dhe vajzat të vazhdojnë arsimin 8-vjeçar të detyrueshëm. Tani s'është më si më parë, kur kishte vetëm një shkollë të mesme në Tiranë, ose në Elbasan, po në të gjitha qytetet ka jo vetëm nga 1, por nga 2 dhe 3 shkolla të mesme. Këtë e bëjmë që populli të ketë dituri, që punëtorët të mësojnë dhe të kenë mundësinë të prodhojnë mirë dhe shpejt.

Shumë banesa kemi ndërtuar dhe të tjera do të ndërtojmë, sepse popullsia në vendin tonë tani rritet me ritme të shpejta.

SADIK BLETA: Nga 850 000 frymë që kishte më parë Shqipëria tani ajo ka arritur në 1 milion e 600 mijë.

SHOKU ENVER HOXHA: Shqipëria tani është një nga vendet që ka shtesën më të madhe të popullsisë dhe kjo vjen sepse njerëzit kanë shpëtuar nga epidemitë e panumërtë të sëmundjeve të tmerrshme që bënin kërdinë në të kaluarën. Një kujdes të veçantë ne kemi treguar sidomos për fëmijët që më parë vdisnin shumë. Jeta mesatare e njeriut, nga 40 vjeç që ishte më parë, ka arritur në 59 vjeç. Kjo ka ardhur sepse është përmirësuar mënyra e jetesës së popullit.

Të gjitha punët Partia dhe populli i rregullojnë me zgjuarsi. Partia jonë nuk e shiti vendin te të tjerët. Ajo e kuptoi se pa luftuar vendi ynë nuk mund të dilte në dritë, prandaj i tha popullit të ngrihej në luftë kundër armiqve e tradhtarëve dhe ai u ngrit i gjithë

në këmbë e i mëndi ata. Gjatë luftës vendi ynë u dogj dhe u shkatërrua, po pastaj pas luftës atdheun e ri-ndërtuam. Kur mbaroi lufta populli u mobilizua dhe punoi me vrull, duke qenë i zbathur dhe me barkun të thatë. Por kjo punë nuk është qetësisht. Nga çlirimi e këtej sa luftë na është dashur të bëjmë kundër tradhtarëve, kundër revisionistëve jugosllavë, kundër monarko-fashistëve grekë dhe neofashistëve italianë! Armiqjtëna hidhnin diversantë për të minuar ndërtimin e socializmit te ne, por ne u tregonim vendin atyre. Puna jonë shkoi gjithnjë përpara.

Tani situata e vendit tonë është forcuar mjaft. Popullin dhe ushtrinë i kemi të fortë, se mbi të gjitha është e fortë Partia që na udhëheq.

SADIK BLETA: Këtë forcë të madhe e pamë edhe në festën e 1 Majit. Më parë ne s'kishim avionë, kurse tani ne i kemi këta dhe bile shumë të mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Gjithë popullin e kemi të armatosur. Ai ka luftuar kurdoherë kundër armiqve, por në Luftën Nacionalçlirimtare ka luftuar heroikisht.

Por edhe ju shqiptarët që jeni larg atdheut keni ndihmuar. Ne ishim të sigurt që te ju kishim vëllezërit tanë patriotë të shquar dhe në këto momente të rëndësishme ju treguat edhe një herë se sa të lidhur ishit me atdheun, sidomos ju të shoqërisë «Skënderbeu», që mban emrin e Heroit tonë Kombëtar, keni mbajtur lart emrin e popullit shqiptar, keni mbrojtur atdheun dhe kurdoherë keni qenë të lidhur me të. Dhe s'ka si të jetë ndryshe, sepse ju që bëni pjesë në shoqërinë «Skënderbeu» jeni njerëz të vuajtur, njerëz të popullit, ku s'ka vend për armiqjtë e tradhtarët si Isuf Luzi e të tjerë.

Një ndihmë shumë të madhe na kanë dhënë deklaratat tuaja dhe letrat që ju na keni dërguar vazhdimisht, të cilat i kemi botuar edhe në gazetë. Ne e konsiderojmë ndihmë të madhe këtë, sepse popullit tonë, kur shikon që vëllezërit e tij flasin mirë për të dhe e vlerësojnë luftën e tij e të Partisë, i vjen mirë dhe inkurajohet. Kështu lufta dhe letrat tuaja kanë ndihmuar shumë.

SADIK BLETA: Ne nuk kemi bërë ndonjë gjë të madhe. Jemi munduar të ndihmojmë me aq sa kemi pasur mundësi. Por ju premtojmë se do ta mbajmë lart emrin e shoqërisë dhe do të jemi gjithnjë me ju.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju keni pasur dëshirë të dërgonit çupën tuaj për të mësuar këtu?

SADIK BLETA: Po, por ajo s'pati mundësinë të vinte, pse nuk iu dha viza nga ana e policisë.

SHOKU ENVER HOXHA: I dërgoni fëmijët tuaj të mësojnë në universitetin tonë, të bëhen inxhinierë, kimistë dhe doktorë, pse këtu keni atdheun tuaj!

SADIK BLETA: Të rrojë Partia nën udhëheqjen Tuaj që ka vendosur të pranojë në shkollë me bursë të shtetit fëmijët tanë!

Ne do të përpiqemi të dërgojmë 2-3 veta me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Të dërgoni jo 2-3 veta, por edhe më shumë bij patriotësh të ndershëm që dë-shirojnë të vijnë në Shqipëri për të studiuar me bursë të atdheut të tyre e të bëhen njerëz të mësuar. Në qoftë se atje ju rroni «eh», po të vini këtu do të rroni mirë, shteti do t'ju japë punë, shtëpi me qira të ulët dhe fëmijët do të venë në shkollë. Kjo varet nga dëshira juaj.

SADIK BLETA: S'ka baba që të mos dojë të dër-

gojë në Shqipëri çupën ose djalin e tij për të mësuar. Kështu do të ruhen gjuha dhe traditat tonë.

Lidhur me luftën kundër revizionizmit, në Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Argjentinës zhvillohen debate. Elementët e mirë përpiken të mësojnë të vërtetën. Unë u kam dhënë këtyre fjalimet Tuaja. Kërkesa për materialet e Partisë së Punës ka mjaft, por, po të kishte mundësi, do të ishte mirë që këto të na dërgohen në gjuhën spanjisht. Dërgimi i materialeve do të ndihmojë që komunistët dhe opinioni publik i atjeshëm të njojin qëndrimin e drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Shqipëria ka sot mjaft miq që kërkojnë të vijnë dhe kanë ardhur, si nga Arjentina, nga Brazili etj. Tani shumë njerëz kërkojnë të vijnë te ne, pse të shumtë janë ata që e kuptuan qëndrimin e drejtë të Partisë sonë, por ka edhe mjaft të tjerë që akoma nuk na kanë kuptuar. Çfarë shpifjesh nuk përdorën revizionistët kundër nesh. Ata arritën gjer atje sa të na akuzojnë se jemi të lidhur dhe bashkëpunojmë me imperializmin. Po ne qëndruam dhe nuk u përkulëm përrpara shpifjeve e shantazheve të tyre, sepse e dinim që ishim në rrugë të drejtë. Me qëndrimin e saj kundër revizionistëve, Shqipëria dha një shembull të madh. Vetëm dy rrugë ka: ose do të ndjekësh rrugën e N. Hrushovit dhe do të përfundosh në tradhti e në marrëveshje me imperializmin amerikan, ose do të vish në pozitat tonë të drejta.

SADIK BLETA: Ky është një triumf për Republikën Popullore të Shqipërisë dhe për Partinë e Punës. Më parë atje e konsideronin Shqipërinë sikur të ishte

një koloni ruse, kurse tani thonë: si është puna që kjo doli tani kundër Rúsise? Prandaj të rrojë Komiteti Qendror i Partisë me Ju në krye!

SHOKU ENVER HOXHA: Në qoftë se ne do t'i thoshim N. Hrushovit «amin» për vijën tradhtare që ai po ndiqte, do të shkelnim gjakun e dëshmorëve. Shqipëria ka triumfuar dhe do të jetojë në saje të marksizëm-lenisizmit, prandaj, duke e mbrojtur atë, si kurdoherë ne do të fitojmë. Sot i gjithë populli shqiptar është i bashkuar si një trup i vetëm me Partinë e tij të Punës.

Ka njerëz që thonë: si është e mundur që Shqipëria e vogël të ngrihet kundër N. Hrushovit, kundër revisionistëve jugosllavë, kundër monarko-fashistëve grekë dhe kundër neofashistëve italianë? Kjo i dedikohet qëndrimit të saj të drejtë marksist-leninist. Pastaj ne nuk jemi vetëm. Me ne janë Kina e madhe dhe të gjithë marksistë-leninistët dhe njerëzit liridashës e përparimtarë në botë.

SADIK BLETA: Do të ishte mirë të kishim edhe 2-3 mësues për të mbajtur gjallë gjuhën shqipe.

Nuk di si t'jua shpjegoj kënaqësinë e madhe që ndicjmë për të gjitha këto ndryshime të mëdha që janë bërë në atdheun tonë gjatë kësaj kohe nën udhëheqjen Tuaj. Në të gjitha vendet ku shkuam pamë ndërtimet e mëdha që bëhen, fabrikat e reja që janë ngritur dhe që po ndërtohen, kënetat e moçalet që janë tharë.

Në fabrikat e ngritura ne pamë që punonin edhe mjafgra.

SHOKU ENVER HOXHA: Më parë, siç e dini, gruaja jonë ka qenë shumë e prapambetur, pa kulturë, kurse tani ajo punon e ndërton njëlloj si burri. Megjithëse

në një shtëpi mund të ketë 2-3 burra që punojnë, gratë kërkojnë të punojnë vetë.

Vendi ynë është i pasur. Gjer tani ne kemi zbuluar mjaft pasuri të nëntokës, po akoma të gjithë vendin nuk e kemi studiuar. Me qindra djem e vajza që mbarojnë shkollat çdo vit nisen për të zbuluar mineralet që janë pasuri e popullit.

SADIK BLETA: Kudo që vajtëm, në fabrikat dhe në ndërmarrjet, gjetëm si drejtues djem të rinj 25-vjeçarë e poshtë, aq sa është edhe djali im. Sa herë më mori vaji kur shikoja këta djem të rinj në krye të punës, zot të vetes e kur mendoja për të ardhmen e pasigurt të fëmijëve tanë në mërgim.

SHOKU ENVER HOXHA: Këta djem të rinj 25-vjeçarë, aq sa është djali juaj, zëvendësuan menjëherë teknikët e specialistët sovjetikë dhe të tjerë dhe po i drejtojnë punët më mirë se ata. Tani i jemi vënë punës për të preqatitur ndërtimin e një hidrocentrali të madh në afërsi të Kukësit. Në të ardhmen e gjithë Shqipëria do të elektrifikohet. Në Shkodër do të ndërtojmë fabrikën e telave prej bakri, që do të prodhojen me bakrin që do të nxjerrim nga malësitë e Veriut.

SADIK BLETA: Ndryshimet që ka bërë Shqipëria nuk mund të krahasohen. Kur shkuam në Vlorë, po të mos na kishin thënë se ku jemi, as kishim për ta njohur, aq shumë ka ndryshuar ky qytet, ashtu siç ka ndryshuar gjithë vendi. Ne nuk jemi në gjendje të shprehemi për ndryshimet e mëdha që janë bërë në Shqipëri.

SHOKU ENVER HOXHA: Të rintjtë nuk e njohin të kaluarën e popullit tonë plot vuajtje e sakrifica, pran-

daj na bie detyrë neve që këtë t'ua tregojmë atyre, kështu më pas ata do të bëjnë edhe më shumë e më mirë nga ne, pse do të jenë dhe më të mësuar. Kur të rriten ata do të thonë se prindërit tanë kanë bërë punë të mirë, por i kanë bërë jo kaq bukur e shpejt sa ne, pse koha ndryshon dhe ndryshtë mendonin baballarët tanë atëherë e ndryshtë mendojmë ne tani. Biftë e nipërit tanë nuk do të na i hedhin gurët, sepse u kemi ndërtuar themele të shëndosha.

SADIK BLETA: Ne duhet t'u mësojmë fëmijëve tanë se ç'është komunizmi dhe t'i paralajmërojmë të jenë të kujdeshshëm se armiqtë do të punojnë gjithnjë.

SHOKU ENVER HOXHA: Prandaj kurdoherë duhet t'i kemi sytë hapur, të jemi vigjilentë.

Pastaj shoku Enver Hoxha u përshëndet me mysafirin dhe i dha atij të fala për shqiptarët patriotë në Argjentinë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbajtur në këtë takim që gjendet në AQP

JU KENI PËRPARA NJË LUFTË TË MADHE, POR SA MË E MADHE TË JETË LUFTA, AQ MË TRIMA E TË PAMPOSHTUR BËHEN KOMUNISTËT

*Nga biseda me një delegacion të Partisë Komuniste
të Brazilit të kryesuar nga shoku Pedro Pomar¹*

21 maj 1963

Pasi shkëmbehen përshëndetjet e rastit fjalën e merr SHOKU ENVER HOXHA: Shokë, jemi shumë të gjëzuar që erdhët këtu te ne. Për këtë falënderojmë Komitetin Qendror të Partisë suaj dhe ju personalisht! Gjithashtu ju falënderojmë, në emër të Komitetit Qendror të Partisë sonë, për mesazhin e ngrohtë që sollët! Kjo është një ndihmë e madhe për ne.

Ne jemi jashtëzakonisht të prekur që ju morët këtë rrugë kaq të gjatë për të ardhur në vendin tonë të vogël, për t'u njobur dhe për të shkëmbyer mendime. Vendet tona gjeografikisht janë larg njëri-tjetrit, por ne, komunistët e të dy vendeve, jemi shumë të afërt, sepse kemi një qëllim të përbashkët, sepse bëjmë të njëjtën luftë, të njëjtat përpjekje e sakrifica dhe do të kemi të njëjtën fitore.

¹ Shoku Pedro Pomar, udhëheqës i PK të Brazilit, në dhjetor të vitit 1976 së bashku me anëtarin tjetër të Komisionit Ekzekutiv të KQ të PK të Brazilit, Anhelo Arrojo, dhe me anëtarin e KQ të Partisë, Huan Batista Drumond, ranë herolikisht në fushën e betejës, në përpjekje me armë me forcat ushtarake reaksionare të Brazilit.

Si ju duket Shqipëria?

SHOKU PEDRO POMAR: Për ne ka qenë një gëzim i madh kur u njoftuam për të ardhur në Shqipëri. Kjo ka qenë një ndihmë e çmuar për ne, sepse reaksionarët dhe revizionistët në Brazil na dënojnë, bëjnë propagandë e shpisin kundër nesh.

SHOKU ENVER HOXHA: E kur armiqtë nuk i kanë sharë marksistë-leninistët?

SHOKU PEDRO POMAR: Është me të vërtetë një miqësi e rrallë ajo që na keni rezervuar.

Për ne njojja nga afër me eksperiencën e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe personalisht me shokun Enver është një rast mjaft i rëndësishëm dhe sinjifikativ. Ne e kemi njojur veprimtarinë e shokut Enver qysh nga Lufta juaj Nacionalçlirimtare dhe gjithnjë kemi ndjekur me vëmendje e respekt përpjekjet revolucionare të Partisë e të popullit shqiptar. Në këto rrethana kaq speciale për lëvizjen komuniste ndërkombëtare del e qartë se merita e Shqipërisë rritet vazhdimisht. Kjo sot ka marrë një rëndësi të posaçme për ne, ndaj nxituam me këtë rast që të vijmë këtu për ta njojur nga afër sa më shumë Shqipërinë dhe popullin shqiptar.

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit për fjalët e ngrohta që thatë për Partinë e Punës të Shqipërisë e popullin shqiptar.

Ne themi se eksperienca e Partisë sonë dhë e popullit tonë është një eksperiencë e vogël. Por si marksistë-leninistë duhet thënë se komunistët, qoftë të një partie të madhe ose edhe të një partie më të vogël, duhet të përfitojnë sa më shumë nga njëri-tjetri. Për Partinë tonë kurdoherë ka qenë e qartë se eksperienca

e partive motra, në radhë të parë e Partisë së Leninit e të Stalinit, e Partisë Komuniste të Kinës, e lëvizjes së madhe revolucionare, e luftës së partive komuniste të Amerikës Latine dhe e partive marksiste-leniniste të të gjitha kontinenteve ka qenë një ndihmë e jashtë-zakonshme. Natyrisht, duke u bazuar në marksizëm-leninizmin, Partia jonë është përpjekur që këtë eksperiencë ta marrë, ta përpunojë dhe ta zbatojë në përpunthje me kushtet e vendit tonë.

Ne i kemi arritur këto suksese jo për arsy se kemi qenë të ditur dhe të mësuar qysh në fillim me një teori të madhe. Kur e filloi luftën Partia jonë njerëzit tanë dinin fare pak teori. Po ne dinim një gjë të rëndësishme: për të fituar duhej krijuar partia, prandaj krijuam një parti marksiste-leniniste revolucionare. Ne e organizuam Partinë në bazë të eksperiencës së madhe të Partisë së Leninit, zbatuam dhe ruajtëm parimet e saj, kalitëm shpirtin revolucionar të komunistëve, duke pasur për qëllim objektivin e madh: çlirimin e popullit nga pushtuesit fashistë dhe feudoborgjezia reaksionare e vendit. Pa një parti të tillë marksiste-leniniste ishte e pamundur të fitonim lirinë dhe të vendosnim diktaturën e proletariatit, demokracinë popullore, e cila është një formë e diktaturës së proletariatit.

Eksperiencia jonë tregoi se nga një bërthamë e vogël komunistësh që ishim në fillim, u themelua Partia marksiste-leniniste e Shqipërisë, që mishëroi në vijën e saj dëshirat dhe aspiratat e popullit. (Në fillim ne ishim gjithsejt 200 veta, kurse partia juaj sot është shumë më e madhe).

Fitorja jonë konsiston në mbrojtjen konsekiente

të parimeve ideologjike, organizative e politike të Partisë dhe në lidhjet shumë të ngushta që krijuam me masat e popullit. Qysh në fillim ne patëm luftë të ash-për me trockistët dhe oportunistët, të cilët u përpoqën, nga jashtë dhe nga brenda, të likuidonin Partinë. Por atyre iu bë një luftë e vendosur. Ne i demaskuam pikëpamjet e tyre oportuniste brenda e jashtë Partisë dhe i përjashtuam nga Partia. Qysh gjatë kohës së luftës, ata u lidhën me reaksionin dhe pushtuesin. Dhe lufta i likuidoi.

Një eksperiencë të pasur ka fituar Partia jonë nga lufta konsekuente dhe pa kompromis që ka bërë kundër klikës tradhtare të Titos dhe, tanë, kundër tradhtarit revizionist, Hrushovit. Partia jonë i ka demaskuar dhe do t'i demaskojë akoma edhe më shumë këta renegatë.

Për Partinë tonë mbajtja e një qëndrimi të tillë ka qenë e vështirë në shumë drejtime, sepse ne dilnim kundër udhëheqjes së Bashkimit Sovjetik, kundër udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe e dinim që kjo udhëheqje tradhtare, ndaj veprimit tonë marksist-leninist, do të bënte një luftë të tërbuar për të shtrembëruar të vërtetën dhe për të na mposhtur. Por Komiteti Qendror i Partisë sonë mendoi se duhej mbrojtur marksizëm-leninizmi, duhej mbrojtur Partia, duhej mbrojtur lëvizja komuniste ndërkombëtare, duhej mbrojtur vetë Bashkimi Sovjetik nga këta armiq që kishin ardhur në krye të tij. Dhe kështu lufta filloi. Ne i morëm parasysh të gjitha metodat antimarksiste dhe shpifarakë që do të përdorte N. Hrushovi për të na gjunjëzuar, por luftën qemë të bindur se do ta fitonim, sepse ne ishim në rrugë të drejtë.

Para se të fillonim luftën e hapët kundër udhëhe-

qjes revizioniste të Bashkimit Sovjetik, ne duruam, duruam shumë. Ne e pamë, jo tani, në këta tre vjetët e fundit, por qysh kur erdhi në krye N. Hrushovi, se udhëheqja e Bashkimit Sovjetik po merrte një rrugë antimarksiste e antileniniste. Në bazë të normave leniniste ne qysh në fillim ua kemi thënë udhëheqësve sovjetikë mendimin tonë për ato çështje për të cilat s'qemë dakord me ta. Kështu ne nuk ia kemi fshehur grupit të N. Hrushovit mendimin tonë për çështjen e Stalinit, për çështjen jugosllave dhe për mjaft çështje të tjera, por Hrushovi dredhonte.

Duke qenë antimarksist ai mendonte se ne do të gjunjëzoheshim para veprimeve të tij dhe do të përuleshim para «ndihmave» që na premtonte. Por qëndrimet tona gjithnjë e më të vendosura e bënë Hrushovin të kuptione se ai kurrë nuk do të arrinte të na gjunjëzonte, ndaj shpresonte e thurte plane që me kohë ta likuidonte udhëheqjen e Partisë sonë. Por as këtë nuk mundi ta bëjë.

Në punën e tyre kundër marksizëm-leninizmit revisionistët janë të lidhur me imperializmin. Prandaj lufta kundër revizionizmit është një luftë që nuk do të mbarojë shpejt. Nga ana jonë do të duhet të bëhen përpjekje të mëdha, sepse rryma revizioniste ka zënë vend në shumë udhëheqje të partive komuniste e punëtore dhe se vija e tyre plot demagogji po i shkakton dëme të mëdha partive të tjera, qoftë në vendet e ashtuquajtura socialiste të Evropës, qoftë në vendet kapitaliste. Kjo natyrisht paraqitet në forma të ndryshme, por, sipas mendimit tonë, qëllimi është i njëjtë: likuidimi i partive marksiste-leniniste nën formulën «të zbatojmë marksisti-

zëm-lininizmin në mënyrë krijuese». Kështu, për shembull, Partia Komuniste e Italisë predikon marrjen e pushtetit në rrugë paqësore, me anën e reformave strukturore. Kjo teori revizioniste po përpunohet në të gjitha partitë komuniste e punëtore të Evropës Perëndimore ku janë në krye revizionistët. Kjo tendencë revizioniste ka rrezik të madh të përhapet edhe në vendet e Amerikës Latine. Grupi i Prestesit¹ dhe të tjerë si ai jo vetëm janë në pozitat e Hrushovit, por ata në qëndrimet e tyre tradhtare kanë edhe nxitjen e imperializmit amerikan dhe të borgjezisë së vendit.

Partia juaj është ndër të parat parti që mori guximin marksist-leninist që, (pas shumë vjet përpjekjesh për të korrigjuar revizionistin Prestes e të tjerë dhe për të pastruar partinë nga elementët armiq e tradhtarë), bëri shkëputjen nga partia revizioniste e Prestesit dhe krijoi partinë e re revolucionare. Ne e kuptojmë se sa rëndësi të madhe ka ky veprim për partinë tuaj dhe përlëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Ju e shikoni këtë edhe vetë në punën dhe në luftën tuaj. Ne kemi një admirim të madh përluftën e popullit tuaj dhe të popujve të Amerikës Latine në përgjithësi. Partia juaj është një parti e re, por ne mendojmë se trashëgimtarja e vërtetë e Partisë Komuniste të Brazilit është pikërisht partia juaj. Ne e kemi ndjekur luftën tuaj me aq sa kemi mundur, po tanë, me ardhjen tuaj këtu, ne e njobëm atë edhe më mirë. Ne e vlerësojmë shumë luftën tuaj dhe e konsiderojmë atë një

1 L. K. Prestes — Sekretar i Përgjithshëm i PK revizioniste të Brazilit.

ndihmë për Partinë tonë. Ne mendojmë dhe themi singjerisht se lufta dhe qëndrimet tuaja janë të drejta, marksiste-leniniste.

Natyrisht ju keni përpara një luftë shumë të madhe e të ashpër, e cila do të kërkojë përpjekje të gjith-anshme e sakrifica të shumta. Por, sa më e madhe dhe konsekuente të jetë lufta, e mbështetur në parimet e marksizëm-leninizmit, aq më trima e të pamposhtur bëhen komunistët. Prandaj e gjithë lëvizja komuniste ndërkontaktare duhet të bëjë përpjekje të mëdha për të ndihmuar luftën tuaj. Komiteti Qendror i Partisë sonë mendon se në Brazil veprojnë marksistë-leninistë të vendosur, të cilët kanë dalë nga gjiri i popullit. Ne nuk e dimë me hollësi historinë e Brazilit, po ne dimë një gjë, që populli brazilian, ashtu sikurse populli shqiptar, ka vuajtur me shekuj nga kolonizatorët e huaj dhe nga borgjezia reaksionare e latifondistët vendës. Gjithë lufta e popullit tuaj ka qenë një luftë e vazhdueshme e klasës punëtore dhe e fshatarësisë kundër ndërhyrjes së huaj dhe reaksiونit të brendshëm.

Partia jonë mendon se çështja e fshatarësisë si në të kaluarën edhe në të tashmen ka rëndësi të madhe. Sa drejt e shikon këtë çështje partia juaj dhe sa anti-marksiste është pikëpamja e Prestesit. Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, që ju përkrahni, është një e vërtetë marksiste-leniniste. Në qoftë se nuk zbatohet drejt kjo aleancë nuk ka revolucion.

Po si ishte te ne gjendja gjatë kohës së luftës? Ne nuk kishim klasë punëtore të zhvilluar. Ajo ishte shumë e vogël në numër dhe në qytete nuk kishte hyrë në luftëra greviste me karakter ekonomik dhe politik në

atë shkallë që ka hyrë partia dhe klasa punëtore e Brazilit. Po ne kishim një fshatarësi revolucionare, luftëtare të paepur. Sikur ne të bënë gabimin që kërkonin trockistët tanë, të cilët na thoshnin se nuk mund ta formonim partinë dhe as të fillonim luftën, për arsy se më parë duhej të krijohej klasa punëtore, që ta futnim këtë në greva e demonstrata dhe pastaj të krijohej partia e të fillonte lufta, ne nuk do të mund të fitonim. Ata predikonin se pushtimi i vendit tonë nga Italia fašiste ishte gjoja një fat i mirë që ndihmonte të krijohej proletariati dhe partia! Por Partia jonë i likuidoi këta trockistë bashkë me teoritë e tyre dhe filloi luftën. Duke forcuar organizativisht e politikisht Partinë, duke u bazuar në pikëpamjet marksiste-leniniste, në ideologjinë e klasës punëtore dhe në aleancë të ngushtë me fshatarësinë, ne ngritëm në këmbë kundër pushtuesit masat e gjera të popullit. Në këtë luftë fshatarësia luajti një rol të madh. Partia e edukoi atë me frymën e klasës punëtore, me ideologjinë, me qëllimet dhe me pikëpamjet marksiste-leniniste të klasës punëtore.

Natyrisht kushtet konkrete të vendit tuaj nuk janë të njëllojta me tonat, por të njëllojta janë mësimet nga të cilat ne udhëhiqemi — parimet e marksizëm-leninizmit. Në Brazil ju keni një klasë punëtore të zhvilluar, po keni edhe një fshatarësi të madhe, që është më pak e zhvilluar se klasa punëtore, por që nuk qëndron pas nga shpirti revolucionar në qoftë se udhëhiqet mirë. Në qoftë se Partia jonë nuk do ta kishte udhëhequr mirë fshatarësinë, atë do të na e kishin tërhequr pas vetes bejlerët, agallarët dhe kulakët. Por politika e drejtë e Partisë, duke e lidhur ngushtë çështjen e çliri-

mit të vendit me zgjidhjen e problemeve jetike të fshatarësisë, bëri që ajo të bashkohej me luftën e klasës punëtore dhe të të gjithë popullit.

Vija juaj, shokë, në lidhje me fshatarësinë është e drejtë dhe do të fitojë. Po ne e dimë se kjo nuk arrihet lehtë dhe në një ditë. Përveç imperialistëve janki, ju keni armiq të betuar borgjezinë reaksionare vendëse si dhe partinë revizioniste, Prestesin me kompani. Por a mundet të thyhen ata? Ata mund të thyhen dhe do të thyhen. Ka shumë shembuj që vërtetojnë se për fitoren e revolucionit një rol të madh luan fshatarësia kur ajo udhëhiqet e edukohet drejt. Në Algjeri, për shembull, fshatarësia mori pjesë aktive në luftën për çlirimin kombëtar. Por Partia Komuniste e Algjerisë qëndroi në qytet, merrej me sindikatat, siç bënte dhe Partia Komuniste e Francës, sepse mendonte se duke qëndruar në qytet do ta merrte fuqinë. Ishin të tjerë ata që i bënë thirrje fshatarësisë, e ngritën në luftë dhe erdhën në fuqi, në vend që klasën punëtore, fshatarësinë dhe krejt masat t'i ngrinte në luftë e t'i udhëhiqte drejt fitores Partia Komuniste. Po a është marksist-leninist ky qëndrim i udhëheqjes së Partisë Komuniste të Algjerisë? Jo. Te ne, siç ju thashë më parë, në vitet e Luftës sonë Nacionalçlirimtare s'kishte një klasë punëtore të madhe, po ajo klasë punëtore e vogël që ishte, i bëri thirrje fshatarësisë të bëhej aleate e fortë me të; pikërisht te fshatarësia ishte pika më e dobët e borgjezisë së vendit dhe e pushtetit, sepse fshatarësia jonë, që gjithmonë është shquar për patriotizmin e saj të lartë, ishte klasa më e vuajtur, s'kishte bukë të hante, vuante nga sundimi i huaj dhe nga shtypja e feudalëve.

Ne shikojmë se taktika e Prestesit me kompani, e Toliatit dhe e Torezit është që të gjithë punën e tyre ta përqendrojnë në qendrat punëtore dhe atje të zhvillojnë pikëpamjet revizioniste. Ndaj me të drejtë ju keni tanë divergjenca me Prestesin, si për shumë çështje të tjera edhe për çështjen e qëndrimit ndaj fshatarësisë.

Ju i dini vetë punët tuaja, por ne mendojmë se lufta juaj për ta ngritur klasën punëtore në revolucion, për ta bashkuar me Partinë Komuniste të Brazilit, për ta hedhur në luftë për kërkesa ekonomike dhe politike, për ta edukuar me frymën e marksizëm-leninizmit, për ta spastruar nga revizionizmi dhe për ta lidhur me fshatarësinë, është e drejtë.

Ne mendojmë se me qëndrimin tuaj, me programin dhe me luftën tuaj, ju do ta shpartalloni vijën e Partisë Komuniste revizioniste të Brazilit dhe do të tërhiqni pas vetes pjesën më të madhe të komunistëve të mirë që ka ajo. Është detyrë themelore e çdo partie marksiste-leniniste që të bëjë për vete masat e gjera punonjëse, veçanërisht klasën punëtore dhe fshatarësinë, t'i bindë ato për drejtësinë e vijës së saj, t'i ruajë nga mashtrimi që mund t'u bëjë reaksiuni, t'i organizojë dhe t'i udhëheqë me zotësi në rrugën e vështirë, por të lavdishme të revolucionit. Partia jonë që me themelimin e saj ishte dhe mbeti e vetmja parti politike në Shqipëri dhe ajo e organizoi Frontin Nacionalçlirimtar. Por edhe reaksiuni u nxitua të krijonte një organizatë të tij me parulla «demokratike». Partia jonë bëri një politikë të drejtë për të mos i lejuar masat të gënjeleshin nga ato parulla e të binin në prehërin e reaktionit. Në bazë të vijës sonë të drejtë, duke u kapur pas disa pikëpamjeve de-

magogjike të krerëve të kësaj organizate reaksionare, ne u thamë atyre: ejani të luftojmë, meqenëse edhe ju thoni se jeni për luftë kundër pushtuesit! Mirëpo, në fakt, ata nuk donin të luftonin. Në këtë mënyrë masat nuk u shkuan pas dhe në këtë organizatë tradhtare mbetën vetëm tradhtarët e popullit tonë, bejlerë, agallarë, tregtarë të mëdhenj e disa të gënjer që u lidhën ngushtë me armikun. Kështu edhe klasa punëtore e Brazilit, me luftën që do të bëni ju, do të shikojë se kush ka të drejtë: partia revisioniste e Prestesit apo Partia Komuniste e Brazilit. Në të vërtetë, vija revolucioniste që ndjek Prestesi, përditë e më tepër po e hedh atë në prehërin e borgjezisë.

Partia jonë ka mbajtur kurdoherë një qëndrim të drejtë e të matur; ajo s'ka pasur frikë kundër elementeve armiq, ajo i ka demaskuar ata pa mëshirë dhe populli e ka kuptuar, ndërsa me patriotët e vërtetë, nacionalistët e ndershëm, ka bërë një politikë të matur. Ka pasur edhe njerëz me pikëpamje përparimtare dhe me influencë te fshatarët tanë patriotë, por që në fillim nuk ishin shumë të qartë rrëth programit të Partisë sonë. Me ta kemi punuar me shumë kujdes, pa bërë lëshime në programin e Partisë. Kështu, për shembull, kemi bashkëpunuar me ta në mënyrë shoqërore në ato pika që ishin dakord me ne, sepse ata nuk ishin për komunizmin, po për një program minimal. Duke bashkëpunuar me ta, duke i sqaruar me kujdes e durim për programin dhe qëllimet e Partisë e të luftës së saj, ata u hodhën në radhët e Frontit Nacionalçlirimtar. Gjatë luftës dhe aksioneve konkrete kundër pushtuese dhe tradhtarëve të vendit ata u bindën akoma më

shumë për drejtësinë e vijës së Partisë, luftuan me trimëri, përqafuan ideologjinë e Partisë dhe shumë prej tyre u pranuan në gjirin e Partisë e u bënë luftëtarë të devotshëm të saj. Ne kemi një shok të nderuar¹, i cili ka qenë nga partizanët më të parë, që ka pasur influencë të madhe në fshatarësinë e krahinës së Tiranës për ndjenjat e tij patriotike, për urrejtjen që kishte ndaj reaksionarëve vendës e pushtuesve të huaj, për mbrojtjen që u bënte njerëzve të thjeshtë të popullit. Ai nuk ishte atëherë komunist dhe thoshte se unë jam e do të jem me ata që do të luftojnë kundër pushtuesit. Kur vajtën shokët tanë dhe i folën se cili ishte programi i Partisë, ai tha se vërtetë unë nuk jam komunist, por jam dakord me vijën e Partisë Komuniste dhe kështu luftoi me trimëri e konsekuencë për çështjen e atdheut, të Partisë e të popullit. Ndaj tij u bënë presione, kurthe e komplate të shumta nga borgjezia, nga kleri, nga tradhtarët e ndryshëm, por ai nuk u lëkund, sepse shikonte vijën e drejtë të Partisë për çlirimin kombëtar dhe shoqëror. Tani ai është rreth 65 vjeç, është një nga komunistët më të mirë dhe zëvendëspresident i Presidiumit të Kuvendit Popullor.

Më poshtë, pasi foli për një varg problemesh që kishin të bënин me lëvizjen komuniste ndërkombëtare, me kontradiktat e ashpra që zhvilloheshin brenda stanit revisionist dhe për rolin e madh të partive dhe të forcave marksiste-leniniste në luftën kundër imperializmit, revisionizmit modern, dhe reaksionit, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

1 Është fjalë për shokun Myslym Peza.

Partia jonë mendon se kur çdo parti dhe çdo komunist i ka të qarta parimet kryesore të marksizëm-leninizmit, çështjen e krijimit të partisë marksiste-leniniste të klasës punëtore dhe të rolit të saj pararojë, të aleançës me fshatarësinë dhe rrëth kësaj aleance grumbullimin e forcave progresive, çështjen e diktaturës së proletariatit, luftën revolucionare, atëherë të gjitha manovrat e imperializmit dhe të armiqve të socializmit dalin përpara syve si pasqyra të qarta dhe kështu partitë komuniste do të dinë të përcaktojnë taktykën e tyre të drejtë, ta zbatojnë këtë dhe të fitojnë. Edhe shoku Stalin, kur na këshillonte ne, na thoshte se s'ka receta se si të silleni në këtë apo në atë situatë, si ta zgjidhni këtë apo atë problem.

Kjo ka rëndësi sepse vetëm komunistët e çdo vendi e dinë më mirë se çdo njeri tjetër situatën e vendit të tyre, ata janë në gjendje pastaj që, mbi bazën e kësaj njohjeje të thellë dhe duke u mbështetur në parimet e marksizëm-leninizmit, të gjejnë edhe ilaçin për zgjidhjen e çdo problemi. Këtu nuk është çështja që të mos bisedojmë në mes shokëve e të mos shkëmbejmë eksperiencën, sepse ne jemi marksistë dhe duhet ta marrim eksperiencën e njëri-tjetrit, po secili duhet të vendosë në bazë të gjendjes konkrete të vendit të vet.

Tani, shokë, kam një propozim, meqenëse erdhi koha e drekës, shkojmë e hamë së bashku dhe atje mund të vazhdojmë të bisedojmë...

Botohet për herë të parë, me shkurtime, sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbajtur në këtë takim që gjendet në AQP

**NJEREZIT E BRUMOSUR NGA PARTIA JONE,
KURRE NUK PËRKULEN, ATA ECIN
KURDOHERË PËRPARA**

*Nga fjala para inxhinierëve dhe teknikëve të naftës
në Qytetin Stalin*

28 maj 1963

Shokë,

Jam shumë i gëzuar që ndodhem sot midis jush! Industria e naftës është një nga sektorët më të rëndësishëm dhe të komplikuar të ekonomisë sonë, por detyrat që i ka caktuar Partia, po i realizon me sukses. Perspektivat e këtij sektori të ekonomisë në vendin tonë janë të mira. Prandaj ne bëjmë kërkime dhe zbulime në fushën e nxjerrjes së naftës dhe, çdo ditë e më shumë, përdorim metoda të reja të shfrytëzimit të saj dhe kjo ka bërë që prodhimi i naftës të rritet vazhdëmisht. Megjithatë, këto metoda ne duhet t'i përvetësojmë akoma më mirë. Kjo, natyrisht, nuk është diçka e lehtë, por jo edhe e pamundur, sepse edhe vendet që nijhen si më të pérparuara në industrinë e naftës kanë kaluar në këtë fazë të rritjes që kalojmë edhe ne. Por në këtë fazë ne shikojmë se akoma nuk i kemi përvetë-

suar të gjitha metodat, se ka edhe gjëra që nuk i dimë dhe që duhet t'i mësojmë e t'i vëmë në zbatim. Pra, inxhinierët, teknikët dhe punonjësit tanë të naftës nuk i kanë përpunuuar akoma të gjitha metodat e përparuara që përdorin vendet e tjera në kërkimin, në zbulimin dhe në shfrytëzimin e naftës, prandaj duhen bërë përpjekje më të mëdha për të mësuar. Të mësuarit ka vështirësitet e veta, por njerëzit e edukuar dhe të brumosur nga Partia janë kurrë nuk përkulen, ata ecin kurdoherë përpara.

Përse e them këtë? Sepse specialistët sovjetikë që ndodheshin në vendin tonë, duke qenë nën ndikimin e udhëheqjes revizioniste sovjetike, na kanë penguar dhe na kanë sabotuar në fushën e naftës.

Ju e dini se për ekonominë tonë nafta ka një rëndësi të madhe. Për këtë qëllim shteti ka investuar dhe do të investojë shuma të tjera akoma më të mëdha, sepse pa naftë nuk mund të përparojë ekonomia. Nga studimet që janë bërë rezulton se në vendin tonë kemi burime të mira nafte. Prandaj, duke ditur rëndësinë dhe perspektivën e saj, ju bie juve barra ta studioni edhe më thellë këtë pasuri të nëntokës dhe të tregoheni shumë të kujdeshshëm edhe në gjërat më të vogla, për të realizuar me sukses detyrën e caktuar nga Kongresi i 4-t i Partisë për zbulimin e fushave të reja të naftës. Them fushat dhe jo shtresat, sepse shtresat ju tani keni filluar t'i zbuloni dhe këto nuk janë të këqija, po të mira, siç është rezultati i një pusi në Patos, i cili, sikurse na thanë shokët, është shpuar në një shtressë të rëndësishme, në shtresën gëlqerore, që na hap perspektiva të mëdha për zhvillimin e naftës, mbasi edhe në vende

të tjera këto shtresa janë naftëmbajtëse. Në vendin tonë kjo rrugë u hap në saje të punës suaj dhe të ekipit gjeologjik, që në punën kërkimore nuk ecën sipas të dhënavës dhe përfundimeve që kishin arritur specialisët sovjetikë. Ky rezultat hap perspektiva jo vetëm për të shfrytëzuar shtresat e tjera gëlqerore, po për të gjetur burimin mëmë, dhe gjatë kësaj rruge ju do të na jepni qindra tonë naftë. Partia ka besim se këtij qëllimi ju do t'ia arrini.

Shumica prej jush që ndodheni këtu, keni mbaruar shkollën e mesme e të lartë dhe kjo është një gjë e mrekullueshme. Duke kryer shkollën ju keni marrë dijenitë e domosdoshme për të ecur përpara, por duhet të keni parasysh se ajo që keni mësuar nuk është e mjaftueshme, prandaj duke punuar duhet të thelloheni e të përvetësoni gjithnjë e më tepër shkencën e zbulimit të vendburimeve të naftës. Vazhdimi i mëtejshëm i studimeve dhe i perfeksionimit nuk duhet të lihet në asnje mënyrë pas dore. Kjo do t'ju hapë perspektiva të gjera dhe do t'ju japë armë të reja. Ne jemi marksistë dhe si të tillë, për çështjet ideologjike, jemi përpjekur që shkencën e marksizëm-leninizmit ta zbatojmë drejt, duke e përvetësuar atë e duke e bërë si gjakun e trupit tonë, prandaj edhe revizionistët nuk mundën dhe nuk do të mundin kurrë ta mashtrojnë Partinë tonë. Kurse përsa i përket shkencës së naftës ju duhet të shfrytëzoni edhe literaturë të huaj. Për këtë ju keni detyrë që të bëni përpjekje të mësoni gjuhë të huaja, në mënyrë që të studioni, pasi përkthimi i literaturës është i vështirë.

Dihet se specialistët sovjetikë na bënë shumë sabo-

time duke vulosur puset me çimento si, për shembull, pusin me perspektivë këtu në Qytetin Stalin. Këto kanë ndodhur se në udhëheqje të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore kanë ardhur në fuqi revisionistët, por te ne atyre s'u eci. Gjëra të tilla po ndodhin tani edhe në vendet e tjera të demokracisë popullore, ku Nikita Hrushovi punon për të vendsur plotësisht diktatin e tij.

Kështu, për shembull, Rumania prodhon 13 milionë tonë naftë në vit dhe kjo është një pasuri e madhe për popullin rumun. Por qëllimi i Hrushovit është që naftën rumune të mos e blejnë vendet e tjera dhe këtë ai u mundua ta realizojë duke i prerë Rumanisë kreditë ekonomike dhe, nga ana tjetër, duke ndaluar vendet e demokracisë popullore të Evropës të blinin naftën e saj. Kjo i ka shkaktuar Rumanisë vështirësi ekonomike.

Partia jonë e ka theksuar me kohë se në mes të revisionistëve s'ka si të ketë unitet. Ajo ishte e bindur se midis tyre me siguri do të ketë përçarje dhe ashtu ndodhi. Kjo çarje s'ka ardhur vetëm për mosmarrëveshjet që ekzistojnë në fushën ekonomike ku Hrushovi kërkon të vendosë diktatin e vet, por ka edhe karakter politik. Në qoftë se revisionistët sovjetikë do të ishin marksistë-leninistë, siç pretendojnë, marrëdhëniet politike dhe ekonomike midis vendeve që sot janë kthyer në revisioniste, do të shkonin në rrugë të drejtë, por për arsyen se mendojnë si kapitalistë dhe si shfrytëzues, ata devijojnë nga parimet edhe në fushën ekonomike, ashtu sikurse në të gjitha fushat e tjera.

Nikita Hrushovi u përpoq t'ia diktonte kushtet e tij edhe Shqipërisë, por nuk ia arriti dot qëllimit, ne pra-

nuam të shtrëngonim rripin, morëm parasysh të gjitha vështirësitetë dhe nuk ramë në grackë. Partia dhe nbarë populli ynë qëndruan dhe u bënë ballë të gjitha presioneve, shantazheve dhe kërcënimeve, sepse çdo gjë e kishim të qartë.

Të gjithë revizionistët, për ndihmën që na jepnin, kishin synime kapitaliste, po ne këtë gjë nuk e lejoni. Para katër vjetësh, kur Çekoslovakia i akordoi vendit tonë një kredi prej 100 milionë rublash, udhëheqësit çekoslovakë na bënë teori të madhe duke na thënë se ne jemi vende socialiste dhe duhet të ndihmojmë njëri-tjetrin, po partia çekoslovake ka si parim të saj që në këto ndihma duhet të ekzistojë leverdia reciproke, pra ku të kenë interes Çekoslovakia dhe Shqipëria.

Çekët kérkonin që ne të nxirrnim lëndën e parë, hekur-nikelin, kurse ata ta përpunonin, domethënë që shqiptarëve t'u binte bretku në punë, kurse ata të siguronin fitimet. Këtë e quanin ata «ndihmë internacionale!» Kjo u bë çështje e madhe. Kur çekët morën vesh që ne filluam të studionim çështjen e ngritjes së metallurgjisë dhe zbuluam rezerva të tjera minerali, atëherë nxituan dhe kérkuan të lidhnim kontrata të tjera për të blerë jo 300 000 tonë mineral në vit, siç kishin kérkuar në fillim, por 600 000 tonë. Kështu e kuptojnë ata bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke! Kurse ne ju përgjigjëm se kjo çshtë çështje tjetër dhe se këtë punë do ta shohim lidhur edhe me perspektivën e metallurgjisë sonë. Për naftën, gjithashtu, kérkonin të mos na jepnin makineri, me qëllim që të mos e përpunonim të gjithë sasinë e saj në vend, por t'ua jepnim bruto e ta

përpunonin ata. Këto qëllime ne i kuptuam me kohë dhe u dhamë përgjigjen e duhur.

Sikurse e ka parashikuar Partia jonë, e vërteta është se atje ku revizionistët sot janë në fuqi, nuk mund të likuidohen me një ose dy vjet, por pas një lufte të gjatë, se armiku nuk i hedh armët shpejt. Lufta jonë dhe e gjithë marksistë-leninistëve do të bëjë që revizionistët të demaskohen dhe të izolohen. Tani ne shikojmë se N. Hrushovi nuk e ka më atë kredi që ka pasur katër-pesë vjet më parë, se ai mbahet duke i kërcënuar me agresion, me gënjeshtra, me poshtërsi të mëdha që kurdis ndaj të gjitha partive të vërteta marksiste-leniniste.

Por vija e tyre tradhtare nuk po u zë vend aty ku duan ata, prandaj bëjnë çmos në këtë drejtim. Rruga tradhtare në të cilën po ecin revizionistët hrushovianë, i ka futur vendet e tyre në një llum e në një kaos nga i cili s'dalin dot. Kështu ndodh në Çekoslovakia ku ekziston një konfuzion i madh. Atje ka korente të ndryshme, ndërhyrje direkte nga revizionistët sovjetikë për të çuar gjer në fund «destalinizimin» dhe për të rehabilituar Slanskin. Në Çekoslovakia në fakt ndodhen tri grupe: i Novotnit, i Shirokit që qëndron në mes, dhe ai i Bacilekut, që ishte ministër i Drejtësisë. Ky i fundit nuk pranonte të akuzohej si përgjegjës për çështjen e Slanskit dhe përgjegjës kryesor quante Novotnin, që i kishte dhënë urdhra për veprim. Prandaj Novotni, për të shpëtuar lëkurën e tij, e përjashtoi Bacilekun nga partia. Kështu në Çekoslovakia gjendja vazhdon të jetë kaotike.

Po kështu paraqitet gjendja në Hungari. Dihet si

Kadari favorizoi kundërrevolucionin në vitin 1956, dhe tani në fakt po e transformon Hungarinë në një vend kapitalist. Me ardhjen e tij në fuqi të gjithë kundërrevolucionarët u lanë të lirë, bile jo vetëm u lanë të lirë, por Komiteti Qendror i Partisë ka marrë vendim që çdo njeri, pavarësisht nga e kaluara e tij dhe fajet që mund të ketë bërë, ka të drejtë të marrë pjesë dhe të vihet gjer në krye të pushtetit. Të gjithë elementët e shëndoshë janë ulur nga përgjegjësitë dhe në vend të tyre janë ngritur në poste elementë liberalë. Politika e jashtme e Kadarit është ajo e Hrushovit, saqë Departamenti i Shtetit të SHBA-së deklaron: «Me kënaqësi të madhe shikojmë që në Hungari situata zhvillohet në rrugën drejt liberalizimit, prandaj ambasada duhet të qëndrojë dhe të dërgojmë atje ambasadorin tonë».

Përsa i përket politikës fetare, Kadari është në ujdi me klerin. Kardinal Minxenti është falur dhe kjo tregon qartë për influencën e madhe që ka atje kisha. Po bëhen tratativa të koordinuara me Gomulkën dhe me N. Hrushovin për shfaqjen e miqësisë ndaj Papës, që gjoja është për paqen, se ai ndryshe nga enciklikat para tij predikon që njerëzit të bëhen më të arsyeshëm dhe të sigurohet paqja kristiane, kurse në fakt kjo do të thotë të futësh opiumin në shpirtërat e njerëzve, të pranosh se bota kështu ka qenë e kështu do të vdesë, që të pasurit të kenë pushtetin dhe të varfërit të mos ngrenë krye. Këtë politikë me disa variante e përkrahin jo vetëm Kadari, Gomulka e Hrushovi, por edhe udhëheqës të Partisë Komuniste të Francës, kur deklarojnë: «Ne e respektojmë Papën që i bën thirrje botës për paqe».

Por çfarëdo që të bëjnë revizionistët, lëvizjes revolucionare, që sa vjen e ngrihet, nuk ia presin dot kurrë hovin e pandalshëm. Hrushovi, i cili me politikën e tij revizioniste u shkaktoi një dëm të madh shumë partive komuniste, të cilat u futën në ilegalitet të thellë ose u përqanë fare, trumbeton se zbaton mësimet e Leninit për të ndihmuar gjoja vendet e pazhvilluara, po me këtë ai ka qëllime të tjera. Ndihma që u jep Hrushovi këtyre vendeve, në fakt ka për qëllim të degjenerojë partitë marksiste-leniniste dhe të minojë fitoret e socializmit, ashtu sikurse ka vepruar Titoja në Jugosllavi. Për të gjitha këto arsyen ne duhet të jemi vigjilentë, të ruajmë unitetin e Partisë, i cili ka një rëndësi të madhe, sepse, po të mos ishim të bashkuar, po të mos kishim një unitet të fortë, në vendin tonë do të ngjiste katastrofa, do të vihej në rrezik ndërtimi i socializmit.

Pra, në këto situata, eksperienca e përditshme e Partisë sonë dhe lufta kundër armiqve na bëjnë të qartë domosdoshmërinë për ta forcuar Partinë edhe më shumë. Uniteti i Partisë duhet të jetë i çeliktë dhe të forcohet vazhdimesht. Gjithashtu, të forcojmë gjithnjë e më shumë lidhjet me masat. Të ngremë nivelin ideologjik të Partisë, sepse kështu ajo do të jetë kurdoherë në lartësinë e detyrës së saj të shenjtë, mbrojtjes së marksizëm-leninizmit. Me punën e saj politike të vazhdueshme Partia ka bërë që i madh e i vogël të kuptojnë nga vjen veprimtaria armiqësore. Lufta që ne zhvillojmë sot kundër revizionizmit modern është një luftë dhëmb për dhëmb. Ne kemi për të bërë akoma luftë të madhe; të ashpër e të gjatë kundër revizionistëve, por

nuk trembemi dhe jemi të sigurt se do t'i bëjmë ballë, mbasi jemi në rrugë të drejtë.

Tani Partia dhe masat punonjëse të vendit tonë janë mobilizuar për të realizuar planet e prodhimit. Në bujqësi, sikurse jeni në dijeni, për shkak të shkatërrimeve nga ujërat gjatë stinës së dimrit, kemi pasur humbje të ndjeshme, por me masat që u morën gjendja u përmirësua. Tani fshatarësia është mobilizuar pëtë marrë prodhime sa më të mira. Në sektorin e industriës punët shkojnë mirë. Me gjithë vështirësitë e krijuara nga revolucionistët, planet po realizohen dhe tejkalojen. Minierat që gjatë dimrit, për shkak të ujërave të shumta, nuk e kishin plotësuar planin e prodhimit, tani po e plotësojnë. Ju e keni tejkaluar planin e naftës dhe me gjetjen e shtresave të reja do ta tejkaloni edhe më shumë.

Ju uroj, shokë, që gjithnjë të keni suksese në punën tuaj!

Botohet për herë të parë, me shkurttime, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

SITUATAT KAPËRCEHEN ME SUKSES NË INTERES TË KOMUNIZMIT, KUR JANË TË QARTE GJITHË PARTIA DHE POPULLI

Nga fjala e mbajtur me kuadrot e rrethit të Beratit

29 maj 1963

Të dashur shokë dhe shoqe,

Me rastin e ardhjes sime në Berat, drejtuesit e komitetit të Partisë të rrethit më propozuan të marr një takim me ju, shokë, për të biseduar lidhur me zhvillimin e gjendjes ndërkombëtare në përgjithësi dhe të lëvizjes komuniste e punëtore.

Eshtë e qartë se për këto çështje jetike, jo vetëm Partia po i gjithë populli ynë është në dijeni. Komiteti Qendror i Partisë ka bërë mjaft mirë që vazhdimesht ka vënë në korent hollësisht Partinë dhe nëpërmjet shtypit të përditshëm edhe masat e gjera të popullit; sepse këto situata nuk mund të kapërcehen me sukses në interes të komunizmit ndërkombëtar, duke i ditur vetëm udhëheqja e Partisë dhe e shtetit, po atëherë kur të jenë të qartë gjithë Partia dhe populli. Kjo ka bërë që vendi ynë të qëndrojë si shkëmb graniti për-

para çdo rreziku e stuhic dhe që në arenën ndërkombe-tare të krijohet një gjendje e favorshme për Partinë e Punës dhe Republikën Popullore të Shqipërisë, duke ngjallur në revolucionarët e popujt e botës simpatinë dhe dashurinë e tyre për Partinë dhe vendin tonë të vogël, që, sado stuhi e turbullira të ngjasin, të mos vihet në rrezik pavarësia e popullit.

Vështirësitë dhe rreziqet në gjendjen ndërkombe-tare vijnë nga imperializmi dhe agjentët e tij, në radhë të parë nga revizionizmi modern, i cili është krahu i djathtë ideologjik i borgjezisë botërore, që ka marrë përsipër të përçajë, të godasë dhe të shkatërrojë komunizmin, partitë marksiste-leniniste dhe të preqatitë terrenin e t'i hapë rrugën imperializmit amerikan për rivendosjen e kapitalizmit në vendet ku ka triumfuar socializmi dhe të forcohet më tپr në vendet ekzistuese kapitaliste. Në këto situata partitë komuniste e punëtore, në radhë të parë, vendet e demokracisë popullore dhe të gjithë komunistët e revolucionarët e botës duhet të luajnë rolin vendimtar kundër qëllimeve të imperializmit dhe të revizionizmit.

Gjatë gjithë kësaj periudhe forcat e kapitalizmit janë dobësuar, kurse forcat e socializmit dhe luftërat e popujve, për t'u çliruar nga imperializmi, kanë ardhur gjithnjë duke u rritur. Të gjitha sukseset e socializmit dhe të luftërave të popujve, për t'u çliruar nga zinxhirët e imperializmit, mbështeten në parimet tona të marksizëm-leninizmit. Popujt që kanë hyrë në rrugën e çlirimt ose që kanë fituar lirinë e tyre, duke shpëtuar nga zgjedha e rëndë e kapitalizmit dhe e imperializmit, në të ardhmen do të luftojnë në një shkallë

edhe më të madhe për të fituar të drejtat demokratike. Nga ana tjetër, fitorja e lirisë kundër imperializmit do të krijojë më vonë një situatë të favorshme edhe për zhvillimin e revolucionit socialist. Kurse N. Hrushovi thotë se ato vende që kanë fituar lirinë, siç është për shembull India, kanë filluar të ndërtojnë socializmin! Kjo nuk është aspak e vërtetë, ky është një mashtrim.

Pra, në një kohë kur kampi socialist po forcohej dhe në botë ekzistonte një gjendje revolucionare, kur imperializmi amerikan dhe aleatët e tij ndodheshin në pozita të vështira e preqatiteshin për luftë, revisionistët modernë dolën për të ndihmuar imperializmin, duke thënë se tani ka ndryshuar koha, se imperialistët nuk janë në gjendje të fillojnë një luftë të re dhe të hedhin botën në zjarr, se nga zhvillimi i forcave të socializmit lufta nuk është e pashmangshme etj., etj.

Është fakt se forcat e socializmit sot janë të fuqishme dhe imperializmi nuk është më në gjendje të sundojë botën, se përpara imperializmit qëndrojnë forca të mëdha që e bëjnë atë të matet shumë përpara se të fillojë një luftë të re, por kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se natyra dhe karakteri i imperializmit kanë ndryshuar, se imperializmi nuk është më agresiv, se ai mund të zbutet, të bindet e të këshillohet, mund të çarmatoset dhe të krijohet «bota pa armë, pa ushtri dhe pa luftëra», siç thonë revisionistët. Këto nuk janë aspak të vërteta. Imperializmi amerikan dhe aleatët e tij s'kanë ndryshuar asgjë, ata do të qëndrojnë agresorë deri në varr; rreziku i luftës së re botërore është dhe vazhdon të shtohet, prandaj marksizëm-leninizmi na ka mësuar që përpara imperializmit duhet të jemi

kurdoherë vigjilentë, të gatshëm, të armatosur. Kjo është garancia absolute e çarmatimit të imperializmit. Ndryshe ne do të pësojmë disfatë.

Në këtë çështje ne ndahemi thellësisht me revisionistët modernë. Ata kërkojnë të vënë popujt në gjumë, të minimizojnë rrezikun e imperializmit dhe të luftës dhe, që ta bëjnë këtë, ata me N. Hrushovin në krye kanë hedhur parullat e bashkekzistencës paqësore dhe të çarmatimit të përgjithshëm, duke i veshur me etiketën e leninizmit. Lenini na mëson se partitë komuniste duhet të zhvillojnë politikën e bashkekzistencës paqësore me shtetet që kanë regjime të ndryshme politike, por kjo në asnjë mënyrë nuk duhet të shuajë luftën ideologjike dhe politike kundër kapitalizmit dhe reaksionit ndërkombëtar, se komunistët dhe popujt duhet të janë të pregetitur dhe kurdoherë të gatshëm për revolucion, domethënë për marrjen e pushtetit. Pra, ato që thonë revisionistët se gjoja bashkekzistenca paqësore është e vetmja politikë që do të zgjidhë të gjitha mosmarrëveshjet midis socializmit dhe kapitalizmit, do të sjellë çlirimin e popujve kolonialë e gjysmëkolonialë dhe se kapitalizmi do të caktojë fondet e tij për të përmirësuar jetesën e këtyre popujve, janë krejtësisht false dhe antimarksiste e antileniniste.

Partitë komuniste dhe punëtore që qëndrojnë në pozita të drejta marksiste-leniniste, dhe partitë e tjera që luftojnë kundër imperializmit e revisionizmit, çështjen e paqes dhc të luftës e kuptojnë drejt. Në qëndrimin që mbahet ndaj çështjes së bashkekzistencës paqësore bëhet edhe ndarja midis marksistë-leninistëve dhe revisionistëve modernë. Të pranosh tezën e bashkekzis-

tencës paqësore të N. Hrushovit do të thotë të ulësh vigjilencën e popujve, të shuash hovin revolucionar dhe luftën e klasës punëtore për përbmbysjen e kapitalizmit dhe marrjen e pushtetit në duart e saj, të mo-hosh revolucionin socialist.

Revisionistët modernë predikojnë rrugën e kalimit paqësor nga kapitalizmi në socializëm, rrugën e reformave strukturore. Duke u mbështetur në tezat e Leninit, Partia jonë dhe partitë e tjera që qëndrojnë në pozita të drejta marksiste-leniniste, nuk ekskludojnë ndonjë rast të rrallë kur borgjezia mund të detyrohet të dorëzohet, por në të vërtetë kjo nuk ka ndodhur gjë më sot dhe vështirë që të ngjasë. Revolucioni është vendimtar për çështjen e pushtetit. Prandaj parulla për marrjen e pushtetit nga ana e proletariatit me anën e rrugës paqësore ose parlamentare është versioni më i përhapur i revisionistëve për të shuar revolucionin, për t'i zgjatur jetën kapitalizmit. Partitë marksiste-leniniste dhe revolucionarët, kudo në botë, duhet të pregetiten për marrjen e pushtetit me anën e forcës. Pregatitja për marrjen e pushtetit me anën e forcës jo vetëm siguron fitoren e revolucionit, por ka avantazhe të mëdha edhe në luftën e popujve për të penguar imperializmin në shpërthimin e luftës. Ndërsa, po të ndiqet rruga tradhtare e N. Hrushovit dhe e Titos, as pushteti nuk mund të merret, as paqja nuk mund të forcohet, përkundrazi klasa punëtore do të çorientohet, do të ulet hovi revolucionar i saj, do të çarmatoset dhe kështu do t'i lihet shteg borgjezisë të infiltrojë në radhët e klasës punëtore për ta shpartalluar atë, pra do të forcohet pushteti i kapitalit.

Çështja e paqes është një problem që preokupon popujt, por, siç thotë Partia jonë, imperializmit paqen duhet t'ia imponosh. Sipas N. Hrushovit, që të mund të rrosh në paqe, duhet të bësh lëshime e sakrifica të një-anshmë në dëm të revolucionit dhe të kampit socialist, pra politika e tij është antimarksiste, pacifiste borgjeze. Marksistët janë për paqen, por kjo sigurohet në radhë të parë duke ngritur popujt në këmbë për ta mbrojtur atë, duke demaskuar vazhdimisht imperializmin dhe natyrën e tij agresive. Ndryshe paqe nuk ka. Paqja fitohet me luftë, me aksione, me përpjekje. Këtu marksistë-leninistët ndahen me revisionistët modernë.

Revisionistët e çdo kohe, që nga Bernshtajni e Kautcki, të njëjtën praktikë kanë ndjekur, dhe revisionistët modernë sot në këtë çështje nuk janë aspak origjinalë. Kur imperializmi po prepatiste kasaphanën e Luftës së Parë Botërore, oportunistët e Internacionales së Dytë e ndihmuant borgjezinë nacionale kundër borgjezisë së vendit tjetër në kurriz të proletariatit dhe të popujve. Kurse tani, në këto momente të vështira për imperializmin, revisionistët modernë lëshojnë parullat e tyre për t'i ardhur në ndihmë imperializmit amerikan. Prandaj lufta kundër revisionizmit modern është detyrë e rëndësishme për popujt dhe për partitë marksiste-leniniste. Në këtë luftë do të fitojnë patjetër partitë marksiste-leniniste, proletariati dhe popujt që hidhen në revolucion. Revolucioni është i pashmangshëm. Në këtë situatë revolucionare për socializmin dhe revolucionin, popujt janë ngritur në këmbë, por kjo nuk do të thotë se rruga është e shtruar më lule dhe se në këtë rrugë nuk do të hasen vështirësi, sepse krimbi i

revizionizmit ka hyrë brenda kampit socialist dhe në partitë komuniste e punëtore, ku po zhvillohet një luf-të e ashpër, në të cilën patjetër do të dalë fitimtar marksizëm-leninizmi.

Partia jonë, e cila është në ballë të luftës kundër revizionizmit modern, qëndron e patrembur, e guxim-shme, e matur dhe shquhet për luftën e saj parimore në mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Pas Partisë Komuniste (bolshevik) të Bashkimit Sovjetik, kur në krye të saj ishte Stalini, Partia jonë e Punës ka qenë e para që u hodh në luftë kundër klikës tradhtare të Titos dhe në këtë luftë ajo nuk i lëshoi armët për asnjë moment. Pas vdekjes së Stalinit, megjithëse revi-zionistët i shkelën me këmbë ato që kishte thënë Stalini, Partia jonë qëndroi deri në fund pa e ulur shpatën kundër revizionizmit titist. Koha vërtetoi se qëndrimi i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik me në krye Stalinin dhe vija e Partisë së Punës të Shqipërisë kundër revizionistëve jugosllavë ishin plotësisht të drejta. Tani vetëm tradhtarët e socializmit e të komunizmit janë bashkuar me klikën e Titos dhe sulmojnë Partinë e Punës për qëndrimin e saj të paepur, kurse marksistë-lenivistët e vërtetë kanë simpati e respekt për të, që e demaskoi klikën tradhtare borgjeze jugosllave në shërbim të imperializmit amerikan.

Tradhtia e Titos është e lidhur edhe me një plan të vjetër të përpunuar nga Çerçilli. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, imperialistët anglezë dhe amerikanë nuk mundën të ndërhynin me armë në Ballkan, por, në ndihmën që gjoja ata i dhanë luftës antifashiste, kishin qëllimet e tyre, të cilat, në saje të luftës nacional-

çlirimtare të popujve, të politikës së drejtë të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të udhëhequr nga J.V. Stalini, dështuan dhe kështu planet e Çërçillit dhe të Ruzveltit nuk u realizuan. Tradhtari Tito në atë kohë hiqej si marksist dhe u desh gjer më 1947—1948 që ai të zbulohet e të demaskohej nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe nga Byroja Informativë e partive komuniste e punëtore. Partia jonë u solidarizua plotësisht me rezolutat e Byrosë Informativë se pse ajo veprimtarinë e revisionistëve jugosllavë e kishët provuar në kurrizin e saj qysh në vitet e Luftës Nacionallirimtare. Qëllimi i imperialistëve anglezë dhe amerikanë ishte që vendet socialiste të Evropës Qendrore e Juglindore të degjeneroheshin, që në to të mëkëmbeshin forcat reaksionare, të rivendosej rendi kapitalist. Klika e Titos filloj ta vërë në zbatim këtë plan të Çërçillit, por ajo u demaskua në saje të largpamësise së Stalinit.

Shumë parti të tjera ranë në grackën e N. Hrushovit dhe ndoqën politikën e tij revisioniste. Plani i Titos ishte që në vendet socialiste të organizonte klikat revisioniste, sikurse veproi me grupet e Koçi Xoxes, Trajçe Kostovit, të Slanskit etj., të cilët, si tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe duke qenë të lidhur me Titon, kërkonin t'i çonin vendet e tyre drejt restaurimit të kapitalizmit. Në luftën konsekutive kundër revisionizmit jugosllav, që rrezikonte jo vetëm pavarësinë e vendit tonë por gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, ne shikojmë pjekurinë e madhe të Partisë sonë.

Në saje të luftës së pandërprerë të marksistë-leni-

nistëve, revizionizmi jugosllav pësoi disfatë dhe e tregoi veten se cili ishte, ai u lidh politikisht, ideologjikisht dhe ushtarakisht me imperializmin dhë u bë një mjet i fuqishëm për propagandën e tij. Kurse tani propaganda e imperializmit ka zënë vend edhe në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe në disa parti të tjera të Evropës.

Klikat revizioniste s'janë gjë tjetër veçse ndihmëse të imperializmit për të shkatërruar socializmin dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Në qoftë se partitë e vërteta komuniste dhe revolucionarët kudo në botë nuk do t'i demaskojnë revizionistët modernë, këta do të fitojnë terren. Kjo nuk duhet lejuar kurrë, prandaj kundër revizionistëve duhet të luftojmë patjetër me vendosmëri.

Tre vjet kanë kaluar që nga Mbledhja e Bukureshit dhe tani ndonjë udhëheqës partie ngrihet e na thotë neve dhe shokëve kinezë që duhet ta kuptojmë, se në Mbledhjen e Bukureshit revizionistët sovjetikë e kishin imponuar me forcë të bënte atë që u bë, se në fillim kishte refuzuar, po, meqë e kërcënuan aq sa nuk mundi të qëndrojë, më në fund u bashkua me ta.

Në gjirin e vetë partive revizioniste po zhvillohet procesi i paevitueshëm i shthurrjes. Në radhët e atyre që ndjekin grupin e N. Hrushovit ekzistonjë kontradikta të thella, gjë që është në favor të marksizëm-leninizmit dhe në disfavor të Hrushovit. Ekzistenca e këtyre kontradiktave e ka burimin në forcën e marksizëm-leninizmit dhe në luftën që zhvillojnë partitë tona marksiste-leniniste kundër revizionizmit modern.

Politika që ndjek N. Hrushovi ka për qëllim të for-

cojë pozitat e klikave revizioniste në partitë komuniste e punëtore të vendeve të demokracisë populllore dhe vendeve kapitaliste të Evropës e kudo. Pra, atë plan që kishte Titoja para vitit 1948 ka tani edhe Hrushovi, për të sjellë në krye të partive komuniste e punëtore klikat revizioniste që e përkrahin. Kështu në Poloni është në fuqi grupei i Gomulkës, i cili, siç e dini, është një revizionist me damkë, por që ka kontradikta me Hrushovin dhe hedh vicka kundër tij. Gomulka është i afërt në ideologji me Titon e me Hrushovin, por në të njëjtën kohë mban lidhje me imperialistët, nga të cilët ka marrë edhe 600 milionë dollarë kredi, përpinqet të bjerë në ujdi me klerin katolik etj. Pra grupei revisionist polak, me në krye Gomulkën, përpinqet taçojë Poloninë në rrugën e kapitalizmit, por do që të mos jetë nën diktatin e Hrushovit, të cilit i thotë: «Mos u trego gjaknxehtë se unë kam edhe aleatë të tjerë nga Perëndimi».

Në të vërtetë në udhëheqje të partisë polake është Gomulka, por brendapërbrenda partia është çorbë. Ekzistenca e 2-3 a më shumë grupeve tregon se partia polake është kthyer në një parti socialdemokrate, e cila ka centristët, krahan e majtë dhe të djathtë. Vendimet në udhëheqjen e partisë nuk merren me unanimitet, po sipas interesave të grupeve të ndryshme, ku secili përpinqet që në aparatin e partisë të futë sa më shumë elementët e tij.

Ekonomia e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve të tjera revizioniste po kalon kriza të thella. Prandaj grupei i N. Hrushovit kërkon që këtë situatë ta kapërcejë duke bërë një propagandë të poshtër kundër Shqipërisë

dhe duke u shtrënguar rripat vendeve të tjera revizioniste, duke i bërë ato gjithnjë e më të varura nga Bashkimi Sovjetik.

Nëpërmjet Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke, N. Hrushovi i detyron vendet anëtare që të zhvillojnë ekonominë e tyre në ato drejtime që i interesojnë Bashkimit Sovjetik. Ai ka hedhur parullën se që të shkojnë të gjitha vendet së bashku në komunizëm duhet krijuar komiteti për koordinimin e planeve, i cili nuk është gjë tjetër veçse një qeveri mbi qeverinë e një shteti tjetër, ashtu sikurse deshën të bënin jugosllavët me komisionin e koordinimit në vendin tonë.

Ju kujtohet, shokë, se çfarë donin të bënin revolucionistët jugosllavë në vendin tonë. Ata na thoshin: «Ju prodhoni naftë, ndërsa uzinat e përpunimit i kemi ne në Jugosllavi, dhe prej andej, ua sjellim vajgurin të gatshëm. Po kështu: «Grurë e misër ju mos mbillni, se e prodhojmë në Jugosllavi, po mbillni pambuk, për të cilin ka nevojë industria jonë! Për të lehtësuar marrëdhëniet midis dy vendeve duhet të barazojmë monedhat, të heqim doganat, të hapim kufirin» etj., etj. Të njëjtën gjë bëjnë edhe revolucionistët sovjetikë. Disa vendeve u thonë të zhvillojnë industrinë dhe disa të tjerave të mbjellin kastraveca e domate.

Një punë e gjerë armiqësore bëhet në vendet ku sundojnë klikat revolucioniste nëpërmjet propagandës dhe shthurjes ideologjike. Në Bashkimin Sovjetik kanë filluar të shfaqen filma që të revoltojnë kur sheh se sitallen me popullin e tyre, ku shihen skena të luftës dhe gratë duken në stacionet e trenave të çorientuara e të llahtarisura. Ç'duan të tregojnë me këtë? Që popu-

Illi sovjetik ka qenë i frikshëm gjatë Luftës së Madhe Patriotike? Po gjithë bota e di se si luftuan e qëndruan popujt sovjetikë. Kësaj i thonë të harrosh e të shkclësh mbi gjakun e atyre miliona luftëtarëve që dhanë jetën për mbrojtjen e fitoreve të Revolucionit të Totorit e të socializmit. Vetë gazeta «Pravda» shkruan për vjedhjet e shumta që bëhen në Bashkimin Sovjetik. Dje radioja njoftonte se ishte zbuluar që zëvendësministri i parë i Tregtisë i Ukrainës ishte kusar, se prokurori merrte ryshfete për të liruar të burgosurit e të tjera gjëra, të cilat tregojnë se ku ka arritur degjenerimi i këtyre njerëzve që grabitin shtetin e tyre dhe vazhdojnë akoma të mbajnë poste me përgjegjësi. Partia jonë elementëve të këqij dhe armiq, të cilët kanë mundur të depërtojnë në radhët tona, ua ka treguar vendin menjëherë.

Grupi i Hrushovit përpinqet të gjejë në Bashkimin Sovjetik mbështetjen e tij në shtresën e re të nëpunësve, kolkozianëve dhe intelektualëve të pasur që marrin shpërblime të mëdha në rubla. Në këtë drejtim klika hrushoviane ecën në rrugën e Titos, në pamje me forma disi të ndryshme, por që në realitet janë të njëjta.

Imperializmi amerikan nuk ia ka dhënë Titos dollarët pa interes. Nuk mundet që kapitalistët të investojnë diku pa u sigruar se do të nxjerrin fitime të mira. Titoja është bërë agjenti më i kualifikuar i imperializmit amerikan në drejtim të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore të Evropës. Ai përpinqet që kudo të ketë njerëzit e tij për t'i shërbyer më mirë imperializmit amerikan. Hrushovi deklaron se «Jugosllavia ndërton socializmin», se Titoja dhe shokët

e tij «po njohin gabimet». Dhe këto u theksuan edhe një herë në kongresin e Partisë Socialiste të Bashkuar të Gjermanisë.

Situata po zhvillohet në favorin tonë. Vija e drejtë e Partisë sonë po përkrahet gjithnjë e më shumë nga revolucionarët e vërtetë. Kudo kanë simpati dhe dashuri të madhe për Partinë e Punës të Shqipërisë. Grupe komunistësh, revolucionarësh e demokratësh progresistë flasin me respekt për qëndrimin e drejtë të Partisë sonë. Neve na vijnë plot letra, revista, trakte e peticione që tregojnë influencën e vijës dhe të qëndrimit të drejtë të Partisë sonë. Në fakt propaganda e Partisë sonë për botën e jashtme ka qenë e paktë, po grupet dhe njerëzit revolucionarë i përhapin vetë materialt tona.

Tani, sikurse jeni në dijeni, revisionistët po mundohen të preqatitin terrenin për një mbledhje ndërkomëtare të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore. Në këtë mbledhje, në qoftë se do të bëhet, vetëm luftë do të ketë dhe asgjë tjetër. Partia jonë mund të shkojë në mbledhje vetëm në qoftë se më parë N. Hrushovi do të pranojë botërisht që ka gabuar kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, në qoftë se ai nuk e bën këtë, atëherë ne nuk kemi përsë të shkojmë atje. Çështja e Shqipërisë nuk është një gjë e veçantë, por e lidhur ngushtë me zbatimin e parimeve të marksizëm-leninizmit. Partia jonë kërkon që Hrushovi të pranojë hapur gabimet që ka bërë kundër Shqipërisë, sepse kjo ka rëndësi të madhe parimore. N. Hrushovi duhet të shpjegojë përsë e sulmoi i pari Partinë e Punës të Shqipërisë, përsë

tha se udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë është e shitur tek imperializmi, përse i preu marrëdhëniet diplomatike me Republikën Popullore të Shqipërisë, përse mbajti qëndrim armiqësor ndaj një vendi socialist etj. Mirëpo këto gabime N. Hrushovi nuk mund t'i pranojë, sepse, po t'i pranojë, e di që do t'i vijë fundi. Prandaj kërkon ta izolojë Shqipërinë, ndërsa në fakt ai po shkon duke u izoluar vetë.

Situata, shokë, do të vijë vazhdimisht duke u përmirësuar në favor të marksizëm-leninizmit. Partia jonë do të qëndrojë kurdoherë e patundur në luftën kundër revizionizmit modern dhe me siguri do të fitojë. Autoriteti i Shqipërisë sot në arenën ndërkombëtare është rritur.

Detyra jonë, shokë, është që të mbajmë vazhdimisht gjallë fryshtë revolucionare dhe ta shpiem gjer në fund luftën kundër revizionizmit modern. Të luftojmë për të realizuar planet ekonomike dhe t'i japim popullit atë që kërkon. Këtë vit bujqësia paraqitet e mirë, pse, me gjithë vështirësitë e kohës, fshatarësia është ngritur në këmbë dhe është mobilizuar si jo më mirë.

Këtu në Berat pashë që është bërë një punë shumë e mirë me krijimin e bllokut të fiqve; ajo është një punë e bukur dhe e dobishme për të cilën Partia ju përgëzon dhe ju uron të vazhdoni më tej jo vetëm duke mbjellë, por edhe duke u kujdesur që ato të futen sa më parë në prodhim, për të rikuperuar investimet e bëra dhe që fiqtë e Beratit të bëhen të njojur edhe jashtë.

Në qytetin tuaj do të zhvillohet edhe industria që do t'ju sjellë shumë të mira. Sikurse e dini, këtu, së

afërmi, do të ngrihet një kombinat tekstili madhështor dhe pranë tij do të ndërtohet një lagje e re e veçantë, prandaj ju, beratasit dhe berataset, duhet të luftoni sa më shumë që të plotësoni nevojat e kombinatit me fuqi punëtore. Partia do të jetë shumë e gjëzuar që vajzat e Beratit të bëhen tekstiliste të këtij kombinati, megjithëse edhe nga rrëthet e tjera do të vijnë për të punuar këtu. Në qoftë se ju do ta bëni këtë, Partia do t'ju përgëzojë, prandaj vajzat tuaja duhet të ndjekin shkollën dhe të mësojnë. Për këtë qëllim organet e Partisë dhe të pushtetit duhet të luftojnë kundër paragjykimeve të disa prindërve që nuk i dërgojnë vajzat e tyre që të mësojnë dhe të punojnë.

Plotësimi i detyrave të planit pesëvjeçar, që do t'i sjellë popullit të mira të tjera materiale, kërkon që së bashku me burrat të punojnë edhe vajzat e gratë. Partia këtu duhet të luftojë tendencën e gabuar të disave që kërkojnë të gjejnë vende të rehatshme; ata njerëz që kanë mundësi të punojnë gjetkë duhet të largohen nga zyrat, nga punët burokratike dhe t'ua lënë këto grave dhe atyre që janë të kaluar nga mosha, kurse të rinjtë e të rejet që kanë plot energji të venë atje ku ka më tepër perspektivë.

Një detyrë tjetër që ju duhet të keni parasysh është mësimi në shkollë. Ju duhet të luftoni dhe të bëni një punë më të organizuar që vajzat e gratë të mësojnë, të ndjekin shkollat, sepse, megjithëse numri i atyre që marrin pjesë në punë është shtuar e rritet vazhdimesht, niveli arsimor është akoma i ulët. Nga ana tjetër, të punohet që ato të ngrihen edhe nga ana profesionale kudo ku punojnë.

Muzeumi që keni në qytet po zbukurohet. Nga vizita që bëra pashë se në muzeum janë grumbulluar mjaft materiale të mira që flasin për kohën e lashtë, të cilat duhet t'i ruajmë, sepse brezat tanë të ardhshëm do të kënaqen shumë dhe do të na falënderojnë që këto sende i kemi mirëmbajtur. Këto do të ngjallin tek ata dashurinë e madhe për vendin tonë. Por, nga ana tjetër, ne duhet të përpinqemi që të mos biem në pozita «të së-mura» që çdo gjë të vjetër ta ruajmë.

Shokë, nuk po zgjatem më. Ju uroj shëndet dhe suksese edhe më të mëdha në punën tuaj!

Të rrojë Partia!

Botohet për herë të parë, me shkurttime, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 24-t

V—VIII

1962

GËZIM I MADH PËR POPULLIN SHQIPTAR QË
FESTON SOT DY NGJARJE TË MËDHA — Fjala e
hapjes në mbledhjen e përbashkët të Byrosë Politike të
KQ të PPSH, të Presidiumit të Kuvendit Popullor të
RPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH, mbaj-
tur në Vlorë me rastin e 50-vjetorit të Shpalljes së
Pavarësisë dhe 18-vjetorit të Çlirimit të Atdheut
(26 nëntor 1962)

1—5

FRYTET E 28 E TË 29 NËNTORIT T'I GËZOJNË
NË SHEKUJ NIPËRIT E STËRNIPËRIT TANË —
Fjala në pritjen e dhënë në Vlorë me rastin e 50-vje-
torit të Shpalljes së Pavarësisë dhe të 18-vjetorit të
Çlirimit të Atdheut (29 Nëntor 1962)

6—29

VËREJTJE MBI TEZAT E KONGRESIT TË 10-të TË
PARTISË KOMUNISTE TË ITALISË (Nëntor 1962)

30—46

NAFTA PËR NE ËSHTË NJË ÇËSHTJE ME SHUMË
RËNDËSI — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH (10 dhjetor 1962)

47—50

VEPRAT E BREZIT TONE DO TË DUKEN TË
VOGLA PËRPARA ATYRE QË DO TË BEJNE BRE-
ZAT E ARDHSHËM — Nga fjala para nxënësve dhe
mësuesve të gjimnazit të Shkodrës me rastin e 40-vje-
torit të tij (16 dhjetor 1962)

51—62

FSHATARËSINË TA MËSOJMË TË DREJTOJË EKO-
NOMINË E MADHE KOLEKTIVE QË TË ARRJË

NJË ZHVILLIM TË LARTË TË BUJQËSISË — Fjala në aktivin e Partisë të rrëthit të Shkodrës (17 dhjetor 1962)	63—103
TEATRI ËSHTË NJË NGA MJETET E EDUKIMIT TË MASAVE — Nga biseda me disa punonjës të artit e të kulturës të Shkodrës (18 dhjetor 1962)	104—112
ZGJONI TE STUDENTËT DASHURINË DHE VULL-NETIN PËR PUNË KRIJUESE — Nga fjala me pedagogët dhe studentët e Institutit Pedagogjik Dvjeçar të Shkodrës (18 dhjetor 1962)	113—116
PUNËTORET TË BËHEN NË RADHË TË PARË SPECIALISTË NË PROFESIONIN E TYRE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 dhjetor 1962)	117—122
NJEREZIT E DREJTËSISË DUHET TË KENE CILËSI TË LARTA POLITIKE DHE MORALE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 dhjetor 1962)	123—127
NË PORTIN E DURRËSIT TË PUNOHET VAZHDIMISHT PËR EDUKIMIN E KUADRIT E TË PUNËTORËVE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 dhjetor 1962)	128—132

1963

TELEGRAM DËRGUAR NDËRTUESVE TË HIDRO-CENTRALIT TË BISTRICËS (21 janar 1963)	133—134
TË FUTIM KULTUREN SOCIALISTE NË ÇDO FA-MILJE TË FSHATIT TONË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 janar 1963)	135—141
GRATË DUHET TË FITOJNË E TË RRITIN PERSONALITETIN E TYRE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 janar 1963)	142—151
DUKE REALIZUAR PLANET, NE FORCOJMË RE-	

PUBLIKËN TONË — Nga fjala e mbylljes në Plenumin e 9-të të KQ të PPSH (26 janar 1963)	152—179
ORGANIZATA E PARTISË NË USHTRI DUHET TË JETË NJË BERTHAMË E ÇELIKTË — Nga fjala e mbajtur në Durrës në mbledhjen vjetore të kuadrove të Ushtrisë sonë Popullore (5 shkurt 1963)	180—212
NGA KONFERENCAT E PARTISË, PËR DHËNIE LLOGARI E ZGJEDHJE, KOMUNISTËT DALIN ME FORCA TË REJA PËR TË PUNUAR EDHE MË MIRE NË TË ARDHMEN — Nga fjala në Konferencën e Partisë të rrëthit të Lushnjës (10 shkurt 1963)	213—248
MENDJA DHE DORA E NJERËZVE TANË DO TA BEJNË FUSHËN E MYZEQESE ËDHE MË TË BUKUR E MË PJELLORE — Fjala para kooperativistëve të Bishqethmit në rrëthin e Lushnjës (11 shkurt 1963)	249—266
TRAKTORISTËT JANË REPARTI PARAROJË I KLASËS PUNËTORE NË BUJQËSI — Nga fjala para kollektivit punonjës të SMT-së së Lushnjës (11 shkurt 1963)	267—280
STUDIMET KUR VIHEN NË JETË, KTUEHEN NË VLERË MATERIALE PËR TË MIRËN E POPULLIT — Nga fjala me kuadrot bujqësorë të rrëthit dhe me punonjësit e Stacionit Eksperimental Bujqësor të Lushnjës (11 shkurt 1963)	281—293
E VËRTETA DO TË DALË, ASAJ S'MUND T'I VËSH GARDHE — Nga biseda me përfaqësuesin e një partie marksiste-leniniste (2 mars 1963)	294—301
PROPAGANDA E ORGANIZUAR E PARTISË BËN QË LIGJET TË ZBATOHEN DREJT — Fjala e mbajtur në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (5 mars 1963)	302—306
TË FORCOJMË PËRBËRJEN E PARTISË NË BAZË TË NJË STUDIMI SHKENCOR — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 mars 1963)	307—316

LËVIZJET E SHUMTA TË ARSIMITARËVE JANE NË DËM TË SHKOLLËS — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 mars 1963)	317—319
PUNA E SHOQATËS SË KRYQIT TË KUQ TË PËRQENDROHET MË TEPËR ATJE KU MUNGOJNË FORCAT E ORGANeve TË SHËNDETËSISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 mars 1963)	320—324
ARMA E SIGURIMIT ëSHTË DORA E ÇELIKTË E POPULLIT QË NDËRTON SOCIALIZMIN — Mësazh drejtar organeve të Sigurimit të Shtetit me rastin e 20-vjetorit të krijimit të tyre (19 mars 1963)	325—329
GAZETA «BASHKIMI» SI AGJITATORE DHE PROPAGANDISTE ëSHTË GJITHMONË NJË GAZETË E DASHUR PËR POPULLIN — Përsyhëndetje drejtar kolektivit të gazetës «Bashkimi» (25 mars 1963)	330—332
KONFERENCAT E PARTISE NË RRETJE TË JENË KURDOHERË MBLEDHJE PUNE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (8 prill 1963)	333—337
RRETHI I KORÇËS I KA TË GJITHA MUNDËSITË QË TË ARRIJË REZULTATE MË TË MËDHA NË PUNË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (8 prill 1963)	338—340
N. HRUSHOVI PËRSËRI NË ROLIN E DEMAGO-GUT, SHPIFËSIT DHE PËRCARËSIT — Nga artikulli i botuar në gazeten «Zëri i popullit» (18 prill 1963)	341—346
MUZIKA DHE KËNGËT KANË RËNDËSI TË MADHE, T'I VLERËSOJMË DHE TI INKURAOJMË DREJT ATO — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (10 maj 1963)	387—393
T'U PRITET RRUGA TË METAVE NË SEKTORIN E BLEGTORISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (10 maj 1963)	394—399

«KALI I TROJËS» VAZHDON VEPRIMTARINË E TIJ NË SHËRBIM TË IMPERIALIZMIT AMERIKAN — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (12 maj 1963)	400—415
VËSHTIRËSITË NE NUK NA TREMBIN, PËRKUNDRAZI ATO NA KALITIN — Bisedë në takimin me delegacionin e Federatës Pankineze të Bashkimeve Profesionale (13 maj 1963)	416—422
PO S'E PREGATITE POPULLIN PËR RRUGËN E REVOLUCIONIT NUK FITOHET LIRIA — Nga biseda në takimin me një delegacion të Qendrës së Punonjësve të Kubës (13 maj 1963)	423—427
SOT TË GJITHA TË MIRAT QË BËN POPULLI ME PUNËN E TIJ, I GËZON VETË — Takim me shqiptarin Sadik Bleta, anëtar i kryesisë së shoqërise «Skënderbeu» të kolonisë shqiptare në Argjentinë (18 maj 1963)	428—436
JU KENI PËRPARA NJË LUFTË TË MADHE, POR SA MË E MADHE TË JETË LUFTA, AQ MË TRIMA E TË PAMPOSHTUR BËHEN KOMUNISTËT — Nga biseda me një delegacion të Partisë Komuniste të Brazilit të kryesuar nga shoku Pedro Pomar (21 maj 1963)	437—449
NJERËZIT E BRUMOSUR NGA PARTIA JONË, KURRË NUK PËRKULEN, ATA ECIN KURDOHERË PËRPARA — Nga fjala para inxhinierëve dhe teknikëve të naftës në Qytetin Stalin (28 maj 1963)	450—458
SITUATAT KAPËRCEHEN ME SUKSES NË INTERES TË KOMUNIZMIT, KUR JANË TË QARTË GJITHË PARTIA DHE POPULLI — Nga fjala e mbajtur me kuadrot e rrëthit të Beratit (29 maj 1963)	459—474